

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

SHKODËR, 2018

UDHËTIMI I PËRJETËSISË

-Vdekja, Varri, Kiameti dhe Jeta e përtejme -

Osman Nuri Topbash

TITULLI ORIGINAL

Ebediyet Yolculuğu

PËRKTHEU

Ilir Hoxha

DREJTOR

Albert Halili

REDAKTOR

Zija Vukaj

Alban Kali

DIZAJN

Bledar Xama

BOTIMI I

Maj 2018, Shkodër

ISBN

ISBN: 978-992-82-0722-7



9 789928 207227

PROGRESI BOTIME

Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti

Shkodër, Shqipëri

Mob: +355 67 340 6182

www.progresibotime.com

 Progresi Botime



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

-Vdekja, Varri, Kiameti dhe Jeta e përtejme -

OSMAN NURI TOPBASH



PREZANTIM

Besimi në botën tjetër, është një nga pjesët themelore të kushteve të besimit Islam.

Ne kemi ardhur në këtë botë, ku do të qëndrojmë për njëfarë kohe dhe të gjithë së bashku me kalimin në Ahiret (botën tjetër) do të fillojmë udhëtimin e përjetësisë.

Ekziston një jetë e pafundme, e cila lidhet shumë me këtë botë. Prandaj është e domosdoshme që ta kuptojmë ashtu siç duhet edhe këtë botë, edhe udhëtimin e përjetësisë...

Të gjitha këto njohuri përfshihen në Librin që Fuqia Madhështore ka dërguar për njerëzimin. Ajo Fuqi ka organizuar ekuilibrin midis kësaj bote dhe tjetrës. Këto njohuri gjenden edhe në fjalët e Udhëzuesit të Bekuar, i cili ia ka përcjellë njerëzimit Librin. Fjalët e tij janë cilësuar nga Krijuesi i Madhëruar si:

﴿٤﴾ وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ﴿٣﴾ إِنَّ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ﴿٤﴾

“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.” (Nexhm, 3-4)

Detyra jonë është që këtë **“Udhëtim të përjetësisë”** ta kuptojmë siç duhet prej Kuranit Fisnik dhe mesazheve të të Dërguarit të Allahut ﷺ, dhe të përpiqemi që dosja e jetës sonë, që do t'i paraqitet Zotit, të ketë cilësi që të na nderojnë.

Libri që keni në duar, është punë e çmuar e hoxhës së nderuar Osman Nuri Topbash dhe na prezanton me të gjitha fazat e **“Udhëtimit të përjetësisë”**.

Ardhja në këtë botë, qëllimi i ardhjes në këtë botë, jeta e kësaj bote, vdekja, Kiameti, varri, Mahsheri¹, Mahkeme-i kubra², Mizan/Peshorja, Ura e Siratit, Xhehenemi, Xheneti dhe jeta e pafundme... Lumturia ose dështimi i pafundëm...

1. Mahsher: Vendi apo sheshi ku do të mblidhen njerëzit pas ringjalljes në ditën e Kiametit.
2. Mahkeme-i Kubra: Gjyqi i madh i cili do të ngrihet në ditën e gjykimit, ku do të gjykohet i gjithë njerëzimi.

Kur shohim këtë radhitje, themi menjëherë se disa prej këtyre fazave i kemi hasur dhe i njohim, e disa të tjera nuk i kemi hasur ende. Pra, po flasim për ato faza dhe ndodhi që nuk mund të perceptohen brenda kufijve të kësaj bote...

Pyetjeve të tipit, **“Si do të ringjallemi pasi kockat tona të jenë bërë pluhur?”**, Kurani Fisnik u përgjigjet duke sqaruar: **“Ashtu siç jeni krijuar herën e parë. A është më e vështirë të krijosh nga e para, apo për herë të dytë?”**

Duke pasur parasysh mundësitë e Allahut të Madhëruar, kuptojmë se për Të asgjë nuk është e pamundur. Edhe krijimi, edhe Kiameti janë mrekulli... Të tilla janë edhe formimi i njeriut nga një pikë uji, edhe palosja e qiejve, edhe lëvizja e maleve (ditën e Kiametit)...

Në mendjet tona, koncepti i mrekullisë lidhet direkt me pamundësitë njerëzore. Ndërkaq, është pamundur të mendosh se ekziston diçka e vështirë për Allahun e Madhëruar.

Ne mund të kuptojmë shumë shpërfaqje, por një pjesë të tyre mbase nuk do të mund t'i kuptojmë dot kurrë. Prej kufizimeve tona në kuptim, na lind pyetja: “Si do të bëhet llogaria e të gjithë njerëzimit që prej fillimit të tij?”. Në fakt, kjo është një pyetje elementare për Allahun.

Mirëpo, duhet të kuptojmë drejtë faktin se jeta jonë në këtë botë shërben si një përgatitje për botën tjetër dhe ne do të japim llogari për çdo gjë që ndodh në këtë botë... e nëse ne neglizhojmë në këtë çështje, në fund na pret dështimi.

Ky libër, pasi na parashtron gjithçka që dihet dhe nuk dihet, na fton drejt vetëdijesimit ndaj një përgjegjësie jetike, duke na thënë: “mos harro se ka botë tjetër... mos harro se do të dalësh para Allahut dhe do të japësh llogari për librin e jetës!”.

PARATHËNIE

Falënderimet dhe lavdet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, i Cili neve, robërit e Tij të dobët, na krijoi nga hiçi, na krijoi si “njerëz”, në pozitën e më të nderuarve, “ahsen-i takuim”, midis të gjitha krijesave dhe na dhuroi udhëzimin në rrugën e drejtë me anët të librave që ka zbritur dhe profetëve që ka dërguar!

Përsëendetjet dhe salavatet e pafundme qofshin për Imamin e profetëve, mëshirën për botët, udhëzuesin tonë më të madh të rrugës së drejtë në këtë botë dhe shpresën tonë për shefat/ndërmjetësim në botën tjetër, Muhamed Mustafain, Ehl-i Bejtin e tij të pastër dhe sahabët e tij të nderuar!

Si natyrë e krijimit të tij, njeriu është i prirur gjithmonë për nga e drejta dhe e vërteta. Për këtë arsye, ai nuk e pranon të panjohurën. Ai gjithmonë kërkon të vërtetën dhe rend pas së njohurës, sepse gjërat që nuk i di dhe nuk do mund t'i dijë, e shkatërrojnë atë shpirtërisht.

Gjatë gjithë historisë, misteri më i madh dhe që më së tepërmi angazhon mendjen njerëzore, është enigma e **“vdekjes”** dhe **“bota tjetër”**. Dhe me të vërtetë, pavarësisht kushteve të tyre të jetesës, njerëzit ndjejnë të njëjtën vuajtje kundrejt vdekjes. Fakti që të gjitha rrugët e jetës së tyre humbasin në horizontin e vdekjes, ua brengos thellësisht zemrat.

Realiteti i **“vdekjes”**, i cili i përfshinë të gjithë si një vorbull më e jash-tëzakonshme dhe më e zjarrtë se mrekullia e **“jetës”**, është ngjarja më e vështirë që do t'i ndodhë, pa përjashtim të gjithëve në këtë botë. Dhe për këtë arsye, njohja e mistereve në lidhje me vdekjen dhe gjithçka që qëndron përtej saj, është prej synimeve më kryesore të njerëzimit.

Jeta është një e vërtetë shumë e lartë, e cila nuk mund të kufizohet në distancën mes djepit dhe varrit. Ndërsa zgjidhja e nyjës së të ardhmes në lidhje me vdekjen dhe gjithçka që gjendet përtej saj, të cilat nuk mund të perceptohen vetëm prej mendjen njerëzore, bën të domosdoshëm kapërcimin e pengesës së egos dhe dëgjimin me gjithë zemër të zërit të Shpalljes.



Arritja e kësaj gjendjeje në mënyrë të përsosur, mundësohet vetëm duke përfitur prej dashurisë dhe pasionit hyjnor që ndodhen në atmosferën e zemrës së profetëve dhe trashëgimtarëve të tyre, që janë dijetarët dhe të dashurit e Zotit.

Mirëpo, pyetjet në lidhje me “**vdekjen**” dhe “**përtej saj**”, që mbështillen si një gjarpër helmues në mendje dhe sa herë që lëvizin e tensionojnë njeriun, është tentuar që në çdo periudhë të shtypen e të burgosen në nënvetëdije nga ideologjitë e devijuara prej atyre që janë larg prej shpalljes dhe udhëzimit të profetëve.

Padyschim se kjo gjendje, është një manifestim i “**psikologjisë së arratisjes**”, të cilën egoja njerëzore, për shkak të indiferencës dhe injorancës së vet, e përdor për të mos u shtypur nën barrën shpirtërore të të vërtetave për të cilat nuk dëshiron të japë llogari. Mirëpo, asnjë e vërtetë nuk asgjësohet duke ikur prej saj apo duke menduar se ajo nuk ekziston.

Nëse njeriu do të mësojë të vërtetën e vdekjes dhe çka gjendet përtej saj, nuk mund të rrugëtojë as nëpër njohuritë njerëzore të turbulluara nga errësira e injorancës, as nëpër filozofitë e çala të përziera me dyshime dhe as nëpër mendime të devijuara që nuk kanë dobi për asgjë. Errësitat e vdekjes nuk mund të ndriçohen nga drita të tilla të shkurtra.

Të tentosh të shëtisësh në luginën e vdekjes dhe të Ahiretit me njohuritë e pjesshme të një mendjeje të mangët, të pafrymëzuar nga shpallja dhe të mbushur me ideologji egoiste, do të thotë ta vësh në rrezik komplet jetën e përjetshme. E gjitha kjo shpjegohet nga fakti se logjikat e sëmura dhe njohuritë njerëzore të privuara nga mbështetja hyjnore në lidhje me udhëtimin e përjetësisë, janë kapitale të dënuara të shkrihen nën hijen tabuteve e të kalben në errësitat e varreve.

Njeriu, që qëndron indiferent ndaj predikimeve hyjnore dhe profetike, endet kot me ngushëllimet boshe të mendimeve njerëzore dhe e mashtron veten duke e pandehur lumturi mjerimin e tij. Mirëpo, ai nuk mund t'i shpëtojë ardhjes së papritur të vdekjes, kapjes në befasi nga Azraili dhe përballjes me surprizat e vështira të jetës së përjetshme. Një jetë e kaluar shkujdesshëm dhe pa shqetësimin më të vogël për botën tjetër, është totalisht një mashtrim i vetes dhe nuk ka asnjë diferencë nga pritshmëria se një dite nuk pasohet nga mbrëmja.

“Të vdesësh nuk është fatkeqësi. Fatkeqësia e vërtetë është të mos dish se çfarë do të të ndodhë pas vdekjes.”

Nisur nga ajo që sqarohet edhe në këtë ajet fisnik:

“...**A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?..**” (Zumer, 9)

Kush di, ndjen edhe shqetësim për botën tjetër.

Kush di, me këtë shqetësim zbaton urdhrin e Zotit të vet.

Kush di, po me këtë shqetësim gjendet në këmbë e në sexhde në kohën para agimit.

Kush di, kapet pas adhurimeve dhe bindjes duke shpresuar në mëshirën e Zotit të vet.

Kush di, vepron me mendje të shëndoshë dhe merr mësim ashtu siç duhet prej lajmeve që Zoti i tij ka sjell në lidhje me botën tjetër.

Në udhëtimin drejt vdekjes e përtej saj, i vetmi pishtar që do të ndriçojë rrugën para nesh, është meditimi dhe vetëdija e mbështetur në shpallje. Për të gjallët, nuk ka ndonjë ndodhi më të rëndësishme se vdekja. Prandaj është e domosdoshme që rëndësia që i jepet asaj në lajmet hyjnore të kuptohet në mënyrën e duhur. Për rrjedhojë, Kurani Fisnik, në lidhje me botën tjetër, për të cilën janë në të njëjtin mendim të gjitha fetë qiellore, është shprehur me fjalët, “**Nebe-i adhim / Lajmi i madh**”³ dhe, e ka shpjeguar atë me shumë argumente logjike, shpirtërore dhe morale.

Zemrat që arrijnë ta perceptojnë siç duhet madhështinë e lajmeve për Ahiretin (Botën tjetër), duke ndjekur zërin e Shpalljes Hyjnore, shpëtojnë nga të mashtruarit prej mirësive kalimtare të kësaj bote. Ato zgjohen nga shkujdesja, e cila i bënte të mendonin se e ardhmja lidhet me iluzionet dhe vegimet e rrejshme, dhe fillojnë përpjekjet për të fituar të ardhmen e vërtetë që është Ahireti. Në fakt, ky është edhe qëllimi për të cilin Allahu i Madhëruar i ka krijuar robërit e Vet dhe iu ka falur mirësitë e kësaj jete të përkohshme. Pra, Allahu i Madhëruar, dëshiron që robërit e Tij t’i jetojnë të vërtetat e Kuranit dhe Sunnetit me frymëzim dhe qetësi shpirtërore dhe të arrijnë lumturinë e përrjetshme.

Nuk duhet harruar se jeta është një mirësi e kufizuar, që na është falur një herë të vetme, me qëllim që të fitojmë lumturinë e Botës tjetër. Po ashtu

3. shih. Nebe’, 2.

edhe sprova e kësaj jete na jepet vetëm me një mundësi, pra as nuk mund të përsëritet e as nuk mund të kompensohet... Nëse dështojmë në një nga provimet e dynjasë, mund të hyjmë përsëri për ta fituar. Madje nëse përsëri nuk e fitojmë as atë, mund ta provojmë sërish njëherë tjetër. Mirëpo, provimi i jetës sonë vlen vetëm njëherë. Pra, vetëm njëherë do të jetojmë, e vetëm njëherë do të vdesim në këtë botë. Nisur nga kjo, çdo njeri me mendje të shëndoshë, duhet që mirësinë e jetës ta përdorë duke marrë parasysh edhe realitetin e **“vdekjes”** dhe **“Ahiretit”**.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“...Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër. (Lumturia e vërtetë, është ajo e botës tjetër!)” (Buhari, Xhihad, 33, Salat, 48, Rikak, 1)

Ndërsa Mevlana i nderuar shprehet:

“A që e di se kjo botë është një arë për Ditën e Gjykimit, mbjell shumë këtu dhe korr shumë atje.”

Pavarësisht këtyre të vërtetave, sistemi kapitalist, materialist dhe liberal i ditëve tona, përpiket t’ia imponojë mendjeve dhe zemrave idenë e një *“bote pa Ahiret”*. Nëpërmjet programeve jo të duhura të televizioneve dhe propagandave të gabuara në internet, njerëzit vetëm po shtyhen drejt një jete egoiste të kufizuar nga nevojat trupore dhe ambiciet e kësaj bote, sikur të ishin në periudhën e injorancës.

Një gjë është e sigurtë - çdo periudhë në të cilën harrohet bota tjetër, është periudhë e injorancës. Ndryshimi i kohës dhe vendit nuk e asgjëson këtë të vërtetë. Nëse analizohen cilësitë e shoqërive injorante, në të cilat janë dërguar më parë profetët, do të vërehet se pothuajse të gjitha janë kapluar nga indiferenca për botën tjetër dhe mohimi i saj. E tillë ishte edhe periudha e injorancës të cilën e eliminoi Islami. Lajmi që i shqetësoi më tepër idhujtarët ishte ringjallja dhe njoftimi se do të jepnin llogari për çdo gjë që kishin vepruar.

Në të njëjtën mënyrë, edhe shoqëria e sotme injorante është zhytur në moçalin e gjynaheve, e mbarsur me iluzionin e një bote pa Ahiret, dhe po rend nga një mizori në një tjetër. Të fuqishmit, të cilët nuk e mendojnë aspak llogarinë hyjnore, prodhojnë mizori të jashtëzakonshme duke shtypur pamëshirë të dobëtit. E gjitha kjo ndodh prejse largimi i njeriut prej të vërtetave hyjnore, shoqërohet njëkohësisht me largim edhe të ndërgjegjes, logjikës, e deri në harrimin e domethënies së termit njeri.

Në ditët tona hasim shumë njerëz të cilëve u është dobësuar besimi, janë kapluar prej filozofive devijuese dhe kanë rënë në kurthin e ateizmit. Kur besimi ndaj botës tjetër e humbet fuqinë në zemra, fiton përparësi edhe animi nga gjithçka e padobishme apo e pavlerë. Pra zemrën, e cila nuk angazhohet me Zotin, e pushton kotësia.

Në këtë pikë, duhet të kontrollojmë shpesh gjendjen tonë, për të vlerësuar se sa e ka përvetësuar zemra jonë besimin në botën tjetër, duke medituar thellësisht dhe duke u përpjekur të vrapojmë drejt përmirësimit.

Elhamdulillah jemi myslimanë! Kushtet e besimit i aprovojmë me zemër dhe i shqiptojmë me gjuhë. Mirëpo, sa e zgjedhim botën tjetër kur testohemi me interesat e kësaj bote? A është zemra jonë mjaftueshëm e fortë kundra virusit të materializmit që është kthyer në një epidemi në kohën tonë? Ne themi se jeta e vërtetë, është ajo e Ahiretit, por sa e marrim për bazë Ahiretin në jetën tonë? Pra, sa përputhet besimi ynë në botën tjetër me jetën që bëjmë në këtë botë?

Është e sigurt se në këtë fundkohë⁴, kemi më shumë nevojë se kurdoherë të kujtojmë e përkujtojmë të vërtetat hyjnore dhe profetike në lidhje me vdekjen, varrin, Kiametin dhe Ahiretin, e të mendojmë shpesh se jeta e vërtetë është ajo e botës tjetër. Mbajtja gjallë, në zemrat tona, e besimit ndaj botës tjetër, luan rolin e një mburoje të fortë që do të na mbrojë nga dhënia e tepërt pas kësaj bote, e për rrjedhojë edhe nga një dënim i dhembshëm.

Të mos harrojmë se, një jetë e pandriçuar me meditimin rreth vdekjes nuk ndryshon aspak nga një natë e errët fatkeqësie. Dielli i lumturisë së përvetshme lind në horizontet e atyre që dinë të jetojnë duke iu përkushtuar me zemër udhëzimit të fjalëve dhe shpalljeve hyjnore dhe emigrojnë në Ahiret me ndërgegje të qetë. Për ata që janë të pavetëdijshëm ndaj Allahut dhe përplasen nga erërat e fatit në shirësen e jetës, nuk qan as bota që lënë pas, e nuk qesh as bota tjetër që i pret përpara.

Qielli mbi ne është po i njëjti qiell që në të shkuarën ka derdhur shkaktërim dhe vuajtje për ata që e kanë mohuar Allahun gjatë gjithë historisë njerëzore. Po ashtu, edhe dielli sipër nesh, është i njëjti diell që dikur ka ndriçuar sarajet e tiranëve si Faraoni, Hamani, Karuni, Nemrudi, etj., e që më pas lindi përsëri me madhështi mbi rrënojat e tyre.

Shkurtimisht, nuk mund të ketë mashtrim dhe dështim më të madh se

4. Fundkohë: Koha afër fundit të botës, Kiametit.

sa të çosh dëm të ardhmen e vërtetë, që është Ahireti, për shkak të lakmive egoiste dhe shqetësimeve për të ardhmen në këtë botë. Allahu i Madhëruar nuk i jep vlerë personit që e harron Ahiretin dhe e robëron zemrën e tij pas kësaj bote, e cila për Allahun nuk ka vlerë as sa krahu i një mize. Ata që e harrojnë Allahun duke u kapluar nga telashet e kësaj bote, do të jenë prej të harruarve nesër, kur të ndahet mëshira hyjnore në botën tjetër.

Nisur nga kjo, nuk duhet të harrojmë kurrë se në këtë botë kemi ardhur për të fituar botën tjetër.

Të nderuar lexues!

Para nesh gjenden shtigje shumë të vështira... **fryma e fundit, varri, Kiameti, ringjallja, Mahsheri, Peshorja dhe Ura e Siratit...**

Në Kuranin Fisnik dhe hadithet profetike gjenden shumë paralajmërime dhe udhëzime në lidhje me këto të vërteta. Kështu që edhe ne po ju prezantojmë këtë vepër modeste, me shpresën që të bëhemi shkak që këto të vërteta të pasqyrohen ashtu siç duhet në mendjen, zemrën dhe përditshmërinë tonë.

Duke përfitur nga rasti, falënderoj Dr. Murat Kaya, Ibrahim Hakki Uzun dhe Mehmet Akif Gunay, të cilët kanë kontribuar në përgatitjen e këtij libri dhe i lutem Zotit që të jetë një sadaka-i xharije për ta.

Zoti ynë na bëftë të gjithëve prej robërve të mirë, që i zgjidhin misteret e vdekjes dhe të Ahiretit në botën e tyre të brendshme me dritën e shpalljes hyjnore dhe që përpiqen të jetojnë me devotshmëri, të zbukurojnë vdekjen dhe ta kthejnë Ahiretin në një lumturi të përjetshme!

Allahu i ruajtë zemrat tona prej dhënies pas jetës së kësaj bote, në të cilën jemi vetëm udhëtarë të përjetësisë!

Po ashtu, Allahu na dhëntë urtësinë dhe mençurinë që të kuptojmë se toka në të cilën shkelim sot, një ditë mund bëhet toka tek e cila do të shkelet mbi ne!

Amin!

**Osman Nuri Topbash
Yskydar**



PJESA I

Udhëtimi i përjetësisë

Vdekja është realiteti i së ardhmes së paevitueshme për çdo të përkohshëm. Të mos harrojmë se, nuk ekziston as vend në të cilin mund të ikim prej vdekjes, as mundësi të kthehemi prej varrit dhe as strehë ku të strehohemi prej tmerrit të Kiametit.

Lum si robërit fatlumë që emigrojnë në atdheun e përjetësisë duke lënë zë të mirë në këtë nënqiell!..

UDHËTIMI I PËRJETËSISË

Është një ligj hyjnor që Allahu i Madhëruar e ka caktuar për çdo gjallesë që ka krijuar: Çdo i lindur jeton afatin kohor që i është caktuar dhe kur të arrijë fundin e këtij afati, do të vdes patjetër. Asnjë gjallesë nuk mund të përjashtohet nga ky ligj. Jeta shkon në formë cikli brenda një rrjedhe përkohshme.

Kjo e vërtetë shprehet në këto ajete fisnike:

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ ﴿٦٢﴾

وَيَبْقَىٰ وَجْهُ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ ﴿٧٢﴾

“Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.”

(Rahman, 26-27)

Kjo botë është krijuar si një vend sprove hyjnore. Në çdo ngjarje që ndodh në të gjenden manifestime të panumërta urtësie. Për rrjedhojë edhe në çdo mirësi apo fatkeqësi që ndodh, gjenden shumë mësimë për ata që mendojnë thellë. Detyra e kësaj bote do të përfundojë me vdekjen e njeriut të fundit që do të jetojë mbi tokë, e më pas do të shkatërrohet. Pas kësaj, me vullnetin e Allahut të Madhëruar, do të fillojë një rregull i ri dhe një tjetër lloj jete.

Kjo gjithësi, e cila është pasqyrë e shfaqjes së qëllimeve dhe urtësive të pafundme, është një shkollë e madhe hyjnore e pajisur më së miri dhe e zbukuruar, për t'i dhënë njeriut vetëdijen dhe kuptimin e devotshmërisë ndaj Allahut. Pra, njeriu është dërguar në këtë botë për t'u arsimuar në devotshmëri dhe për të vërtetuar (me vepra) besnikërinë e tij ndaj Allahut.

Ekzistenca e njeriut mbi tokë nuk është aspak një aventurë e rastësishtme dhe pa urtësi. Me qëllim që njeriu të fitojë vetëdijen dhe kuptimin e



devotshmërisë, atij i janë dhënë mendja, logjika dhe aftësia për të kuptuar. Përveç këtyre, Allahu i Madhëruar gjithmonë i ka treguar atij rrugën e drejtë me anë të profetëve që ka dërguar dhe fletëve apo librave që ka zbritur. Të gjitha krijesat, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh, që prej mikros e deri tek makroja, janë krijuar me një urtësi dhe qëllim të caktuar. Në Kuranin Fisnik sqarohet:

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَاعِبِينَ

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur!” (Duhan, 38)

أَيَحْسَبُ الْإِنْسَانُ أَنْ يُتْرَكَ سُدًى

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36)

أَفَحَسِبْتُمْ أَنْمَّا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا وَأَنْكُمْ إِلَيْنَا لَا تُرْجَعُونَ

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115)

Çdokush do ta shijojë vdekjen!

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit (për asgjë tjetër), përveçse që të Më adhurojnë Mua!” (Dharijat, 56) Në këtë ajet, Zoti ynë i Madhëruar shprehet se prej nesh dëshiron vetëm që ta adhurojmë Atë. Pra njëkohësisht, Ai dëshiron që ne të ngrihemi në gradë shpirtërore dhe të arrijmë njohjen e Tij (marifetullah), pra ta njohim Atë me zemër.

Nisur nga kjo, mund të themi se, nëse dikush jeton dhe vepron si një udhëtar i shkujdesur, pa e ditur qëllimin e ardhjes së tij në shkollën e kësaj bote të përkohshme, përgjegjësinë e tij në këtë jetë dhe urtësinë e lindjes në këtë botë dhe hedhjes së tij në vorbullën e vdekjes, ai me të vërtetë është i mashtruar. Është me të vërtetë një dështim i hidhur nëse dikush e kthen këtë botë në sheshin e veprave të tij të ulta, pa e menduar se do të japë llogari për gjithçka në botën tjetër! Shpëtimi prej këtij dështimi të hidhur



është i mundur vetëm nëse frymëmarrjet e numëruara i vlerëson si lëvizje në udhëtimin e përjetësisë.

Padyshim se **“vdekja”**, tek e cila do të arrijë patjetër çdo udhëtar i jetës, është një enigmë të cilën janë të detyruar ta zgjidhin të gjithë ata që kuptojnë. Për rrjedhojë, në ajetin 35 të sures Enbija, Allahu i Madhëruar urdhëron:

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ وَنَبَلُّوكُم بِالشَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً وَإِلَيْنَا تُرْجَعُونَ

“Çdokush do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe e me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.”

Ndërsa në ajetin 2 të sures Mulk urdhëron:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا...

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë...”

Pra vdekja është një realitet i paevitueshëm i së ardhmes për çdo të përkohshëm. Të mos harrojmë se nuk ekziston as vend ku të ikim prej vdekjes, as mundësi të kthehemi prej varrit dhe as strehë ku të strehohemi prej tmerit të Kiametit. Kurani Fisnik u drejtohet me këto fjalë atyre që duan të ikin nga realiteti i vdekjes:

قُلْ إِنَّ الْمَوْتَ الَّذِي تَفِرُّونَ مِنْهُ فَإِنَّهُ مُلَاقِيكُمْ ثُمَّ تُرَدُّونَ إِلَىٰ عَالَمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

“Thuaj: «Vdekja prej së cilës po ikni, do t’ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t’ju njoftojë ju për atë që keni bërë.»” (Xhum’a, 8)

أَيْنَمَا تَكُونُوا يُدْرِكُكُمُ الْمَوْتُ وَلَوْ كُنْتُمْ فِي بُرُوجٍ مُّشِيدَةٍ...

“Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!..” (Nisa, 78)

E meqenëse nuk ka shpëtim nga vdekja, ajo që duhet të bëhet është:

Të përpiqesh të zbukurosh vdekjen

Por, si zbukurohet vdekja? Për kë bëhet vdekja si një kthim nga kurbeti dhe takim me të dashurit?

Ashtu siç është kusht një ecuri e mbarë për një përfundim të mirë, ashtu është e domosdoshme edhe një jetë e zbukuruar me vepra të mira dhe në rrugë të drejtë në këtë botë, për të gëzuar një jetë të lumtur në botën tjetër. Një vdekje që hapet drejt lumturisë së përjetshme, fitohet vetëm nga një jete e pastër e kaluar nën dritën e besimit dhe Kuranit.

Për rrjedhojë një mysliman nuk duhet ta harrojë Islamin në asnjë fazë të jetës së tij. Ai duhet të përpiqet që t'i përdorë njëzet e kater orët e tij si Profeti ﷺ, që i është prezantuar atij si udhëzuesi më i mirë. Madje, në lidhje me këtë çështje, ai duhet ta peshojë veten vazhdimisht.

Omeri , ka thënë:

“Llogariteni vetveten para se të llogariteni. Zbukurohuni (me vepra të bukura) për audicionin tuaj më të madh (për ditën kur të dilni para Allahut)! Padyshim se për atë që e ka llogaritur vetveten në jetën e kësaj bote, llogaridhënia do të jetë e lehtë në Ditën e Gjykimit.” (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459)

Për shembull, një mysliman duhet që çdo natë të bëjë llogarinë e ditës së shkuar dhe t'i drejtojë vetes këto pyetje:

- ✓ Si e hape librin e jetës këtë mëngjes? A e falënderove Zotin tënd që të fali një ditë të re?
- ✓ A nxitove të takoheshe me Zotin tënd në kohën para agimit, kur Ai të fton për t'i kërkuar falje? Sa arrite të përfitoje prej mëshirës dhe faljes hyjnore që gufon në atë kohë? Apo mos ndoshta i ke humbur në gjumë këto mundësi të vyera?
- ✓ A ke mundur ta bartësh gjatë gjithë ditës frymëzimin e kohës para agimit? Sa kohë ke kaluar sot në atmosferën e përmendjes së Allahut? Sa kohë qëndrove në frymëzimin shpirtëror të përmendjes së Zotit tënd?
- ✓ A meditove sot në lidhje me vdekjen, e cila t'i asgjëson kënaqësitë e egos?
- ✓ Sa i je drejtuar Zotit sot duke u zhveshur nga shqetësimet e panevojshme të jetës? Sa thellë të kanë bërë të meditosh manifestimet dhe shfaqjet hyjnore të cilat ke hasur?

✓ Sa kohë namazi ke falur me xhemat, duke iu përgjigjur ftesës hyjnore që ngrihej prej minareve? A munde t'i falje namazet me përkushtimin e duhur dhe harmoninë zemër-trup me të cilën kënaqet Allahu?

✓ A ke bërë kujdes nëse fitimi yt i sotëm, ushqimi, pija dhe veshja jote janë hallall, të dyshimta apo haram? A të ka shoqëruar ndjenja e ruajtjes prej haremeve në çdo veprim?

✓ A je kujdesur sot për të drejtat e njerëzve të tjerë? A mund të thuash, “unë s’i kam hyrë në hak asnjë robi dhe nuk kam lënduar askënd!”?

✓ A ke mundur sot t’i shohësh krijesat me syrin e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë së Krijuesit?

✓ A je kujdesur ndaj të drejtave të maces apo të qenit, që ke gjetur tek dera jote? A je sjellë me mëshirë ndaj krijesave duke kujtuar faktin se një person meritoi ndëshkimin hyjnor për shkak se e la macen të ngordhte nga uria, kurse një tjetër gëzoi faljen hyjnore për shkak se i dha ujë një qeni të etur për vdekje?

✓ A ke mundur ta shohësh sot familjen tënde me syrin e zemrës, si kopshtin tënd të Xhenetit, duke u përpjekur ta mbrosh atë nga ndikimet negative të rrugës, tregjeve, modës, reklamave, televizionit dhe internetit? Sa ke arritur ta zbatosh Urdhrin Hyjnor:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ...

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!..” (Tahrim, 6)

✓ Nëse je zonjë shtëpie, a e ke përcjellë burrin tënd me fytyrë të qeshur e dashuri, duke u lutur që të sjellë furnizim hallall në shtëpi? Po ashtu, a e ke pritur me fjalë të ëmbla në mbrëmje, duke u përpjekur t’i largosh lodhjen dhe të bëheni një familje e pastër e shembullore?

✓ Nëse je zot shtëpie, me sa butësi dhe mëshirë je sjellë ndaj gruas dhe fëmijëve të tu? A e ke menduar se trashëgimia më e madhe që mund t’u lësh atyre është ajo e botës tjetër dhe, a je përpjekur aq sa duhet për zhvillimin e tyre fetar, moral e shpirtëror?

✓ Çfarë u mësove sot nga edukata fëmijëve të tu që Allahu i Madhëruar t’i ka lënë amanet? A ke mundur të fusësh në zemrat e tyre dashurinë për të Dërguarin e Allahut ﷺ, profetët e tjerë dhe robërit e mirë të Allahut?



✓ Fëmijët e tu, janë ata që nesër do të të përfaqësojnë dhe do të jenë një pjesë e vazhdimësisë tënde! Për rrjedhojë, çfarë ke bërë ti sot që ata të fitojnë personalitetin Islam?

✓ Çfarë virtutesh ke mbjellë sot në kopshtin e zemrave të fëmijëve të tu, që ata të jenë drita e syve të tu dhe krenaria jote në ditën e Kiametit?

✓ A ke mundur t'i vetëdijësosh fëmijët e tu se feja, besimi, atdheu dhe të gjitha gjërat e shenjta janë amanete që duhen mbrojtur? A ia ke kujtuar fëmijëve të tu dëshmorët që kanë rënë në mbrojtje të atdheut? A i ke mësuar ata se Kurani që është mirësia më e madhe e Allahut, ezani që jehon në qiejt tanë dhe flamuri ynë që valëvitet i lirë në këtë vend, janë nderi dhe krenaria jonë më e madhe?

✓ Ti shpenzon kohë dhe pasuri për një periudhë të gjatë në arsimimin e fëmijëve të tu në këtë botë. Po për arsimin në lidhje me Ahiretin e tyre çfarë ke bërë? Apo mos vallë i ke konsideruar të mjaftueshme disa ditë mësimi fetar në kurset e verës, për një arsimim që ka të bëjë me botën tjetër?

✓ A ke mundur që sot, atyre që kanë nevojë për udhëzim t'u afrosh me gjuhë të ëmbël dhe me një zemër që shpërndan mëshirë? A i ke urdhëruar ata për të mirë dhe i ke ndaluar nga e keqja? A je lutur për udhëzimin e tyre? A ke mundur të bëhesh shembull "i një personaliteti mysliman" për ta?

✓ Duke filluar prej familjes, a ke marrë masa mbrojtjeje për njerëzit që ke nën përgjegjësi, kundër të këqijave dhe problemeve të kohës, ndërkohë që sot breza të tërë po humbasin si trungjet në përrënjt?

✓ A ke mundur ta marrësh përdore një fëmijë apo një të ri, e të shkoni bashkë ne xhami? A je përpjekur të mbledhësh rreth vetes disa të rinj për t'i qerasur materialisht e shpirtërisht, duke ua bërë të dashur të vërtetën? Çfarë dhurate i ke dhënë një personi të cilin e do për hir të Allahut?

✓ Me kë dhe sa prej të mirave që të ka dhuruar Allahu i Madhëruar i ke ndarë sot? A ke mundur të bëhesh bamirës sot?

✓ A e ke përjetuar sot kënaqësinë shpirtërore që të jep gëzimi i një besimtari?

✓ A e ke përkëdhelur sot kokën e një jetimi? A e ke vizituar ndonjë të sëmurë? A e ke përcjellë ndonjë xhenaze?

✓ A je interesuar sot për fqinjët dhe nevojtarët përreth teje? A ta ka



drithëruar zemrën një fqinj që ka mbetur i uritur apo ndonjë i pastrehë që dridhet në të ftohtë?

✓ A të kanë hidhëruar sot hallet e myslimanëve që vuajnë goftë edhe në anën tjetër të botës?

✓ A ke bërë ndonjë përpjekje sot për ngopjen e të uriturve, shërimin e të sëmurëve dhe për lehtësimin e atyre që janë të shtypur nën barrën e borxheve? A je lutur për këtë çështje me fjalë, me zemër, dhe ç'është më e rëndësishme, me vepra?

✓ A ke përshëndetur sot me selam të gjithë njerëzit që i njeh dhe nuk i njeh? A i ke pritur njerëzit me fytyrë të qeshur duke e ditur se buzëqeshja është sadaka?

✓ A je sjellë me mirësi dhe a e ke falur sot ndonjë që të ka bërë keq ose është sjell keq me ty?

✓ A ke fituar sot ndonjë mik dhe me sa miq e ke freskuar miqësinë?

✓ A je përpjekur sot të qëndrosh me ndonjë njeri të mirë? A ke bërë miqësi me ndonjë besimtar të sinqertë që do t'i thotë të vërtetat për hir të Allahut edhe pse nuk do t'i pëlqenin egos tënde? A ke bartur ndopak shqetësim në zemrën tënde për t'u ruajtur nga qëndrimi me gjynahqarët dhe njerëzit e këqij?

✓ A ke hequr sot nga rruga ndonjë pengesë që i bezdis kalimtarët?

✓ A je marrë sot me ndonjë shërbim apo veprimtari që të ka shtuar diturinë dhe të ka zhvilluar kulturën?

✓ A ke mundur që sot, nëpërmjet bisedave fetare që janë si farmaci zemre, të marrësh prej ilaçeve shpirtërore që të shërojnë zemrën e shpirtin dhe të shtojnë frymëzimin?

✓ Sa faqe ke lexuar sot prej Kuranit Fisnik, i cili është mrekullia më e madhe që do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit? A ke mundur të punosh siç duhet me të duke medituar mbi mesazhet që jep ai? A je prej atyre që ia kanë mësuar të tjerëve Kuranin, i kanë shërbyer atij dhe e kanë ndihmuar atë për t'u bërë prej robërve më të mirë?

✓ A ke treguar vullnet të fortë për t'iu vënë kundër zakoneve të këqija që përpiqen të hyjnë në jetën tënde?



✓ A e ke ruajtur gjuhën tënde sot nga fjalët e kota e të padobishme, nga gënjeshttrat dhe thashethemet, nga përgojimet dhe debatet dhe nga shpimi i ndonjë zemre me fjalë helmuese?

✓ Si e ke mbyllur ditarin e jetës sot? Çfarë janë shkruar në librin tënd të punëve në lidhje me ditën e sotme? A do të mund të japësh llogari në ditën e gjykimit për faqen e kësaj dite?

✓ Shkurtimisht, a e ke menduar se sot je duke u regjistruar nga kamerat hyjnore në çdo lëvizje dhe çdo veprim tëndin për të mbushur kasetën e jetës tënde? A e ke bërë llogarinë e 24 orëve të fundit që ke kaluar dhe a e ke kontrolluar veten?..

Ja pra, besimtarët që përpiqen të bëjnë një vetëllogaritje të tillë duke u përgatitur për vdekjen, në vend që ta kenë frikë, e konceptojnë atë si një mundësi për takimin e përjetshëm. Në këtë mënyrë, vdekja, e cila është si një portë midis dy botëve, fillon dhe bëhet e bukur.

Nisur nga kjo, mund të thuhet se zgjidhja e vetme për të shpëtuar nga drithërimat e ftohta të vdekjes, është të përpjekja për të bërë një jetë të devotshme, duke u thelluar në meditimin e shprehjes: “Vdisni, para se t’ju vijë vdekja!”. Kjo, sepse:

Vdekja e secilit do të ketë ngjyrën e tij

Vdekja do ta arrijë patjetër çdo gjallesë, por veçanërisht për njeriun ajo do të jetë një kiamet personal. Ashtu siç nuk do të ketë frikë dhe hidhërim në ditën e Kiametit për ata që i besojnë Allahut dhe jetojnë në rrugë të drejtë, edhe në çastin e vdekjes, që është një kiamet i veçantë për çdo person, do të përjetohet e njëjta gjendje. Për rrjedhojë, vdekja do të manifestohet sipas gjendjes shpirtërore të gjithsecilit.

Mevlana i nderuar është shprehur shumë bukur kur ka thënë:

“Biri im! Vdekja e gjithsecilit është në ngjyrën e tij. Atyre që e urrejnë vdekjen dhe janë armiq të saj, sepse nuk mendojnë se vdekja është takim me Allahun, ajo ka për t’iu dukur një armik i frikshëm. Ndërsa atyre që janë miqësuar me të, iu shfaqet si mik.

“O shpirt që frikësohesh dhe ikën nga vdekja! Nëse dëshiron të dish se si është puna dhe cila është e vërteta, dije se në të vërtetë ti nuk ke frikë nga vdekja, ti ke frikë nga vetja.”

“Ajo që sheh në pasqyrën e vdekjes dhe frikësohesh, nuk është çehrija e vdekjes, por fytyra e shëmtuar e botës tënde të brendshme. Shpirti yt i ngjan një peme. Ndërsa vdekja është gjithja e asaj peme. Dhe çdo gjëthe është sipas llojit të pemës...”

“Dita e Kiametit është një “Bajrami i Kurbanit” i frikshëm për qetë laramane, pra për mohuesit dhe gjynahqarët me mendime të këqija. Ajo ditë është vdekje për qetë dhe Bajram për besimtarët.”

Në ditën e Bajramit të Kurbanit, besimtarët festojnë ndërsa kafshët bëhen kurban. Në paralelizëm me këtë, edhe njeriu në ditën e Kiametit do të vendoset në njërin nga këto dy role, në bazë të zgjedhjeve dhe prirjeve të tyre në këtë botë: Ose do të jetë prej atyre që do festojnë, ose prej atyre që do të meritojnë dënimin...

Nisur nga këto të vërteta, nëse një njeri jeton duke e robëruar veten sikur kjo botë të ishte zoti i tij, varri do ta presë si një burg i errët dhe i mbushur plotë me ndodhi e sende të frikshme. Ndërsa tmerri i vdekjes e bën këtë njeri të vuajë aq shumë, sa nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër. Mirëpo, nëse njeriu i respekton parimet Islame, duke i kapërcyer dëshirat e ulëta të egos dhe përparon në drejtim të virtyteve të larta që gjenden në shpirtin e tij, atëherë vdekja shihet si një kusht i detyrueshëm i takimit me Zotin, i Cili është i Lartë dhe Madhështor përtej çdo imagjinate. Vetëm në këtë mënyrë, vdekja, e cila shkakton drithërima të ftohta tek shumica e njerëzve, kthehet në entuziazmin e takimit me “Mikun më të Lartë”.

I nderuari Mevlana, vdekjen e vet e ka konsideruar si “Sheb-i Arus / Natë dasme”, pra si shpëtim prej kurbetit në këtë botë dhe rrugëtim drejt takimit me të Dashurin e tij:

“Ditën kur të vdes e trupi im të bartet, mos kujto se shqetësohem për këtë botë! Mos pandeh se jam hidhëruar prej ndarjes nga kjo botë! Mos guxo të qash pse kam vdekur; mos thuaj as: «vaj medet, e mjerë ai!». Nëse unë kam rënë në kurthet e shejtanit sa kam qenë gjallë, atëherë mund të qash!

Dhe kur të më lëshojnë në tokë, mos thuaj: «Lamtumirë, lamtumirë!»! Dije se ajo nuk është koha e ndarje sime, por e takimit (me Zotin tim)!

Varri është një perde, pas së cilës gjendet paqja e Xhenetit! Perëndimin e ke parë, apo jo? Shikoje edhe lindjen! A i humbet gjë Diellit dhe Hënës kur zhiduken në horizont?

Edhe pse kjo gjendje të duket si perëndim apo zhdukje, në fakt kjo është një lindje, takim i ri me jetën!

Nëse fara bie në tokë, a mund të thuhet se ajo «vdiq»?..

Dije se vdekja është dhimbja e lindjes së shpirtit në një botë tjetër. Në lidhje me këtë botë të përkohshme, emri i saj është «vdekje», por në raport me botën tjetër të përjetshme emri i saj është «lindje»!..

A nuk është Allahu Ai që e merr shpirtin?.. Pra, dije se vdekja për robërit e mirë është e ëmbël si sheqer. Edhe nëse vdekja është zjarr, për atë që është mik/halil i Allahut, ajo është kopësht Xheneti, ujë i jetës...”

Shkurtimisht, vdekja nuk është asgjësim, por lindje në jetën e përjetshme. Ashtu siç është lindje ardhja në këtë botë për një bebe, ashtu edhe dalja e shpirtit nga trupi dhe hyrja në botën e varrit është lindje në një botë tjetër. E më pas, ai do të lindë në botën e përjetshme.

Ta japësh shpirtin si mysliman

Allahu i Madhëruar, na ka paralajmëruar shumë herë se si duhet të jenë veprimet dhe sjelljet tona me qëllim që jeta jonë të mos përfundojë në mënyrë të hidhur. E mbase një prej më të rëndësishmëve prej tyre, është edhe ky:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al-i Imran, 102)

Ne jemi sjellë nga mosekzistenca në ekzistencë, pa paguar asnjë çmim, pra falas. Po ashtu, ne u nderuam mes të gjitha krijesave duke u krijuar si “qenie njerëzore”, dhe si myslimanë ndër të gjithë njerëzit. Allahu i Madhëruar na ka pajisur me cilësi të veçanta me të cilat mund të arrijmë njohjen dhe dashurinë e Tij. Ai na ka krijuar si, “*ahsen-i takuim / krijimin më të mirë*”. Na ka dhuruar mirësi të mëdha duke na dërguar libra dhe profetë. Po ashtu, Ai ka shfaqur manifestimet e mistereve dhe urtësive hyjnore për sytë që shohin në Librin e gjithësisë, që është edhe dëshmitari i fuqisë dhe madhështisë së pakufishme të ekzistencës dhe njëshmërisë së Tij. Të gjitha këto janë mirësi dhe bukuri madhështore për të cilat nuk jemi mjaftueshëm të aftë të falënderojmë...

Përveç këtyre, Allahu i Madhëruar ka përgatitur edhe lumturinë e përjetshme për ne, pra Xhenetin e Tij. E për Xhenetin ekziston një çmim që duhet paguar. Domethënë, edhe pse në këtë botë kemi ardhur pa paguar asnjë çmim, ne jemi të detyruar të shkojmë në botën tjetër duke paguar njëfarë çmimi. E në fakt nuk e kemi aspak të garantuar se mund të shkojmë si myslimanë në botën tjetër. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

أَحْسِبَ النَّاسُ أَنْ يُتْرَكُوا أَنْ يَقُولُوا آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë «Ne besojmë», pa u vënë në provë?!” (Ankebut, 2)

Kjo do të thotë që e gjithë jeta jonë është prova e dorëzimit të shpirtit amanet, tek i zoti, në mënyrë të kënaqshme, pa lëshuar pe nga besimi ynë dhe pavarësisht çdo ndodhie.

Me shprehjen, **“Vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”**, Allahu i Madhëruar duket sikur na paralajmëron: *“Mos guxoni të vdisni pa e shpëtuar edhe besimin tuaj!”*, duke na tërhequr vëmendjen se ky është rreziku më i madh për robin në këtë botë. Pra, Ai na bën të ditur se vdekja ndodh vetëm një herë dhe se fryma e fundit që jepet duke qenë larg besimit është një katastrofë e përjetshme e pakompensueshme.

Në Kuranin Fisnik, Zoti ynë na sjell shembull heronjtë, si magjistarët e Faraonit dhe As’hab-i Uhdud, të cilët sakrifikuan jetën, pasuritë dhe gjithçka që kishin, për të shpëtuar besimin e tyre. Po ashtu Ai na njofton edhe për fundin e fatkeqëve si Bel’am ibn Baura dhe Karuni, të cilët pavarësisht jetës shumë të devotshme, u larguan nga rruga e drejtë dhe pësuan dështimin e përjetshëm.

Shqetësimi për dhënien e frymës së fundit me besim është domosdoshmëri dhe tregues i besimit të vërtetë, sepse përveç profetëve dhe atyre të cilët janë përgëzuar me Xhenet prej profetëve, askush tjetër nuk e ka të garantuar se do të jetë prej të shpëtuarve në botën tjetër. Madje edhe sahabët, të cilët janë përgëzuar me Xhenet që në këtë botë, kanë jetuar vazhdimisht me shqetësimin për frymën e fundit dhe gjendjen e tyre në botën tjetër, nga frika se mos nuk e ruanin dot gradën e tyre të besimit.

Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë kjo ndodhi:



Njëherë, dy persona shkuan tek sahabi Selman Farisiu ﷺ dhe pasi e përshëndetën me selam, e pyetën:

“A je prej sahabëve të Profetit ﷺ?”

“Nuk e di!” - u përgjigj ai.

“Mos vallë kemi ardhur gabim?” - thanë ata duke ngurruar.

Mirëpo, edhe pse ishte përgëzuar nga vetë Profeti ﷺ, me fjalët: “Selmani është prej nesh, prej Ehl-i Bejtit”⁵ dhe gëzonte virtyte të larta, ky sahabi i bekuar nuk i quante asnjëherë të mjaftueshme përpjekjet e tij fetare dhe, me zemrën që i dridhej midis ndjenjave të “frikës” dhe “shpresës”, ai u shpreh me këto fjalë:

“Po, unë e kam parë të Dërguarin e Allahut ﷺ, dhe jam gjendur në tubimet e tij. Por sahabi i vërtet i të Dërguarit të Allahut ﷺ, është ai që arrin të hyjë së bashku me të në Xhenet.” (Hejthemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549)

Ja pra, kjo është ndjesia e zemrës së një sahabi të zgjedhur prej sahabëve të nderuar, të cilët janë brezi më shembullor për të gjithë ummetin Islam deri në ditën e Kiametit...

Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se ne ecim në një terren të rrëshqitshëm deri në frymën e fundit. Ashtu personi që detyrohet të bëjë kujdes në çdo hap që hedh, kur kalon në një zonë të minuar, ashtu edhe besimtari duhet të bëjë kujdes me devotshmëri të lartë ndaj gjendjeve dhe sjelljeve që ka ndaluar Allahu në rrugëtimin e kësaj jete të përkohshme, me qëllim që të mos devijojë nga rruga e drejtë.

Gjithashtu, Zoti ynë i Madhëruar na tregon rrugën e drejtë, me qëllim që këmbët të mos na rrëshqasin dhe të ecim me hapa të sigurt në këtë rrugë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَنْصُرُوا اللَّهَ يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.” (Muhamed, 7)

Kjo do të thotë se në asnjë fazë të jetës sonë nuk duhet ta hedhim Islamin në plan të dytë. Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë Zotin tonë as në

shtëpi, as në punë, as në rrugë, as në treg, e as në shkollë dhe duhet t'i respektojmë urdhrat e Tij në çfarëdolloj situatë. Përpjekja më e madhe në jetën tonë duhet të jetë dhënia shpirt vetëm si myslimanë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nëse dikush dëshiron të shpëtojë prej Xhehenemit dhe të hyjë në Xhenet, duhet të vdesë me besim tek Allahu dhe Dita e gjykimit.” (Muslim, Imare, 46; Nesai, Bej'at, 25; Ibn-i Maxhe, Fiten, 9)

E gjithë çështja është që këtë jetë të përkohshme ta jetojmë në kuadrin e këtyre të vërtetave hyjnore dhe profetike.

Të gjithë janë të shqetësuar...

Në fillim të sures Nebe urdhërohet:

عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ﴿١﴾ عَنِ النَّبِيِّ الْعَظِيمِ ﴿٢﴾ الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ ﴿٣﴾

“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime.” (Nebe', 1-3)

Në këtë mënyrë, na bëhet e ditur se edhe mohuesit bien në kundërshtime dhe shqetësohen në lidhje me Kiametin, duke thënë: “Po sikur lajmi për botën tjetër të jetë i vërtetë? Po sikur Xhehenemi dhe Xheneti të ekzistojnë vërtetë, si do të vejë halli ynë?..”. Madje, ky lajm cilësohet edhe si **“Lajm i Madh”**.

Në periudhën e injorancës, ashtu siç ndodh edhe sot në kohën tonë shekullare, jetohej pa u shqetësuar për botën tjetër, pa kontroll dhe pa përgjegjësi. Ata nuk ndjenin qoftë edhe shqetësimin më të vogël për faktin se një ditë do të jepnin llogari për mizoritë dhe padrejtësitë që kishin kryer. Kjo u lejonte atyre që t'i shtypnin të dobëtit me sa të kishin mundësi dhe të shfaqnin një egërsi dhe monstruoze që ua kalonte edhe hienave. Për këtë arsye, kur Kurani ua solli lajmin për botën tjetër, ai tronditi sistemin e prishur që idhujtarët kishin ngritur vetë, ua lëkundti atyre optimizmin dhe ua ngushtoi shpirtrat.

Për rrjedhojë, idhujtarët shkuan tek i Dërguari i Allahut ﷺ, dhe i bënë të ditur se nëse ai do të hiqte dorë nga lajmi i botës tjetër, nëse do të hiqte haramet që kishte predikuar dhe nëse nuk do të prekte idhujt, ata do ta pranonin dhe do ta ndiqnin.



Njëlluj, edhe gjendja e atyre që sot bezdisen nga lajmi për botën tjetër, nuk duan ta kujtojnë vdekjen dhe dëshirojnë të bëjnë një jetë pa adhurime, pa përgjegjësi dhe pa rregulla, të kujton gjendjen e periudhës së injorancës.

Për shembull, nëse në një lagje, ku jetojnë më tepër njerëz që janë larg fesë, ndërtohet ndonjë xhami, çmimi i banesave që gjenden afër xhamisë do të bjerë, sepse falja e namazeve të xhenazes u kujton vdekjen dhe ua rrezon moralin atyre që duan të bëjnë një jetë pa shqetësimin ndaj botës tjetër.

Madje kur në hyrjen e një varreze u vendos ajeti i Kuranit:

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ ...

“Çdokush do ta shijojë vdekjen!..” (Al-i Imran, 185), shumë njerëz u ankuan duke thënë: “Hiqeni këtë shkrim se na bën pesimist!..”

Kjo do të thotë se në fakt, në lidhje me jetën pas vdekjes, të gjithë -besimtarë apo jo- kanë një lloj frike dhe shqetësimi... Edhe tek besimtari, edhe tek jobesimtari ekziston një shqetësim në lidhje me vdekjen, Kiametin dhe Jetën e përjetshme. Por secila palë e sheh në mënyra të ndryshe.

Frika e jobesimtarit është e formës: “Po sikur lajmi për botën tjetër të jetë i vërtetë?!”. Shqetësimi i tij është: “Po sikur vdekja të mos jetë fundi?!”. Ndërsa dyshimi i tij është: “Po sikur të japim llogari me të vërtetë?!”. Ky është një problem shpirtëror që buron prej mos plotësimit të prirjes së devotshmërisë ndaj Allahut që gjendet në natyrën e njeriut, edhe pse kjo nuk reflektohet si besim apo vepër e mirë në sjelljet e tyre...

Ndërsa shqetësimi tek besimtari është: “Ç’do të bëhet me mua në botën e përjetshme, e cila është jeta e vërtetë, nëse nuk veprojmë me devotshmërinë e duhur ndaj Allahut?” ...

Zemra e besimtarit është e gjalle dhe bartë këto karakteristika :

- ✓ Është e mbushur me shqetësimin nëse frymën e tij të fundit do të mund ta japë me besim.
- ✓ Është e mbushur me shqetësimin e të pasurit të devotshmërinë së duhur, të tillë që kur t’i vijë shpirti në fyt e të takohet me Azrailin, t’i thotë “mirëserdhe!” atij të dërguari të Zotit?
- ✓ Është e mbushur me shqetësimin e të qenit të varrit të tij një kopësht Xheneti apo një gropë e Xhehenemit (Allahu na ruajtë!).

✓ Është e mbushur me shqetësimin mbi gjendjen e tij kur të ngrihet gjyqi suprem (mahkeme-i kubra), të vihen në peshore besimi dhe punët e tij dhe t'i silltet para libri i punëve, në të cilin Kiramen Katibin⁶ kanë shkruar të gjitha veprat e vogla e të mëdha, pra kur t'i jepet diploma e arsimimit të devotshmërisë së tij në këtë botë.

Po ashtu besimtari mendon:

Vallë nga cila anë do të më silltet libri i punëve? Nga e djathta, e majta, para apo mbrapa? Me çfarë do të përballem në librin e punëve të mia, pra, në llogarinë e jetës sime që është regjistruar moment për moment?..

Në fakt unë e llogaris veten që në këtë botë, para se të merrem në llogari në botën tjetër. Por, a është kjo llogari që bëj unë, në përputhje me atë të botës tjetër? A do të përshtatet llogaria ime këtu me atë atje?..

Sa bukur e shpjegon kjo ndodhi këtë shqetësim të zemrave besimtare:

Një njeri i mirë shkoi në treg për të blerë disa gjëra të nevojshme. Ai e kishte llogaritur që në shtëpi se sa do të kushtonin ato që do të blinte dhe mendoi se paratë që kishte do t'i mjaftonin. Mirëpo, kur shkoi në treg, paratë nuk i mjaftuan për gjithçka që donte të blinte. I mërzhitur tej mase, njeriu qau me ngashërim për një kohë të gjatë.

Njerëzit përreth u habitën shumë nga kjo ndodhi dhe u munduan ta ngushëllonin duke i thënë se nuk ia vlente të qante për shkak se nuk i mjaftonin paratë. Më në fund njeriu mblodhi veten dhe iu drejtua me këto fjalë turmës përreth e cila e shihte me habi:

“Mos mendoni se lotët e mi janë për këtë botë! Kjo ndodhi më bëri të mendoj se përderisa llogaria që bëra në shtëpi nuk përputhet me llogarinë e tregut, si do të përputhet llogaria që bëjmë në këtë botë me llogarinë e botës tjetër?..”

E në fakt, në atë Peshore Hyjnore do të llogariten edhe përgjegjësitë në nivelin e grimcës, për të cilat as që na shkon mendja kurrë. Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar urdhëron:

﴿۷﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ﴿۸﴾

6. Kiramen Katibin: Dy melekë që shkruajnë çdo gjë që bën njeriu gjatë jetës së tij.

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë. E kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.” (Zelzele, 7-8)

Kur një beduin dëgjoi këto ajete prej Profetit ﷺ, pyeti me habi të madhe:

“O i Dërguar i Allahut! Sa pesha e një thërmije?!”

“Po!” - iu përgjigj Profeti ﷺ. Atë moment beduini ndryshoi përnjëherë dhe filloi të rënkojë me hidhërim duke thënë:

“Mjerë unë për gabimet e mia!..”. Madje ai i përsëriti disa herë këto fjalë. Më pas u ngrit dhe iku duke përsëritur ajetet që sapo kishte dëgjuar.

Pasi shkoi, Profeti ﷺ, tha:

“Besimi hyri në zemrën e këtij beduini.” (Sujuti, ed-Duurru'l-Mensur, VII, 595)

Domethënë se të mendosh dhe të shqetësohesh edhe për gabimet sa një thërmijë që sot nuk shihen të rëndësishme, por që do të llogariten në peshoren e Ditës së Gjykimit, është tregues i një besimi të vërtetë.

Nisur nga kjo themi se shqetësimi për sasinë e veprave pozitive dhe negative që do të dalin prej asaj peshore precize, është ndjenjë e zemrave besimtare.

Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik urdhëron:

نُمُّ لَتَسْأَلَنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”

(Tekathur, 8)

Kur zbriti ky ajet fisnik, një sahab që nuk kishte as çadër ku të fuste kokën, u ngrit dhe pyeti:

“A kam unë ndonjë gjë prej mirësive (për të cilat do jap llogari) o i Dërguar i Allahut?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Hijen e pemës, nallanet që vesh në këmbë dhe ujine ftohtë” (Shih. Sujuti, VII, 619)

nuk posedon asgjë, ka shumë mirësi për të cilat do të japë llogari në botën tjetër.

Duhet të mendojmë se:

Përqindja që duhet të japim si zekat nga pasuria është e ditur: pra një e dyzeta. Nëse e japim këtë sasi ne shpëtojmë prej përgjegjësisë minimale të mirësisë së pasurisë. Mirëpo në Ditën e Gjykimit, Allahu i Madhëruar nuk do t'i pyes njerëzit vetëm për pasurinë dhe pronën, por për të gjitha mirësitë që mund të vijnë në mendje, si aftësitë, talentet, forca, koha e lirë, shëndeti, etj. Përqindja e këtyre mirësive është e panjohur për ne...

Mbi të gjitha ky ajet na e thekson mendimin e mësipërm:

وَإِنْ تَعُدُّوا نِعْمَةَ اللَّهِ لَا تُحْصُوهَا...

“Nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato...” (Nahl, 18), dhe na tregon qartë se ne zotërojmë shumë mirësi të Allahut të Madhëruar, të cilat i dimë dhe nuk i dimë. Ashtu siç jemi të paaftë të evidentojmë qoftë edhe numrin e këtyre mirësive, ne jemi të paaftë të falënderojmë ashtu siç duhet për këto mirësi sado që të përpiqemi e të sakrifikojmë...

Ja pra, pikërisht për shkak se sahabët e nderuar e ndjenin thellësisht përgjegjësinë e madhe që u kishte ngarkuar kjo e vërtetë, ata ia kishin kush-tuar jetën shërbimit në rrugën e Allahut me një përpjekje që vetëm shtohet vazhdimisht, deri në frymën e fundit. Ata kanë përdorur të gjitha mundësitë dhe kanë shkuar deri në Kinë, Semerkand, në Afrikën e Mesme, etj. Po ashtu, ata shërbyen në rrugën e Allahut me dashurinë për besimin dhe entuziazmin e kumtimit të fesë, pa u lodhur dhe pa u mërzhitur asnjëherë.

Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik urdhëron:

فَلَنَسْأَلَنَّ الَّذِينَ أُرْسِلَ إِلَيْهِمْ وَلَنَسْأَلَنَّ الْمُرْسَلِينَ

“Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të dërguar, e patjetër që do t’i pyesim edhe të dërguarit.” (Araf, 6)

Edhe profetët, për të cilët nuk ka dyshim se do të jenë banorë të Xhenetit, kanë bërë një jetë me sakrifica në shërbim të fesë me shqetësimin e dhënies llogari për saktësinë e kryerjes së detyrës së tyre të kumtimit.

Edhe Profeti ﷺ, ka duruar çdo lloj vuajtjeje me qëllim që të mund t’ia kumtonte njerëzve ftesën e udhëzimit. Ai është keqtrajtuar, sharë e ofenduar, e gjithsesi pavarësisht kushteve të vështira dhe të rrezikshme, ai nuk e braktisi detyrën e tij të shenjtë, duke treguar përpjekje të pashoqe në këtë rrugë. Madje, për këtë arsye ai edhe është qortuar nga Allahu i Madhëruar me fjalët:

“(o Muhamed) **A mos vallë do ta shkatërrosh veten për shkak se ata** (banorët e Mekës) **nuk duan të besojnë?”** (Shu’ara, 3)

Ndërsa në Ligjëratën e Lamtumirës, ai doli para njëqind e ca mijë sahabëve dhe i pyeti tre herë rresht:

“O sahabët e mi! Nesër do t’ju pyesin për mua. Çfarë do të thoni? A e kumtova (mesazhin)?

Sahabët e nderuar u përgjigjën:

“Po o i Dërguar i Allahut, e kumtove!” Pas kësaj përgjigje që mori, Profeti ﷺ, tha tre herë:

“Dëshmo o Zot!”⁷

Kjo vetëdije e lartë përgjegjësie e Profetit ﷺ, është një udhëzues shumë domethënës për ne si ummeti i tij. Për shkak të këtyre të vërtetave, çdo besimtar duhet të bartë në thellësitë e shpirtit të vet një “shqetësim ndaj Kiametit” që e përforcon gjithmonë rrugën e tij të drejtë dhe e mbanë të gjallë entuziazmin e besimit të tij. Ai duhet të përpiqet të bëjë një jetë fetare aktive, me zemër të gjallëruar në sajë të meditimit për vdekjen.

Zoti ynë i Madhëruar na bën të ditur, që ne duhet të kontrollojmë e të korrigjojmë veten tonë, duke pasur gjithmonë në mendje Kiametin dhe Botën tjetër. Dhe këtë e kthjellon duke iu drejtuar Profetit ﷺ:

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ

“**A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse (Kiametin)?**” (Gashije, 1)

Sigurisht që ai “Lajm i madh” na ka ardhur. Por Allahu i Madhëruar në një farë mënyre na qorton e ndoshta me këtë do na të thotë:

7. Shih. Muslim, Haxh, 147; Ebu Daud, Menasik, 56; Ibn-i Maxhe, Menasik, 76, 84; Ahmed, V, 30; Ibn-i Hisham, IV, 275-276; Hamidullah, el-Uesaik, fq. 360.

- Si është e mundur që ju qëndroni kaq rehat, sikur nuk ju ka ardhur ky lajm i madh?

- Si është e mundur që ju rendni pas lakmive dhe gjërave të kota në këtë botë?

- Si është e mundur që po e shpërdoroni në indiferencë jetën tuaj, e cila është edhe kapitali juaj më me vlerë?

Ndërsa në ajetin që vijon, tërhiqet vëmendja tek fytyrat që do të kenë në ditën e Kiametit, ata të cilët në këtë botë e kanë kaluar jetën në indiferencë:

﴿٢٣٧﴾ وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ خَاشِعَةٌ

“Atë Ditë disa fytyra do të poshtërohen.” (Gashije, 2)

Përkundër kësaj, fytyrat e besimtarëve të sinqertë që ia kushtuan jetën e tyre të përkohshme rrugës për fitimin e jetës së përjetshme, duke mos u mashtruar nga kjo “botë e rreme”, përshkruhen në këtë mënyrë:

﴿٢٣٨﴾ وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاعِمَةٌ

“Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara.” (Gashije, 8)

Si do të jetë gjendja jonë atë ditë?

Në këtë botë, ne kujdesemi për pamjen e jashtme, veshjen, pastërtinë, rregullsinë dhe bukurinë tonë. Por si do të jetë pamja, forma dhe fytyra jonë në botën tjetër? Në fakt a nuk duhet të kujdesemi e t'i japim më shumë rëndësi kësaj?

Në çfarë gjendje do të jetë fytyra jonë atë ditë? Do të jetë një fytyrë e pluhurosur, e djersitur, e poshtëruar, e zbehur dhe errët? Apo do të jetë një fytyrë e lumtur, e shndritshme, që ndriçon me gjurmët e sexhdes, e pastër dhe e mbuluar nga drita?

Zoti ynë i Madhëruar, na bën të ditur se fytyrat tona në këtë botë do të reflektohen edhe në fytyrat tona në botën tjetër:

﴿٢٣٩﴾ وَوَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ مُّسْفِرَةٌ ﴿٢٣٨﴾ صَاحِكَةٌ مُّسْتَبْشِرَةٌ ﴿٢٣٩﴾ وَوَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ مُّسْفِرَةٌ

عَلَيْهَا غَبْرَةٌ ﴿٤٠﴾ تَرَهَّقَهَا قَتْرَةٌ ﴿٤١﴾ أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرَةُ الْفَجْرَةُ ﴿٤٢﴾

“Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura, që do t’i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët.” (Abese, 38-42)

Në cilën gjendje do të paraqitet trupi ynë atë ditë? Një trup, organet e të cilit do të dëshmojnë kundër tij, i ringjallur me shenjat e shëmtuara të gjynaheve të hapura e të fshehta që ka vepruar në dynja, i shtrydhur nën peshat e rënda dhe me etiketat e padrejtësive dhe të këqijave që ka vepruar e i varen në qafë? Apo një trup, gjymtyrët e të cilit ndriçojnë për shkak të abdestit, sytë e të cilit rezatojnë dritë besimi, që bartë shenja të shpërblimeve të punëve të mira që ka vepruar, i pastër, i bukur, i përkryer dhe i qetë?

Shkurtimisht, një gjë nuk duhet harruar kurrë: Ajo që do të përcaktojë gjendjen e pamjes dhe fytyrës sonë nesër në ditën e Kiametit, është niveli shpirtëror i zemrës sonë në këtë botë. Zemrat që janë bërë katran nga njollat e gjynaheve në këtë botë, do të ringjallen në gjendje të shëmtuar, të pistë, të poshtëruar dhe të shpifur në botën tjetër. Ndërsa zemrat që janë dëlirur dhe rafinuar nga papastërtitë shpirtërore dhe janë zbukuruar me vepra të mira, me mirësinë dhe bujarinë e Allahut, në botën tjetër do të ringjallen të bukura, të shndritshme dhe të lumtura.

Ata që do të jenë të mbrojtur nga shtigjet e vështira e plot telashe dhe probleme të botës tjetër, si dhe nga frika dhe hidhërimi, janë vetëm ata që kanë arritur të miqësohen me Allahun në këtë botë. Në një ajet fisnik urdhërohet:


أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” (Junus, 62)

Synimi i vetëm i jetës së kësaj bote, në sytë e besimtarëve të urtë, është përparimi në rrugën e miqësisë me Allahun e Madhëruar, pra përpjekja për fitimin e një përsosmërie që do të meritonte shikimin e bukurisë së Allahut në botën tjetër.

Allahu i madhëruar na e mundësoftë të bëjmë një jetë në përputhje me kënaqësinë e Tij dhe të dalim para Tij me zemër të pastër. Allahu na ruajtë nga dënimi i varrit dhe e na e bëftë atë një



kopsht prej kopshteve të Xhenetit. Allahu na pranoftë në grupin e miqve të tij që janë të sigurt nga tmerret e Kiametit dhe botës tjetër dhe na bëftë prej robërve të Tij fatlumë që do të jenë fqinjë të Profetit , në Firdeusi Ala!

Amin!..





PJESA II

Besimi në botën tjetër

Sot, njerëzimi po bën shumë kërkime shkencore me qëllim që të jetojë pak më shumë në këtë botë, e madje të shpëtojë edhe nga vdekja. Dhe për këtë arsye është shpenzuar shumë mund e pasuri në prodhimin e ilaçeve dhe produkteve kozmetike. Mirëpo, në jetën e vërtetë, që është ajo e botës tjetër, askush nuk do të shqetësohet nëse ka jetuar pak apo shumë në dynja. Atje, të gjithë do të kenë hall se sa kapital për botën e përjetshme kanë fituar apo humbur në jetën e shkurtër të dynjasë, e cila krahasuar me jetën e Ahiretit duket vetëm sa një mbrëmje, apo sa një paradite...

BESIMI NË BOTËN TJETËR

Besimi në Ahiret është edhe një prej shtyllave të besimit Islam. Dhe për të treguar rëndësinë e kësaj shtylle në sistemin e besimit Islam, mund të cekim faktin se kjo është një prej shtyllave të besimit që në Kuran përmendet shpesh, së bashku me “besimin në Allahun”:

“...kushdo prej tyre që beson Allahun dhe jetën tjetër (sipas Kuranit), **dhe bën vepra të mira** (sipas Islamit), **do të shpërblehen nga Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo të pikëllohen!”** (Bekare, 62)

“...Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit!..” (Nisa, 59)

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre...” (Muxhadele, 22)⁸

8. Edhe largimi me zemër prej atyre që nuk i do Allahu, është një prej kushteve të saktësisë së besimit, ashtu siç është edhe dashuria ndaj atyre që do Allahu. Kjo, sepse besimi bën të domosdoshme dashurinë për atë që e meriton dhe urrejtje ndaj atij që e ka hak. Për shembull, surja el-Mesed, është një sure që na e tregon më së miri urrejtjen ndaj atyre që e kanë hak atë, sepse Ebu Lehebi, edhe pse ishte xhaxhai i Profetit ﷺ, për shkak të armiqësisë së tij ndaj Islamit, ka merituar mallkimin e Zotit në këtë sure të Kuranit. Po ashtu, Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh që në çdo rekat të namazit, t'i lutemi Atij duke thënë:

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

“(na udhëzo) **në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi**”. Ndërsa se kush janë ata, të cilëve u janë dhuruar mirësi, Allahu na e bën të ditur në një ajet tjetër: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** (Nisa, 69)

Më pas, me lutjen:

غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ



Gjithashtu, duke i lavdëruar besimtarët, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...ata që besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit...” (Teube, 44)

Duke qenë një çështje që i takon të fshehtës dhe që e kapërcen mendjen njerëzore, është e pamundur që enigma e **“vdekjes dhe Ahiretit”** të zgjidhet vetëm me mendje. Në këtë pikë, njeriu ka nevojë të padiskutueshme për udhëzimin e shpalljeve hyjnore. Allahu i Madhëruar nuk i ka lënë pa ndihmë robërit e Tij në lidhje me këtë çështje. Në shumë sure të Kuranit Fisnik, ndonjëherë me argumente të qarta, ndonjëherë me shembuj e ndonjëherë edhe me përsëritje të shpeshtë të ajeteve në lidhje me Ahiretin, është synuar gdhendja dhe skalitja e besimit në botën tjetër, në zemrat e besimtarëve. Kjo është edhe arsyeja pse në vitet e para të profetësisë, Profetit ﷺ i janë zbritur më tepër ajete që forcojnë themelet e besimit sesa ajete që lidhen me adhurimet. Madje këto çështje janë trajtuar shpesh edhe midis temave të adhurimeve dhe veprave, të cilat kanë zbritur pas emigrimit të Profetit ﷺ në Medinë, sepse një nga shkaqet më të rëndësishme të problemeve në periudhën e injorancës ishte “mohimi i Ahiretit”.

E në fakt, mohimi i ekzistencës së botës tjetër s’ka të bëjë as me mendjen e as me logjikën. Duhet menduar se:

“Për shembull: Nuk është parë asnjëherë, që një grup teatral të mbyllë perdet pas shfaqjes së skenës së parë, duke e lënë shfaqjen me ndodhi të shkëputura nga njëra-tjetra dhe në mënyrë që të kenë nevojë për shpjegim?! Nëse do të ndodhte diçka e tillë, çfarë do të mendonin shikuesit që sapo kanë filluar të futen në mendime, janë tensionuar dhe që mezi presin të mësojnë qëllimin dhe idenë kryesore të shfaqjes dhe skenaristit? Edhe

“...jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”, dëshiron që ne të kërkojmë të mos i ngajmë atyre që janë zhytur në batakun e mohimit e të atyre që kanë humbur në luginën e devijimit.

Nuk duhet harruar se ruajtja nga ngjasimi me jo myslimanët është një nga kushtet më të rëndësishme të ruajtjes së personalitetit dhe pjekurisë Islame. Për këtë arsye, Profeti ﷺ ka urdhëruar që agjërimi i ditës së 10 të muajit Muharrem, e cila agjërohet edhe nga hebrenjtë, të bëhet duke agjëruar bashkë me të edhe një ditë para, ose një ditë pas saj, si dallim prej tyre. Pra, Profeti ﷺ na e ka ndaluar t’u ngajmë jomyslimanëve edhe në adhurime. Po ashtu, Profeti ﷺ, ka urdhëruar: *“Kush përpiqet t’i ngajë një popull, ai është prej tyre.”* (Ebu Daud, Libas, 4/4031)

Një gjë është e sigurt se Islami, që është e vetmja fe e vërtetë tek Allahu, zotëron përsosmërinë për t’i dhënë përgjigje nevojave të të gjithë njerëzimit deri në ditën e Kiametit. Madje, ai nuk ka nevojë as për fetë e tjera të prishura, as për besimet e kota dhe as për filozofit e mangëta njerëzore.

një fëmijë i zgjuar, nuk e pranon që një pjesë teatrale të mbarojë në këtë mënyrë. Atëherë, si mund të mendohet që Allahu i Madhëruar, i Cili ka krijuar çdo gjë në mënyrë të përsosur dhe di gjithçka, ta mbyllë historinë e kësaj Gjithësie të stërmadhe në një mënyrë që as edhe një fëmijë nuk do ta bënte?!⁹

Është një realitet i qartë fakti se të gjithë vijnë në këtë botë nga një derë, pra nga barku i nënës, e më pas të mbushur me sjellje dhe ndjenja trupore e shpirtërore, jetojnë në këtë botë të përkohshme, e cila i ngjan një piste vrapimi me pengesa. Pasi e kalojnë korridorin e shkurtër midis djepit dhe varrit, hyjnë nga dera e vdekjes dhe hedhin hapin drejt varrit, që është edhe stacioni i parë i Botës tjetër. Varri është salla e pritjes së gjykatës hyjnore, ku do të gjykohemi në ditën e Kiametit.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Jobsimtarët thonë: «Nuk do të na vijë Ora (e Kiametit)!» Thuaju: «Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t’ju vijë!» Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t’i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë.” (Sebe’, 3)

“Allahu! Nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai do t’ju mbledhë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka dyshim aspak! E kush është në fjalë më i vërtetë se Allahu?” (Nisa, 87)

“(Njeriu) pyet: «Kur do të jetë Dita e Kiametit?»

Por, kur t’i verbohen sytë, të zihet Hëna dhe Dielli e Hëna të bashkohen, atë ditë njeriu do të thotë: «Ku të iki?»

Askund! S’ka strehë! Atë ditë, streha është tek Zoti yt. Atë ditë, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë.” (Kijame, 6-13)

“Thuaju: «Allahu jua jep jetën, pastaj ju bën të vdisni e mandej do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit e për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi; por shumica e njerëzve nuk e dinë.» I Allahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës! E kur të arrijë Ora (e Kiametit), atë ditë mohuesit do të humbasin.” (Xhathije, 26-27)

9. Shih. Dr. M. S. Ramadan el-Buti, *Kubra'l-Jakinijati'l-Keunijje*, fq.180.

“Thuaj: «Bëhuni gurë ose hekur, ose çfarëdo krijese tjetër që është më e madhe sipas jush!»

Ata do të thonë: «Kush do të na kthejë ne (në jetë?)»

Thuaj: «Ai që ju ka krijuar herën e parë.»

Ata do t’i tundin kokat nga ti e do të pyesin: «Kur do të bëhet ajo?»

Ti thuaju: «Mund të vijë shpejt!» (Isra, 50-51)

Pra kjo botë, në cilën jetojmë, është mbushur e është zbratur nga njerëzit që prej Ademit ﷺ, e deri në ditët tona, si shembulli i një hani me dy porta. Por a ka dijeni prej njerëzve se ku janë ata tani? Ose, ku do të jemi ne pas njëfarë kohe? Mister!.. Mirëpo diçka është e sigurt, se vdekja vjen edhe për shtypësit edhe për të shtypurit, edhe për të devotshmit edhe për gjynahqarët... e të gjithë presin Kiametin, që është fillimi i Jetës së përjetshme...

Toka mbi të cilën shkelim dhe ecim është e mbushur me kufomat e miliarda njerëzve të shndërruar në dhe. Miliarda silueta të vendosura njëra mbi tjetrën... Nesër edhe ne do të varrosemi bashkë me veprat tona në gjirin e kësaj toke, duke u shkrirë brenda siluetes së dendur. Më pas do të fillojë një jetë e përjetshme dhe një udhëtim i pafundëm. E meqenëse i gjithë ky rrugëtim nuk është alternativ atëherë duhet të ndalemi pak e të mendojmë:

Dynjaja pranë Ahiretit...

E çfarë rëndësie ka nëse në këtë botë kalimtare kemi jetë të gjatë apo të shkurtër? Në të vërtetë, jeta e kësaj bote të përkohshme është veç një flluskë sapuni në krahasim me jetën e përjetshme të Ahiretit. Sado gjatë të jetojë biri i njeriut në këtë botë kalimtare, jeta e tij në krahasim me jetën e botës tjetër do të jetë shumë e shkurtër. Lidhur me këtë fakt Kurani Fisnik urdhëron:

“Ai do t’u thotë (jobesimtarëve):

«Sa vjet keni qëndruar në Tokë?» Ata do të përgjigjen:

«Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë dite. Pyesni ata që i kanë numëruar!» Ai do të thotë:

«**Keni qëndruar shumë pak. Eh, sikur ta kishit ditur!**» (Mu'minin, 112-114)

Ndërsa në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar sqaron:

“**Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.**” (Naziat, 46)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, për t’ia lehtësuar mendjes njerëzore kuptimin e kohës, vlerës dhe madhësisë së Ahiretit në krahasim me jetën e dynjasë, është shprehur:

“Për Allahun! Dynjaja ne krahasim me Ahiretin është si të fusësh gishtin në oqean dhe të shohësh sa ujë ke marrë. (Muslim, Xhennet, 55)

Ndërsa poeti mistik Junus Emre e ka shprehur në mënyrë shumë të bukur faktin se ekzistenca jonë në këtë botë të përkohshme në fakt është vetëm një pushim i shkurtër në një konak:

*Prej barkut të nënës erdhëm në Pazar,
Morëm një qefin, u kthym në varr!..*

Prandaj, e gjithë detyra jonë është që këtë jetë, e cila është shumë e shkurtër në krahasim me jetën e botës tjetër, ta zbukurojmë me devotshmëri, adhurime dhe bindje ndaj Allahut të Madhëruar.



Nga ana tjetër, mund të themi se ditët e shkurtra të jetës në këtë botë, janë më të vlefshme në krahasim me ato të botës tjetër, sepse ajo botë është vendi ku do të merren shpërblimet, ndërsa kjo botë është vendi ku punohet për t’i fituar ata.

Transmetohet se, kur Iljasi عليه السلام pa përballë vetes melekun e vdekjes, u dridh i tmerruar. Mirëpo, Azraili عليه السلام i çuditur nga kjo e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! A u frikësove nga vdekja?”

Iljasi عليه السلام u përgjigj:

“Jo! Unë nuk u frikësova nga vdekja, në të vërtetë më frikësoi fakti se do t’i jap lamtumirën kësaj bote...” Më pas vazhdoi duke thënë:

“Në jetën e kësaj bote përipiqesha të adhuroja Zotin tim, të nxisja vep-



rimet e mira, e të ndaloja këdo nga vepra e keqe. Kohën e mbushja me adhurime dhe vepra të mira, duke u munduar të jetoja me moral të bukur. Dhe kjo gjendje ishte burim paqeje për mua dhe ma mbushte zemrën me lumturi dhe gëzim shpirtëror. Prandaj jam shumë i mërzitur, sepse kur të vdes, nuk do t'i përjetoj më këto kënaqësi dhe do të mbetem si peng në varr deri në ditën e Kiametit!”



Ndërsa Amir ibn Abdilkajsi, prej brezit të tabiinëve, kur e ndjeu se po i afrohej vdekja, filloi të qante. Kur e pyetën:

“Pse po qan?”, ai u përgjigj:

“Nuk po qaj as nga frika e vdekjes, e as për shkak të lakmisë për këtë botë. Unë po qaj sepse do të privohem nga agjërimi në ditët e nxehta dhe ngritja në adhurimet e natës.” (Dhehebi, Sijer, IV, 19)



Lidhur me të vërtetën se lumturia e Ahiretit fitohet në dynja, i nderuari i Xhunejd Bagdadi është shprehur:

“Një ditë e kësaj bote është më e vlefshme se njëmijë ditë të botës tjetër, sepse fitimi dhe humbja përjetohej vetëm në këtë botë. Ndërsa në botën tjetër nuk do të ketë më mundësi të bëhet diçka për arritur shpëtimit.”

Le të mendojmë pak nëse Allahu do na kishte dhënë njëmijë vite jetë, pra nëse do të lindnim në vitin 1000 e do të jetonim në luks e mirësi deri në vitin 2000... Në fund, përsëri do të vdisnim! Pra sado gjatë të jetonim, jeta e përkohshme e dynjasë do të ishte vetëm një periudhë e shkurtër në krahasim me jetën e përhjetshme të Ahiretit. Prandaj:

Cila mendje do të zgjidhte “çastin” në vend të “së pafundmes”?!

Mendja e atyre që zgjedhin dynjanë në vend të Ahiretit, nuk ndryshon aspak nga mendja e fëmijës që kujton se qepa që ka në dorë është ushqimi më i shijshëm në botë, për shkak se nuk i njej ushqimet e tjera të llojllojshme. Të zgjedhësh këtë botë të përkohshme në vend të botës së pafundme të Ahiretit, do të thotë të kesh të njëjtën mendje me atë të zogut



të mjerë që preferon kafazin e ngushtë ndërkohë që mund t'i rrahë krahët në qiellin paanë e pafund.

I ndjeri Nexhip Fazëll, e përmbledh me dy rreshta këtë indiferencë të madhe:

*Ora ime plot tridhjetë vite ka punuar, e unë paskam ndaluar,
Pa dijeninë e qiellit, balona kam fluturuar...*

Ndërsa një njeri i urtë ka thënë:

“Nëse dynjaja do të ishte prej ari dhe e përkohshme, ndërsa Ahireti prej balte dhe i përjetshëm, njeriu i mençur do të zgjidhte të përjetshmen në vend të përkohshmes. Po sikur të ishte e kundërta e kësaj pra dynjaja të ishte prej balte dhe e përkohshme, ndërsa Ahireti prej ari dhe i përjetshëm, vallë çfarë duhej bërë?”¹⁰

Padyshim se një mendje e shëndoshë nuk do t'i ndërronte fitimet me dobi të pafundme, me interesa të vogla, të thjeshta e të përkohshme. Për këtë arsye, detyra e një njeriu me mendje të mprehtë është të ruhet nga joshja e kësaj bote të përkohshme dhe të përpiqet të fitojë lumturinë e Ahiretit të përjetshëm.

Në një hadith fisnik, njerëzit me të vërtetë të mençur përkufizohen me këto fjalë:

“I mençur është ai që punon për pasvdekjes duke mbizotëruar ndaj egos dhe duke e llogaritur atë. Ndërsa budalla është ai që shpreson prej Allahut, edhe pse e ka vënë veten në ndjekje të dëshirave.” (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459)

Nën dritën e këtyre të vërtetave duhet të peshohet gjendja reale e mendjes sonë. Domethënë, i mençur është ai që jep të përkohshme dhe fiton të përherëshmen. Ndërsa njeriu që e harron Ahiretin dhe mashtrohet nga dynjaja, është i shkujdesur dhe indiferent. Siç shprehet edhe Omeri رضي الله عنه, ai që shet Ahiretin e vet për hir të dynjasë së dikujt tjetër është edhe injorant, edhe i marrë!.. Sepse Allahu nuk i jep vlerë atij që e harron Ahiretin duke u zhytur në këtë botë, e cila tek Allahu nuk ka vlerë as sa krahu i një mize.

Për këtë arsye, Lukman Hakimi ka këshilluar:

“Flijoje dynjanë tënde për Ahiretin, që t'i fitosh të dyja. Por mos e flijo Ahiretin për dynjanë, sepse i humbet të dyja.”

10. Ebu'l-Abbas Ahmed ibn Muhamed Ibn-i Axhibe, el-Bahru'l-Medid fi Tefsiri'l-Kurani'l-Mexhid, Kajro 1419. II, 112.

Dynjaja është si një mirazh mashtrues që egove të papërpunuara, që nuk e kanë arritur përsosmërinë, iu ngjan si ujë. Figurativisht mund të krahasohet me mollën e sheqerit që pëlqehet shumë nga fëmijët ngaqë nga jashtë reflekton ngjyra të ëmbla, por në fakt brendësia ka përmbajtje të thartë dhe të prishur.

Në Kuranin Fisnik sqarohet:

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (Hadid, 20)

“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia pakëson kujt të dojë. Jobsimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote në krahasim me botën tjetër është vetëm kënaqësi kalimtare.” (Ra'd, 26)

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!” (Ankebut, 64)

“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse bota tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?” (En'am, 32)

“Mjerë ata që jetën e kësaj bote e duan më shumë se atë të botës tjetër, që largojnë njerëzit nga rruga e Allahut dhe dëshirojnë ta shtrembërojnë atë! Ata janë në humbje të madhe.” (Ibrahim, 3)

“Kjo, sepse ata e duan më shumë jetën e kësaj bote, sesa jetën e botës tjetër; Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë mohuesit.” (Nahl, 107)

“Këta janë ata që jetën e kësaj bote e kanë blerë me jetën e ardhshme. Atyre nuk do t'u lehtësohet dënimi dhe askush nuk do t'u vijë në ndihmë.” (Bekare, 86)

“...Thuaju: «Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta tjetër

është më e mirë për ata që e kanë frikë Allahun e s’bëjnë gjynahë...»” (Nisa, 77)

“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij xhehe-nemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpër-blehet.” (Isra, 18-19)

“Por ju doni këtë jetë (kalimtare), e për jetën tjetër nuk kujto-heni!” (Kijame, 20-21)

“...Në të vërtetë, jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme, ndërsa jeta tjetër është Shtëpi e përhershme.” (Gafir, 39)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, e shpreh këtë të vërtetë, me këto fjalë:

“O Allah! Jeta e vërtetë është ajo e Ahiretit! (Lumturia e vërtetë, është ajo e përjetshmja!)” (Buhari, Xhihad, 33, Salat, 48)


Po ashtu edhe në këtë hadith të transmetuar nga Abdullah ibn Mes’udi , ka shumë këshilla për ne:

Njëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, kishte fjetur mbi një hasër. Kur u ngrit nga gjumi, hasra kishte lënë gjurmë në trupin e Profetit ﷺ. Për këtë arsye ne i thamë:

“O i Dërguar i Allahut! A të gjejmë një dyshek për ju?!”

Por i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“E çfarë lidhje kam unë me dynjanë? Në këtë botë, unë jam si ai udhë-tari që pushon nën hijen e një peme, e më pas i hipën kafshës së vet dhe largohet prej aty.” (Tirmidhi, Zuhd, 44/2377)

Njëherë, Omeri  shkoi tek shtëpia e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Kur hyri, hodhi sytë përçark dhomës dhe vuri re se në dhomë nuk kishte asgjë (asnjë mobilje), përveç një hasre të thurur me gjethe hurmash, mbi të cilën ishte shtrirë i Dërguari i Allahut ﷺ. Hasra e thatë kishte lënë gjurmë në lëkurën e bekuar të Profetit ﷺ. Ndërsa në një qoshe gjendej pak miell elbi, e pranë tij një kacek i vjetër uji, i varur në mur. Kaq ishte gjithçka!.. Kjo ishte e gjithë pasuria e kësaj bote e Profetit ﷺ, në kohën kur i gjithë Gadishulli Arabik i bindej atij.



Kur Omeri ﷺ e pa këtë gjendje, mori frymë thellë dhe duke mos e mbajtur dot veten filloi të mbytej në lot. Profeti ﷺ, e pyeti:

“Pse po qan o Omer?”

“Si të mos qaj o i Dërguar i Allahut! Kajseri dhe Kisra notojnë në mirësitë e kësaj bote, ndërkohë që i Dërguari i Allahut jeton mbi një hasër të thatë!?” - tha Omeri ﷺ.

Profeti ﷺ e qetësoi Omerin ﷺ kështu:

“Mos qaj o Omer! A nuk është më mirë që të gjitha mirësitë dhe kënaqësitë e dynjasë të jenë të tyre, ndërsa ato të Ahiretit të jenë tonat?!”¹¹

Po ashtu, edhe Allahu i Madhëruar i paralajmëron kështu besimtarët që i kanë zili njerëzit gjynahqarë për pasuritë, rehatinë dhe luksin në të cilin ata jetojnë në këtë botë:

“Dhe, sikur (të mos kishte rrezik që) njerëzit të mos bëheshin një bashkësi mohuesish, Ne do t’i bënim prej argjendi çatitë e shtëpive të atyre që nuk besojnë në të Gjithëmëshirshmin, madje edhe shkallët nëpër të cilat ngjiten, edhe dyert e shtëpive të tyre, edhe divanet në të cilat mbështeten. Po ashtu (do t’u jepnim edhe) stoli prej ari. Por të gjitha këto janë vetëm kënaqësi të kësaj jete, kurse jeta tjetër te Zoti yt është për punëdrejtët që ruhen (nga gjynahet dhe nga dënimi i Allahut).” (Zuhruf, 33-35)

“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!” (Al-i Imran, 196-197)

“Në të vërtetë, atyre që nuk besojnë në jetën tjetër, Ne kemi bërë që t’u duken të bukura veprat e tyre, prandaj ata ecin verberishtë. Janë pikërisht ata që i pret dënimi i rëndë dhe, në jetën tjetër do të jenë më të humburit.” (Neml, 4-5)

Po ashtu i nderuari Mevlana ka thënë:

“Njeriu, i cili kërkon dynjanë që është e përkohshme, ka kërkuar diçka

11. Shih. Ahmed, II, 298; Taberani, el-Mu’xhemu’l-Kebir, tahk. Hamdi Abdulmexhid es-Selefi, Bejrut, Daru Ihjai’t-Turathi’l-Arabi, X, 162.

të keqe sa s'bëhet më! Ndërsa ai që kërkon Ahiretin, ka kërkuar të mirën, të bukurën dhe të drejtën.”

Një person shkoi tek Sufjan Theuri dhe i tha:

“Më këshillo!”

Dhe ai e këshilloi:

“Puno për dynjanë tënde aq sa do të rrish në dynja dhe puno për Ahiretin tënd aq sa do rrish atje!..Us-selam!” (Ebu Nuajm, Hilje, VII, 56)

Prandaj shpesh duhet të mendojmë:

Sa rëndësi i japim jetës së kësaj bote të shkurtër dhe sa rëndësi i japim jetës së përjetshme të botës tjetër?

Sot njerëzimi po bën shumë kërkime shkencore me qëllim rritjen sado-pak të jetëgjatësisë në këtë botë, e madje edhe që të mund shpëtojë nga vdekja. Për këtë qëllim janë shpenzuar shumë mund e pasuri në prodhimin e ilaçeve dhe produkteve kozmetike. Mirëpo, në jetën e vërtetë të botës tjetër askush nuk do të shqetësohet nëse ka jetuar pak apo shumë në dynja. Atje të gjithë do të kenë hall se sa kapital për botën e përjetshme kanë fituar apo humbur në jetën e shkurtër të dynjasë, e cila krahasuar me jetën e Ahiretit ngjan vetëm me një mbrëmje, apo me një paradite...

Shumë njerëz, edhe pse i dinë këto të vërteta, bien pre e egos së tyre dhe nuk arrijnë të shpëtojnë nga indiferenca. Në Kuranin Fisnik lajmërohet:

﴿١٦﴾ بَلْ تُؤْتُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ﴿١٦﴾ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٧﴾

“Por ju, perkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.” (A'la, 16-17)

Lidhur me këtë çështje, dëshiroj të ndaj me ju një vëzhgim personal, që ka përfshirë zemrën time në mendime të thella:

Një ditë, teksa po dilja nga shtëpia për të shkuar në namazin e Sabahut, dëgjova nga jashtë rënkime macesh, që të këpusnin shpirtin. U bëra kureshtar dhe kur dola në oborr vura re dy mace që qëndronin përballë njëra-tjetrës, gati për sulm. Ato hungërinin si tigra të vegjël dhe e shikonin njëra-tjetrën pa lëvizur. Qimet u ishin ngritur përperjetë dhe ishin gati të copëtonin njëra-tjetrën në lëvizjen më të vogël.

Ndërkohë që po mendoja për shkakun e kësaj hasmërie të tepruar, vura re se midis tyre qëndronte një mi i vogël i ngordhur. Macet kishin filluar një dyluftim të tillë vetëm për atë mi të cofur. Ato dëshironin ta godisnin njëra-tjetrën vetëm për atë mi të vogël që qëndronte në mes!..

Kjo shfaqje, e cila duket si diçka krejt e zakonshme, në fakt bart një mesazh shumë mësimdhënës për ne, sepse paraqet më së miri para nesh pasojat negative që sjell rendja pas lakmive të kësaj bote. Në njëfarë kup-timi të kujton këdo që për hir të ambicieve të kësaj bote, zgjedh humbjen në botën tjetër. Kjo tregon se shumë dëshira kalimtare, pasione dhe lakmi për pozita e pushtet, të cilat ndiqen nga njerëzit indiferentë, janë thjesht cofëtina dhe se nuk ia vlenë aspak të çosh dëm mirësitë e përjetshme të Ahiretit për to.

Të mos mjaftuarit me mirësitë e lejuara, me të cilat është i kënaqur Allahu i Madhëruar, dhe mashtrimi me gjërat joshëse që dëshiron egoja, e çojnë njeriun drejt një fundi shumë të hidhur. Këtë e tregon më së miri edhe shembulli i mëposhtëm:

Gjatë Miraxhit, Xhibrili عليه السلام me të Dërguarin e Allahut ﷺ, kishin parë një grup njerëzish që po dënoheshin. Para tyre kishte ushqime të shijshme me mish të pjekur dhe cofëtina të kalbura e të papjekura. Ata i linin ushqimet e shijshme dhe hanin cofëtinat e kalbura. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, pyeti se kush ishin ata, Xhibrili عليه السلام, iu përgjigj:

“Ata janë burrat e ummetit tënd që linin gruan e tyre që e kishin hallall e shkonin me gratë e tjera që i kishin haram dhe gratë që i linin burrat e tyre dhe shkonin me burrat që i kishin haram.” (Hejthem, I, 67, 68)

Kapja me pasion pas kënaqësive të kësaj bote pa bërë kujdes nëse janë hallall apo haram, duke neglizhuar botën tjetër, llogarinë dhe ndëshkimin, është një mashtrim i hidhur që e dënon njeriun me privime, turpërim dhe torturë të tmerrshme.

Prandaj është shumë për t'u habitur me atë person që punon vetëm për këtë botë, edhe pse beson se Ahireti është vendi i përjetësisë! Nuk ka marrëzi më të madhe se sa të konsumosh pa asnjë kriter jetën e kësaj bote, sikur nuk do të përfundojë kurrë dhe të mos e kthesh atë në një kapital për botën tjetër. Kjo botë nuk është fushë loje dhe argëtimi, por është i vetmi vend ku mund të sigurohet kapitali për botën tjetër. Lidhur me këtë në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَأَتَّبِعْ فِيمَا آتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ ۗ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا
وَأَحْسِنْ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ...

“Përpiqu të fitosh jetën e botës së ardhshme me atë që të ka dhënë Allahu, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!..” (Kasas, 77)

Në këtë porosi hyjnore theksi qëndron në të kuptuarit që për të arritur lumturinë e botës tjetër, njeriu nuk duhet të heqë dorë nga kjo botë, por duhet të japë prej mirësive që i ka dhuruar Allahu në këtë botë, në mënyrë që Ai të jetë i kënaqur dhe me qëllim që të na i kthejë ato në kapital për botën tjetër.

Një ditë një prej të dashurve të Allahut, i nderuari Xhunejd Bagdadi, rastisi pranë një personi që shiste akull. Kur dëgjoji shitësin të thërriste: “Ndihamoni atë që po i tretet kapitali!” (duke aluduar për veten), u trondit jashtë mase dhe ra pa ndjenja.

Siç theksohet edhe në suren Asr, njeriu është një udhëtar përjetësie, të cilit i konsumohet kapitali ditë pas dite e çast pas çasti. Nëse ai nuk arrin ta kthejë kapitalin e dynjasë në kapitalin e Ahiretit, me anë të horizontit të besimit, përpjekjet e tij në këtë botë janë vetëm mirësi që shejtanët do t’i ndajnë me njëri-tjetrin. Ndërsa përfundimi i tij, do të jetë humbje e madhe dhe dënim i dhembshëm.

Osmani , shprehet:

“Padyshim se dynjaja është e përkohshme, ndërsa Ahireti i përjetshëm. Mos t’ju përkëdhelë e mos t’ju harbojë e përkohshmja... mos t’ju pengojë nga e përhershmja! Zgjidhni të përhershmen në vend të së përkohshmes, sepse dynjaja ka fund dhe kthimi është tek Allahu. Kini frikë Allahun!” (Ibni Ebi’ d-Dunja, Meusu’a, I, 77)

Përgatitja për Ahiret

Njëherë, i Dërguari i Allahut , e pyet Ebu Dherin:

“Kur dëshiron të dalësh për udhëtim, a përgatitesh?”

Ebu Dheri , u përgjigj:

“Po o i Dërguar i Allahut!”



Profeti ﷺ, vazhdoi më tej:

“Mirë, por si do të jetë udhëtimi i ditës së Kiametit? Dëgjomë, a të t'i them ato që do të kenë dobi për ty atë ditë?”

Ebu Dheri رضي الله عنه me entuziazëm të madh pohon:

“Po o i Dërguar i Allahut! T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im!”

Kësaj here Profeti ﷺ tha:

“Dita e ringjalljes është një ditë shumë e nxehtë. Për t'u freskuar atë ditë agjëro që tani!

Për vetminë e varrit fal dy rekat namaz në errësirën e natës!

Për ndodhitë e mëdha të Kiametit bëj njëherë haxhin dhe jep sadaka!

Ose fol drejtë, ose pengoje gjuhën nga të folurit fjalë të këqija!” (Ibni Ebi'd-Dunja, Kitabu't-Tehexhxhud; Gazali, Ihja, I, 354)

Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ وَاتَّقُوا اللَّهَ
إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se çfarë ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!” (Hashr, 18)

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar përdor fjalën “**nesër**” kur flet për Ahiretin. Zoti ynë, i Cili nuk ndikohet nga koha dhe hapësira, në lidhje me vaktin e Kiametit dhe Ahiretit flet për një kohë që është e afërt sa e “nesërmja”, ndërkaq mohuesve u duket sikur s'do të vijë kurrë, ndërsa indiferentëve u duket larg.

Ndërsa në këtë ajet fisnik, na bëhet e ditur se sa relativ është koncepti i kohës:

... وَإِنَّ يَوْمًا عِنْدَ رَبِّكَ كَأَلْفِ سَنَةٍ مِّمَّا تَعُدُّونَ

“...Një ditë te Zoti yt, është sa një mijë vjet sipas llogarisë suaj.” (Haxhxh, 47)

Për të korrur produktin e lumturisë së Ahiretit, që është jeta e pafundme e që në të vërtetë gjendet afër sa e “nesërmja”, nuk duhet të vonohemi e të neglizhojmë mbjelljen e farave të punëve të mira sot në arën e kësaj bote. Ne duhet ta përdorim aq mirë kohën që kemi në dispozicion, saqë edhe po të na lajmërohet që nesër do të vdesim, ne nuk duhet të ndjejmë asnjë nevojë për të ndryshuar diçka në programin e jetës sonë!

Këto këshilla të Shejh Sadi Shirazit, janë shumë domethënëse:

“Furnizimin për në botën tjetër bëje vetë, sepse pasi të kesh vdekur të afërmit e tu mund t’i kaplojë lakmia dhe nuk bëjnë asnjë bamirësi për shpirtin tënd. Floririn dhe të mirat që ke jepi sot sa je gjallë! Pasi të kesh vdekur, këto të mira nuk mund t’i kesh më! Nëse dëshiron të mos vuash, mos i hiq nga mendja të vuajturit! Ndaje shpejt atje ku duhet thesarin, sa e ke në dorë sot, e mos e lër për nesër, sepse nesër çelësat mund të mos i kesh më. Furnizimin dërgoje vetë që sot! Pasi të vdesësh mos prit mëshirë nga gruaja e nga fëmija jot!

Ai që e përgatit vetë furnizimin për në botën tjetër, ka bërë punën më të rëndësishme. Kurrizin tim, vetëm thoi im mund ta kruajë duke menduar për mua, e askush tjetër.

Çfarëdo lloj pasurie të kesh, vendose në pëllëmbë të dorës dhe jep aty ku duhet dhënë! Nëse nuk jep, nesër do të pendohesh dhe do të kafshosh duart.”

Allahu i Madhëruar, në këtë ajet na bën të ditur furnizimin më të mirë që na duhet për udhëtimin e përjetësisë:

...وَمَا تَفْعَلُوا مِنْ خَيْرٍ يَعْلَمُهُ اللَّهُ وَيَزِيدُوا فَإِنَّ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَىٰ
وَأَتَّقُوا يَا أُولِي الْأَبْصَارِ

“...çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”

(Bekare, 197)

Allahu i Madhëruar dëshiron të bëhet mik me robërit e Tij. Mënyrat e arritjes së miqësisë i përkufizon në urdhrat hyjnorë. Kurse vetë miqësia rrjedh prej gjërave të përbashkëta. Që të bëhesh mik me Allahun e Madhëruar, është kusht që të duash ata që Ai do dhe të braktisësh ata që Ai nuk i do.



Furnizimi më i çmuar që mund të çohet në botën tjetër, është **“takua-ja”** (frikë-respekti ndaj Allahut), që nënkupton pajisjen me cilësi të mira që kënaqin Allahun dhe dëlrirjen prej cilësive negative, të cilat Ai nuk i do. Për të arritur miqësinë me Allahun, duhet t’i transmetosh një zemër të pastër e të zbukuruar me ndjesinë e **“takua-s”**.

Duke u nisur nga kjo e vërtetë, i nderuari Mevlana, në veprën e tij Mesnevi shprehet:

“Nëse dëshiron të miqësohesh me Allahun e Madhëruar, dije mirë se tek miqtë nuk shkohet duarbosh! Të shkosh duarbosh tek miqtë, është si të shkosh pa grurë në mulli.

Allahu i Madhëruar do t’i pyesë robërit e Tij në ditën e gjykimit:

«Çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit?»

Pastaj do të thotë:

«Ju keni ardhur duarbosh, pa furnizim, të vetmuar dhe nevojtarë ashtu siç ju krijuam në fillim. Na tregoni çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit? Apo ndoshta nuk shpresonit se do të ktheheshit nga dynjaja në Ahiret e do të dilnit para Allahut? A mos ju duk kot lajmi i Kuranit në lidhje me Kiametin?»

O ahsen-i takuim, pra, o njeri që je krijuar me cilësitë më të bukura! Nëse nuk e mohon ditën e Kiametit, si shkel në derën e Atij Miku kështu, duarbosh? Pakësoje gjumin, ushqimin dhe pijen në këtë botë të përkohshme dhe përgatit një dhuratë për kohën kur do të takohesh me Allahun e Madhëruar!..”

Shkurtimisht, dhurata më e bukur që mund t’i çohet Allahut të Madhëruar është pasqyra e një zemre të lehtë e të pastër, ku manifestohen emrat e Tij të bukur.

Dobitë e besimit në botën tjetër

Besimtari që jeton me vetëdijen se dynjaja është e përkohshme, ndërsa Ahireti është i përjetshëm, nuk e lidh zemrën e vet me këtë botë, e di se mirësitë e përkohshme janë shkaqe të sprovave hyjnore dhe të gjitha këto mirësi i përdor në përputhje me kënaqësinë e Allahut. Pra, shqetësimi për botën tjetër dhe përpjekja për t’u përgatitur për vdekjen, luan rolin e një rregullatori të drejtimit të robit. Për rrjedhojë, një besimtar që thotë:



إِنَّا نَخَافُ مِنْ رَبِّنَا يَوْمًا عَبُوسًا قَمْطَرِيرًا

“Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.” (Insan, 10), është e qartë se ai do të largohet nga gjynahet dhe do të shtojë punët e mira.

Njeriu indiferent jeton sipas qejfit të vet, larg shqetësimit për botën tjetër. E në fakt, ai është i mposhtur nga egoja e tij, por nuk është i vetëdijshëm për këtë dhe mjerimin e vet e pandeh lumturi. Ai e konsumon jetën në një letargji të tmerrshme, sikur të mos ekzistonin fare fazat e frikshme që e presin në varr dhe në Ahiret.

Asnjë ndodhi nuk asgjësohet vetëm prejse dikush nuk e pranon ekzistencën e saj. Për më tepër, deri më sot nuk është dëgjuar asnjëherë që të kenë shpëtuar nga vdekja ata të cilët ikin prej saj dhe prej Ahiretit e Allahut. Po ashtu, frika e thatë ndaj vdekjes nuk ja ka shtyer askujt afatin e saj.

Realiteti i vdekjes dhe Ahiretit, një ditë do t’u dalë përballë edhe atyre që i mohojnë. Lumturia e rreme dhe të qeshurat false që shfaqin sot njerëzit indiferentë, atë ditë do të kthehen në dështim dhe pendim, që të djeg shpirtin.

Besimi në botën tjetër e bën njeriun e mençur të mendojë se një ditë do t’i pritë lidhja me dynjanë, do të përballet me të mirat dhe të këqijat që ka vepruar dhe do të marrë, pa asnjë mangësi, shpërblimin e të gjitha veprave të tij pozitive e negative. Pra, të meditosh në lidhje me vdekjen dhe Ahiretin, bëhet shkak i vetëdijesimit, i prishjes së lidhjes së zemrës me këtë botë, i korrigjimit të veprimeve e sjelljeve dhe i qëndrimit sa më larg gjynaheve.

Mendimi rreth vdekjes, ndërkohë që është mes të mirave dhe luksit, e ruan robin nga ndikimi negativ i pasurisë. Ndërsa mendimi për të, ndërkohë që është i varfër e nevojtar, e bën robin të kënaqur me atë që zotëron, falënderues dhe të qetë në shpirt.

Sprova më e madhe dhe katastrofa më e tmerrshme për njeriun është vdekja. Por më keq akoma është të jetosh indiferent ndaj vdekjes dhe jetës përtej saj, të fshish mendimin për to dhe të konsumosh kapitalin e jetës pa bërë asnjë vepër që meriton kënaqësinë e Allahut. Ajo që i ka hije një njeriu të mençur është përgatitja ende pa i ardhur vdekja. Pikësëpari duhet të pastrohet egoja nga zakonet e këqija, sepse një ego e papërpunuar dhe e



paedukuar me kriteret hyjnore, nuk mund ta pranojë kurrë përkohshmërinë dhe vdekjen. Lidhur me egon, Ismail Hakki Bursevi shprehet:

“E si të bëhet myslimane egoja?! Ajo është nëna e mohimit. Madje edhe shejtani u bë mohues për shkak të egos.”¹²

Pra nëse nuk frenohet egoja dhe nuk i kufizohen në minimum dëshirat dhe lakmitë, ajo nuk do t'i lejojë hapësirë të menduarit për vdekjen dhe gjithçka ka përtej saj, dhe në frymën e fundit egoja do e mbizotërojë shpirtin, duke u bërë shkak që njeriu të largohet pa besim në botën tjetër (Allahu na ruajt!).

Për t'i shpëtuar këtij rreziku të madh, është e domosdoshme që egoja të edukohet dhe të pastrohet, ndërsa shpirti të përforcohet me adhurime dhe përmendje të Allahut.

I nderuari Shejh Sadi, shprehet kështu në lidhje me nevojën e edukimit të egos para se të vijë vdekja:

“O vëlla, në fund do të bëhesh dhe! Prandaj bëhu modest si dheu para se të bëhesh dhe!”



I Dërguari i Allahut ﷺ, urdhëron:

“Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, të mos e shqetësojë fqinjin e vet! Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, le të gostitë mikun! Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, ose të flasë fjalë të dobishme, ose të heshtë!” (Buhari, Nikah 80, Edeb 31, 85, Rikak 23; Muslim, Iman, 74, 75)

Një besimtar, që u vë veshin dhe zemrën këtyre porosive profetike, i karakterizon marrëdhëniet e tij ndërnjerëzore përherë me tipare si mëshira, delikatesa, mirësjellja, edukata dhe respekti.

Besimi në botën tjetër forcon ndjenjën e përgjegjësive në zemra dhe nxit përpjekjet për kryerjen me përpikëri të detyrave dhe përgjegjësive. Dijenia se Allahu vëzhgon vazhdimisht, se veprat regjistrohen çdo çast dhe se në botën tjetër do të merremi në llogari, mundëson që të fitohet ndjenja e ruajtjes nga veprimet e palejueshme, qoftë edhe aty ku nuk na

sheh askush. Ndërsa veprat e mira që bëhen larg syve të njerëzve janë më të suksesshme në arritjen e misterit të “sinqeritetit”. Prandaj, kohët dhe rastet e tilla, konsiderohen si mundësi të mëdha për fitimin e kënaqësisë së Allahut. Në këtë mënyrë, njeriu bëhet një krijesë e pastër, të cilit i besohet në çdo lloj situatë.

Nga ana tjetër, Ahireti është një botë, ekzistenca e së cilës është e domosdoshme edhe për shtypësit, edhe për të shtypurit, edhe për të këqijtë, edhe për të mirët. Kjo, sepse nuk ka asgjë më të natyrshme se shpërblimi i të mirëve dhe ndëshkimi i të këqijve. Njëlloj funksionon edhe në kushtet e kësaj bote. Nëse nuk do të kishte vend ku të strehoheshin të mirët dhe burgje ku të burgoseshin të këqijtë, jeta do të bëhej e padurueshme. Madje, vetëm për hir të kësaj urtësie, është i domosdoshëm edhe besimi në ekzistencën e Ahiretit.

Nga një anë, njeriu dëshiron ta ndëshkojë edhe një mizë që e pickon, e nga ana tjetër, një kafe e mban mend për vite me radhë. Prandaj është e kotë të mendosh se sjelljet negative apo pozitive gjatë një jete mund të ngelen pa marrë shpërblimin e tyre tek Allahu i Madhëruar, sepse në këtë botë ekziston mizoria e mizorit, rënkimi i të shtypurit, mohimi i mohuesit dhe besimi i besimtarit. E nëse nuk do të ekzistonte shpërblimi dhe ndëshkimi i këtyre sjelljeve, programi hyjnor që ka vënë gjithçka në shërbim të njeriut do të ishte i pakuptimtë dhe krijimi i njeriut do të ishte i kotë, gjë e cila nuk përputhet aspak me cilësitë e larta të Allahut, “**el-Adl**”¹³ dhe “**el-Hakim**”¹⁴. Mirëpo, Allahu i Madhëruar është larg prej çdo të mete dhe për rrjedhojë ai nuk do t’i bënte kurrë padrejtësi robit të Vet dhe nuk do të vepronte asgjë pa një urtësi të caktuar.

Në Kuranin Fisnik shprehet qartë:

“Ne nuk e kemi krijuar kot qiellin, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre. Kjo është hamendja e jobesimtarëve; prandaj mjerë jobesimtarët kur të hidhen në zjarr! A t’i trajtojmë njëlloj ata që besojnë e bëjnë vepra të mira dhe turbulluesit në Tokë?! A t’i trajtojmë njëlloj njerëzit e devotshëm dhe njerëzit e mbrapshtë?!”

(Sad, 27-28)

13. el-Adl: I Drejti

14. el-Hakim: I Urti

“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata! Allahu i krijoi qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë, në mënyrë që çdo njeri të jetë i shpërblyer për atë që ka punuar. E, askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.” (Xhathije, 21-22)

Pra Allahu i madhëruar do t’i shpërblejë të mirët dhe do t’i ndëshkojë të këqijtë në botën tjetër. Po sipas Kuranit:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë” (Zelzele, 7-8)

Ndërsa në suren Lukman urdhërohet:

“O djali im, Allahu do ta nxjerrë në shesh edhe veprën që peshon sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.” (Lukman, 16)

Përveç kësaj, njerëzit, prej zemrave të të cilëve është fshirë mendimi për botën tjetër dhe frikë-respekti ndaj Allahut të Madhëruar, është e sigurt se do të bëhen adhurues të interesave dhe qëllimeve të veta, duke u bërë kështu elementët më të dëmshëm të kësaj bote. Në syrin e njerëzve të tillë, përgjegjësitë fetare, morale e shpirtërore, dashuria për atdheun dhe njerëzit, janë gjëra qesharake. Aftësia dhe talenti më i madh, për këta moskokëçarës, është vetëm mashtrimi i njeriut.

Lidhur me problemet e personalitetit dhe karakterit të atyre që nuk besojnë në botën tjetër, Allahu i Madhëruar na jep këtë shembull në Kuranin Fisnik:

“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit!..” (Bekare, 264)

Gjithashtu, tentativa për të dobësuar mendimin e fesë dhe të Ahiretit tek njerëzit është një veprim shumë i rrezikshëm që mund t’i çojë shoqëritë drejt shkatërrimit. Shembuj të tillë janë vërejtur shumë, si në të shkuarën e largët, ashtu edhe në të afërtën.

Duhet theksuar se tek besimtarët që i besojnë botës tjetër dhe e rregullojnë jetën e tyre sipas këtij besimi, pavarësisht shqetësimit për dhënie e frymës së fundit me besim, nuk ekziston “frika nga vdekja”. Ideali për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të arritur paqen e përjetshme, e ndihmon njeriun ta jetojë jetën e tij në mënyrë të plotë dhe i jep edhe forcën për të duruar vuajtjet dhe vështirësitë e kësaj bote. Në fakt, kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote nuk arrijnë ta kënaqin kurrë shpirtin e njeriut, sepse paqja e shpirtit gjendet në kënaqësitë e larta shpirtërore të cilat fitohen në sajë të besimit.

Nisur nga kjo, në shumë ajete lidhur me vdekjen dhe Ahiretin, përdoret fjala, “*lika*” (likallah, likau’l-ahira), në kuptimin “*takim me Allahun, arritje në Ahiret*”:

مَنْ كَانَ يَرْجُو لِقَاءَ اللَّهِ فَإِنَّ أَجَلَ اللَّهِ لَآتٍ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

“Kush shpreson takimin e Allahut, ta dijë se Dita e caktuar nga Ai do të arrijë. Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (Ankebut, 5)

Domethënë se sado që vdekja është një ndarje e hidhur dhe plot mall për ata që mbeten pas, për zemrat besimtare është një shkak që siguron shpëtimin e shpirtit nga kafazi i trupit, kalimin nga e përkohshmja në të përhershmen dhe kthimin prej kurbetit në takimin me të Dashurin.

Gjithashtu, pa përpjekjet për t’u kthyer me shpirt të qetë dhe me nder tek Ai të cilit i takojmë, është e pamundur të flitet për ndonjë sukses në këtë botë. Lidhur me ata që nuk i besojnë Ahiretit, në Kurandin Fisnik thuhet:

“Kush janë më të padrejtë se ata që trillojnë gënjeshtër për Allahun? Ata do të sillen para Zotit të tyre, e dëshmitarët do të thonë: «Këta janë ata që kanë gënjer kundër Zotit të tyre. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët, të cilët pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe përpiqen ta shtrembërojnë atë, ndërsa vetë nuk besojnë në botën tjetër.»” (Hud, 18-19)

“Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me Allahun! Kur Ora (e Kiametit) t’u vijë papritur, ata do të thërrasin: «Të mjerët ne, sa shumë që e kemi neglizhuar (Kiametin) në jetën e Tokës!» dhe do të bartin gjynahet e veta mbi shpinat e tyre. Eh, sa e shëmtuar është ajo barrë!” (En’am, 31)



“O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.” (Nisa, 136)

Si e fton Allahu i Madhëruar para Vetes robin e Tij?

Allahu i Madhëruar i fton robërit e tij në Daru’s-Selam, pra në Xhenetin e Tij, që është vendi i shpëtimit dhe lumturisë. Por sigurisht që çdo ftesë ka edhe kushtet e pranimit sepse çdo mirësi e ka një çmim. Në Xhenet mund të hyhet vetëm me zemër të pastër, të ndritshme e të purifikuar. Kjo pastërti zemre është viza e hyrjes në Xhenet.

I nderuari Ebu’l-Hasan Harakani thotë:

“Allahu i Madhëruar ju dërgoi të pastër në këtë botë, prandaj mos dilni të papastër para Tij!” (Harakani, Nuru’l-Ulum, fq. 258)

Megjithëse njeriu e ka burimin nga uji i turbullt, kur lind ai ka aromë të këndshme, sy të përdritur dhe aftësi për të paqtuar zemrat. E gjitha kjo zë fill prej të qenit të tij i pafajëshëm dhe i pastër nga gjynahet. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar dëshiron që ne të mbetemi të dëlirë ashtu siç jemi dërguar në këtë botë, të bëjmë një jetë të pastër, të kemi librin e punëve të panjolllosur dhe të kthehemi përsëri tek Ai me zemër të kulluar.

Në Xhenetin e bukurive nuk mund të hyhet me papastërtinë e gjynahëve. Gjynahet janë njolla që nxijnë zemrën dhe shumimi i këtyre njollave bëhet shkak i verbimit të syrit të zemrës, gjë e cila çon në humbjen e kujdesit ndaj haremeve.

Omer ibn Abdulazizi ka thënë:

“Haramet janë zjarr. Dhe drejt tyre e zgjasin dorën vetëm ata që kanë zemra të vdekura. Nëse ata që i zgjasin duart do të kishin zemra të gjalla, patjetër që do ta ndjenin nxehësinë djegëse të atij zjarri.”

Zemrat të cilat nxihen nga gjynahet janë të verbra edhe ndaj dritës së të vërtetës. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik sqarohet:

...فَإِنَّهَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَارُ وَلَكِنْ تَعْمَى الْقُلُوبَ الَّتِي فِي الصُّدُورِ

“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (Haxhxh, 46)

وَمَنْ كَانَ فِي هَذِهِ أَعْمَىٰ فَهُوَ فِي الْآخِرَةِ أَعْمَىٰ وَأَضَلُّ سَبِيلًا

“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.” (Isra, 72)

وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمَىٰ

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.” (TaHa, 124)

قَالَ رَبِّ لِمَ حَشَرْتَنِي أَعْمَىٰ وَقَدْ كُنْتُ بَصِيرًا

“Ai do të thotë: «O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?»” (TaHa, 125)

قَالَ كَذَلِكَ أَتَتْكَ آيَاتُنَا فَنَسِيْتَهَا وَكَذَلِكَ الْيَوْمَ تُنْسَىٰ

“(Allahu) do t’i thotë: «Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato, e po kështu sot do të jesh i harruar.»” (TaHa, 126)

Shkurtimisht, ata që vijnë vërdallë me fytyra të vrenjtura e të ftohta, duke luajtur me indiferencë në shkollën e sprovave hyjnore brenda së cilës jetojnë, në botën tjetër do të jenë përjetësisht të verbër. Ndërsa ata, të cilëve u është verbuar syri i zemrës nga errësirat e gjynaheve, nuk mund ta gjejnë rrugën e Xheneitit për tek i cili na fton Allahu i Madhëruar. Është e domosdoshme që para Allahu të dalim me zemër të pastër. Edhe Profeti ﷺ e ka bërë të ditur rrugën që do t’i bëjë dobi robit në botën tjetër:

“Allahu i Madhëruar nuk shikon pamjen dhe pasurinë tuaj, por zemrat (sinqeritetin dhe devotshmërinë) dhe veprat tuaja.” (Muslim, Birr, 34)

Gjatë leximit të Kuranit Fisnik do të vërejmë se Allahu i Madhëruar i fton robërit e Vet të dalin para Tij me **“kalb-i selim”, “kalb-i munib”** dhe **“nefs-i mutmainne”**. Më poshtë po sqarojmë pak më gjerësisht keto tre terma:

Kalb-i selim, është zemra e ruajtur nga priirjet egoiste dhe sulmet e tyre, ose e pastruar nga rëndesa e gjynaheve. Në Kuran theksohet:

﴿٨٨٨﴾ إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ ﴿٨٨٩﴾

“Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shu’ara, 88-89)

Në këtë botë të përkohshme, e cila është ara e mbjelljes së Ahiretit, njeriu duhet të përpiqet të përmbushë kushtin që Allahu i Madhëruar vlerëson më së shumti - “kalb-i selim / zemrën e pastër”, me qëllim që të arrijë shpëtimin e përjetshëm. Për arritjen e nivelit të “kalb-i selim”, pikësëpari është kusht që në zemër të zërë vend një besim i cili përjetohet me dashuri e pasion, sepse vetëm në këtë mënyrë adhurimet mund të kryhen me përkushtim të lartë, në kuadër të harmonisë zemër-trup. Adhurimet që kryhen në këtë mënyrë janë vitamina për shpirtin.

Niveli “kalb-i selim”, të cilin Allahu i Madhëruar ia ka falur njeriut bashkë me natyrën e tij të pastër dhe ia ka lënë amanet, arrihet vetëm me pastrimin e egos dhe dëlirjen e zemrës. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar numëron disa cilësi të besimtarëve të vërtetë që zotërojnë nivelin “kalb-i selim”:

“...Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë!

Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, fërgëllojnë kur përmendet Allahu dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten!.. (Po ashtu edhe) **Ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë. Njëmend, ata janë besimtarë të vërtetë. Ata do të kenë shkallë përnderimi te Zoti i tyre, falje dhe furnizim bujar (në Xhenet).”**

(Enfal, 1-4)

Kalb-i munib, është zemra që drejtohet përherë nga Zoti dhe në çdo situatë gjen të vërtetën dhe të mirën. Kjo zemër e ndan qartë të mirën nga e keqja, tregon gjithmonë rrugën e drejtë me të cilën është i kënaqur Allahu dhe vrapon drejt kënaqësisë së Allahut, sa herë që i jepet mundësia. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“(Do t’u thuhet:) «Kjo është premtuar për ju, për këdo që është penduar dhe ruajtur (nga gjynahet), që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga Allahu).»” (Kaf, 32-33)



Nefs-i Mutmainne, është nefsi/egoja, e cila duke zbatuar siç duhet urdhrat e Allahut të Madhëruar dhe duke u ruajtur me kujdes prej ndalesave të Tij, ka shpëtuar prej sëmundjeve shpirtërore, ka gjetur paqen në besimin e vërtetë e të fortë dhe ka arritur të jetë e qetë dhe e kënaqur. Zemra është dëlirur prej dyshimeve dhe ngurrimeve me anë të begatisë së përmendjes së Allahut dhe në çdo çast falënderon dhe madhëron Allahun.

Në këtë gradë, cilësitë e shëmtuara e të këqija ia lënë vendin moralit të mirë. Po ashtu, në këtë gradë përjetohet mrekullisht, me një kënaqësi të papërshkrueshme, morali i lartë i Profetit ﷺ, i cili përbën majën e pjekurisë së sjelljeve dhe është shembull për të gjithë njerëzimin. Në këtë pikë zemra e njeriut kurorëzohet me durim, mbështetje tek Allahu, dorëzim dhe kënaqësi.

I nderuari Sami Efendi ka thënë:

“Mundësia e hyrjes në Islam, në kuptimin e plotë të fjalës, varet nga eliminimi i nefsit emmare dhe ndjekja me përpikëri e urdhrave hyjnorë. Islami që pranohet vetëm me zemër, para se të arrihet grada e nefsit mutmainne, quhet “Islam mexhazi/figurativ”, ndërsa besimi që arrihet pas ngritjes së nefsit/egos në gradën mutmainne, quhet “besimi i vërtetë”.¹⁵

Në këtë gradë asgjësohet perdja e trashë njerëzore që pengon shikimin dhe shfaqet drita e së vërtetës.

Nefsi në këtë gradë, ka merituar edhe përmendjen në instancat hyjnore me fjalët:

يَا أَيَّتُهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ

“O ti nefsi (ego, person, shpirt) i qetësuar!” (Fexhr, 27)

Siç theksohet edhe në ajetin në vijim, për shkak të kënaqësisë së qëndrueshme që ky nefsi ndjen ndaj Zotit të tij, ka fituar edhe kënaqësinë dhe pëlqimin e Zotit të vet. (shih. Fexhr, 28)



Në një hadith kudsij, të transmetuar prej Enes ibn Malikut رضي الله عنه, thuhet:

15. M. Sami Ramazanoglu, Musahabe, c, I, 127-129, Istanbul 2008.



“Disa prej robërve të Mi besimtar i mban të fortë (besimtarë) vetëm pasuria. Nëse do t’i bëja të varfër, kjo gjendje do t’i prishte ata.

Disa prej robërve të Mi besimtar i mban të fortë varfëria. Nëse do t’ua shtoja shumë rrizkun, kjo gjendje do t’i prishte ata.

Disa prej robërve të Mi besimtar dëshirojnë gradë (të lartë) në devotshmëri. Mirëpo, Unë nuk ia plotësoj këtë dëshirë, me qëllim që ata të mos bëhen mendjemdhenj e të mos u pëlqej vetja, gjë e cila i prish ata.

Disa prej robërve të Mi besimtarë i mban të fortë vetëm shëndeti i mirë. Nëse do t’u jepja sëmundje, kjo gjendje do t’i prishte ata.

(transmetuesi shton: më duket se ka thënë edhe këtë:)

Disa prej robërve të Mi besimtarë ua ruan besimin vetëm sëmundja. Nëse do t’u jepja shëndet, kjo gjendje do t’i prishte ata.

Çështjet e robërve të Mi, përfshirë edhe ato të zemrës, i drejtoj me dijen Time. Unë jam Ai që di çdo gjë dhe i njoftuar për gjithçka.” (Bejhaki, el-Esma ue’s-Sifat, fq. 122)

Le t’i analizojmë pikë për pikë mesazhet që jepen në këtë hadith kudsij:

1) Disa prej robërve të Mi besimtar i mban të fortë (besimtarë) vetëm pasuria. Nëse do t’i bëja të varfër, kjo gjendje do t’i prishte ata!

Allahu i Madhëruar shpjegon:

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ

“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: «Zoti im më ka nderuar.»” (Fexhr, 15)

وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ

“Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: «Zoti im më ka poshtëruar.»” (Fexhr, 16)



Pra disa njerëz janë falenderues kur kanë të mira të shumta, por jo kur ato iu mungojnë. Mirëpo, është më e drejtë të falënderosh si në kamje, ashtu edhe në skamje dhe të ruash ekuilibrin e zemrës pa rreshtur së falenderuari dhe së qeni mirënjohës.


Transmetohet se:

“Në ditën e Kiametit do të sillen një rob shumë i pasur, të cilit Allahu i Madhëruar do t’i thotë:

«Çfarë të ka penguar ty të më adhurosh Mua?»


I pasuri do përgjigjet:

«O Zot! Mua ma mori mendjen pasuria e shumtë.»

Mirëpo, Allahu i Madhëruar, duke i dhënë shembull Sulejmanin , do t’i thotë:

«A mos ishe më i pasur se robi im Sulejmani? Përse atij nuk ia mori mendjen pasuria?» (shih. Bursevi, Ruhu'l-Bejan, IV, 258; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, V, 202-203)

Të arrish të përdorësh pasurinë në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar është art. Të pasurit bujarë e falënderues, që nuk e transformojnë zemrën në kasafortë të kësaj bote dhe të varfrit durimtarë, të ndjeshëm dhe të kënaqur, janë të barabartë në dinjitetin njerëzor dhe kënaqësinë hyjnore.

Ebu Bekri dhe Abdurrahman ibn Auf , të cilët kanë përjetuar si pasurinë, ashtu edhe varfërinë, janë shembuj të mrekullueshëm për të dyja gjendjet.

Nuk duhet harruar se Islami i dënon (moralisht) të pasurit mendjemëdhenj e koprracë dhe të varfrit e padurueshëm e kryeneçë.

2) Disa prej robërve të Mi besimtar i mban të fortë varfëria. Nëse do t’ua shtoja shumë rrizkun, kjo gjendje do t’i prishte ata!

Shembujt më të mirë, për të shpjëguar këtë hadith kudsij, janë Salebe dhe Karuni, të cilët kur ishin të varfër jetonin me devotshmëri të lartë, por kur u sprovuan me mirësi të mëdha nuk arritën të përmbaheshin dhe duke u lazdruar e harbuar u gjetën në fundin e hidhur dhe disfatën e përjetshme.

Po ashtu, gjendja e atyre që përmendnin vazhdimisht Allahun e Madhëruar në kohë të vështira, por që kur arritën mirësitë e Allahut e braktisën përmendjen, në Kuranin Fisnik përshkruhen në këtë mënyrë:



“Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhi dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t’i vënë poshtë, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: «Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës».

E kur Allahu i shpëton ata, ata përnjëherë pa kurrfarë të drejte bëjnë turbullira në Tokë...” (Junus, 22-23)

Pra, parë nga dritarja e botës tjetër, gjendja e varfërisë dhe nevojës në të cilën gjenden disa njerëz, në fakt është mëshirë për ta. Sigurisht nëse arrijnë të durojnë e të falënderojnë... dhe kjo është e mundur vetëm përmes ndjesisë “takua”...

3) Disa prej robërve të Mi besimtar dëshirojnë gradë (të lartë) në devotshmëri. Mirëpo, Unë nuk ia plotësoj këtë dëshirë, me qëllim që ata të mos bëhen mendjemëdhenj e të mos u pëlqejë vetja, gjë e cila i prish ata!

Ndonjëherë, të mos qenit i vetëdijshëm ndaj pjekurisë personale shpirtërore mund të jetë një mirësi, sepse ai që e konsideron veten të plotësuar shpirtërisht nuk mund të shpëtojë lehtë nga kurthi i pasivitetit, mendjemadhësisë dhe ndjenjave të krenarisë. Për këtë arsye, i nderuari Taha el-Hariri ka thënë:




“Gjendja e mistikut me syrin e zemrës të hapur dhe atij me syrin e zemrës të pahapur, i ngjan rrugëtimit të dy udhëtarëve në Hixhaz, njëri prej të cilëve sheh, ndërsa tjetri është i verbër. Gjatë gjithë udhëtimit, që të dy i afrohen vazhdimisht qëllimit të tyre. Mirëpo, shpërblimi/sevapi që merr njeriu i verbër është më i madh.

Ndonëse nuk duket haptazi, mistiku që ndodhet në udhëtimin shpirtëror dhe nuk e ka të hapur syrin e zemrës, përfiton më shumë se mistiku me syrin e zemrës të hapur, për shkak se ai përparon vazhdimisht, gjatë gjithë kohës.”¹⁶

Pra syri i zemrës në gjendje të mbyllur mund të jetë më i dobishëm për shumë udhëtarë të rrugës shpirtërore. E në fakt, nëse do të ishte i hapur,

mbase ata nuk do të përmbaheshin dot e do të devijonin. Shembull i tillë është Bel'am ibn Baura, gjendja e të cilit përshkruhet kështu në Kuranin Fisnik:

“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, shejtani e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.” (A'raf, 175-176)

Pra, e rëndësishme është mbajtja e rrugës së drejtë, e jo kerameti¹⁷. Për shembull, Ebu Bekri , i cili konsiderohet si njeriu më i virtytshëm, pas të Dërguarit të Allahut , në dukje nuk kishte ndonjë keramet të veçantë. Por kerameti i tij më i madh ishte dorëzimi dhe bindja e plotë ndaj të Dërguarit të Allahut , dhe përpjekja e tij për të qenë vazhdimisht në rrugë të drejtë.

Edhe robërit e dashur të Zotit, që janë si yjet në qiellin shpirtëror, nga frika se mos kaplohen nga mendjemadhësia dhe krenaria e tepërt, janë ruajtur gjithmonë nga kerametet e dukshme dhe shfaqja e gjendjeve dhe pozitive të larta shpirtërore që zotëronin.

4) Disa prej robërve të Mi besimtarë i mban të fortë vetëm shëndeti i mirë. Nëse do t'u jepja sëmundje, kjo gjendje do t'i prishte ata!

Ebu Bekri  ka thënë:

“Kërkoni shëndet prej Allahut, sepse pas besimit absolut, askujt nuk i është dhënë një mirësi më e madhe se sa shëndeti i mirë.”

Ndërsa Enesi , transmeton:

I Dërguari i Allahut , vizitoi një të sëmurë rëndë dhe e pyeti:

“A i je lutur Allahut për ndonjë gjë, ose a ke kërkuar gjë prej Tij?”

17. Gjendje të jashtëzakonshme (mrekulli) të manifestuara nga njerëz me grada të larta shpirtërore.

I sëmuri tha:

“Po, i lutesha duke thënë: «O Allah! Dënimin që do të ma japësh në Ahiret, ma jep direkt këtu në këtë botë!»”

Pasi e dëgjoi, i Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“*Subhanallah! Ti nuk mund ta përballosh këtë. A nuk do të ishte më mirë të lutesh kështu:*

«... Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)» (Bekare, 201)

Pas bisedës, personi u lut si e këshilloi Profeti dhe u shërua. (Muslim, Dhikr, 23; Tirmidhi, Deauat, 71/3487)

Edukimi i devotshmërisë kërkon që sprovat e caktuara nga Allahu i Madhëruar t'i përballojmë me durim, falënderim dhe duke qenë të kënaqur. Në fakt, kur Allahu i Madhëruar u jep një sprovë robërve të mirë, u jep gjithashtu edhe forcën për ta duruar sprovën. Mirëpo, të kërkuarit të sprovave me dëshirën personale konsiderohet si guxim i tepruar, gjë të cilën njeriu nuk mund ta përballojë dot.

5) Disa prej robërve të Mi besimtarë ua ruan besimin vetëm sëmundja. Nëse do t'u jepja shëndet, kjo gjendje do t'i prishte ata!

Disa njerëz i luten më shumë Allahut kur janë të sëmurë. Ata e përmendin më tepër Allahun sepse nefsi/egoja dobësohet gjatë sëmundjes dhe nuk ka më fuqi për t'u tërbuar dhe për të kaluar kufijtë, siç bën kur trupi është i shëndetshëm dhe i fortë. Nëse peshohen me peshoren e Ahiretit, sëmundjet dhe problemet e shëndetit janë mundësi të mëdha mëshire për robërit durimtarë.

Nga ana tjetër, nëse njeriu i kryen në mënyrë të rregullt adhurimet nafie/vullnetare kur është në gjendjet të mirë shëndetësore, Allahu i Madhëruar do t'i japë shpërblim të pandërprerë edhe nëse ai nuk arrin t'i kryejë ato në kohë të vështira. Kjo bazohet në këtë ajet fisnik:

“Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera.” (Tin, 6)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nëse robi del në udhëtim ose sëmuret, Allahu i shkruan atij të njëjtat (sevape) punë që ka kryer kur ka qenë në shtëpi dhe i shëndetshëm.” (Buhari, Xhihad, 134; Ahmed, IV, 410, 418)

“Nëse dikush që e ka bërë zakon faljen e namazit të natës, nuk arrin të ngrihet nga gjumi dhe nuk e fal atë, Allahu ia shkruan sevapin e faljes së atij namazi. Ndërsa gjumi është një sadaka për të.” (Muvatta, Salatu'l-Lejl, 1)

Po ashtu, në një hadith tjetër thuhet:

“Qoftë mashkull apo femër, Allahu nuk e lë besimtarin pa e sprovuar me veten, familjen dhe pasurinë e tij, derisa të arrijë pa gjynahe tek Allahu.” (Tirmidhi, Zuhd, 57)

E rëndësishme është të vetëdijesohemi se këto bela dhe fatkeqësi janë manifestime të sprovave hyjnore, të cilat duhet t'i përballojmë me durim e dorëzim të plotë dhe pa e dëmtuar ekuilibrin shpirtëror kundrejt Allahut.

6) Çështjet e robërve të Mi, përfshirë edhe ato të zemrës, i drejtoj me dijen Time. Unë jam Ai që di çdo gjë dhe i njoftuar për gjithçka!

Në një ajet fisnik theksohet:

“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai...” (En'am, 59)

Pra, njeriu duhet të tregojë pëlqim ndaj caktimit që Allahu ka vendosur për të, nëse dëshiron të bëjë pjesë në grupin e fatlumëve, të cilët nuk do të kenë frikë e hidhërim në botën tjetër. Madje caktimin e Zotit duhet ta konsiderojë shumë më të mirë se sa dëshirat e tij. Në këtë mënyrë, edhe skamjen, edhe kamjen, edhe sëmundjen, edhe shëndetin e mirë duhet t'i kthejë në mundësi të përfitimit të kënaqësisë së Allahut të Madhëruar. Pra, që Zoti të jetë i kënaqur me robin, ai duhet t'i dorëzohet plotësisht Atij, ta falënderojë dhe të kryejë detyrat e tij të devotshmërisë me kënaqësi të plotë.



PJESA III



Vdekja

Kur shpirtit i vishet roba e trupit dhe hyn në këtë botë nga një derë e caktuar, automatikisht njeriu është udhëtar i vdekjes.

Edhe po të mblidheshin gjitha mirësitë e përkohshme në një njeri të vetëm dhe ai të ishte i pasur sa Sulejmani عليه السلام, në aspektin material, i bukur sa Jusufi عليه السلام, dhe të jetonte njëmijë vite në lumturi e madhështi, përsëri nuk do t'i bënin dobi!.. A nuk është një gropë e ngushtë në tokë përfundimi i gjithësecilit prej nesh ?!..

VDEKJA

Meditimi i vdekjes

Nëse njeriu i sheh me syrin e zemrës manifestimet hyjnore që ekspozohen në vetë qenien e tij dhe në gjithësi, do të fillojë të meditojë në lidhje me mënyrën se si duhet ta jetojë jetën e kësaj bote. Ditët, netët, javët, muajt, stinët, e vitet që ndjekin me shpejtësi njëri-tjetrin, të rejat që vjetërsohen, pallatet madhështore që kthehen në gërmadha, fytyrat në pasqyrë që ndryshojnë ditë pas dite e flokët që thinjen e bien, na kujtojnë vazhdimisht rruga jonë na drejton diku. Për rrjedhojë, e vërteta me të cilën lidhet më shumë meditimi ynë është ndodhia e **“vdekjes”**. E në fakt të gjithë ne, pa përjashtim, një ditë do të kalojmë patjetër nga shtegu i vdekjes, duke iu nënshtruar urdhrit hyjnor: **“Çdokush do ta shijojë vdekjen!..”** (Enbija, 35)

Vdekja, që është e vërteta më absolute që njohim në lidhje me të ardhmen tonë, në një farë kuptimi është vetëm një natë midis ditës së dynjasë dhe asaj të Ahiretit. Pra dynjaja është një ditë kalimtare, vdekja është një natë provizore, ndërsa Ahireti është një mëngjes i së vërtetës së përrjetshme.



Ky fjalim i **Kuss ibn Saide**¹⁸, i mbajtur në panairin e Ukazit në kohën e injorancës, para se të vinte Shpallja, është një përkujtim dhe paralajmërim i jashtëzakonshëm për zemrat e ndjeshme dhe në të njëjtën kohë edhe një përkufizim i bukur i besimit monoteist:

“O njerëz!

Ejani, dëgjoni, ngulitni në mend dhe merrni mësim!

18. Kryetari i fisit Ljad i cili ka jetuar pak kohë para ardhjes së Muhamedit ﷺ, si i dërguar i Allahut. Ai ka pasur besim monoteist të bazuar në shpalljen që i erdhi Isait ﷺ. Gjithashtu ishte edhe një orator dhe poet i njohur.



Kush jeton, vdes; kush vdes tretet e humbet! Bie shiu e mbin bari, fëmijët lindin e zënë vendin e prindërve, pastaj të gjithë pushojnë së qeni e humbasin! Këto ndodhi nuk ndërpriten, ato veçse ndjekin njëra-tjetrën!

Vini vesh e dëgjoni me kujdes! Ka lajme nga qielli se në tokë ka dukuri e elemente mësimdhënëse! Toka është dyshek i shtruar, ndërsa qielli një tavan i lartë. Yjet ecin, detet qëndrojnë. Kush vjen nuk mbetet, kush ikën nuk kthehet. Vallë arsyeja pse nuk kthehen është të qenurit të kënaqur nga vendi ku kanë shkuar, apo se mbahen (me forcë) dhe zhyten në gjumë?..

Betohem se te Allahu është një fe e cila është shumë më e dashur se kjo që keni ju sot!

Dhe është një Profet i Allahut, ardhja e të cilit është shumë e afërt. Hija e tij tashmë gjendet mbi kokat tuaja. Lum për atë që do ta besojë dhe do të mësojë rrugën e drejtë prej tij! Mjerë për atë që do ta mohojë e do t'i dalë kundër!

Mjerë ato popuj që jetën e tyre e kalojnë të shkujdesur!

O njerëz!

Ruhuni nga shkujdesja! Çdo gjë është e përkohshme, vetëm Allahu është i përjetshëm. Ai është një i vetëm, nuk ka shok e të barabartë! Ai s'ka lindur kënd dhe as është i lindur. Vetëm Ai duhet adhuruar!

Ka shumë mësimë që duhet të marrim prej atyre që erdhën në këtë botë dhe larguan para nesh.

O fisi Ijad! Ku janë etërit dhe gjyshërit tuaj?! Ku janë Adi dhe Themudi që ndërtonin tempuj të stolisur dhe shtëpi prej guri?! Ku janë Faraoni dhe Nemrudi, që të fryrë nga ndjenja e krenarisë për pasuritë e kësaj bote, u thoshin popujve të tyre: “Unë jam Zoti juaj më i madh!”?!

Kjo tokë i bloi ata në mullirin e vet dhe i bëri pluhur. Madje edhe kockat e tyre u shkërmoqën dhe u shpërndanë, edhe shtëpitë e tyre ngelën të shkreta. Vendin e tyre tani e gëzojnë qentë! Ruhuni dhe mos u bëni të shkujdesur si ata. Mos shkoni gjurmëve të tyre. Çdo gjë është e përkohshme, vetëm Allahu është i përjetshëm!

Lumi i vdekjes ka porta hyrëse, por s'ka asnjë hapësirë për të dalë prej tij!.. Të vegjël e të mëdhenj, të gjithë ikin e mërgojnë. Ç'i ka gjetur të tjerët, do më gjejë edhe mua.” (Bejhaki, *Kitabu'z-Zuhd*, II, 264; Ibn-i Kesthir, *el-Bidaje*, II, 234-241; Hejthemi, IX, 418.)



Në fakt, Allahu i Madhëruar ua kujton robërve të tij çdo ditë realitetin e vdekjes, duke dhënë si shembull kapitjen e trupave në gjumin e natës, pas lodhjes me punë të ndryshme gjatë ditës. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik lajmërohet:

“Ai jua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t’ju tregojë gjithçka që keni bërë.” (En’am, 60)

“Allahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë, këto janë shenja për njerëzit që mendojnë.” (Zumer, 42)

Ditët e para kur Profeti ﷺ kishte filluar ftesën në Islam, ua kujtoi këtë të vërtetë Kurejshëve, duke u folur atyre prej Kodrës Safa me këto fjale:

“...Ju do të vdisni sikur bini në gjumë dhe do të ringjallen sikur ngriheni nga gjumi. Patjetër që ju do të ngriheni nga varri, do të dilni para Allahut dhe do të jepni llogarinë e çdo veprimi tuaj në këtë botë. Si përfundim, do të shihni shpërblimin e mirësive dhe adhurimeve tuaja dhe dënimin e ashpër të punëve tuaja të këqija! Shpërblimi është Xheneti i përjetshëm, ndërsa ndëshkimi Xhehenemi i përjetshëm.” (Shih. Belazuri, Ensabu'l-Eshraf, I, 118; Ibnu'l-Esir, el-Kamil, II, 61; Halebi, Insanu'l-Ujun, I, 459)

Për rrjedhojë, këtë jetë të përkohshme nuk duhet ta jetojmë duke nenvleftësuar ekzistencën e Ahiretit, siç bëjnë mohuesit, që janë bërë robër të dëshirave egoiste dhe propagandojnë se: **“Nuk ka jetë tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më.”** (Mu'minun, 37), por duhet ta çmojmë ashtu siç dëshiron Allahu i Madhëruar dhe të ecim në rrugën e drejtë të Kuranit dhe Sunnetit, duke u nisur prej faktit se: **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë...”** (Mulk, 2)

Ne duhet t'i japim rëndësi këshillës që i Dërguari i Allahut ﷺ, i dha Tarik ibn Abdullahut ؓ, kur i tha: **“O Tarik! Përgatitu për vdekjen pa t'u afruar ajo!”** (Hakim, Mustedrek, IV, 347/7868)

Me qëllim që asnjëri të mos jetë i papërgatitur për ndodhinë e vdekjes, që është një realitet i paevitueshëm dhe të cilin nuk e mohon dot askush, Profeti ﷺ e ka motivuar ummetin e tij që të meditojë rreth vdekjes, duke na këshilluar:



“Kujtoni vdekjen dhe kalbjen e trupit e të kockave tuaja pasi të vdisni! Kush dëshiron jetën e Ahiretit, e braktis zbukurimin e jetës së dynjasë.”
(Tirmidhi, Kijamet, 24/2458)



Sahabët e nderuar, të cilët u edukuan nga dora e Profetit ﷺ, kishin fituar një butësi zemre të tillë në lidhje me meditimn rreth vdekjes, sa që çdo gjë që shihnin u kujtonte përkohshmërinë e dynjasë, varrin, kiametin, llogarinë dhe dënimin.

Lidhur me këtë, një prej personaliteteve më të larta të brezit të tabii-nëve, Ebu Uail tregon:

“Njëherë dolëm për udhëtim me Abdullah ibni Mes’udin ﷺ. Bashkë me ne ishte edhe Rebi ibn Hajthem. Kur po kalonim pranë një hekurpunuesi, Abdullahu ﷺ ndaloi dhe filloi të shohë hekurin brenda zjarrit. Edhe Rebiu pa zjarrin dhe gati sa nuk ra në tokë. Më pas u larguam prej aty. Kur shkua para një furre në breg të Euftratit, Abdullahu ﷺ pa zjarrin që flakëronte brenda në furrë dhe lexoi ajetin:

“Kur ai t’i vërej prej së largu, ata do t’ia dëgjojnë vlimin dhe rënkimin. E kur të hidhen në një vend të ngushtë të tij, të lidhur duarsh, do të luten për shkatërrimin (e vet).” (Furkan, 12-13)

Pas kësaj Rebiut i ra të fikët. E morëm dhe e dërguam tek familja e tij. Abdullahu ﷺ i qëndroi tek koka deri në mbrëmje, kur më në fund Rebiu erdhi në vete...” (Ebu Ubejd, Fedailu’l-Kuran, fq. 23)



Një prej dijetarëve Islam, Abdulhamdi Keshk thotë:

“Kur një sahab kthehej në mbrëmje në shtëpi, gruaja e tij së pari i bënte këto dy pyetje:

“Sa ajete u zbritën sot nga Kurani?”

“Sa prej haditheve të Profetit ﷺ ke mësuar përmendësh sot?”

(Në mëngjes) Kur dilte nga shtëpia, gruaja i thoshte:

“Ki frik Allahun, mos fito në haram! Ne e durojmë urinë në këtë botë, por nuk mund ta durojmë dot zjarrin në ditën e Kiametit!” (Abdulhamid Keshk, Fi fihabi’t-tefsir, I, 26)



Ndryshe nga dëshira dhe shqetësimi që ka njerëzimi në ditët e sotme, për të jetuar më gjatë dhe më rehat në këtë botë, dëshira më e madhe e brezit të sahabëve ka qenë mërgimi në botën tjetër me zemër të pastër, qetësi shpirtërore dhe nder.

Një ditë, Abdullah ibn-i Mes'udi  i thotë miqve të tij prej tabiinëve:

“Ju agjëroni, falni namaz dhe bëni punë të mira më shumë se sahabët e të Dërguarit të Allahut. Mirëpo, ata ishin më të mirë se ju.”

“Si është e mundur kjo?” - pyetën ata.

Ndërsa ai iu përgjigj:

“Ata ishin më asketë se ju kundrejt kësaj bote dhe e dëshironin më shumë se ju Botën tjetër.” (Hakim, Mustedrek, 4/135)



Muhamed ibn Ka'b el-Kurazi tregon:

“Një ditë u takova me **Omer ibn Abdulazizin** në Medine-i Muneuere. Atëherë ai ishte një djalosh i ri shumë simpatik që jetonte me gjithë të mirat. E kam takuar edhe më pas kur ai u bë halif. Kur e pashë herën e dytë u habita dhe rrija duke e vështruar i shtangur. Më pyeti:


- O Muhamed, çfarë ke që më shikon gjithë habi?

- O prijësi i besimtarëve, - i thashë unë, - ju paska ikur ngjyra, trupi ju është lodhur dhe flokët ju janë zbardhur e ju kanë rënë! Nuk munda ta fsheh habinë time kur ju pashë në këtë gjendje.

Omer ibn Abdulazizi më tha:

- O Muhamed, kushedi sa do të ishe habitur po të më shihje tri ditë pasi të jem varrosur? Atëherë kur krimbat të më kenë ngrënë sytë dhe të më vërshojnë nëpër faqe, dhe kur goja dhe hunda të më jetë mbushur me qelb dhe gjak. Atëherë nuk do të më kishe njohur aspak dhe do të ishe habitur edhe më shumë me mua...” (Hakim, IV, 300/7706)



I Dërguari i Allahut , në një hadith fisnik thotë:

“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila ua pret si me thikë të gjitha kënaqësitë!” (Tirmidhi, Zuhd, 4)




Njeriu që arrin të meditojë siç duhet rreth vdekjes, pa e larguar asnjëherë nga mendja, nuk mashtrohet me kënaqësitë e përkohshme, ndërsa ai që e di se është një udhëtar i përjetësisë, nuk mashtrohet me lodrat e kësaj bote duke humbur kohën me to.

Fëmijët luajnë buzë detit dhe bëjnë kështjella prej rëre, me të cilat kalojnë orë të tëra. Pastaj kur ju mërzenit i gjuajnë dhe i rrafshojnë... ose vjen një dallgë e fuqishme dhe përpin gjithçka.

E njëjtë është edhe vdekja. Biri i njeriut thur ëndrra, plane dhe projekte në lidhje me të ardhmen. Por, kur kujton vdekjen, horizontin e zemrës së tij e kaplon hidhërimi. Ndërkohë që njerëzit janë duke realizuar nga çasti në çast planet që kanë mendje, u vjen vdekja dhe ua shkatërron gjithçka për një moment. Gjithë ai mund e përpjekje asgjësohet si kështjella prej rëre e fëmijëve. Prandaj konsiderohet shkujdesje e tepruar të jetuarit duke ia lënë ëndrrave egoiste në dorë frerët e jetës dhe duke harruar të vërtetën e vdekjes...

Ebu Said el-Hudri , transmeton:

Njëherë, i Dërguari i Allahut , nguli një shkop në tokë. Pranë tij nguli një të dytë, e pak më tej një të tretë. Më pas u kthye nga sahabët dhe i pyeti:

“A e dini se çfarë kuptimi kanë këto?”

Ata, ashtu si përherë, u përgjigjën:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!”

Më pas Profeti  ua shpjegoi çështjen sahabëve që dëgjonin me kureshtje, duke thënë:

“Shkopi i parë është njeriu, i dyti është exheli (vdekja) dhe i treti përfaqëson dëshirat dhe kërkesat e tij. Ndërkohë që njeriu urapon pas dëshirave të veta, exheli i pret rrugën dhe e merr.” (Ahmed Ibn-i Hanbel, Musned, III, 18)



Sa mashtrim i hidhur është fakti që njeriu e konsumon kapitalin e jetës së vet me gjëra të kota sikur do të jetojë përgjithmonë në këtë botë, ndërkohë që vdekja është realitet?!..

Lidhur me këtë indiferencë të përgjithshme të njerëzve, i nderuari Sufjan Theuri, shprehet duke na dhënë një shembull:



“Nëse një tellall thërret një grup njerëzish të mbledhur në një vend dhe u thotë:

«Kush mund të deklarojë se sot do të jetojë deri në mbrëmje, le të ngrihet në këmbë!», do të shohim se askush nuk do të ngrihet në këmbë. Por e çuditshmja është se edhe nëse ai u thotë të gjithë njerëzve:

«Kush është përgatitur për vdekjen, të çohet në këmbë!», përsëri nuk do të ngrihet askush!..”



Në një hadith fisnik thuhet:

“Sa i mjerë është robi që thur iluzione për superioritet dhe e harron Allahun e Madhëruar!

Sa i mjerë është ai që me mizori shkel të drejtat dhe harron Atë që është i fuqishëm e madhështor!

Sa i mjerë është ai që qesh e luan me indiferencë dhe harron varrin e kalbjen nën tokë!

Sa i mjerë është ai që i kalon kufijtë dhe harron lindjen, vdekjen dhe çka ka përtej saj!” (Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 17)

Shkurtimisht mund të themi se dija më e rëndësishme fillon me zgjidhjen e enigmave të mbulimit me dhe dhe të lindjes në Botën e përjetshme. E kush mund të jetë më i mjerë se sa udhëtari indiferent i përjetësisë, kup-timi dhe vetëdija e të cilit nuk kalojnë përtej kufijve material të mureve të varrezave?!

Të mos harrojmë se zemrat e pandriçuara nga meditimi rreth vdekjes dhe kohës përtej saj, janë si rrënojat e privuara nga drita e diellit. Aq dritë e fortë është meditimi mbi vdekjen, sa që një jetë e pandriçuar nga ajo, është e dënuar të mbetet në errësirat e indiferencës.

Nisur nga kjo, edhe të parët tanë, të cilët i kanë pasur parime të jetës së tyre këto të vërteta absolute, varrezat i kanë ndërtuar brenda qyteteve dhe para xhamive, me qëllim që kjo të nxisë vazhdimisht meditimin mbi përkohshmërinë dhe realitetin e botës tjetër. Në këtë mënyrë, kushdo që kalon andej sheh ardhmërinë e vet dhe mediton mbi gjendjen personale. Kjo bën që njeriu të ndjejë përkohshmërinë e vet dhe të mos e harrojë



Ahiretin. Madje kjo e shtyn njeriun që mirësitë e kësaj bote t'i përdorë si shkallë për arritjen e lumturisë së Ahiretit. Kështu ai nuk do të mashtrohet me rininë, shëndetin dhe fuqinë e tij, duke e pandehur veten të përjetshëm në këtë botë. Ai do t'i kthejë shpinën punëve dhe gjërave të padobishme dhe do të përpiqet, sa më shumë të jetë e mundur, të sigurojë kapitalin e duhur për jetën e Ahiretit.

Një udhëtim i vetmuar dhe pa kthim

Vdekja është një kalim i detyruar nga bota e siluetave në botën e vërtetë dhe udhëtimi më i vështirë të cilin njeriu do ta bëjë i vetëm. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“(Allahu do t’u thotë): **«Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë, duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar...»**” (En’am, 94)

Në këtë udhëtim, njeriun nuk do të mund ta shoqërojnë kurrsesi as të afërmit, as fëmijët dhe as pasuria. I vetmi shok i udhës, që do të ketë afër, do të jetë besimi në zemër -nëse ka- dhe punët e mira e bamirësitë që ka dërguar në Ahiret, që kur ka qenë gjallë.

Të urtët i këshillojnë indiferentët e dhënë pas kësaj bote me këto fjalë:

“O ti që mashtrohesh pas dynjasë duke harruar misterin e sprovës, ti njeri indiferent që krenohesh me pasurinë e përkohshme!

Kujdes, mos u beso shumë vilave dhe sarajeve që ke ndërtuar! Mos harro se po të pret një vend nën dhe. Vilat e tua të larta dhe të gjera do të qëndrojnë këtu, ndërsa ti do të shtrihesh në shtëpinë tënde poshtë dheut, i vetmuar dhe pa rrugëdalje. Aty do të hysh vetëm me punët e tua dhe llogarinë e atyre që ke fituar!..”

Pasuria që nuk kthehet në kapital për lumturinë e Ahiretit, do të jetë shkak i një pendese të thellë për të zotin. Lidhur me këtë njerëzit e urtë kanë thënë:

“Kur një njeri vdes, ai përballet me dy fatkeqësi në lidhje me pasurinë e tij, të cilat nuk i ka hasur asnjëherë më parë: E para është marrja e të gjithë pasurisë nga duart dhe e dyta është llogaritja e hollësishtme për të gjithë pasurinë, edhe pse ajo tashmë i është marrë nga duart.”

Kushedi sa e vështirë është për një njeri marrja në llogari për një pasuri që në fund të fundit nuk i ka bërë dobi!..

Siç tregohet me hollësi edhe në një hadith fisnik, e vetmja gjë që do ta shoqërojë robin në varr është puna e tij. Nëse punët e tij janë të mira, ato do të jenë miq e shokë për të zotin. Ato e përgëzojnë atë me lajme të mira dhe e ruajnë nga ndëshkimi e të këqijat. Mirëpo, nëse punët e tij janë të këqija -Allahu na ruajtë!-, ato do ta tmerrojnë të zotin në varr, do ta trembin e do ta mbysin në errësirë, duke ia ngushtuar varrin.” (shih. Abdurrezzak, el-Musannef, III, 581-582)

Po ashtu, nuk duhet harruar as kjo e vërtetë e shprehur nga i nderuari Hasan Basriu:

“Mos të të mashtrojë numri i madh i njerëzve që sheh përreth, sepse ti do të vdesësh i vetëm, do të ringjallesh i vetëm dhe do të merresh në llogari i vetëm!” (Bursevi, Ruhul-Bejan, Tekathur, 3)

Ndërsa Osmani , paralajmëron kështu në lidhje me indiferencën:

“O biri Ademit! Dije se meleku i vdekjes të vjen vërdallë që kur ke ardhur në këtë botë. Madje duke kërcyer prej zverkut tënd, ai kap një tjetër. Kjo vazhdon për sa kohë ti të jesh në këtë botë. Mirëpo do të vijë një ditë që ai do të kërcëjë prej zverkut të të tjerëve e do të të kapë ty. Kjo do të ndodhë në një moment të papritur për ty. Prandaj përgatitu për frymën e fundit dhe përpigu të mos zihesh i shkujdesur, sepse meleku i vdekjes nuk është kurrë i shkujdesur ndaj teje!..

O biri Ademit! Dije se nëse ti je i shkujdesur ndaj vetes tënde dhe nuk përgatitesh për vdekjen, padyshim se askush nuk do t’i bëjë përgatitjet për ty. Mos e harro kurrë se ti patjetër do të dalësh para Allahut dhe për këtë arsye bëje vetë përgatitjen për veten, duke siguruar furnizim për të! Pra mos guxo t’ia lësh dikujt tjetër këtë punë!” (Ali el-muttaki, no: 42790)

Si të jetosh, ashtu do të vdesësh dhe po ashtu do të ringjallesh

Jeta është si pikat e ujit që mbushin një gotë. Ndërsa fryma e fundit është pika e fundit që e bën gotën të derdhet. Kthjelltësia e ujit në gotë varet nga kthjelltësia e pikave të ujit. Për të dalë të pastër, para Allahut të Madhëruar, është e domosdoshme që ato pika të mos ndoten me baltën e gjynaheve.



Treguesi më i rëndësishëm i gjendjes sonë shpirtërore, në frymën e fundit, është mënyra se si e përdorim ne frymën tonë në këtë moment. Që të largohemi me sukses nga kjo botë e përkohshme, është e domosdoshme që çdo frymë që japim dhe marrim të jetë si përgatitje për frymën e fundit, sepse:

“Njeriu vdes ashtu siç ka jetuar dhe ringjallet ashtu siç ka vdekur”.

(Munavi, Fejzu'l-Kadir, V, 663)

Pra gjendja shpirtërore e frymëve, që japim dhe marrim, me adhuri-me, vepra dhe moral të bukur në jetën e kësaj bote, është si një letër për frymën tonë të fundit. Në të njëjtën kohë është edhe përkthyes në këtë botë i gjendjes sonë në botën tjetër.

Sa bukur e shpjegon këtë të vërtetë kjo ndodhi:

I nderuari **Behlul Dana** shpesh qëndronte duke vëzhguar murin e anuar të një shtëpie të shkatërruar dhe gjithmonë meditonte për fundin e vet. Përsëri, një ditë, kur ishte ulur përpara shtëpisë së shkatërruar dhe po meditonte thellë, papritur muri rrëzohet. Kjo gjë e lumturoi pamasë Behlul Danën, aq sa lumturia mund të dallohej lehtë në fytyrën e tij. Njerëzit, të cilët e panë, nuk arritën ta kuptonin gëzimin e tij të jashtëzakonshëm dhe me kureshtje të madhe e pyetën për shkakun e këtij gëzimi.

“A nuk e patë, muri u shemb nga ana që ishte anuar!” -tha Behluli.

Të habitur nga kjo përgjigje, njerëzit e pyetën përsëri:

“Mirë, por çfarë ka për t’u çuditur këtu?!”

Atëherë Behlul Dana tha:

“Meqenëse në këtë botë çdo gjë rrëzohet në anën që anon, kur të vdes edhe unë do të shkoj tek Allahu inshAllah, sepse edhe animi im është kah Ai. O njerëz! Të mundohemi ta shtojmë animin tonë nga Zoti i gjithësisë me anë të rukeve dhe sexhdeve, që të mos rrëzohemi në ndonjë anë tjetër!..”



I nderuari Haxhe Ubejdullah Ahrar tregon:

“Një njeri i mirë pa në ëndërr Bahauddin Nakshibendin pas vdekjes së tij dhe e pyeti:

«Çfarë duhet të bëjmë për të arritur shpëtimin në botën e përjetshme?»

Ai iu përgjigj:

«Bëni atë që duhet bërë në frymën e fundit!»

Pra, ashtu siç është e nevojshme që në frymën e fundit të mendojmë plotësisht vetëm Allahun e Madhëruar, ashtu duhet të veprojmë edhe gjatë gjithë jetës!» (Reshahat, fq. 130)

Në të shumtën e rasteve, zemrat që duhet t'ia përkushtojmë Allahut, në frymën e fundit merren me atë që janë marrë më shumë gjatë jetës, pra ato vdesin ashtu siç kanë jetuar. Shembuj të tillë kemi plot:

Për shembull një prej dijetarëve të njohur të hadithit, i nderuari Abdulaziz Reuud tregon një ndodhi shumë mësimdhënëse që i ka ndodhur vetë atij:

“Njëherë gjendesha në Medine-i Muneuere. Një natë, teksa po shkoja në xhaminë e Profetit ﷺ, një grua mu afrua e shqetësuar dhe më tha:

«Zotëri! Nëse dëshiron të fitosh sevape, eja më ndihmo! Ketu gjendet një i sëmurë që po jep shpirt. Do ishte mirë sikur ta nxisje të shqiptonte shehadetin!»

Shkova menjëherë, por sado që u përpoqa ta shtyja të shqiptonte shehadetin, ai nuk arrinte ta thoshte. Papritur ai hapi sytë dhe tha:

«Është e disata herë që më kërkon të them shehadetin! Unë kam kohë që i kam kthyer shpinën shehadetit dhe fesë Islame, e tani nuk arrij ta them dot!» Pa kaluar shumë ai vdiq.

Më pas mësova se ai ishte një person që pinte vazhdimisht verë. Pastaj reflektova me vete se padyshim Profeti ﷺ ka thënë të vërtetën kur është shprehur se: «Ai që e bën zakon pirjen e verës, është i njëjtë me këdo që adhuron idhuj.»” (Ibn Maxhe, Eshribe, 3)

Pra një jetë e errët nuk mund të pasohet nga një vdekje e ndritur!..

Lidhur me këtë çështje edhe Rebi ibn Hajsem na tregon një ngjarje të ngjashme:

“Njëherë jam gjendur pranë një personi që po jepte shpirt. Ndërkohë që unë e nxisja të shqiptonte «La ilahe il-lallah!», dukej sikur ai nuk më dëgjonte fare dhe vazhdonte të bënte llogari me gishta, sikur numëronte paratë. (Pra po jepte shpirt ashtu siç kishte jetuar)”



Prandaj zemra e një besimtarit duhet të jetë gjithmonë e shqetësuar nga pyetje të tilla si: “Ku dhe në çfarë gjendjeje do të takohemi me vdekjen? Në çfarë situatë dhe si do të realizohet takimi ynë i paevitueshëm me melekun e vdekjes?..” Sepse:

Mund të vdesësh edhe duke shkuar në xhami, edhe duke u përpjekur të fitosh rizikun prej hallallit, edhe duke i qarë hallin një të vuajtori, ose duke shoqëruar një të vetmuar, edhe duke u dhuruar njerëzve prej pasurisë për të fituar kënaqësinë e Allahut, etj... Por, -Allahu na ruajtë! - mund të vdesësh edhe duke vepruar të kundërtën e të gjitha këtyre, duke qenë në një vend të papërshtatshëm, duke lënduar një zemër, duke mbajtur anën e të padrejtit në vend të të drejtit, mund të jesh në një moment zemërimi, në kthetrat e dëshirave të ulëta, në miqësi me armiqtë e Allahut dhe gjynahqarët, duke bërë sehir ndaj të këqijave dhe duke qenë i zhytur në haramë!..



Padyshim se njeriu do të ringjallet në gjendjen që ka vdekur. Njëherë Abdullah ibn Amr  kishte pyetur:

“O i Dërguari i Allahut! A mund të më tregoni në lidhje me luftën dhe pjesëmarrjen në të?”

I Dërguari i Allahut , u përgjigj:

“O Abdullah ibn Amr! Nëse lufton me sinqeritet duke duruar dhe duke e pritur shpërblimin vetëm nga Allahu, Ai do të të ringjallë si një person të sinqertë e durimtar, që e pret shpërblimin vetëm prej Tij.

Por, nëse lufton për t’u dukur dhe për t’u mburrur me pasurinë e shumtë dhe trimërinë e madhe, Allahu i Madhëruar do të të ringjallë si një person që dëshiron të duket e të mburret dhe mendjemadh.

O Abdullah ibn Amr! Në çfarëdo gjendjeje të luftosh apo të vdesësh, në atë gjendje do të ringjallë edhe Allahu!” (Ebu Daud, Xhihad, 24/2519; Hakim, II, 95/2437)

Lidhur me këtë çështje flasin edhe këto hadithe:

“Ditën e Kiametit njerëzit do të ringjallen në gjendjen që kanë vdekur!”
(Muslim, Xhenet, 83)

fshinë të gjithë e më pas çdokush ringjallet sipas veprave të tij.” (Muslim, Xhenet, 84)

Për të dhënë frymën e fundit me besim

Çdo diplomë, që njeriu merr në këtë botë, është e vlefshme për gjatë gjithë jetës së tij. Mirëpo në jetën shpirtërore nuk funksionon kështu. Aty nuk ka një garanci të tillë sepse ekziston rreziku që çdo gjendje dhe pozitë që fitohet të mund të humbet në çdo moment. Kurani Fisnik na jep shembull njerëzit si Bel'am ibn Baura dhe Karuni, të cilët kanë rrëshqitur nga rruga e drejtë në momentet e fundit.

Në fillim Karuni ishte një njeri i devotshëm dhe prej komentuesve më të mirë të Teuratit. Më vonë ai u sprovua me pasuri dhe prej krenarisë, që i dhanë pasuria e pushteti, ai i doli kundër Musait عليه السلام. Kjo krenari dhe mendjemadhësi, e çoi atë drejt shkatërrimit.¹⁹

Po ashtu, edhe Bel'am ibn Baura²⁰, i cili kishte arritur majat e gradëve shpirtërore, më në fundanoi kah dëshirat e egos dhe u shkatërrua.

Në fakt, garancinë e shpëtimit dhe dhënies së frymës së fundit me besim e kanë vetëm profetët dhe njerëzit të cilët janë përgëzuar nga ata.

Për këtë arsye besimtari:

✓ Duhet të jetojë gjatë gjithë jetës me frikë, me shpresë dhe me vigjilencë të lartë shpirtërore.

✓ Duhet të përpiqet të kuptojë misterin e ajetit fisnik: **“Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (Hixhr, 99)

✓ Duhet që çdo frymë të jetës ta vlerësojë duke u munduar të vërë në jetë mësimet e Kuranit dhe Sunnetit dhe pa hequr nga gjuha dhe zemra lutjen e Jusufit عليه السلام: **“...(O Zoti im) Bëj që të vdes si mysliman dhe më bashko me punëmirët** (në botën tjetër)!” (Jusuf, 101)

19. shih. Kuran, Kasas, 76-82.

20. **“Tregoj atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit”** (A'raf, 175) Komentuesit e Kuranit janë të mendimit se personi në këtë ajet, të cilit nuk i përmendet emri, është pikërisht Bel'am ibn Baura, prej popullit të Musait عليه السلام. Në fillim ky person i kishte besuar Musait عليه السلام, por më pas ra në mohim për hir të disa interesave të cekëta të kësaj bote.

✓ Nuk duhet të harrojmë se diploma më e rëndësishme e kësaj bote të përkohshme është dëshmia e besimit që do të merret në frymën e fundit.

Lidhur me domosdoshmërinë e vigjilencës së zemrës deri në frymën e fundit, po japim një shembull shumë mësimdhënës:

Të nderuarit Sufjan Theurit i ishte kërrusur beli që në moshë të re dhe atyre që e pyesnin për shkakun, u përgjigjej:

“Kisha një mësues prej të cilit merrja dituri. Kur i erdhi momenti i vdekjes, u përpoqa ta nxisja të shqiptonte shehadetin por sado që u mundova ai nuk arriti ta thoshte. Dhe pikërisht kjo ndodhi ma kërrusi belin.”



Fryma e fundit është momenti më kritik dhe më i vështirë i jetës. Në atë moment përmbysen të gjitha mendimet, ëndrrat dhe planet e njeriut për këtë botë. Lidhur me këtë në një ajet fisnik sqarohet:


“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër): ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t’i ikje.” (Kaf, 19)

Ndërsa Aisheja , tregon:

“(Në momentin e vdekjes) Para të Dërguarit të Allahut gjendej një enë me ujë. Ai i fuste duart e tij të bekuara në këtë enë dhe fërkonte fytyrën. Më pas thoshte: «*La ilahe illallah! Padyshim se vdekja është gjendje e vështirë!*»...” (Buhari, Rikak, 42. Megazi, 83)

Nëse dëshirojmë që frymën e fundit ta japim me besim, duhet të përgatitemi për atë moment të vështirë, sepse një person në zemrën e të cilit nuk është rrënjosur besimi sa ka qenë gjallë, nuk ka jetuar në përputhje me Kuranin dhe Sunnetin dhe nuk e ka mësuar gjuhën e tij me përmendjen e shpeshtë të Allahut, e ka të vështirë që në atë moment të keq të sjell ndërmend shehadetin.

Këtë të vërtetë, e shpreh shumë mirë kjo ndodhi:

Transmetohet se një rrobaqepës e ka pyetur një dijetar në lidhje me hadithin e Profetit , ku thuhet: “*Allahu e pranon teuben e robit të Tij derisa nuk i ka ardhur shpirti në fut.*”²¹

Dijetari i përgjigjet duke e pyetur:

- Po, ashtu është. Por cili është profesioni yt?
- Unë jam rrobaqepës.
- Cila është gjëja më e thjeshtë në profesionin tënd?
- Të marrësh gërshtë dhe të presësh copën.
- Sa vjet ke që e bën këtë punë?
- Që prej tridhjetë vjetësh.
- A do të mund ta presësh copën kur të të vijë shpirti në fyt?
- Jo, nuk do të mundem.
- O rrobaqepës! Atëherë, nëse nuk do të mund të bësh një punë që

e ke mësuar për një farë kohe dhe ke tridhjetë vjet që e bën lehtësisht, si do ta bësh teuben të cilën nuk e ke bërë asnjëherë në jetën tënde kur të të vijë shpirti në fyt? Teuben bëje sot kur ke fuqi dhe shëndet! Përndryshe, në frymën e fundit nuk do ta kesh të mundur kërkimin e faljes dhe përfundimin e mirë... A nuk e ke dëgjuar ndonjëherë fjalën: “Nxitoni në teube pa ardhur vdekja!”²²


Për rrjedhojë, lënia e teubes, istigfarit, falënderimit, dhikrit, mirënjohjes dhe adhurimeve ndaj Allahut, për një të ardhme e cila nuk dihet a do të vijë, ose për në fund të jetës, është shkak i një dështimi të hidhur, sepse ne nuk e dimë se kur do të na mbarojnë frymët tona të numëruara dhe në ç’gjendje do të na gjejë fryma e fundit. Ky është një mister hyjnor.



Një ditë, **Omeri**  vuri re se **Talha**  ishte shumë i mërzitur. Kur e pyeti për shkakun, Talha  tha:

“-Njëherë, i Dërguari i Allahut, tha:

«Unë di një fjalë, që nëse shqiptohet në momentet e vdekjes, ajo patjetër do të bëhet dritë për librin e punëve të tij dhe në ato momente, trupi e shpirti i tij arrijnë kënaqësinë hyjnore, mëshirën dhe paqen, në sajë të kësaj fjale.»

Mirëpo, Resulallahu  ndërroi jetë dhe unë nuk pata mundësi që ta pyes për fjalën. Prandaj jam i mërzitur.”

22. Munavi, V, 65.



Pas kësaj, Omeri رضي الله عنه, tha:

“Unë e di atë fjalë. Ajo është shprehja «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» (*La ilahe il-lallah*) të cilën Profeti صلى الله عليه وسلم dëshironte ta dëgjonte të thënë nga xhaxhai i tij (Ebu Talibi). Nëse Resulallahu صلى الله عليه وسلم do të dinte një fjalë më shpëtuese se kjo, patjetër do ishte ajo që do të dëshironte ta degjonte nga xhaxhai.” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 54. Shih. Ahmed I, 6)

E në fakt i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, ka thënë:

“*Kush thotë «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» hyn në xhenet!*” (Ebu Daud, Xhenaiz, 15-16/3116; Ahmed, V, 247; Hakim, I, 503. Shih. Buhari, Xhenaiz, 1)

Sipas mendimit të dijetarëve, në këtë hadith bëhet fjalë për shprehjen **“La ilahe il-lallah”** dhe pjesën tjetër të pandashme të formulës së teuhidit **“Muhamedu’r-Rasulullah”**. Pra është e domosdoshme që këto pjesë të shqiptohen të dyja njëherësh. Në disa transmetime ceket vetëm shprehja “la ilahe il-lallah”, por në fakt synohen të dyja pjesët, sepse shprehja “la ilahe il-lallah” në aspektin e sheriatit pranohet si deklarimi i të dyja pjesëve.²³

Nëse një jetë bëhet në përputhje të plotë me qëllimin e “formulës së teuhidit”²⁴, kjo formulë gdhendet në zemër. Por nëse robi është neglizhent ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut të Madhëruar, nëse ka shumë të meta, ose është plotësisht moskokëçarës, midis tij dhe shprehjes së teuhidit hapet një humnerë e madhe. Nëse ai nuk bën teube dhe nuk heq dorë nga indiferenca, kjo humnerë thellohet edhe më shumë. Dështimi më i madh pason jetën, nëse lidhja e kësaj shprehjeje me njeriun mbetet vetëm një shqiptim i thatë i germave të saj.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.” (Ankebut, 2-3)



Njëherë Uehb ibn Munebbih është pyetur:

23. Adhimabadi, Aunu'l-Ma'bud, Bejrut, 1415, VIII, 267-268.

24. “La ilahe il-lallah Muhamedu’r-Rasulullah”

“A nuk është «*La ilahe il-lallah*» çelësi i Xhenetit?”

“Po, ashtu është. Mirëpo çdo çelës ka patjetër edhe dhëmbët e tij. Nëse mbart çelësin me dhëmbët e duhur dera do të hapet, përndryshe jo.” - u përgjigj ai. (Buhari, Xhenaiz, 1)

Po ashtu edhe Imām Zuhri, është pyetur në lidhje me hadithin e Profetit ﷺ: “*Kush thotë «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» hyn në xhenet!*”, e ai është përgjigjur:

“Ky rregull vlente për ditët e para të Islamit, para se të zbriteshin farzet, urdhrat dhe ndalesat.” (Tirmidhi, Iman, 17/2638)

Pas pranimit të fesë, është kusht që gjykimet e Kuranit dhe Sunnetit të zbatohen me përpikëri. Nisur nga kjo, të jetuarit në përputhje të plotë me “formulën e teuhidit” është domosdoshmëri për lumturinë tonë të përjetshme.

Veprat e këqija, që burojnë nga ndjekja e dëshirave dhe egos dhe nga neglizhenca e urdhrave të fesë, shpeshherë bëhen pengesë për shqiptimin e shehadetit në frymën e fundit. Lidhur me temën tregohet edhe një ndodhi e tillë:

Një person, i cili gjatë gjithë jetës ishte munduar të peshonte saktë me peshore, gjendej në momentet e vdekjes. Ndërkohë që po e nxisnin të shqiptonte shehadetin (*La ilahe il-lallah*), ai me shumë mundim tha:

“Lutjuni Allahut për mua që të ma lehtësojë shqiptimin e shehadetit. Gjuha e peshores mbizotëron mbi gjuhën time dhe më pengon ta shqiptoj shehadetin, sepse unë nuk i pastroja pluhurat që binin në pjatën e peshores!”²⁵

Kur ishte duke shëtitur në shkretëtirat e Jemenit, Xhunejd Bagdadi (Allahu e mëshiroftë), pa një qen gjahu. Ai vuri re se atij i kishin rënë dhëmbët, ndërkohë që putrat me të cilat dikur sulmonte luanët, s’kishin më fuqi. Ai ishte dobësuar dhe bërë si dhelpër e plakur. Një herë e një kohë ai u vërsulej demave dhe drerëve, ndërsa tani kishte filluar të gjuhej me brirë edhe nga deshët.

Kur Xhunejdi e pa qenin në atë gjendje të mjeruar e të këputur, i dha një copë bukë prej ushqimit të vet dhe me keqardhje për qenin tha këto fjalë:

“O qen! Nuk e di se cili nga ne të dy do të dali më mirë nesër. Me sa shoh tani, meqenëse unë jam njeri, jam më i mirë se ti. Mirëpo nuk e di se

25. Imam Sharani, *Ölum Kıyamet Ahiret*, Bedir Yay, sf. 48.



çdo më sjelli kaderi në të ardhmen! Nëse besimit tim nuk i rrëshqet këmba, do të vë në kokë kurorën e faljes së Allahut Teala. Por nëse më bie veshja e urtësisë që zotëroj, do të jem edhe më poshtë se ty, sepse sado i keq të jetë qenin nuk e çojnë në Xhehenem”.

Ndërsa i nderuari Muhamed Masum Faruki ka thënë:

“Frika për frymën e fundit është një mirësi aq e madhe, saqë të gjithë të dashurit e Zotit janë kapluar nga ajo.”

Besimtari që vazhdimisht bartë në zemrën e tij këtë ndjesi, e jeton jetën e kësaj bote me një kujdes të veçantë, sikur është duke ecur në një fushë të minuar. Me qëllim që banesa e fundit, ku do të arrijë, të jetë si një prej kopshteve të Xhenetit, ai bëhet dëgjuesi më i përsjirtshëm i udhëzimit të heshtur të varrezave. Për rrjedhojë ai arrin nivelin e urtësisë që i mundëson të kuptojë se përgatitja për vdekjen nuk është përgatitje e varrit për veten, por përgatitje e vetes për varrin.



Shejh Ahmed Harbi kishte një komshi të moshuar me emrin Behram, i cili ishte mexhusi, pra adhurues i zjarrit. Një ditë, Ahmed Harbi e këshilloi Behramin në lidhje me besimin. Mexhusiu i moshuar tha:

“O i madhi i myslimanëve! Do të të pyes për tre gjëra. Nëse do mund t’i përgjigjesh, do t’i besoj fesë tënde”.

“Pyet!” -tha shejh Ahmedi.

“Përse e krijoi Allahu njerëzimin? Ai u dha atyre çdo gjë dhe i furnizoi, por përse i vret? E meqenëse i vret, përse i ringjall?” - pyeti Behrami.

Shejh Ahmedi u përgjigj:

“Njerëzimin e krijoi që ata të njohin ekzistencën dhe njëshmërinë e Tij, të kuptojnë fuqinë hyjnore dhe shfaqjet madhështore. I furnizoi ata që të shohin Furnizimin dhe Mëshirën e Tij. I vret ata, që të njohin Fuqinë absolute të Tij. I ringjall ata, që të njohin Pafundshmërinë e Tij. Shkurtimisht, gjithçka ka për qëllim që ata të kuptojnë se Ai është mbikëqyrësi absolut në çdo ndodhi dhe ngjarje të jetës”.

Kur Behrami i dëgjoi këto, pranoi islamin. Mirëpo, papritur shejh Ahmed Harbi u frikësua jashtë mase dhe i ra të fikët. Kur erdhi në vete e pyetën:

“Ç’të ndodhi o shejh?”

“Dëgjova një zë që më tha: Behrami ishte një mohues që adhuronte zjarrin tash e shtatëdhjetë vjet dhe tani u bë mysliman. Ndërsa ti je mysliman tash e shtatëdhjetë vjet, por a e di se çdo të bëhet me ty në frymën e fundit?!.. (Tedhkiretu’l- Evlija, fq. 97)

Prandaj duhet që çdo frymë tonën ta harxhojmë në mënyrë të atillë që çasti ynë i fundit në këtë botë të jetë si mbas pritshmërive. Përveç kësaj, që të arrijmë shpëtimin e përjetshëm, ne duhet që gjithmonë të kërkojmë strehim tek mëshira e Allahut, e jo t’i besojmë vetëm punëve tona të mira dhe rrugës së drejtë që ndjekim.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Dikush për një kohë të gjatë bën punë që të shpien në Xhenet, më vonë fillon të punojë vepra që të shpien në Xhehenem. Ndërsa një tjetër, për një kohë të gjatë bën punë që të shpien në Xhehenem, më vonë puna e tij përfundon me një vepër që të shpie në Xhenet”. (Muslim, Kader, 11)



Osmani  ka thënë:

“Një besimtar i vërtetë bart gjashtë lloje frikash:

1. Frika se mos i merret besimi prej Allahut të Madhëruar.
2. Frika se mos melekët shkruajnë gjërat të cilat do ta turpërojnë atë në ditën e Kiametit.
3. Frika se mos shejtani i mallkuar ia çon veprat dëm.
4. Frika se mos kapet në mënyrë të papritur dhe të papërgatitur nga meleku i vdekjes, Azraili.
5. Frika se mos nuk arrin të merret mjaftueshëm me përmendjen e Allahut të madhëruar për shkak të dhënies së tepërt pas familjes.
6. Frika se mos mburret me mirësitë që ka në këtë botë dhe mbetet indiferent ndaj botës tjetër.”

Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se si duhet të kërkojmë strehim tek Ai, duke na mësuar këtë dua:



رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!” (Al-i Imran, 8)



I Dërguari i Allahut ﷺ, bënte shpesh një dua të tillë:

يَا مُقَلَّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ

“O Allahu im, që i kthen zemrat nga një gjendje në tjetrën! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!”

Madje, kur Enes ibn Maliku ﷺ e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Ne të kemi besuar ty dhe fesë që ke sjellë ti. Mos ndoshta keni frikë se po na ndryshon besimi?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Po! Zemrat janë midis gishtave të Allahut dhe ai i rrotullon ato si dëshiron.” (Tirmidhi, Kader, 7/2140)



Një çështje tjetër, është edhe mendimi i mirë që duhet të ketë robi në lidhje me Allahun e Madhëruar. Lidhur me këtë, Xhabir ibn Abdullah ﷺ ka thënë:

“Tre ditë para se ai të ndërronte jetë, e dëgjova Profetin ﷺ, të thoshte:

«Çdonjëri prej nesh duhet të vdesë me mendim të mirë për Allahun (jo në mënyrë tjetër)!» (Muslim, Xhennet, 82; Ebu Daud, Xhenaiz, 12-13/3113)

Po ashtu, është transmetuar edhe një hadith kudsij, ku Allahu i Madhëruar ka lajmëruar:

“Unë jam ashtu siç mendon robi Im për mua. Unë jam aty ku ai më përmend.” (Buhari, Teuhid, 15, 35; Muslim, Teube, 1)

Të ushqesh mendim të mirë për Allahun, do të thotë të kërkosh mëshirën dhe bujarinë e Tij, të mos i këpusësh kurrë shpresat prej mëshirës së



pafundme dhe ndihmës së Tij, të shpresosh se Ai do të të trajtojë me falje dhe mëshirë, e madje të besosh pa asnjë dyshim se do të arrish lumturinë në botën tjetër. Mirëpo, për realizimin e kësaj, është e domosdoshme që njeriu të zotërojë **“besim”** dhe **“vepra të mira e të sinqerta”**. Përmendja e besimit dhe e veprave të mira, pranë njëra-tjetrës në shumë ajete të Kuranit, tregon qartë domosdoshmërinë e zotërimit nga njeriu të të dyja këtyre elementeve.

Një njeri që bart në vete shpresën se do të shohë mirësi, mëshirë dhe falje prej Allahut të Madhëruar dhe përpiqet me sa ka mundësi të çojë në vend të gjitha detyrat e tij të devotshmërisë, do ta gjejë Allahun ashtu siç e pret. Po kështu, edhe ai që pret të kundërtën prej Allahut, atë do të gjejë.

Le ta përfundojmë këtë temë me këtë lutje të sinqertë të Ebu Bekrit :

“O Zoti im! Fundi i jetës, qoftë periudha më e mirë e jetës sime, përfundimet qofshin pjesa më e mirë e punëve të mia dhe dita që do takohem me Ty, qoftë dita më e mirë e ditëve të mia!” (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq. 103)


Amin!..

Pranë personit që është duke vdekur

Profeti , e ka këshilluar ummetin e tij të flasë gjëra pozitive pranë dikujt që është duke vdekur:

“Kur të jeni pranë një të sëmuri apo të vdekuri, flisni për gjëra pozitive dhe të bukura, sepse melekët thonë “Amin!” pas fjalëve tuaja.” (Muslim, Xhenaiz, 6; Ebu Daud, Xhenaiz, 15)

“Kur t’i afroheni një të sëmuri, i thoni atij gjëra të bukura në lidhje me vdekjen, qetësojeni dhe jepini shpresë! Këto fjalë nuk mund ta kthejnë pas diçka që është caktuar t’i ndodhë të sëmurit, por ia kënaqin zemrën atij.” (Tirmidhi, Tib, 35/2087; Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 1/1438)

Gjithashtu të nxisësh dikë që të shqiptojë shehadetin, “La ilahe il-lallah”, në frymën e fundit, është një detyrë fetare, sepse Profeti , ka thënë:

“Nxitini ata që janë duke vdekur të thonë «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ!»” (Muslim, Xhenaiz, 1, 2; Ebu Daud, Xhenaiz, 15-16/3117)

Mirëpo gjatë kryerjes së kësaj detyre duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm, delikatë dhe të butë. Nuk është e drejtë që i sëmuri të lodhet



apo të tprohet në këmbënguljen për ta nxitur atë që të shqiptojë shehadetin, sepse zemërimi i të sëmurit në një gjendje të tillë, mund të shkaktojë vdekjen e tij pa e thënë ende shehadetin, ose -Allahu na ruajt!- shfaqjen e veprimeve në kundërshtim me besimin, gjë e cila është një prej katastrofave më të mëdha.

Përveç këtyre, nëse besimtari nuk ka folur më asnjë fjalë të kësaj bote pasi e ka shqiptuar shehadetin, sado që t'i zgjasë sëmundja, konsiderohet se fjala e tij e fundit është “La ilahe il-lallah”. Për këtë arsye shpresohet që ai person të përfshihet në përgëzimin e Profetit ﷺ, që thotë: “Kush thotë «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» *hyn në xhenet!*”²⁶ Për rrjedhojë, nuk është më e nevojshme që personat në gjendje të tillë të nxiten të shqiptojnë shehadetin.

Gjithashtu, është mirë që pranë njerëzve që janë duke dhënë frymën e fundit, të lexohet Kuran me një zë të bukur e qetësues e veçanërisht surja Jasin.

Çasti i vdekjes

Të gjithë do të përballen me vdekjen në një formë që përputhet me llojin e jetës që kanë bërë. Dikujt vdekja do t'i vijë si lumturia e një mëngjesi bajrami, e dikujt tjetër si një udhëtim drejt dënimit plot me makthe...

Prandaj në momentin e vdekjes, besimtarëve të mirë, melekët ua marrin shpirtin lehtë, pa i shkakuar vuajtje dhe duke i përgëzuar me fjalët:

“Shpëtimi qoftë mbi ju! Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!” (Nahl, 32)

Në momentin e vdekjes do të hiqen perdet e syve, melekët do të bëhen të dukshëm dhe besimtarët e mirë do të përgëzohen. Lidhur me këtë të vërtetë në Kuran premtohet:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkonit, dhuratë e pasur prej një Zoti Falës dhe Mëshirëplotë.»” (Fussilet, 30-32)

Kurani na bën të ditur se njerëzit, të cilët e kanë kaluar jetën me bindje të plotë ndaj Allahut, zemra e të cilëve ka gjetur paqen nga përmendja e Zotit dhe kanë arritur pjekurinë e vërtetë shpirtërore, në fillim në momentin e vdekjes e më pas në ditën e gjykimit dhe kur të hyjnë në Xhenet, do të thirren në këtë mënyrë:

يَا أَيَّتُهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ ﴿٢٢٧﴾ ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ﴿٢٢٨﴾

فَادْخُلِي فِي عِبَادِي ﴿٢٢٩﴾ وَاَدْخُلِي جَنَّتِي ﴿٣٠﴾

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt! Ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Fexhr, 27-30)

Nëse vihet re me kujdes, ajetet e mësipërme na bëjnë të ditur se pikë-sëpari robi duhet të jetë i kënaqur prej Zotit të vet. Pra që njeriu të marrë te drejtën për në Xhenet, duhet të jetë gjithmonë i kënaqur me caktimin e Zotit të tij përballë baticave dhe zbaticave të jetës, në kushtet e një jete që ndryshon vazhdimisht. Ai duhet të vazhdojë detyrat e devotshmërisë me durim dhe falënderim, derisa Zoti i tij të jetë i kënaqur me të.



Ndërsa momenti i vdekjes së zemrave të ngurta e të pa ndriçuar me dritën e besimit, është me të vërtetë një katastrofë më vete, sepse melekët do t’ua shkulin dhe do t’ua nxjerrin shpirtin me dhunë.²⁷ Ata do të japin shpirt në mënyrë të dhimbshme midis vorbullave të frikshme të vdekjes dhe goditjeve të melekëve.

Allahu i Madhëruar na e përshkruan kështu këtë pamje të tmerrshme:

“Eh, sikur të shihje sesi melekët ua marrin shpirtat mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë (duke u thënë): «Shijoni dënimin e zjarrit!»” (Enfal, 50)

“Melekët ua marrin shpirtin (jobsimtarëve), ndërkohë që ata janë të padrejtë ndaj vetvetes. Ata do të shfaqin përulje (duke thënë):

27. shih. Naziat, 1.



«**Ne nuk kemi bërë asgjë të keqe!**» (Melekët do t'u thonë):

«**Nuk është kështu! Natyrisht që Allahu i di mirë veprat që keni punuar. Hyni në portat e Xhehenemit, ku do të mbeteni përgjithmonë! Eh, sa vendbanim i shëmtuar është ai për mendjemëdhenjtë!**» (Nahl, 28-29)

Ndërsa në këtë hadith fisnik përshkruhet mënyra e tmerrshme me të cilën do të nxirret shpirti nga trupi i një gjynahqari:

“*(Nxjerrja e) shpirtit nga trupi do të realizohet përmes një procesi shumë të vështirë, njësoj sikur tërhiqet dhe nxirret një shufër me kanxha dhe grepa prej leshit të lagur.*” (Hakim, Mustedrek, I, 93-95/107. Shih. Ahmed, IV, 287, 295; Hejthemi, III, 50-51)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar u drejtohet kështu idhujtarëve në Kuran:

“**Por, kur shpirti të vijë në grykë e të thërrasin, «A ka shërues?», atëherë, ai (që po vdes) do të bindet se ky është çasti i ndarjes dhe këmbët do të ngrijnë.**

Atë ditë, ai do të sillet te Zoti yt. Ai as nuk besoi dhe as nuk u fal, por e mohoi të vërtetën dhe ia ktheu kurrizin, e pastaj shkoi te njerëzit e vet, duke u krenuar.” (Kijame, 26-33)

Në suren Uakia na ilustron momentin e vdekjes së njerëzve me fund të veshtirë:



“**Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, - ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re- përse pra nuk ia ktheni shpirtin atij, nëse (pretendoni se) nuk do të gjykoheni (në jetën e përtejme)? Përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën!**” (Uakia, 83-87)

I gjithë njerëzimi do t'i nënshtrohet e dorëzohet caktimit hyjnor. Madje edhe njerëzit më mizorë e mendjemëdhenj, që kanë kundërshtuar me inat urdhrat hyjnore gjatë jetës, në atë moment nuk do të kenë mundësi të bëjnë asnjë kundërshtim. Ai do të shohë e do të kuptojë se sundimi i vërtetë i gjithësisë i takon vetëm Allahut të Madhëruar, vetëm në momentin kur prej mendjes njerëzore të hiqen perdet e panumërta të indiferencës. Mirëpo kjo njohje tekembranja nuk do t'i bëjë asnjë dobi!..

“Kështu, nëse ai (në agoni) është nga ata që janë të afërt (me Allahun), do të ketë prehje, kënaqësi dhe dhunti të Xhenetit. E, nëse është nga njerëzit e së djathtës, (ai do të përshëndetet) «Paqe për ty» nga njerëzit e së djathtës. Por, nëse (ai në agoni) është nga përgënjeshtuesit e humbur, ai do të gostitet me ujë të valuar dhe do të përcëllohet në Zjarrin e flakëruar (të Xhehenemit). Pa dyshim, kjo është e Vërteta e sigurt. Andaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërisëm!” (Uakia, 88-96)

Njëherë i Dërguari i Allahut , tha:

“Nëse dikush dëshiron të takohet me Allahun, edhe Allahu dëshiron të takohet me të. Por, kujt nuk i pëlqen të takohet me Allahun, as Allahut nuk i pëlqen të takohet me të!”



Aisheja , ose një nga gratë e tjera të Profetit , ka thënë:

“O i Dërguar i Allahut! Të gjithë ne e shohim të shëmtuar vdekjen dhe nuk na pëlqen. (pra a përfshihet këtu edhe mospëlqimi i vdekjes?)”

“Jo, nuk është kështu! Por, kur besimtarit i vjen vdekja dhe ai përgëzohet me mëshirën e Allahut, kënaqësinë dhe Xhenetin e tij, ai e dëshiron shumë takimin me Allahun. Gjithashtu, edhe Allahu e dëshiron takimin me të. Ndërsa, kur i vjen vdekja mohuesit, ai njoftohet me zemërimin dhe dënimin e Allahut. Për këtë arsye, ai nuk e pëlqen takimin me Allahun. Po ashtu, edhe Allahu nuk e do takimin me të.” (Buhari, Rikak, 41; Muslim, Dhikr, 14)



Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut , ka rrëfyer:

“Daudi  ishte tepër i kujdesshëm në lidhje me namusin (nderin). Kur dilte nga shtëpia ai kyçte dyert me qëllim që askush të mos hynte tek anëtarët e familjes së tij, derisa ai të kthehej. Një ditë doli duke e lënë shtëpinë të kyçur... Kur Daudi  u kthye dhe pa një njeri në mes të shtëpisë, pyeti:

«- Kush je ti?»

«- Ai, i cili nuk u frikësohet sundimtarëve dhe për të cilin nuk ka pengesa!» - U përgjigj personi.

«- Atëherë, për Allahun ti qenke meleku i vdekjes! Urdhëro, unë po i përgjigjem urdhrin të Allahut!»



Pas kësaj, ai ia mori shpirtin...” (Ahmed, II, 419)

Një fjalë e urtë thotë: *“qesh më mirë, ai që qesh i fundit”*. Kuptimi i vërtetë i kësaj shprehjeje lidhet me momentin kur robit do t’i hiqen të gjitha perdet në frymën e fundit dhe do t’i tregohet vendi ku do të dërgohet. Nuk do të ketë buzëqeshje më të bukur se kjo! Pra, kjo do të jetë buzëqeshja më e bukur, më kuptimplote dhe më e lumtur në këtë botë. Zoti na e bëftë të mundur të gjithëve!..



Një prej halifeve Emeui, Sulejman ibn Abdulmeliku, e pyeti dijetarin asket të devotshëm Ebu Hazmin:

“Si do të jetë arritja tek Allahu i Madhëruar?”

Ebu Hazmi përgjigjet:

“Arritja e një robi të bindur tek Allahu do të jetë si takimi i një njeriu me familjen e vet që e pret me dashuri, ndërkohë që ai ka qenë larg prej kohësh. Ndërsa mbërritja e një njeriu të pabindur tek Allahu është si kthimi i skllavit tek i zoti, ndërkohë që i është larguar njëherë atij.”

Pendimi

Njëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, duke dashur të na tërheqë vëmendjen neve, umetit të tij, tha:

“Nuk do të ketë asnjë person që do të vdesë, e nuk do të ndjejë pendesë.”

Kur sahabët e pyetën:

“Për çfarë do të pendohet o i Dërguar i Allahut?”, ai u përgjigj:

“Nëse (i vdekuri) është njeri i mirë, do të pendohet se nuk ka shtuar dot më tepër mirësitë e tij (duke përfituar më shumë prej mirësisë të jetës). Por nëse (i vdekuri) është njeri negativ, do të bëhet pishman se përse nuk ka hequr dorë nga veprat e këqija dhe nuk ka përmirësuar veten.” (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403)

Lidhur me këtë çështje Allahu i Madhëruar i paralajmëron kështu robërit e Tij:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُلْهِكُمْ أَمْوَالُكُمْ وَلَا أَوْلَادُكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ
وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9)

وَأَنْفُسُكُمْ مِنْ مَا رَزَقْنَاكُمْ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ فَيَقُولُ
رَبِّ لَوْلَا أَخَّرْتَنِي إِلَىٰ أَجَلٍ قَرِيبٍ فَأَصَّدَّقَ وَأَكُن مِّنَ الصَّالِحِينَ

“Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: «O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!»” (Munafikun, 10)

يَقُولُ يَا لَيْتَنِي قَدَّمْتُ لِحَيَاتِي

“Ai do të thotë: «Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!»” (Fexhr, 24)

وَلَنْ يُؤَخِّرَ اللَّهُ نَفْسًا إِذَا جَاءَ أَجَلُهَا وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

“Por Allahu nuk ia shtyn afatin askujt që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju.” (Munafikun, 11)

Robi duhet t’i dërgojë në Ahiret mirësitë për të cilat bën fjalë Allahu, atëherë kur ai i ka ende mundësitë në dorë. Pra ai duhet të përgatitet që sot për atë ditë të vështirë, të ashpër e të vuajtur të Kiametit. Nesër, kur të kalojmë në vendbanimin tonë të përjetshëm, nuk do të kemi më në dorë asgjë për të dhuruar, edhe nëse kemi qenë të pasur. Po ashtu, nuk do të kemi më as mundësi që mirësitë e përkohshme t’i konvertojmë në kapital të lumturisë së përjetshme!..

Sa bukur shprehet poeti Nexhip Fazil:

*Argjendari i mirë, një tjetër qese qep për vete!
Çfarëdo paraje që vlen në varr, atë ndan më vete!*



Aliu ﷺ, thotë:

“Kjo botë ka kthyer shpinën e po shkon, ndërsa bota tjetër po vjen drejt nesh. Të dyja këto kanë fëmijët e vet të veçantë. Ju bëhuni fëmijët e botës tjetër, e jo fëmijët e kësaj bote.

Sot është dita e kryerjes së veprave dhe nuk ka llogari. Nesër ka llogari, por nuk ka mundësi për të kryer vepra!” (Buhari, Rikak, 4)

Një nxënës që del nga salla e provimit, nuk mund të hyjë përsëri në provim e të shkruajë më tepër përgjigje për të shtuar notën, edhe nëse i vijnë në mendje përgjigjet e sakta të cilat nuk i kujtoi gjatë provimit. Në të njëjtën mënyrë edhe gjetja e përgjigjeve të sakta të pyetjeve të provimit të jetës, nuk ka asnjë dobi për njeriun pas vdekjes. Përkundrazi, kjo do të bëhet shkak për pendimin e thellë të tij.



Këto fjalë të urta të Ebu Dherrit ﷺ, janë një përmbledhje shumë e bukur e domosdoshmërisë së përgatitjes për vdekjen dhe për çka vjen përtej saj, me qëllim që më vonë të mos thuhet “Ah sikur!”:

“Një mall ka tre ortakë. I pari është i zoti i mallit, pra ti vetë. I dyti është kaderi (caktimi), i cili nuk të pyet ty për çfarë do të të sjelli (ai mall), mirësi apo fatkeqësi. Ndërsa i treti është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh)! E pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti jep llogari për të. Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!

Allahu i Madhëruar urdhëron: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”**²⁸. Ja, kjo deve është pasuria ime që e dua më shumë dhe po e dërgoj (jap sadaka) para vetes (në Ahiret që të më presë atje).” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163)



Gjendja e një prej të dashurve të Allahut, Rebi ibn Hajsemit, është një shembull mbresëlënës në lidhje me çështjen e përgatitjes për vdekjen dhe kohën përtej saj:

I nderuari Rebi ibn Hajsemi kishte hapur një varr në bahçen e vet. Kur e ndjente se zemra i ishte ngurtësuar, hynte në varr dhe qëndronte aty për njëfarë kohe. Aty meditonte se një ditë patjetër do t'i jepte lamtumirën kësaj bote dhe se në varr do të kishte nevojë qoftë edhe për një istigfar apo sadaka të vetme. Në këtë mënyrë, ai kalonte në një gjendje përsiatjeje të thellë, duke u shqetësuar për llogarinë që do jepet në Ahiret. Më vonë lexonte këto ajete:

حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَحَدَهُمُ الْمَوْتُ قَالَ رَبِّ ارْجِعُونِ
لَعَلِّي أَعْمَلُ صَالِحًا فِيمَا تَرَكْتُ كَلَّا إِنَّهَا كَلِمَةٌ هُوَ قَائِلُهَا
وَمِن وَّرَائِهِمْ بَرْزَخٌ إِلَىٰ يَوْمِ يُبْعَثُونَ

“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: «O Zoti im, më kthe që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!» Kursesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai e thotë (kot)! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Mu'minun, 99, 100)

Ndërsa kur Rebiu dilte prej varrit, i thoshte vetes:

“O Rebi! Pa shiko, sot u ktheve pas! Por do të vijë edhe një çast kur kjo kërkesë nuk do të të pranohet, e nuk do të kthehesh më pas në këtë botë. Prandaj merr masat që tani dhe shtoji veprat e mira, përpjekjet në rrugën e Allahut dhe furnizimet e Ahiretit!”



Edhe këto këshilla të Imam Gazaliut janë shumë mësimdhënëse në lidhje me këtë çështje:

“Biri im! Zëre se vdiqe sot... Sa keq do të të vijë për momentet e indiferencës që ke kaluar në këtë jetë, duke thënë «ah sikur»? Mirëpo më kot! (Tashmë nuk mund të kthehesh më pas!)”

“Pasi të ketë falur namazin e sabahut, çdo besimtar duhet t'i kujtojë vetes këto gjëra:

«Jeta është kapitali im. Me humbjen e jetës, më humbet edhe kapitali, e atëherë nuk kam më mundësi të fitoj. Kjo ditë që sapo ka filluar është një ditë e re dhe Allahu më ka gostitur duke më lejuar të jetoj edhe sot. (Më hapi edhe një fletë të re prej kalendarit të jetës) Nëse do të ma kishte marrë

shpirtin, unë do të dëshiroja të më kthente përsëri në këtë botë, qoftë edhe për një ditë, që të veprojë sa më shumë të mira.

Tani supozo se ke vdekur dhe të është dhënë leje të kthehesh vetëm për një ditë në këtë botë... Pra, mos iu afro absolutisht haramëve! Kujdes mos ta kalosh kot qoftë edhe një çast të kësaj dite, sepse çdo frymë është një mirësi e paçmueshme!»



Përpjekja më e rëndësishme e të gjithëve duhet të jetë sigurimi i furnizimit për Ahiret, në mënyrë të shpejtë, për sa kohë ekziston ende mundësia. Prandaj nuk duhet të mashtrohemi prej kënaqësive kalimtare e të rrejshme të kësaj bote. Ne nuk duhet të harrojmë se mirësitë që mendojmë se zotërojmë, ngjajnë me një thesar të gjetur në ëndërr. Siç shprehet edhe i nderuari Mevlana: “Ne duhet të përpiqemi t’i kthejmë të zotit të vërtetë çdo gjë që duhet t’i jepet, para se vdekja të na marrë çdo gjë që na është dhënë!”.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَكُمْ
يَوْمٌ لَا يَبِيعُ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفَاعَةٌ وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobsimtarët janë keqbërësit e vërtetë.” (Bekare, 254)

Nuk duhet të harrojmë se fryma e fundit është si një pasqyrë e pastër dhe pa njolla. Në këtë pasqyrë, çdo njeri sheh qartë gjithë jetën e vet, me bukuritë dhe shëmtitë e saj. Atë çast, mbi sy dhe zemra nuk ekziston më asnjë perde refuzimi dhe indiference egoiste. Përkundrazi, të gjitha perdet hiqen dhe çdo rrëfim e fut mendjen dhe shpirtin në një atmosferë pendese.

Duke respektuar parimin “*vdismi para se t’ju vijë vdekja!*”, ne duhet t’i braktisim sot me vullnetin tonë të gjitha ambiciet egoiste, para se të jemi të detyruar t’i braktisim për shkak të vdekjes. Ne duhet ta përmirësojmë veten duke u penduar dhe duke kërkuar falje pa na ardhur vdekja, me qëllim që fryma e fundit të mos jenë një pasqyrë në të cilën do të shohim jetën tonë



me pendesë. Pasi të përmbushet afati i panjohur i jetës sonë e të vijë vdekja, atëherë nuk do të kemi mundësi të bëjmë asgjë për Ahiretin tonë, ndërkohë ndjenja e pendesës sonë për jetën e kësaj bote, do të jetë e padobishme.

Koha është mirësia hyjnore më e çmuar e Allahut të Madhëruar për robin e Tij. Koha nuk mund të kthehet pas, nuk mund të kursehet dhe nuk mund merret apo jepet borxh. Edhe vetë Allahu i Madhëruar betohet në kohën, në suren Asr, duke paralajmëruar se ata të cilët nuk e përdorin kohën në besim, në vepra të mira dhe në këshillimin e së vërtetës dhe durimit, janë në humbje të madhe.

Sot është dita që ne duhet të përgatitemi për këtë llogari, e cila do të na sigurojë shpëtimin në Ditën e gjykimit! Ky është çasti për të kryer vepra të mira! Kjo është edhe mundësia që kemi për t'ia kthyer të zotit të vërtetë amanetet që kemi! Po ashtu, kjo është edhe arsyeja e thënies profetike: “Janë shkatërruar ata që thonë, e bëj nesër!”, sepse nuk ka asnjë garanci se e nesërmja do të arrihet.

Ne duhet të nxitojmë në kryerjen e punëve të dobishme dhe të marrim si parim të jetës sonë këto këshilla të Profetit ﷺ:

“O Njerëz! Pendohuni tek Allahu para se të vdisni! Nxitoni në vepra të mira, para se të përballeni me vështirësi e vuajtje që do t’ju mbajnë të zënë! Përpiquni t’i jepni Allahut të drejtën që ka mbi ju, duke e përmendur shumë Atë dhe duke dhënë sadaka hapur dhe fshehtas, me qëllim që të arrini furnizimin, të merrni ndihmën e Tij dhe të përmirësoheni!” (Ibn-i Maxhe, Ikame, 78)

Udhëtimi i shpirtit

I Dërguari i Allahut ﷺ, na ka përshkruar disa tablo prej ndodhive të varrit, Kiametit dhe Ahiretit, me qëllim që ne të meditojmë, të marrim mësim, e të përgatitemi për frymën e fundit dhe për kohën përtej saj:

Ebu Hurejre رضي الله عنه, transmeton se, njëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Kur besimtarit i del shpirti, atë (shpirtin) e presin dy melekë dhe e ngrenë lart.” Më pas, tha se shpirti i besimtarit mban erë të mirë, e cila përhapet rreth e qark. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, vijoi:

“Banorët e qiellit thonë:

«Sa shpirt i bukur e i mirë po vjen nga toka! Allahu të mëshiroftë ty dhe trupin brenda të cilit ke qenë!»

Më pas, shpirti nxirret menjëherë para Allahut, i Cili urdhëron:

«Dërgojeni atë (në varrin e tij që është si kopsht Xheneti) të qëndrojë derisa të mbarojë jeta e berzahut!»

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, foli për erën e keqe të shpirtit që del nga trupi i mohuesit, për mallkimin që bie mbi të dhe për faktin se të gjithë duan të largohen prej tij. Ai vazhdoi me këto fjalë:

“Kur del shpirti i mohuesit (banorët e qiellit) thonë:

«Sa shpirt i ndyrë po vjen nga toka!» Më pas thuhet:

«Dërgojeni atë (në varrin e tij që është si një prej gropave të Xhehenemit) të qëndrojë derisa të mbarojë jeta e berzahut!»

Ndërkohë që po rrëfente këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, (për shkak të erës së keqe të shpirtit të mohuesit) kishte vendosur në hundën e tij të bekuar një rrobë të hollë, të cilën e kishte më parë mbi supe.” (Muslim, xhenet, 75)



Ndërsa Bera ibn Adhib tregon:

Bashkë me të Dërguarin e Allahut ﷺ, shkuam në xhenazen e njërit prej ensarëve. Kur arritëm tek varri, i vdekuri nuk ishte varrosur ende. Ne u ulëm rreth të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili filloi të shohë sa në tokë e sa në qiell. Ai i ngriti dhe i uli tri herë sytë e tij të bekuar, e më pas u lut:

“O Allah! Strehohem tek Ti prej dënimit të varrit!” Pas kësaj tha:

“Kur vjen koha që një mysliman të ndahet prej kësaj bote, e i afrohet Ahiretit, ujen meleku i vdekjes dhe ulet tek koka e tij. Prej qiellit zbresin edhe melekë (të tjerë), të cilëve u shndrisin fytyrat si dielli. Ata kanë me vete qefin dhe parfum prej Xhenetit. Këta melekë ulen para njeriut, në vendin ku sheh ai. Ndërkohë meleku i vdekjes thotë:

«O shpirt që ke arritur paqen! Dil që të arrish faljen dhe kënaqësinë e Zotit tënd!»

E ai del (prej trupit) me lehtësi ashtu siç derdhet pika e ujit prej enës.

Melekët e tjerë, pa e lënë atë shpirt qoftë edhe sa hap e mbyll sytë në dorën e mekut të vdekjes, e marrin menjëherë dhe e ngrenë në qiell. Sa herë që kalojnë pranë një grupi melekësh, thuhet:



«Kush është ky shpirt i bukur?» Ndërsa melekët që po e ngrënë në qiell, duke e përmendur atë me cilësi të bukura, thonë:

«Ky është filani, biri i filanit!»

Kur arrijnë në qiell, hapen të gjitha portat e tij. Në çdo kat që kalojnë, këtë shpirt e përcjellin melekët “mukarrabun”, pra melekët më të afërt me Allahun, derisa arrijnë në katin e shtatë të qiellit. Më pas thuhet:

«Librin e punëve të tij shkruajeni në Il-lijjin!»

E më pas thuhet:

«Dërgojeni në tokë robin Tim, sepse Unë kam premtuar se do t'i krijojë ata prej dheut, do t'i rikthej në të dhe do t'i nxjerr përsëri prej tij!»

Pas kësaj, shpirti kthehet përsëri në trupin e tij.²⁹

Melekët afrohen pranë të vdekurit dhe e pyesin:

«Kush është Zoti yt?»

«Allahu!» -thotë ai.

«Cila është feja jote?» -pyesin ata.

«Islami» -thotë ai.

«Kush ishte ky person që ka dalë prej jush?» -pyesin përsëri ata.

«Ishte i Dërguari i Allahut.» -përgjigjet ai.

«Nga e di këtë?» -pyesin ata.

«Lexova Librin e Allahut, i besova dhe e pranova Atë!» -thotë ai.

Pas kësaj, një zë thërret nga qielli:

«Ka thënë të vërtetën! Përgatitini atij një vend në Xhenet, visheni me rrobat e Xhenetit dhe tregojini vendin e tij në të!»

Më vonë ai person vendoset në varrin e vet, ku i vijnë erërat e Xhenetit dhe flladet e tij të këndshme. Pasi i bëhen këto, pranë tij shfaqet një njeri me fytyrë të bukur, rroba të pastra dhe aromë të mirë, i cili i thotë:

«Gëzohu me gjërat që të pëlqejnë! Kjo është dita që të është premtuar!»

29. Sado i gjerë të jetë horizonti i meditimt, ashtu siç nuk është e mundur t'i përshkruash siç duhet të gjitha ngjyrat për mendjen e dikujt tjetër, ashtu nuk është e mundur që ne në këtë botë, të kuptojmë siç duhet botën e varrit, të cilën nuk e kemi parë. Për këtë arsye, ne besojmë se ndodhitë e varrit dhe përtej tij, janë ashtu siç jemi lajmëruar nga Kurani dhe Sunneti. Për shkak se mendja njerëzore mendon me modele të kësaj bote, edhe i Dërguari i Allahut ﷺ, të vërtetat në lidhje me jetën e varrit i ka shpjeguar sipas nivelit të kuptimit tonë. Përndryshe, vetëm Allahu i Madhëruar e njeh më mirë atë botë dhe mënyrën e funksionimit të saj.

Kur myslimani e pyet:

«Kush je ti? Paskë një fytyrë përgëzuese!», njeriu thotë:

«Unë jam vepra jote e mirë.»

Më pas, myslimani lutet:

«O Zot! Bëje menjëherë Kiametin, që të takohem me familjen dhe pasurinë time (që do të më dhurosh në Xhenet)!»

Pasi tha këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, këndoi ajetin:

“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër...” (Ibrahim, 27)

Më pas, Profeti ﷺ, vazhdoi:

“Sa i përket gjynahqarit; kur atij i vjen koha të ndahet nga kjo botë e i afrohet Ahiretit, i vjen meleku i vdekjes dhe i ulet tek koka. Nga qielli zbresin melekë me fytyra të nxira që mbajnë në duar rroba të ashpra të bëra prej qimeve dhe ulen para tij, në vendin ku ai sheh. Më pas meleku i vdekjes thotë:

«O shpirt i ndyrë! Dil që të shijosh ashpërsinë dhe zemërimin e Allahut!»

Më pas, shpirti ndahet me vështirësi prej trupit, sikur nxirret një shufër me grepa e ganxha nga leshi i lagur. Madje, bashkë me të (duket sikur) këputen edhe të gjithë damarët dhe nervat (pra aq shumë vuan).

Melekët ngrihen menjëherë dhe pa e pritur shumë atë shpirt, e ngrenë në qiell. Sa herë që kalojnë pranë një grupi melekësh, thuhet:

«Kush është ky shpirt i ndyrë?»

Melekët, duke e përmendur atë me cilësi negative, thonë:

«Ky është filani.»

Kur arrijnë në qiell, dyert e qiellit i mbyllën në fytyrë dhe thuhet:

«Librin e punëve të tij shkruajeni në Sixhxhin!»

E më pas thuhet:

«Dërgojeni në tokë robin Tim, sepse Unë kam premtuar se do t'i krijojë ata prej dheut, do t'i rikthejë në të dhe do t'i nxjerr përsëri prej tij!»

Shpirti i tij hidhet në tokë dhe bie në trupin e tij.”

Pasi sqaroi këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, këndoi këtë ajet:

“...Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.” (Haxh, 31)

Më pas, Profeti ﷺ, vazhdoi:

“Melekët i vijnë gjynahqarit dhe e pyesin:

«Kush është Zoti yt?»

«Nuk e di!» -thotë ai.

Atë moment nga qielli thërret një zë, i cili thotë:

«Nuk ka thënë të drejtën! Përgatitini atij një vend prej zjarrit, vishini roba të Xhehenemit dhe tregojini vendin e tij në të!»

Varri e shtrëngon aq shumë atë, saqë brinjët i hyjnë njëra me tjetrën.³⁰ Atij fillojnë t'i vijë era dhe nxehtësia e Xhehenemit. Pas këtyre, pranë tij shfaqet një njeri me fytyrë të shëmtuar, i veshur keq dhe me erë të pështirë, i cili i thotë:

«Përgëzohu me atë që nuk të pëlqen! Kjo është dita që të është premtuar.»

Gjynahqari thotë:

«Kush je ti? Fytyra jote ndjell të keqen!» E ai i përgjigjet:

«Unë jam vepra jote e keqe!»

Pas kësaj, gjynahqari thotë:

«O Zot! Mos e sill fare Kiametin!» (Hakim, Mustedrek, I, (93-95/107. Shih. Ahmed, IV, 287, 295; Hejthemi, III, 50-51)

Udhëtimi i trupit

Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kur xhenazja vendoset në tabut dhe njerëzit (ose burrat) e marrim mbi supe, nëse ai (i vdekuri) njeri ka qenë i mirë thotë:

30. Ne nuk e dimë me saktësi, nëse këto shprehje janë përdorur me kuptim të vërtetë apo met - forik, sepse në fakt, me mundësitë që kemi në këtë botë nuk mundemi t'i njohim plotësisht ato që do të ndodhin në varr. Të dhënat që mësojmë nga hadithet fisnike në lidhje me botën e berzahut, janë përshkruar me gjëra që janë përjetuar dhe njihen në këtë botë. E në fakt, kjo është bërë me qëllim që ne ta kuptojmë mjaftueshëm tmerrin dhe ashpërsinë e dënimit në varr, e të marrim mësimet dhe masat e duhura për atë moment.



«Më takoni sa më parë, më takoni sa më parë (me shpërblimin e punëve të mia të mira)!»

Por nëse nuk është njeri i mirë, fillon e qahet duke thënë:

«Mjerë unë! Ku e çoni këtë tabut?»

Fjalët e kësaj xhenazeje i dëgjon çdo qenie tjetër përveç njerëzve. Nëse njeriu do ta dëgjonte këtë zë, do t'i binte të fikët menjëherë.” (Buhari, xhenaiz, 50, 90, 91)



Ndërsa Bera ﴿﴾, e tregon kështu gjendjen e Profetit ﴿﴾, gjatë përcjelljes së një xhenazeje:

“Bashkë me të Dërguarin e Allahut ﴿﴾, gjendeshim në një xhenaze, ku ai u ul në anë të varrit dhe filloi të qajë aq shumë sa toka u lag me lotët e tij. Më pas tha:

«O vëllezërit e mi! Përgatituni pikërisht për një vend të tillë të rëndësishëm!»” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 19)



PJESA IV



Jeta e varrit

Edhe pse nga jashtë duket si një grumbull dheu i heshtur, në fakt varri ku do të hyjë biri i njeriut është një shembull i ditës së mahsher-it. Varri, i cili është stacioni i parë i Ahiretit, do të marrë formë sipas zbatimit të urdhrave të Allahut në këtë botë. Profeti ﷺ, ka thënë:

“Varri është ose një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, ose një gropë prej gropave të Xhehenemit...” (Tirmidhi, Kiamet, 26)

JETA E BERZAHUT DHE BOTA E AHIRETIT³¹

Pasi të ndahemi nga kjo botë, në sajë të vdekjes, do të kalojmë në jetën e varrit, e quajtur ndryshe “bota e Berzahut”, e cila është një ndalesë e përkohshme. Më pas do të fillojë edhe ndalesa e fundit që është jeta e Ahiretit.

Jeta e berzahut është kalimtare njësoj si kjo botë. Ndërsa jeta e Ahiretit është ajo ku lumturia ose ndëshkimi janë të përjetshëm.

Pika më e rëndësishme që nuk duhet të harrojmë kurrë në lidhje me botën e berzahut dhe atë të Ahiretit është fakti që jeta në këto dy botë është shumë më ndryshe nga jeta e kësaj bote, në shumë aspekte. Në këto dy botë koha edhe hapësira do të matet ndryshe.

Për shembull, në këtë botë koha matet në bazë të lindjes dhe perëndimit të diellit. Ditën e llogarisim me orë, muajin me ditë, e vitin me muaj. Por me të hyrë në varr, të gjitha këto njësi matëse do ta humbasin kuptimin e tyre. Matja e kohës në varr, do të jetë në përputhje me botën e berzahut.

E njëjta gjë vlen edhe për jetën e Ahiretit. Madje, për shkak se jeta e Ahiretit do të jetë e përjetshme, njësitë matëse, sasisë, koha dhe hapësira në atë jetë do të jenë komplet ndryshe nga ato të jetës së dynjasë. Ndërkohë që përpiqemi të kuptojmë më shumë në lidhje me jetën e Ahiretit, përmes të dhënave që marrim prej ajeteve dhe haditheve, ne nuk duhet të anashkalojmë edhe faktin se krahasimet janë bërë duke u bazuar në kriteret e kësaj bote.

Njeriu ka zbuluar se edhe koncepti i kohës dhe hapësirës që njohim në këtë botë, vlen vetëm për Tokën (si planet), sepse është vërejtur se në kozmos koha dhe hapësira janë relative. Ato mund të shkurtohen e ngushtohen ose të zgjaten e të zgjerohen në kushte të ndryshme. Shkencëtarët kanë vërtetuar se nëse marrim një fëmijë dhe e vendosim të jetojë 10 vite sipas matjes së Tokës në një planet tjetër me tërheqje gravitacionale më të fuqishme, kur të kthehet në Tokë pas 10 vitesh do të vërehet se ai do të jetë më i ri se një fëmijë tjetër i lindur po në të njëjtën ditë por që ka jetuar

31. Relacioni që hoxxa i nderuar Ebu Bekir Sifil ka bërë në librin tonë në lidhje me jetën e varrit dhe gjendjen në botën tjetër.

në Tokë. Po ashtu, astronauti Scott Kelly, i cili u dërgua në hapësirë nga NASA në vitin 2015, kur u kthye në Tokë, pas afro 1 viti, ishte zgjatur 5 cm dhe ishte rinuar afro 1 të 100 e sekondit.

Këto të dhëna na ndihmojmë të kuptojmë më mirë se pse nuk është e drejtë të përpiqemi ta kuptojmë jetën e pafundme të Ahiretit me kriteret matëse të kësaj bote. Gjërat që nuk i dimë, mendja jonë përpiket t'i kuptojë duke i krahasuar me ato që dimë. Kur dikush është duke përshkruar dikë që nuk e njohim, ai tregon duke lidhur ngjashmëri me të njohurit e për-bashkët. Për shembull, trupin e ka si të filanit, fytyrën si filani, ndërsa sytë si filani, etj...

Por si mund ta përshkruajmë një qenie të cilën nuk e njohim aspak?! Nëse dikush na thotë: "Pak më parë pashë dikë, që nuk ishte as burrë, as grua. Pra nuk kishte gjini.", çfarë do të kuptojmë ne nga kjo?! Në fakt nuk do të kuptojmë asgjë, sepse ne nuk kemi parë asnjëherë dikë që është pa gjini. Megjithatë, ne besojmë në mënyrë absolute në ekzistencën e një qenie që quhet "melek", për shkak se jemi njoftuar nga Kurani Fisnik dhe Sunneti i Profetit ﷺ. E melekët nuk kanë gjini.

As për shpirtin ne nuk kemi dijeni, pra nuk e dimë se çfarë është "shpirti", nga se përbëhet dhe çfarë cilësish ka. Mirëpo ne besojmë në mënyrë absolute në ekzistencën e tij. Allahu i Madhëruar, në ajetin 85 të sures Isra, na lajmëron se në lidhje me shpirtin, "neve na është dhënë veçse pak dijeni", duke na e bërë të qartë se "ka shumë" gjëra që nuk mund t'i dimë e t'i shpjegojmë.

Pra, "të besosh" është tjetër gjë, "të kuptosh" tjetër. Ne i besojmë shumë gjërave për të cilat lajmërohemi në Kuran dhe Sunnet, edhe pse mund të mos i kuptojmë ashtu siç duhet. Ky është edhe kuptimi i "besimit në të fshehtën".

Në këtë aspekt duhen vlerësuar edhe çështjet e jetës së berzahut si pyetjet në varr, zgjerimi i varrit për besimtarët, ngushtimi për mohuesit, etj. Po ashtu edhe çështjet e tjera në lidhje me Ahiretin si pafundësia e jetës në Xhenet, fakti që atje nuk ka plakje, sëmundje dhe gjëra që të bëjnë të vuash, djegia e trupave të mohuesve në Xhehenem dhe ripërtëritja e tyre vazhdimisht pa u lënë të digjen komplet, etj. Të gjitha këto janë të vërteta dhe reale, megjithëse nuk mund t'i shpjegojmë siç duhet duke u nisur nga njohuritë dhe termat e kësaj bote.

JETA E VARRIT

Jeta e varrit nënkupton “jetën e berzahut”, e cila fillon me vdekjen e njeriut dhe vazhdon deri në ditën e ringjalljes në Mahsher. Kjo e vërtetë shprehet kështu në Kur’ânin Fisnik:

“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, ai thotë:

«O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!»

Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai e thotë (kot)! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Mu’minun, 99-100)

Sado dhe sido që të jetojë njeriu në këtë botë të përkohshme, pasi të konsumojë frymët e tij të numëruara, ai patjetër do të bëhet udhëtari i një bote tjetër që është varri. E vetmja gjë e kësaj bote që ai mund të marrë me vete në këtë udhëtim, është pak metra beze të qefinit.

Qefini, që është edhe veshja e fundit e tregut të kësaj jete të përkohshme, një ditë do t’i mbështjellë të gjithë dhe vdekja do t’i vërë vulën e anulimit të gjitha marrëdhënieve të kësaj bote, kënaqësive, argëtimeve dhe bukurive mashtruese!.. Trupi i njeriut do të kthehet në dheun prej të cilit është krijuar.

Trupi i njeriut është si një mbështjellëse për shpirtin e tij. Në ditën e Kiametit, kur të realizohet ringjallja, këtij shpirti do t’i vishte një trup i ri. Përbërja e këtij trupi të ri do të jetë në bazë të nivelit shpirtëror të fituar në dynja.

Mevlana lidhur me këtë fakt është shprehur:

“Mos e ushqe shumë trupin tënd me yndyrë e gjëra të ëmbla, sepse ushqimi me tepri të bën pre të dëshirave të nefsit dhe në fund largohesh i poshtëruar.”



“Shpirtin mëkoje me ushqime shpirtërore. Jepi mendim të pjekur, botëkuptim të thellë dhe bukuri, që të marrë forcë për atje ku duhet të shkojë.”

Në frymën e fundit do të fillojnë të duken shenjat e para të lumturisë apo katastrofës që na pret në jetën e përjetshme. Po kështu edhe jeta e varrit, si ndalesa e parë e Ahiretit, do të jetë niveli i dytë më i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje.

Hani ﷺ, skllavi i liruar i Osman ibn Affanit ﷺ, tregon:

Kur Osmani ﷺ, qëndronte pranë një varri, qante aq sa i lagej mjekra. Njëherë i thanë:

“Ti nuk qan kur përkujtohet Xheneti dhe Xhehenemi! Pse qan kur kujton varrin?” Osmani ﷺ, u përgjigj:

“Sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ, të thotë:

«Varri është ndalesa e parë e Ahiretit. Nëse njeriu arrin të shpëtojë prej tij, të tjerat janë më të lehta. Nëse nuk arrin të shpëtojë prej tij, ndalesat e tjera do të jenë më të vështira dhe më të ashpra se varri... Asnjë prej pamjeve që kam parë nuk është më e frikshme dhe më e tmerrshme se ajo e varrit!»
(Tirmidhi, Zuhd, 5/2308; Ahmed, I, 63-64)

I vdekuri në varr është si një person që po mbytet në det dhe kërkon ndihmë i tmerruar. Ai pret dua prej nënës, babait, vëllait dhe shokëve të mirë e të sinqertë. Nëse vjen ndonjë dua, kjo është më e vlefshme dhe më e gëzueshme për të se e gjithë bota dhe çka në të.

Për këtë arsye, kur një besimtar shkon në varreza, në fillim duhet të përshëndesë me selam banorët e varrezave, pastaj duhet të lutet për ta, duhet të lexoj Kuran sa ka mundësi dhe duhet të meditojë mbi faktin se një ditë edhe ai do të jetë aty. Një prej miqve të Allahut, i nderuari Hatem-i Esam ka thënë:

“Një njeri që shkon në varreza dhe nuk lutet për banorët e varreve duke medituar edhe për fundin e vet, ka tradhtuar edhe veten edhe ata.”
(Ihja, IV, 868)

Ndërsa dijetari i madh Islam, Sufjan ibn Ujejne ka thënë:

“Nevoja që të vdekurit kanë për duanë është më e madhe se nevoja që kanë të gjallët për ushqimin dhe pijen.” (Sujuti, Sherhu’s-Sudur, Lubnan, 1417, fq. 297)

Padyschim se Allahu i Madhëruar i shpërblen banorët e varrit në sajë të begatisë së duasë së të gjallëve. Dhurata më e mirë që të gjallët mund t'i dërgojnë të vdekurve është lutja për faljen e tyre dhe dhënia e sadakasë në emër të tyre.

Sipas besimit të ehl-i sunetit, një person që vdes mund të dëgjojë, të ndjejë e të jetë i vetëdijshëm. Ai përfiton dhe gëzohet prej mirësive që bëhen. E po ashtu vuan e hidhërohet nga të këqijat që bëhen. Pra, njeriu vdes me trup por jo me shpirt.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Qënia ime gjallë është në të mirën tuaj: Ju bisedoni me mua dhe unë bisedoj me ju! Edhe vdekja ime është mirësi për ju: Veprat tuaja më prezantohen mua. Kur shoh punët tuaja të mira, falënderoj Allahun për to. Por kur shoh punët tuaja të këqija, i kërkoj Allahu që t’ju falë.” (Hejthemi, IX, 24)

Po ashtu, në Hutben e Lamtumirës, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kujdes, mos ma nxini fytyrën (me gjynahe)!” (shih. Hejthemi, III, 271; Hamidullah, el-Uesaik, fq. 367)

Pra, të gjitha veprat që kryejmë ne si ummet i Profetit ﷺ, i paraqiten atij. Po ashtu, atij i arrin edhe çdo selam që i dërgojmë.³²

Ndërsa në një tjetër hadith fisnik lajmërohem se veprat tona i paraqiten edhe të afërmeve tanë që janë robër të udhëzuar (besimtarë):

“Veprat tuaja u tregohen të vdekurve prej të afërmeve dhe farefisit tuaj. Nëse veprat tuaja janë të mira, ata gëzohen. Por nëse nuk janë të mira, ata luten duke thënë: «O Allah! Mos ua merr shpirtin pa i udhëzuar edhe ata, ashtu siç na udhëzove neve!»” (Ahmed, III, 164; Taberani, Kebir, IV, 129/3887)

Shkurtimisht, varri është pika e fillimit të hidhërimeve dhe vuajtjeve të mëdha për ata që e çojnë dëm jetën e tyre të përkohshme, duke vrapuar pas dëshirave të egos. Ndërsa për ata që e kalojnë jetën e tyre në atmosferën shpirtërore të Kuranit dhe Sunnetit, varri është shkalla e parë e lumturisë së pafundme.

Një ditë, pranë Profetit ﷺ kaloi një xhenaze, e ai tha:

“Ka arritur qetësinë ose kanë shpëtuar prej tij!”

32. shih. Ebu Daud, Menasik, 96.



Sahabët pyetën të habitur:

“-O i Dërguar i Allahut! Çfarë deshët të thoshit me shprehjen: «Ka arritur qetësinë ose kanë shpëtuar prej tij?»»

Resulallahu ﷺ, u përgjigj:

“-Kur vdes një rob besimtar, ai qetësohet prej lodhjes e vështirësive të kësaj bote dhe arrin mëshirën e Allahut. Ndërsa kur vdes një gjynahqar, njerëzit e tjerë, qytetet, pemët dhe kafshët shpëtojnë prej tij dhe gjejnë qetësi.” (Buhari, Rikak, 42)

Pyetjet e varrit

Çdo njeri që i nënshtrohet provimit të devotshmërisë, në shkollën e kësaj bote, patjetër që do të merret në pyetje pasi të ketë plotësuar frymët e tij të numëruara e të hyjë në varr. Madje, edhe ata që janë djegur në zjarr, janë mbytur në ujë ose kanë përfunduar si ushqim për kafshët e shpendët dhe nuk kanë hyrë në varr, do ta arrijnë botën e berzahut e do të merren në pyetje.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:


“Kur besimtari vendoset në varr, atij i vijnë melekët dhe ai dëshmon: «Përveç Allahut nuk ka zot tjetër dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!». Pikërisht për këtë gjendje bën fjalë edhe Allahut i Madhëruar në Fjalën e Tij: **«Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i shpie në humbje; Allahu bën ç’të dojë.»** (Ibrahim, 27)” (Buhari, Xhenaiz, 87, Tefsir, 14/2)


Osmani ﷺ, transmeton se pas varrimit të një personi, i Dërguari i Allahut ﷺ, është ulur në krye të varrit dhe ka thënë:


“Kërkoni prej Allahut faljen e vëllai tuaj dhe dëshironi suksesin e tij, sepse ai tani po merret në pyetje.” (Ebu Daud, Xhenaiz, 69)

Njeriu ndjen gjithmonë tension dhe shqetësim të madh nga çështjet e panjohura për të. Një nga çështjet, që reflekton shqetësime të tilla në zemra, është padyshim edhe ajo e jetës së varrit, sepse njeriu nuk ka asnjë njohuri në lidhje me aventurën e nëntokës. Në fakt, edhe pse Profeti ﷺ, na ka lajmëruar shkurtimisht se, “Varri është ose një kopsht prej kopshteve



të Xhenetit, ose një gropë prej gropave të Xhehenemit...³³, ai na ka dhënë edhe detaje të tjera në lidhje me këtë çështje. Për shembull, Esmā bint-i Ebi Bekr , thotë:

“Njëherë, i Dërguari i Allahut filloi të mbante hutbe dhe tregoi në lidhje me pyetjet që do t’i bëheshin njeriut (në varr). Ndërkohë që Profeti , po e tregonte gjendjen e varrit me detaje, myslimanët filluan të qanin përnjëherësh me zë të lartë.” (Buhari, Xhenaiz, 87)

Këto fjalë të Profetit , janë gjithashtu prej atyre haditheve fisnike që na japin të dhëna të detajuara në lidhje me gjendjen e njeriut në varr:

Enesi , transmeton se i Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Kur robi vendoset në varr e të afërmit i kthejnë shpinën dhe ikin (në këtë moment i vdekuri i ndjen hapat e njerëzve që po ikin), atij i vijnë pranë dy melekë. Ata e ulin dhe e pyesin:

«Çfarë thoshe në lidhje me personin që quhet Muhamed?» Besimtari, kësaj pyetje i përgjigjet duke thënë:

«Dëshmoj se ai është rob dhe i Dërguari i Allahut!» Më pas i thuhet:

«Shiko vendin tënd në Xhehenem! Allahu e ndërroi atë me një vend në Xhenet për ty.» (Njeriu i sheh që të dyja vendet)

[Katade thotë: “Sipas një transmetimi, atij i zgjerohet varri shtatëdhjetë parakrah dhe i mbushet me mirësi. E ai do të jetë në mirësi të tilla derisa të ringjallet.”]³⁴

Nëse i vdekuri është mohues apo hipokrit (pyetjes së melekëve) u përgjigjet:

«Nuk e di. Unë thosha atë që thoshin njerëzit!» Atij i thuhet:

«Nuk e mësove, nuk e kuptove dhe as nuk shkove pas një të dituri!»

Më pas, ai goditet me një çekiç prej hekuri midis veshëve dhe si shkak i dhimbjes nga kjo goditje, ai bërtet aq fort saqë zërin e tij e dëgjon çdo gjë përreth tij, përveç dy botëve (ajo e njerëzve dhe e Xhinëve).” (Buhari, Xhenaiz, 68, 67; Muslim, Xhennet, 70; Ebu Daud, Xhenaiz, 78/3231; Nesai, Xhenaiz, 110; Tirmidhi, Xhenaiz, 70/1017)

33. Tirmidhi, Kijamet, 26.

34. Muslim, Xhennet, 70.



Në një transmetim tjetër thuhet se dy melekët që vijnë kanë ngjyrë të zezë, sy blu qiell dhe emrat e tyre janë Munker dhe Nekir.

Po ashtu, në një tjetër hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“I vdekuri vendoset në varr. Nëse është njeri i mirë do të qëndrojë në varr pa u shqetësuar dhe pa frikë. Pastaj pyetet:

«Çfarë feje kishe?»

«Unë isha në fenë Islame!» -përgjigjet ai. Më pas pyetet (në lidhje me besimin në Profetin a.s):

«Kush është ky njeri?» E ai thotë:

«Është Muhamedi ﷺ, i Dërguari i Allahut. Ai na solli argumente të qarta prej Allahut dhe ne e pranuan atë.» Më pas pyetet:

«A e ke parë Allahun e Madhëruar?»

«Askush nuk mund ta shohë Allahun e Madhëruar në dynja!» -përgjigjet ai.

Më pas i hapet një dritare nga ana e Xhehenemit. I vdekuri vështron në të dhe sheh flakët e Xhehenemit që godasin njëra-tjetrën (prej fuqisë dhe nxehtësisë së madhe). Në atë moment i thuhet:

«Shikojë zjarrin prej të cilit të ka ruajtur Allahu i Madhëruar!»

Më pas i hapet një dritare nga ana e Xhenetit, ku ai sheh bukuritë dhe mirësitë e tij. Pastaj i thuhet:

«Ja, ky vend i bukur është i yti!»

«Ti kishe besim të fortë (në dynja), me këtë besim të fortë ke vdekur dhe inshaAllah po me këtë besim do të ringjallesh.»³⁵

Ndërsa njeriu i keq do të vendoset në varr mes tmerrit e frikës dhe do të pyetet:

«Çfarë feje kishe?»

35. Edhe pse në hadith thuhet se besimtari do të pyetet dhe më në fund do t'i tregohet vendi i tij në xhenet, në të vërtetë, njeriu do të merret në pyetje pas Kiametit. Atëherë, njeriu do të shohë shpërblimin e çdo të mire apo të keqeje, qoftë edhe sa grimca. Në Kuranin fisnik thuhet qartë se edhe profetët, të cilët nuk ka dyshim se janë në xhenet, do të merren në pyetje. (shih. A'raf, 6)

«Nuk e dil!» -përgjigjet ai. Më pas pyetet (në lidhje me besimin në Profetin ﷺ):

«Kush është ky njeri?» E ai thotë:

«Njerëzit thoshin disa gjëra në lidhje me të. Po ato thosha edhe unë.» (Pra, ai shprehet se nuk ka qenë shumë i interesuar në lidhje me fenë dhe ka ndjekur verbërisht njerëzit e tjerë)

Pastaj, atij i hapet një dritare nga ana e Xhenetit, ku ai sheh bukuritë e tij. Në atë moment i thuhet:

«Shikojë Xhenetin që Allahut i Madhëruar e largoi prej teje (për shkak se nuk ke besuar)!»

Më vonë i hapet një dritare nga ana e Xhehenemit, ku ai vështron dhe sheh flakët që godasin njëra-tjetrën. Aty i thuhet:

«Ja ky është vendi yt! Ke jetuar me dyshim (në lidhje me Islamin), ke vdekur me dyshim dhe inshaAllah do të ringjallesh me dyshim (në ditën e Kiametit)!»” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 32. Shih. Buhari, Xhenaiz, 68, 87; Muslim, Xhennet, 70)



Në një hadith tjetër thuhet se nëse personi i vdekur është prej banorëve të Xhenetit, atij do t'i tregohet një vend prej Xhenetit, e nëse është prej banorëve të Xhehenemit, do t'i tregohet një vend prej Xhehenemit. Më pas, atij do t'i thuhet:

“Ky është vendi yt (i ardhshëm e i përjetshëm). Këtu do të dërgojë Allahu ditën e Kiametit.” (Buhari, Xhenaiz, 90)

“...Vendi ku përket do t'i tregohet në këtë mënyrë deri në ditën që do të ringjallet.” (Buhari, Rikak, 42)


Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, na lajmëron se njerëzit do t'i nënshtrohen një lloj prove besimi në varr dhe do t'u bëhen disa pyetje. Lidhur me këtë ai thotë:

“Mua më është shpallur se në varr ju do t'i nënshtroheni një sprove si fitnja e Dexhalit (ose), përafërsisht si ajo.” (Buhari, Udu, 37)

Me anë të këtij hadithit, Profeti ﷺ na paralajmëron me forcë në lidhje me ashpërsinë dhe tmerrin e pyetjeve.



Uathile Ibnu'l-Eska , transmeton:

Njëherë i Dërguari i Allahut fali namazin e xhenazes së njërit prej mys-limanëve. Më pas, dëgjova që i Dërguari i Allahut , bëri këtë dua:

“O Allah! Filanin, birin i filanit, e ke amanet dhe nën mbrojtjen Tënde! Ruaje atë nga fitnja e varrit dhe dënimi i Xhehenemit. Ti e mban premtimin dhe meriton falënderimin!

O Allah! Fale dhe mëshiroje atë! Padyshim Ti je falës dhe mëshirues...”

(Ebu Daud, Xhenaiz, 56; Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 23)



Sa lumturi e madhe është arritja e mëshirës së Allahut të Madhëruar. Njëherë, njërin prej miqve të Allahut, Maruf-i Kerhin, e kanë pyetur:

“O Maruf! Çfarë të shtyn të bësh kaq shumë adhurime?” Maruf-i Kerhi heshti, por pyetësi nguli këmbë dhe tha:

“Përkujtimi i vdekjes?”

Maruf-i Kerhi tha:

“E çfarë është vdekja?”

“Apo mos vallë meditimi mbi varrin dhe botën e berzahut?” -pyeti ai përsëri.



“E çfarë është varri?” -tha përsëri Maruf-i Kerhi. Por pyetësi vazhdoi të këmbëngulte dhe tha:

“Apo frika nga Xhehenemi dhe shpresa për Xhenet?” Pas kësaj pyetje, Maruf-i Kerhi i dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“E ç’janë këto?! Ai që ka në dorë fenomenet që ti përmende, është një Zot aq madhështor sa nëse arrijmë të ndiejmë dashuri dhe dëshirë të thellë karshi Tij, Ai na mundëson t’i harrojmë të gjitha këto. Nëse midis nesh dhe Allahut lindin njohja dhe dashuria në të tilla përmsa, në sajë të tyre, Ai na shpëton prej të gjitha dukurive që ti numërove!”³⁶

Dënimi i varrit

“Dënimi i varrit” është një nga çështjet e së fshehtës, e cila nuk mund të kuptohet me shqisat dhe mendjen tonë, përveçse me anë të shpalljes hyjnore. Dënimi i varrit është ndëshkimi hyjnor për të pabindurit ndaj urdhrave të Allahut, që do të përjetohet pas vdekjes, në fazën e pritjes në varr deri në ditën e Kiametit. Ky dënim, në disa hadithe fisnike është cilësuar si “fitneja e varrit”.

Sa’d ibn-i Ebi Uakkasi , transmeton se i Dërguari i Allahut , pas namazeve strehohej tek Allahu duke bërë këtë dua:


“O Allah! Strehohem tek Ty prej mungesës së guximit dhe prej kopracisë! Strehohem tek Ty prej matufosjes së pleqërisë. Strehohem tek Ty prej fitnes së dynjasë. Strehohem tek Ty prej fitnes së varrit.” (Buhari, Xihhad, 25, Deauat, 37, 41, 44)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, në lidhje me dënimin e varrit lajmëron:

“...Ah sikur t’i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart (duke thënë): «Dorëzoni shpirtrat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për Allahun dhe shpërfilljes që i keni bërë shpalljeve të Tij!»”. (En’am, 93)

“Në të vërtetë, për keqbërësit ka edhe një dënim tjetër para këtij; por shumica e tyre nuk e dinë.” (Tur, 27)

“Ka beduinë në mjedisin tuaj, që janë hipokritë, por ka edhe ndër banorët e Medinës të atillë që janë këmbëngulës në hipokrizi. Ti nuk i di ata. Ne i dimë. Ne do t’i dënojmë dy herë e pastaj, do të kthehen në dënimin e madh (në Xhehenem).” (Teube, 101)

Sipas dijetarëve të ehl-i sunnetit, ajetet të cilat na njoftojnë se Faraoni dhe ndjekësit e tij do të çohen para zjarrit në mëngjes e në mbrëmje, ndërsa në ditën e Kiametit do të shijojnë dënimin më të ashpër³⁷, dhe ajetet që na bëjnë të ditur se pasi populli i Nuhut  mbytet në ujë, ata hidhen menjëherë në zjar³⁸, janë argumente për dënimin e varrit.


37. shih. Gafir, 46.

38. shih. Nuh, 25.




Po ashtu, në hadithet fisnike bëhet e ditur se veprat e cilësuara haram si përgojimi³⁹, kuja pas të vdekurit⁴⁰, vdekja si borxhli⁴¹, gënjeshtria, kurvëria, ngrënia e kamatës dhe pirja e alkoolit⁴² janë shkak i dënimit të varrit.

Nëna jonë, Aisheja  ka thënë:

“Nuk e kam parë kurrë të Dërguarin e Allahut , të falë namaz e të mos strehohet tek Allahu prej dënimit të varrit!” (Buhari, Xhenaiz, 87)

Ndërsa sahabët e nderuar, Ebu Xhuhajfe, Bera ibn Adhib dhe Ebu Ejjub el-Ensari , kanë thënë:

“Një ditë, i Dërguari i Allahut , kishte dalë (jashtë Medinës) pas perëndimit të diellit. (Papritur) dëgjoji një zë dhe tha: «*Hebrenjtë po dënohen në varr!*»” (Buhari, Xhenaiz, 88; Muslim, Xhennet, 69)

Në lidhje me temën mund të na përfshijë dilema e mëposhtme:


“Ne nuk shohim asnjë shenjë që tregon se një i vdekur po dënohet në varr! Për shembull, si ulet ai në varr, si pyetet ai dhe si goditen disa me çekiç prej hekuri?!”

Nëse logjikojmë përmes përjetimeve tona rezulton se:

“Kjo nuk është aspak e pamundur, sepse edhe në këtë botë ekzistojnë situata të ngjashme. Për shembull, një njeri që sheh ëndërr në gjumë mund të ndjejë realisht kënaqësinë apo dhimbjen që sheh, ndërkohë që askush tjetër përveç tij nuk mund t’i përjetojë këto ndjesi. Po ashtu edhe një person që është zgjuar, mund të ndjehet i entuziazmuar apo i hidhëruar prej një fjale që ka dëgjuar apo një mendimi që e ka përshkuar, ndërkohë që asnjë person që ai mund të ketë pranë, nuk ndjen të njëjtën gjë me të.”⁴³



Zejd ibn Sabiti , tregon:

“I Dërguari i Allahut , ndodhej në një kopsht të bijve të Nexhxharit hipur mbi një mushkë. Ndërsa ne ishim pranë tij. Papritur mushka u tremb

39. shih. Musned, I, 225; Buhari, Xhenaiz, 88.

40. shih. Buhari, Xhenaiz, 33; Muslim, Xhenaiz, 16-28.

41. shih. Ibn-i Maxhe, Sadakat, 12

42. shih. Buhari, Xhenaiz, 92, Tabir, 48.

43. shih. Tijbi, el-Kashif an Hakaiki's-Sunen, Mekke-i Mukerreme, 1417, II, 590.



dhe për pak sa nuk e hodhi në tokë të Dërguarin e Allahut ﷺ. Më pas vumë re se para nesh gjendeshin katër a pesë varre. Profeti ﷺ pyeti:

«Kush i njuh të zotët e këtyre varreve?»

Një prej sahabëve që ndodhej aty tha: «Unë i njoh!»

Profeti ﷺ, pyeti përsëri:

«Kur kanë vdekur ata?»

«Kanë vdekur në periudhën e idhujtarisë.» - u përgjigj sahabi. Atëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Ky ummet do të përjetojë provën e varrit (do të merret në pyetje dhe do të dënohet)! Nëse nuk do të kisha frikë se nuk do ta varrosnit njëri-tjetrin, do t'i lutesha Allahut t'ju bënte të dëgjonit edhe ju dënimin e varrit që po dëgjoj unë!»

Më pas, ai e ktheu fytyrën e tij të bekuar nga ne dhe tha:

«Strehohuni tek Allahu prej dënimit të Xhehenemit!»

Sahabët thanë:

«Strehohemi tek Allahu prej dënimit të Xhehenemit!»

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Strehohuni tek Allahu prej dënimit të varrit!»

Sahabët thanë:

«Strehohemi tek Allahu prej dënimit të varrit!»

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Strehohuni tek Allahu prej fitneve të hapëta dhe të fshehta!»

Sahabët thanë:

«Strehohemi tek Allahu prej fitneve të hapëta dhe të fshehta!»

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:


«Strehohuni tek Allahu prej fitnes së Dexhalit!»

Sahabët thanë:

«Strehohemi tek Allahu prej fitnes së Dexhalit!» (Muslim, Xhennet, 67)



Ibn-i Abbasi , tregon:

“Në momentin që i Dërguari i Allahut , doli nga një prej kopshteve të Medine-i Muneuures, dëgjoi zërin e dy personave që po vuanin në varr. Për këtë arsye ai tha:

«Këta të dy po ndëshkohen për shkak të gjynaheve që sipas tyre nuk ishin të mëdha. Por në fakt gjynahet e tyre ishin me të vërtetë të mëdha. Njëri nuk ruhej prej (stërpikave të) urinës, ndërsa tjetri bartte fjalë dhe merrej me thashetheme.»

Më pas kërkoi një degë hurme të njomë, të cilën e ndau në dy pjesë dhe i vendosi në krye të varreve dhe tha:




“Shpresohet t’u lehtësohet ndëshkimi derisa sa të thahen!” (Buhari, Edeb, 49, Udu, 55-56, Xhenaiz, 82)⁴⁴

Ebu Derda , ka thënë:

“O varr! Sa i heshtur je nga jashtë, por sa i frikshëm e i tmerrshëm je përbrenda!..”



Xhabir ibn Abdullah , tregon:

“Kur Sa’d ibn Muadhi , ndërroi jetë, ne shkuam së bashku me të Dërguarin e Allahut , i cili pasi i fali namazin e xhenazes, u ul tek varri i Sa’dit dhe e rregulloi duke i hedhur dhe sipër. Pastaj i Dërguari i Allahut , bëri tesbihat⁴⁵. Po ashtu edhe ne bëmë tesbihat së bashku me të për një kohë të gjatë. Më pas ai bëri tekbir⁴⁶, edhe ne bëmë tekbir. Më vonë, kur u pyet:

«O i Dërguar i Allahut! Përse bëtë tesbih dhe tekbir?», ai u përgjigj:

«Varri e shtrëngoi fort këtë rob të mirë, derisa Allahu ia zgjeroi atë!»
(Ahmed, III, 360, 377)

44. shih. Muslim, Taharet, 111; Ebu Daud, Taharet, 11; Tirmidhi, Taharet, 53; Nesai, Taharet, 26, Xhenaiz, 116; Ibn-i Maxhe, Taharet, 26.

45. Tesbihat: Dhikër, përmendje e Allahut me emrat e Tij të bukur, ose duke thënë “subhanallah, elhamdulillah, Allahut Ekber”.

46. Tekbir: Allahu Ekber (Allahu është më i madhi).




Ndërsa Ibn-i Abbasi  transmeton:

“Ditën kur u varros Sa’d ibn Muadhi , i Dërguari i Allahut , u ul në krye të varrit të tij dhe tha:

«Nëse dikush do të shpëtonte prej fitnes apo prej llogarisë së varrit, ky do të ishte Sa’d ibn Muadhi. Mirëpo, në fillim varri e shtrëngoi atë, e më pas Allahu i dha zgjerim!» (Taberani, el-Mu’xhemu’l-Kebir, X, 334; Hejthemi, III, 46)



Semure ibn Xhundeb  transmeton një hadith i cili na bën të ditur se cili gjynah do ta bëjë njeriun të pësojë ndëshkimin në var:

I Dërguari i Allahut , i pyeste shpesh shokët e vet:

“A ka kush prej jush që ka parë ndonjë ëndërr?” Nëse dikush kishte parë ëndërr, ai e komentonte ashtu siç dëshironte Allahu. Një mëngjes i Dërguari i Allahut na tha:

“Mbrëmë më kanë ardhur dy persona (Xhibrili dhe Mikaili) dhe më thanë:

«Lëre çdo gjë dhe eja me ne!»

Unë shkova me ta dhe hasëm një njeri të shtrirë mënjanë, ndërkohë që një njeri tjetër qëndronte mbi të me një gur në dorë. Ky e goditi njeriun e shtrirë dhe ia dërrmoi kokën. Guri u rrokullis dhe ai që e hodhi gurin, shkoi pas për ta marrë. Ndërkohë ai me kokë të dërrmuar u shërua menjëherë dhe koka e tij u kthye në gjendjen e mëparshme. Më pas njeriu me gur e përsëriti veprimin e tij si herën e parë.”

(Profeti ) tha:

“Personave me të cilët kam udhëtuar, u thashë:

«Subhanallah(Laudia i qoftë Allahut), ç’është kjo?»

Ata më thanë: «Vazhdo, ec!»

Ecëm dhe arritëm tek një njeri, i cili ishte i shtrirë në shpinë, ndërkohë që një njeri tjetër qëndronte mbi të me çengel (apo sharrë) hekuri. Ai kaloi nga njëra anë e atij që ishte shtrirë në shpinë dhe duke ia ngulur çengelën e hekurit në faqe, e çau nga një vrimë e hundës, (duke kaluar) nga njëri sy e deri pas qafës. Pas kësaj, ai kaloi në anën tjetër të fytyrës dhe bëri të



njëjtën gjë. Pa mbaruar me anën e dytë, ana e parë e fytyrës së tij u shërua e gjitha siç ishte. Njeriu me çengeljin prej hekuri filloi (nga e para) të bëjë të njëjtën gjë.

Profeti tha: «Pasi i pashë të gjitha, atëherë thashë:

«Subhanllah, ç'janë këta të dy?»

Dy shokët e mi më thanë: «Vazhdo, ec!»

Ecëm më tej dhe më në fund arritëm tek diçka e ngjashme me një furrë të ndezur. Aty dëgjoreshin britma, rënkime të ngatërruara, të cilat nuk kuptoheshin se çfarë thoshin. Kur vështruam në furrë, vumë re se aty kishte meshkuj dhe femra të zhveshur. Kur flakët e zjarrit ngriheshin nga poshtë, ata rënkonin. Unë sërish u thashë shokëve të mi:

«Ç'janë këta!»

Dy shokët e mi më thanë: «Vazhdo, ec!»

Ecëm më tej dhe arritëm deri tek një lumë prej gjaku, ku notonte një njeri, ndërkohë që në breg të lumit qëndronte një njeri tjetër që kishte tubuar një grumbull të madh me gurë. Kur notuesi shkante në breg të lumit për të dalë, ai i cili kishte tubuar një grumbull të madh me gurë ia hidhte një gur në gojë dhe e kthente pas. Ai ikte dhe sërish kthehej tek ai. Sa herë që vinte në breg për të dalë, njeriu tjetër i hidhte nga një gur në gojë, e ai kthehej pas. Sërish u thashë shokëve të mi:

«Ç'bëhet me këta të dy?»

Dy shokët e mi më thanë: «Vazhdo, ec!»

Ecëm më tej, derisa arritëm tek një njeri me pamje mjaft të shëmtuar, më të shëmtuarën që kam parë ndonjëherë. Ky njeri ndizte zjarr dhe vazhdimisht sillej rreth tij. Sërish i pyeta shokët e mi:

«Ç'është ky?»

Ata sërish më thanë: «Vazhdo, ec!»

Ecëm derisa mbërritëm tek një kopsht i gjelbër, në të cilin ndodheshin të gjitha llojet e luleve pranverore. Në mes të kopshtit qëndronte një njeri i gjatë. Ai ishte aq i gjatë, saqë pothuaj nuk ia shihja kokën, e cila shkante deri në qiell. Rreth tij kishte aq shumë fëmijë, sa s'kisha parë kurrë më herët. Unë sërish u thashë shokëve:




«Ç'është ky burrë dhe ç'janë këta (fëmijët)?»

Ata sërish më thanë: «Vazhdo, ec!»

Ecëm derisa arritëm tek një pemishte e madhe. Kurrë më herët nuk kisha parë pemishte të tillë kaq të bukur e të madhe. Ata më thanë: «Hyr brenda!». Hymë bashkë dhe na u shfaq përpara një qytet i ndërtuar me tulla të arta e të argjendta. Erdhëm deri tek dera e qytetit, trokitëm dhe kërkuam të na hapet. Dyert na u hapën dhe ne hymë. Aty na pritën disa njerëz, njëra anë e trupit të të cilëve ishte aq e bukur sa nuk keni parë ndonjëherë, ndërsa ana tjetër ishte aq e shëmtuar sa nuk keni parë ndonjëherë. Shokët e mi u thanë atyre:

«Shkoni dhe hyni në këtë lumë!»

Mirëpo, ç'të shoh, ai ishte një lumë me ujë si qumësht i bardhë që rridhte për së gjëri. Ata shkuan, hynë në lumë, e më pas dolën e u kthyen te ne. Shëmtia që ishte në njërin anë të tyre u zhduk e ata morën pamje shumë të bukur. Profeti  rrëfeu:

Dy shokët e mi më thanë:

«Ky është Xheneti i Adnit, kurse kjo është banesa jote.» Shikimi im u ngrit në lartësi dhe atje pashë një pallat të ngjashëm me re të bardha.

Ata më thanë: «Kjo është banesa jote.»

Unë u thashë atyre të dyve: «Allahu ju bekoftë të dyve, më lejoni të hyj në këtë pallat!» Ata më thanë:

«Tani për tani jo, ti do të hysh një herë tjetër.»

U thashë atyre:

“Vërtet unë këtë natë kam parë çudira. Çfarë janë ato që kam parë?”

Më thanë: «Lidhur me këtë, të sqarojmë ne:

Sa i përket njeriut të parë, koka e të cilit dërrmohej me gurë; ai është njeriu që e ka braktisur Kuranin pasi e ka mësuar dhe ka fjetur pa i falur namazet e obliguara (sidomos namazin e sabahut).

Sa i përket njeriut të cilit i nxirren fytyra, nofulla, vrimat e hundës dhe sytë e i copëtohen dhe priten; ai është njeriu që del nga shtëpia dhe përhapë gënjeshtër anembanë.



(Në një transmetim tjetër thuhet se: «Ai ishte një gënjeshtar që thosh-te vazhdimisht gënjeshtër në dynja. Gënjeshtër që përhapte ai kaplo-nin horizontin. Ky gënjeshtar do të vuajë në këtë mënyrë deri në ditën e Kiametit.»)

Sa u përket meshkujve dhe femrave të zhveshura që vuajnë në furrën e ndezur të zjarrit; ata janë lavirat dhe laviret.

Sa i përket njeriut që notonte në lumë, të cilit i hidhnin gurë në gojë; ai ishte fajdexhi që ka ngrënë kamatë.

Sa i përket njeriut me pamje shumë të shëmtuar që sillej rreth zjarrit; ai është Maliku, roja i Xhehenemit.

Sa i përket njeriut të gjatë në kopsht; ai është Ibrahim.

E sa u përket fëmijëve rreth tij; ata janë fëmijët që kanë vdekur në natyrën e pastër fëmijërore (fitreh).»

Njëri prej myslimanëve pyeti:

«O i Dërguari i Allahut! Edhe fëmijët e idhujtarëve?»

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha: «Edhe fëmijët e idhujtarëve!», e më pas vazhdoi:

Sa i përket njerëzve, njëra anë e të cilëve ishte e bukur, e ana tjetër mjaft e shëmtuar; ata janë njerëz që i kanë përzier punët e mira me të këqija, por Allahu ua kafaluar punët e këqija.» (Buhari, Ta'bir, 48, Xhenaiz, 93, Tehexhxhud, 12, Buju, 2, Xhihad, 4, Bed'u'l-Halk, 6, Enbija, 8, Tefsir, 9/15, Edeb, 69; Tirmidhi, Ru'ja, 10/2295)

Domethënë, nëse dëshiron Allahu i Madhëruar i fal robërit e Tij gjy-nahqar dhe nuk i dënon, ose mund t'ua ndërpresë dënimin pas një farë kohe. Mirëpo myslimani nuk mund të jetë asnjëherë i sigurt për faljen, sepse Allahu i Madhëruar nuk i ka dhënë askujt garanci për këtë, përveç se profetëve. Për rrjedhojë, robi duhet të përpiqet gjithmonë të jetojë me teube dhe istigfar, të largohet nga gjynahet dhe të nxitojë në punë të mira e të sinqerta.



Mejmun ibn Mihran, tregon:

Bashkë me **Omer ibn Abdulazizin**, shkuam drejt një varreze. Sapo e pa varrezën, ai u hidhërua. Më pas mu drejtua:

“O Mejmun! Këto janë varret e të parëve të mi. Duket sikur nuk janë përzierë fare me këtë botë. Pa shiko si kanë mbetur poshtë varrit! Varret u janë vjetëruar, ndërsa trupat ua ka ngrënë toka.” Më pas, duke parë një varr, me sy të përlotur tha:

“Vallahi, nuk mund të mendoj ndonjë njeri më fatlum se ai që ka hyrë në këtë varr dhe ka shpëtuar prej dënimit.” (Ihja, IV, 868)

Për të shpëtuar prej dënimit të varrit

I Dërguari i Allahut ﷺ, lutej në këtë mënyrë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ ، وَمِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ ،
وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ

“O Allah! Kërkoj strehim tek Ti prej dënimit të Xhehenemit dhe dënimit të varrit, prej sprovave të jetës, të vdekjes dhe mesihut (të rremë) Dexhxhallit!”⁴⁷

Në botën e varrit gjithsecili do të jetë vetëm për vetëm me veprat që ka bërë në dynja. Veprat e këqija do të jenë poshtërim i madh për njeriun, ndërsa veprat e mira do të jenë mik dhe mbrojtës i mirë për të zotin.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kur njeriu hyn në varr, nëse është besimtar, atë e rrethojnë veprat e tij si namazi, agjërimi etj. Ndërkohë që meleku përpiqet t’i afrohet nga ana e namazit, namazi e kthen mbrapsht, e kur përpiqet të afrohet nga ana e agjërimin, edhe ai e kthen mbrapsht. (Më pas) Meleku thërret nga larg duke thënë: “Ngrihu!”. E njeriu ngrihet prej vendit ku është shtrirë dhe ulet...

Nëse personi në varr është gjynahqar apo mohues, meleku i vjen pranë dhe midis të vdekurit dhe melekut (ndëshkues) nuk ka asgjë (vepër e mirë apo adhurim) që mund ta pengojë (melekun)...” (Ahmed, VI, 352. Shih. Hejthemi, III, 51-52)

“Kur njeriu vendoset në varr, i vjen (meleku ndëshkues). Nëse vjen nga ana e kokës, atë e largon leximi i Kuranit (që njeriu ka bërë në dynja).

47. Buhari, Xhenaiz, 88; Muslim, Mesaxhid, 128-134.



Nëse vjen nga ana e duarve, atë e largon zekati dhe sadakaja (që ka dhënë në dynja). Nëse vjen nga ana e këmbëve, atë e largon ecja për në xhami. Ndërsa durimi qëndron në anë si një mburojë e fortë. Meleku thotë: «Nëse do të kisha gjetur ndonjë hapësirë, do t'i isha afruar të vdekurit!» (Hejthemi, III, 52)

Po ashtu është nënvizuar se edhe ata që e lexojnë shumë suren Mulk, do të shpëtojnë prej vuajtjeve të varrit. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë: “Ajo është pengesë!”. Pra kjo sure e pengon vuajtjen dhe dënimin e varrit.⁴⁸

Xhabiri ﷺ ka thënë:

“I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk flinte pa lexuar suret “الم تنزيل” (Sexhde) dhe “تبارك الذي بيده الملك” (Mulk).” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kuran, [Seuabu'l-Kuran], 9/2892)

Ndërsa një prej dijetarëve të brezit të tabiinëve, Taus ibn Kejsan, thotë:

“Këto dy sure kanë 70 sevape më shumë se suret e tjera të Kuranit.”

(Tirmidhi, Fedailu'l-Kuran, [Seuabu'l-Kuran], 9/2892)

Përveç këtyre, bëhet e ditur se gjatë sëmundjeve vdekjeprurëse është mirë të lexohet shumë surja Ihlas.⁴⁹

Mirësitë e varrit

Besimtarët e devotshëm të cilët e jetojnë jetën e kësaj bote në përputhje me urdhrat e Allahut të Madhëruar, duke e kthyer atë në kapitalin e jetës së përjetshme, në varr do të kenë mirësi të cilat i di dhe i dëshiron Vetë Allahu i Madhëruar.

Ata el-Horasani ka thënë:

“Koha kur Allahu e mëshiron më tepër robin e Vet, është çasti kur ai vendoset në varr dhe të afërmit ndahen prej tij.” (Kurtubi, Tezkire, fq. 345)

Lidhur me mirësitë që besimtari do të gëzojë në varr, mund të themi se:

Varr i besimtarit do të zgjerohet, do të mbushet me mirësi dhe do të marrë formën e njërit prej kopshteve të Xhenetit. Po ashtu, besimtarit do t'i tregohet vendi i tij në Xhenet. Ndërsa profetët dhe shehidët (dëshmorët) do të furnizohen menjëherë me mirësitë e Xhenetit.

48. shih. Tirmidhi, Fedailu'l-Kuran, 9/2890; Hakim, II, 540/3839; Hejthemi, VII, 128.

49. shih. Imam Sharani, Olum, Kijamet, Ahiret, Bedir yay, s. 102, 130.


I Dërguari i Allahut ﷺ, na ka bërë të ditur se profetët janë të gjallë në varr dhe aty falin namaz.⁵⁰ Profeti ﷺ thotë se gjatë Isras dhe Miraxhit i ka parë profetët Musa, Isa dhe Ibrahim (alejhiumu's-Selam) duke falur namaz. Madje, kur ka ardhur koha e namazit, vetë Profeti ﷺ ka dalë imam dhe u ka falur namazin të gjithë profetëve. (shih. Muslim, Iman, 278)

Në hadithet fisnike thuhet:

“Profetët janë të gjallë në varret e tyre dhe aty falin namaz!” (Hejthemi, VIII, 211)

“Natën e Israsë shkova tek Musai, i cili gjendej pranë kodrës së rërës së kuqe. Ai ishte ngritur prej varrit të tij dhe po falte namaz.” (Muslim, Fedail, 164)

Gjithashtu ka edhe prej besimtarëve që kanë gëzuar të tilla mirësi. Shejban ibn Xhizr transmeton kështu prej babait të vet:

“Betohem në Allahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër se, Sabit el-Bunanin (i cili ka qenë 40 vite nxënës i Enesit ) e kam varrosur unë vetë. Pranë meje ka qenë Humejd et-Tauili dhe dikush tjetër. Pjesën e sipërme të varrit e rregulluam me tulla. Në një moment, një tullë ra nga vendi i vet. Kur ç'të shoh! Sabiti po falte namaz në varrin e tij. Atij që kisha afër i thashë:

«Pa shiko!»

Ndërsa ai tha: «Hesht!»

Pasi rregulluam varrin, shkua tek vajza e Sabitit dhe e pyetëm:

«Çfarë vepre ka bërë më shpesh babai juaj kur ka qenë gjallë?»

Ndërsa ajo na pyeti: «Çfarë patë?» Pasi i treguam atë që pamë, vajza e Sabitit tha:

«Babai im kishte 50 vite që ngrihej natën dhe falte namaz nafile. Kur vinte koha e agimit bënte dua dhe thoshte:

O Allah! Nëse dikujt prej robërve të Tu i ke dhënë mundësinë që të falë namaz në varr, ma jep edhe mua!..»” (Ebu Nuajm, Hilje, II, 319; Ibnu'l-Xheuzi, Sifatu's-Safue, III, 263)

50. shih. Muslim, Iman, 278. Krahas. Ebu Nuajm, Hilje, II, 319; Ibnu'l-Xheuzi, Sifatu's-Safue, III, 263.



Megjithëse për të vdekurin nuk mbetet më asnjë përgjegjësi, ky namaz që falin profetët dhe disa prej robërve të devotshëm buron prej dashurisë ndaj adhurimit të Allahut të Madhëruar dhe kënaqësisë shpirtërore që ndihet nga falja e namazit.

Siç lajmërohemi edhe në hadithe të ndryshme, Profeti ﷺ, ka thënë se ka parë disa profetë që kanë shkuar në haxh duke bërë telbije⁵¹ dhe duke bërë tavaf Qabenë.⁵²

Një prej mirësive të varrit do të shfaqet edhe si rezultat i angazhimit të njeriut me Kuranin në këtë botë. Lidhur me këtë, Ebu Said el-Hudri رضي الله عنه thotë:

“Kush lexon Kuran dhe ndërron jetë pa e mësuar përmendësh (megjithëse e ka dashur me gjithë shpirt), atij do t’i vijë një melek në varr dhe do t’ia mësojë. Në këtë mënyrë, ai njeri do të dalë para Allahut me Kuranin e mësuar përmendësh.”⁵³

Ndërsa i nderuari Hasan Basriu thotë:

“Sipas një lajmi që më ka mbërritur, nëse një besimtar ndërron jetë pa e mësuar përmendësh Kuranin (megjithëse e ka dëshiruar shumë), melekët e memorizimit do të urdhërohen që t’ia mësojnë atij Kuranin në varr. Në këtë mënyrë, në ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do ta ringjallë atë me njerëzit e Kuranit.”⁵⁴

Po ashtu, sipas një transmetimi, ata që kalonin pranë varrit të Sabit el-Bunanit në kohën e agimit, kanë dëgjuar lexim Kurani.⁵⁵



Duhet të theksojmë se ka mendime të ndryshme lidhur me entitetin që do të përrjetojë në varr vuajtjet ose mirësitë, dikutimet lidhen me çështjen se a do t’i ndjejë njeriu ato me shpirt apo edhe me trup!

Megjithëse dijetarët selefë thonë se është e pamundur që jeta e varrit

-
51. Telbije: Shprehje që e thonë haxhinjtë që shkojnë në umre ose në haxh: Lebbejk Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, innel hamde uenni’mete leke uel mulk, la sherike lek.
 52. shih. Buhari, Libas, 68; Muslim, Iman, 268; Ahmed, I, 232; Hakim, II, 638/4123.
 53. shih. Sujuti, Bushra’l-Keib bi Likai’l-Habib, Dimashk 1425, fq. 48.
 54. shih. Sujuti, Bushra’l-Keib bi Likai’l-Habib, fq. 48; Bursevi, Ruhul-Bejan, [Nisa, 100.]
 55. shih. Ebu Nuajm, Hilje, II, 322; Ibnu’l-Xheuzi, Sifatu’s-Safue, III, 263.

të vlerësohet siç duhet në aspektin e natyrës së saj, disa prej tyre mendojnë se jeta e varrit do të përjetohet vetëm me trup, e disa të tjerë mendojnë se do të përjetohet vetëm me shpirt.

Ibn-i Hazm dhe Ibn-i Kajjim el-Xheuzijje, mbrojnë mendimin se vuajtjen apo mirësinë në botën e varrit do ta perceptojë vetëm shpirti.

Sipas shumicës së dijetarëve të ehl-i sunnetit, llogaria, dënimi dhe mirësitë në varr do të përjetohej edhe me shpirt edhe me trup, sepse në disa hadithe fisnike na është bërë e ditur se gjatë llogarisë shpirti tashmë është kthyer në trup. (shih. Ebu Daud, Sunnet, 23)

Shumica e dijetarëve Esh'ari dhe Maturidi thonë se në trupin e të vdekurit do të krijohet aq jetë, sa ai mund të ndjejë dhimbjen e dënimit dhe shijen e mirësive. Por ata kanë ngurruar të thonë se shpirti do t'i kthehet trupit në mënyrë të njëjtë siç ka qenë, duke theksuar se në lidhje me jetën e të vdekurit në varr është e pamundur të dihet diçka në mënyrë të prerë. Ndërsa shkaku që mbi kufomën e të vdekurit nuk shihen gjurmët e dënimit apo mirësisë, është se shqisave tona nuk u është dhënë aftësi për të perceptuar botën e varrit.

Domethënë se natyra e jetës së varrit do të kuptohet në mënyrë të qartë vetëm kur të përjetohet. Të dhënat në lidhje me të, në Kuran dhe Sunnet, janë pasqyruar në bazë të botëkuptimit njerëzor me modele të kësaj bote. Kuptimi i natyrës së saj të vërtetë është përtej mundësive të mendjes së kufizuar njerëzore. Gjithsesi, detyra kryesore e besimtarit nuk është të hetojë rreth natyrës së botës së varrit por të merret me përgatitjen për atë botë. Shembull i kësaj, është rasti kur një sahab e pyeti Profetin ﷺ:

“Kur do të bëhet Kiameti?”, e ai iu përgjigj shkurt:

*“Çfarë ke përgatitur ti për Kiametin?”*⁵⁶

Pra detyra kryesore e besimtarit, nuk është të merret me aspektin e natyrës së jetës së varrit dhe të Ahiretit, gjë e cila nuk është përgjegjësi e tij, por të merret me përgatitjen për atje, sepse kjo duhet t'i interesojë më shumë.

Derisa vjen në këtë jetë, njeriu kalon nëpër botë me natyra të ndryshme. Po kështu, me vdekjen ai do të lindë në një botë me natyrë plotësisht

56. shih. Muslim, Birr, 163.



të ndryshme. Mbase edhe Ahireti do të jetë një botë me natyrë krejtësisht ndryshe nga ajo e varrit. E mbase, Zoti ynë i Madhëruar do të na japë edhe shqisa e aftësi kuptimi të ndryshme për çdo botë në të cilën kalojmë.

Shkurtimisht, lidhur me këto çështje, të cilat i kalojnë kufijtë e dijes dhe kuptimit njerëzor, është më e saktë të themi: “لَا يَلْعَلُ الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ / Askush nuk e di të fshehtën përveç Allahut” dhe “اللَّهُ أَعْلَمُ بِالصَّوَابِ / Allahu e di më së miri të drejtën”.

Atyre të cilëve nuk u priset trupi në varr

Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun prej dheut⁵⁷ dhe gjatë gjithë jetës e ushqen dhe e zhvillon atë me ushqime që dalin prej tij. Po ashtu, edhe kur të vdesë, njeriu do të kthehet në tokë. Allahu i Madhëruar urdhëron:

مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَىٰ

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.” (TaHa, 55)

Kjo e vërtetë tregon se trupi i njeriut është i dënuar të jetë i përkohshëm me fazat që përjeton në dynja dhe gjendjet e tij personale. Dhe për shkak se struktura e tij materiale është prej dheut, trupi i njeriut në varr do të shndërrohet përsëri në dhe, duke u kthyer kështu në origjinën e vet.

Mirëpo, Allahu i Madhëruar nuk do t’i prishë trupat e disa prej robërve të Tij në jetën e berzahut, por do t’i ruajë ata të freskët. Në krye të këtyre robërve vijnë profetët.

Sipas rrëfimit të Eus ibn Eus رضي الله عنه, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

“Dita më e virtytshme për ju është dita e Xhuma. Prandaj atë ditë lutuni shumë për mua për paqe e mëshirë, sepse lutjet tuaja më tregohen mua!”

Atëherë, sahabët e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, si do të të tregohen lutjet tona pasi të vdesësh e të mos mbetet asnjë gjurmë nga ti?”



Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Allahu i Madhëruar ia ka ndaluar tokës t’i kalbë trupat e profetëve!”

(Ebu Davud, *Salat*, 201; shih. Nesai, *Xhuma*, 5)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

“Po, edhe pas vdekjes sime do të më dërgohen salatet dhe përshëndetjet tuaja! Allahu i Madhëruar ia ka ndaluar tokës të hajë trupat e profetëve. Profeti i Allahut është i gjallë dhe furnizohet vazhdimisht.” (Ibn-i Maxhe, xhe-naiz, 65)

Po ashtu, ka pasur edhe dëshmi të gjalla se trupat e profetëve ruhen pa u prishur. Për shembull, në një kohë të afërt, atëherë kur po ndërtohej Hidrocentrali i Dixhles⁵⁸, i cili ujit një pjesë të rëndësishme të Luginës Dijarbakir në Turqi, për shkak të përmybtjes që do të ndodhte, varret e Eljesas  dhe Dhulkiflit , që ishte djali i xhaxhait të tij dhe pasardhësi i tij, u transferuan në një varr të ri në një kodër që ndodhej në atë zonë. Siç dëshmohet edhe prej atyre që u morën me procesin e transferimit të varreve, të dy trupat e profetëve ishin si të gjallë.⁵⁹



Një kategori tjetër njerëzish, trupat e të cilëve nuk treten nga toka, janë shehidët/dëshmorët që kanë rënë në luftë për hir të Allahut. Sot, në vende të ndryshme rastisen trupa të shehidëve, të cilët qëndrojnë të paprishur në varret e tyre.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Kursesi mos i quani të vdekur ata që janë vvarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).”

(Al-i Imran, 169-170)



Por padyshim se gjallëria e profetëve, është më superiore në krahasim

58. Hidrocentral mbi një degë të lumit Tigër, në Dijarbakir të Turqisë.

59. shih. Altinoluk Dergisi, Temmuz 2014, sayı 341, fq. 48.



me atë të shehidëve. Përveç profetëve dhe shehidëve, është vërtetuar me argumente të transmetuara dhe dëshmi të gjalla se toka nuk i tret as trupat e robërve të mirë, zemra e të cilëve është e mbushur me dashuri për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, dhe që janë ruajtur gjatë gjithë jetës së tyre prej haramëve dhe gjërave të dyshimta, duke u ushqyer me kafshatë hallall dhe devotshmëri të lartë ndaj Allahut të Madhëruar. Ja disa shembuj prej kohës së myslimanëve të parë:

Në kohën e Uelid ibn Abdulmelikut, muri i dhomës së nënës sonë Aishe ؓ, ishte shembur mbi varrin e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij.⁶⁰ Gjatë punimeve për rindërtimin e murit u shfaq këmba e njërit prej të vdekurve. Të gjithë u frikësuan dhe pandehën se ishte këmba e bekuar e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Mirëpo Urue ibn Zubejri shkoi atje dhe vërejti:

“Jo, për Allahun kjo nuk është këmba e bekuar e Profetit ﷺ! Kjo është këmba e Omerit ؓ.” (Buhari, Xhenaiz, 96)



Xhabir ibn Abdullah ؓ, transmeton:

“Një natë para betejës së Uhudit, im atë më thirri pranë dhe më tha:

«Më duket se unë do të jem i pari nga sahabët e Profetit ﷺ që do të bie dëshmor. Me përjashtim të të Dërguarit të Allahut ﷺ, për mua ti je personi më i çmuar që do të lë pas. Kam borxhe; paguaji ato dhe sillu gjithmonë mirë me vëllezërit!»


Në mëngjes, im atë qe personi i parë që ra dëshmor. E varrosa atë në një varr bashkë me një dëshmor tjetër. Pastaj desha ta varros më vete në një vend tjetër. E nxora nga varri gjashtë muaj më vonë, por ç'të shihja?! Përveç një pjese të njërit vesh, i gjithë trupi ishte si atë ditë kur e pata varrosur për herë të parë! Më pas e varrosa në një varr më vete!” (Buhari, Xhenaiz, 78)

Kjo pra është gjendja e veçantë e besimtarëve të singertë!..



Po ashtu, edhe dy prej dëshmorëve të Uhudit, Amr ibn Xhemuh dhe

60. Varri i Profetit ﷺ, gjendet pranë varreve të Ebu Bekrit dhe Omerit ؓ, brenda Xhamisë së Profetit ﷺ, në Medinë.

Abdullah ibn Amr , ishin varrosur në një varr. Vendi kur ishin varrosur ishte pikërisht në rrjedhën e ujërave të përrrenjve. Për këtë arsye ishte i nevojshëm ndërrimi i vendit të varreve. Kur u hapën varret, u vu re se trupat e këtyre dy dëshmorëve qëndronin të paprishur, sikur të ishin varrosur një ditë më parë. Madje, njëri prej tyre që ishte plagosur para se të binte dëshmor, kishte vënë dorën mbi plagë dhe në atë mënyrë ishte varrosur kur vdiq. Ata që po merreshin me zhvarrimin, u përpoqën t'ia shtrinin dorën, por ajo shkoi përsëri atje ku ishte. Mirëpo, që nga koha e betejës së Uhudit e deri në kohën e hapjes së varreve kishin kaluar dyzetegjashtë vite.⁶¹

Trupat e shëhidëve ishin të butë dhe kur u ngritën ata përkuleshin e përthyeshin si trupat e njerëzve të gjallë. Pra nuk ishin ngurtësuar aspak. Në një moment, lopata e njërit prej punonjësve goditi padashje këmbën e njërit prej dëshmorëve dhe prej saj filloi të rridhte gjak. (shih. Abdu'r-Razzak, Musannef, III, 547)



Një shembull tjetër lidhur me faktin se toka nuk i tret trupat e robërve të devotshëm që kanë jetuar në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, është edhe ai i një muezini hafiz, i cili ka qenë një besimtar shumë i devotshëm, nga Adana e Turqisë. I nderuari Mahmud Sami Ramazanoglu (Allahu e mëshiroftë) tregon se gjatë punimeve për hapjen e një rruge në Adana, ka qenë dëshmitar okular në hapjen e varrit të një hafizi që kishte vdekur para 30 vitesh. Trupi i tij nuk ishte prishur aspak. Mbi të gjitha edhe qefini i tij ishte shumë i pastër.

Kjo ndodhi tregon se edhe njerëzit që janë angazhuar shumë me Kuranin dhe kanë qenë hafizë të vërtetë, do të gëzojnë shumë mirësi të Allahut të Madhëruar, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.



Në lidhje me natyrën e begatisë së shërbimit të bërë ndaj Kuranit të Shenjtë, hoxha i nderuar Emin Saraç përcjell prej Abdylkadir Beklit, që ishte një prej njerëzve të nderuar të Medinës, një rrëfim plot kuptim dhe urtësi të shënuar edhe në Protokollin e Gjykatës Juridiko-fetare vendase:

61. shih. Muuatta, Xhihad, 49.



Ishte sezoni i haxhit. Në Medinë u nxor në ankand një tekst i Kuranit të Shenjtë, i shkruar me një shkrim mjaft të bukur. Haxhinjtë e ardhur nga vende të ndryshme shihnin shkrimin e tij të hijshëm dhe ofronin nga një çmim. Ndërkohë, një haxhi turk afrohet me kureshtje tek teksti i Kuranit, pasi e sheh dhe e njeh shkrimin e tekstit, bërtet i mahnitur:

“Po ky është Kurani i Shenjtë i shkruar prej tim eti!”

Dhe shton:

“Mirëpo ne ia patëm vendosur Kuranin në varr, sipas amanetit që pati lënë ai vetë!”

Haxhiu turk u përpoq të zgjidhë misterin e kësaj ndodhie. Pasi kjo iu tregua personave përgjegjës që kishin pasur lidhje me ngjarjen, dolën në pah këto të dhëna:

Meqë në varrezën “Xhennetul Baki” të Medinës nuk kishte më vend, ishte bërë praktikë që herë pas here, në vendin e varreve të vjetra të bëheshin varrime të reja. Kështu që kur kishin hapur një varr, pak a shumë të vjetër, për të varrosur një person të porsavdekur, kishin vënë re se trupi i të vdekurit të mëparshëm kishte mbetur i paprishur fare dhe mbi të ndodhej një tekst i Kuranit. Të gjithë të pranishmit kishin mbetur të mahnitur! Personat e ngarkuar me këtë detyrë, e kishin hequr tekstin e Kuranit nga varri. Pasi ishin këshilluar me njëri-tjetrin, kishin vendosur ta nxirrnin shkrimin në ankand dhe paratë që do të përfitoheshin nga shitja, do t’i depozitonin në thesarin e shtetit me qëllim që të përdoreshin për shërbime publike.

Haxhiu turk u përplot nga lajmet dhe rrëfeu këtë ngjarje mësimdhënëse:

“Im atë ishte një kaligraf osman. Çdo vit shkruante një tekst Kurani dhe me të siguronte jetesën. Ndërkaq, ai ishte përqëndruar tek një tekst Kurani që e shkruante me kujdes dhe përkushtim të veçantë. Aq bukur ishte shkruar sa njeriu s’ngopej së pari. Im atë e shkruante atë pa u ngutur aspak, me një dëshirë dhe kënaqësi të papërshkrueshme, sikur dëshironte të shkrinte në të të gjithë aftësinë dhe mjeshtërinë e vet. Pas një kohe të gjatë të kaluar me durim, më në fund, doli në pah një kryevepër e mrekullueshme. Babai ynë, i tejmbushur me ndjenjën e falënderimit dhe gëzimit për suksesin që kishte arritur, na mblodhi ne, bijtë e tij, dhe na tha:

«Bijtë e mi! Unë e shkrova këtë tekst të Kuranit të Shenjtë që të më bëhet ndërmjetësues në jetën tjetër, në Ahiret! Porosia ime për ju është që pasi të vdes, ta mbështillni atë mirë e mirë dhe të ma vendosni mbi gjoks!»

Kur ai ndërroi jetë, ne ia përmbushëm porosinë!

Misteri i vërtetë i cili më gëzoi aq sa edhe më la të mahnitur, është fakti se megjithëse im atë qe varrosur së bashku me Kuranin në Stamboll, vite më vonë u gjat në tokat e bekuara, në një varrezë të bekuar!”

Veprat që duhen bërë pas vdekjes së dikujt

Siç theksohet hapur edhe në Kuranin Fisnik, besimtarët janë vëllezër.⁶² Dhe një prej detyrave më të rëndësishme që kjo vëllazëri i ka ngarkuar besimtarëve, është kryerja e detyrës së fundit ndaj vëllezërve të fesë që ndërrojnë jetë. Pra, larja, qefinosja dhe varrosja e tyre me etikë dhe kujdes të madh, ashtu siç i ka hije dinjitetit të njeriut, krijesës që Allahu i Madhëruar e ka krijuar në formën më të bukur (ahseni takuim) dhe e ka bërë më të nderuarën ndër të gjitha krijesat.

Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, na bën të ditur disa të drejta që myslimanët kanë ndaj njëri-tjetrit:

“Të drejtat e myslimanit ndaj myslimanit, janë pesë:

T’i përgjigjet selamit, të vizitojë të sëmurin, të përcjellë xhenazen nga pas (duke i falur namazin e xhenazes dhe duke u marrë me çështjet e varrit), t’i përgjigjet ftesës dhe atij që psherëtin t’i thotë: «يَرْحَمُكَ اللَّهُ» / Allahu të mëshiroftë!» (Buhari, Xhenaiz, 2; Muslim, Selam, 4)

“Të drejtat e myslimanit ndaj myslimanit, janë gjashtë:

T’i japë selam kur të takohet me të, t’i përgjigjet ftesës nëse ftohet, ta këshillojë nëse kërkohet këshilla e tij, nëse vëllai psherëtin dhe falënderon Allahun (thotë elhamdulillah), t’i thotë “jerhamukellah”, ta vizitojë nëse sëmurët dhe t’i përcjellë xhenazen kur të ndërrojë jetë.” (Muslim, Selam, 5)

1. Përgatitja, qefinosja dhe përcjellja

Falja e namazit të xhenazes së një vëllai mysliman që ka ndërruar jetë dhe varrosja e tij në varr, është farz kifaje,⁶³ ndërsa shërbimet e tjera ndaj

62. shih. Huxhurat, 10.

63. **Farz kifaje:** Obligim fetar, i cili nëse kryhet nga një ose më shumë persona, shpëtojnë nga përgjegjësia të gjithë myslimanët e tjerë.



tij janë sunnet ose mustehab (të pëlqyeshme). Por nëse këto detyra neglizhohen, të gjithë myslimanët që jetojnë në atë zonë, konsiderohen se kanë braktisur farzin (obligimin) dhe marrin gjynah.

I Dërguari i Allahut ﷺ, i ka dhënë rëndësi të madhe përgatitjes së xhenazes. Ai ka kërkuar prej atyre që merren me punët e xhenazes, që ta lajnë mirë, ta parfumosin dhe ta qefinosin ashtu siç duhet. Për të theksuar më tepër rëndësinë e kësaj detyre, Profeti ﷺ ka thënë:

“Allahu i Madhëruar e fal dyzet herë personin, i cili e lan një të vdekur dhe i fsheh gjërat e papëlqyeshme që sheh tek ai. Atij që qefinos të vdekurit, i vesh rroba të Xhenetit të punuara me mëndafsh. Ndërsa atij që hap varrin dhe varros të vdekurin, i jep shpërblim sikur të kishte akomoduar një të varfër në një shtëpi ku do të qëndrojë deri në ditën e Kiametit.” (Hakim, I, 506/1307)

Një çështje tjetër mbi të cilën duhet bërë kujdes gjatë qefinosjes së xhenazes, është që të mos bëhet asnjë veprim ndaj të cilit i vdekuri do të mërziqej po të ishte gjallë. Për shembull, të mos e lash xhenazen me ujë shumë të ftohtë ose shumë të nxehtë. Përveç kësaj, është mirë që gjatë përgatitjes dhe qefinosjes së të vdekurit, të mos shpenzohet tepër por edhe të mos tregohet koprraci.

Xhabiri ﷺ, tregon:

“Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ, mbajti një hutbe në lidhje me njërin prej sahabëve, i cili kishte vdekur dhe ishte varrosur natën i mbështjellë me një qefin të pamjaftueshëm. Më pas, me qëllim që atij t’i falej namazi i xhenazes, ai e ndaloi varrosjen e të vdekurit natën pa qenë nevoja. Pastaj tha: «Kur dikush prej jush qefinosë vëllain e vet, le ta qefinosë sa më mirë!» (Muslim, Xhenaiz, 49; Ebu Daud, Xhenaiz, 29-30/3148; Nesai, Xhenaiz, 37)

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Vishuni me rroba të bardha, sepse rroba e bardhë duket më e pastër dhe më e bukur! Po ashtu edhe të vdekurit tuaj qefinosini me të bardha!” (Tirmidhi, Edeb, 46/2810)

Përveç këtyre i Dërguari i Allahut ﷺ, ka këshilluar që xhenazja të mos pritët shumë gjatë, por të varroset sa më parë:

“Xhenazen barteni me shpejtësi! Nëse ai është njeri i mirë, kjo është mirësi për të, sepse do të mundësoni që ai të takohet sa më shpejt me të





mirat dhe shpërblimet e tij në varr. Por nëse nuk është njeri i mirë, kjo do të jetë një tjetër e keqe për të, sepse do ta hidhni shumë shpejt prej supeve tuaja!” (Buhari, Xhenaiz, 51; Muslim, Xhenaiz, 50, 51)

Me gjithë porosinë e Profetit ﷺ në lidhje me këtë çështje, vihet re se në disa vende xhenazja pritet më tepër se ç’duhet me qëllim që njerëzit të arrijnë në namazin e xhenazes. E në fakt, e rëndësishme është që i vdekuri të mos presë shumë, por të varroset menjëherë, sepse siç thamë edhe më sipër namazi i xhenazes është farz kifaje. Xhemati që është i pranishëm mund ta fali xhenazen. Ndërsa ata që nuk e arrijnë dot, mund ta falin përsëri më vonë nëse dëshirojnë.⁶⁴ Përveç kësaj, ata që nuk kanë mundur të jenë prezent, mund të falin namazin e xhenazes në mungesë, në vendin ku ndodhen vetë.



Mirëpo nëse është e nevojshme që xhenazja të pritet për shkak të procesit të autopsisë apo diçka tjetër të ngjashme me këtë, atëherë mund të vendoset në morg. Por vendosja në morg pa qenë e nevojshme, konsiderohet si torturë për xhenazen.



Është e lejuar vendosja e një guri tek koka e varrit, me qëllim të njohjes së varrit. Muttalib ibn Ebi Uedaa tregon:

“Kur ndërroi jetë Osman ibn Madh’uni , xhenazja e tij u varros jash-të Medinës. Osmani , ishte prej muhaxhirëve të parë që ndërruan jetë. I Dërguari i Allahut , urdhëroi një person që të sillt një gur. Ai gjeti një gur, por nuk mundi ta ngrrejë. Për këtë arsye, Profeti  përveshi mëngët dhe shkoi ta barte vetë.”

Transmetuesi thotë:

“Më duket sikur e kam para syve bardhësinë e krahëve të Profetit , kur ai përveshi mëngët. Më pas ai e solli gurin, e vendosi tek koka e Osmanit  dhe tha:

«Kështu mund ta njoh dhe ta gjej varrin e vëllait tim. Kështu që edhe

64. Sipas Hanefive dhe Malikive, falja e namazit të xhenazes për herë të dytë, është mekruh (e papëlqyeshme). Ndërsa sipas Shafiive dhe Hanbelive, ata që nuk e arrijnë xhenazen, mund ta falin namazin e xhenazes qoftë edhe pasi i vdekuri të jetë varrosur. Madje sipas Shafiive kjo është sunnet.



ata që do të vdesin prej familjes sime do t'i vendos pranë tij.» (Ebu Daud, Xhenaiz, 57-59/3206. Shih. Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 42)



Gjatë udhëtimit për në Mekë (për umren e Hudejbijes), i Dërguari i Allahut ﷺ, u kthye në Ebua dhe tha:

“Padyshim që Allahu i Madhëruar e lejoi Muhamedin të vizitojë varrin e nënës së tij!”

Shkoi tek varri, e rregulloi dhe qau pranë tij. Për shkak të lotëve të Profetit, qanë edhe myslimanët e tjerë. Më vonë, kur u pyet se pse veproi në atë mënyrë, ai tha:

“Mu kujtua dhembshuria dhe mëshira e nënës ndaj meje, prandaj gava.” (Ibn-i Sa'd, I, 116-117. Shih. Muslim, Xhenaiz, 105-108)



Rregullimi i varrit vjen si domosdoshmëri e etikës dhe punës së përsosur që ka urdhëruar Islami. Kur u mbulua varri i djalit të tij Ibrahimit, i Dërguari i Allahut ﷺ, vuri re se vendi pranë varrit nuk ishte aspak i rregullt. Ndërkohë që po rregullonte vendin me duart e tij të bekuara, tha:

“Kur dikush prej jush të bëjë një punë, le ta bëjë mirë, sepse kështu ngushëlloni zemrën e atyre që i ka goditur dhimbja!” (Ibn-i Sa'd, Tabakat, I, 141-142)

Sipas një transmetimi tjetër, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, po qëndronte në anë të varrit të djalit të tij Ibrahimit, pa një të çarë tek pllakat e varrit. Ai i dha pak baltë atij që kishte hapur varrin, me qëllim që ta rregullonte dhe tha:

“Kjo nuk ka as dëm e as dobi për të vdekurin. Mirëpo kjo (varri i rregullt) ia ndriçon sytë të gjallit, e gëzon dhe e kënaq atë!” (Ibn-i Sa'd, Tabakat, I, 142, 143; Belazuri, Ensabu'l-Eshraf, I, 451)

Po ashtu, nuk ka asnjë problem edhe nëse varri spërkatet me ujë për të forcuar dheun. Kur u varros djali i tij Ibrahimit, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“A mund të më sjellë dikush një kacek me ujë?” Menjëherë, njëri prej ensarëve solli një kacek me ujë dhe i Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:



“Spërkate varrin e Ibrahimit me të!” (Ibn-i Sa'd, Tabakat, I, 141)

I Dërguari i Allahut ﷺ, urdhëroi të sillej një gur, i cili u vendos tek koka e varrit të Ibrahimit.⁶⁵ Po ashtu, ai qe i pari që iu spërkat ujë mbi varr.⁶⁶



Edhe mbjellja e pemëve, në një vend të përshtatshëm të varrit dhe gjelbërimi përreth tij, është konsideruar diçka e preferuar. Siç bëhet e ditur edhe në një hadith fisnik, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, po kalonte pranë dy varreve, ai tha se të vdekurit në ato varre po vuanin. E më pas, ai kërkoi një degë të njomë hurme, të cilën e ndau në dy pjesë dhe secilën prej tyre e nguli në krye të varrit. Pas kësaj tha:

“Shpresohet t’u lehtësohet ndëshkimi derisa sa të thahen!” (Muslim, Taharet, 111)

Imam Kurtubiu, i cili ka qenë dijetar i tefsirit, hadithit dhe i jurisprudencës Islame, në shpjegimin e këtij hadithi fisnik shprehet:

“Shprehja “derisa të mos thahen” tregon se sa të jenë të njoma, degët do të bëjnë tesbih e do të përmendin Zotin duke e madhëruar. Dijetarët tanë kanë thënë: «Të vdekurit përfitojnë nga mbjellja e pemëve në varre dhe nga leximi i Kuranit atje. Po qe se edhe mbjellja e një peme ua lehtëson mundimin të vdekurve, kush e di se sa përfiton besimtari nga këndimi i Kuranit! Tek i vdekuri arrin edhe mirësia (sevabi) e çdo gjëje që dhurohet për të vdekurin.»” (Kurtubi, Tefsir, X, 267).



Ulja dhe shkelja mbi varre është mekruh (e papëlqyeshme). Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Është më mirë të uleni mbi prush, t’ju digjet rroba dhe prej saj t’ju arrijë trupin, sesa të uleni mbi një varr.” (Muslim, Xhenaiz, 96; Ebu Daud, Xhenaiz, 77; Nesai, Xhenaiz, 105)

Xhabiri ﷺ transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka ndaluar lyerjen e varreve me gëlqere, uljen dhe ndërtimin e binave mbi ta.⁶⁷

65. Ibn-i Sa'd, Tabakat, I, 144; Belazuri, Ensabu'l-Eshraf, I, 451.

66. Ibn-i Abdiberr, Istab, I, 59; Ibn-i Esir, Usdu'l-Gabe, I, 51; Kastalani, Meuahibu'l-Ledunnijje, I, 269.

67. shih. Muslim, Xhenaiz, 94; Ebu Daud, Xhenaiz, 76; Tirmidhi, Xhenaiz, 58.



Në lidhje me “fjalimin” që mbahet pas varrosjes së të vdekurit, ka pasur mendime të ndryshme. Ka prej atyre që thonë se një gjë e tillë është e dobishme.

Këshilla e të Dërguarit të Allahut ﷺ: “Lexoni JaSin për të vdekurit tuaj!”⁶⁸, kuptohet që të vdekurit duhet t’i lexohet shpesh surja JaSin, si para vdekjes, ashtu edhe pas saj.

2. Pagimi i borxheve

Myslimani jeton gjithmonë me ndjenjën e mirësisë, duke qenë i vetë-dijshëm se ndodhet vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore dhe ka frikë të dalë borxhli përpara Allahut të Madhëruar.

Nëse dikush ndërron jetë pa paguar borxhet, të afërmit duhet të mbyllin të gjitha borxhet që ai ka lënë, përpara se të çojnë në vend amanetet e tij dhe të ndajnë trashëgiminë. Në hadithet fisnike, na bëhet e ditur se as shehidi nuk do të hyjë në Xhenet pa i paguar borxhet.⁶⁹

Më konkretisht, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Shpirti i besimtarit mbetet i lidhur pas borxhit të vet derisa ta shlyejë.”

(Tirmidhi, Xhenaiz, 74, shih. Ibn-i Maxhe, Sadakat, 12)

Kjo do të thotë se borxhi është burg, i cili e pengon robin të ngrihet në pozita të larta. Përveç kësaj, për borxhliun nuk mund të jepet as gjykimi nëse do të shpëtojë apo do të shkatërrohet. E për këtë arsye ai vazhdon pritjen i shqetësuar.



Ebu Hurejre ؓ, transmeton:

“Kur të Dërguarit të Allahut ﷺ, i sillej një xhenaze me borxhe të palara, ai pyeste:

«A ka lënë ndonjë pasuri për të paguar borxhin?»

Nëse i thuhej se ka lënë pasuri të mjaftueshme për të paguar borxhin

68. Ebu Daud, Xhenaiz, 19-20; Ahmed ibn-i Hanbel, Musned, V, 26, 27; Ibn-i Hibban, Sahih, V, 3.

69. shih. Muslim, Imare, 119, 120; Nesai, Buju, 98; Ahmed, V, 289.



(ose nëse dikush nga myslimanët jepte garanci të fortë se do t'ia shlyente borxhin⁷⁰), ai ia falte namazin. Në të kundërt, u thoshte myslimanëve:

«Faljani ju namazin (e xhenazes) shokut tuaj!»

Mirëpo me kalimin e kohës, kur Allahu i Madhëruar ia zgjeroi mundësitë materiale Profetit ﷺ, ai ia ka falur namazin e xhenazes edhe besimtarëve që nuk kanë pasur pasuri për të paguar borxhin (duke ia paguar vet).⁷¹ Pas kësaj, ai thoshte:

«Unë jam njeriu më i afërt për çdo besimtar, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Në qoftë se dëshironi, mund të lexoni këtë ajet: **«I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin.»**⁷²

Çdo pasuri të lënë pas nga ndonjë besimtar që vdes, le ta marrin trashëgimtarët e tij. Në qoftë se ka lënë pas ndonjë borxh apo njeri që ka nevojë për kujdes, le të vijnë tek unë, sepse unë do të bëhem kujdestari i tyre.» (Buhari, Tefsir, 33/1, Kefalet 5, Feraidh, 4, 15, 25, Muslim, Feraidh, 14)



Sa'd ibn Atual ﷺ tregon:

«Vëllai im ndërroi jetë dhe la treqind dërhëm dhe familjen që kishte nevojë për përkujdesje. Paratë që la, doja t'i shpenzoja për familjen e tij, por i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Vëllai yt gjendet i burgosur për shkak të borxhit, prandaj paguaj borxhin!» Thashë:

«O i Dërguari i Allahut! Unë i lava borxhet e tij. Kanë mbetur vetëm dy dinarë tek një grua që pretendonte (se i kishte dhënë borxh) por që nuk solli asnjë provë.»

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Jepja asaj gruas dy dinarët që ka pretenduar, sepse ajo po thotë të vërtetën!» (Ibn-i Maxhe, Sadakat, 2)



70. shih. Tirmidhi, Xhenaiz, 69/1069; Nesai, Xhenaiz, 67.

71. shih. Buhari, Nefekat, 15; Muslim, Feraidh, 14.

72. Ahzab, 6



I Dërguari i Allahut ﷺ, në një hadith fisnik, i ka porositur besimtarët që në ditën e Kiametit të mos dalin me borxhe:

“Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me përpara se të vijë dita e Kiametit, ku nuk do të ketë flori dhe argjend. Në të kundërt, nëse ka vepra të mira, do t’i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi (dhe do i jepen atij që i është bërë padrejtësia). Por nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t’i ngarkohen atij.” (Buhari, Medhalim, 10, Rikak, 48)

3. Respektimi i testamentit

Pas përgatitjes, qefinosjes dhe larjes së borxheve, çohet në vend testamenti i të vdekurit për “një të tretën” e pasurisë së mbetur. Ndërsa dy të tretat ndahen ndër trashëgimtarët.

Lidhur me këtë çështje, një prej sahabëve të përgëzuar me Xhenet, Sa’d ibn Ebi Uakkas ﷺ transmeton:

“Në vitin e Haxhit të Lamtumirës (në Mekë) më zuri një sëmundje e rëndë. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ më erdhi për vizitë, e pyeta:

«O i Dërguar i Allahut! Siç e sheh jam shumë i sëmurë. Unë jam njeri i pasur dhe nuk kam trashëgues tjetër përveç një vajze. A ta ndaj si sadaka dy të tretën e pasurisë sime?»

«Jo!» - tha Profeti ﷺ.

«Të ndaj gjysmën?» - thashë unë.

«Jo!» - tha ai përsëri.

«Si thua për një të tretën o i Dërguar i Allahut?» - pyeta unë.


«Ndaj një të tretën! Madje edhe ajo është shumë! Është më mirë t’i lësh trashëgimtarët e tu të pasur, sesa nevojtarë që t’u shtrijnë dorën të tjerëve. Për çdo shpenzim që bën duke menduar (synuar) kënaqësinë e Allahut, do të marrësh shpërblim. Madje edhe për kafshatat që vendos në gojën e gruas gjatë ushqimit.»

Sa’d ibn Ebi Uakkas vazhdoi:


«O i Dërguari i Allahut! A do të mbetem (vdes) këtu e shokët e mi do të ikin?» - pyeta unë. Por i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Jo, ti nuk do të mbetesh këtu! Ti do të ngrihesh dhe do të bësh gjëra të mira për Allahun. Shpresoj prej Allahut që duke jetuar shumë, disa (besimtarët) të kenë dobi prej teje, e disa të tjerë (mohuesit) të dëmtohen.


O Allah! Plotësoje hixhretin (emigrimin) e shokëve të mi (nga Meka në Medinë)! Mos i kthe ata pas, e mos ja lër në gjysmë hixhretin! Sa'd ibn-i Haule, është në gjendje të keqe!»

Me këto fjalë, i Dërguari i Allahut , ka shprehur keqardhjen e tij për Sa'd ibn Haulen, që vdiq në Mekë.” (Buhari, Xhenaiz, 36, Uesaja, 2, Nefekat, 1, Merda 16, Deauat, 43, Feraidh, 6; Muslim, Uasijjet, 5)


4. Lutjet dhe kërkimi i faljes



Lutja e parë për një mysliman që ndërron jetë është falja e namazit të xhenazes. I Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Cilitdo mysliman, që nuk i ka bërë shirk Allahut, dhe që i shkojnë dyzetë persona e i falin namazin, Allahu patjetër do ta pranojë shefaatin (ndërmjetësimin në ditën e gjykimit) e tyre për personin e vdekur.” (Muslim, Xhenaiz, 59)

Numri “dyzetë” në këtë hadith është cekur për të shprehur një grup të madh njerëzish, sepse në një hadith tjetër ky numër është “njëqind”⁷³, në një transmetim tjetër thuhet se mjafton të jetë një xhemat me tre safa/rreshta⁷⁴. Madje, Malik ibn Hubejbe , që përcjell transmetimin e fundit, kur shihte një xhenaze me pak njerëz, menjëherë i vendoste ata në tre safa përputhje me hadithin që kishte dëgjuar.



Për të vdekurin është një arritje e madhe kur ai gëzon dëshminë pozitive të myslimanëve. Lidhur me këtë, Enesi , tregon:

“Kur Profeti  po rrinte me disa sahabë, pranë kaloi një xhenaze. Disa nga sahabët e përmendën të vdekurin për mirë dhe Profeti  tha:

«U vendos!»

73. shih. Muslim, Xhenaiz, 58.

74. shih. Ebu Daud, Xhenaiz, 39/3166; Tirmidhi, Xhenaiz, 40.



Pastaj kaloi një xhenaze tjetër, të cilin të pranishmit e përmendën për keq. Ndërsa Profeti ﷺ përsëri tha:

«U vendos!»

Pas kësaj, Omer ibn Hattabi ؓ pyeti:

«O i Dërguari i Allahut, çfarë u vendos?»

Profeti ﷺ u përgjigj:

“Të vdekurin e parë e përmendët për të mirë, prandaj u vendos që ai të shkojë në Xhenet. Pastaj të vdekurin tjetër e përmendët për të keq, prandaj u vendos që ai të shkojë në Xhehenem. Kjo, sepse ju besimtarët, jeni dëshmitarët e Allahut mbi tokë!” (Buhari, Xhenaiz, 86; Muslim, Xhenaiz, 60)



Pjesëmarrja në xhenazen e vëllait të fesë, duke i falur namazin dhe duke e përcjellë atë deri në varr, i sjellë shpërblime të mëdha besimtarit. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kushdo që shkon në xhenazen e një myslimani dhe pret gjersa t’i falet namazi e të varroset, duke besuar në shpërblimin e kësaj veprë dhe duke e pritur atë vetëm nga Allahu, kthehet me dy sasi sevapesh, secila prej tyre sa mali i Uhudit. Kurse ai që merr pjesë në faljen e namazit të të vdekurit dhe largohet pa pritur varrosjen e tij, kthehet me një sasi sevapesh!” (Buhari, Iman, 35)

Një ditë, kur Abdullah ibn Omeri po rrinte së bashku me Sa’d ibn Ebi Uakkas-in, vjen Habbab ibn Eret dhe u thotë:

“O Abdullah! Pa shih se ç’thotë Ebu Hurejre!” Dhe përmend hadithin e mësipërm. Atëherë Ibni Omeri dërgoi Habbabin tek Aishja ؓ për të hetuar mbi këtë hadith, duke i thënë: “Pyete atë dhe kthehu!”

Pasi u largua Habbabi, Ibni Omeri mori një grusht guralecë dhe filloi t’i vërtisë nëpër duar i nxehur. Kur u kthye Habbabi me lajmin e Aishes ؓ, e cila kishte thënë se Ebu Hurejre thotë të vërtetën, i hodhi tutje gurët që mbante në duar dhe shprehu hidhërimin e vet me këto fjalë:

“Pse s’thua se ne paskemi humbur shumë sasi sevapesh?” (Muslim, Xhenaiz, 56)



Sasia e sevapeve që premtohen këtu, Allahu e di më mirë, më tepër se përcaktimi i një kufiri, duhet të jetë përmendur për të theksuar vlerën e përcjelljes së xhenazes, sepse Allahu i Madhëruar veprat i shpërblen në bazë të nivelit të qëllimit dhe sinqeritetit të zemrës.



I Dërguari i Allahut ﷺ, i cili shprehet: “kur të falni namazin e xhenazes, lutuni me sinqeritet për të vdekurin”⁷⁵, ka qenë shembulli më i mirë për ummetin e tij në këtë çështje. Ja disa shembuj të lutjeve që ai ka bërë me rastin e xhenazeve:

“Allahu im! Fale atë, mëshiroje, shpëtoje nga mundimet dhe shqetësimet! Falja të metat dhe gabimet! Fali pjesë nga Xheneti dhe bëja të gjerë vendin (varrin) ku do të hyjë! Laje atë me ujë, dëborë dhe akull! Pastroje atë nga mëkatet siç pastrohen rrobat e bardha nga papastërtitë!.. Vendose atë në Xhenet dhe mbroje nga dënimi i varrit dhe i Xhehenemit!” (Muslim, Xhenaiz, 85)



Ebu Hurejre  transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ, është lutur kështu në namazet e xhenazes:

“O Allah! Fali të gjallët dhe të vdekurit tanë, të vegjlit dhe të mëdhenjtë tanë, burrat dhe gratë tona, ata prej nesh që janë prezent dhe ata që nuk janë prezent këtu!

O Allah! Bëji të jetojnë në Islam ata që do t’i lejosh të jetojnë, e merrua jetën me besim, atyre që do t’i bësh të vdesin!

Mos na privo nga sevapet e pjesëmarrjes në këtë xhenaze dhe mos na fut në sprova pas saj!” (Tirmidhi, Xhenaiz, 38)

“O Allah! Ti Je Zoti i kësaj xhenazeje (i të vdekurit), Ti e krijove atë dhe Ti e udhëzove në Islam. E tani, Ti e more edhe shpirtin e tij. Ti ia di më mirë çka ka bërë fshehtas dhe haptazi. Ndërsa ne po të drejtohem i Ty si ndërmjetës për të, prandaj fale atë!” (Ebu Daud, Xhenaiz, 56)



75. shih. Ebu Daud, Xhenaiz, 54-56/3199.



Ibn-i Abbasi رضي الله عنه, tregon:

“Një natë, i Dërguari i Allahut ﷺ, shkoi tek një varr. Atij iu ndez një kandil. Pasi e ktheu nga kibla xhenazen e shtrirë, iu drejtua duke u lutur me këto fjalë:

«Padyshim se ti ishte një njeri që luteshe dhe lexoje shumë Kuran. Allahu të mëshiroftë!» Më pas bëri katër tekbir (Allahu Ekber).” (Tirmidhi, Xhenaiz, 62/1057)



Po ashtu edhe Allahu i Madhëruar na bën të ditur se besimtarët lutën kështu për paraardhësit e tyre:

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ
وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

“...«O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!»” (Hashr, 10)

Një nga gjërat më të rëndësishme që të vdekurit presin prej të gjallëve është lutja për faljen e tyre. Njëherë, kur u varros një xhenaze, i Dërguari i Allahut ﷺ, i këshilloi myslimanët të kërkonin falje për të vdekurin, me shpresën që llogaria e tij në varr të kalonte lehtë.

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, i vizitonte shpesh shokët e tij në varrezën Baki dhe dëshmorët e Uhudit. Siç shprehet edhe nëna jonë Aishe رضي الله عنها: “Profeti ﷺ, në pjesën e fundit të çdo nate që ka qëndruar tek unë, shkonte tek varrezat Baki, i përshëndeste me selam (banorët e varreve) dhe lutej për ta”.⁷⁶

Një natë Xhibrili عليه السلام i kishte ardhur të Dërguarit të Allahut ﷺ, dhe i kishte thënë:

“Zoti yt ka urdhëruar të shkosh tek banorët në Baki e të lutesh për faljen

e tyre!” I Dërguari i Allahut ﷺ, e zbatoi menjëherë këtë urdhër dhe shkoi për vizitë tek varrezat Xhenetu’l-Baki. (shih. Muslim, Xhenaiz, 103)



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kur biri i njeriut vdes, atij i priten të gjitha veprat, përveç këtyre të triave: Sadakaja xharije⁷⁷, dija e dobishme dhe fëmija i mirë që lutet për të.” (Muslim, Vasijjet, 14)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Pas vdekjes (një) robit i ngrihet grada, e ai pyet:

«O Zoti im! Nga erdhi ky shpërblim?» Allahu i Madhëruar përgjigjet:

«Fëmija i mirë e i devotshëm (që ke lënë pas), u lut dhe kërkoi falje për ty.»” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 1; Ahmed, II, 509)

Në këtë botë, fëmijët kanë nevojë për prindërit e tyre gjatë rritjes. Mirëpo nga fundi i jetës së tyre, prindërit kanë nevojë për fëmijët. Ndërsa pas vdekjes, prindërit kanë përsëri nevojë për lutjet e fëmijëve të tyre dhe që ata të jenë sadaka xharije për ta.

Siç u cek edhe në hadithin fisnik, fëmijët e mirë e të devotshëm bëhen sadaka xharije dhe shkak mëshire ndaj prindërve dhe të parëve të tyre të vdekur. E kundërta ndodhë me fëmijët që nuk kanë marrë edukatë Islame, të cilët bëhen një sejjie xharije (pra një gjynah i vazhdueshëm) për prindërit e tyre -Allahu na ruajt!-. Prindër të tillë mbeten pa vizitorë dhe të vetmuar në varret e tyre, edhe pse kanë shumë nevojë.

Mbi të gjitha:

Kur fëmijët lihen në qejf të tyre, duke thënë: “S’ka gjë, ai është ende i vogël, me kalimin e kohës do të rregullohet...” dhe nuk edukohen në vijën e Kuranit dhe Sunnetit, në ditën e Kiametit ata do t’i padisin prindërit e tyre duke thënë:

“Prindërit e mi më lanë pas dore dhe nuk më edukuan si mysliman të mirë...”

77. Sadaka xharije: Një vepër e mirë, prej së cilës përfitojnë krijesat edhe pas vdekjes së atij që e ka bërë. Psh, mbjellja e një peme frutore, prej së cilës do të hanë njerëzit dhe krijesat e tjera edhe pas vdekjes së atij që e ka mbjellë.



Të mos harrojmë se fëmijët vijnë në këtë botë me një pastërti që meriton Xhenetin. Mirëpo nëse prindërit e neglizhojnë edukimin shpirtëror të fëmijëve të tyre, që janë një amanet hyjnor për ta, këta zogj të Xhenetit -Allahu na ruajt !- mund të fluturojnë në vende të gabuara. Për rrjedhojë, prindërit që nuk kanë shijuar asgjë prej burimit të gjerë shpirtëror të Kuranit dhe Sunnetit, e që për këtë arsye nuk i ndihmojnë dot as fëmijët që të shijojnë diçka, ndodhen përballë një gjynahu të madh që do ndikojë Ahiretin e tyre.

Në këtë botë, prindërit, fëmijët, shokët-miqtë, të afërmit, etj., jetojnë në bashkësi. Mirëpo në botën tjetër do të ketë një “*jeumu’l-fasl*”, një “*ditë ndarjeje*”, pra dita kur ndahen rrugët, për të cilën Allahu i Madhëruar na njofton në Kuranin Fisnik. Duke folur për banorët e Xhenetit thuhet:

سَلَامٌ قَوْلًا مِّن رَّبِّ رَحِيمٍ

“«Paqe!», do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë!” (JaSin, 58)

Allahu i Madhëruar bën të ditur se Ai do t’i ftojë robërit e mirë në Xhenetin e Tij, me mirësi dhe lavde të shumta. Mirëpo, edhe nëse janë prej së njëjtës familje apo bashkësi, gjynahqarëve do t’u thuhet:

وَأَمَّا زُورًا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمُجْرِمُونَ

“Veçohuni sot ju, o kriminelë!” (JaSin, 59)

Në këtë mënyrë, atje do të marrë fund miqësia apo afërsia që kishin në këtë botë dhe gjynahqarëve do t’u tregohet rruga e Xhehenemit.

Mbase atje do të ndahen me mijëra bashkëshortë. E me mijëra fëmijë e prindër do të jenë udhëtarë të rrugëve të ndryshme. Të afërmit e fqinjët, që në dynja jetonin së bashku, por që në fakt busullën e zemrave e kishin në drejtime të ndryshme, do të ndahen një pjesë nga një anë e një pjesë në anën tjetër. Ajo do të jetë një ditë e tmerrshme ndarjeje!..

Me qëllim që atë ditë të mos hidhërohem, duhet të bëjmë që sot kujdes edhe në drejtimin personal, edhe në edukimin në mënyrën më të bukur të fëmijëve tanë që në moshë të njomë, duke i konsideruar ata si amanet i Zotit.

Prindërit më të mëshirshëm janë ata që e përgatisin fëmijën e tyre për të ardhmen e tyre të vërtetë, që është Ahireti, duke e edukuar nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunnetit. Trashëgimia më e vlefshme që mund t’i lërë njeriu fëmijës së tij është një personalitet dhe karakter i bukur Islam.

Butësia dhe mëshira që duhet t'u tregohet fëmijëve, nuk konsiston thjesht në ushqyerjen e tyre, veshjen bukur, argëtimin dhe sigurimin e rehatisë së tyre trupore, sepse kjo i shtyn ata të mendojnë se jeta është vetëm në këtë botë. Butësia dhe mëshira e vërtetë ndaj fëmijëve tregohet duke ushqyer në radhë të parë shpirtat e tyre. Në këtë mënyrë e ardhmja e tyre shpëtohet prej dënimit dhe personalitetit të tyre i jepen vlerat shpirtërore që do ta kthejnë të ardhmen e tyre në një pranverë lumturie të pafundme.

Prindërit e mëshirshëm, të cilët besojnë në Allahun dhe në botën tjetër, kur kanë përballë lumturinë e dynjasë dhe atë të Ahiretit të fëmijëve të tyre, refuzojnë dynjanë pa ngurruar aspak dhe zgjedhin Ahiretin. Pra, ata preferojnë për të bijtë oqeanin në vend të disa pikave ujë.

Ai nuk mund të zgjedhi që fëmija të hajë këtu në këtë botë, pa në botën tjetër le të hajë ç'të dojë! Le të ketë një të ardhme të ndritur në këtë botë, pa në botën tjetër le të bëhet edhe prej faqezinjve!..

Ndërkohë, në ditët tona, arsimimit të dynjasë i jepet një rëndësi e veçantë për sigurimin e një të ardhme më të ndritur të fëmijëve, duke shpenzuar me tepri kohë, pasuri dhe mund. Për fat të keq, në lidhje me edukimin fetar, i cili do të garantojë lumturinë e tyre në Ahiret, nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme. Përkrah diplomave të dynjasë, nuk bëhet kujdes edhe për diplomat e botës tjetër. Dërgimi i fëmijëve dy a tre muaj në kurset e xhamive, gjatë kohës së verës, konsiderohet e mjaftueshme. Mirëpo, ta parit të edukimin fetar në mënyrë kaq të thjeshtuar, është tregues i hidhur i dobësisë së besimit në zemër.

Veçanërisht në ditët e sotme, prindërit fetarë duhet ta vendosin kokën midis duarve dhe të mendojnë:

✓ Kush e siguron të ardhmen? A është e ardhmja e vërtetë në këtë botë apo në botën tjetër?..

✓ Vallë, a dëshirojmë që fëmijët tanë të kenë pozita të larta edhe në vendin e përjetësisë në botën tjetër, po aq sa dëshirojmë që ata të marrin edukim të mirë në këtë botë e të arrijnë pozita të larta në tregun e kësaj jete të përkohshme?

✓ Vallë a po edukohen fëmijët tanë, sikur me të vërtetë janë tanët? Kush ua formon personalitetin dhe karakterin? Me botëkuptimin dhe orientimin e kujt edukohen? Çfarë shembujsh dhe cilët personalitete ndodhen në zemrat,

idealet dhe synimet e fëmijëve tanë? Fëmijët tanë përdorin televizionin, internetin dhe telefonin, apo këto aparate po i komandojnë fëmijët tanë?!

✓ Sigurisht, çdo prind dëshiron ta shohë fëmijën e tij të veshur me rrobat më të bukura. Mirëpo një prind që ka të instaluar mirë besimin në botën tjetër, mendon dhe shqetësohet më tepër se a do ta mbështjellë fëmijën e tij me mëndafshin dhe atllasin e Xhenetit, apo me zjarrin flakëruar të Xhehenemit në botën tjetër. Me qëllim që fëmijët të përvetësojnë kujdesin ndaj mbulesës, ata duhen mësuar që në moshë të vogël të vishen në një mënyrë me të cilën do të jetë i kënaqur Allahu i Madhëruar. Por a e tregojmë ne shqetësimin për gjendjen e fëmijëve tanë duke menduar për ditën që ata do të dalin para Allahut të Madhëruar, aq sa bëjmë kujdes ndaj veshjes së fëmijëve tanë me qëllim që të mos shihen si të papërshtatshëm kur të dalin midis shoqërisë?

✓ A i japim më tepër rëndësi përpjekjeve që bëjmë për të zbukuruar pamjen e jashtme të fëmijëve tanë, apo përpjekjeve që bëjmë për të gjelbëruar botën e zemrës së tyre në atmosferën e Kuranit dhe Sunnetit? Çka Allahu i Madhëruar vlerëson më tepër tek robërit e Tij, shprehet qartë në këtë ajet fisnik:

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij!..” (Huxhurat, 13)

Ndërsa në një hadith fisnik thuhet:

“Padyshim se Allahu i Madhëruar nuk sheh trupat dhe pamjet tuaja, por vetëm zemrat tuaja!” (Muslim, Birr, 33)

Në udhëtimin tonë të përjetësisë, ajo që do të na bëjë dobi neve dhe fëmijëve tanë, nuk është as fuqia trupore e as bukuria e jashtme, por vetëm devotshmëria dhe punët e mira e të sinqerta...

Shkurtimisht, që nesër të mos mbetemi fillikat me një pendesë të thellë në varrin e shkretuar dhe të sigurojmë lutjet e fëmijëve tanë për ne, duhet të përpiqemi sot sa kemi mundësi t'i edukojmë fëmijët tanë me frymëzimin shpirtëror të Kuranit. Ne duhet të interesohemi nga afër me edukimin e fëmijëve, duke u përpjekur të injektojmë në zemrat e tyre të pastra dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, dhe kulturën e Kuranit e Sunnetit. Duke u nisur nga fakti se motivimi është një nga mënyrat më të mira të edukimit, ne duhet t'i motivojmë ata me dhurata dhe fjalë inkurajuese me qëllim që tek fëmijët tanë të gjallërohen më lehtë bukuritë dhe mirësitë shpirtërore.

Imam Maliku ka thënë:

“Sa herë që unë mësoja përmendësh një hadith, babai më jepte një dhuratë. Por erdhi një kohë që edhe nëse babai im nuk më jepte dhuratë, mësimi përmendësh i haditheve u kthye në kënaqësi për mua.”

Të mos harrojmë se çfarëdo lloj fare të mbjellim në tokën e zemrës së fëmijëve tanë, atë prodhim do të marrim. Pra çfarë kemi dhënë, duhet të presim!..

5. Sadakaja dhe dhurimi

Pas duave dhe kërkimit të faljes, ajo që i bën më tepër dobi të vdekurit është sadakaja e dhënë në emër të tij.

Abdurrahman ibn Ebi Amra tregon se nëna e tij dëshironte të lironte një rob. Ajo e shtyu për në mëngjes lirim, por ndërroi jetë pa ardhur mëngjesi. Abdurrahmani pyeti Kasim ibn Muhamedin:



“Nëse unë liroj një rob, a ka dobi nëna ime prej kësaj?”

Kasimi u përgjigj:

“Sa’d ibn Ubade ka shkuar tek Profeti ﷺ dhe e ka pyetur:”

«Nëna ime ndërroi jetë. Nëse unë liroj një rob në emër të saj, a ka dobi për të?»

«Po!» - ishte përgjigjur i Dërguari i Allahut ﷺ. (Muuatta, Itk, 13; shih. Buhari, Uesaja, 15)

Djali i Ebu Bekrit , Abdurrahmani, ka vdekur në gjumë dhe nëna jonë Aisheja  ka liuar shumë robër në emër të vëllait të saj. (shih. Muuatta, Itk, 14)

Të gjitha këto, tregojnë se një besimtar që ka ndërruar jetë, mund të ketë dobi prej duave, sadakave dhe dhurimeve që bëjnë të afërmit dhe vëllezërit e tij besimtar që janë ende gjallë, gjë e cila i motivon edhe më shumë besimtarët drejt mirësive.



Ibn-i Abbasi , tregon:

“Një person shkoi tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe e pyeti:



«O i Dërguar i Allahut! Nëna ime ka ndërruar jetë ndërkohë që kishte ende një muaj borxh për të agjëruar. A ta shlyej borxhin në emër të saj?»

I Dërguari i Allahut ﷺ, e pyeti:

«A do t'i kishe shlyer borxhet e pasurisë në emër të nënës, nëse ajo do të kishte të tillë?»

«Po, do t'i kisha paguar!»- tha ai.

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, sqaroi:

«Borxhi ndaj Allahut meriton edhe më tepër të paguhet!» (Muslim, Sijam, 155)

Të sëmurët dhe të moshuarit, të cilëve u dobësohet trupi përditë e më shumë, duhet të kompensojnë agjërimet e tyre kur të shërohen ose duhet ta lënë në testament kompensimin e atyre ditëve. Nëse ekziston një testament i tillë dhe një e treta e pasurisë së lënë mjafton për çuar në vend testamentin, trashëgimtarët e kanë për detyrë të paguajnë kompensimin. Por nëse një e treta e pasurisë së lënë nuk mjafton për të çuar në vend testamentin ose nëse nuk ekziston ndonjë testament fare, atëherë është e këshillueshme që trashëgimtarët të paguajnë këtë kompensim në formë dhurimesh.

Edhe pse gjatë udhëtimit, sëmundjes, shtatzënisë, zisë për bukë, vuajtjeve të tepërta, etj., është e lejuar të mos agjërosh ose ta ndërpresësh agjërimin e filluar, këto arsytetime nuk e lejojnë mos kompensimin e ditëve që nuk janë agjëruar. Sapo të përfundojë shkaku i arsytimit, ato ditë duhen agjëruar kaza. Nëse këta persona kanë ndërruar jetë pa e plotësuar kompensimin, trashëgimtarët e tyre duhet ta paguajnë këtë kompensim. Ky veprim, sipas dijetarëve Islam, është konsideruar i lejuar, e madje, i këshilluar!

Po ashtu është thënë se shpagimi për agjërimet e pa mbajtura, jepet edhe pas vdekjes së atyre personave, që pa asnjë arsye nuk kanë agjëruar gjatë jetës, e as që i kanë plotësuar kaza më vonë. Madje ky shpagim mund të konsiderohet si “iskat”⁷⁸ për borxhin e agjërimit që ka i vdekuri. Mirëpo, lidhur me këtë temë, mes dijetarëve ka pasur kundërshtime dhe debate.

Debati i sipërpërmendur përqendrohet tek “namazi” dhe “agjërimi” për shkak se ato janë adhurime trupore. Ndërsa shpagimi për kurbanin,

78. **Iskat:**Nëse dikush ka vdekur pa bërë kompensimin apo shpagimin e borxheve apo të adhurimeve si namazi, agjërimi, kurbanin, zotimi, etj., trashëgimtarët e tij duhet t'u paguajnë një sasi të caktuar të varfërve, me qëllim që i vdekuri të shpëtojë prej këtyre borxheve.

zotimin, zekatin, e të tjera detyrime si këto, të cila i ndjeri nuk i ka kryer gjatë jetës, konsiderohet e pranueshme që të kryhen nga trashëgimtarët sipas testamentit ose sipas dëshirës dhe mundësive të trashëgimtarëve, në mungesë të ndonjë testamenti. E në fakt, në këto raste ka përputhje të borxhit me shpagimin dhe përveç kësaj këto lloj adhurimesh kanë lidhje me të drejtat e personave të tretë. Gjithashtu, është i lejuar caktimi i një përfaqësuesi për shpagimin e adhurimeve në pasuri.

Në themel të këtyre mendimeve, me tepër se ndonjë argument ligjor, gjendet dëshira e mirë e mbështetur tek shpresa dhe kujdesi.

6. Leximi i Kuranit

Leximi i Kuranit Fisnik dhe dhurimi i sevapit të këtij leximi, për personat që kanë vdekur, është një prej mirësive që mund të bëhet në emër të tyre.

Leximi i Kuranit, e në mënyrë të veçantë i sures JaSin, me qëllim që i vdekuri të përfitojë mëshirën hyjnore, është një metodë e njohur dhe e zbatuar nga të gjithë. Në një hadith fisnik thuhet:

“...JaSin është zemra e Kuranit. Nëse dikush e lexon duke kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe botën tjetër, atij do t’i falen gjynahet. Suren JaSin lexojani edhe të afërmve tuaj të vdekur.” (Ahmed, V, 26)

Ndërsa në një hadith tjetër thuhet:

“Kur të vdes ndonjë prej jush, varroseni pa e vonuar shumë. Dhe kur ta varrosni, dikush prej jush le t’i lexojë suren Fatiha tek koka dhe pjesën e fundit të sures Bekare (amenerresulu) tek këmbët.” (Taberani, Kebir, XII, 340; Dejlami, I, 284; Hejthemi, III, 44; Dejlami, Musned, I, 284)



Ala ibn el-Lexhlaxh ka transmetuar se në prag të vdekjes, i ati Lexhlaxhi, u ka lënë këtë porosi:

“Kur të më varrosni, thoni Bismil’lah ue ala sunneti Resulil’lah,⁷⁹ pastaj më hidhni dhé sipër. Tek koka më këndonin fillimin dhe pjesën e fundit të sures

79. (Po të lëmë amanet te Zoti ty) Me emrin e Allahut dhe sunnetin e të Resulullahut ❸!



Bekare. Me të vërtetë, unë kam qenë dëshmitar kur Abdullah ibn Omeri e ka konsideruar të bukur këtë praktikë.” (Bejhaki, *es-Sunenu'l-Kubra*, IV, 56)

Po ashtu, edhe i biri i Ala ibn el-Lexhlaxhit, Abdurrahmani ka thënë:

“Babai më tha:

«Biri im! Kur të vdes bëj një varr si sarkofag! Kur të më varrosni, thoni “(Teksti arabisht)” (Bismil’lah ue ala milleti Resulil’lah), pastaj më hidhni dhé sipër me lopata. Tek koka më këndon fillimin dhe pjesën e fundit të sures Bekare. Unë kam dëgjuar se kështu ka urdhëruar i Dërguari i Allahut, ﷺ.»” (Hejthemi, III, 44)



Janë interesante edhe këto fjalë, të cilat sahabi Amr ibn As ﷺ, ua ka thënë të pranishmëve si porosi në prag të vdekjes:

“Kur të më shtini në varr, prisni në krye të varrit aq kohë sa ç’duhet për të therur një deve e për t’ia copëtuar mishin, në mënyrë që të gjej mundësi që me anë të pranisë suaj të mësohem me jetën e re dhe t’i përgatis përgjigjet që do të më duhet t’ua jap përfaqësuesve të Allahut!” (Muslim, Iman, 192)

Imam Neueui i cili e citon këtë hadith në veprën e tij, ka transmetuar këto fjalë të imam Shafiut:

“Këndimi i ajeteve dhe sureve në krye të varrit është mustehab. Kurse këndimi i plotë i Kuranit (hatme) është më i bukur!”⁸⁰

Siç transmetohet edhe në një hadith fisnik, kur Sa’d ibn Muadhi ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut ﷺ, i fali namazin e xhenazes dhe pasi e futën në varr e i hodhën dhé sipër, qëndroi tek varri bashkë me sahabët, duke bërë tesbihë dhe duke thënë tekbire.

Ndërsa një prej dijetarëve të mëdhenj të brezit të tabiinëve, Imam Sha’bi thotë:

“Kur u vdiste dikush nga të afërmit, ensarët e vizitonin shpesh varrin e tij dhe këndonin Kuran pranë tij.”⁸¹

Po ashtu, Imam Sha’bi ka thënë:

80. Neueui, *Rijadu's-Salihin*, f. 293

81. Ebu Bekir ibn Hallal, *el-Kirae inde'l-Kubur*, Bejrut, 1424, fq. 89. Nr: 7.



“Ensarët lexonin suren Bekare pranë të vdekurit.” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, II, 445/10848)

Gjithashtu, edhe Xhabir ibn Zejdi, prej tabiinëve, lexonte suren Ra'd pranë të vdekurit. (shih. Ibn-i Ebi Shejbe Musannef, II, 445/10852)



Siç kuptohet nga të gjitha këto transmetime, vizita e varreve, përsëhëndetja me selam e banorëve të varreve, lutja dhe kërkimi i faljes për ta, bamirësia dhe leximi i Kuranit në emër të tyre, është mëshirë edhe për të gjallët edhe për të vdekurit.

Fjalët dhe praktikat e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij në lidhje me vizitën e varreve, na tregojnë qartë se si duhet të veprojmë në këtë çështje, pa kaluar në ekstreme.

7. Ngushëllimet

Shkuarja për ngushëllim tek njerëzit të cilëve u ka vdekur ndonjë i afërm ose kanë pësuar ndonjë fatkeqësi, me qëllim për t'iu gjendur pranë e për t'i këshilluar me durim, është një detyrë e rëndësishme shoqërore.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do ta veshë me rroba nderi myslimanin, i cili e ngushëllon vëllain e fesë në rastin e një fatkeqësie.” (Ibni Maxhe, Xhenaiz, 56)

Biri i njeriut është krijuar i dobët. Ai ka nevojë për mbështetje dhe ngushëllim në raste fatkeqësie e hidhërimi. Për këtë arsye, përcjellja e xhenazes dhe ngushëllimi janë detyra të rëndësishme Islame dhe njerëzore. Neglizhimi i tyre është gjynah dhe mangësi e madhe për njeriun.

Përveç kësaj, të mos harrojmë se nesër edhe ne do të kemi shumë nevojë për një vizitë ngushëllimi, që sot mund të na duket e tepërt për vëllain tonë. Nëse dëshirojmë të gjejmë një degë ku të mbahemi në kohë nevojë, duhet të përpiqemi që sot të ndajmë hidhërimin e vëllezërve tanë dhe t'ua qajmë hallet atyre. Një vëllazëri e vërtetë kërkon që ashtu siç ndahen gëzimet, ashtu të qahen edhe hallet së bashku me vëllezërit e fesë.



Gabimet që bëhen pas të vdekjes së dikujt

Detyra e fundit që besimtarët kanë ndaj njëri-tjetrit, në jetën e kësaj bote të përkohshme, është pjesëmarrja në varrimin e vëllait të fesë, falja e namazin të xhenazes dhe varrosja e tij. Përveçse detyra e fundit ndaj të vdekurit, kjo në të njëjtën kohë është edhe shenjë respekti dhe vlerësimi ndaj të afërmeve të tij.

Myslimanit i ka hije që të jetë pranë vëllait të fesë si në momente gëzimi, ashtu edhe në momente hidhërimi. Dhe pikërisht vdekja është momenti më i hidhur dhe më mësimdhënës i jetës. Në ceremonitë e varrimit zemrat zbuten në klimën e meditimit të thellë dhe dhimbjes e hidhërimit që shkakton ndarja. Ata që arrijnë të marrin mësim prej vëllait të tyre të vdekur, gjejnë mundësinë e përsiatjes, në aspektin e shtimit të kujdesit ndaj urdhrave të Allahut të Madhëruar për pjesën tjetër të jetës së tyre.

Sot përballemi shpesh me gjendje dhe veprime që bien në kundërshtim me parimet hyjnore dhe nuk përputhen aspak me etikën Islame. Këto bid'ate (risi) dhe gabime burojnë nga injoranca, indiferenca, interesi ose ndikimi i feve dhe kulturave të huaja. Kështu mund të përmendim:

- *Dërgimin e kurorave me lule në xhenaze.*
- *Vendosjen e xhenazes mbi altar dhe homazhet.*
- *Dërgimin e xhenazes në vendin ku ka punuar kur ka qenë gjallë dhe mbajtjen e fjalimit tek koka e tij.*
- *Përcjelljen e xhenazes duke e shoqëruar me bandë muzikore ose me muzikë funebre.*
- *Pritjen e xhenazes në morg ose frigoriferë pa pasur arsye.*

Në Islam i jepet përparësi varrosjes së shpejtë të xhenazes, pa e pritur gjatë. Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka bërë shumë paralajmërime. Për shembull, kur Talha ibn-i Bera ؓ u sëmurë, Profeti ﷺ i vajti për vizitë dhe kur u largua prej aty, i porositi kështu të pranishmit:

“Shoh që Talhas i është afruar vdekja. Nëse ndërron jetë më lajmëroni! Veproni shpejt në përgatitjen dhe qefinosjen (e xhenazes), sepse nuk është mirë që xhenazja e një myslimani të pritët gjatë pranë familjes së tij!” (Ebu Daud, 34)



“Tre gjëra mos i vono! Namazin që i ka hyrë koha, xhenazen e përgatitur (për varrim) dhe gruan pa burrë së cilës i ke gjetur njeriun e përshtatshëm (për ta martuar).” (Tirmidhi, Salat, 13/171)

● Po ashtu edhe larja e xhenazes me ujë të ftohtë apo të valuar është e gabuar. Në fakt, xhenazja duhet të lahet me ujë të vakët, duke treguar respekt ashtu siç tregohet edhe për një të gjallë.

Ummu Kajs bint-i Mihsan , tregon:

“Djali im ndërroi jetë dhe unë u hidhërova shumë. Ashtu e mërzitur, i thashë atij që po e lante:

«Mos ma laj djalin me ujë të ftohtë se do ta vrasësh!»

Ukkashe , shkoi menjëherë tek i Dërguari i Allahut dhe e lajmëroi për ato që thashë unë. Ndërsa i Dërguari i Allahut , buzëqeshi dhe tha:


«Kështu thotë ajo?! Atëherë jeta e saj u zgjat!»

Transmetuesi i këtij hadithi, ka thënë: “Ne nuk kemi parë askënd tjetër të jetoj më gjatë se ajo grua.” (Nesai, Xhenaiz, 29)

Një tjetër prej gabimeve, që haset shpesh në ditët tona, është edhe bartja e xhenazes për ta varrosur në një vend tjetër.

● Xhenazja mund të varroset vetëm në qytetin ku ka vdekur, në një varrezë myslimane. Nëse nuk ka varrezë të tillë, atëherë gjendet një vend i përshtatshëm. Kjo është një çështje me rëndësi, sepse ashtu siç bëhet kujdes për të qëndruar me njerëzit e mirë gjatë jetës, ashtu duhet të bëhet kujdes që edhe pasi të vdesë myslimani të varroset midis njerëzve të mirë.

● Një nga qëllimet e shërbimit ndaj xhenazes është kujtimi i vdekjes, meditimi për botën tjetër dhe marrja e mësimi prej ndodhisë. Për të mos e zbehur këtë qëllim, disa dijetarë nuk e shohin të pëlqyeshme as leximin e Kuranit, tekбирëve dhe dhikrit që mund të bëhet me zë të lartë, gjatë përcjelljes së xhenazes. Në shërbimet ndaj xhenazes, ku duhet të mbizotërojë modestia, thjeshtësia dhe sinqeriteti, nuk është e drejtë të bëhen ceremoni luksoze që çojnë në shpërdorim të tepërt.

Tregohet se ndër sahabët fisnikë Usejd ibn Hudajr , ka qenë një njeri shumë i virtutshëm. Ai thoshte shpesh:

“Nuk kam asnjë dyshim se do të jem prej banorëve të Xhenetit nëse arrij të qëndroj vazhdimisht në këto tri gjendje:



1. Nëse ruaj gjendjen shpirtërore që ndjej kur lexoj Kuran apo kur e dëgjoj atë nga dikush tjetër.

2. Nëse ruaj vazhdimisht gjendjen shpirtërore e cila më kaplon kur dëgjoj bisedat e Profetit ﷺ.

3. Nëse përjetoj vazhdimisht gjendjen që ndjej gjatë përcjelljes së xhenazes drejt varrezave. Sa herë që ndodhem në ndonjë xhenaze mendoj me vete: “Vallë, çfarë do t’i ndodhë kësaj xhenazeje, si do të vejë halli i saj dhe ku do ta shpien më në fund?!” (shih. Ahmed, IV, 351; Hakim, III, 326/5260)

● Përveç këtyre, nuk lejohet as përzierja e grave me xhematin e burrave në namazin e xhenazes dhe as shkuarja e tyre për të përcjellë xhenazen tek varri, pa qenë e domosdoshme.

Namazi i xhenazes dhe detyra e pjesëmarrjes në varrim, të cilat konsiderohen virtyte për burrat, nuk janë parë të përshtatshme për gratë dhe është pranuar si “*tenzihen mekruh*”⁸², sepse gratë kanë në natyrën e tyre ndjenja të theksuara të dhembshurisë dhe mëshirës dhe në raste të tilla hidhërimi, është shumë e mundur që ato të bëjnë veprime të papëlqyeshme.

Një nga gratë sahabe, Ummu Atijje ؓ, ka thënë:

“Ne grave na është ndaluar pjesëmarrja në (namazin e) xhenaze. Por, përcjellja e xhenazes nuk na është ndaluar në mënyrë të prerë.” (Buhari, Xhenaiz, 29, l’tisam, 27; Muslim, Xhenaiz, 34-35)

Mirëpo edhe nëse gratë nuk përzihen me burrat, futja në rresht për të falur namazin e xhenazes është mekruh. Madje edhe falja e tyre në namazet me xhemat është e lejuar me disa kushte. Kushti më i rëndësishëm është ruajtja nga përzierja burra-gra. I Dërguari i Allahut ﷺ, në lidhje me njëren prej dyerve të Mesxhidit Nebeui ka thënë:

“*Sikur t’ia lëmë grave këtë derë!?*”

Pas kësaj, burrat nuk e përdorën më atë derë. (shih. Ebu Daud, Salat, 53/571)

Ndërsa pas namazit, me qëllim që burrat të mos përziheshin me gratë, Profeti ﷺ ngrihej pasi gratë ishin shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre. Pas tij


82. **Mekruh:** Një vepër e cila edhe pse nuk është e haram/ e ndaluar me fe, ajo lejohet vetëm në raste të veçanta dhe urrehet të veprohet në gjendje normale. Ndërsa “*tenzihen mekruh*”, nënkupton veprën e cila është e papëlqyeshme, por më pranë hallallit.

ngriheshin edhe sahabët. Në mënyrë të veçantë, namazi i sabahut falej pa u zbardhur ende mirë. Gratë ngriheshin sapo jepnin selam dhe duke u mbështjellë me rrobat e tyre futeshin nëpër shtëpi. Ashtu siç nuk i njihte njeri, ndonjëherë as ato nuk e njihnin njëra-tjetrën.⁸³


Një ditë, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, po dilte prej xhamisë, vuri re se burrat po përziheshin me gratë dhe duke iu drejtuar grave tha:

“Mos ecnin në mes të rrugës, por në anë të saj!”

Pas kësaj, gratë filluan të ecnin në anë të murit, aq sa rrobat e tyre ngecnin nëpër mur. (Ebu Daud, Edeb, 167-168/5272)

Njëherë, në periudhën Emeuite, nëna jonë Aisheja  vuri re se gratë po përziheshin me burrat. Për këtë arsye ajo tha:

“Nëse i Dërguari i Allahut ﷺ, do t’i kishte parë gratë që veprojnë kështu, do t’i ndalonte ato nga ardhja në xhami, njësoj siç i ndalojnë bijtë e israilit gratë e tyre.” (Buhari, Ezan, 163)

Edhe pse Islami i jep një rëndësi të jashtëzakonshme faljes së namazit me xhemat, për të ndaluar përzierjen e burrave me gratë, ai i ka liruar gratë nga kjo përgjegjësi dhe ka ligjësuar se për gruan është më e virtytshme të falet në shtëpi se sa në xhami. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Mesxhidët më të mirë për gratë janë qoshet e shtëpive të tyre!” (Ahmed, VI, 297)

Nisur nga kjo, sidomos në kohë fitnesh, është më e përshtatshme që gratë t’i falin në shtëpi namazet e tyre. Mirëpo, në kohët kur nuk bëhet fjalë për fitne, nëse gratë dëshirojnë të shkojnë në xhami për të falur namazin, ato duhet të shkojnë pa u zbukuruar dhe pa u parfumosur.

Ndërsa në dy xhamitë e shenjta (Qabeja dhe Xhamia e Profetit), për shkak të shenjtërisë së vendit, gratë që kanë ardhur për umre apo për haxh mund t’i falin në xhami me xhemat të gjitha namazet, përfshirë edhe atë të xhenazes. Megjithatë, ato duhet të mos zbukurohen, të mos parfumosen, të ruhen nga përzierja me burrat dhe nga shkaktimi i çdo lloj ngatërrese apo fitneje.

83. shih. Buhari, Ezan, 162-166.



● Gjithashtu edhe vajtimi me kujë pas të vdekurit është një veprim i ndaluar.

Sipas transmetimit të Enes Ibni Malikut رضي الله عنه, i Dërguari i Allahut ﷺ, kaloi pranë një gruaje e cila po vajtonte duke bërë titur në krye të një varri dhe i tha:

“Ki respekt ndaj Allahut dhe bëj durim!”

Gruaja u përgjigj:

“Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’ të ka rënë ty!”

Gruaja nuk e kishte njohur Profetin ﷺ. Mirëpo më pas, kur i thanë se ai që ia këshilloi të ketë respekt dhe durim, ishte vetë Profeti ﷺ, ajo nxitoi për tek shtëpia e të Dërguarit të Allahut ﷺ, hyri brenda dhe tha duke kërkuar falje:

“Unë nuk ju njoha.”

Ndërsa Profeti ﷺ, tha:

“Durimi i vërtetë, është ai në momentin e parë të fatkeqësisë.”⁸⁴

Në një rast tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Xhenazja nuk pasohet as me zë (me kujë) e as me zjarr!” (Muuatta, Xhenaiz, 13; Ebu Daud, Xhenaiz, 46/3171)


● Zgjatja e zisë me javë e me muaj të tërë, duke qëndruar të hidhëruar gjithë kohën, është po ashtu një veprim i papërshtatshëm.

● Edhe përfolja pas të vdekurit dhe harrimi i tyre janë veprime jo të drejta.

● Gjithashtu, edhe falja e namazit në drejtim të varrit dhe ndërtimi i ndonjë faltoreje apo xhamie mbi varr janë të ndaluara.

● Një gabim tjetër është edhe punimi i varreve në mënyrë luksoze e madhështore, duke i mbushur ato me lavde dhe shprehje të tepruara. Kjo nuk përshtatet as me moralin Islam e as me etikën njerëzore. Sado i virtytshëm të ketë qenë ai që ka vdekur, myslimani duhet të ruhet nga shprehjet absolute që nënkuptojnë garancinë që ai person është prej banorëve të Xhenetit. Kjo ndodhi e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë:

84. Buhari, Xhenaiz 32, 43; Ahkam 11; Muslim, Xhenaiz 14-15. Shih edhe. Ebu Daud, Xhenaiz 23; Tirmidhi, Xhenaiz 13; Nesai, Xhenaiz 22.

Një nga sahabët që ishte i njohur për përkushtimin që kishte ndaj adhurimit, Uthman ibën Madh'un , ndërroi jetë në qytetin e Mendinës, në shtëpinë e një gruaje të quajtur Ummu'l-Ala. Kjo grua tha:

“O Uthman! Beto hem se në këtë moment Allahu Teala po të gositë me të mira.”

Profeti i Allahut , ndërhyu:

“Nga e di ti se Allahu është duke e gositur?”

Gruaja tha:

“Beto hem për Allahun që nuk e di!”

Profeti  sqaroi:

“Shikoni! Uthmani ndërroi jetë. Unë personalisht për të shpresoj të mirën prej Allahut. Mirëpo, megjithëse jam Profet, as unë nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua dhe me ju”.

Ummu'l Ala ka rrëfyer:

“Beto hem për Allahun se pas kësaj ndodhie, nuk fola më në lidhje me askënd”. (Buhari, Tabir, 27)

Një nga gjërat më të rëndësishme, që ua drithëron zemrat robërve të mirë, është frika se mos merren në llogari përpara Allahut për shkak të lavdërimeve të tepërta që u bëjnë njerëzit. Shembull i kësaj, është edhe i nderuari Halid Bagadadi, i cili është cilësuar si “*dielli i diejve*” në dije dhe urtësi. Ai ka lënë amanet që pas vdekjes së tij, të mos shkruhen shprehje lavdëruese në gurin e varrit të tij.

- Edhe leximi i Kuranit dhe bërja e hatmes “kundrejt pagesës”, gjatë varrimit ose pas tij, është konsideruar bid’at (risi në fe). Këtu bëjnë pjesë edhe këndimi i mevludeve “kundrejt pagesës” apo shtrimi i drekave e darkave me rastin e përvjetorëve të të ndjerit. Me leximin e Kuranit me rastin e vdekjes së dikujt, shpresohet shpërblimi për atë që e lexon dhe dobia për të vdekurin. Mirëpo kryerja e këtij shërbimi kundrejt një pagese, bëhet shkak që ata të cilët lexojnë Kuranin, të mos e bëjnë këtë për hir të Allahut por për hir të pagesës që do të marrin, gjë e cila çon në humbjen e vlerave dhe të shpërblimeve.

- Një prej zakoneve, që konsiderohet bid’at, është edhe “turi/qarku-



llimi i borxhit të adhurimeve”⁸⁵, i cili zbatohet pas varrimit të të vdekurit. “Iskat”-i, që bëhet për të shpëtuar të vdekurin nga borxhet e adhurimeve nuk duhet të kthehet në një hile.

Imam Muhamedi, duke u nisur nga lejimi i shpagimit që bëhet për agjërimet të cilat nuk mbahen për shkaqe të detyrueshme dhe që as nuk mund të plotësohen më vonë si kaza, ka përdorur metodën e kijasit/analogjisë për të gjykuar në të njëjtën formë edhe në lidhje me namazet e pa falura. Ky veprim është quajtur “*iskat-i salat*”. Në bazë të këtij gjykimi, për çdo namaz të pa falur, duhet të plotësohet nevoja një ditore e një të varfri për ushqim ose të dhurohet një sasi parash të barasvlershme me këto nevoja. Ky dhurim duhet t’i kalojë nevojtarit pa bërë asnjë ndryshim në sasi.

Në këtë mendim të Imam Muhamedit, gjenden tre dobi të rëndësishme:

- 1) Nxitja për dhurim dhe fitimi i sevapeve nga ana e atij që dhuron.
- 2) Gëzimi i nevojtarëve dhe lutja që i bëjnë ata të vdekurit.
- 3) Shpresa në faljen dhe mëshirën e Allahut të Madhëruar ndaj të vdekurit.

Për fat të keq, në ditët e sotme ka shumë njerëz që abuzojnë në zbatimin “iskat”-it, duke përdorur hilen e “turit/qarkullimit”⁸⁶, gjë e cila e nxjerr këtë zbatim nga qëllimi i tij kryesor dhe bie ndesh me shpirtin e Islamit. Me anë të kësaj metode, bëhet përpjekje për shpagimin e adhurimeve të pakryera, me dhurime që në fakt nuk janë bërë.

Me qëllim që dikush, i cili ka ndërruar jetë, të shpëtojë prej borxhit të namazeve që mund të mos i ketë falur, nxirret një sasi parash dhe në vend

85. **Turi i borxhit:** Ky është një veprim që konsiderohet si hile dhe ka për qëllim të paguajë borxhin e adhurimeve të të vdekurit kur pasuria që ka lënë ai me testament, ose një e treta e pasurisë së tij nuk mjafton për t’i paguar këto borxhe. Pasi konstatohet se pasuria nuk mjafton për të larë borxhet e adhurimit, trashëgimtarët e të vdekurit i japin një të varfri aq para sa gjenden aktualisht. Më pas -në bazë të marrëveshjes-, i varfri, pasi deklaron “*i pranova*”, ua fal ato para atyre që ia dhanë, të cilët bëjnë të njëjtin veprim në formë turi/qarkullimi, derisa të lahet komplet borxhi.

86. Një zbatim i tillë nuk ka ekzistuar as një kohë e Profetit ﷺ, as në kohë e tabiinëve dhe as në atë të tabi tabiinëve. Në fakt, “*iskati*” është lejuar në fund të shekullit të II hixhri, ndërsa “*turi/qarkullimi*” është futur në përdorim në shekullin e V hixhri. Mirëpo, ky zbatim që është bërë traditë dhe pandehet se mbështetet në burimet Islame, bëhet shkas i koprracisë në dhurim dhe i përtacisë në adhurime. E në fakt, ky është një bid’at (risi) dhe nuk ka mbështetje në Islam. (Hayrettin Kahraman, Ebediyet Yolcusunu Ugurlarken, s. 81-85)

që këto t'i jepen një të varfri në mënyrë të sinqertë, -për fat të keq- shpesh herë ato kalojnë dorë më dorë midis disa personave të cilët deklarojnë shprehjet “e pranova” dhe “e fala”. Me këtë metodë, gjoja shtohet sasia e parave që dhurohen, edhe pse jo në mënyrë faktike por vetëm juridike. Mirëpo, ky zbatim është vetëm një bid’at i shëmtuar me të cilin mashtrohen vetëm ata që besojnë se një gjë e tillë e shton sasinë e parave dhe e lanë borxhin e të vdekurit.

Më e habitshmja është se këtë metodë e përdorin sidomos të pasurit, të cilët shpresojnë se do të arrijnë diçka me këtë veprim. Mbi të gjitha, kjo tregon një mungesë logjike, të cilën mund ta përdorin ata që e shikojnë Islamin në mënyrë negative dhe me syrin e kritikës. Po ashtu kjo mund të shihet edhe si një përpjekje për të mashtruar Allahut.

- Një problem tjetër që shfaqet pas vdekjes së dikujt, është edhe kaplimi prej lakmive personale dhe armiqësia midis të afërmeve për shkak të trashëgimisë. Besimtarët duhet ta ndajnë trashëgiminë në mënyrën që ka dëshiruar Allahu i Madhëruar dhe nuk duhet t'i lënë vend shkëputjes së lidhjeve farefisnore për këtë shkak.

Për fat të keq, në ditët tona, shumë njerëz që i kanë dobësuar lidhjet me besimin dhe Islamin, nuk tregojnë pëlqim ndaj gjykimit të Allahut në ndarjen e trashëgimisë, duke shkaktuar kështu zemërim dhe armiqësi midis të afërmeve.

Mirëpo, për ata që nuk i binden urdhrave të Allahut në lidhje me këtë çështje, janë ligjëruar kërcënime të rënda. Ndërkohë që në Kuranin Fisnik shumë çështje janë trajtuar në mënyrë të përgjithshme, çështja se si do të ndahet trashëgimia është shpjeguar me detaje dhe me shprehjet më të qarta⁸⁷:

تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ ۚ وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۚ وَذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

“Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojë përherë. Kjo është fitorja e madhe.” (Nisa, 13)

87. shih. Nisa, 11-12.



وَمَنْ يَعِصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ

يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُهِينٌ

“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” (Nisa, 14)

● Gjithashtu edhe në lidhje me çështjen e organizimit të ceremonive, mevludeve apo hatmeve të Kuranit për të shtatat, të dyzetat, etj., nuk ka asnjë të dhënë që mbështetet në Kuran apo sunnet.

Për një mysliman që ka ndërruar jetë duhet kërkuar falje, duhet bërë bamirësi në emër të tij dhe duhet lexuar Kuran vazhdimisht. Por nëse këto bëhen vetëm në ditë të caktuara, atëherë mund të harrohet i ndjeri në ditët e tjera. Nga ana tjetër, njerëzit që nuk i dinë këto gjëra, mund të pandehin se këto lloj ceremonish janë rregulla të Islamit.

Mendohet se zakoni i të shtatave, të dyzetave, etj., pas vdekjes, mund të jetë shfaqur nga frika e njerëzve se nëse i vdekuri nuk kujtohet të paktën në këto raste, ai mund të harrohet fare. Mirëpo, mundësia që një person të harrohet plotësisht po të mos ishin këto lloj ceremonish, në një farë mënyrë është një tregues i hidhur se ai person nuk ka lënë kujtime të vlefshme në zemrat e njerëzve. Aliu عليه السلام ka këshilluar:

“Qëndro me njerëzit e mirë e besnikë! Krijto miqësi me ta (me qëllim që karakteri dhe personaliteti i tyre të ndikojë tek ty)! Bëj një jetë aq të drejtë sa që sa të jesh gjallë njerëzit të të kërkojnë, e pas vdekjes tënde t’i marrë malli!..”

Po ashtu, edhe poeti shprehet po me të njëjtin kuptim:

*Atë ditë kur të lindi nëna, e në botë të nxori,
Ti qaje, e bota qeshte mënjanë,
Tani jeto ashtu, që ti të qeshësh kur të vdesësh,
E bota pas teje lotët t’i bëjë ujëvarë...*

Njerëzit e mirë kanë bërë një jetë plot me shërbime në rrugë të Allahut, duke lënë pas breza të denjë, kujtime të bukura, vepra të dobishme dhe lutje mirësie. Edhe pse trupat e tyre gjenden tashmë nën tokë, emrat e tyre vazhdojnë të jetojnë në zemra për shekuj të tërë. Lidhur me këtë, i nderuari i Mevlana shprehet:



“Pas vdekjes, varrin tonë mos e kërkoni në tokë sepse ai gjendet në zemrat e të urtëve.”

Lum si robërit e mirë që kanë arritur të lënë emrin e mirë në këtë kupë qiellore duke hedhur firmën e tyre të pashlyeshme të dashurisë në zemra!..

Disa besëtytni në lidhje me xhenazen

Tashmë dihet se në shumë vende janë shfaqur disa besëtytni në lidhje me xhenazen dhe vdekjen, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me Islamin. Disa prej këtyre besëtytnive, të cilat nuk duhet të merren kurrë për bazë janë:

- Në shtëpinë ku natën ulërin një qen (ose në oxhakun e së cilës këndon ndonjë kukuvajkë) do të vdesë dikush, ose prej asaj familjeje, ose prej ndonjë familjeje tjetër të afërt.

- Nëse në orët e vona të natës jepen enë, si tenxhere, tava, tepsi, etj., nga një shtëpi në tjetrën, ky veprim ndjell vdekjen.

- Nëse gërshërët mbeten të hapura, kjo nënkupton se ato do të presin qefin.

- Gjilpëra me të cilën qepet qefini duhet të thyhet, përndryshe ndjell fatkeqësi e vdekje.

- Nëse kazani i ujit me të cilin lahet i vdekuri nuk kthehet përmbys pas larjes së xhenazes, nënkupton se aty do të vdesë dikush tjetër.

- Nëse prej një shtëpie del një xhenaze, enët e ujit që ndodhen aty duhet të boshatisen. Nëse nuk boshatisen, për shkak se Azraili عليه السلام ka prekur ujin e tyre, atëherë aty do të vdesë dikush tjetër.

- Nëse një prej sendeve të shtëpisë bie apo thyhet vetvetiu, kjo tregon se në atë shtëpi do të vdesë dikush.

- Nëse këpuca kthehet përmbys ndërkohë që hiqet nga këmba, në atë shtëpi do të vdes dikush.

- Në shtëpinë nga ka dalë një xhenaze, nuk fiket drita deri në 40 ditë, me qëllim që kur shpirti i të vdekurit të kthehet, ta gjejë dhomën e tij të ndriçuar.

Lista e këtyre besëtytnive është shumë më e gjatë. Prandaj ne duhet



t'i japim rëndësi të madhe edukimit fetar, njohurive dhe mësimin të dijeve Islame, me qëllim që të ruajmë edhe veten, edhe pasardhësit tanë.

Gabimet që bëhen gjatë vizitave në varreza

- Lidhja e leckave pranë varreve apo tyrbeve, ngjitja e gurëve, hedhja e parave, spërkatja me kripë, prerja e kurbanit në oborrin apo pragun e varrezave e tyrbeve, nderja e qirinjve, lutja drejtuar të vdekurit në varr, etj., janë disa prej gabimeve që bëhen gjatë vizitave në varreza.

- Lidhja e leckave në varreza është një ritual i trashëguar prej shamanizmit, sipas besimit të të cilit çdo mal, përrua, liqen e lumë, pemë e madhe dhe shkëmb, ka të zotin e vet. Këto qenie shpirtërore, që quhen “Izi”, kërkojnë kurbane prej njerëzve. Ata ato dëmtojnë këdo që nuk bën kurban për ta. Mirëpo këto qenie shpirtërore janë aq modeste saqë mund t'i kënaqësh edhe me një copë leckë, një tufë qimesh kali e madje edhe me një copë guri që hidhet si kurban. Prej kësaj besëtytnie ka lindur edhe zakoni i lidhjes së leckave apo hedhja e diçkaje në varre. E për fat të keq gjurmët e këtyre besimeve të kota është e mundur t'i gjesh ende mes njerëzve të paditur.

Nëse nuk ruhem me kujdes të madh prej këtyre besëtytnive që kanë lidhje me besimin, do t'i shkaktojnë njeriut disfatë në botën tjetër, sepse besimi monoteist nuk pranon as edhe idhujtarinë më të vogël.

Selman Farisiu ﷺ transmeton se Profeti ﷺ ka treguar një ndodhi shumë mësimdhënëse:

“Një person hyri në xhenet për një mizë.”

Të pranishmit thanë:

“Si është e mundur kjo, o i Dërguari i Allahut?!”

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Dy persona kaluan pranë një populli që adhuronte një idhull. Ata nuk lejonin të kalonte njeri, derisa të ofronte diçka për idhulin. Njërit prej tyre i thanë:

«Ofro diçka për këtë idhull!»

Ai u përgjigj:

«S’kam ç’të ofroj!»

I thanë:

«Jep qoftë edhe një mizë!»

Ai i ofroi një mizë (si kurban) dhe e lanë të kalonte. Personi në fjalë hyri në zjarr.

Pastaj i thanë edhe tjetrit:

«Ofro edhe ti diçka!»

Ai iu përgjigj:

«Nuk ofroj asgjë (kurban) për dikë tjetër veç Allahut!» Ata e vranë këtë person e ai fitoi *Xhenetin*.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 203)

● Edhe ndezja e qirinjve nëpër varre është një zakon i mbetur prej adhuruesve të varreve.

● Një gabim tjetër i rëndë është edhe rrotullimi rreth varrit të një njeriu që konsiderohet i mirë (i shenjtë), sikur bën tavaf rreth Qabesë.

Vepra të tjera që nuk përputhen aspak me besimin Islam janë edhe:

● Vizatimi i gjërave të dëshiruara në këtë botë, si shtëpi, makinë, fëmijë, etj., në dyert e tyrbeve.

● Marrja e një sasive dheu prej vendit të tyrbeve me qëllim shërimit, hedhja ose ngjitja e parave në to.

● Puthja e tyrbeve, fërkimi i tyre me dorë dhe hyrja në to duke u përkulur me shpresën dhe besimin se do të zgjidhet një hall ose do të plotësohet një dëshirë.



Njeriu është shumë i dobët. Gjithkush dhe gjithçka është nevojtar për Allahun e Madhëruar. Dhe dihet mirë se vetëm Allahu i dëgjon lutjet dhe i plotëson ato. Disa njerëz, kur shkojnë tek varret e njerëzve të mirë ose edhe në mungesë të tyre, fillojnë e u luten me shprehje të tilla si: “O filan më shëro!” ose “O filan ma plotëso këtë dëshirë!”, etj., por këto veprime konsiderohen shirk ndaj Allahut të Madhëruar.



Këto shprehje që aludojnë se dikush tjetër përveç Allahut mund të eliminojë problemet dhe të menaxhojë gjithësinë e ngjarjet, nuk duhet të përdoren absolutisht në asnjë mënyrë. Është detyrë e çdo myslimani paralajmërimi ndaj veprimeve, vazhdimësia e të cilave të çon drejt shirkut, qoftë edhe për shkak të injorancës apo pakujdesisë. Mirëpo, edhe ata që e teprojnë duke konsideruar “shirk” edhe vizitat e varreve që bëhen në përputhje me etikën Islame, në emër të kundërshtimit të veprimeve të gabuara, nuk bëjnë gjë tjetër veçse të njëjtin gabim në aspektin e kundërt.

Ashtu si për çdo çështje, edhe në lidhje me vizitën e varreve, Islami parashikon ekuilibrin dhe rugën e mesme. Fjalët dhe praktikat e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij janë shembulli më i mirë për ne, që na tregojnë se si duhet të veprojmë lidhur me këtë çështje, pa shkuar në ekstreme. Padyshim se sahabët e nderuar e kanë ditur më mirë se ne çfarë është “shirk” e çfarë është “teuhid”. Kjo ndodhi është një përgjigje shumë kuptimplote ndaj atyre që e teprojnë duke e konsideruar “shirk” vizitën e varreve:

Një ditë, kalifi Emeuit, Mervan ibn Hakemi, vuri re një person i cili kishte vënë kokën tek guri i varrit të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai mendoi se personi po bënte një veprim në kundërshtim me Islamin, prandaj duke e kapur për jake i tha:

“Çfarë mendon se po bën?”

Mirëpo kur njeriu e ktheu kokën, Mervani pa se ishte Ebu Ejjub el-Ensariu ؓ! Ky sahab i dashuruar pas Profetit ﷺ tha:

“Po, unë e di se ç’po bëj! Unë erdha te i Dërguari i Allahut ﷺ, e jo te guri, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ, të thotë:

«Kur punët e fesë t’i marrin përsipër njerëz kompetentë, mos u shqetëso! Por kur njerëz jokompetentë të fillojnë të përzihen në këtë punë, ke gjithë të drejtën të shqetësohesh e të qash.» (Ahmed Ibni Hanbel, V, 422; Hakim, IV, 560/8571)

Nga kjo ngjarje kuptojmë se të konsideruarit shirk të vizitës së varreve që bëhet në përputhje me etikën Islame, është i pavend. Shirk bën personi që konsideron një të gjallë apo të vdekur, si të fuqishëm për të bërë dobi apo dëm si Allahu i Madhëruar.

Shkurtimisht, gjatë vizitave në varreza duhet të bëjmë kujdes të madh ndaj rregullave dhe etikës Islame. Po ashtu duhet të ruhem i të mos i shër-

bejmë përhapjes së gabimeve që cënojnë Islamin. Si besimtarë që jemi, ne duhet t'ia bëjmë të ditur familjes dhe rrethit tonë botëkuptimin e drejtë të Islamit në lidhje me çdo çështje dhe të bëjmë një jetë në përputhje të plotë me sunnetin e të Dërguari të Allahut ﷺ.



PJESA V



Kiameti

Nëse bie tërmet ose shpërthen ndonjë bombë, ne menjëherë themi: “kërciti Kiameti”. Ndërsa Kiameti i vërtetë, ai kur yjet do të derdhen, qielli do të mbështillet si letër e malet do të bëhen pluhur, është një shpërthim aq i madh sa mendja e njeriut nuk arrin ta konceptojë... Ajo është një ditë kur foshnjat do të thinjen nga frika, gratë shtatzëna do të abortojnë, sytë do të dalin nga vendi dhe njerëzit do të bëhen si të dehur pa pirë. Lidhur me robërit fatlumë që do të jenë të sigurt dhe nën mbrojtjen hyjnore nga hidhërimi dhe frika e një ditë të tillë të tmerrshme, në Kuran urdhërohet:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut).” (Junus, 62-63)

KIAMETI

Allahu i madhëruar, ka vendosur që çdo gjë që ka krijuar të jetë e përkohshme. Ashtu siç ka caktuar një kohë vdekjeje për njeriun, Allahu ka caktuar edhe një kohë “Kiameti” për botën. Ashtu siç e ka bërë të panjohur kohën e vdekjes për çdo njeri, edhe informacioni se kur do të bëhet Kiameti është një lajm që i përket të fshehtës dhe dijes së Tij. Lidhur me këtë çështje, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Ata të pyesin ty (Muhamed) rreth Orës (së Kiametit). Thuaju:

«Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ajo, do ta tregojë vetëm Ai. Do të jetë e rëndë për qiejt dhe Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas.» Ata të pyesin, a thua se ti di diçka për të. Thuaj:

«Këtë e di vetëm Allahu, ndërsa shumica e njerëzve nuk e dinë (pse kjo gjë është e fshehtë).»” (A’raf, 187)

“Njerëzit të pyesin për Orën (Kiametin), thuaju: «Vetëm Allahu ka dijani mbi atë». Kush e di?! Ndoshta Kiameti mund të jetë afër?!” (Ahzab, 63)

“Qoftë i lartësuar në lavdi Ai, të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe gjithçka që gjendet mes tyre. Vetëm Ai ka dijani mbi Orën (e Kiametit) dhe tek Ai do të ktheheni!” (Zuhruf, 85)

SHENJAT E KIAMETIT

Lidhur me pyetjet që i janë drejtuar rreth Kiametit, i Dërguari i Allahut, ﷺ, është përgjigjur duke thënë: “i pyeturi nuk di më shumë se pyetësi!”. Me këtë përgjigje ai ka dashur të bëjë të ditur se as ai nuk e dinte se kur do të bëhej Kiameti. Me qëllim që ummeti i tij të marrë mësim dhe të ruhet, ai ka dhënë informacione në lidhje me shenjat e Kiametit. Në një ajet fisnik paralajmërohet:

فَهَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا السَّاعَةَ أَنْ تَأْتِيَهُمْ بَغْتَةً فَقَدْ جَاءَ أَشْرَاطُهَا
فَأَنَّى لَهُمْ إِذَا جَاءَتْهُمْ ذِكْرَاهُمْ

“A mos vallë mohuesit presin, që t’u vijë befasisht vetëm Ora (e Kiametit)? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur. Po për çfarë do t’u shërbejnë atyre këshillat, kur t’iu ketë ardhur Kiameti?!”

(Muhamed, 18)

Një pjesë e shenjave të Kiametit janë fizike, të tilla si shfaqja e Dexhalit dhe lindja e Diellit nga perëndimi. Ndërsa një pjesë tjetër janë shpirtërore, të tilla si dobësimi i fesë tek njerëzit, etj.

Disa dijetarë, shenjat e Kiametit i kanë ndarë në tre pjesë:

1. Shenjat që janë shfaqur dhe kanë kaluar, të cilat ndryshe quhen edhe “shenjat e largëta” ose “shenjat e vogla”. Këtu bëjnë pjesë dërgimi i Muhamedit ﷺ si profet, lufta e Xhemelit dhe Siffinit, marrja e hilafetit nga Emevitët, etj.

2. Shenjat, një pjesë e të cilave janë shfaqur por nuk kanë kaluar ende dhe janë duke shkuar drejt fundit e duke u shtuar. Këto quhen “shenjat e mesme”.

3. “Shenjat e afërta” ose “shenjat e mëdha”, pas të cilave do të vijoje menjëherë Kiameti. Këto shenja do të shfaqen njëra pas tjetrës, ashtu siç dalin nga peri ruazat e tespihve kur këputen.

Këtu do të trajtojmë shenjat e vogla dhe të mesme në një pjesë, ndërsa shenjat e mëdha në një pjesë tjetër:

a) Shenjat e vogla dhe të mesme

Ekzistojnë shumë shenja që lajmërojnë Kiametin para se ai të afrohet mirë. Këto lloj shenjash janë paralajmëruese për besimtarët dhe u kujtojnë atyre që të përgatiten sa më mirë. Ja disa prej tyre:

1. Dërgimi i Muhamedit ﷺ si profet

Profeti ﷺ, është hallka e fundit e zinxhirit të profetëve, pra fleta e fundit e kalendarit profetik. Ai është profeti i fundit për të gjithë njerëzimin, që prej dërgimit të tij deri në ditën e Kiametit. Pra pas tij nuk do të ketë më asnjë

profet tjetër. Për rrjedhojë, nderimi i botës me Muhamedin ﷺ në të njëjtën kohë është edhe shenjë e afrimit të Kiametit.

Xhabiri ﷺ, tregon:

“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, mbante hutbe, sytë i skuqeshin, zëri i ngrihej dhe emocionet i shtoheshin si një komandant që porosiste ushtrinë e tij: «Armiku do t’ju sulmojë në mëngjes ose në mbrëmje, prandaj mbroni veten!». Pastaj, bashkonte gishtin tregues me gishtin e mesit dhe thoshte:

«Unë jam dërguar si Profet në një kohë kur midis meje dhe Kiametit distanca është sa kjo midis këtyre dy gishtave!» (Muslim, xhum’a, 43. Shih. Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 7)

2. Shtimi i paditurisë në dijet fetare

Në një hadith fisnik thuhet:

“Mësojeni Kuranin dhe mësojuani atë të tjerëve! Mësoni edhe shkençën e trashëgimisë dhe mësojuani atë të tjerëve! Sepse së shpejti do të vijë një kohë, kur dy persona do të diskutojnë mbi një çështje në lidhje me trashëgiminë e nuk do të gjejnë një dijetar që do të gjykojë midis tyre dhe të zgjidhë çështjen.” (Hejthemi, IV, 223)

Mësimi i dijeve fetare dhe të jetuarit sipas tyre është farz/e detyrueshme për çdo mysliman. Mos angazhimi mjaftueshëm në dijet Islame, për shkak të dobësimit të ndjenjave fetare tek njerëzit dhe për pasojë të mos jetuarit të fesë me sinqeritet, është një nga shenjat e Kiametit.

Në një tjetër hadith thuhet:

“Islami do të fshihet e do shkojë ashtu siç fshihet e shkon qëndisja në rrobë. Madje, nuk do të dihet çfarë është as agjërimi, as namazi, as haxhi, as umreja dhe as sadakaja. Libri i Allahut (Kurani) do të ngrihet e do të merret brenda një nate dhe mbi tokë nuk do të mbetet qoftë edhe një ajet prej tij. Do të mbeten vetëm disa burra e gra të moshuar të cilët do të thonë:

«Ne i kemi arritur (parë) të parët tanë, të cilët thoshin shprehjen: “La ilahe il-lallah!”. Edhe ne e themi!»⁸⁸

88. Situata të ngjashme kanë ndodhur në kohën e komunizmit në disa vende të botës, si Kina, Rusia dhe Azia e Mesme. (E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Shqipëri gjatë regjimit komunist, i cili e ndaloi fenë me ligj në vitin 1967, duke u shpallur kështu i vetmi vend ateist në botë)

Kur Hudhejfe ﷺ transmetoi këtë hadith, Sila ﷺ i cili gjendej pranë tij e pyeti:

“A do t’ju bëjë dobi shprehja «La ilahe il-lallah!» atyre të moshuarve, ndërkohë që nuk dinë as çfarë është namazi, agjërimi, haxhi dhe sadaka-ja?”

Hudhejfa ﷺ nuk i dha përgjigje kësaj pyetje. Sila ﷺ e përsëriti tri herë këtë pyetje dhe çdo herë Hudhejfa ﷺ refuzoi të përgjigjej. Kur Sila ﷺ, e ripërsëriti, Hudhejfa ﷺ tha:

“O Sila, kjo shprehje do t’i shpëtojë ata nga Xhehenemi (i përjetshëm).” Këtë e përsëriti tre herë. (Ibn-i Maxhe, Fiten, 26)

Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ngritja e dijes, rrënjosja e injorancës, konsumimi i alkoolit dhe shtimi i zinasë⁸⁹, janë prej shenjave të Kiametit.” (Buhari, IIm, 21)

Injoranca e përgjithshme në dijet fetare sot vihet re shumë lehtë. Po ashtu edhe përhapja e alkoolit dhe zinasë është një realitet i hidhur që pranohet nga të gjithë. Gjendja e atyre që në këtë kohë e quajnë prapambetje konsiderimin e zinasë si krim, që nuk njohin asnjë kufi në kënaqjen e dëshirave dhe epsheve të tyre egoiste e që për rrjedhojë, siç shprehet edhe Profeti ﷺ, “janë si gomarët”⁹⁰, nuk është aspak më ndryshe se gjendja e njerëzve më të këqij e më të mallkuar mbi të cilët do të bëhet Kiameti.



Përmendja këtu e këtyre gjynaheve është për shkak se ato janë tregues të qartë të prishjes së sistemit të domosdoshëm të besimit Islam, mbi të cilin qëndron në këmbë dhe ruhet dynjaja dhe Ahireti. Rënia (zhdukja) e dijes bëhet shkak i prishjes së “fesë”, përhapja e alkoolit të merr “mendjen”, zinaja shkatërron “brezat”, ndërsa shtimi i fitneve (trazirave) shkakton humbje “jetësh” dhe “pasurie”. E në fakt detyra më e rëndësishme e myslimanëve është mbrojtja e këtyre pesë themeleve jetike. Prishja e këtyre pesë themeleve është treguesi më i madh i shkatërrimit të botës. Allahu i Madhëruar ka premtuar se njeriu nuk do të lihet të sillet gjithmonë si t’i dojë qejfi.⁹¹ E meqenëse pas Profeti ﷺ nuk do të vijë më asnjë profet tjetër, tashmë njerëzit që do t’i humbasin këto amanete me siguri që do të shkatërrohen.

89. Zina: Marrëdhënie seksuale jashtëmartesore.

90. shih. Muslim, Fiten, 110; Tirmidhi, Fiten, 59; Ibn-i maxhe, Fiten, 33.

91. shih. Kuran, el-Kijame, 36.

3. Shtimi i fitneve dhe vrasja e njerëzve

Fitnet (trazirat) në vendet Islame, kanë filluar në kohën e hilafetit të Osmanit . Manifestimet e tyre kanë qenë të ndryshme në çdo periudhë. Domethënë, nuk është e thënë që fitnet të ndodhin të gjitha në të njëjtën kohë. Ato do të ndodhin në kohë e në forma të ndryshme deri në ditën e Kiametit. Njëherë, i Dërguari Allahut , ka thënë:

“Do të vijë një kohë e tillë, kur kurrat (lexuesit e Kuranit) do të shtohen, ndërsa fakihët (dijetarët e vërtetë të urtë e punëmirë) do të pakësohen, dituria do të ngrihet, e herxhi do të shtohet!”

Sahabët pyetën:


“Çfarë është herxhi o i Dërguar i Allahut?”


Profeti  u përgjigj:

“Vrasja juaj me njëri-tjetrin!..”

Më pas do të vijë një kohë, kur njerëzit do të këndojnë Kuran, por çka këndojnë nuk do t’u zbrësë më poshtë se gurmazi (pra nuk do të kenë ndikim në zemër e nuk do të praktikohen).

Më pas do të vijë një kohë kur hipokriti, mohuesi dhe idhujtari do të flasin si besimtarë dhe do të debatojnë në lidhje me Allahun!” (Hakim, Mustedrek, IV, 504/8412. Shih. Buhari, Ilm, 24)

Sot vërejmë se janë shtuar shumë hoxhallarët apo teologët me etiketën e dijetarëve, modernistë e historicistë⁹², që e interpretojnë Kuranin dhe Sunnetin sipas mendjes së tyre e që flasin për reforma në fe. Po ashtu janë shtuar edhe tekfivistët,⁹³ të cilët luftojnë me myslimanët në emër të Islamit dhe sufistët (mistikët) e paditur që e dobësojnë rrugën e vërtetë. Të gjitha këto, e vërtetojnë më së mirë fjalën e të Dërguarit të Allahut .

Paralajmërim që i Dërguari i Allahut , i ka bërë Abdullah ibn Omerit  në lidhje me këtë çështje, është një kriter i rëndësishëm për orientimin tonë:

92. **Historicism:** Rrymë relativiste, që refuzon idenë e interpretimeve universale, fundamentale dhe të patjetërsueshme.

93. **Tekfir:** Akuzimi i të tjerëve për veprën e mohimit të Allahut, të kushteve të besimit dhe Islamit.



“O Ibn-i Omer! Kapu mirë pas fesë tënde, kapu mirë pas fesë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Bëj kujdes se prej kujt e mëson fenë! Dijet dhe gjykimet fetare merri prej dijetarëve që janë në rrugë të drejtë, e jo prej atyre që anojnë majtas-djathtas!”⁹⁴



Nëse në një shoqëri dobësohen dijet fetare (Islame), është e natyrshme të shtohen edhe problemet e fitnet (trazirat). Njerëzit përditë e më shumë po bëhen egoistë dhe interesaxhinj, gjë e cila shkakton verbimin e ndjenjave të mirësisë dhe i hap rrugën animit nga e keqja në çdo moment. Kjo e bën shoqërinë si një kazan fitnesh, ku askush nuk gjen paqe e siguri.

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Betohem në Allahun, i Cili mban në dorën e tij të fuqishme shpirtin tim, se do të vijë një kohë kur vrasësi nuk do ta dijë përse ka vrarë e i vrari nuk do ta dijë se përse është vrarë.” (Muslim, Fiten, 55)

Sahabët pyetën:

“Si është mundur kjo?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, u përgjigj:

“Kjo është herxh (fitne, anarki, trazirë)! Edhe vrasësi edhe i vrari janë në zjarr!” (Muslim, Fiten, 56)

Tabloja e përgjithshme në çdo vend, ku sot mbizotëron terrori dhe anarkia, e vërteton edhe më mirë këtë realitet. Grupet terroriste që shpesh organizohen dhe menaxhohen prej forcave të errëta prapa skene, bëjnë gjakderdhje pa e ditur se kujt i shërbejnë. Për rrjedhojë vrasësi nuk e di se përse vret e i vrari nuk e di përse është vrarë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Betohem për Allahun, i Cili mban shpirtin tim në dorën e Tij të fuqishme se jetës në dynja nuk do t’i vijë fundi, derisa një njeri i cili kalon pranë një varri nuk do hidhet mbi varr e të thotë: «Ah sikur të isha unë në këtë varr në vend të personit që prehet këtu!» Ai do të veprojë kështu, jo për shkak të fesë, por për shkak të fatkeqësive që i kanë rënë.” (Buhari, Fiten, 22; Muslim, Fiten, 54)

Nga kjo kuptohet se jeta, në kohën para se të bëhet Kiameti, do të jetë shumë e vështirë për njerëzit. Në atë kohë jeta do të jetë aq stresuese, sa njeriu do të bëhet pishman që është gjallë. Njëkohësisht jeta do të jetë aq e pavlerë, sa vrasësi nuk do ta dijë përse vret e i vrari nuk do ta dijë përse vritet. Madje edhe njerëzit që s'kanë asnjë lidhje me fenë e besimin, do ta urrejnë këtë botë e do të dëshirojnë vdekjen.

Në një situatë të tillë do të jetë e vështirë edhe të orientohesh nga e mira, edhe të bësh vepra të mira. Për këtë arsye, ne duhet ta vlerësojmë mirë kohën e paqes dhe sigurisë para se të vijnë ato kohë të vështira dhe të përpiqemi që këto mundësi t'i shndërrojmë në një kapital për lumturinë e botës së përjetshme.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nxitoni në bërjen e punëve të dobishme, sepse në një të ardhme të afërt vendin do ta kaplojnë disa fitne (trazira) si netët e errëta. Në atë kohë, njeriu gdhihet besimtar dhe ngryset mohues (qafir); ngryset besimtar dhe gdhihet mohues. Ai do ta shesë fenë për pak gjë të kësaj bote.” (Muslim, Iman, 186)⁹⁵

“...Personi që do të kapet fort pas fesë në një kohë të tillë, do të jetë si ai që mban në dorë prush (ose gjemba).” (Ahmed, II, 390)⁹⁶

Në kohë të tilla, njerëzit me karakter të dobët nuk do t'i japin rëndësi Kuranit dhe Sunnetit dhe do të veprojnë sipas mendjes së tyre. Kur të interpretojnë ajetet dhe hadithet, gjithmonë do të vënë në plan të parë interesat e tyre. Lidhur me këtë, Profeti ﷺ ka thënë:

“Robërit e mirë të Allahut do të emigrojnë në Ahiret njëri pas tjetrit dhe pas tyre do të ngelen vetëm njerëzit pa vlerë, si mbetjet e elbit dhe të hurmave. Ndërsa Allahu i Madhëruar nuk u jep fare rëndësi atyre njerëzve.” (Buhari, Rikak, 9)⁹⁷

4. Dhënia autoritetet njerëzve të paaftë e pa merita

Ebu Hurejre  tregon:

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte duke biseduar me sahabët, vjen një beduin dhe e pyet:

95. shih. Tirmidhi, Fiten, 30, Zuhd 3; Ibni Maxhe, Ikame 78; Ahmed, II, 303, 372, 523.

96. shih. Muslim, Iman, 186; Tirmidhi Fiten, 30/2196.

97. shih. Darimi, Rikak, 11.



“- Kur do të bëhet Kiameti?”

Mirëpo, Profeti ﷺ vazhdoi bisedën pa e ndërprerë fjalën. Për këtë arsye, një nga sahabët tha:

“Ai e dëgjo pyetjen e bedunit, por nuk i pëlqeu.”

Ndërsa një tjetër tha:

“Jo, ai nuk e dëgjo pyetjen.”

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, mbaroi fjalën tha:

“*Ku është ai që pyeti rreth Kiametit?*”

Beduini tha:

“Këtu jam o i Dërguar i Allahut!”

“*Kur të humbasë amaneti, prite Kiametin!*” - tha Profeti ﷺ.

“Si humb amaneti?”, pyeti përsëri beduini.

“*Kur punët t’u besohen njerëzve të paaftë, prite Kiametin!*” (Buhari, Ilm, 2, Rikak, 35)⁹⁸

Lënia e punëve në dorën e njerëzve të paaftë, do të thotë që punët të mos u besohen njerëzve që kanë dije, përvojë dhe meritë. Njerëzit e paaftë nuk i kryejnë ashtu siç duhet punët që kanë marrë në përgjegjësi por rendin vazhdimisht pas interesave të tyre personale. Për këtë arsye, ata bëjnë padrejtësi ndaj punëve e njerëzve, gjë e cila e shkatërron sistemin në një kohë të shkurtër.

5. Kalimi i shpejtë i kohës

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“*Nuk do të bëhet Kiameti pa u afruar koha! Ky afrim është i atillë që një vit do të jetë si një muaj, një muaj si një javë, një javë si një ditë, një ditë si një orë dhe një orë si një shkëndijë zjarri.*” (Tirmidhi, Zuhd, 24/2332)

Drejt fundit të botës, pasuria do të shtohet dhe për shkak se njerëzit do të angazhohen më tepër me të e do të zhyten në argëtime, ose për shkak të trazirave të shumta që do të shfaqen, ata do të shqetësohen. Në këtë

mënyrë ata nuk do ta vënë re se si kalojnë ditët e netët dhe nuk do të përfitojnë aspak prej tyre. Mendohet se ky hadith fisnik ka aluduar edhe për shkurtimin e jetëgjatësisë dhe për kohën e cila do të kalojë pa begati.

Dijetari i hadithit, Hattabi, ka thënë se shkurtimi i kohës do të ndodhë pas ardhjes së Mehdiut ose pas zbritjes së Isait عليه السلام. Ndërsa dijetari i njohur Ali el-Kari, ka thënë se kjo do të ndodhë në kohën e të dyve, sepse shkurtimi i kohës do të fillojë kur të shfaqet Dexhali. E ai do të shfaqet midis Mehdiut dhe Isait عليه السلام.

6. Shtimi i pasurisë së kësaj bote

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Gëzohuni dhe shpresoni në gjëra që do t’ju gëzojnë! Betohem në Allahun se unë për ju nuk kam frikë varfërinë. Unë kam frikë se bota do të shtrohet para jush, ashtu siç u është shtruar popujve të mëparshëm, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe bota do t’ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata.” (Buhari, Rikak, 7; Muslim, Zuhd, 6)

“Për ju kam frikë se pas meje do t’ju hapen mirësitë dhe stolitë e kësaj bote, e ju do t’ia jepni zemrën atyre!” (Buhari, Zekat, 47, Xhihad, 37; Muslim, Zekat, 121-123)⁹⁹

“Dynjaja është e ëmbël dhe ka pamje të bukur. Padyshim se Allahu do t’jua japë juve drejtimin e botës dhe do të shohë se si do të silleni e çfarë punësh do të bëni. Prandaj ruhuni prej dynjasë dhe grave (mendjelehta)!” (Muslim, Dhikr, 99)

Pasuria do të vijë duke u shtuar vazhdimisht dhe në kohën pranë Kiametit do të shtohet në mënyrë të jashtëzakonshme, aq sa do t’i ngopë syrin edhe njerëzve të pangopur. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Në ditët e fundit të botës, një prej halifeve tuaj do ta ndajë pasurinë me grushte pa pasur nevojë ta numërojë.” (Muslim, Fiten, 68, 69)¹⁰⁰

Të gjitha këto janë paralajmëruar nga Profeti ﷺ. Mbase me kalimin e kohës do të shtohen edhe më shumë, por raste të tilla dëshmohen edhe në ditët tona.

99. Shih. Nesai, Zekat, 81; Ibn-i Maxhe, Fiten, 18.

100. shih. Ahmed, III, 317.

7. Dobësimi i përshëndetjes me selam

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Para Kiametit do të shfaqet selami i veçantë¹⁰¹. Tregtia do të përhapet mjaft, aq sa edhe gruaja do ta ndihmojë burrin e saj në tregti. Lidhjet farefisnore do të shkëputen. Dëshmia e rreme do të shtohet e do të fshihet e vërteta...” (Ahmed, I, 407, 419; Hakim, IV, 110/7043)

“Një nga shenjat e Kiametit, është edhe dhënia e selamit vetëm për të njohurit.” (Ahmed, I, 405. Shih. Abdurrezzak, Musannef, III, 154)

8. Disa shenja të tjera të Kiametit për të cilat ka lajmëruar Profeti ﷺ

“Nuk do të bëhet Kiameti pa luftuar dy ushtri të mëdha me njëra-tjetrën. Megjithëse të dyja këto dy grupe ushqejnë të njëjtat ideale, mes tyre do të zhvillohet një luftë e madhe.

Nuk do të bëhet Kiameti pa u shfaqur rreth tridhjetë Dexhalë gënjeshtarë e të mallkuar. Të gjithë këta Dexhalë do të deklarojnë se janë të dërguarit e Allahut...

Nuk do të bëhet Kiameti pa u shtuar tërmetet dhe pa u afruar koha mes tyre...

Po ashtu, nuk do të bëhet Kiameti pa u shtuar pasuria midis jush, e pa rrjedhur si lumë. Pasuria do të shtohet aq shumë sa njeriu do të shqetësohet se kush do t’ia pranojë zekatin. Njeriu do të mundohet t’ia japë zekatin dikujt, por ai do t’i thotë: «Unë nuk kam nevojë për këtë!»...” (Buhari, Fiten, 25)

Pamundësia e gjetjes së dikujt që do të pranojë zekatin ka ndodhur në kohën e Omer ibn Abdulazizit. Megjithatë kjo do të ndodhë edhe në të ardhmen. Madje, edhe sot e kësaj dite, për shkak të shtimit të pasurisë, në disa vende mund të jetë e vështirë të gjesh dikë që e meriton zekatin në kuptimin e vërtetë të fjalës. Në këtë pikë duhet bërë kujdes, sepse për shkak të mos sensibilizimit ndaj nevojtarëve dhe të të parit vetëm në ambientin përreth, disa persona mund të mendojnë se në shoqëri nuk kanë mbe-tur të varfër, dhe ky është tregues për një indiference shumë të theksuar.

101. Atë kohë, njeriu do të përshëndesë me selam vetëm të njohurit, ose kur shkon pranë një grupi, përshëndet vetëm disa persona të caktuar prej tyre.



Besimtarët e pasur, sipas kritereve Islame, e kanë për detyrë t'i kërkojnë vetë të varfrit, t'i gjejnë ata dhe ta çojnë në vend detyrën e tyre të zekatin në mënyrën më të bukur.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Betohem në Allahun Dhukhelal që ka në dorë jetën time se nuk do të bëhet Kiameti pa vlarë imamin (prijësin, kryetarin e shtetit) tuaj, pa nxjerrë shpatat për të luftuar njëri-tjetrin dhe pa e trashëguar botën të këqijtë tuaj!”
(Tirmidhi, Fiten, 9/2170)

“Nuk do të bëhet Kiameti pa shteruar uji i lumit Euftrat dhe pa u zbuluar në shtratin e tij një mal floriri, pa vdekur nëntëdhjetenëntë ndër njëqind që përleshën me njëri-tjetrin, duke thënë: «unë duhet të shpëtoj e të fitoj!»”
(Buhari, Fiten, 24; Muslim, Fiten, 29)¹⁰²

“Së shpejti, në shtratin e tharë të lumit Euftrat do të zbulohet një thesar floriri. Kush ia arrin asaj dite, të mos marrë asgjë prej atij thesari!” (Buhari, Fiten, 24; Muslim, Fiten, 29-32; Ebu Davud, Melahim, 13; Tirmidhi, Sifatu'l-Xhenne, 26)

Në këto hadithe lajmërohem se lumi Euftrat do të shterojë dhe në shtratin e tij do të dalë në pah një mal me flori ose ndonjë minierë ari. Fjala “mal” mund të jetë përdorur edhe për të shpjeguar më mirë madhësinë e thesarit që do të zbulohet. Mendohet se kjo do të ndodhë në një kohë afër Kiametit.

Gjithashtu, në një hadith tjetër që tregon për shfaqjen e këtyre ndodhive para Kiametit, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë: *“Toka do t'i kthejë të gjitha thesaret e veta në formën e kolonave të arit e të argjendit.”*¹⁰³ Në atë kohë, njerëzit e mbushur me lakmi, do të hyjnë aty dhe nëntëdhjetenëntë në njëqind (sipas një transmetimi tjetër nëntë në dhjetë) veta do të vdesin në këtë përpjekje.



Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Femrat do të shtohen, ndërsa meshkujt do të pakësohen aq shumë

102. Ibn-i Maxhe, Fiten, 25.

103. Muslim, Zekat, 62.



sa pesëdhjetë gra do të kenë vetëm një person (burrë) që do të kujdeset për to.” (Buhari, Ilm, 21)

Kjo shprehje në këtë hadith fisnik, -Allahu e di më mirë!- mund të jetë edhe në formë figurative. Por nga kjo kuptohet qartë se, në kohën afër Kiametit, një burrë do të jetë i detyruar të kujdeset për disa gra.

Përveç kësaj, për shkak se me afrimin e Kiametit do të shtohen fitnet/ trazirat, po ashtu do të shtohen edhe vrasjet, edhe luftrat, gjë e cila do të çojë në pakësimin e numrit të burrave.



Në hadithin fisnik, që njihet edhe si “Hadithi i Xhibrilit”, i Dërguari i Allahut ﷺ, është pyetur për shenjat e Kiametit, për të cilat ai është përgjigjur kështu:

“Kur nënat të lindin fëmijë të cilët do t’i trajtojnë ato si skllave dhe kur barinjët e deleve këmbëzbathur e të zhveshur të garojnë me njëri-tjetrin në ndërtimin e pallateve të larta (prite Kiametin)”. (Muslim, Iman, 1, 5)¹⁰⁴

Shenja, e cila tregon se “skllavja do të lindë zotërinë e saj”, mund të shpjgohet në këtë mënyrë:

1. Nënat mund të lindin fëmijë të këqij që i trajtojnë ato si skllave dhe abuzojnë me prindërit e tyre.

2. Kur zotëria shkon me skllaven e tij dhe ajo lind një fëmijë, i cili do të kalojë në vend të babait vet. Në këtë rast fëmija bëhet zotëria i nënës së vet.

3. Kur një grua me fëmijë merret e shitet si skllave dhe duke kaluar dorë më dorë, pas një farë kohe, blihet nga fëmija i saj.

Ndërsa shenja që tregon “garën e barinjve këmbëzbathur e të zhveshur në ndërtimin e pallateve të larta”, aludon në rritjen e mirëqenies dhe pasurisë, aq sa edhe njerëzit që më parë kanë qenë shumë të varfër do të garojnë në ndërtimin e pallateve të larta.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“...Nuk do të bëhet Kiameti derisa njerëzit të garojnë në ndërtimin e pallateve të larta...” (Buhari, Fiten, 25)

104. Shih. Buhari, Iman, 37; Tirmidhi, Iman, 4; Ebu Daud, Sunnet, 16; Nesai, Meuakit, 6; Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 9.

Profeti ﷺ ka lajmëruar se midis shenjave të Kiametit, të cilat janë si zërat e hapave të tij, janë edhe shtimi i “zinase” dhe “ndërtesave”. Nëse shohim tablonë e përgjithshme të kohës sonë, për fat të keq do të vërejmë se zinaja dhe ndërtesat e larta janë shtuar shumë.

Zinaja dhe imoraliteti janë duke helmuar qetësinë dhe shpirtin e shoqërive. Ndërsa ndërtesat e larta të kujtojnë gurët e varrit të qyteteve të pajetë, të cilëve u është dobësuar aspekti shpirtëror.

9. Do të vijë një kohë e tillë që...

I Dërguari i Allahut ﷺ, e ka lajmëruar ummetin e tij në lidhje me disa fitne dhe fenomene të këqija që do ndodhin në të ardhmen, duke dëshiruar që ata të tregohen më të kujdesshëm në këtë çështje. Disa prej haditheve që bëjnë të ditur një pjesë prej këtyre ndodhive, të cilat cilësohen si lajmëtare të Kiametit, janë edhe këto:

“Mbi njerëzit do të vijë një kohë e tillë që askush nuk do të mbetet pa ngrënë kamatën! Edhe nëse nuk e përfiton direkt prej saj, atë do ta prekë pluhuri¹⁰⁵ i saj.” (Ebu Daud, Buju, 3/3331)¹⁰⁶

“Do të vijë një kohë e tillë që njeriut nuk do t’i interesojë aspak nëse pasurinë e ka fituar hallall apo haram!” (Buhari, Buju, 7, 23)

“Do të vijë një kohë e tillë që kush thotë të vërtetën do të përgënjeshtrohen, e gënjeshtarët do të besohen. Njerëzit e besueshëm do të konsiderohen tradhtarë, e tradhtarët do të konsiderohen të besueshëm. Njeriu do të dëshmojë pa iu kërkuar të dëshmojë dhe do të betohet pa iu kërkuar të betohet.

Njerëzit më të lumtur në botë (duke përfituar tepër prej mirësive të kësaj bote) do të jenë ata më të poshtrit, që nuk besojnë as Allahun e as të Dërguarin e Tij!” (Taberani, el-Mu’xhemu’l-Kebir, XXIII, 314; Hejthemi, VII, 283)

“Do të vijë një kohë e tillë që njerëzit nuk do të këshillojnë më të mirën dhe nuk do të pengojnë askënd nga e keqja.” (Hejthemi, Mexhmau’z-Zeuaid, VII, 280)

Theubani , tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

105. Në transmetimin e Ebu Daudit, përmendet fjala “avull”.

106. Shih. Nesai, Buju, 2/4452; Ibn-i Maxhe, Tixharat, 58; Ahmed, VV, 494; Bejhaki, Sunen, IV, 275.

“Është e afërt koha kur popujt e huaj do t’ju sulmojnë si egërsirat e uritura drejt ushqimit.”

E pyetën:

“A është kjo për shkak se do te jemi pak, o i Dërguari i Allahut?”

Ai tha:

“Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Allahu do të nxjerrë nga zemrat e armiqve tuaj frikën prej jush e do të fusë dobësinë në zemrat tuaja?”



“Ç’është dobësia, o i Dërguari i Allahut?” - u pyet.


“Dashuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja!” - tha ai.” (Ebu Daud, Melahim 5/4297; Ahmed, V, 278)

Siç e kuptojmë edhe nga ky hadith fisnik, armiqtë e Islamit do t’i sulmojnë myslimanët të bashkuar për të thyer forcën e tyre, për t’i përçarë dhe si përfundim për t’i eliminuar ata. Dhe këtë do ta bëjnë me shumë lehtë, sepse çka u jep guxim atyre, nuk është numri i pakët i myslimanëve, por përkundrazi, edhe pse numri i tyre do të jetë i madh, ata do të jenë të dobët në besim në aspektin e devotshmërisë dhe do të jenë të dhënë shumë pas kësaj bote. E në fakt kush e ka frikë vdekjen dhe është i dhënë tepër pas kësaj bote, nuk mund të bëjë sakrificë, nuk mund të durojë vështirësi dhe e braktis luftën kundër armikut me jetën dhe pasurinë e tij. Kështu myslimanët do ta humbasin madhësitinë e tyre që dikur mbillte frikën në zemrën e armiqve. E për këtë arsye armiqtë e Islamit nuk do të kenë më frikë prej myslimanëve.




Zubejr ibn Adi  tregon:

Shkuam tek Enes ibn Maliku  dhe iu ankuam për padrejtësitë që na bënte Haxhaxhi. Ndërsa Enesi  na tha:

“Bëni durim deri sa të takoheni me Zotin tuaj, sepse çdo ditë që vjen do të jetë më e keqe se ajo që shkon. Këtë e kam dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut .” (Buhari, Fiten, 6; Tirmidhi, Fiten, 35/2206)



Abdullah ibn Omeri  ka rrëfyer:

I Dërguari i Allahut , u drejtua nga ne dhe tha:

“O muhaxhirë! Ekzistojnë pesë gjëra pas të cilave ju mund të jepeni, strehohem tek Allahu që ju të mos i arrini këto:

1. Kur në një popull përhapet zinaja dhe prostitucioni, derisa ata e kryejnë këtë gjynah publikisht, tek ta do të shfaqet patjetër sëmundja e murtajes dhe sëmundje të tjera që nuk janë parë në popujt që kanë jetuar para tyre.

2. Populli që mat dhe peshon mangët, patjetër që do të ndëshkohen me uri, vështirësi jetese dhe padrejtësitë e kryetarëve të tyre.

3. Çdo popull që i ikën pagesës së zekatit të pasurisë së vet, patjetër që do të privohet nga shiu dhe po të mos ishte për kafshët e tyre, nuk do t’u lëshohej fare shi.

4. Çdo popull që do të braktisë urdhrat e Allahut dhe sunnetin e të Dërguarit të Tij, patjetër që Allahu do t’u vërsul një armik që nuk është prej tyre, i cili do të marrë një pjesë të zotërimeve të atij popull.

5. Drejtuesit (e një populli) që nuk punojnë me Librin e Allahut, por zgjedhin ato që u vijnë përshatë nga gjykimet e tij, Allahu do t’i ndëshkojë duke i përplasur me njëri-tjetrin (përfshihen nga trazirat dhe anarkia).” (Ibn-i Maxhe, Fiten, 22; Hakim, IV, 583/8623; Bejhaki, Shuab, III, 197)



I Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Një popull që drejtohet nga gratë (në çështjet e drejtimit dhe gjykimit) nuk ka shpëtim!” (Buhari, Megazi, 82)

“Nëse drejtuesit tuaj janë njerëz të mirë, nëse të pasurit janë njerëz bujarë, nëse çështjet i zgjidhni duke u këshilluar mes jush, atëherë mbitoka është më e mirë se nëntoka (vdekja). Por nëse drejtuesit tuaj janë njerëz të këqij, nëse të pasurit janë koprracë dhe nëse çështjet tuaja janë në dorë të grave, nëntoka është më e mirë se mbitoka.” (Tirmidhi, Fiten, 78/2266)

E në fakt, në një popull të tillë është e pamundur të mbizotërojnë urdhrat e Islamit...



Aliu ﷺ, tregon:

“Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Kur populli im të bëjë këto pesëmbëdhjetë gjëra, mbi të do fillojnë të bien fatkeqësitë!»

Të pranishmit pyetën:

«Çfarë janë këto o i Dërguar i Allahut?»

Profeti ﷺ i rreshtoi kështu:

«1. Kur pasuria publike qarkullon vetëm midis të pasurve dhe njerëzve me pushtet, pa rënë kurrë në dorë të të varfërve e nevojtarëve.

2. Kur amaneti (detyra) shihet si plaçkë dhe shpërdorohet.

3. Kur zekati nuk shihet si adhurim por si një peshë e rëndë dhe humbje.

4. Kur njeriu i bindet gruas (në punë të këqija).

5. Kur njeriu tregohet i pabindur ndaj nënës së vet.

6-7. Kur njeriu sillet ashpër me babanë e tij, ndërkohë që sillet mirë me shokun.

8. Kur në xhami të kumbojnë zërat (të humbasë përkushtimi në adhurim).

9. Kur drejtuesit e një populli janë nga më të poshtrit e tyre. (Në kohën tonë, ky është një fenomen që vërehet shpesh në shumë vende të botës).

10. Kur dikush respektohet nga frika e së keqes së tij.

11. Kur të lejohen pijet alkoolike të prodhuara nga emra të ndryshëm.

12. Kur meshkujt të veshin rroba prej mëndafshi.

13-14. Kur të rritet interesi për këngëtarët dhe veglat muzikore. (Për fat të keq, fenomene të tilla janë më të përhapurat në ditët tona)

15. Dhe kur brezat e rinj të këtij populli të mallkojnë brezat e mëherëshëm të tij.

Ja pra, pikërisht atëherë priteni erën e kuqe (që merr shpirtrat e besim-



tarëve), fundosjen në tokë ose shndërrimin në derra apo majmunë¹⁰⁷, tërmetin dhe rënien e gurëve nga qielli!

Më pas, do të shfaqen shumë shenja të tjera, njëra pas tjetrës, të cilat do ta ndjekin njëra-tjetrën si rruazat e një gjerdani të vjetër të cilit i është këputur peri.” (Tirmidhi, Fiten, 38/2211)

Të fshehtën e di vetëm Allahu. Por me shumë gjasa, këto janë shenja që do të ndodhin si rezultat i shtimit të së keqes me afrimin e Kiametit.



Në një hadith fisnik thuhet:

“Së shpejti do të shfaqet një fitne e tillë që, prej saj njeriun mund ta shpëtojë vetëm Allahu dhe një lutje si ajo e njeriut i cili është duke u mbytur...” (Bejhaki, Shuab, II, 367-1077)

Ndërsa Hudhejfe , ka thënë:

“Mbi njerëzit do të vijë një kohë e tillë, nga e cila mund të shpëtojë vetëm ai person që lutet si dikush që është duke u mbytur në det.” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VI, 22/29173; Hakim, IV, 471/8308.



I Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Do të vijë një ditë që njerëzit do ta braktisin Medinën ndërkohë që ajo është në gjendjen më të mirë e më të bukur. Aty do të mbeten vetëm kafshët e egra dhe zogjtë.

Njerëzit që do të vdesin të fundit në botë janë dy barinj prej fisit Muzejne. Ata i thërrasin delet e tyre duke dashur të hyjnë në Medinë. Mirëpo, ata e gjejnë atë të shkretuar e të mbushur me kafshë të egra. Kur arrijnë në kodrën e lamtumirës, edhe ata bien me fytyrë në tokë e vdesin.” (Buhari, Fedailu'l-Medine, 5; Muslim, Haxh, 498, 499; Muvatta, Xhami, 8)



107. shih. Tirmidhi, Fiten, 38/2210



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Mehdiu do të jetë prej sojit tim, prej fëmijës së Fatmas!” (Ebu Daud, Mehdi, 1/4284; Ibn-i Maxhe, Fiten, 34)

“Mehdiu është prej sojit tim. Ai ka ballë të gjerë e hundë të hollë. Ai do ta mbushi me drejtësi botën, siç ishte mbushur me mizori e padrejtësi, dhe do të sundojë për të shtatë vjet.” (Ebu Daud, Mehdi, 1/4286)

Të gjitha këto që janë lajmëruar në hadithet fisnike, janë realizuar ose në mënyrë të njëjtë ose të ngjashme. Mirëpo për shkak se çasti i Kiametit nuk mund të dihet në mënyrë të prerë, është e mundur që këto shenja të realizohen edhe në të ardhmen në forma edhe më të ashpra. Ne si myslimanë duhet të jemi gjithmonë të kujdesshëm dhe të përgatitemi sa më mirë për botën tjetër.

b) Shenjat e mëdha

Një ditë, disa prej sahabëve po bisedonin në lidhje me një çështje. I Dërguari i Allahut ﷺ, i pyeti se për çfarë po bisedonin dhe ata i thanë se po bisedonin në lidhje me “çështjen e Kiametit”. Për këtë arsye, Profeti ﷺ tha:

“Pa u shfaqur dhjetë shenja, nuk do të ndodhë Kiameti:

Duhani (tymi), Dexhali, Dabbetu’l-Ard (kafsha), lindja e diellit nga perëndimi, zbritja e Isait عليه السلام, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët, fundosja e tokës në perëndim dhe në gadishullin Arabik dhe zjarri që do të fillojë prej Jemenit e do vazhdojë deri në vendin ku do ringjallen njerëzit.” (Muslim, Fiten, 39-40; Ebu Daud, Melahim, 11; Ibn-i Maxhe, Fiten, 28)

Dijetarët Islamë këto ndodhi i kanë përkufizuar si shenjat e mëdha të Kiametit. Edhe pse në këtë hadith fisnik janë përmendur njëherësh dhjetë shenja të Kiametit, në lidhje me çdonjërin prej këtyre shenjave ka hadithe të ndryshme.

Informacionet në lidhje me Kiametin bëjnë pjesë në fushën e gajbit/të fshehtës. Dhe në lidhje me gajbin mund të mësojmë vetëm aq sa na kanë informuar Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij ﷺ. Nisur nga rëndësia e gajbit, në Kuran flitet në gjashtëdhjetë vende lidhur me këtë çështje. Në këto ajete bëhet e ditur se gajbin/të fshehtën e di vetëm Allahu i Madhëruar. Por në këtë çështje ka vetëm një përjashtim, i cili tregohet kështu në Kuranin Fisnik:

“Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur...” (Xhinn, 26-27)

Allahu i Madhëruar ia ka bërë të ditura edhe Profetit ﷺ informacionet në lidhje me Kiametin, Ahiretin, Xhenetin, Xhehenemin dhe shumë çështje të tjera. Ndërsa ai e ka lajmëruar ummetin e tij në lidhje me çka ka parë si të përshtatshme. Padyshim se gjithçka që i Dërguari i Allahut ﷺ, i ka bërë të ditur ummetit të tij, lidhet me çka ka dëshiruar Allahu i Madhëruar. Në fakt, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka qenë në dijeni të të vërtetave hyjnore që i tejkalojnë kufijtë e kuptimit njerëzor, e që mund të kuptohen vetëm në sajë të dritës profetike. Përveç të vërtetave të cilat i kishte për detyrë t'i kumtonte, disa informacione të tjera të veçanta ai nuk ia ka transmetuar ummetit të tij. Lidhur me këtë fakt, ai shprehet kështu në një hadith:

“Unë shoh atë që ju nuk e shihni dhe dëgjoj atë që ju nuk e dëgjoni. Qielli po kërcet! Kërcitja e tij është reale, sepse atje nuk ka as sa katër gishta vend bosh, ku të mos gjendet një melek që e ka vënë kokën në sexhde për Allahun! Për Zotin, sikur t'i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë, nuk do të preokupoheshit me bashkëshortet tuaja, do të dilnit nëpër rrugë dhe do t'i kërkonit ndihmë Allahut me zë të lartë...” (Tirmidhi, Zuhd, 9/2312; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 19)

Shkaku që njeriut nuk i janë dhënë disa informacione në lidhje me vdekjen, varrin, Kiametin dhe Ahiretin, të cilat janë përtej kufijve të mendjes njerëzore, është që të mos çrregullohet sistemi i jetës njerëzore, gjë e cila është një tregues më vete i mëshirës së Allahut të Madhëruar. Nëse njeriut do t'i ishin dhënë informacione që e kapërcejnë kufirin e mendjes së tij, ai nuk do të mund t'i përballonte dot dhe do të çmendej. Ndërsa informacionet profetike dhe hyjnore që i janë dhënë njeriut në lidhje me vdekjen dhe çka përtej saj, nuk janë për të çrregulluar sistemin e jetës, por përkundrazi për ta rregulluar atë.

Njeriu është i padrejtë e i paditur dhe shpesh herë në vend që të rendë pas të vërtetave që i bëjnë dobi, vrapon pas gjërave që kur t'i mësojë do ta dëmtojnë atë. Mirëpo mosdijenja e disa çështjeve është një mëshirë hyjnore për njeriun.

Për shembull, nëse një njeri do të mësonte se pas një viti do të vdiste, atij do t'i kthehej përmbys ekuilibri i mendjes dhe i shpirtit, nuk do ta shijonte më jetën dhe në vend që të vdesë vetëm njëherë, ai do të vdiste me mijëra



herë. E në fakt, njeriu i cili nuk e di se do të vdesë pas tre ditësh, bën një jetë më të qetë dhe më të lumtur.

Fakti që përfundimi i tij dhe udhëtimi i tmerrshëm që e pret - vdekja, varri, ringjallja, llogaria, ura e Siratit, etj., janë të panjohur, bëhet shkak i një emocioni dhe shqetësimi të madh. Nëse njeriu do të meditonte me gjithë shpirt vetëm në këtë çështje, ai nuk do të hante, nuk do pinte dhe nuk do të bënte jetë normale nga të qarat dhe përgjërimit.

Në sajë të mëshirës së Allahut të Madhëruar, ne e vazhdojmë jetën tonë me pak shkujdesje dhe harresë. Kjo do të thotë se, një sasi e caktuar shkujdesjeje, konsiderohet si mirësi për rregullin e jetës njerëzore. Por nëse kjo shkujdesje i kalon kufijtë, atëherë bëhet e papranueshme. Pra, nëse bëhet jetojmë duke harruar vdekjen, llogarinë në botën tjetër dhe ndëshkimin, fundi do të jetë një katastrofë dhe dështim i përjetshëm.

Për këtë arsye, feja jonë na mëson të zotërojmë një devotshmëri që do të na sigurojë ekuilibrin shpirtëror, në sajë të të cilit do të jetojmë midis “frikës” dhe “shpresës”, pra me frikën e ndëshkimit nga Allahu dhe me shpresën e arritjes së mëshirës së Tij në botën tjetër.




1. Duhan-i / Tymi



Duhan-i është një nga shenjat e mëdha të Kiametit, prej së cilës ka marrë emrin edhe një sure e Kuranit Fisnik. Në fakt ka pasur disa kundërshtime lidhur me faktin se Duhan-i/Tymi, për të cilin ka folur i Dërguari i Allahut si një shenjë e Kiametit, është apo jo i njëjti me Duhan-in për të cilin bëhet fjalë në këtë sure të Kuranit:

فَارْتَقِبْ يَوْمَ تَأْتِي السَّمَاءُ بِدُحَانٍ مُّبِينٍ ﴿١٠﴾ يَغْشَى النَّاسَ
هَذَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١١﴾ رَبَّنَا اكْشِفْ عَنَّا الْعَذَابَ إِنَّا مُؤْمِنُونَ ﴿١٢﴾
أَنَّى لَهُمُ الذِّكْرَى وَقَدْ جَاءَهُمْ رَسُولٌ مُّبِينٌ ﴿١٣﴾



“Andaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë, që do t’i mbulojë njerëzit, (e do t’u thuhet): «Ky është dënim i dhembshëm!» (Mohuesit do të thonë): «O Zoti ynë, lirona prej dënimit! Ne tashmë besojmë!» E si mund të përfitojnë ata nga këshilla, ndërkohë që më parë atyre u pat ardhur një i Dërguar me shpjegime të qarta.” (Duhan, 10-13)

Mendimi i parë:

Sipas mendimit të Abdullah ibn Mes'udit  dhe shumicës, kur i Dërguari i Allahut , pa se idhujtarët e Mekës i shtuan torturat ndaj myslimanëve, ai iu lut Allahut të Madhëruar që t'i ndëshkojë ata me uri dhe Allahu ia pranoi lutjen. Për rrjedhojë banorët e Mekës pësuan një zi të madhe buke. Idhujtarët e Mekës, të cilët u detyruan të hanin cofëtina dhe kocka nga kjo uri, nuk po shikonin më nga sytë dhe përreth tyre shihnin vetëm tym. Për këtë arsye, ata shkuan tek i Dërguari i Allahut , dhe i kërkuan që ai t'i lutej Allahut për t'i shpëtuar nga kjo fatkeqësi, duke i premtuar se nëse do të përfundonte uria, ata do t'i besonin atij.

Mirëpo idhujtarët e pagdhendur, me t'u lehtësuar prej vështirësive në sajë të lutjes së Profetit , filluan përsëri t'i torturonin dhe ofendonin myslimanët. Sipas Abdullah ibn Mes'udit , kuptimi i Duhan-it/Tymit, që përmendet në Kuran, është tymi që idhujtarët shikonin përreth tyre për shkak të urisë së madhe.

Ibn-i Mes'udi  ka thënë:

Fisi i Kurejshëve u vonua të hyjë në Islam. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut , bëri një lutje kundër tyre dhe ata i kaploi zia e bukës, aq sa atë vit u këputën fare, hëngrën cofëtina e brejtën kocka. Ebu Sufjani erdhi tek i Dërguari i Allahut , dhe tha:

“O Muhamed! Ndër ato (mësimet) që ke sjellë ti, bëjnë pjesë edhe (kujdesi për) të afërmit. Mirëpo njerëzit e tu po shkatërrohen. Lutju Allahut tashmë!”

I Dërguari i Allahut , ose Ibn-i Mes'udi , lexuan ajetin:

“Andaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë!..”

(Duhan, 10)

Më vonë, Kurejshët iu kthyen përsëri mohimit të tyre. Por ndëshkimi i kthimit të tyre, bëhet i ditur në këtë urdhër të Allahut të Madhëruar:

“Ditën, kur do t'i mbërthejmë ata me forcën më të madhe, Ne do të hakmerremi.” (Duhan, 16)

Kjo hakmarrje u realizua ditën e Bedrit.

Një prej transmetuesve të këtij hadithi, Mansuri, shton këtë pjesë:



“I Dërguari i Allahut u lut dhe atyre iu dha shi. Ata u begatuan me shi të bollshëm shtatë ditë e shtatë net. Mirëpo kësaj here njerëzit u ankuan për shiun e shumtë. Prandaj Profeti ﷺ u lut duke thënë: «O Allah! Bëje shiun të bjerë përreth nesh, jo mbi ne!» Pas kësaj retë mbi ta u hapën menjëherë dhe shiu filloi të bjerë mbi zonat përreth.”¹⁰⁸

Këtu duhet bërë kujdes edhe në faktin se Profeti ﷺ, i cili u dërgua si mëshirë për botët, nuk është lutur kurrë kundër idhujtarëve për shkak të padrejtësive që i bënin vetë atij, por për shkak se ata e përgënjeshtronin Islamin dhe tregoheshin kryeneçë ndaj Allahut. Prandaj edhe më pas ai lutej që fatkeqësia që binte mbi ta të merrte fund, me shpresën se ata do të nderoheshin me Islam. Pra i gjithë shqetësimi dhe dëshira e Profetit ﷺ ishte shpëtimi i përvetshëm i njerëzimit.

Mendimi i dytë:

Sipas disa sahabëve si Abdullah ibn Abbasi dhe Abdullah ibn Omeri رضي الله عنهما, ky “duhan” është “tymi” që do të mbulojë botën para Kiametit. Këtë mendim e kanë përvetësuar edhe disa mufesirë si Ibn-i Kethiri, etj.

Nisur nga kjo, në kohën kur të afrohet Kiameti, nga qielli do të zbresë një tym i cili do të mbulojë gjithë botën dhe do të vazhdojë për dyzetë ditë. Për pasojë, toka do të nxehet jashtë mase. Besimtarët do të ndikohen shumë pak nga ky tym, sikur t’i kapë një rrufë e lehtë, ndërsa mohuesit dhe hipokritët do të tronditen shumë e do të bëhen si të dehur.¹⁰⁹

2. Dexhali

“Dexhal” do të thotë gënjeshtar, hileqar, dikush që e përzien të vërtetën me gënjeshtren, të mirë me të keqen, mashtrues, etj. Lidhur me Dexhalin në Kuran nuk gjendet ndonjë informacion. Por nga hadithet e Profetit ﷺ mësojmë se ai është një mashtrues e gënjeshtar i madh që do të shfaqet në kohën afër Kiametit dhe në sajë të disa aftësive dhe mundësive që i ka dhënë Allahu, dhe do të bëjë disa gjëra të jashtëzakonshme. Në këtë mënyrë, ai do t’i devijojë disa njerëz nga e vërteta.

Neuwas ibn-i Sem’an رضي الله عنه tregon:

108. Buhari, Istiska, 13, Tefsir, 30, 44/2. Shih. Muslim, Munafikin, 39, 40; Ahmed, I, 431, 441.

109. shih. Metin Yurdagur, “Duhan”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, IX, 547.

Një mëngjes, i Dërguari i Allahut ﷺ, foli gjatë e gjerë në lidhje me Dexhalin. Në fund u lodh dhe e uli zërin. Më pas filloi të flasë përsëri me zë të lartë. Duke u nisur nga mënyra se si e tregonte, ne kujtuam se Dexhali kishte ardhur deri tek hurmat përreth Medinës. Kur shkuam përsëri tek Profeti ﷺ, ai e kuptoi hidhërimin tonë dhe pyeti:

“Si është puna?”

Ndërsa ne i thamë:

“O i Dërguar i Allahut! Në mëngjes folët për Dexhalin. Por për shkak se ju flisnit herë me zë të lartë, e herë me zë të ulët, ne pandehëm se Dexhali ka ardhur deri tek hurmat.”

I Dërguari i Allahut ﷺ sqaroi:

“Frikësohem për ju në lidhje me Dexhalin, më tepër se prej çdo gjëje. Nëse Dexhali del kur jam ende në mesin tuaj, unë do t’ia prish lojën dhe do t’ia shkatërroj argumentet (e rreme). Nëse ai del pasi të jem larguar prej mesit tuaj, atëherë gjithsecili duhet ta ruajë veten prej tij. Në fakt, Allahu i Madhëruar do t’i ruajë besimtarët prej tij.

Dexhali do të ketë flokë kaçurrela, njërin sy të verbuar dhe do t’i ngjajë Abduluzza ibn Katanit (i cili ka vdekur në kohën e injorancës). O robër të Allahut, ruajeni besimin tuaj dhe rezistoni!” Ne pyetëm:

“O i Dërguar i Allahut! Sa kohë do të qëndrojë Dexhali në tokë?”

Ai tha:

“Dyzet ditë! Një ditë do të jetë sa një vit, një ditë tjetër sa një muaj, një ditë tjetër sa një javë, ndërsa ditët e tjera sa ditët që i dini edhe ju.”

Ne pyetëm përsëri:

“O i Dërguar i Allahut! A do të mjaftojnë namazet e një dite, kur ajo të jetë sa një vit?”

“Jo, ju do t’i llogaritni dhe do t’i caktoni namazet sipas asaj dite!” - tha ai.

“O i Dërguar i Allahut! Sa do të jetë shpejtësia e tij në tokë?” - pyetëm ne përsëri.

Ndërsa Profeti ﷺ u përgjigj:

“Ai kalon pranë njerëzve si reja që e shtyn era. Ai u thotë njerëzve se



është zot, duke kërkuar që ata t'i besojnë, e ata i besojnë. Ai e urdhëron qiellin të lëshojë shi dhe ai lëshon shi. E urdhëron tokën të mbijë bimë, e ajo mbin bar e livadhe. Ndërsa kafshët, që njerëzit i kanë lëshuar të kullotin, kthehen më të pashme, më të shëndosha e me më shumë qumësht.

Pastaj shkon tek disa njerëz të tjerë dhe i fton t'i besojnë atij. Mirëpo ata nuk i besojnë dhe ia refuzojnë kërkesën. Ai largohet prej tyre. Por në mëngjes, uji i tyre shterohet, livadhet dhe bari thahen e kafshët iu ngordhin.

Dexhali shkon tek disa rrënoja dhe thotë: «Nxirri në shesh thesaret e tua!». Pastaj thesaret e rrënojave shkojnë pas Dexhalit si bletët pas mbretëreshës së tyre.

Më pas Dexhali thërret një djalosh trim dhe e ndan atë më dysh me shpatë. Pjesët e trupit të tij bien njëra në një anë, e njëra në anë tjetër. Pastaj e thërret atë dhe djaloshi kthehet tek ai me fytyrë të qeshur.

Ndërkohë që Dexhali vazhdon me këto punë, Allahu i Madhëruar dërgon Mesihun, birin e Merjemes عليه السلام.

Mesihu do të zbresë pranë minares së bardhë në lindje të Damaskut, i veshur me dy rroba me ngjyra dhe i mbështetur me duar mbi krahët e dy melekëve. Kur Mesihu e ul kokën poshtë me fytyrën që i shkëlqen, nga flokët e tij pikojnë djersë, e kur e ngre kokën prej tij rrjedhin pika të ndritshme si perla. Mohuesit që ndjejnë aromën e frymës së tij vdesin menjëherë. E fryma e tij arrin menjëherë aty ku ai sheh.

Mesihu i vihet pas Dexhalit, e kap dhe e vret atë në Babulud (në afërsi të Kudsit/Jerusalem). Më pas Isai عليه السلام shkon tek disa njerëz, të cilët Allahu i Madhëruar i ka ruajtur prej të keqes së Dexhalit, dhe duke ua ledhatuar fytyrat u thotë atyre se fitnja e Dexhalit mori fund dhe se ata i presin grada të larta në Xhenet...” (Muslim, Fiten, 110)¹¹⁰



Padyshim se fitneja e Dexhalit do të jetë më e madhja që biri i njeriut do të shohë mbi tokë. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, shprehet:

“Prej kur është krijuar Ademi عليه السلام e deri në ditën kur do të bëhet Kiameti, nuk do të ketë asnjë fitne më të madhe se Dexhali.” (Muslim, Fiten, 126)¹¹¹

110. shih. Tirmidhi, Fiten, 59; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.



111. shih. Ahmed ibn-i Hanbel, Musned, IV, 19-21.


Për këtë arsye, të gjithë profetët u kanë folur popujve të tyre dhe i kanë paralajmëruar ata në lidhje me këtë fitne.¹¹² Po kështu edhe Profeti ﷺ ka kërkuar strehim tek Allahut prej fitnes së Dexhalit. Ai na ka porositur edhe ne që të bëjmë të njëjtën gjë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, na ka lajmëruar se para daljes së Dexhalit të vërtetë, prej ummetit të tij “do të dalin rreth tridhjetë Dexhalë të remë”, të cilët do ta prezantojnë veten e tyre si profetë, duke u thënë njerëzve: “Unë jam i dërguari i Allahut!”¹¹³ Dhe me të vërtetë që, gjatë gjithë historisë kanë dalë shumë mashtrues me cilësi të tilla, të cilët Allahu i Madhëruar i ka shkatërruar. Padyshim se edhe Dexhali i vërtetë do të pësojë të njëjtin përfundim.



Rib'ij ibn Hirash  transmeton:

Së bashku me Ebu Mes'ud el-Ensariun  shkuam tek Hudhejfete ibn Jemani . Ebu Mes'udi i tha atij:

“Më trego çfarë ke dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut , për Dexhalin?”

Hudhejfete  tha:

“Dexhali do të dalë me të vërtetë dhe me vete do të ketë ujë dhe zjarr. Sa i përket asaj që (disa nga) njerëzit e shohin si ujë, në të vërtetë ai është zjarr që digjet. E sa i përket asaj që njerëzit e shohin si zjarr, në të vërtetë ai është ujë i ftohtë e i pijshëm. Kush nga ju e arrin (Dexhalin), le të qëndrojë në anën e atij që njerëzit e shohin si zjarr, sepse ai do të jetë ujë i ëmbël, i ftohtë, e i pijshëm.” (Buhari, Enbija, 50, Fiten, 26; Muslim, Fiten, 105, 108)

Sipas një transmetimi që përmendet në Sahihun e Muslimit, i Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Unë e di shumë mirë se çfarë ka me vete Dexhali. Ai ka dy lumenj. Njëri duket i bardhë si ujë, e tjetri si zjarr që digjet. Nëse dikush e arrin Dexhalin, le të shkojë tek lumi që i ngjan zjarrit e të mbyllë sytë. Më pas të ulë kokën e të pijë prej tij, sepse ai është ujë i ftohtë.”

112. shih. Tirmidhi, Zuhd, 3; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.

113. shih. Buhari, Fiten, 25; Muslim, Fiten, 84.



Ndërsa në transmetime të tjera thuhet se: *“Dexhali do të ketë me vete dy gjëra që ngjajnë me Xhenetin dhe Xhehenemin. Çka quan Xhenet, në të vërtetë është zjarr, pra Xhehenem.”* (shih. Muslim, Fiten, 109)

Allahu i Madhëruar, i Cili zjarrin si një mal të Nemrudit e ktheu në kopsht trëndafilash për Ibrahimin عليه السلام, do ta kthejë në ujë të freskët e të pijshëm edhe zjarrin e rremë të Dexhalit mashtrues, për njerëzit me besim të fortë që nuk mashtrohen prej tij. Pra zjarri i tij nuk do t'i dëmtojë aspak besimtarët e vërtetë.

Padyshim se Dexhali është një sprovë shumë e madhe, të cilit i janë dhënë mundësi të jashtëzakonshme për të sprovuar njerëzit, me qëllim që të dallohet qartë besimtari i vërtetë nga ai i rremë. Nisur nga kjo, besimtarët e vërtetë duhet ta përgënjeshetrojnë Dexhalin dhe nuk duhet të kenë frikë prej zjarrit që ai sjell me vete, sepse në të vërtetë ai nuk është zjarr por mëshirë, nuk është Xhehenem, por Xhenet.¹¹⁴



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nuk do të mbetet asnjë vend pa u shkelur nga Dexhali, përveç Mekës dhe Medinës. Melekët do të rreshtohen në të gjitha rrugët e Mekës dhe Medinës dhe do t'i mbrojnë këto dy qytete. Dexhali do të zbresë në një vend ranor e të shkretë. Më pas, Medina do të lëkundet tre herë dhe Allahu i Madhëruar do të nxjerrë jashtë saj mohuesit dhe hipokritët.” (Muslim, Fiten, 126)¹¹⁵

Këtu lajmërohem i se Dexhali do të shkelë të gjitha vendet dhe zonat e banuara në tokë, përveç Mekës dhe Medinës. Të gjithë njerëzit do të kalojnë një sprovë shumë të madhe. Allahu i Madhëruar do ta mbrojë prej

114. Këtu duhet të theksojmë se ashtu siç është Kiameti një ndodhi e jashtëzakonshme për të gjithë botën, është e natyrshme që edhe shenjat që e paralajmërojnë atë të kenë aspektet e tyre të jashtëzakonshme. Për rrjedhojë, nuk duhet të habitemi nga fakti se në kohën pranë Kiametit do të shfaqen disa fenomene që janë jashtë imagjinatës dhe botëkuptimit tonë. Për shembull, sot shihet qartë se shkencat dhe teknologjia kanë arritur gjëra që para 40 apo 50 vitesh as që mund të mendoheshin. Kështu, edhe shenjat e Kiametit për të cilat lajmërohem i në Kuran dhe hadithe, do të realizohen kur të vijë koha e caktuar, sepse për Allahun e Madhëruar nuk ekziston asnjë vështirësi.

115. shih. Buhari, Fedailu'l-Medine, 9, 26, 27, Teuhid, 31; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.



Dexhalit zonën e haremit, pra dy qytetet e shenjta, Mekën dhe Medinën, si dhe myslimanët e sinqertë që nuk do t'i braktisin këto dy qytete.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“70 mijë persona me tajlasan,¹¹⁶ prej hebrenjve të Isfahanit, do t'i shkojnë pas Dexhalit.” (Muslim, Fiten, 124)

Midis atyre, që e besojnë dhe e vlerësojnë Dexhalin, janë edhe hebrenjtë. Ashtu siç do të shkelë në çdo vend të botës, Dexhali do të shkojë edhe në Isfahan. Aty do të mbështetet prej 70 mijë personave me tajlasan, të cilët do të jenë hebrenj.



Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte në mes të një grupi, ndër të cilët gjendej edhe Ummu Sherik. Duke folur në lidhje me Dexhalin, mes të tjerash tha:

“Njerëzit do të ikin prej Dexhalit e do të strehohen në male.” Mirëpo, fakti që edhe luftëtarët trima të Islamit nuk do t'i bëjnë ballë Dexhalit e do të ikin prej tij, e hidhëroi thellësisht Ummu Sheriken. Për këtë arsye, ajo pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Ku do të jenë arabët atë ditë?”

Profeti ﷺ tha:

“Ata do të jenë shumë pak atë ditë.”

Me këtë ai deshi të thotë se ata nuk do ta përballojnë dot Dexhalin, prandaj do të ikin me qëllim që të shpëtojnë prej fitnes dhe së keqes së tij. (Muslim, Fiten, 125)¹¹⁷



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nxitoni në punë të mira pa ardhur këto shtatë gjëra. Apo mos vallë po prisni:

116. Tajlasan: Pjesa e shallit që rrethohet si çallmë pas kokës dhe që varet pas si bisht

117. Shih. Tirmidhi, Menakib, 69; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.



1. Varfërinë që të bën të harrosh (adhurimin dhe kufijtë e hallallit e harramit),

2. Pasurinë që të tërbon,

3. Sëmundjen që të shkatërron,

4. Pleqërinë që të dobëson mendjen e të bën të flasësh përçart,

5. Vdekjen që të vjen papritur,

6. Fitnen më të keqe që pritët të vijë, Dexhalin,

7. Dhe Kiametin

E Kiameti është katastrofa më e jashtëzakonshme dhe më e dhimbshme.” (Tirmidhi, Zuhd, 3/2306)



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kur të shfaqet Dexhali, një prej besimtarëve do të shkojë drejt vendit ku ndodhet ai. Mirëpo, njerëzit e armatosur të Dexhalit do t’i dalin para dhe do ta pyesin:

«Ku kërkon të shkosh?»

«Tek ai personi që ka dalë (rishtazi)!» -thotë besimtari.

Njerëzit e Dexhalit thonë:

«A nuk i beson ti zotit tonë?»

«Zoti ynë nuk ka ndonjë anë të fshehtë, që ne ta braktisim Atë e t’i besojmë dikujt tjetri.» -thotë besimtari.

Pastaj disa prej njerëzve të Dexhalit do të urdhërojnë:


«Vriteni!»

Ndërsa një pjesë tjetër prej tyre do të thonë:

«A nuk ua ka ndaluar zoti jua vrasjen pa dijeninë e tij!»

Më pas do ta marrin besimtarin dhe do ta çojnë tek Dexhali. Kur besimtari do shohë Dexhalin, do thërrasë besimtarët e tjerë:

«O besimtarë! Ky person është Dexhali për të cilin ka folur i Dërguari

i Allahut !» Atëherë, Dexhali do t'iu drejtohet njerëzve të vet e do t'iu thotë:

«Rriheni mirë këtë njeri!»

Sapo ata ta kapin për ta rrahur, Dexhali do t'iu thotë:

«Kapeni dhe çajani kokën!»

Pasi e rrahin fort duke e goditur në shpinë e në bark, Dexhali do ta pyes:

«A nuk më beson mua?»

«Ti je Mesihu i rremë!» -do t'i thotë besimtari.¹¹⁸

Më pas, me urdhrin e Dexhalit ata do e presin besimtarin më dysh me sharrë nga koka tek këmbët. Pasi Dexhali do kalojë përmes trupit të besimtarit, të ndarë në dy pjesë, do të urdhërojë:

«Ngrihu në këmbë!»

E ai do të drejtohet dhe do të ngrihet. Dexhali do ta pyes përsëri:

«A më beson?»



Besimtari do të thotë:

«Mendimi im në lidhje me ty vetëm se u përforcua!».

Më pas do të kthehet nga populli dhe do të thotë:

«O njerëz! Pas meje, ai nuk do të mund të vrasë dhe të ringjallë më askënd!»

Dexhali do të tentojë ta therë personin në fjalë. Mirëpo Allahu i Madhëruar do ta shndërrojë në bakër besimtarin, prej fytit deri në klavikul.

118. Ashtu siç njihet Isai , si Mesihu, ashtu edhe Dexhalit i thonë Mesih (Mesihu'd-Dexhxhal). Fjala Mesih ka kuptimin "të fshish" dhe rrjedh prej fjalës "mes'h". Fakti që Dexhali përmendet me këtë emër, është për shkak se mirësia do të fshihet e do të merret prej tij, ose për shkak se një anë e fytyrës së tij bashkë me syrin është e rrafshët (si e fshirë). (shih. Buhari, Ta'bir, 11, 33) Thuhet se Dexhali përmendet si Mesih, edhe për shkak se ai udhëton shumë dhe fshin çdo distancë. Ndërsa Isai , quhet Mesih për shkak se ai i shëron njerëzit e sëmurë duke i fërkuar (fshirë) me dorën e tij të bekuar. Pra, sa kuptimplotë është fakti se Allahu do ta fshijë një Mesih me një Mesih tjetër. Kurani shprehet qartë se të gjitha besimet e kota dhe besëtytnitë, përfshi këtu edhe Dexhalin, do të eliminohen e do zhduken: **“Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zhduket!..”** (Enbija, 18)



Për këtë arsye Dexhali do ta ketë të pamundur therjen. Pas kësaj, Dexhali do ta kapë atë nga duart e këmbët dhe do ta hedhë diku. Njerëzit do të mendojnë se ai e hodhi në Xhehenem, por ai është hedhur në Xhenet.”

I Dërguari i Allahut ﷺ, shtoi:

“Ja pra, për Zotin e botëve, ky besimtar është shehidi/dëshmori më i rëndësishëm ndër të gjithë njerëzit!” (Muslim, Fiten, 113)¹¹⁹

Ka mendime se ky besimtar që e njihte mirë Dexhalin, hilet dhe mashtrimet e tij, mund të ketë qenë Hidri. Fakti që ky besimtar thotë: *“Zoti ynë nuk ka ndonjë anë të fshehtë, që ne ta lëmë Atë, e t’i besojmë dikujt tjetri.”*, tregon se besimtarët e njohin Allahun e Madhëruar me të gjitha cilësitë e Tij, nuk dyshojnë kurrë në lidhje me ekzistencën, njëshmërinë dhe fuqinë e Tij dhe besojnë në mënyrë absolute se Ai është i përsosur dhe pa të meta.

Ngjarja tregon qartë se sa e rëndësishme është që zemrat të mbushen me frymëzimin e njohjes së Allahut, për t’i bërë ballë fitneve dhe rreziqeve shpirtërore. Edhe guximi i besimtarit, i cili qëndroi me trimëri përballë Dexhalit me besimin dhe diturinë e tij, tregon se sa e dobishme dhe e nevojshme është për një besimtar marrja e njohurive të Kuranit dhe Sunnetit në lidhje me fitnet e fundkohës dhe Kiametin. Njëkohësisht, ky hadith fisnik na bën të ditur se fitnja e Dexhalit do të marrë fund shumë shpejt pas daljes së tij. Prandaj detyra e besimtarëve, që do të sprovohen me këtë fitne, është kapja fort pas besimit dhe rezistenca përballë Dexhalit me guximin e besimit, pa u kapluar nga dobësia dhe frika.

Cilësitë e Dexhalit

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Të gjithë profetët i kanë lajmëruar popujt e tyre ndaj rrezikut të Dexhalit gënjeshtar e qorr. Dijeni se njëri prej syve të tij është qorr dhe Zoti juaj i Lartmadhërisëm nuk është me një sy. Midis dy syve të Dexhalit shkruhet kafir (ke-fe-re)” (Buhari, Fiten, 26, Teuhid, 17; Muslim, Fiten, 101, 102)¹²⁰

“...Syri i tij (qorr) është si një kokërr rrushi që pluskon.” (Buhari, Fiten, 26, Teuhid, Teuhid, 17; Muslim, Iman, 274)¹²¹

119. shih. Buhari, Fiten, 27.

120. shih. Ebu Daud, Melahim, 14, Sunnet, 25-26; Tirmidhi, Fiten, 56, 62.

121. shih. Tirmidhi, Fiten, 60.

Nisur nga ky hadith dhe të tjerë të tillë, ne mund të përmbledhim disa prej cilësive të Dexhalit:

✓ Dexhali i ka të dy sytë sakat. Syri i djathtë është si kokërr rushi e plasur, ndërsa syri i majtë është plotësisht i fshirë, atij i është fikur drita e nuk sheh fare.

Krijimi i Dexhalit me cilësi që mund të shihen, të njihen dhe të kujtohen lehtë nga besimtarët, është një mirësi e veçantë e Allahut. Ata që mund të përfitojnë prej kësaj mirësie, kur të përballen me këtë sprovë të madhe, janë vetëm besimtarët me besim të palëkundur dhe të singertë.

✓ Midis dy syve të Dexhalit shkruhet fjala (arabe) “kafir” (ose ke-fe-re), me qëllim që ai të njihet si mashtrues nga besimtarët..

Edhe nëse nuk di të lexojë arabisht, çdo besimtar do ta ndjejë dhe do ta kuptojë këtë fjalë në sajë të një frymëzimi që do t’i lindë në zemër. Ndërsa ata që nuk e gëzojnë mëshirën hyjnore, edhe nëse do të dinë të lexojnë arabisht, nuk do të arrijnë ta shohin këtë fjalë.

✓ Dexhali ka me vete diçka që i ngjan Xhenetit dhe Xhehenemit, të cilën ua ka premtuar si shpërblim apo dënim atyre që do të sprovohen prej tij. Por çka ky mashtrues thotë se është Xhenet, në fakt është Xhehenem. Pra ai që hyn aty ky Dexhali thotë se është Xhenet, për shkak se i ka besuar atij dhe është mashtruar prej tij, do i duket Xhenet, por në të vërtetë do të hyjë në Xhehenem. Ndërsa ai që hidhet në Xhehenem për shkak se kundërshton Dexhalin, në të vërtetë do ketë fituar Xhenetin.

✓ Dexhali do të ketë flokë kaçurrela dhe do të jetë në moshë të re.

✓ Do të ketë trup të gjerë, por të shkurtër.¹²²

✓ Sipas gjasave, Dexhali do të dali në lindje, në Horasan, Isfahan ose në një vend midis Sirisë dhe Irakut.¹²³

✓ Dexhali nuk do të shkelë dot dy qytetet e shenjta, Mekën dhe Medinën, sepse Allahu do t’i mbrojë ato me melekët e tij.

✓ Ashtu si tridhjetë Dexhalë të remë që do të dalin para tij, edhe Dexhali i vërtetë në fillim do të thotë: “Unë jam i dërguari i Allahut”¹²⁴, pastaj do të deklarojë se është Zot.

122. shih. Buhari, Fiten, 26; Ebu Daud, Melahim, 14.

123. shih. Muslim, Fiten, 110.

124. shih. Buhari, Fiten, 25; Muslim, Fiten, 84.

✓ Për shkak se Dexhali do të jetë një sprovë e rëndë për njerëzit që do jetojnë në kohën në të cilën ai do të shfaqet, atij i janë dhënë aftësi dhe mundësi të jashtëzakonshme si lëshimi i shiut, tharja e bimëve, nxjerrja e thesareve nga toka, etj. Këto aftësi të jashtëzakonshme që do t'i jepen Dexhalit, përbëjnë një rrezik shumë të madh për ata që kanë besim të dobët.

✓ Për shkak se Dexhali do të jetë prej hebrenjve¹²⁵, edhe ndjekësit dhe mbështetësit e tij më të shumtë do të jenë prej hebrenjve.

✓ Dexhali do të mund të vrasë e të presë më dysh me sharrë vetëm një person. Më pas do ta ringjallë atë. Por pavarësisht kësaj, ai person do t'i thotë haptazi Dexhalit se është gënjeshtar dhe se e ka kuptuar që është pikërisht Dexhali që na është paralajmëruar. Pas kësaj ndodhie, ai nuk do të mund të vrasë e të ringjallë më askënd tjetër.

✓ Dexhalin do ta vrasë Isai عليه السلام, i cili do t'i japë fund edhe gjithë asaj sprove të madhe.

Për t'u ruajtur prej Dexhalit

Kërkimi i strehimit tek Allahu ndaj Dexhalit dhe sprovës së tij, është një porosi e rëndësishme që Profeti ﷺ i ka lënë ummetit të tij. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka këshilluar:

“Pasi dikush të ketë bërë teshehudin (në namaz), le të bëjë këtë lutje dhe të strehohet tek Allahu prej katër gjërave:

“O Allah! Strehohem tek Ti prej dënimit të Xhehenemit dhe dënimit të varrit, prej sprovës së jetës e të vdekjes dhe fitnes së Dexhalit!” (Muslim, Mesaxhid, 128)



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush mëson përmendësh dhjetë ajete nga fillimi i sures Kehf, është i ruajtur prej Dexhalit!” (Muslim, Musafirin, 257; Ebu Daud, Melahim, 14)

Në burimet e haditheve, shohim se është këshilluar edhe mësimi përmendësh i dhjetë ajeteve nga fundi i sures Kehf. Gjithsesi, në dhjetë ajetet e para të kësaj sureje bëhet fjalë për njohjen e Allahut të Madhëruar dhe

cilësive të Tij. Po ashtu flitet edhe për mbrojtjen që Allahu i dha As’habi Kehfit (Shokëve të Shpellës) prej Dakianusit mizor. Kjo është arsyeja pse ata të cilët do ta shohin Dexhalin, janë këshilluar të lexojnë këto dhjetë ajete.¹²⁶



I Dërguari i Allahut ﷺ, është shprehur se: “Frikësohem për ju në lidhje me Dexhalin, më tepër se prej çdo gjëje...”

Për t’u mbrojtur prej fitnes së Dexhalit, është e domosdoshme që ne të përpiqemi sa më shumë që të bëhemi besimtarë të devotshëm, të edukojmë njerëz me dije dhe sinqeritet në fe dhe të jetojmë në rrugën e drejtë të Kuranit dhe Sunetit. Vetëm njerëz të tillë do të mund të përballen me mashtruesin e quajtur Dexhal dhe në sajë të mirësisë dhe mëshirës së Allahut nuk do të mposhten prej tij dhe si përfundim do të meritojnë Xhenetin.

Padyshim se mënyra më e sigurt për të njohur Dexhalin, është njohja e Kuranit dhe Sunetit. Pra njerëzit që shfaqin pretendime fetare, mund të maten gjithmonë me këto dy burime të sigurta të fesë.

Edhe thënia e të Dërguarit të Allahut ﷺ: “...Nëse Dexhali del pasi të jem larguar prej mesit tuaj, atëherë gjithsecili duhet ta ruajë veten prej tij...”, tregon se çdo mysliman duhet ta mësojë shumë mirë fenë e tij. Nëse Islami mësohet dhe jetohet në mënyrën e duhur, myslimanin nuk do të mund ta mashtrojë as Dexhali i vërtetë e as ai i rremi.

3. Dabbetu’l-Ard

Fjala “dabbe” përdoret për qeniet që kanë nevojë të hanë e të pinë. Ndërsa “Dabbetu’l-Ard” do të thotë “gjallesa që do të dalë prej toke”. Lidhur me “Dabbetu’l-Ard”-in, që është një prej shenjave të mëdha të Kiametit, Kurani Fisnik lajmëron:

وَإِذَا وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ أَخْرَجْنَا لَهُمْ دَابَّةً مِّنَ الْأَرْضِ تُكَلِّمُهُمْ أَنَّ النَّاسَ

كَانُوا بِآيَاتِنَا لَا يُوقِنُونَ

“Dhe, kur të përmbushet Fjala Jonë kundër tyre, Ne do të

126. shih. Përkthimi dhe Komentimi i Rijadu’s-Salihin, Yaşar Kandemir, İsmail Lutfi Çakan, Raşit Kuçuk, İstanbul: 1434/2013, VII, 536-578.



bëjmë që nga Toka të dalë një kafshë, e cila do t’u flasë atyre, se njerëzit nuk u janë bindur shpalljeve Tona.” (Neml, 82)



Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Janë tre shenja që kur të shfaqen, «atëherë nuk do t’i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë, ose nuk ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij!»¹²⁷ Këto janë, lindja e Diellit nga perëndimi, Dexhali dhe Dabetu’l-Ard.” (Muslim, Iman, 249; Ahmed, II, 445)

“Kur të dalë Dabetu’l-Ard, do të ketë me vete vulën (unazën) e Sulejmanit ﷺ dhe bastunin e Musait ﷺ. Fytyrën e besimtarit do ta ndriçojë me bastun, ndërsa hundën e mohuesit/qafirrit do ta damkosë me vulë. Kur njerëzit të mblidhen në sofër, njëri do t’i thotë tjetrit, «o besimtar!» (për shkak të fytyrës së ndritshme), kurse tjetri do t’i thotë atij, «o mohues/qafir!» (për shkak të damkës në hundë). (Pra edhe besimtari, edhe qafiri do të njihen nga fytyra)” (Tirmidhi, Tesfir, 27/3187; Ibn-i Maxhe, Fiten, 31)

“Shenjat e para (të mëdha) të Kiametit, për nga radha e daljes, janë lindja e Diellit nga perëndimit dhe dalja e Dabetu’l-Ard-it në kohën e paradites. Sapo e para të dalë, tjetra do të vijë shumë shpejt pas saj.” (Muslim, Fiten, 118; Ebu Daud, Melahim, 12)



Dabetu’l-Ard është një gjallesë që do të dalë nga toka. Mirëpo lloji i kësaj gjallese nuk është shpjeguar qartë në hadithet sahih (të saktë). Dihet se ajo do t’i qortojë njerëzit duke u folur. Kjo gjallesë do të dalë në një kohë kur të jetë braktisur “urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja” dhe do të deklarojë hapur se përveç Islamit, të gjitha fetë e tjera janë të pavërteta. Madje, kjo ndodhi do t’u tregojë mohuesve në mënyrë të qartë edhe se si Allahu i Madhëruar i ringjall të vdekurit.

Dabbe do t’i njoftojë mohuesit se Kiameti është afruar. Allahu do ta bëjë këtë krijesë të flasë, duke i poshtëruar mohuesit, sepse ata janë mjeranë të cilët nuk e kanë pranuar dhe e kanë refuzuar fjalën më elokuate, pra Kuranin Fisnik, që ka përcjellë prej Zotit njeriu më i nderuar i njerëzimit,



Profeti ﷺ, i cili fliste gjuhën më të pastër. Allahu i Madhëruar do t'ua bëjë të ditur të vërtetat me gjuhën e një krijese tjetër dhe në mënyrën të cilën ata kuptojnë. Edhe nëse mohuesit do të besojnë pas kësaj, ky besim nuk do t'iu bëjë asnjë dobi.

4. Lindja e Diellit nga perëndimi

Lindja e Diellit nga perëndimi është një nga shenjat më të mëdha të Kiametit. Trupat qiellorë vazhdojnë udhëtimin e tyre në gjithësi me një rregull dhe sistem shumë preciz që prej krijimit të universit. Allahu i Madhëruar sqaron:

الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ بِحُسْبَانٍ

“Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar.” (Rahman, 5)

Dhe me të vërtetë që Dielli dhe Hëna përbëjnë dy kalendarë precizë që rrotullohen në hapësirë si manifestime të fuqisë dhe madhështisë hyjnore. I gjithë njerëzimi i organizon punët e tij në bazë të këtyre dy kalendarëve. Ata janë aq precizë, saqë nuk devijojnë qoftë edhe një sekondë dhe nuk bëjnë as vonesën më të vogël.

Çdo makineri, qoftë edhe e prodhuar me teknologjinë më të përparuar të ditëve tona, pas një farë kohe vjetrohet, nxjerr defekte dhe në fund bëhet e papërdorshme. Ndërsa Dielli dhe Hëna vazhdojnë udhëtimin e tyre të përcaktuar për to, pa devijuar aspak në rrugën e tyre, që prej kohës që janë krijuar.

Mbi të gjitha, ky rregull kaq preciz nuk vlen vetëm për Diellin dhe Hënën. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar shpjegon:

الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ طِبَاقًا مَّا تَرَىٰ فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِن تَفَٰوُتٍ
فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ

“Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë të çarë (hapësirë bosh)?” (Mulk, 3)

Kur Allahu i Madhëruar, si Krijuesi dhe Pronari i universit, të dëshirojë t'i japë fund jetës së dynjasë, Ai do ta prishë këtë rregull preciz që ka krijuar dhe organizuar, po me vullnetin dhe llogarinë e Tij të përsosur. Dhe pikë-



risht atëherë Dielli do të lindë nga perëndimi. Njerëzit që do ta shohin këtë fenomen, do të kuptojnë menjëherë se botës i ka ardhur fundi. Mirëpo, për shkak se tashmë është mbyllur dera e pendimit, besimi që ata do të shfaqin nuk do t'iu bëjë asnjë dobi.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nuk do të bëhet Kiameti derisa të lindë Dielli nga perëndimi. E kur Dielli të lindë nga perëndimi, njerëzi do ta shohin dhe do të besojnë të gjithë përnjëherësh. Kjo është pikërisht koha që na bën të ditur ky ajet fisnik:

«...Ditën kur të vijnë disa shenja të Zotit tënd, atëherë nuk do t'i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij!...» (En'am, 158)” (Buhari, Rikak, 40; Ahmed, II, 369)¹²⁸


“Atij që pendohet para se të lindë Dielli nga perëndimi, Allahu ia pranon pendesën!” (Muslim, Dhikr, 43)

“Allahu i Madhëruar hap dorën e Tij natën për të pranuar pendimin e atij që ka bërë gjynahe ditën. Po ashtu, Ai hap dorën e Tij ditën për të pranuar edhe pendimin e atij që ka bërë gjynahe natën. E kështu do të jetë derisa të lindë dielli nga vendi ku perëndon, pra deri në Kiamet.” (Muslim, Teube, 31)

Domethënë, çdo gjë ka vlerë kur ajo bëhet në kohën e vet. E meqenëse Kiameti një ditë do të bëhet patjetër dhe të gjithë do të japin llogari në Ahiret, për çdo gjë që kanë vepruar ose jo në dynja, atëherë ajo që duhet të bëjmë është e qartë: të qëndrojmë larg gjynaheve në këtë jetë dhe të bëjmë një teube/pendesë të sinqertë, të kapemi fort pas besimit dhe të bëjmë vepra të mira, duke e forcuar besimin tonë me mirësi e duke e fortifikuar si një kala të fortë e të pamposhtur.


5. Zbritja e Isait ﷺ


Isai ﷺ u dërgua si profet tek bijtë e Israelit (hebrenjtë). Në sajë të madhësisë dhe fuqisë së Allahut, ai ka ardhur në jetë pa baba dhe ka

realizuar shumë mrekulli. Në fillim hebrenjtë e akuzuan si gënjeshtar, e më pas deshën ta kryqëzonin. Mirëpo Allahu i Madhëruar e shpëtoi atë dhe e ngriti pranë Vetes. Lidhur me Isain , në Kuranin Fisnik sqarohet:

“Dhe, për fjalët e tyre: «Ne e vramë Mesihun - Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut!» (ne i kemi bërë të mallkuar hebrenjtë) **Por, ata as e vranë, e as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.”** (Nisa, 157-158)

“**(Kujtoje, o Muhamed) kur Allahu tha: «O Isa! Unë do të të marr, do të të ngre pranë Meje dhe do të të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do t’i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit. Pastaj, të gjithë do të ktheheni tek Unë dhe do të gjykoj midis jush për çështjet që jeni grindur.»**” (Al-i Imran, 55)

Nisur nga këto ajete, dijetarët Islam janë të një mendimi: Isai  është ngritur në qiell. Mirëpo në lidhje me çështjen se a është ngritur vetëm me shpirt, apo me shpirt dhe me trup, ka pasur mendime të ndryshme.

Gjithashtu, në Kuranin Fisnik ka ajete që aludojnë për zbritjen e Isait  në tokë. Përveç ajeteve që përmendëm më sipër, janë edhe këto ajete ku lajmërohet:

“Të gjithë ithtarët e Librit do t’i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe, në Ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre.” (Nisa, 159)

“Në të vërtetë, Isai është shenjë e Orës (së Kiametit), në ardhjen e të cilës mos dyshoni kurrsesi. Pra, ndiqmëni mua, kjo është rruga e drejtë!” (Zuhruf, 61)



Ndërsa Profeti  ka thënë:

“Betohem në Allahun e Lartëmadhëruar, i Cili ka në dorë jetën time! Është e afërt dita kur Isai, i biri i Merjemes, do të zbresë mes jush si një



gjykatës i drejtë, do të thyejë kryqin (duke deklaruar pavlefshmërinë e krishterimit), do të vrasë derrin¹²⁹ dhe do të heqë xhizjen (sepse Islami do të jetë e vetmja fe). Në atë kohë, pasuria do të shtohet aq shumë, sa askush nuk ka për ta pranuar (si zekat apo sadaka)...” (Buhari, Buju, 102, Medhalim, 31, Enbija, 49; Muslim, Iman, 242, 243, 247, Haxh, 216, Fiten, 34, 39, 110)¹³⁰

“Një grup prej ummetit tim do të vazhdojë luftën për hir të së vërtetës, duke qenë fitimtarë, deri në Ditën e Kiametit. Atë kohë, do të zbresë Isai, biri i Merjemes, dhe prijësi i myslimanëve do t’i thotë:

«Eja na e fal namazin!»

Mirëpo, Isai عليه السلام do të thotë:

«Jo, ju jeni prijës të njëri-tjetrit, si një mirësi e Allahut për këtë ummet!»

(Muslim, Iman, 247)



Lidhur me zbritjen e Isait عليه السلام në tokë dhe zbatimin e ligjeve Islame nga ana e tij, ka edhe shumë hadithe të tjera.¹³¹

Fakti që Muhamedi ﷺ është profeti i fundit dhe se pas tij nuk do të vijë më asnjë profet tjetër, nuk bie aspak ndesh me zbritjen e Isait عليه السلام, sepse ai nuk do të zbresë në tokë si një profet që do të kumtojë urdhra të reja të Allahut të Madhëruar, por si një “gjykatës i drejtë” i cili do të zbatojë fenë e Profetit ﷺ.



Në veprat burimore flitet edhe për luftën që hebreujtë do të bëjnë me myslimanët në kohën afër Kiametit. Madje shënohet se kjo luftë do të ndodhë pas zbritjes së Isait عليه السلام.

129. Atë kohë, Isai عليه السلام, do ta ndalojë aq ashpër ngrënien e mishit të derrit, saqë për të treguar rëndësinë e kësaj, do të urdhërojë të vriten të gjithë derrat. Me anë të këtij urdhri qortohen ashpër edhe ata që megjithëse pretendojnë se janë në rrugën e tij, e bëjnë të lejuar ngrënien e mishit të derrit. Po ashtu, këtu tregohet se Isai عليه السلام do të shkatërrojë edhe simbolet e shenjta të të krishterëve, duke e deklaruar të pavlefshëm krishterimin.

130. shih. Ebu Daud, Melahim, 12, 14 (4324); Tirmidhi, Fiten, 21, 54, 59, 62.

131. Muhamed Enuershah el-Keshmiri (v. 1352/1933), lidhur me këtë çështje ka mbledhur 101 transmetime, 75 prej të cilave janë hadithe “merfu”, pra fjalët e Profetit ﷺ. Këto transmetime i ka mbledhur në veprën e tij të quajtur *Et-Tasrih bima Teutateri fi-Nuzuli'l-Mesih* (Halep, 1385/1965).

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ju patjetër që do të luftoni me hebrenjtë dhe do t’i urisni ata. Madje edhe një shkëmb do të thërrasë:

«O mysliman! Ja ku është një hebre i fshehur pas meje. Eja dhe vrite atë!» (Muslim, Fiten, 79-82)

Pra, atë ditë, çfarëdo gjëje pas të cilës ata do të fshihen ata, Allahu i Madhëruar do ta bëjë të flasë. Në hadithe të tjera thuhet:

“Hebrenjtë do të luftojnë me ju dhe ju do t’i mposhtni ata...” (Muslim, Fiten, 81)

“Nuk do të bëhet Kiameti, derisa hebrenjtë të luftojnë me myslimanët dhe myslimanët t’i vrasin ata! Madje, kur një hebre të fshihet pas një guri apo një druri, guri apo druri do të thonë:

«O Mysliman, o robi i Allahut! Ja ku është një hebre i fshehur pas meje. Eja dhe vrite atë!»

Vetëm pema e quajtur Gargad nuk do të tregojë, sepse ajo është prej pemëve të hebrenjve.” (Muslim, Fiten, 82. Shih. Buhari, Xhihad, 94, Menakib, 25)

Synimi kryesor i Isait ﷺ është Dexhali dhe ndjekësit e tij. Për shkak se Dexhali do të jetë me origjinë hebraike, ndjekësit e tij kryesorë do të jenë hebrenjtë. Për këtë arsye, Isai ﷺ do të jetë shumë i zemëruar me ta dhe do t’i zhdukë nga faqja e dheut. Kjo tregon se lufta e hebrenjve me myslimanët do të vazhdojë deri në atë kohë.

6. Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët

Pas Dexhalit, mbase fitnja më e madhe për njerëzit do të jenë Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët. Në Kuranin Fisnik Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët përmenden në dy vende:

E para është ndodhia e popullit të Je’xhuxh-Me’xhuxhëve, të cilët krijonin trazira në tokë dhe të cilët Dhulkarnejni ﷺ i mbylli në vendin ku ndodheshin, me anë të një muri/pengese prej hekuri, në mënyrë që ata të mos dilnin më prej aty.¹³²

Ndërsa e dyta, shpjegohet në këto ajete që paralajmërojnë hapjen e pengesës së Je’xhuxh-Me’xhuxhëve, prej së cilës ata do të dalin e do të vërshojnë prej çdo kodre:

132. shih. Kehf, 94-98.



حَتَّىٰ إِذَا فُتِحَتْ يَأْجُوجُ وَمَأْجُوجُ وَهُمْ مِّن كُلِّ حَدَبٍ يَنْسِلُونَ

“Dhe, kur të dalin Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët, e të vërshojnë prej çdo lartësie.” (Enbija, 96)

وَأَقْرَبَ الْوَعْدِ الْحَقِّ فَإِذَا هِيَ شَاخِصَةٌ أَبْصَارُ الَّذِينَ كَفَرُوا

يَا وَيْلَنَا قَدْ كُنَّا فِي غَفْلَةٍ مِّنْ هَذَا بَلْ كُنَّا ظَالِمِينَ

“Dhe të afrohet premtimi i vërtetë (Kiameti), atëherë sytë e atyre që nuk kanë besuar, do të zgurdullohen, (e thonë): «Mjerë për ne! Ne kemi qenë të pavëmendshëm ndaj kësaj dhe e kemi ngarkuar veten me gjynahe».” (Enbija, 97)

Këta dy popuj do të përhapen në tokë dhe do të sjellin trazira për një farë kohe.



Sipas një transmetimi të nënës sonë Zejneb bint-i Xhahsh رضي الله عنها, një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ, erdhi pranë saj duke u dridhur nga frika dhe tha:

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër! Mjerë arabët prej së keqes që po afrohet! Sot në pengesën e Je’xhuxhëve dhe Me’xhuxhëve është hapur një vend kaq!” dhe e tregoi duke bashkuar në formë rrethore gishtin e madh me atë tregues.

Pas kësaj, nëna jonë Zejnebe رضي الله عنها pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! A do të shkatërrohemi edhe nëse midis nesh do të ketë të mirë?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Po! Atëherë kur të këqijat dhe gjynahet të shtohen!” (Buhari, Fiten, 4, 28; Muslim, Fiten, 1)¹³³



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“(Pasi Isai عليه السلام, të ketë vrarë Dexhalin) Allahu i Madhëruar e urdhëron Isain عليه السلام, duke thënë: «Unë krijova robër që nuk mund t’i vrasë askush. Prandaj mbliidhi edhe njerëzit e tjerë dhe dërgoi në (malin) Tur!»

Allahu i Madhëruar lëshon Je’xhuxh-Me’xhuxhët në tokë dhe ata vërshojnë e zbresin me shpejtësi prej lartësive. Të parët e tyre arrijnë tek Liqeni Taberije dhe e pinë të gjithë ujin e tij. Kur të fundit e tyre arrijnë në të njëjtin vend dhe thonë: «Më parë këtu ka pasur shumë ujë!»

Isai عليه السلام dhe besimtarët që janë bashkë me të, mbeten të bllokuar në Malin Tur. Çdo njëri prej tyre vlen më tepër se një ka, ose më shumë se një-qind monedha floriri, shprehur me paratë që përdorni ju sot. Isai عليه السلام dhe besimtarët që janë bashkë me të, i luten Allahut të Madhëruar që t’i shpëtojë nga kjo e keqe. Dhe Allahu bën që në zverkun e Je’xhuxh-Me’xhuxhëve të shfaqen disa krimba, prej të cilëve ata do të vdesin menjëherë.

Më pas Isai عليه السلام dhe besimtarët zbresin prej Malit Tur, ku shohin se nuk gjendet asnjë pëllëmbë tokë e pambuluar prej kufomave të Je’xhuxh-Me’xhuxhëve. Për këtë arsye, Isai عليه السلام, bashkë me besimtarët, i luten përsëri Allahut të Madhëruar që t’i shpëtojë edhe nga kjo e keqe. Dhe Allahu dërgon disa shpendë të mëdhenj si qafa devesh, të cilët i marrin kufomat dhe i hedhin aty ku dëshiron Allahu.

Më pas, Allahu i Madhëruar dërgon një shi, të cilit nuk mund t’i bëjë ballë asnjë shtëpi apo çadër. Ky shi e pastron tokën në mënyrë të përsosur. Pas kësaj toka urdhërohet: «Çeli frutat dhe sill begatinë tënde!». Atë ditë, një grup njerëzish do mund të ngopen vetëm me një shegë dhe me lëvoren e saj do të bëjnë hije. Kafshët që dërgohen për të kullotur begatohen aq shumë me qumësht, saqë qumështi i një deveje mund të ngopë një turmë të madhe njerëzish, qumështi i një lope mund të ngopë një fis, e qumështi i një deleje mund të ngopë një xhemat.

Ndërkohë që njerëzit jetojnë në këtë mënyrë, Allahu dërgon një erë të lehtë, e cila i mbështjell prej sjetullave dhe merr shpirtrat e çdo besimtari mysliman. Pas kësaj, në tokë mbeten vetëm njerëzit e këqij. Ata do t’i hipin sipër njëri-tjetrit si gomerë dhe do të kryejnë marrëdhënie në sytë e të gjithëve. Mbi këta njerëz do të bëhet edhe Kiameti.” (Muslim, Fiten, 110)¹³⁴

134. shih. Tirmidhi, Fiten, 59; Ibn-i Maxhe, Fiten, 33.

7. Fundosja e tokës në Lindje,**8. Në Perëndim dhe****9. Në Gadishullin Arabik**

Në hadithet fisnike, ku i Dërguari i Allahut ﷺ, na ka lajmëruar se pa u shfaqur dhjetë shenja nuk do të bëhet Kiameti, bëhet e ditur se tre prej këtyre shenjave janë edhe fundosja e tokës në Lindje, Perëndim dhe në Gadishullin Arabik.

Ashtu siç janë shfaqur disa shenja të vogla që konsiderohen si paralajmëruese të shenjave të mëdha të Kiametit, padyshim se deri më sot është vërejtur edhe fenomeni i fundosjes së tokës në shumë vende. Mirëpo fundosja e tokës për të cilën i Dërguari i Allahut ﷺ, na ka lajmëruar, do të jetë shumë më e madhe dhe më e tmerrshme se ato që janë mëtuar deri tani.

10. Zjarri i madh në Jemen dhe Hixhaz.¹³⁵

Në kohën afër Kiametit, në zonën e Jemenit dhe Hixhazit do të dalë një zjarr i madh, i cili do të ndriçojë gjithë vendin.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nuk do të bëhet Kiameti pa u shfaqur një zjarr në zonën e Hixhazit. Ky zjarr do të ndriçojë qafat e deveve në Busra¹³⁶.” (Buhari, Fiten, 24; Muslim, Fiten, 42)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Para Kiametit do të dalë një zjarr prej Hadrameutit -ose prej detit të Hadrameutit-, i cili do t'i mbledhë njerëzit.”

Të pranishmit pyetën:

“O i Dërguar i Allahut! Çfarë na urdhëroni të bëjmë (nëse e arrijmë atë ditë)?”

Profeti ﷺ tha:

“Unë ju këshilloj Shamin (pra të shkoni në Siri).” (Tirmidhi, Fiten, 42)

135. Hixhaz: Zona në perëndim të Arabisë Saudite, ku ndodhen Meka dhe Medina.

136. Busra: Qytet në Siri.

Nga këto hadithe kuptohet qartë se zjarri i madh që do të dalë në zonën e Hixhazit, do të vërehet që prej Sirisë. Kjo është një prej shenjave të mëdha të Kiametit.


SHPËRTHIMI KIAMETIT

Kur të jenë shfaqur të gjitha shenjat e vogla e të mëdha të Kiametit dhe të vijë çasti i vdekjes së kësaj bote, i caktuar prej Allahut të Madhëruar, atëherë do të realizohet edhe premtimi i madh hyjnor.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“...Kiameti do të ndodhë patjetër dhe menjëherë, saqë kur shitësi dhe blerësi të kenë hapur copën (e pëlhurës), nuk do të kenë kohë as për të bërë pazar dhe as për ta mbledhur atë. Edhe pse njeriu do ta ketë mjelë qumështin e devesë, nuk do të ketë kohë ta pijë, sepse Kiameti do të shpërthejë papritur. Po ashtu, kur njeriu ta ketë rregulluar mirë basenin e ujit, Kiameti do të shpërthejë papritur, pa pasur mundësi që ai ta përdorë ujin. Njeriu do ta ngrejë dorën për të futur kafshatën e bukës në gojë, por nuk do të mund ta hajë, sepse Kiameti do të shpërthejë papritur.” (Buhari, Rikak, 40; Ahmed, II, 369. Shih. Muslim, Fiten, 140, Iman, 248)

Fryrja e Surit

Shpërthimi i Kiametit do të fillojë me fryrjen e Surit. Suri është një lloj borie në formë briri, të cilit do t'i fryjë meleku Israfil , njëherë për të filluar shpërthimin e jashtëzakonshëm të Kiametit dhe njëherë për të filluar ringjalljen e njerëzve pas Kiametit dhe mbledhjen e tyre në sheshin e madh të Mahsherit.

Lidhur me këtë bori (Sur), e cila përmban shumë aspekte të panjohura për ne, gjejmë disa të dhëna në këto hadithe fisnike:

“Suri është briri, që i fryhet (në Ditën e Kiametit)” (Ebu Daud, Sunnet, 24)

Në Kuranin Fisnik lajmërohem se Surit do t'i fryhet dy herë. Në këto ajete fisnike, na bëhen të ditura disa prej ngjarjeve që do të ndodhin në univers si rezultat i fryrjes së parë:

“Dhe kur t'i fryhet një herë Surit, kur toka dhe malet të ngrihen lart e të thërrmohen me një goditje shkatërrimtare, atëherë



do të ndodhë Ngjarja e pashmangshme (Kiameti). Dhe do të çahet qielli, që atë ditë do të jetë i thyeshëm.” (Hakka, 13-16)

“Ditën, kur Toka dhe malet dridhen e bëhen si pirgje rëre të lëvizshme.” (Muzzemmil, 14)

“Kur yjet të shuhën dhe, kur qielli të çahet dhe, kur malet të thërrmohen si pluhur dhe, kur të dërguarit të tubohen në kohën e caktuar.” (Murselat, 8-11)

“Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt!..” (Ibrahim, 48)

“Atë Ditë, Ne do të palosim qiellin, ashtu siç paloset letra e librit. Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim atë. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtetë.” (Enbija, 104)

“Kur të të pyesin ty (o Muhamed) për malet, thuaj: «Ato do t’i bëjë hi e pluhur Zoti im, ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje!»” (TaHa, 105-107)



Ndërsa në këto ajete fisnike na bëhet e ditur gjendja e njerëzve në të dyja fryrjet e Surit:

“Kur do t’i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.” (Zumer, 68)

“Ditën kur do të dridhet gjithçka nga ushtima (që lajmëron Kiametin), e cila do ta ndiqet nga një e dytë, disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr e shikimet e tyre do të bien përdhe.” (Naziat, 6-9)

Padyshim, dita kur t’i fryhet Surit, do të jetë më e tmerrshme për jetën e kësaj bote. Foshnjat do të kthehen në pleq të thinjur për shkak të tmerrit të asaj dite. Lidhur me këtë Allahu i Madhëruar lajmëron:

“Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobsimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen? Atë ditë qielli do të çahet e premtimi i Zotit do të përmbushet.” (Muzzemmil, 17-18)

Por do të ketë edhe njerëz, të cilët do të jenë nën mbrojtjen e Allahut



atë ditë të tmerrshme dhe do të jenë të sigurt prej hidhërimit dhe frikës. Lidhur me këtë, në Kuran sqarohet:

“Dhe Ditën kur të fryhet në Sur, do të tmerrohet çdokush që gjendet në qiej e në Tokë, përveç atyre që Allahu nuk dëshiron t’i frikësojë. Të gjithë do t’i vijnë Atij të përlulur.” (Neml, 87)



Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“E si mund të gëzohem e të kënaqem me mirësitë, ndërkohë që meleku përgjegjës e ka marrë surin në dorë dhe është duke pritur t’i fryjë atij menjëherë, sapo të vijë urdhri!”

Kjo gjendje iu duk tepër e rëndë sahabëve. Prandaj Pejgamberi ﷺ i këshilloi:

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ عَلَى اللَّهِ تَوَكَّلْنَا

“Thoni kështu: «Allahu i Madhëruar na mjafton, Ai është mbrojtësi më i mirë. Ne mbështetemi tek Allahu!»” (Tirmidhi, Kijamet, 8/2431; Ahmed, I, 326)



PJESA VI



Bota tjetër

Mohuesit, gjynahqarët dhe indiferentët, të cilët në jetën e tyre të përkohshme ëndërrojnë gjithmonë një dynja pa llogari, pa përgjegjësi dhe pa Ahiret, do të jenë të gatshëm të japin çdo gjë që kanë zotëruar në jetën e dynjasë, madje shumëfish më tepër, për të shpëtuar prej dënimit të asaj dite të keqe, në të cilën do të përballen me situatat e tmerrshme të Kiametit. Mirëpo, atë ditë gjithçka do të ketë përfunduar dhe nuk do të ketë më mundësi për asgjë.

BOTA TJETËR

1. Ba'th (Ringjallja)

Ringjallja, e cila do të ndodhë ditën e Kiametit, do të fillojë me fryrjen për herë të dytë të Surit nga ana e Israfililit عليه السلام. Pra, me fryrjen për herë të dytë të surit, do të ringjallen të gjitha gjallesat që kanë qenë krijuar në këtë botë të përkohshme. Kjo quhet “*Ba'thu ba'de'l-meut*”, domethënë “*ringjallja pas vdekjes*”.

Ebu Hurejre رضي الله عنه e ka pyetur Profetin صلى الله عليه وسلم, se sa kohë do të kalojë midis dy fryrjeve të Surit dhe ai i ka thënë “*dyzet*”.

Pasi Ebu Hurejre رضي الله عنه e përmendi këtë thënie të Profetit, sahabët e pyetën:

“O Ebu Hurejre! Dyzet ditë?”

“S’mund të them gjë!” - Iu përgjigj ai.

“Dyzet vjet?” - E pyetën sahabët.

“S’mund të them gjë!” - tha përsëri ai.

“Dyzet muaj?” - E pyetën sërish sahabët.

“S’mund të them gjë!” - tha sërish Ebu Hurejre رضي الله عنه dhe pastaj e plotësoi hadithin deri në fund:

“Allahu do të lëshojë ujë nga qielli dhe njerëzit do të mbijnë nga toka siç mbijnë perimet dhe bimët. Përveç një kocke, i gjithë trupi i njeriut kalbet e humbet. Kjo kockë që nuk kalbet është “axhbu’dh-Dheneb”, kocka e kërbishtit. Prej kësaj kocke do të fillojë edhe ringjallja ditën e Kiametit.”

(Buhari, Tefsiru Sure 39/3; Muslim, Fiten, 141; Muuatta, Xhenaiz, 48; Ebu Daud, Sunnet, 24; Nesai, Xhenaiz, 117)

Në disa transmetime bëhet e ditur se koha midis dy fryrjeve të Surit është dyzet vjet¹³⁷, gjë të cilën e kanë pranuar edhe shumica e dijetarëve.¹³⁸

Sipas mufesirit dhe dijetarit të gjuhës, Ferra-s:

“Njerëzit dhe të gjitha krijesat do të vdesin me Surin e parë. Ndërmjet tij dhe Surit tjetër do të kalojnë dyzet vjet. Në këtë kohë Allahu i Madhëruar do të dërgojë një shi, i cili do të bierë në formë viskoze, si “uji” i mashkullit, dhe njerëzit do të mbijnë në varret e tyre ashtu si zhvillohen në barkun e nënës. Kjo është faza për të cilën aludohet edhe në këtë ajet fisnik:

“...po kështu do t’i ringjallë edhe të vdekurit...” (A’raf, 57)

Domethënë, ashtu siç i nxjerrim bimët prej një vendi të vdekur, ashtu do t’i nxjerrim edhe të vdekurit nga varri.”¹³⁹



Në Kuranin Fisnik, Allahu iu drejtohet atyre që kanë dyshime në lidhje me faktin se si do të realizohet ringjallja:

“O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t’jua bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar.

Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë. Disa nga ju vdesin e disa ngelin deri në pleqëri të thellë, që të mos dinë asgjë nga ajo që kanë ditur më parë.

137. Ibn-i Mende, Ebu Abdullah Muhamed b. Is’hak b. Muhamed b. Jahja el-Abdi (v. 395), *el-Iman* (I-II), Verifikuar nga Ali. B. Muhamed b. Nasir el-Fakihi, Bejrut: Muessesetu’r-Risale, 1406, II, 794; Bejhaki, Shuabu’l-Iman, I, 541.

138. Gazali, Ebu Hamid Muhamed b. Muhamed (v. 505), *ed-Durretu’l-Fahire fi Keshfi Ulumi’l-Ahire* (Në brendësi të *Mexhmuatu Resaili’l-Imam el-Gazali*), Bejrut: Daru’l-Kutubi’l-Ilmijje, 1409, fq. 118; Begau, VII, 132; Kurtubi, *et-Tedhkire*, I, 287; Sujuti, *el-Buduru’s-Safire*, fq. 86-88; Bebek, “Sur” md., DIA, XXXVII, 534.

139. Ferra, I, 382. Edhe Taberiu përmend të njëjtin transmetim pa zinxhir. Transmetohet se në hadithin e përcjellë prej tij, ky lloj shiu quhet “Mau hajeuan”. (Taberi, XII, 493-494) shih. Ibn-i Ebi Hatim, VIII, 2784; Bejhaki, Shuab, I, 541; Ebu Hajjan, V, 79.

Në transmetimet sahih, është bërë e ditur se Allahu i Madhëruar do të lëshojë një shi nga qielli dhe me të do t’i rikrijojë të vdekurit njësoj siç i rrit bimët. (Buhari, Tefsir, 78/1) Mirëpo, transmetimet në lidhje me përbërjen e këtij shiu janë të dobëta.

Dhe ti e sheh tokën të tharë, por, kur Ne lëshojmë ujë mbi të, ajo trazohet dhe gufon dhe prej saj mbijnë gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme në çift.

Kjo ndodh (që ta dini) se Allahu është e Vërteta, se Ai i ringjall të vdekurit, se Ai është i Fuqishëm për çdo gjë, se Ora (e Kiametit) do të vijë, gjë për të cilën s'ka dyshim dhe se Allahu do t'i ringjallë ata që janë në varre.” (Haxh, 5-7)

Ndërsa në suren Mu'mininu tregohen fazat mësimdhënëse që kalon njeriu nga jeta në barkun e nënës, në jetën e dynjasë, vdekjen dhe ringjalljen pas saj:

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër). Më pas, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!

Mandej, pas kësaj ju do të vdisni, pastaj, ju me siguri që do të ringjalleni në Ditën e Kiametit.” (Mu'mininu, 12-16)



Këto të vërteta, për të cilat na ka njoftuar Allahu i Madhëruar, shprehen kështu edhe në një bisedë midis Profetit ﷺ dhe Ebu Rezin-it ﷺ:

Ebu Rezin el-Ukajdi ﷺ tregon:

Një ditë e pyeta të Dërguarin e Allahut ﷺ:

“O i Dërguari i Allahut! Si i ringjall Allahu i Madhëruar krijesat? A ka ndonjë shembull në këtë botë?”

Ndërsa ai u përgjigj:

“A nuk ke kaluar ndonjëherë në kohën e thatësirës në luginën ku jeton populli yt? Më pas, a nuk ke kaluar përsëri në kohën e verës kur çdo anë është e gjelbëruar?”

“Sigurisht!” - u përgjigja unë.



“Ja pra, ky është shembulli se si e kryen Allahu ringjalljen. Kështu do t’i ringjallë Allahu edhe të vdekurit!” - tha ai ﴿﴾ (Ahmed, IV, 11)



Ndërsa tronditja dhe pendimi i madh që do të ndjejnë mohuesit e botës tjetër kur të ringjallen, shprehet në këtë mënyrë në këto ajete fisnike:

“Ai (zëri i bririt të ringjalljes) do të jetë një zë i vetëm dhe të gjithë (mohuesit e ringjallur) do të shohin (se ç’do të bëhet me ta) dhe do të thonë: «Mjerë për ne, kjo është Dita e Gjykimit!» Po, kjo është Dita e Gjykimit, të cilën ju e keni përgënjeshtuar!” (Saffat, 19-21)

“Me sy të përulur do të dalin nga varret, sikur të ishin karkaleca të shpërndarë, duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Atëherë, mohuesit do të thonë: «Kjo është ditë e vështirë!»” (Kamer, 7-8)

E në fakt, ata e konsideronin si gënjeshtër jetën e Ahiretit dhe pandehnin se jeta e tyre ishte vetëm ajo që bëjnë në dynja. Lidhur me këtë, Kurani Fisnik shprehet:

“Ata thonë: «Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron». Ata nuk kanë kurrfarë dijeje për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.

Kur atyre u lexohen shpalljet Tona të qarta, argumenti i tyre i vetëm është: «Ringjallni të parët tanë, nëse thoni të vërtetën!» Thuaju:

«Allahu jua jep jetën, pastaj ju bën të vdisni e mandej do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit, e për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi; por shumica e njerëzve nuk e dinë.» (Xhathije, 24-26)

Ubej ibn Halef ishte një prej armiqve të betuar të Islamit dhe e mohonte kategorikisht ringjalljen pas vdekjes. Njëherë, ai mori një kockë të kalbur nga toka dhe duke e shkërmoqur me dorë, u kthye nga Profeti ﴿﴾ dhe në një mënyrë tallëse tha:

“Ti beson se Allahu do t’i ringjallë këto kocka të kalbura?”

I Dërguari i Allahut ﴿﴾, tha:

“Po, Allahu do të ringjallë ty dhe do të fusë në Xhehenem!” (Kurtubi,

el-Xhami, XV, 58; Uahidi, fq. 389)



Pas kësaj ngjarjeje zbritën këto ajete:

“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?! Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: «Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?» Thuaj: «Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë!»” (JaSin, 77-79)



Allahu i Madhëruar, në fillim të sures Kijame, na e bën të qartë se për Të nuk është aspak e vështirë t’i ringjallë njerëzit pasi të vdesin:

لَا أَقْسِمُ بِيَوْمِ الْقِيَامَةِ

“Betohehem në Ditën e Kiametit!” (Kijame, 1)

وَلَا أَقْسِمُ بِالنَّفْسِ اللَّوَّامَةِ

“Betohehem në shpirtin qortues!” (Kijame, 2)

أَيَحْسَبُ الْإِنْسَانُ أَنْ نَجْمَعَ عِظَامَهُ

“A mendon njeriu se nuk do të mund t’i mbledhim eshtrat e tij?!” (Kijame, 3)

بَلَىٰ قَادِرِينَ عَلَىٰ أَنْ نُسَوِّيَ بَنَانَهُ

“Po, si jo! Ne jemi të Zotë t’ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave¹⁴⁰ të tij.” (Kijame, 4)



140. Dega shkencore e daktiloskopisë, e cila studion gjurmët e gishtave, ka zbuluar se gjurmët e gishtave të njeriut, qëndrojnë të njëjta dhe të pandryshueshme gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, gjurmët e gishtave të një njeriu nuk ngjajnë aspak me ato të cilido njeriu tjetër. Për këtë shkak, në polici dhe në drejtësi, identifikimi më i sigurt i personave, bëhet me anë të gjurmëve të gishtave. Ky zbulim, është bërë në fund të shekullit të 19. dhe prej atëherë, njerëzimi ka filluar të përfitojë prej kësaj mirësie. Mirëpo, Kurani Fisnik, na e ka tërhequr vëmendjen në këtë të vërtetë që katërmbëdhjetë shekuj më parë, duke shfaqur kështu një mrekulli më vete. Dhe ky është vetëm një prej shembujve të panumërt që tregon se Kurani është gjithmonë në krye, ndërsa shkencat pozitive i vijnë nga pas duke e interpretuar dhe vërtetuar.



Ndërsa në suren Lukman, Zoti ynë i Madhëruar urdhëron:

مَا خَلَقَكُمْ وَلَا بَعَثَكُمْ إِلَّا كَنَفْسٍ وَاحِدَةً إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

“Krijimi dhe ringjallja e ju të gjithëve është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha.”

(Lukman, 28)

Padyshim se, krijimi për herë të parë është një argument edhe për krijimin për herë të dytë, sepse të krijosh nga asgjëja është më e vështirë se të asgjësosh atë që ekziston dhe ta ringjallësh. E të pranosh të vështirën, ndërkohë që pretendon se më e lehta është e pamundur, nuk është aspak e logjikshme. Për më tepër, Allahu i Madhëruar, i Cili ka dije dhe fuqi të pakufishme, nuk ka shfaqur asnjë lloj dobësie apo pamundësie në krijimin e parë, por ka krijuar krijesa të panumërta, ku secila prej tyre është një krijim më vete.

Allahu i Madhëruar i pyet kështu robërit e Tij:

أَفَعَيْنَا بِالْخَلْقِ الْأَوَّلِ بَلْ هُمْ فِي لَبْسٍ مِّنْ خَلْقٍ جَدِيدٍ

“Vallë, a mos u lodhëm Ne gjatë krijimit të parë? Jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm.” (Kaf, 15)



Gjendja e birit të njeriut, kur të ringjallet e të ngrihet nga varri, përshkruhet kështu në ajetet fisnike:

“Dhe, kur të fryhet në Sur, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: «Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?»¹⁴¹ (Atëherë do t’u thuhet):

“Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit kanë thënë të vërtetën!” (JaSin, 51-52)

141. Mendimet e mufesirëve në lidhje me këtë çështje janë si më poshtë:

a. Këtu, vdekja është krahasuar me gjumin, sepse në të dyja gjendjet nuk ka lëvizje. Për shkak të tmerrit të asaj dite, mendja e njeriut do të hutohet dhe ata mund ta kujtojnë veten në gjumë.

b. Kur të kuptojnë gjendjen pas jetës së varrit dhe tmerrin e dënimit të Xhehenemit, varri do t’u duket si gjumë në krahasim me to. Prandaj edhe mund të thonë ashtu. (shih. Alusi, Ruhu’l-Meani, XII, 31)

“Ditën, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një altari, me shikim të frikësuar e të kapluar nga poshtërimi. Ajo është Dita që u është premtuar atyre!” (Mearixh, 43-44)

“Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t’i mbledhim ata të gjithë.” (Kaf, 44)

“Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse, Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!” (Adijat, 9-11)



Tmerri dhe mjerimi i asaj dite përshkruhet kështu në Kuran:

“Kur të fryhet në Sur (Ditën e Ringjalljes), atëherë, midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin.” (Mu’minun, 101)

“Por, kur të vijë Ushtima, atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t’i mjaftojë.” (Abese, 33-37)

Nëna jonë, Aisha , transmeton:


“Një ditë, i Dërguari i Allahut , tha:

«Ditën e Gjykimit njerëzit do të ringjallen të zbathur, të zhveshur dhe të pabërë sunet.» (E habitur) I thashë:

«O i Dërguari i Allahut! Meshkujt dhe femrat bashkë, të shikojnë njëri-tjetrin!?»

Ai tha:

«Oj Aisha! Situata do të jetë aq e tmerrshme, saqë askujt nuk do t’i bjerë ndërmend të shikojë tjetrin.»” (Buhari, Rikak, 45; Muslim, Xhennet, 56)

Po ashtu, siç na bëhet e ditur edhe në një hadith tjetër, kur të vdekurit të ringjallen, të parit që do t’i vishen rrobat, do të jetë Ibrahim . ¹⁴² Më

142. shih. Buhari, Enbija, 8.



pas, do t'i vishen Profetit ﷺ. Pas kësaj, Profeti ﷺ do të qëndrojë në anën e djathtë të Arshit, vetëm. Për këtë arsye, atë do ta kenë zili edhe të mëparshmit, edhe të mëvonshmit.



Allahu i Madhëruar do t'i mbledhë të gjitha pjesët e trupit të njeriut në një vend dhe duke iu kthyer shpirtrat, do t'i nxjerrë të vdekurit nga varret. Për njerëzit, që sapo janë rikrijuar, do të fillojë një jetë që nuk do të ketë fund.

Ditën e Kiametit, njeriu që do të ringjallet dhe do të dalë i pari nga varri, është Profeti ﷺ.¹⁴³

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, kishte hyrë në xhami. Në njërin krah të tij qëndronte Ebu Bekri ؓ, ndërsa në tjetrin Omeri ؓ. Profeti ﷺ u kapi duart dhe u tha:

“Ja, kështu do të ringjallemi Ditën e Kiametit.” (Tirmidhi, Menakib, 16/3669)

Shembujt e ringjalljes në Kuranin Fisnik

Edhe pse ka pasur diskutime në lidhje me çështjen nëse ringjallja do të jetë me trup apo me shpirt, në Kuranin Fisnik gjenden shumë ajete të cilat tregojnë se ringjallja do të jetë me trup. Pra, Allahu i Madhëruar do t'ia kthejë shpirtin çdo njeriu dhe do t'i ringjalli me trup.

Me qëllim që të forcojë zemrat e besimtarëve, në lidhje me faktin se ringjallja pas vdekjes është e vërtetë dhe se për Të kjo nuk është aspak e vështirë, Allahu i Madhëruar ka ringjallur disa krijesa që në jetën e kësaj bote dhe shembujt e tyre i ka përmendur në Kuranin Fisnik:

a) Ringjallja e shpendëve të copëtuar:

Në Kuran sqarohet:

“Ibrahimi tha:

«O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!» - Zoti i tha:

«A nuk beson?»

«Besoj!» - iu përgjigj Ibrahimimi, «por dëshiroj të më qetësohet zemra.» Allahu i tha:

«Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.» (Bekare, 260)

Sipas transmetimit, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Ibrahimin عليه السلام të priste katër shpend, t'ua hiqte puplat dhe t'ua ndante mishin në copa. Më pas, e urdhëroi që t'i mbante kokat e tyre, ndërkohë që pjesët e trupave të tyre duhet t'i vendoste në majën e çdo kodre.

Po sipas transmetimeve, thuhet se Ibrahimimi عليه السلام zuri një pallua, një gjel, një korb dhe një shqiponjë. Çdonjërin prej tyre e ndau në katër pjesë, i përzjeu mirë e mirë me njëri-tjetrin (si brumë) dhe vendosi në çdo majë kodre nga një pjesë të përzierjes. Më pas, i thirri: “Ejani tek unë me lejen e Allahut!”. Pas kësaj, çdo pjesë e tyre fluturoi drejt pjesëve të tjera të ngjashme, duke formuar nga një trup të vetëm, secili më pas u bashkua me kokën përkatëse dhe morën formën e tyre origjinale.¹⁴⁴

Thuhet se fakti që Ibrahimimi عليه السلام i vuri pjesët e shpendëve në majat e kodrave, tregon se rreth tij ka pasur edhe një grup të madh njerëzish. Domethënë, urdhri për t'i vendosur pjesët e shpendëve në majat e kodrave, ka qenë me qëllim që ato të shihen lehtë nga njerëzit e tjerë. Po ashtu, thuhet se kjo ngjarje ka ndodhur si pasojë e lutjes së Ibrahimimit عليه السلام, i cili kërkoi prej Allahut të Madhëruar një mrekulli për t'u dhënë argumente të qarta atyre që e mohonin ringjalljen në botën tjetër.



Siç dihet, Ibrahimimi عليه السلام është një prej profetëve të mëdhenj. Prandaj është e pamundur të mendohet se ai ka pasur ndonjë dyshim në lidhje me çështjen e ringjalljes së të vdekurve nga Allahut i Madhëruar. Po ashtu, edhe Allahu i Madhëruar e dinte se Ibrahimimi عليه السلام ishte besimtar i devotshëm. Mirëpo, me qëllim që të dihet nga të gjithë se çfarë donte të thoshte Ibrahimimi عليه السلام me frazën: “**O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!**”, e pyeti atë; “**A nuk beson?**”. Ndërsa Ibrahimimi عليه السلام, ashtu siç bëhet e ditur edhe

144. shih. Taberi, Xhamiu'l-Bejan, III, 81-82.



në ajetin fisnik, shprehet se ai kërkoi diçka të tillë prej Allahut të Madhëruar, me qëllim që besimi i tij të ngrihej në gradën “hakka’l-jakin”¹⁴⁵ dhe zemra e tij të qetësohej, duke e parë me sytë e vet të vërtetën hyjnore. E në fakt, dihet se kur njeriu e sheh me sytë e vet diçka që e beson, besimi i tij bëhet edhe më i fortë e i palëkundur.

Nga ana tjetër, është e qartë se Ibrahimî عليه السلام e ka shprehur këtë dëshirë, me qëllim që zemra e tij të arrinte qetësinë dhe sigurinë e plotë në lidhje me faktin se ai ishte “mik i Allahut”.

Përveç këtyre, nga ky ajet fisnik del në pah e vërteta se, çfarëdo pozite shpirtërore të arrijë një njeri, ai ka ende rrugë për të bërë drejt përsosmërisë së besimit dhe qetësisë së zemrës. Edhe Ibrahimî عليه السلام, për të cilin lajmërohem në Kuran se ka qenë prej profetëve të mëdhenj (Ulu’l-Adhm) dhe mbante titullin “Halilullah/Mik i Allahut”, duke gëzuar edhe plot lavdërime të tjera, i është lutur Allahut të Madhëruar që t’i shtohej qetësia dhe siguria e zemrës.

Një gjë është e sigurt: aq sa shtohet afërsia e njeriut me Allahun e Madhëruar, aq shtohet edhe horizonti i tij në botën e zemrës. Ai e kupton edhe më qartë dobësinë e tij, nevojën, mangësinë dhe të qenit asgjë karshi Allahut. Prandaj, edhe Ibrahimî عليه السلام, në kuadër të këtyre ndjesive, iu lut Allahut duke thënë:



وَلَا تُخْزِنِي يَوْمَ يُبْعَثُونَ ﴿٨٧﴾ يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بُنُونَ ﴿٨٨﴾
إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ

“Dhe mos më turpëro Ditën kur do të ringjallen njerëzit, Ditën kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, e as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shu’ara, 87-89)



Në lidhje me ajetin në të cilin Ibrahimî عليه السلام kërkon prej Allahut të shohë ringjalljen e të vdekurve, në tefsirin “Letaifu’l-Isharat” të Imam Kushejrit thuhet:

145. Besim i mbështetur në dijen e përjetuar dhe të ndjerë me të gjitha shqisat. Dije e sigurt dhe pa asnjë fije dyshimi.

“Ibrahimi  me këtë lutje ndaj Allahut, ka kërkuar ringjalljen e zemrës. Ndërsa Allahu i Madhëruar i ka bërë të ditur se zemra e tij duhet t’i shkëpusë lidhjet me gjërat e tjera. Nisur nga kjo, me katër shpendët që copëtoi Ibrahimi , aludohen katër cilësi të këqija që ka nefsi/egoja. Palloi përfaqëson zbukurimin, korbi përfaqëson dëshirat e pafundme, gjeli përfaqëson ephshin, ndërsa shqiponja përfaqëson lakminë. Për rrjedhojë, ata që nuk i presin fytin këtyre cilësive negative të egos, me anë të përpjekjes dhe edukimit shpirtëror, nuk mund të arrijnë ringjalljen e zemrës (vetëm) me vëzhgim.” (Kushejri, “Letaifu’l-Isharat”, I, 121)



b) Ringjallja e atyre që vdiqën nga goditja e rrufesë:

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:



“Kujtoni kur i thatë Musait:

«O Musa! Ne nuk do të të besojmë ty, derisa të shohim Allahun haptazi!».

Atëherë një rrufe ju goditi, ndërsa ishit duke parë. Pas vdekjes suaj, Ne ju ringjallëm, që të bëheni falënderues.” (Bekare, 55-56)

Siç kuptohet edhe prej ajeteve, disa persona prej popullit të Musait  deklaruan se nuk do ta besonin profetin, pa e parë Allahun haptas, dhe Allahu i Madhëruar i goditi ata me rrufe. Më pas Allahu i ringjalli personat që vdiqën nga goditja e rrufesë, duke i bërë ata vetë dëshmi të gjallë të fuqisë së Allahut dhe të madhësisë së Tij. Pra, edhe kjo ndodhi që na rrëfëhet në Kuranin Fisnik, ka si qëllim sqarimin e atyre që mohojnë ringjalljen, në lidhje me thjeshtësinë me të cilën Allahu i Madhëruar e realizon diçka të tillë. Madje, dihet mirë se për t’i treguar fuqinë e Allahut atyre që e mohojnë ringjalljen në botën tjetër, janë dhënë edhe shembujt e Isait , i cili shfaqti mrekullinë e ringjalljes së të vdekurve, dhe të As’habi Kehf-it, të cilët u zgjuan pasi u mbajtën në gjumë për treqind e ca vite.

c) Ringjallja e atij që qëndroi njëqind vjet i vdekur:

Një nga çështjet për të cilën idhujtarët e kundërshtonin më shumë të Dërguarin e Allahut , ishte ringjallja e të vdekurve. Ata nuk donin ta pranonin këtë të vërtetë, për shkak të egos së tyre, por edhe për shkak se nuk arrinin ta kuptonin se si do të ngjalleshin përsëri trupat e kalbur ose ata që nuk ekzistonin më. Mirëpo, Allahu i Madhëruar i shpalli Profetit 



shumë ajete të cilat do t'i eliminonin këto mendime të idhujtarëve. Me anë të shumë shembujve, Ai e ka shpjeguar qartë në Kuranin Fisnik të vërtetën e ringjalljes pas vdekjes. Një prej këtyre shembujve, është edhe ai i njeriut, në kohën e Uzejrit **عزير**, i cili u ringjall pasi qëndroi i vdekur për njëqind vjet. Në Kuran urdhërohet:

“(A nuk ke dëgjuar) Për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha:

«Si mund ta kthejë në jetë Allahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!» Dhe Allahu e vdiq atë për njëqind vjet e pastaj e ringjalli dhe e pyeti:

«Sa kohë ke ndenjur këtu?» - Ai u përgjigj:

«Një ditë ose gjysmë dite.»

«Jo!» - i tha Allahu, «por ke ndenjur njëqind vjet. Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur! Shikoje gomarin tënd (si do ta ringjallim) që të të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit; vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i veshim me mish!» Kur atij iu bë e qartë, ai tha:

«Tashmë e di se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë!» (Bekare, 259)

Në disa tefsirë thuhet se ky person ka qenë vetë Uzejri **عزير**, i cili kur arriti në një qytet të rrënuar, banorët e së cilit kishin vdekur e ishin zhdukur, filloi të mendonte me vete se si do t'i ringjallte Allahu të vdekurit. I zhytur në këto mendime, Allahu i Madhëruar ia merr jetën dhe ia kthen përsëri pas njëqind vjetësh. Kur u ringjall, ai pandehu se kishte fjetur për një kohë të shkurtër dhe ishte zgjuar, sepse ushqimet e tij nuk ishin prishur ende. Mirëpo, kur ai pa gomarin e vet, e kuptoi se ai kishte kohë që kishte ngordhur, sepse atij i kishin mbetur vetëm kockat që po i shkërmoqeshin. Pas kësaj, Allahu i Madhëruar e ringjalli gomarin para syve të tij, në mënyrë që ai të dëshmonte personalisht se si Allahu ua merr jetën robërve dhe i ngjall ata përsëri.

Hauzi

Thuhet se njerëzit do të dalin nga varret e tyre të etur dhe për të shuar etjen do të vrapojnë me një frymë drejt “hauzit” që ndodhet në sheshin e madh të Mahsherit. Mirëpo, jo të gjithë do të mund të arrijnë atje.

Në një hadith fisnik bëhet e ditur se, ata të cilët i kanë kthyer shpinën besimit në jetën e dynjasë dhe kanë hyrë në rrugë të devijuara, do të pengohen nga pirja e ujit të hauzit:

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, shkoi tek varrezat dhe tha:

“Selam ju qoftë o banorët myslimanë të këtij vendi! InshaAllah, një ditë edhe ne do të vijmë pranë jush.” (Pasi përshëndeti banorët e varreve) Tha:

“Sa kisha dashur t’i shihja vëllezërit e mi!” Sahabët pyetën të habitur:

“A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Ju jeni shokët e mi të ngushtë, vëllezërit e mi akoma nuk kanë ardhur në jetë.”

Sahabët pyetën përsëri:

“Si do t’i njihni Ditën e Gjykimit ata që akoma nuk kanë ardhur në këtë jetë, o i Dërguari i Allahut?”

Mirëpo, Profeti ﷺ i pyeti:

“Mendoni një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të bardha! A nuk e njeh ky njeri kalin e tij në mesin e një tufe me kuaj të zinj?”

Sahabët pohuan:

“Po o i Dërguari i Allahut, e njeh!”

Pas kësaj, Profeti ﷺ vazhdoi:

“Ja pra, vëllezërit e mi në Ditën e Gjykimit do të vijnë me fytyrë, duar dhe këmbë të shndritshme, për shkak se kanë marrë abdest. Unë do të shkoj para tyre në krye të hauzit (të Keutherit) dhe do t’i pres që t’u jap ujë!”

Kini kujdes! Disa njerëz do të dëbohen nga hauzi im, ashtu siç dëbohen devetë e huaja nga tufa. Kurse unë do t’i thërras ata: «Ejani këtu!». E mua do të më thuhet:

«Ata devijuan nga rruga jote dhe morën rrugë të tjera!»¹⁴⁶

146. Thuhet se këta janë një numër i vogël beduinësh, të cilët e lanë fenë pasi i dhanë besën të Dërguarit të Allahut. Në një hadith tjetër, thuhet: “...Mua më thuhet: «Pasi u ndave prej



Për këtë arsye, unë do të them:

«Qofshin larg, qofshin larg!» (Muslim, Taharet, 39, Fedail, 26)¹⁴⁷

Nga ky rrëfim kuptohet se prej ujit të Hauzit do të pinë vetëm ata që do të arrijnë atje. Ndërsa ata që nuk do të pinë prej hauzit, janë ata që nuk do të kalojnë dot as urën e Siratit.



Në një hadith fisnik, Profeti ﷺ e ka përshkruar hauzin në këtë mënyrë:

“Hauzi im është i madh sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi dhe aroma e tij është më e këndshme se miski. Ndërsa gotat janë të shumta sa yjet në qiell. Kush pi prej tij, nuk e merr më etja përjetësisht.” (Buhari, Rikak, 53; Muslim, Fedail, 27)

Ai që nuk arrin të pijë ujë prej atij hauzi, do të jetë përjetësisht i etur.

Sipas transmetimeve mësojmë se i pari që do të arrijë tek hauzi do të jetë Profeti ﷺ, i cili do të përgatitet që të gostisë ummetin e tij me ujë.¹⁴⁸ Ndërsa njerëzit që do të arrijnë të parët tek hauzi, janë të varfrit prej muhaxhirëve.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“*(Ditën e Kiametit) Çdo profet ka hauzin e tij dhe çdonjëri prej tyre krenohet dhe gëzohet karshi të tjerëve me numrin e shumë të njerëzve që vijnë tek hauzi i tyre. Unë shpresoj të jem profeti të cilit i vijnë më shumë njerëz tek hauzi!*” (Tirmidhi, Kiamet, 14/2443)

tyre, ata u kthyen pas mbi thembrat e tyre dhe që prej asaj dite vazhduan në irtidat (lënie të fesë)!» (Muslim, Xhennet, 58)

Lidhur me njerëzit që nuk do të arrijnë dot tek hauzi, ka mendime të ndryshme. Këto mendime janë si më poshtë:

1. Hipokritët dhe murtedët (lënësit e fesë).
2. Ata që kanë jetuar në kohën e Profetit ﷺ dhe që pas vdekjes së tij kanë braktisur fenë.
3. Ata që kanë kryer gjynahe të mëdha.
4. Ata që kanë ndjekur medh'hebe me besim të gabuar dhe janë marrë me bid'ate. (Sujuti, ed-Dibaxh ala Sahihi Muslim ibn-i Haxhxhaxh, Daru Ibn-i Affan, 1416, II, 43)
5. Njerëzit e këqij. Pra, ata që nuk e kanë lënë fenë, por janë marrë me punë të këqija. (Neueui, Sherhu Sahihi Muslim, XV, 64)

147. shih. Nesai, Taharet, 110/150; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 36; Muuatta, Taharet, 28; Ahmed, II, 300, 408.

148. shih. Muslim, Fedail, 25-45; Tirmidhi, Kiamet, 15/2444; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 36; Ahmed, V, 275; Hejthemi, X, 360-367.

Për rrjedhojë, me qëllim që të mos e zhgënjejme Profetin ﷺ, ne duhet ta ndjekim sunnetin e tij me kujdes dhe respekt të madh, dhe duhet të përpiqemi të motivojmë edhe njerëzit e tjerë përreth nesh, që të jetojnë në këtë rrugë.

Ringjallja dhe Mahsheri

Pasi t'i ringjallë të gjitha krijesat, Allahu i Madhëruar do t'i mbledhë ato në sheshin e Mahsherit, ku do të vërë peshoren dhe do të fillojë llogarinë. Lidhur me këtë fakt, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“O Zoti ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, Allahu nuk e shkel premtimin”. (Al-i Imran, 9)

“Ditën, kur do të fryhet në Sur, pikërisht atë Ditë do t'i tubojmë të ligjtë me sy të zgurdulluar.” (TaHa, 102)

“Për Zotin tënd! Ne do t'i tubojmë ata dhe djajtë, pastaj do t'i sjellim ata të gjunjëzuar rreth Xhehenemit!” (Merjem, 68)

“Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre.” (Zelzele, 6)



Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka përshkruar kështu sheshin e Mahsherit ku do të mblidhen njerëzit:

“Ditën e Kiametit njerëzit do të mblidhen në një fushë që ngjan me një kulaç prej mielli të bardhë, të sigur e të pastruar prej krundeve.”

Një prej transmetuesve të hadithit ka bërë këtë shpjegim:

“Në atë fushë, nuk gjendet asnjë shenjë (si mal, gur, etj) që tregon diçka për dikë apo që orienton ndonjë rrugë!” (Buhari, Rikak, 44)

Në Kuranin Fisnik thuhet se kur t'i fryhet Surit për herë të parë, malet do të shkërmoqen e do të bëhen pluhur, toka do të bëhet e rrafshët dhe e shkretë dhe nuk do të gjendet asnjë e përpjetë apo e tatëpjetë.¹⁴⁹



149. shih. TaHa, 105-107.



Njerëzit, kur të mblidhen në sheshin e Mahsherit, do të kenë forma të ndryshme, sipas gjendjes shpirtërore që ata kanë pasur në jetën e dynjasë. Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, ju do të vini në sheshin e Mahsherit në këmbë, hipur (në mjet apo kafshë), ose duke u zvarritur me fytyrë përtokë.” (Tirmidhi, Kiamet, 3/2424. Shih. Muslim, Xhennet, 57)

Ndërsa në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Ai, që Allahu e udhëzon në rrugën e drejtë, është i udhëzuar; ndërsa për atë që Ai e çon në humbje, me siguri që nuk do të gjesh mbrojtës tjetër, përveç Atij. Ne do t’i tubojmë ata në Ditën e Kiametit, me fytyrat përtokë, të verbër, shurdhë e memecë. Vendbanimi i tyre është Xhehenemi. Kurdo që të zbehet zjarri, Ne do t’ia shtojmë flakën.” (Isra, 97)

“Ata që do të tubohen me fytyrat përmbys në Xhehenem, do të jenë në vendin më të keq dhe më të larguarit prej rrugës së vërtetë.” (Furkan, 34)

Enes ibn Malik ﷺ tregon:

“Erdhi një person dhe pyeti:

«O i Dërguar i Allahut! Si do të ringjallet mohuesi me fytyrë përtokë në ditën e Kiametit?»

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«A nuk ka fuqi Allahu, i Cili atë që e bën të ecë mbi këmbë në dynja, ta bëjë të ecë mbi fytyrë ditën e Kiametit?»

Katade, i cili e transmeton këtë hadith, në fund thotë:

“Po, betohem në madhësinë e Zotit tonë se Ai është i plotfuqishëm për këtë!” (Buhari, Rikak, 45; Muslim, Munafikin, 54)



Një nga ngjarjet që do të zhvillohet në sheshin e Mahsherit, është edhe afrimi i Diellit mbi njerëzit. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka shpjeguar:

“Ditën e Kiametit, Dielli do t’u afrohet njerëzve deri në distancën një



milje¹⁵⁰. Njerëzit do të zhyten në djersë në masën e veprave të këqija të tyre. Dikush do të zhytet deri në thembra, dikush deri në gjunjë, e dikush deri në brez. Ndërsa disa të tjerë do të zhyten deri në fut.” (Muslim, Xhennet, 62; Tirmidhi, Kiamet, 2/2421)

“Ditën e Kiametit, njerëzit do të djersitin në sheshin e Mahsherit (për shkak të ngjeshjes, tmerrit dhe afrimit të Diellit). Aq sa djersa e derdhur do të futet në tokë deri në thellësinë shtatëdhjetë parakrahë (dhira). Më pas do të ngrihet (niveli i djersës) derisa t’ua mbyllë gojën, e madje do të arrijë deri në veshët e tyre.” (Buhari, Rikak, 47)

“Ditën, kur të gjithë njerëzit do të ngrihen (të dalin para) Zotit të botëve!”¹⁵¹ Njëri prej tyre, do të ngrihet në këmbë i zhytur në djersën e tij, që i arrin deri në gjysmë të veshëve.” (Buhari, Rikak, 47; Muslim, Xhennet, 60)

Me këtë rast, duhet të theksojmë edhe njëherë se jeta e berzahut dhe e Ahiretit, kanë kushtet dhe cilësitë e tyre të veçanta, të cilat do të jenë shumë të ndryshme nga ato të jetës së dynjasë. Për shembull, nëse Dielli do të afrohej në këtë botë, çdo gjë do të digjej e do të shkrumbohej. Po ashtu, nëse një tufan do të shkaktonte përmbytjen e gjithë botës, të gjithë njerëzit do të vdisnin. Mirëpo, në Ahiret, gjëra të tilla do të manifestohen sipas gjendjes së veçantë të gjithsecilit. Për rrjedhojë, me afrimin e Diellit në ditën e Kiametit, gjynahçarët do të vuajnë shumë, por nuk do të vdesin, sepse atje nuk do të ketë më vdekje.

Gjithashtu, kur njerëzit në Mahsher të djersitin për shkak të nxehtësisë së Diellit, gjithsecili do të mbytet vetëm në djersën e vet. Në analogji me këtë fenomen, na është sqaruar edhe fakti se në ditën e Kiametit gjithkush do të ecë në dritën e vet. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik shpjegohet:

“Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtare, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet):

«Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!» Atë Ditë, hipokritët dhe hipokritet do t’u thonë besimtarëve:

150. Një nga transmetuesit e hadithit, Sulejm ibn Amir, ka thënë: “Beto hem në Allahun se, nuk e di nëse Profeti ﷺ, me (fjalën) “mil” ka pasur për synim një njësi matëse në tokë, apo “milin” që përdoret për të lyer sytë!”.

151. Mutaffifin, 6.



«Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!» Por atyre do t’u thuhet:

«Kthehuni prapa e kërkoni tjetër dritë!» Dhe, ndërmjet tyre, do të vendoset një mur me portë: brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim.» (Hadid, 12-13)

Në atë ditë të tmerrshme, drita e çdo njeriu do të mjaftojë vetëm për të dhe nuk do t’i bëjë dobi askujt tjetri. Kjo është një nga gjendjet më të jashtëzakonshme dhe më të mrekullueshme të ditës së Kiametit.

Si paralelizëm i kësaj gjendje në këtë botë, shpjegohet ky shembull:

Një besimtar ecën nën dritën e besimit të vet, ndërkohë që një mohues pranë tij mbetet gjithmonë në errësirën e mohimit dhe nuk përfiton aspak prej dritës së besimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe një i verbër që ecën për-krah me një njeri që sheh, nuk përfiton aspak prej dritës së syrit të tjetrit.

I nderuari Imam Sharani, lidhur me djersën e jashtëzakonshme që do të derdhin njerëzit në ditën e Mahsherit shprehet:

“Është e sigurt se njerëzit që do të djersitin atë ditë, kur kanë qenë në dynja nuk kanë djersitur duke bërë punë të mira si: lufta në rrugën e Allahut të Madhëruar, shkuarja në haxh, agjërimi, falja e namazit, ndihma e myslimanëve në punët e tyre dhe hapja e puseve me qëllim që njerëzit të pinë prej tyre. (Kanë qëndruar larg këtyre punëve) Për këtë arsye, ata do të mbyten në djersë në sheshin e Mahsherit. Përveç kësaj, kur të jenë duke pritur në sheshin e Mahsherit, ata do të djersitin edhe prej turpit, frikës dhe shqetësimit të madh.” (Imam Sharani, “Vdekja, Kiameti, Ahireti”, fq. 159)

Shkurtimisht, është bërë e ditur se ditën e Mahsherit do të ketë ngjarje aq të frikshme, saqë edhe njerëzit, të cilët në varr janë përgëzuar me Xhenet, do ta harrojnë këtë mëshirë dhe falje hyjnore.¹⁵² Strehohemi tek Allahu i Madhëruar prej të gjitha këtyre tmerreve...

Shefaati (ndërmjetësimi) i Profetit ﷺ.

Ebu Hurejre رضي الله عنه transmeton:

Një ditë ishim së bashku me të Dërguarin e Allahut ﷺ, në një gosti.

Profetit ﷺ iu ofrua një copë shpatull, të cilën e pëlqente shumë. Pasi këputi një kafshatë prej saj me majat e dhëmbëve, tha:

“Unë do të jem zotëria i njerëzve në Ditën e Kiametit! Dhe a e dini pse? Allahu do t’i grumbullojë njerëzit në Ditën e Kiametit, nga të parët tek të fundmit, në një vend të rrafshët. Aty, nëse u hedh shikimin, është e mundur t’i shohësh të gjithë, e nëse dikush thërret, mund t’ia dëgjojnë zërin të gjithë. Dielli afrohet dhe njerëzit ndiejnë vështirësi dhe vuajtje, aq sa nuk i rezistojnë dot. (Në një transmetim thuhet se kjo pritje do të zgjasë shtatëdhjetë vjet)¹⁵³ Disa njerëz u thonë të tjerëve:

«A nuk e shikoni se në çfarë gjendje jemi? A nuk e shikoni se çfarë na ka gjetur? Pse nuk kërkoni dikë që mund të ndërmjetësojë për ju tek Zoti juaj?» Disa të tjerë thonë:

«Shkoni tek babai juaj Ademi!»

Njerëzit shkojnë tek Ademi  dhe i thonë:

«O Adem! Ti je babai i njerëzimit. Allahu të ka krijuar me duart e Tij dhe ka fryrë tek ti nga shpirti i krijuar prej Tij. Po ashtu, Ai ka urdhëruar melekët, e ata të ranë ty në sexhde, dhe pastaj të vendosi në Xhenet. Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Ai më ndaloi që të haja nga “pema”, por unë nuk e dëgjova. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër, shkoni tek Nuhu!»

Ata shkojnë tek Nuhu  dhe i thonë:

«O Nuh! Ti je i pari i të Dërguarve dhe Allahu të ka cilësuar si **“rob shumë falënderues”**¹⁵⁴! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se në ç’gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk

153. shih. Is’hak ibn Rahuje, Musned, I, 84/10; Bejhaki, el-Ba’th ue’n-Nushur, I, 336/609.

154. shih. Isra, 3.



do të zemërohet ndonjëherë si tani. Një lutje (të pranuar) që e kam pasur, e bëra kundër popullit tim. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek Ibrahim!

Ata shkojnë tek ai dhe i thonë:

«Ti je i Dërguar i Allahut dhe mik i Tij ndër banorët e tokës! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se në ç'gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Pastaj, ai iu kujton atyre “(tre) gënjeshttrat e tij”. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te dikush tjetër, shkoni tek Musai!»

Ata shkojnë tek Musai **موسى** dhe i thonë:

«O Musa! Ti je i Dërguar, Allahu të ka përzgjedhur duke të dhënë Shpallje (Risaleh) dhe duke të të folur drejtpërdrejt! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt, a nuk e sheh se në ç'gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Unë kam vrarë një njeri, të cilin nuk isha urdhëruar ta vrisja. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek Isai!»

Ata shkojnë tek Isai **إسحٰى** dhe i thonë:

«O Isa! Ti je i Dërguar i Allahut, u ke folur njerëzve kur ishe në djep, ti je Fjalë prej Tij (Allahut), të cilën Ai e vendosi tek Merjemja, si shpirt i krijuar prej Tij! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se në ç'gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Isai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Por ai nuk iu përmend ndonjë gabim. (E megjithatë thotë) -Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek dikush tjetër! Shkoni tek Muhamedi **محمد**!»

Profeti **ﷺ**, vazhdimin e kësaj ngjarjeje e përcjell kështu në një hadith tjetër:

“Ata vijnë tek unë dhe më thonë:

«O Muhamed! Ti je i Dërguar i Allahut dhe vula e Profetëve. Allahu të ka falur gabimet e kaluara dhe të mëvonshme!¹⁵⁵ Ndërmjetëso për ne tek

155. Këtu aludohet në ajetin 2, të sures Fet'h, ku urdhërohet: **“Për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme!..”** dhe kjo shprehje është një kallëp që përdoret për të përforcuar kuptimin. Domethënë, me këtë shprehje, Allahu i Madhëruar dëshiron të tregojë se Profeti ﷺ është i pafajshëm dhe i ruajtur prej gjynaheve. Përveç kësaj, në lidhje me fjalën “gjynah” që përdoret në ajet, janë bërë këto shpjegime:

- Me këtë gjynah, nënkuptohen rastet kur i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ka bërë zgjedhjet më të mira dhe më primare, por ato më pak të drejta. Në fakt, cilësimi i këtyre veprimeve si “gjynah”, ndërkohë që normalisht nuk është gjynah, është për shkak se Allahu i Madhëruar e sheh Profetin ﷺ në pozitë të lartë. Prandaj edhe është thënë: “Disa vepra të mira dhe të pranueshme të njerëzve të mirë e të devotshëm, mund të konsiderohen si të meta për ata që janë në një nivel të lartë në afërsinë me Allahun e Madhëruar, sepse niveli i afërsisë që kanë ata me Allahun, e bën të domosdoshme që ata të shfaqin virtyte edhe më të larta.

- Disa dijetarë kanë thënë se këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë gjynah të vepruar, por për ndonjë veprim që të mos kritikohet. Ndërsa me shprehjen “gjynahet e ardhshme”, nënkuptohen disa gjynahe të ummetit të tij, të cilat do të falen në sajë të ndërmjetësismit të Profetit ﷺ.

- Me këtë shprehje janë aluduar gabimet apo gjynahet e vogla, të cilat mund të jenë të pavullnetshme. Gjithsesi, qofshin të vullnetshme apo jo, këto gabime janë të pranueshme për profetët, sepse ato i ruajnë ata nga pëlqimi i vetvetes. Përveç kësaj, fakti që edhe profetët janë qenie njerëzore, i bën ata të gabueshëm, gjë e cila i pengon ummetit e tyre që t'i ngrënë ata apo t'u atribuojnë atyre cilësi të larta në mënyrë të tepruar.

- Kjo shprehje mund të jetë përdorur me qëllim që të nxisë ummetin e Muhamedit ﷺ, drejt kërkimit të faljes (istigfarit).

- Nëse merret parasysh koha, vendi dhe gjendja në të cilën është zbritur ky ajet, bëhet e qartë se, qëllimi i kësaj shprehjeje, janë disa gabime që myslimanët kanë vepruar gjatë luftës dhe përpjekjeve në përhapjen e Islamit nën udhëheqjen e Profetit ﷺ, në ato 19 vite. Këto gabime nuk i di askush. Madje, mendja e njeriut nuk arrin të gjejë ndonjë të metë në këto përpjekje të sinqerta. Mirëpo, në syrin e Allahut të Madhëruar, i Cili vlerëson me kriteret e më të mirës dhe më të bukurës, ishin gabime të tilla, saqë për shkak të tyre, myslimanët nuk kishin gëzuar asnjë fitore të padiskutueshme ndaj idhujtarëve. Për rrjedhojë, Allahu i Madhëruar, me këtë urdhër dëshiron të thotë: “Nëse do të kishit vazhduar përpjekjet dhe luftën tuaj me këto gabime, do të duhej edhe shumë kohë që t'i mundnit e t'i mposhtnit idhujtarët arabë. Mirëpo, Ne jua falëm të gjitha këto të meta e gabime dhe duke i eliminuar ato vetëm me mirësinë dhe mëshirën tonë, ju hapëm derën e çlirimit dhe fitores në Hudejbije. Përndryshe, ju nuk do ta kishit arritur dot këtë fitore me forcat tuaja!”

Këtu, duhet kuptuar mirë edhe çështja se, për çfarëdo qëllimi të përpiqet dhe të luftojë një grup apo bashkësi, të gjitha mangësitë, të metat dhe gabimet e asaj përpjekjeje, i ngarkohen liderit të atij grupi. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se këto janë mangësi dhe gabime personale të liderit. Në fakt, ato gabime janë bërë nga e gjithë ajo bashkësi, pra, janë rezultat i veprimeve të asaj bashkësie. Por, për shkak se përgjegjësia bie mbi liderin, edhe akuzat bien mbi të.

Përveç kësaj, duhet theksuar edhe se surja Nasr, është zbritur në ditët e fundit të Profetit ﷺ, si lajmërim për vdekjen e tij. Në këtë sure, Allahu i Madhëruar e fton të gjithë ummetin Islam në emër të Profetit ﷺ, të falënderojnë Allahun me tesbih për çdo fitore dhe të kërkojnë faljen e Tij për çdo gabim që e bëjnë në mënyrë të pavullnetshme. Për rrjedhojë, edhe Profeti ﷺ, kohët e fundit të jetës së tij, i përsëriste shpesh këto fjalë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ أَتُوبُ إِلَيْهِ



Zoti yt! A nuk e sheh se në ç'gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Unë nisem dhe shkoj nën Arshin (e Allahut) dhe bie në sexhde për Zotin tim. (Kjo sexhde do të zgjasë një javë)¹⁵⁶ Pastaj Allahu më frymëzon disa laude dhe falënderime për Të, të cilat nuk ia kishte frymëzuar tjetërkujt para meje. (Pasi thura laude dhe falënderime me to) Allahu i Madhëruar më thotë:

«O Muhamed! Ngrije kokën (nga sexhdja)! Kërko e do të të jepet, ndër-mjetëso dhe do të të lejohet!»

Unë e ngre kokën dhe them:

«O Zot! Ummeti im, ummeti im!»

Atëherë më thuhet:

«O Muhamed! Ata që nuk do të merren në llogari prej ummetit tënd, futi në Xhenet nga porta e djathtë. (Babu'l-Ejmen)! E ata do të hyjnë bashkë me njerëzit edhe nga portat e tjera veç kësaj!»

Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, se distanca ndërmjet dy anëve të një dere prej dyerve të Xhenetit, është sa distanca ndërmjet Mekës dhe Hexherit (Në Bahrejn), ose sa distanca ndërmjet Mekës dhe Busras (qytet në jug të Sirisë)” (Buhari, Enbija 3, 9, Tefsir 17/5; Muslim, Iman, 327, 328; Tirmidhi, Kiamet, 10)

Në një transmetim tjetër, i Dërguari i Allahut ﴿﴾, thotë:

“...Unë kërkoj leje tek Allahu (për ndërmjetësim) dhe ajo më jepet. Ai më frymëzon dhe unë e falënderoj Atë me fjalë që ende nuk i di.. E falënderoj me to dhe bie në sexhde për Të. Pastaj më thuhet:

“Larg të metave është Allahu dhe falënderimet i takojnë Atij. Kërkoj faljen e Tij dhe pendohem tek Ai!”

Kur nëna jonë Aisha ﴿﴾, e pyeti për shkakun e përsëritjes së shpeshtë të këtyre fjalëve, Profeti ﴿﴾, tha: “Zoti im më lajmëroi se do të shoh një shenjë brenda ummetit tim. Që kur e kam parë atë shenjë, i përsëris shpesh këto tesbih. Atë shenjë e kam parë në suren Nasr, e cila lajmëron për çlirimin e Mekës: “**Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve!**” (Nasr, 1-3)” (Muslim, Salat, 220)

156. shih. Ahmed ibn Hanbel, Musned, I, 4; Ibn-i Hibban, Sahih, XIV, 394; Hejthemi, X, 374.



«O Muhamed! Ngrije kokën! Fol e do të dëgjohesh, kërko e do të të jepet, ndërmjetëso e do të të lejohet të ndërmjetësosh!» Them:

«O Zot! Ummeti im, ummeti im!»

Thuhet:

«Shko dhe nxirr prej tij (Xhehenemit) atë që në zemrën e tij ka besim sa kokrra e elbit (ose e grurit)!» Nisem dhe ashtu veproj. Pastaj kthehem dhe e falënderoj (Allahun) me këto falënderime...”

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, shkon për herë të dytë, i thuhet: “nxirr prej tij (Xhehenemit) atë që në zemrën e tij ka besim sa një grimcë apo sa një kokërr sinapi!”. Ndërsa kur shkon për herë të tretë, i thuhet: “nxirr prej tij (Xhehenemit) atë që në zemrën e tij ka besim sa kokrra më e vogël e sinapit!” (shih. Muslim, Iman, 326, 322)

Siç shihet edhe në hadithet fisnike, ditën e Kiametit, të gjithë njerëzit do të kërkojnë një shpëtimtar për t’i shmangur prej vuajtjeve dhe tmerreve të asaj dite. Mirëpo, ata do të vërejnë të tmerruar se të gjitha degët, ku zgjaten për t’u kapur, do t’u ngelen në dorë një e nga një. Më në fund, në një moment kur shpresat e tyre do të fillojnë të veniten, ata do të kuptojnë se i vetmi person, të cilit i ecën fjala në atë shesh të tmerrshëm, është Profeti ynë ﷺ, dhe do të shkojnë menjëherë tek ai. Pas kësaj, Profeti ﷺ, do të ndërmjetësojë për ta dhe do t’i shpëtojë prej tmerreve e vuajtjeve.

Në një kohë kur të gjithë profetët do të qajnë hallin e vet, Profeti ﷺ do të jetë i vetmi që do të mendojë për ummetin e tij dhe i vetmi të cilit do t’i dëgjohet kërkesa e do t’i pranohet lutja.



Gjithashtu, Profeti ﷺ do të ketë edhe të drejtën e ndërmjetësimeve më të veçanta për ummetin e tij. Lidhur me këtë, ai ka thënë:

“Shefaati (ndërmjetësimi) im, (pikësëpari) do të jetë për ata që kanë bërë gjynahe të mëdha prej ummetit tim!” (Ebu Daud, Sunnet, 20-21/4739; Tirmidhi, Kiamet, 11/2435-6; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 37; Ahmed, III, 213)

Fakti që i Dërguari i Allahut në këtë hadith shprehet se do të ndërmjetësojë për ata që kanë kryer gjynahe të mëdha prej ummetit të tij, nuk do të thotë se shefaati i tij do të jetë vetëm për ta. Sigurisht që ata që kanë kryer gjynahe të mëdha kanë më tepër nevojë për shefaatin e tij. Por shefaati i tij



do të jetë në disa lloje. Për këtë arsye, çdokush që dëshiron Allahu, do të përfitojë prej shefaatit të Profetit ﷺ, në përputhje me gjendjen e tij.

Nga ana tjetër, ky hadith fisnik nuk duhet të na bëjë pasivë dhe as të bëhet shkak që ne të neglizhojmë detyrat tona të devotshmërisë. Sjelljet që ne i konsiderojmë të parëndësishme, ose për të cilat mendojmë se gjithsesi do të na falen, tek Allahu mund të jenë gjynahe të mëdha. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ju përcillnit me gjuhët tuaja dhe flisnit me gojët tuaja diçka, për të cilën nuk kishit dijeni. Ju këtë e merrnit për gjë të lehtë, por para Allahut kjo ishte një shkelje e madhe.” (Nur, 15)

Ndërsa në një hadith fisnik, na bëhet e ditur se një grua ka merituar dënimin e Xhehenemit për shkak se ka lënë të ngordhë urie një mace.¹⁵⁷ Sigurisht që edhe e kundërta e kësaj është e mundur. Pra, një mirësi që ne e konsiderojmë të vogël, mund të bëhet shkak që ne të fitojmë kënaqësinë dhe mëshirën e Allahut. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tregon:

“Kohë më parë, një njeri kishte pasur etje gjatë udhëtimit. Ai kishte gjetur një pus, kishte zbritur poshtë, kishte pirë ujë dhe kishte dalë. Por ç’të shihte! Një qen po merrte frymë me gjuhën e nxjerrë një pëllëmbë jashtë, dhe prej etjes së madhe po lëpinte dheun e lagësht. Njeriun e kishte brejtur ndërgjegjja dhe kishte thënë me vete:

«Këtë qen e paska marrë etja njësoj si mua!» Pastaj, kishte zbritur menjëherë në pus, kishte mbushur këpucën me ujë dhe duke e mbajtur me gojë, ishte ngjitur lart dhe i kishte shuar etjen qenit. Allahu i Madhëruar, ishte kënaqur prej veprimit të tij dhe ia kishte falur gjynahet.”

Sahabët, me habi të madhe pyetën:

«O i Dërguar i Allahut! A do të kemi sevape edhe prej kafshëve?»

Profeti ﷺ, iu tha:

“Për çdo gjallesë ka sevape.” (Buhari, Shurb, 9; Muslim, Selam, 153)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Një person, pa një degë peme në rrugë dhe tha: «Betohem në Allahun se do ta largoj këtë degë peme që të mos i pengojë myslimanët!»

E largoi dhe për këtë fitoi Xhenetin.” (Muslim, Birr, 128)

Nisur nga kjo, ne duhet të ruhemi prej të gjitha gjynaheve dhe të kryejmë sa më shumë vepra të mira, pa peshuar madhësinë e tyre!



Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

...عَسَىٰ أَنْ يَبْعَثَكَ رَبُّكَ مَقَامًا مَّحْمُودًا

“...Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.” (Isra, 79)

Shprehja “*makamen mahmuden / vend-pozitë e lavdëruar*”, që përmendet në këtë ajet fisnik, aludon pikërisht në pozitën e shefaatit/mundësisë së ndërmjetësimit, që do të gëzojë Profeti ﷺ.

Siç përmendet edhe në hadithin e mësipërm, ajo pozitë do të jetë e posaçme vetëm për Profetin ﷺ, i cili është mëshirë për botët. Në atë kohë, Profeti ﷺ, do të mbajë në dorë Flamurin e Falënderimit (Livau'l-Hamd) dhe të gjithë profetët, përfshirë edhe Ademin ﷺ, do të mblidhen nën këtë flamur.¹⁵⁸

Është me vend të theksojmë edhe faktin se profetët, tek të cilët njerëzit do të shkojnë për të kërkuar ndërmjetësim para se të shkojnë tek Profeti ynë ﷺ, nuk e konsiderojnë veten të denjë për të ndërmjetësuar për shkak të gabimeve që kanë bërë. Kjo sjellje na flet për përulësinë dhe modestinë e tyre të lartë, por shpreh edhe faktin se pozita e ndërmjetësimit ka disa gradë dhe më të lartën e zotëron Profeti ﷺ. Më vonë, me lejen e Allahut, edhe profetët e tjerë do të ndërmjetësojnë për njerëzit.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, është shprehur se Allahu i Madhëruar i ka dhënë të drejtën e tre lutjeve të pranuar. Më pas vazhdon:

“...Pas kësaj unë u luta:

«O Allah! Fale ummetin tim! O Allah! Fale ummetin tim!»

Ndërsa lutjen time të tretë e kam ruajtur për ditën kur të gjitha krijesat, madje edhe Ibrahimimi ﷺ, do të kenë nevojë për mua dhe do të më kërkojnë të ndërmjetësoj.” (Muslim, Musafirin, 273)



158. shih. Tirmidhi, Menakib, 1/3615, Tefsir, 18; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 37.



E pavarësisht gjithë këtyre fakteve, disa persona thonë se askush nuk mund të bëjë ndërmjetësim tek Allahu, sado i devotshëm qoftë. Ata i anashkalojnë këto hadithe në lidhje me shefaatin dhe nuk duan t’i pranojnë këto të vërteta. Mirëpo, në shumë ajete fisnike, shprehet qartë se ata që lejon Allahu, do të mund të bëjnë ndërmjetësim në botën tjetër. Për shembull:

“...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?..” (Bekare, 255)

“...S’ka ndërmjetës tek Ai, përveçse me lejen e Tij!..” (Junus, 3)

“Askush nuk do të mund të ndërhyjë, përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.” (Merjem, 87)

“Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai jep leje...” (Sebe’, 23)

E në mënyrë të veçantë, ky ajet fisnik është shembull i qartë që tregon se shefaati është një e vërtetë që do të realizohet vetëm me lejen e Allahut:

“Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala.” (TaHa, 109)

Zbritja e banorëve të qiellit në tokë

Në sajë të ndërmjetësimit të Profetit ﷺ, tashmë i vjen fundi edhe pritjes së frikshme e të tmerrshme në sheshin e Mahsherit, dhe fillon dhënia e llogarisë. Për rrjedhojë, banorët e qiellit zbresin në tokë, dhe sipas një transmetimi, ata bartin librat e punëve të robërve¹⁵⁹ dhe i rrethojnë ata.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَيَوْمَ تَشَقُّقُ السَّمَاءِ بِالْغَمَامِ وَنُزِّلَ الْمَلَائِكَةُ تَنْزِيلًا

“Ditën, kur qielli me re do të hapet e engjëjt do të lëshohen në zbritjen e madhe.” (Furkan, 25)

الْمَلِكُ يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ لِلرَّحْمَنِ وَكَانَ يَوْمًا عَلَى الْكَافِرِينَ عَسِيرًا

“Atë ditë pushteti i vërtetë do t’i përkasë vetëm të Gjithëmëshirshmit. Kjo do të jetë ditë e vështirë për jobesimtarët.”

(Furkan, 26)

Ibn-i Abbasi , pasi i komenton këto ajete fisnike, tregon se si do të ndodhë kjo ngjarje e madhe:

“Qielli i dynjasë hapet dhe të gjithë melekët që ndodhen në çdo kat të qiellit zbresin në tokë. Në fillim zbresin banorët e katit të parë, të cilët janë më shumë se xhinët dhe njerëzit në tokë. Banorët e tokës i pyesin:

«Midis jush është Zoti juaj?»

«Jo!» - thonë ata.

Më pas zbresin banorët e katit të dytë, të cilët janë edhe më shumë se banorët e katit të parë dhe atyre të tokës të marrë së bashku. Banorët e tokës i pyesin:

«Midis jush është Zoti juaj?»

«Jo!» - thonë edhe ata...

Në këtë mënyrë zbresin me radhë të gjithë melekët, që prej katit të shtatë, dhe rreshtohen radhë-radhë.¹⁶⁰ Melekët e çdo kati, janë më tepër se ata të një kati më parë dhe të gjithë banorët e tokës të marrë së bashku.”

(Hakim, IV, 613/8699)

Shfaqja e Allahut të Madhëruar

Pas zbritjes së banorëve të qiellit në tokë, do të shfaqet edhe Allahu i Madhëruar. Në atë moment, të gjithë popujt dhe melekët do të jenë të rreshtuar radhë-radhë. Në Kuranin fisnik lajmëron:

“E ç’presin tjetër ata, që t’u vijë Allahu përmes hijeve të reve bashkë me melekët?!¹⁶¹ Atëherë merr fund puna! Tek Allahu kthehen të gjitha punët.” (Bekare, 210)

160. shih. Nebe’, 38; Fexhr, 22; Zumer, 75.

161. Në këtë ajet aludohet në ardhjen e Allahut të Madhëruar në vendin e Mahsherit në një mënyrë të panjohur për ne, ku do të shfaqet ashtu si dëshiron Ai dhe do të fillojë të marrë në llogari robërit e Tij. Ndërsa disa dijetarë, mendojnë se ky ajet duhet të kuptohet si “ardhje e urdhrët të Allahut dhe dënimit të Tij”.



“Dhe Toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmitarët, e ata do të gjykohen me drejtësi, e nuk do t’u bëhet asnjë padrejtësi.” (Zumer, 69)

Ndërsa në një ajet tjetër fisnik, na përshkruhet një skenë prej asaj dite të vështirë e të tmerrshme - ditës së Kiametit:

“Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime, kur të vijë Zoti yt (për të ndarë gjykimin) me melekët të rreshtuar radhë-radhë.”
(Fexhr, 21-22)

Nga një hadith fisnik, bëhet e ditur se kur të shfaqet Allahu i Madhëruar, njerëzit nuk do ta përballojnë dot madhësitinë dhe fuqinë e Tij dhe do t’u bjerë të fikët. I pari që do të vijë në vete, është Profeti ﷺ.¹⁶²

Abdullah ibn Omer رضي الله عنه, tregon:

“Një ditë, e pashë të Dërguarin e Allahut ﷺ në minber tek thoshte:

«Allahu -Azze ue Xhelle- do t’i palosë e do t’i mbledhë qiejt dhe tokat, do t’i marrë në dy duart e Tij dhe do të urdhërojë:

“Unë jam Allahu! Unë jam Sunduesi! Ku janë sunduesit e tokës? Ku janë të fuqishmit (tiranët), ku janë mendjemëdhenjtë?!»

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut thoshte këto fjalë, mbledhte dhe hapte gishtat e tij të bekuar. Atë moment vura re se minberi po lëkundej me themel. Aq, sa fillova të shqetësohem duke menduar, «se mos përmbysen minberi dhe rrëzon Profetin ﷺ?!» (shih. Muslim, Munafikin, 23-26)

Në një ajet fisnik, sqarohet se atë ditë njerëzit do të dalin në audiencën hyjnore duke u vendosur në rreshta:

“Ata do të sillen të radhitur para Zotit tënd (e do t’u thuhet):

«Tashmë Na erdhët, ashtu siç ju krijuam herën e parë, ndonëse ju (o jobesimtarë) pretendonit se nuk do t’ju caktonim një takim (ringjalljen)».” (Kehf, 48)

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar shpreh edhe indiferencën e madhe të robërve në jetën e kësaj bote, në lidhje me faktin se një ditë do të

kthehen e do të dalin përsëri para Tij. Mirëpo, për shkak se çdo gjë atëherë do të ketë mbaruar, pendimi i tyre në atë vend nuk do t'u bëjë asnjë dobi.

Ata që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari

I Dërguari i Allahut ﷺ, në një hadith fisnik na ka lajmëruar se disa njerëz do të hyjnë në Xhenet pa përjetuar vuajtjet e llogarisë:

“Zoti im më ka premtuar se do të vendosë në Xhenet shtatëdhjetëmijë persona nga ummeti im, pa i llogaritur dhe pa i dënuar. Në të njëjtën kohë, Ai më ka premtuar se për çdo njëmijë persona, do të hyjnë në Xhenet shtatëdhjetëmijë të tjerë dhe tre grushte të mbushur plot prej grushteve të Zotit tim¹⁶³.” (Tirmidhi, Kiamet, 12/2437; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 34; Ahmed, V, 250)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, na bën të ditur shpërblimin e madh që ka detyra e ruajtjes së kufirit në mbrojtje të atdheut dhe mirësitë që do të arrijë ai person që bie dëshmor në krye të kësaj detyre:

“Të bësh roje në kufi një ditë e një natë, është më e dobishme se një muaj i kaluar ditën me agjërim dhe natën me adhurim. Nëse personi vdes gjatë shërbimit të rojës, sevapi dhe shpërblimi i punës që ishte duke bërë, vazhdon gjer në Kiamet. Po ashtu, atij i vazhdon edhe furnizimi si dëshmor (në Xhenet), ndërsa në varr është i sigurt nga pyetjet e melekeve që kërkojnë llogari!” (Muslim, Imare, 163)¹⁶⁴

Njëherë, një sahab i nderuar pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Përse besimtarët sprovohen me pyetjet e melekeve në varr, ndërkohë për dëshmorin/shehidin bëhet përjashtim?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, iu përgjigj kështu:

“Sepse atij i mjafton si provë shkëlqimi i shpatës mbi kokë!” (Nesai, Xhenaiz, 112/2051)

Kjo do të thotë se qëndrimi i tij përballë shpatave dhe mos hezitimi i tij në sakrificimin e jetës në rrugë të Allahut, mjafton si provë e besimit të tij dhe nuk ka më nevojë për ndonjë sprovë apo llogari tjetër. Ndërsa besimtarët që nuk vdesin si dëshmorë, duhet të kalojnë nëpërmjet një sprove besimi.

163. Kjo shprehje, -Allahu e di më mirë- mund të jetë përdorur në mënyrë metaforike për të shprehur një sasi të madhe.

164. shih. Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 2; Nesai, Xhihad, 39; Ibn-i Maxhe, Xhihad, 7.



Përveç kësaj, kushti më i rëndësishëm i statusit të dëshmorit tek Allahu i Madhëruar, është “sinqeriteti”. Pra, statusi i dëshmorit bëhet vizë e hyrjes në Xhenet pa u marrë në llogari, vetëm nëse ai bëhet posaçërisht për hir të Allahut dhe pa pritur shpërblim nga askush tjetër. Nisur nga kjo, dëshmorë mund të quhen vetëm ata që përpiqen për një qëllim të lartë, siç është përhapja e fesë së Allahut dhe mos përdhosja e saj dhe simboleve të saj nën këmbët e armiqve, në tokën e atdheut ku feja e Allahut jetohet e lirë. Përndryshe, ata që vdesin duke u përpjekur për përfitime të kësaj bote si pasuri, pronë, famë apo nder, nuk mund të quhen dëshmorë.¹⁶⁵

Domethënë, dëshmorët që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, janë besimtarët e sinqertë që presin shpërblimet e tyre vetëm prej Allahut të Madhëruar, e jo ata që presin lavdërime dhe përfitime prej njerëzve në këtë botë.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka lajmëruar:

“Kur njerëzit do të qëndrojnë për të dhënë llogari, do të vërehet një grup me shpata të vendosura në qafë dhe me plagë që u rrjedhin gjak, të cilët do të jenë të mblidhur para derës së Xhenetit. Do të pyetet:

«Kush janë këta?»

Do t’u thuhet:

«Këta janë dëshmorë. Në fakt ata nuk kishin vdekur, ishin të gjallë dhe furnizoheshin nga Allahu!»

Më pas, një thirrës do të lajmërojë:

«Ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut, të ngrihen e të futen në Xhenet!»

Ai do ta përsërisë këtë për herë të dytë:

«Ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut, të ngrihen e të futen në Xhenet!»

Njerëzit do të pyesin:

«Kush janë ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut?» Do t’u thuhet:

«Ata që i falnin njerëzit!»

Më pas, thirrësi do lajmërojë për herë të tretë:

«Ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut, të ngrihen e të futen në Xhenet!»

Pas kësaj, do të ngrihen kaq mijë vetë dhe do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari.” (Taberani, Eusat, II, 285; Hejthemi, X, 411)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, lidhur me këta njerëz, shprehet kështu në Kuranin Fisnik:

“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.” (Shura, 40)



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Mua m’u treguan të gjithë popujt. Një profet filloi të kalonte pranë meje dhe kishte me vete një popull. Kaloi një profet tjetër që kishte vetëm një grup. Kaloi një profet që kishte vetëm dhjetë veta. Kaloi një profet tjetër që kishte pesë veta. Kaloi edhe një profet tjetër, por i vetmuar. Më pas, vura re një turmë të madhe... dhe pyeta:

«O Xhibrill! Ky është ummeti im?»

Ai tha:

«Jo, por shiko horizontin!»

Kur pashë atje, vura re një turmë shumë të madhe. Më pas, Xhibrili ﷺ tha:

«Ja, ai është ummeti yt! Ndërsa për ata shtatëdhjetëmijë persona që ndodhen në krye të tyre, nuk do të ketë as llogari, e as dënim!»

«Përse?» -pyeta unë. Xhibrili ﷺ, u përgjigj:

«Sepse ata;

- Nuk janë përpjekur të kurohen duke u damkosur me zjarr,

- Nuk kanë kërkuar prej askujt që t’u bëjë rukje (për t’i shëruar),¹⁶⁶

166. Rukja, pra, kërkimi prej Allahut të Madhëruar që t’i japë shërim të sëmurit me anë të disa shprehjeve që gjenden në Kuran dhe në hadithe, është e lejuar. Lidhur me këtë, ekzistojnë edhe transmetime që tregojnë se Profeti ﷺ, e ka praktikuar personalisht. Ndërsa dënosa që bëhet në këtë hadith ndaj atyre që kërkojnë t’u bëhet rukje, është për shkak se ata e bëjnë këtë punë duke mos e pritur shërimin dhe dobinë prej Allahut, por prej krijesave, gjë e cila është në kundërshtim me parimin e mbështetjes vetëm në Allahun e Madhëruar. Njësoj si ai



- Ata mbështeten vetëm tek Zoti i tyre!»

Kur Profeti ﷺ tha këto fjalë, Ukkashe ibn Mihsan ؓ u ngrit menjëherë në këmbë dhe tha:

“O i Dërguar i Allahut) Lutju Allahut që të më bëjë prej tyre!” I Dërguari i Allahut ﷺ u lut duke thënë:

“O Allah! Bëje këtë person prej tyre!” Më pas, një sahab tjetër u ngrit dhe tha:

“Lutju Allahut të më bëjë edhe mua prej tyre!” Kësaj here, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ukkashe ta kaloi në këtë çështje!” (Buhari, Rikak, 50; Muslim, Iman, 367-374)

Ndërsa në një transmetim tjetër përdoret shprehja, “ata nuk bënë dhe nuk lejonin të bëhej magji”.¹⁶⁷



Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, na ka lajmëruar edhe për besimtarët e tjerë që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari:

“Ditën e Kiametit, njerëzit do të mblidhen në një vend të sheshtë. Nëse u hedh shikimin, është e mundur t’i shohësh të gjithë, e nëse dikush thërret, mund t’ia dëgjojnë zërin të gjithë. Atë ditë, një thirrës do të thërrasë tre herë:

«Sot, të gjithë do ta marrin vesh se kush janë në të vërtetë njerëzit më të çmuar!»

Pastaj do të thotë:

«Ku janë ata që ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu dhënë Ne?»¹⁶⁸

që e konsideron shërimin prej ilaçit dhe doktorit, e jo prej Allahut. E në fakt, njeriu kurohet në saje të mundësive që i ka dhënë Allahu. Prandaj, ai nuk duhet t’ia atribuojë kurrë shërimin krijesave të përkohshme, por Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik, Ibrahim i ؑ thotë: “(Ai) i Cili, kur sëmurem, më shëron.” (Shu’ara, 80)

Domethënë, edhe nëse njeriu kapet pas shkaqeve, ai duhet të besojë me gjithë zemër se shërimi në kuptimin e vërtetë vjen vetëm prej Allahut të Madhëruar, se vetëm Atij duhet t’i besojë, se duhet të jetë i kënaqur me caktimin e Tij dhe se duhet të bëjë durim pëndajçdo gjëje që e godet.

167. shih. Muslim, Iman, 374.

168. shih. Sexhde, 16.

Ku janë ata të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin e japin zekatin?»¹⁶⁹

Më vonë, një thirrës do të lajmërojë përsëri:

«Sot, të gjithë do ta mësojnë se kush janë në të vërtetë njerëzit më të çmuar!»

Pastaj do të thotë:

«Ku janë Hammadun-ët, të cilët e falënderojnë shumë Zotin e tyre?»

(Hakim, Mustedrek, II, 433/3508; Bejhaki, Shuab, IV, 539)



Shkurtimisht, nën dritën e ajeteve dhe haditheve të mësipërme, mund të themi se njerëzit më fatlumë, të cilët do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, janë besimtarët që:

- ✓ Mbështeten plotësisht tek Allahut i Madhëruar
- ✓ Nuk besojnë në ogurin e zi
- ✓ Nuk bëjnë dhe nuk lejojnë të bëhet magji
- ✓ Nuk damkosin me zjarr
- ✓ Bien dëshmorë
- ✓ Falin njerëzit
- ✓ Ngrihen në namazin e natës ¹⁷⁰

169. shih. Nur, 37.

170. Allahu i Madhëruar e urdhëron Profetin ﷺ të vazhdojë të ngrihet në namazet e natës dhe e përgëzon me lajmin se do ta ngrejë në pozitën e lartë të “Makam-i Mahmud”. (shih. Isra, 79) Nisur nga kjo, mund të themi se nëse edhe besimtarët vazhdojnë të kryejnë namazet e natës, ata mund të arrijnë grada të larta shpirtërore. Për shkak se Zoti ynë dëshiron që robërit e Tij të përfitojnë sa më shumë prej kësaj mirësie, në shumë ajete fisnike, Ai nxit me këmbëngulje namazin e natës:

...وَالْمُسْتَغْفِرِينَ بِالْأَسْحَارِ

“...që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.” (Al-i Imran, 17)

كَانُوا قَلِيلًا مِّنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ ﴿٧١﴾ وَيَالِ الْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ ﴿٨١﴾

“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).” (Dharijat, 17-18)

مَنْ هُوَ فَانْتَ أَنَاءَ اللَّيْلِ سَاجِدًا وَقَائِمًا يَحْذَرُ الْآخِرَةَ وَيَرْجُو رَحْمَةَ رَبِّهِ

“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?!..” (Zumer, 9)



- ✓ Dhurojnë me sinqeritet për hir të Allahut
- ✓ Përmendin shumë Allahun, e falenderojnë vazhdimisht Atë dhe për këtë arsye shpërblimi i tyre i takon Allahut.

Ata që do të hyjnë në Xhehenem pa dhënë llogari

Përveç atyre që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, si manifestim i faljes dhe mëshirës hyjnore të Allahut të Madhëruar, do të ketë edhe prej atyre që do të hidhen në Xhehenem pa pasur fare nevojë të merren në llogari. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, është shprehur:

“Ditën e Kiametit, prej Xhehenemit do të dalë një qafë (copë zjarri), e cila do të ketë dy sy që shohin, dy veshë që dëgjojnë dhe një gjuhë që flet. Ajo do të thotë:

«Unë jam caktuar si kujdestare për tre persona (tre kategori njerëzish që do t'i djegë në zjarr):

Të gjithë zullumqarët inatçi e mizorë, ata që adhurojnë dikë tjetër së bashku me Allahun dhe ata që bëjnë portrete (pikturë/skulpturë).”¹⁷¹ (Timidhi, Xhehenem, 1/2574; Ahmed, II, 336; Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 51/34141)

وَالَّذِينَ يَبْتُغُونَ لِرَبِّهِمْ سُجَّدًا وَقِيَامًا

“Dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë” (Furkan, 64)

تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.” (Sexhde, 16)

171. Juristët dhe mufesirët Islam janë të mendimit se “pikturimi i krijesave jo të gjalla dhe bimëve si peizazhet, malet, pemët, pyjet, etj., janë të lejuara në Islam”. Në disa hadithe fisnike, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka bërë të ndaluar pikturimin e gjërave të gjalla, sepse respekti i tepruar që tregohet ndaj pikturave dhe skulpturave, i ka çuar njerëzit në idhujtari. Ajo që konsiderohet e ndaluar në këtë hadith, është piktura, skulptura dhe basorelievi i krijesave të gjalla, të cilat bëhen me dorë, sepse kjo shpreh tentativën për të ngjarë me artin e krijimit të Allahut të Madhëruar. Ndërsa fotografia, përbën përjashtim, për shkak se ajo është vetëm pasqyrimi i diçkaje që ekziston. Po ashtu, edhe veshja apo zbukurimi i mureve me copa të pikturuara në këtë mënyrë, është i ndaluar. Hanefitë nuk e kanë konsideruar si mekruh (të papëlqyeshme) shtrimin e copave të pikturuara, në tokë apo në vende që përdoren për t’u ulur. Kjo, sepse e rëndësishme në këtë pikë, është fakti i respektimit apo jo i pikturës. Ndërsa pikturat dhe skulpturat e gjallesave që varen në mur, ose mbahen në vende të larta, i kanë konsideruar mekruh në mënyrë unanime.



Pasi thotë këto fjalë, copa e zjarrit që del prej Xhehenemit në formë qafe, i merr një nga një nga radhët, ashtu siç mbledh zogu kokrrat e susamit nga toka, dhe i hedh në Xhehenem. (Ibnu'l-Mubarek, ez-Zuhd, II, 101)



Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَأَمْتَاوَا الْيَوْمَ أَيَّهَا الْمُجْرِمُونَ

“Veçohuni sot ju, o kriminelë!” (JaSin, 59)

Fjala “muxhrimun” që përdoret në këtë ajet, përmbledh mendjemë-dhenjtë, mohuesit e Allahut, hipokritët dhe idhujtarët. Dhe pikërisht këto katër kategori, janë ata që do të hidhen në Xhehenem, pa pasur nevojë të merren në llogari.

Lidhur me këtë ajet fisnik, Ismail Hakki Bursevi, jep këtë shpjegim:

“Allahu i Madhëruar bën të ditur se Ai patjetër që do t’i ndajë besimtarët nga mohuesit, duke i ringjallur besimtarët me fytyrë të ndritur, ndërsa mohuesit me fytyrë të nxirë; duke ua dhënë besimtarëve librin e punës nga e djathta, ndërsa mohuesve nga e majta; duke e rënduar peshoren e sevapeve të besimtarit, ndërkohë që do ta lehtësojë atë të mohuesit; duke e zhytur besimtarin në dritë, ndërsa mohuesin në errësirë; duke ia forcuar besimtarit këmbët në Urën e Sirati, ndërkohë që do t’ia rrëshqasë këmbët mohuesit; dhe shumë çështje tjera.” (Ruhu'l-Beyan, c. 16, sf. 383)

Kjo e vërtetë, në një ajet tjetër shprehet kështu:

وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُومِنُونَ

“E, atë ditë kur të arrijë Ora, ata (besimtarët dhe jobesimtarët) do të ndahen.” (Rum, 14)

Ndërsa Hasan Basriu -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, (besimtarët dhe mohuesit) do të ndahen, edhe sikur të kenë qenë bashkë në dynja. Besimtarët do të jenë në “a’la-ji il-lijjin” (në lartësitë më të mëdha), ndërsa mohuesit do të jenë në “esfel-i safilin” (në vendin më të ulët). Një do të jetë në gradën e takimit, ndërsa tjetri në pikën e ndarjes. Ai që gjendet në gradën e takimit, do të qëndrojë në fronin e



dashurisë, ndërsa ai që gjendet në pikën e ndarjes, do të qëndrojë në hasrën e hidhërimit dhe vuajtjes. Një popull do të jetë në lumturi e mirësi, ndërsa një popull tjetër do të tretet në zjarrin e ndarjes.” (Ruhu'l-Beyan, c. 15, sf. 35)



Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, na bën të ditur numrin e atyre që do të hidhen në Xhehenem:

“Njeriu i parë që do të thirret ditën e Kiametit, është Ademi عليه السلام. Atij do t’i shfaqen pasardhësit dhe do të shohin njëri-tjetrin. Atyre do t’u thuhet:

«Ky është babai juaj Ademi!»

Ditën kur të thirret, Ademi عليه السلام, do të thotë:

«Urdhëro, jam në urdhrat Tuaja! Të bindem me gjithë dëshirë o Zoti im!» Allahu i Madhëruar e urdhëron:

«Nxirr prej pasardhësve të tu, ata që do të shkojnë në Xhehenem!»

«O Zot! Sa do të nxjerr?» -thotë Ademi عليه السلام. E, Allahu i Madhëruar përgjigjet:

«Nxirr nëntëdhjetë e nëntë për çdo njëqind vetë!» Sahabët të frikësuar jashtë mase, pyesin:

“O i Dërguari i Allahut! Nëse merren nëntëdhjetë e nëntë për çdo njëqind prej nesh, çfarë do të mbetet pas?!” Profeti ﷺ, përgjigjet:

“Ummeti im do të jetë qimja e bardhë mbi kaun e zi, ndër të gjithë ummetet e tjera!” (Buhari, Rikak, 45)

Po ashtu, në një hadith të ngjashëm, i Dërguari i Allahut ﷺ, u ka thënë kështu sahabëve:

“Allahu i Madhëruar do të thotë (Ditën e Kiametit):

«O Adem!» Ademi do të përgjigjet:

«Lebjeke ue Saadejke (Ja ku jam, të përgjigjem! E gjithë mirësia është në Dorën Tënde!)» Allahu do t’i thotë:

«Nxirri mënjanë njerëzit që do të hyjnë në Zjarr!» Ademi do të thotë:

«O Allah! Sa do të jenë njerëzit e Zjarrit?» Allahu do t’i thotë:



«Në çdo njëmijë vetë nxirr nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë (për t'i futur në Zjarr)!»

Atë moment fëmijët do të thinjen, çdo grua shtatzënë do ta dështojë barrën dhe do t'i shohësh njerëzit si të dehur, ndërkohë që nuk do të jenë të pirë, por, në të vërtetë, ndëshkimi i Allahut do të jetë i rreptë.”

Sahabët e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, kush do të jetë ai «njëri» prej nesh (që do të shpëtojë nga Zjarri)?” Profeti ﷺ iu tha:

“Gëzohuni për sihariqin! Një do të jetë prej jush dhe njëmijë do të jenë nga Je'xhuxh- Me'xhuxhët.”

Pastaj i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“(Betohem) për Atë, në Duart e të Cilit është jeta ime! Shpresoj shumë që ju të jeni çereku i banorëve të Xhenetit!”

Për këtë arsye, sahabët falënderuan Allahun dhe bënë tekbirë (Allahu Ekber). Më pas Profeti ﷺ shtoi:

“Shpresoj shumë që ju të jeni gjysma e banorëve të Xhenetit.” Sahabët thirrën përsëri: «Allahu Ekber»

Pastaj Profeti ﷺ tha:

“Ju (muslimanët në krahasim me popujt e tjerë) jeni si një qime e bardhë në lëkurën e një kau të zi...” (Buhari, Rikak, 46)

Hapja e librit të veprave

Ditën e Kiametit do të hapen librat ku janë shkruar të gjitha veprat, të këqija apo të mira, që njerëzit kanë bërë në jetën e dynjasë dhe të gjithë do t'i shikojnë qartë veprat e tyre. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

يَوْمَ نَدْعُو كُلَّ أُنَاسٍ بِإِمَامِهِمْ ۗ فَمَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ فَأُولَٰئِكَ يَقْرَءُونَ

كِتَابَهُمْ وَلَا يُظْلَمُونَ فَتِيلًا

“Ditën, kur Ne do t'i thërrasim të gjithë popujt me prijësin (të dërguarin) e vet, ata, që do t'u jepet libri në anën e djathtë, do ta



lexojnë librin e vet dhe nuk do të pësojnë as padrejtësinë më të vogël.” (Isra, 71)

وَتَرَىٰ كُلَّ أُمَّةٍ جَائِيَةً كُلُّ أُمَّةٍ تُدْعَىٰ إِلَىٰ كِتَابِهَا الْيَوْمَ تُجْزَوْنَ مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ

“Atëherë të gjithë popujt do t’i shohësh të gjunjëzuar. Çdo popull do të thirret në Librin e vet (e do t’i thuhet): «Sot do të shpërbleheni për atë që keni bërë!»” (Xhathije, 28)

وَكُلِّ إِنسَانٍ أَلزَمْنَاهُ طَائِرَهُ فِي عُنُقِهِ وَنُخْرِجُ لَهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ كِتَابًا يَلْقَاهُ مَنْشُورًا

“Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t’ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur. (Pastaj do t’u themi):” (Isra, 13)

اقْرَأْ كِتَابَكَ كَفَىٰ بِنَفْسِكَ الْيَوْمَ عَلَيْكَ حَسِيبًا

“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” (Isra, 14)

وَأَشْرَقَتِ الْأَرْضُ بِنُورِ رَبِّهَا وَوُضِعَ الْكِتَابُ وَجِيءَ بِالنَّبِيِّينَ وَالشُّهَدَاءِ

وَقُضِيَ بَيْنَهُم بِالْحَقِّ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ

“Dhe Toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmitarët e ata do të gjykojnë me drejtësi, e nuk do t’u bëhet asnjë padrejtësi.” (Zumer, 69)



Vetëm Allahu i Madhëruar e di natyrën e librit të veprave. Mirëpo, sipas asaj që na është bërë e ditur, ai është libri ku do të shënohet çdo gjë e madhe apo e vogël që ka vepruar njeriu, pa u anashkaluar qoftë edhe vepra më e imët. Lidhur me këtë, në Kuran sqarohet:


“Dhe Libri (i veprave të tyre) do t’u vihet përpara, e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë:

«Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë?»



Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.” (Kehf, 49)

Siç vihet re në këtë ajet, njerëzit do të ankohen për shkak se do të shohin të shënuara edhe gjynahet që ata kanë menduar se kanë qenë të vogla.

I Dërguari i Allahut ﷺ, i cili e ka ditur më së miri këtë të vërtetë, na ka paralajmëruar neve, si ummetin e tij, duke iu drejtuar nënës sonë Aishes :

“O Aishe! Ruhu prej veprave që nënvleftësohen (edhe prej gjynaheve më të vogla që nuk u jepet rëndësi)! Sepse tek Allahu është një (melek) që i vëzhgon dhe i shënon ato.” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 29; Darimi, Rikak, 17; Ahmed, VI, 70, 151)

Ndërsa në një hadith tjetër shprehet:

“Ruhuni prej gjynaheve që duken të vogla, sepse ato mblidhen tek dikush dhe në fund e shkatërrojnë atë!” Pastaj, në lidhje me gjynahet e vogla ka dhënë një shembull:

Një grup njerëzish qëndrojnë për të pushuar në shkretëtirë. Në kohën e ushqimit, njëri shkon e sjell një degë të vogël peme, e një tjetër shkon e sjell një degë tjetër dhe kështu mbledhin një pirq të madh. Më pas i ndezin dhe gatuajnë ushqimin.¹⁷²

Domethënë, gjynahet që konsiderohen të vogla dhe nuk evitohen, me kalimin e kohës mblidhen dhe i dalin para njeriut si një dënim i madh. Për rrjedhojë, ajo që duhet të bëjë njeriu, është të ruhet me kujdes prej të gjitha gjynaheve, pa bërë dallim në madhësinë e tyre. Por, nëse nuk arrijmë të ruhem dhe biem në ndonjë gjynah, pa humbur kohë duhet të pendohemi tek Allahu i Madhëruar dhe t'i kërkojmë falje me lot në sy.



Ditën e Kiametit, ata, të cilëve u jepet libri i veprave nga e djathta, arrijnë lumturinë e përjetshme me një gëzim të papërshtueshëm, ndërsa ata, të cilëve u jepet libri nga e majta apo nga mbrapa, do të ndajnë deri në palcë dhimbjen që u shkakton humbja e përjetshme. Në Kuranin Fisnik, gjendja e tyre përshkruhet në këtë mënyrë:

172. shih. Ahmed, I, 402-403; V, 331.



“Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t’u thotë (njerëzve të tij): «Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.»

Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur, në një kopsht të lartë, frutat e të cilit do t’i kapë lehtë. (Njerëzve të tillë u thuhet:)

«Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!»

Por ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë:


«Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time!» (Hakka, 19-26)

“Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. Kurse ai, të cilit do t’i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet, sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari).” (Inshikak, 7-14)

Shkurtimisht, ata që mashtrohen prej tundimit të egos dhe shejtanit në këtë botë të përkohshme dhe lodrojnë në indiferencën e kënaqësive të ulëta, duke e pandehur mjerimin si lumturi, në Ahiret do të përpëliten mes frikës së tmerrshme dhe hidhërimeve të pafundme.

Përkundër kësaj, besimtarët që përpiqen të bëjnë një jetë të devotshme në këtë botë, pa ndaluar adhurimet gjatë gjithë jetës, ashtu siç e meriton të adhurohet Allahu i Madhëruar, në jetën e vërtetë që është Ahireti, do të arrijnë lumturinë dhe paqen e vërtetë.



Ditën e Kiametit, askush nuk do të mendojë për askënd në atë situatë të tmerrshme. Nëna jonë Aishja  tregon:

“Një herë tek mendoja rreth Xhehenemit fillova të qaj. Kur Profeti , më pa në këtë gjendje më pyeti:

«Aisha, çfarë ke?»

«Mu kujtua Xhehenemi dhe nisa të qajë. Ju profetëve, a do t’ju bjerë ndërmend për familjet tuaja ditën e Kiametit?» - iu përgjigja unë.



I Dërguari i Allahut ﷺ, më dha këtë përgjigje:

«Janë tre momente kur njeriut nuk ka për t'i rënë ndërmend për askënd përveç vetes :

1. Kur të peshohen veprat dhe të jetë duke mësuar nëse peshorja do të jetë e rëndë me vepra, apo e lehtë!

2. Kur t'i jepet libri dhe t'i thuhet “...Urdhëro dhe lexo librin!”¹⁷³, (sepse) ende nuk e di nga do t'i vijë ai: djathtas, majtas apo nga pas!

3. Dhe kur të vendoset Ura e Siratit mbi Xhehenem! Në të dy anët e kësaj ure do të ketë shumë kanxha dhe gjemba të fortë. Me ato kanxha, Allahu do të kapë kë të dëshirojë nga krijesat e Tij dhe do ta hedh në Xhehenem. Ja pra, derisa të mësojë nëse do të shpëtojë apo jo nga këto kanxha, njeriut nuk i bie ndërmend për askënd tjetër përveçse për veten e tij!» (Hakim, IV, 622/8722. Shih. Ahmed, VI, 101, 110)

Llogaria

Llogaria e kafshëve

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, na ka bërë të ditur se edhe kafshët do t'i nënshtrohen llogaridhënies në Ahiret:

“Patjetër që ditën e Kiametit, do t'u jepni të drejtat (që u keni marrë) të zotëve të tyre! Madje, edhe për delet pa brirë¹⁷⁴, do të merret haku prej deleve me brirë që e kanë dëmtuar.” (Muslim, Birr, 60; Tirmidhi, 2/2420)

Një ditë, pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ, po kullotnin dy dele. Në një moment, njëra prej deleve i ra me brirë tjetrës, duke u bërë shkas që ajo të dështojë qengjin që kishte në bark. Profeti ﷺ, që e dëshmoi këtë ngjarje, buzëqeshi. Kur e pyetën:

“Përse buzëqeshët o i Dërguar i Allahut?”, ai u përgjigj:

“U habita me gjendjen e këtyre kafshëve! Beto hem në Atë, në dorën e të Cilit gjendet jeta ime, se ditën e Kiametit do të merret hak për këtë ngjarje, duke marrë shpazim prej deles tjetër!” (Ahmed, V, 172)

173. shih. Hakka, 19.

174. Këtu aludohet ose në llojin e bagëtisë (si dele, dhi, etj), ose në racën e veçantë të llojit të deleve me brirë.

Këto deklarata të Profeti ﷺ, tregojnë se veprat do të peshohen vërtet, dhe përbëjnë një këshillë shembullore për ne. Pra, fakti se askujt nuk do t'i mbetet e drejtë pa u marrë, madje se edhe padrejtësitë që ndodhin midis kafshëve do të gjykohen pa asnjë mangësi, na shtyn të mendojmë e të imagjinojmë se sa serioze do të jetë llogaridhënia që na pret.

Ne duhet të nxjerrim mësim prej lajmeve që na kanë ardhur dhe të ruhem, me aq sa të kemi mundësi, prej shkeljes së të drejtave të robërve dhe të kafshëve. Përveç kësaj, ne duhet t'i shohim krijesat me syrin mëshirues të Krijuesit, duke iu afruar atyre me butësi, mëshirë dhe dashuri të madhe.

Nuk duhet të harrojmë se të gjitha krijesat janë krijuar për t'i shërbyer njeriut, por edhe si mësim për të. Ato ia janë lënë po atij nën kujdes. Prandaj, mëshira dhe ruajtja e të drejtave të tyre, është detyrë morale për njeriun. Ndërsa padrejtësia ndaj kafshëve është një gjynah me të cilin do të përballemi në botën tjetër.

Njëherë, nëna jonë Aisha ؓ, kishte hipur në një deve pak të egër. Për ta qetësuar devenë, ajo filloi ta lëvizte me forcë para-mbrapa. I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha Aishes ؓ:

“Sillu butë me kafshën, sepse butësia zbukuron, kudo që të gjendet. Një sjellje pa butësi, është e shëmtuar.” (Muslim, Birr, 789, 79)



Osmanët kanë shfaqur shembuj të shumtë të butësisë ndaj krijesave dhe të respektimit të të drejtave të tyre, prej të cilëve ne duhet të marrim mësim. Për shembull, të parët tanë e kishin ndaluar ngarkimin e tepërt të kafshës. Madje, disa zabitë janë ngarkuar me detyrën e ndjekjes së atyre që e shkelnin këtë ligj, me qëllim që t'i çlodhnin kafshët dhe të gjobitnin pronarët e tyre, duke i bërë të bartin të njëjtën ngarkesë, si dënim për ta.

Fakti që sulltan Sulejman Kanuni- Ligjvënësi, gjatë ndërtimit të xhamisë Sulejmanije, pati nxjerrë një sërë fermanësh/dekretesh mbi kafshët e transportit, është një tregues i kësaj ndjeshmërie! Në kuadër të këtyre dekreteve, është respektuar edhe koha e pushimit dhe kullotjes në lëndina të kuajve, gomarëve dhe mushkave që përdroreshin për punë, duke treguar kështu përpjekje të jashtëzakonshme në mos shkeljen e të drejtave të krijesave. Fakti që Sulltan Sulejman Kanuni ka treguar një kujdes kaq të madh në ruajtjen e të drejtave të robërve dhe të kafshëve, mbase përbën edhe një



prej motiveve kryesore të pozitës së jashtëzakonshme shpirtërore që ka xhamia e famshme Sulejmanije.

Një ditë, sulltan Sulejman Ligjvënësi, me anë të një dyvargëshi poetik, i kërkoi fetva (vendim juridiko-fetar) Shejhu'l-Islamit Ebu's-Suud Efendit, për të vrarë milingonat që po i thanin drurët e dardhave në kopshtin e pallatit:

*Nëse milingonat, pemët frutore dëmtojnë,
A ka ndonjë të keqe nëse ato i shfarojmë?*

Kësaj kërkese të padishahut, edhe Shejhu'l-Islamit Ebussuud Efendiu i dha përgjigje poetike me një dyvargësh të tillë:

*Nesër para Zotit në gjyq kur të dalë,
Milingonat, nga Sulejmani hakun kanë për të marrë!*



Lidhur me ajetin, **“Dhe kur egërsirat të tubohen.”**¹⁷⁵, Ibn-i Abbas , ka thënë:

“Çdo gjë do të ringjallet dhe do të mblidhen në sheshin e Mahsherit. Madje, edhe mizat!” (Ibn-i Kethir, Tefsir, et-Tekuir, 5)

Pasi të mblidhen të gjitha krijesat në sheshin e Mahsherit, do të fillojë edhe llogaridhënia. Mirëpo, çështjet gjyqësore midis kafshëve do të zgjidhen para atyre të njerëzve. Në fund të këtij gjyqi, të gjitha kafshët do të kthehen përsëri në dhé. Lidhur me këtë, në Kuran urdhërohet:

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا طَائِرٍ يَطِيرُ بِجَنَاحَيْهِ إِلَّا أُمَمٌ أَمْثَالُكُمْ
مَا فَرَطْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ يُحْشَرُونَ

“Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju. Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.” (En'am, 38)

Po ashtu, lidhur me këtë ajet fisnik, Ebu Hurejre  shprehet:

175. Tekuir, 5.



“Ditën e Kiametit, të gjitha krijesat do të mblidhen në sheshin e Mahsherit - kafshët, insektet, zogjtë dhe çdo gjë tjetër. Aty do të sundojë plotësisht drejtësia e Allahut të Madhëruar. Madje, edhe e drejta e deles pa brirë, do të merret prej deles me brirë që e ka dëmtuar. Më pas, Allahu i Madhëruar do t’i urdhërojë kafshët: **«Bëhuni dhé!»** Pikërisht atëherë, mohuesit që do e shohin këtë, (nga frika e llogaridhënies) do të thonë: **«Ah, sikur të bëhesha dhé (si kafshët)!»**” (Hakim, Mustedrek, II, 345/3231. Shih. Hakim, IV, 619/8716)

Padyshim, ky përshkrim tregon qartë nivelin që do të arrijnë atë ditë, ndjenjat e pendesës, turpit dhe frikës!



Fakti që edhe për kafshët do të vendoset drejtësi në mënyrë të hollësishtme, duhet ta ftojë njeriun në një nivel të lartë meditimi!

Një prej Shejhu’l-Islam-ëve, Osman Kadizade, shprehet:

“Nëse njeriu nuk ka siguruar hallallekun¹⁷⁶ në këtë botë, nga të dëmtuarit e ndonjë padrejtësie të tij, në botën tjetër ata do t’ia kërkojnë të drejtën e tyre. Mbi të gjitha, nëse ai të cilit i është bërë padrejtësi është mohues ose kafshë, çështja vështirësohet, sepse mohuesit dhe kafshës nuk mund t’i japen sevape prej të besimtarit...”¹⁷⁷

Llogaridhënia e njerëzve

Në Mahsher, momenti më i frikshëm për njeriun, është ai kur do të japë llogari për të gjitha veprat që ka kryer, në këtë botë të përkohshme që është edhe vendi i sprovave. Ky bilanc do të përcaktojë njëherë e përgjithmonë drejtimin e jetës së tij. Për këtë arsye, në momentin e llogaridhënies, njeriut i shtohet në maksimum frika dhe shqetësimi.

Një person shkoi tek Aliu ﷺ dhe e pyeti:

“Si do të pyeten përnjëherësh të gjithë ata që do të jenë në Mahsher?”

Aliu ﷺ i dha këtë përgjigje shumë të urtë:

“Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do t’i pyesë të gjithë përnjëherë,

176. Të shprehësh keqardhje dhe kërkosh falje për të keqen që ke bërë.

177. shih. Birgivi Vasiyetnamesi Kadizade Şerhi, s. 128.

ashtu siç i furnizon (në këtë botë) të gjithë përnjëherë!”¹⁷⁸



Sipas një transmetimi, llogaritë e përbashkëta do të bëhen para llogarive personale. Pra, në Mahsher njerëzit do të thirren: “O ju që keni bërë këto gjynahe!”, dhe ata menjëherë do të ngrihen në këmbë dhe do të poshtërohen në sytë e të gjithë njerëzve në Mahsher.

Nisur nga kjo, asketi i njohur prej tabiinëve, Ebu Hazm el-A'raxh, bënte shpesh vetllogari me këto fjalë:




“O Ebu Hazm! Ditën e Kiametit do të thirret: «O ju që keni bërë këtë gjynah!» dhe ti do të ngrihesh së bashku me ata që e kanë vepruar atë gjynah! Më pas do të thirret për një gjynah tjetër, e ti përsëri do të ngrihesh! O A'raxh, mesa duket ti dëshiron të ngrihesh vazhdimisht me gjynahqarët!”


(Ebu Nuajm, Hilje, III, 230; Imam Sharani, “Vdekja, Kiameti, Ahireti”, fq. 152-153)

Pasi të mbarojnë llogaridhëniet e përbashkëta, njerëzit do të merren në llogari një nga një.



Ibni Ebu Mulejke  tregon:

Kur Aishja  bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut  dëgjonte diçka që nuk e kuptonte si duhet, hetonte mbi çështjen derisa të ishte krejt e qartë. Një ditë, Profeti  kishte thënë: “Kush llogaritet në mënyrë të hollësishme (në Ditën e Gjykimit), ai ndëshkohet!”

Aishja  e kishte pyetur:

“O i Dërguar i Allahut! A nuk thotë Allahu i Madhëruar (në Kuran): **«Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë»?**¹⁷⁹

Profeti  ishte përgjigjur:

“Në të vërtetë, ajo (për të cilën bëhet fjalë në ajet) është “ard”. Mirëpo, kush llogaritet në mënyrë të hollësishme, do të shkatërrohet.” (Buhari, IIm, 36,

178. shih. Birgivi Vasiyetnamesi Kadızade Şerhi, s. 126.

179. Inshikak, 7-8.



Rikak, 49; Muslim, Xhennet, 79, 80; Ebu Daud, Xhenaiz, 1/3093)

Fjala “ard” që përdoret në hadith, shpreh paraqitjen e njerëzve tek Mizani/Peshorja për peshimin e veprave, ose paraqitjen e veprave tek të zotët e tyre. Në Kuranin Fisnik tregohet se për njerëzit e devotshëm, që quhen “As’hab-i Jemin”, llogaria ditën e “ard”-it do të kalojë shumë lehtë.¹⁸⁰ As’hab-i Jemin, pra ata të cilëve do t’u jepet libri nga e djathta, do të përgëzohen me falje, dhe kur t’u paraqiten veprat e tyre, bashkë me gabimet do të shohin edhe mirësitë që do t’i gëzojnë. Për këtë arsye, ata nuk do të vuajnë shumë gjatë llogaridhënies. Ndërsa llogaridhënia e atyre që nuk do të përgëzohen me falje, do të jetë shumë e vështirë. Gjatë llogaridhënies, personi do të shohë se shumë vepra që i pandehte të mira, nuk do t’i pranohen, gjë e cila do ta bëjë të vuajë atë njeri.



Ka shumë vepra që pandehen si mirësi, por për shkak se janë bërë me para të pista (haram), ose janë përzier me qëllime jo të pastra, siç është dukja, nuk do të pranohen tek Allahu i Madhëruar. Këto lloj veprash, në Ahiret do të jenë një zhgënjim i madh për të zotin, i cili shpreson të marrë shpërblimin e tyre, dhe do jenë burim i thellë pendimi.

Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

﴿٤﴾ تَصَلُّى نَارًا حَامِيَةً ﴿٣﴾ عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ

“Kanë punuar e janë rraskapitur (po më kot). Ata do të digjen në zjarr të nxehtë!” (Gashije, 3-4)

قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿١٠٣﴾ الَّذِينَ ضَلَّ سَعِيُهُمْ فِي الْحَيَاةِ

الدُّنْيَا وَهُمْ يَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴿١٠٤﴾

“Thuaj: «A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënë vepra të mira?»” (Kehf, 103-104)

Për shembull, një person financon ndërtimin e një xhamie, të një kursi Kurani, apo ndonjë fondacion bamirësie, dhe vendos emrin e tij në to, me qëllim që të tregojë famën e vet. Ky veprim nuk konsiderohet aspak i drejtë, për shkak se i hap derën dukjes, mendjemadhësisë dhe mburrjes; dhe dëshira për vëmendje, -siç shprehet edhe Profeti ﷺ-, “është një shirk i vogël”¹⁸¹. Mirëpo, besimi monoteist nuk e toleron aspak ortakërinë/shirkun (në adhurim). Megjithatë, pas vdekjes së bamirësit (që ka financuar vepra të tilla), është e lejuar vendosja e emrit të tij në ato vepra, me qëllim të kujtimit të tij me lutje.

Dëshmitarë të fortë

Gjatë llogaridhënies në Ahiret, robi do të ketë pranë edhe dëshmitarë, sepse mohuesit dhe njerëzit e këqij, ashtu si në jetën e dynjasë, do të vazhdojnë mohimin dhe kundërshtimet e tyre edhe gjatë llogaridhënies. Atëherë, Allahu i Madhëruar do t’ua vulosë gojët dhe do të urdhërojë që të flasin gojët e tjera. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

يَوْمَ تَشْهَدُ عَلَيْهِمْ أَلْسِنَتُهُمْ وَأَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.” (Nur, 24)

الْيَوْمَ نَخْتِمُ عَلَىٰ أَفْوَاهِهِمْ وَتُكَلِّمُنَا أَيْدِيهِمْ وَتَشْهَدُ أَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ

“Sot Ne do t’ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.”

(JaSin, 65)

حَتَّىٰ إِذَا مَا جَاءُوهَا شَهِدَ عَلَيْهِمْ سَمْعُهُمْ وَأَبْصَارُهُمْ

وَجُلُودُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

“Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.” (Fussilet, 20)

وَقَالُوا لَجُلُودِهِمْ لِمَ شَهِدْتُمْ عَلَيْنَا ۗ قَالُوا أَنطَقْنَا اللَّهُ الَّذِي أَنطَقَ كُلَّ شَيْءٍ

181. shih. Ahmed, V, 428, 429.

وَهُوَ خَلَقَكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

“Ata do t’u thonë lëkurëve të veta:

«Pse dëshmuat kundër nesh?» E ato do të përgjigjen:

«Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.» (Fussilet, 21)¹⁸²



Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me këtë çështje ka thënë:

“...Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do t’i thotë robit të vet:

«A nuk mendove fare se do të takohesh me mua?» Robi do të përgjigjet:

«O Zoti im, unë të kam besuar Ty, librave të Tu dhe të dërguarve të Tu. Kam falur namaz, kam agjëruar dhe kam dhënë lëmshë!» Më pas do ta laudërojë Allahun e Madhëruar aq sa ka mundësi. Allahu xhel-le xhelaluhu do t’i thotë:

«Prit atëherë! Tani do të vijë një dëshmitar kundër teje!»

Robi do të mendojë me vete:

«Kush do të jetë ai që do të dëshmojë kundër meje?» Ndërkaq, robit i vuloset goja. Pastaj, këmbëve, mishit dhe kockave të tij do t’u thuhet:

«Hajde, flisni!»

Këmbët, mishi dhe kockat e tij do të flasin dhe do të tregojnë gjithçka që ka bërë ai. Ky person është një munafik (hipokrit), dhe do të vuaj zemërimin e Allahut.” (Muslim, Zuhd, 16)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

“Robi thotë:

«O Zoti im! A nuk më ruajte Ti nga padrejtësia?» Allahu i Madhëruar i përgjigjet:

182. Për hadithet lidhur me këtë çështje, shih: Buhari, Tefsir, 41/1, 2, Teuhid, 41; Muslim, Sifatu'l-Munafikin, 5; Tirmidhi, Tefsir, 41/3248.



«Po të ruajta!» Për këtë arsye robi thotë:

«Sot, unë nuk dua që dikush tjetër të dëshmojë për mua përveç vetes time!» Allahu i Madhëruar thotë:

«Sot, ty të mjafton vetja si dëshmitar i vetëm dhe Kiramen Katibin¹⁸³ si dëshmitarë të shumtë!»

Pastaj atij i vuloset goja dhe organeve të tjera u thuhet:

«Flisni!»

Atëherë, ata tregojnë për veprat e personit. Pastaj atij i jepet leje të flasë dhe ai u drejtohet organeve të veta:

«Turp të keni! Zhdukuni që këtu! Unë për ju po përpiqem!» (Muslim, Zuhd, 17)



Po ashtu, Allahu i Madhëruar na bën të ditur në Kuranin Fisnik se si dëshmitare do të thirret edhe toka mbi të cilën ka jetuar personi:

يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ﴿٤﴾ بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا ﴿٥﴾

“Atë Ditë ajo (toka) do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë.” (Zelzele, 4-5)

Njëherë, Profeti ﷺ, këndoi këtë ajet fisnik dhe i tha sahabëve:

“A e dini se cilat janë lajmet që do të tregojë toka?” Ata thanë:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!” Më pas, Profeti ﷺ sqaroi:

“Lajmet e saj janë dëshmia për veprat që ka bërë mbi tokë çdo rob, femër apo mashkull qoftë, duke thënë: «Në këtë ditë dhe në këtë kohë ke vepruar këtë gjë!». Ja, këto janë lajmet e tokës.” (Tirmidhi, Kiamet, 7/2429; Tefsir, 99/3353; Ahmed, II, 374; Hakim, II, 281/3012)

Po ashtu, në një hadith tjetër thuhet:

“Ruhuni prej tokës, sepse ajo është nëna juaj! Ajo është vendi në të cilën jetojmë dhe tek e cila do të kthehemi në fund. Ajo do të tregojë për të gjitha veprat e mira apo të këqija që bëhen mbi të!” (Hejthemi, I, 241)

183. Kiramen Katibin: Melekët që shkruajnë veprat e njeriut.



Atë ditë, njeriu do të pyes i shastisur: “Çfarë ka kjo tokë!? Si mund të tregojë gjithçka që ka ndodhur?!” , e më pas do të ngrihet i tmerruar.



Atë ditë do të ketë dëshmitarë prej melekëve dhe njerëzve. Mirëpo, dëshmitari më i madh, padyshim që është Vetë Allahu i Madhëruar. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَوُفِّيَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ وَهُوَ أَعْلَمُ بِمَا يَفْعَلُونَ

“Secilit do t’i jepet shpërblimi për atë që ka bërë, sepse Ai e di më së miri se çfarë kanë punuar.” (Zumer, 70)

Nëse ne arrijmë ta kuptojmë këtë të vërtetë ashtu siç duhet dhe heqim dorë nga çdo e keqe, nuk do të ketë nevojë për asnjë dëshmitar tjetër përveç Allahut të Madhëruar, i Cili është shumë i mëshirshëm me robërit e Tij.

Lidhur me këtë çështje, tregohet se njëherë një vaiz (predikues) ishte duke treguar çështjet e botës tjetër, ndërkohë që midis xhematit ndodhej edhe i nderuari Shejh Shibli.

Vaizi, duke folur për pyetjet që do të bëjë Allahu i Madhëruar në Ditën e Gjykimit, u shpreh:

“Do të pyetesh se ku e ke përdorur diturinë! Do të pyetesh se ku e ke fituar dhe ku e ke shpenzuar pasurinë! Do të pyetesh se si e ke kaluar jetën, adhurimet si i ke pasur! A ke bërë kujdes ndaj haramit dhe hallallit?.. Pas këtyre, do të pyetesh për këto e ato gjera!..”, dhe numëroi edhe disa gjëra të tjera të rëndësishme.

Shejh Shibli, i cili po dëgjonte me vëmendje, me një zë të butë tha:

“O vaiz efendi! Harrove një nga pyetjet më të rëndësishme! Allahu i Madhëruar, shkurt do të pyesë:

«O robi Im! Unë isha me ty, më afër se damari i qafës tënde; po ti me kë ishe?!»”

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

...وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ...

“...Ai është me ju kudo që të jeni!..” (Hadid, 4)



وَوَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ...

“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet!” (Kaf, 16)

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ...

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër...” (Bekare, 186)

Pra, Allahu i Madhëruar, i Cili nuk ndikohet aspak nga koha dhe hapësira, është çdo çast me ne robërit e Tij! Ai di çdo gjendje tonën dhe dëshmon për çdo vepër që bëjmë... Për rrjedhojë, duke qenë të vetëdijshëm për këtë realitet, si besimtarë që jemi, ne duhet ruhem me shumë kujdes nga veprimet dhe sjelljet që nuk i kanë hije edukatës sonë.



Në atë ditë të madhe llogarie, do të sillet si dëshmitar për popullin e tij, edhe Profeti ﷺ. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

فَكَيْفَ إِذَا جِئْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ بِشَهِيدٍ وَجِئْنَا بِكَ عَلَىٰ هَؤُلَاءِ شَهِيدًا

“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty (o Muhamed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!”

(Nisa, 41)

Është gjithmonë e rëndë llogaridhënia para të dashurve tanë për një faj që kemi bërë. Për rrjedhojë, duhet medituar mbi gjendjen tonë, në kohën e llogaridhënies para profetëve, prijësve dhe dëshmitarëve të tjerë. Për më tepër, gjynahet e bëra në fshehtësi në dynja, në Ahiret do të shfaqen para shumë dëshmitarëve!..

Për këtë arsye, Profeti ﷺ, i cili u dërgua si mëshirë për botët, në Hutben e Lamtumirës na është drejtuar me këto fjalë:

“...Dijeni se unë do të shkoj para dhe do t’ju pres në krye të Hauzit! Do të krenohem me numrin tuaj të shumë krahasuar me atë të ummeteve të tjerë. Prandaj, kujdes, mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..”¹⁸⁴

184. shih. Hejthemi, III, 271; Hamidullah, el-Uesaik, fq. 367.



Ndërsa në këtë ajet fisnik urdhërohet:

يَوْمَئِذٍ يَوْمَئِذٍ الَّذِينَ كَفَرُوا وَعَصُوا الرَّسُولَ لَوْ تَسَوَّىٰ بِهِمُ الْأَرْضُ
وَلَا يَكْتُمُونَ اللَّهَ حَدِيثًا

“Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që nuk i janë bindur të Dërguarit, do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën, por Allahut nuk mund t’i fshehin asnjë fjalë.” (Nisa, 42)

Shkurtimisht, nëse sot njeriu jeton larg Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Allahu do të bëjë që ditën e madhe të llogarisë, ai të ndjejë një poshtërim aq të madh, sa të dëshirojë të futet në dhe.

Ashpërsia e llogaridhënies

Mohuesit, gjynahqarët dhe indiferentët, të cilët në jetën e tyre të përkohshme ëndërrojnë gjithmonë një botë pa llogari, pa përgjegjësi dhe pa Ahiret, do të jenë gati të japin çdo gjë që kanë zotëruar në jetën e dynjasë, madje shumëfish më tepër, për të shpëtuar prej dënimit të asaj dite të keqe dhe përballjes me situatat e tmerrshme të Kiametit. Mirëpo, atë ditë gjithçka do të ketë përfunduar. Kjo gjendje, në Kuranin Fisnik përshkruhet në këtë mënyrë:

...يَوْمَئِذٍ يَوْمَئِذٍ الَّذِينَ كَفَرُوا وَعَصُوا الرَّسُولَ لَوْ تَسَوَّىٰ بِهِمُ الْأَرْضُ
وَصَاحِبَتِهِ وَأَخِيهِ ﴿١٢﴾ وَفَصِيلَتِهِ الَّتِي تُؤْوِيهِ ﴿١٣﴾
وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ يُنْجِيهِ ﴿١٤﴾

“...Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, kriminelit do të sakrifikoje me gjithë qejf fëmijët e vet, edhe gruan, edhe vëllain e vet, edhe farefisin, që i gjendej pranë (në jetën e Tokës), si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte.” (Me’arixh, 11-14)

Ndërsa Profeti ynë i nderuar ﷺ, lidhur me ashpërsinë e llogarisë hyjnore, ka thënë:

“Ditën e Gjykimit thirret një mohues dhe pyetet:



« Sikur të kishe një botë me ar, a do ta jepje gjithë pasurinë si shpagim për të shpëtuar?»¹⁸⁵

Mohuesi pa hezituuar aspak, thotë

«Po!» Pastaj i thuhet:


«Ty t'u kërkua diçka më e lehtë (adhurimi i Allahut) kur ishe në dynja, por ti iu shmange.» (Buhari, Rikak, 49; Muslim, Munafikin, 52-53)

Ndërsa në një transmetim tjetër, thuhet se kjo pyetje i bëhet: «Atij që e ka dënimin më të lehtë prej banorëve të Xhehenemit».¹⁸⁶




Adij ibn Hatim , tregon:

«Një ditë, i Dërguari i Allahut , tha:

«Ruajeni veten tuaj prej zjarrit!» dhe e tërhoqi fytyrën e tij tre herë sikur po ruhej prej zjarrit atë moment... Atëherë ne e kuptuam se Profeti  po fliste duke parë Xhehenemin. Më pas vijoi:

«Ruajeni veten tuaj prej zjarrit qoftë edhe me një gjysmë hurme! Kush nuk e gjen as atë, të paktën ta ruajë veten me fjalë të bukura!» (Buhari, Edeb, 34; Ibn Hisham, Siret, III, 30)

Ndërsa në një hadith tjetër të ngjashëm me këtë, Profeti , ka thënë:

«...Secili prej jush do të qëndrojë para Allahut të Madhëruar! Ndërmjet jush dhe Allahut nuk do të ketë as perde (pengesë) dhe as përkthyes për fjalën e Zotit. Allahu do t'i thotë robit:

«A nuk të dhashë pasuri?»

«Po o Zot, më dhe!» -do të përgjigjet ai.

«A nuk të solla të Dërguar?» -do ta pyet përsëri Allahu.

«Po, ma solle o Zot!» -do të thotë robi.

Pastaj robido të vërejë në të djathtë dhe nuk do të shohë asgjë tjetër

185. shih. Maide, 36; Junus, 54; Ra'd, 18; Zumer, 47.

186. shih. Buhari, Rikak, 51; Muslim, Munafikin, 51.



përveç Xhehenemit. Do vërejë në të majtë, por nuk do të shohë asgjë tjetër përveç Xhehenemit.

Prandaj, secili prej jush të ruhet prej Xhehenemit qoftë edhe me gjysmë hurme! Kush nuk e gjen as atë, të paktën ta ruajë veten me fjalë të bukura!”

(Buhari, Zekat, 9)

Në botëkuptimin Islam, pasuria i takon Allahut. Prandaj, Allahu i Madhëruar, prej robrit, i cili konsiderohet i pasur sipas rregullave Islame, kërkon çdo vit si “zekat”, një të dyzetën e pasurisë që i ka falur -jashtë nevojave bazike për jetën-. Për rrjedhojë, myslimani e ka farz/ të detyrueshme ta shlyej pagesën e sasisë së kërkuar.

Përveç kësaj, Allahu i Madhëruar dëshiron që robërit e Tij të japin lëmoshë dhe të dhurojnë prej pasurisë (aq sa kanë mundësi). Lidhur me këtë, në Kuran urdhërohet:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ ۚ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Al-i Imran, 92)

Kjo tregon se dhurimi, është një prej rrugëve më të rëndësishme që na afron me Allahun e Madhëruar.

“Gjysma e hurmës”, që përmendet në hadithin e mësipërm, është për atë që nuk ka asgjë tjetër çfarë të japë. Pra, nëse dikush që ka shumë më tepër mundësi, shpërndan disa hurma dhe mendon se kjo do ta shpëtojë atë prej përgjegjësisë së dhurimit, atëherë ai ka rënë në një gabim shumë të madh. Në fakt, kjo shprehje na tregon se sa vend të rëndësishëm zë “dhurimi” (për hir të Allahut) në shpëtimin e njeriut nga Xhehenemi, dhe në të njëjtën kohë na tregon se sa adhurim i rëndësishëm është ky për të gjithë ne. Nëse edhe dikush që ka një hurmë urdhërohet të japë gjysmën e saj, atëherë se sa duhet të japin ata të cilët kanë shumë më tepër mundësi, mund të kuptohet duke bërë një krahasim me këtë që u tha.

I Dërguari i Allahut ﷺ, i ka thënë një prej sahabëve më të varfër, Ebu Dherrit:

“O Ebu Dherr! Shtoji pak më tepër ujë supës tënde dhe kujdesu edhe për fqinjin tënd!” (Muslim, Birr, 142)

Kur zbriti ajeti për dhurim, edhe sahabët e varfër dolën në mal, bënë dru, dhe me ato që fituan nga shitja e tyre, dhuruan në rrugë të Allahut.

Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar thotë:

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ...

“Ata të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi...” (Al-i Imran, 134)

...وَيَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ قُلِ الْعَفْوَ...

“...Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: «Tepicën!»...” (Bekare, 219)



Po ashtu, lidhur me ashpërsinë e llogarisë në Ditën e Gjykimit, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit njeriu do të sillet si qengj dhe do të mbahet përpara Allahut të Madhëruar, i Cili do t’i thotë:

«(O rob i Im!) Të kam dhënë shumë mirësi (jetë, shëndet, etj), të kam dhënë pasuri dhe begati (fëmijë, mall e pozitë)! Çfarë ke bërë ti në këmbim të këtyre?»

Ai do të përgjigjet:

«O Zoti im! I kam kursyer, i kam shtuar dhe i kam lënë mbrapa në një gjendje më të madhe se sa ishin. Më kthe mbrapa¹⁸⁷ (në dynja) dhe do të t’i sjellë Ty (duke i shpenzuar në rrugën Tënde)!» Allahu i Madhëruar do të thotë:

«Eja më trego ato që i ke dërguar më parë në Ahiret!»

Ai do të thotë:

«O Zoti im! I kam kursyer, i kam shtuar dhe i kam lënë mbrapa në një gjendje më të madhe se sa ishin. Më kthe mbrapa (në dynja) dhe do të t’i sjellë Ty!»

187. shih. Sexhde, 12; En’am, 27-28; A’raf, 53; Mu’minun, 99, 103-111; Shuara, 94-102; Fatir, 36-37; Zumer, 55-59; Gafir, 10-12; Shura, 44-45.



Por në fakt, ai rob nuk ka vepruar asgjë të mirë për në Ahiret, prandaj ai hidhet menjëherë në Xhehenem.” (Tirmidhi, Kiamet, 6/2427; shih. Musim, Zuhd, 16)



Ndërsa Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik e shpreh kështu gjendjen e keqe ku do të bien robërit indiferentë që merren në llogari:

وَهُمْ يَصْطَرِحُونَ فِيهَا رَبَّنَا أَخْرِجْنَا نَعْمَلْ صَالِحًا غَيْرَ الَّذِي كُنَّا نَعْمَلُ
 أَوَلَمْ نُعَمِّرْكُم مَّا يَتَذَكَّرُ فِيهِ مَن تَذَكَّرَ وَجَاءَكُمُ النَّذِيرُ
 فَذُوقُوا فَمَا لِلظَّالِمِينَ مِن نَّصِيرٍ

“Atje, ata do të thërrasin: «O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë!» (Atyre do t’u thuhet):

“Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!» (Fatir, 37)

Ky, është një ajet shumë mësimdhënës, mbi të cilin duhet të qëndrojmë e të meditojmë seriozisht. Edhe pse jeta e kësaj bote të përkohshme është vetëm një çast shumë i shkurtër në krahasim me Ahiretin, për ata që dëshirojnë të mendojnë e të marrin mësim, është një afat kohor më se i mjaftueshëm. Në këtë botë, të gjithëve na është dhënë edhe kohë e mjaftueshme për të menduar, por na ka ardhur edhe një Profet, i cili na ka paralajmëruar për ndëshkimin në botën tjetër. Përveç këtyre, që prej kohës së Profetit ﷺ e deri në ditët tona, janë shkruar edhe shumë vepra që shpjegojnë mësimet e Profetit dhe Librin hyjnor që u shpall me të. Në këtë mënyrë, neve na janë mbyllur të gjitha dyert e justifikimeve përballë Allahut të Madhëruar.


Për këtë arsye, sot, nuk duhet të vonohemi aspak në braktisjen e sjelljeve dhe veprimeve të këqija dhe orientimin drejt punëve të mira e të sinqerta! Para se të llogaritemi në Peshoren hyjnore, ne duhet ta llogarisim shpesh veten tonë në mënyrë serioze, me qëllim që atë ditë, llogaria jonë të jetë e lehtë...





Manifestimi i mëshirës për besimtarët

Allahu i Madhëruar, ka një cilësi që quhet “Settaru’l-Ujjub”, e cila do të thotë: “Ai që mbulon dhe fsheh të metat”. Për rrjedhojë, një pjesë të besimtarëve gjynahqarë që do t’i falë, Ai i merr në llogari në mënyrë të fshehtë, me qëllim që atyre të mos u dalin në shesh gjynahet, e që të mos turpërohen para të gjithëve.

Safuan ibn Muhriz el-Mazini  tregon:

“Njëherë, ndërkohë që isha duke ecur bashkë me Abdullah ibn Omerin , na doli para një person dhe e pyeti Ibn-i Omerin:

«Si e keni dëgjuar çështjen Nexhua¹⁸⁸ prej të Dërguarit të Allahut ?»
Ibn-i Omeri  iu përgjigj:

«E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut , të thotë:

“Me të vërtetë që Allahu i Madhëruar do ta marrë afër robin e vet Ditën e Gjykimit dhe do t’i hedhë perden e Tij (në mënyrë që ta marrë në llogari, pa e parë askush!)” Pastaj do ta pyesë:

«A e mban mend filan gjynah? A e mban mend filan gjynah?»

«Po, e mbaj mend, e mbaj mend o Zoti im!» -ia kthen robi me keqardhje të madhe.

Duke i pohuar në këtë mënyrë gjynahet, në një moment, kur tashmë e kishte të sigurt që do të shkatërrohej, Allahu i Madhëruar i thotë:

*«Unë t’i kam mbuluar ato në dynja dhe sot, dhe do të t’i fal të gjitha!»
Më pas, besimtarit i jepet libri i të mirave.*

Sa i përket mohuesve dhe hipokritëve, dëshmitarët do të thonë në sy të të gjithëve:

«...Këta janë ata që kanë gënjer kundër Zotit të tyre. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët!»¹⁸⁹ (Buhari, Medhalim, 2, Tefsir, 11/4; Ahmed, II, 74)



188. Nexhua, do të thotë, “bisedë e fshehtë mes dy personave”. Këtu aludohet për llogarinë e fshehtë që do t’i kërkojë Allahu i Madhëruar robit të Vet, pa e dëgjuar askush tjetër.

189. Hud, 18.



Fakti që besimtari do të qëndrojë vetëm për vetëm me Allahun në momentin e llogaridhënies, është një mirësi shumë e veçantë. Për këtë arsye, njerëzit e dashuruar me Allahun, e shohin plotësisht ndryshe llogaridhënien. Prandaj edhe i nderuari Bejazid-i Bistami, një ditë tha:

“Të gjithë njerëzit duan t’i ikin llogaridhënies, ndërsa unë dua që Allahu i Madhëruar të më marrë në llogari!” Kur e pyetën për arsyen, ai dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“Mbase gjatë llogaridhënies, Allahu më thërret: «O robi Im!» Dhe unë do t’i përgjigjem: «Lebbejk/Urdhëro o Zoti im!» Fakti që Ai do të më thërrasë: «O robi Im!», është më i dashur për mua se e gjithë bota dhe çka në të. Më pas le të bëjë ç’të dojë me mua!”¹⁹⁰

Çfarë do të pyetet?

I Dërguari i Allahut ﷺ, na ka lajmëruar se pyetja e parë që do të bëhet, do të jetë në lidhje me shtyllën e fesë, që është “namazi”:

“Vepra e parë për të cilën do t’i kërkohet llogari robit ditën e Kiametit, është namazi. Nëse namazet i ka kryer me rregull (siç dëshiron Allahu), llogaridhënia do t’i shkojë mirë dhe personi do të arrijë atë që do. Por, nëse namazet s’i ka në rregull, do të dalë i humbur.

Nëse ka mangësi në namazet farz, Zoti ynë i Madhëruar e i Fuqishëm do të urdhërojë:

«Shihni, a ka robi im namaze nafile/vullnetare?» Mangësitë e farzeve plotësohen me nafilet.

Pastaj, ai vazhdon të merret në llogari në të njëjtën mënyrë edhe për punët e tjera.” (Tirmidhi, Salat, 188/413; Nesai, Salat, 9/462)



Ndërsa llogaria e parë që njeriu do të japë në lidhje me hakun e robit, do të jetë “derdhja e padrejtë e gjakut”. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Çështjet e para ndërmjet njerëzve, të cilat do të shqyrtohet Ditën e Gjykimit, janë ato në lidhje me derdhjen e gjakut.” (Buhari, Dijat, 1; Muslim, Kasame, 28)

Fakti që llogaria e gjynaheve në lidhje me derdhjen e gjakut shqyrtohet që në fillim, tregon qartë se sa e zemëron Allahun e Madhëruar vrasja apo plagosja e padrejtë e dikujt.

Vrasja e një njeriu për çështje të dynjasë, është një gjynah shumë i madh. Mirëpo, nëse dikush vret një njeri, duke e ditur se është besimtar, gjynahi është edhe më i madh. Allahu i Madhëruar, lidhur me dënimin që do të ketë një njeri i tillë, urdhëron:

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِّدًا فِجْرًاؤُهُ جَهَنَّمَ خَالِدًا فِيهَا

وَعَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُ وَأَعَدَّ لَهُ عَذَابًا عَظِيمًا

“Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh.” (Nisa, 93)



Ndërsa në lidhje me çështjet e tjera, për të cilat do të jepet llogari ditën e Kiametit, i Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Ditën e Kiametit, një nga mirësitë për të cilën do të merret në llogari robi, sqarohet në pyetjen:

Atij do t’i thuhet: «A nuk i dhamë shëndet trupit tënd? A nuk të ngopëm me ujë të ftohtë?»” (Tirmidhi, Tefsir, 102/3358)

“Ditën e Kiametit, asnjë rob nuk do të hedh qoftë edhe një hap pa u pyetur për këto pesë gjëra:

- *Ku e konsumove jetën?*
- *Ku e përdore dijen dhe çfarë veprash ke bërë me të?*
- *Ku e ke fituar pasurinë?*
- *Ku e ke shpenzuar pasurinë?*
- *Ku e ke mplakur trupin?”* (Tirmidhi, Kiamet, 1/2417)¹⁹¹



191. shih. Darimi, Mukaddime, 45/543-545; Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 125/34694.



Sot jetojmë në një kohë që quhet “shekulli i shkencës”, kohë në të cilën është shumë e lehtë të arrihet çdo lloj diturie. Tashmë injoranca pothuajse nuk mund të quhet më justifikim. Një mysliman që dëshiron të mësojë për fenë e vet, ka shumë mundësi të bëjë kërkime e të pyes. Prandaj nuk duhet të harrojmë se një ditë do të japim llogari edhe për masën në të cilën e kemi përdorur këtë mirësi të madhe, me çfarë dijesh e kemi mbushur mendjen dhe ku e kemi lodhur zemrën tonë. Nuk duhet të harrojmë se edukimi primar që duhet të marrim, është mësimi i drejtë i fesë sonë dhe zbatimi i saj në jetën tonë, me devotshmëri të lartë.

Sot shohim shumë të rinj që kanë mbaruar universitetin, kanë kryer studimet pasuniversitare, janë të ditur dhe të kulturuar. Mirëpo, për fat të keq ata nuk e njohin fare kulturën e Kuranit dhe Sunnetit. Ata mendojnë se edukimi që kanë marrë, është dija e cila lavdërohet në Kuran dhe Sunnet. Mirëpo, dijet që nuk e çojnë mendjen dhe zemrën e njeriut tek Allahu dhe nuk e bëjnë atë të mendojë për madhështinë dhe fuqinë e Tij, mund t'i sjellin njeriut një gradë apo një diplomë në këtë botë, por nuk mund ta shpëtojnë atë nga dështimi i përjetshëm.

Dija më e madhe konsiston në njohjen e Allahut të Madhëruar dhe në devotshmërinë ndaj Tij. Prandaj, ne duhet të kontrollojmë shpesh veten tonë, se sa vend zënë në jetën tonë dijet në lidhje me Kuranin Fisnik dhe Sunnetin Profetik, sepse nesër do të japim llogari, edhe për këtë.



Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik urdhëron:

ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ تَخْتَصِمُونَ

“Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!”

(Zumer, 31)

Në kohën kur u zbrit ky ajet fisnik, një prej sahabëve, Zubejri رضي الله عنه, pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! A do të përsëritet armiqësia midis nesh në Ahiret pasi të jemi gjykuar (në gjyq) në këtë botë,?”


I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, tha:

“Po! (kjo do të vazhdojë derisa atij që i është bërë padrejtësi, të marrë të drejtën e tij)” Zubejri رضي الله عنه, reflektoi:

“Atëherë puna qenka me të vërtetë shumë e vështirë!” (Tirmidhi, Tefsir, 39/3236)



Atë ditë, të shtypurit nuk do t’i mbetet asnjë e drejtë e pa marrë prej shtypësit.



Sahabët fisnik, tregonin shumë kujdes që të mos kryenin vepra për të cilat nuk do të mund të jepnin llogari ditën e gjykimit. Madje, ata të cilët tregonin pakujdesi lidhur me këtë çështje, i paralajmëronin ashpër. Një ditë, Ebu Hurejre , pa dikë që po e përzierte qumështin me ujë. Me qëllim që t’i kujtonte se duhet të vepronte duke menduar për jetën e përjetshme dhe jo vetëm për këtë jetë, i tha:

“Imagjino si do ndjehesh, nëse ditën e Kiametit do të të thuhet: «Ndaje ujin prej qumështit!»?» (Bejhaki, Shuab, VII, 231/4927)



Një ditë, i Dërguari i Allahut , po udhëtonte mbi devenë e tij, ndër-kohë që shokët ecnin para tij. Muadh ibn Xhebel  pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! Nëse nuk ju bezdis, a më lejoni të vij pranë jush?”

Me t’i dhënë leje Profeti , Muadhi  tha:

“Të qoftë falë jeta ime o i Dërguari i Allahut! I lutem Allahut që të na e marri shpirtin para teje. Qoftë larg, por nëse t’i ndërron jetë para nesh, çfarë adhurimesh të bëjmë pas teje?”

Profeti  nuk iu përgjigj kësaj pyetje. Por Muadhi  e pyeti përsëri:

“A të bëjmë xhihad në rrugën e Allahut?”

Pas kësaj Profeti , urdhëroi e tha:

“Xhihadi në rrugën e Allahut është vepër e bukur, por për njerëzit ka diçka më të mirë se ai!”

“Domethënë, të agjërosh dhe të japësh zekat apo jo?” -tha Muadhi .

“Edhe të agjërosh dhe të japësh zekat është vepër e bukur!” - tha Profeti .

Pas kësaj Muadhi  përmendi të gjitha të mirat që mund të bëjë njeriu.



Por i Dërguari i Allahut ﷺ, vazhdonte të thoshte:

“Për njerëzit ka diçka më të mirë se kjo”.

Më në fund Muadhi ﷺ pyeti:

“Të qofshin falë jeta e babait dhe nënës sime. Çfarë është më e mirë për njerëzit?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Të heshtë, nëse nuk flet diçka të mirë!”

“A do të japim llogari edhe për ato që flasim?” - pyeti Muadhi ﷺ. Profeti ﷺ, duke e rrahur lehtë gjurin e Muadhit, tha:

“Allahu të dhëntë mirësi o Muadh! E çfarë tjetër përveç gjuhës së tyre i zvarrit njerëzit për fytyrë në Xhehenem? Kush i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit, ose të flasë fjalë të mira, ose të heshtë e të mos flasë fjalë të këqija! Fitoni duke shqiptuar fjalë të mira dhe arrini paqen dhe qetësinë duke mos thënë të këqija!” (Hakim, IV, 319/7774)

Domethënë se, ditën e Kiametit do të kërkohet llogari për çdo fjalë që del prej gojës sonë në jetën e kësaj bote. Ndërsa lidhur me disa përjashtime në këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Të gjitha fjalët e birit të Ademit janë në disfavor të tij, përveç nëse urdhëron për të mirë, ndalon nga e keqja, ose përmend Allahun e Madhëruar!” (Tirmidhi, Zuhd, 63/2412)



Përveç kësaj, ashtu siç ka llogaridhënie për fjalët e kota dhe të dëmshme që dalin nga goja, do të ketë llogaridhënie edhe për fjalët që duhen thënë, por nuk thuhën:

Ebu Hurejre ﷺ tregon:

“Dëgjonim (që ndër sahabë thuhej):

Ditën e Kiametit, dikush do të kapet për jake nga një i panjohur. I habitur, personi do të thotë:

«Çfarë do prej meje në këtë kohë dhe në këtë çast kaq të vështirë? Unë nuk të njoh fare!» Ai që e ka kapur për jake do t'i sqarojë:



«Kur ishim në jetën e dynjasë, më pe duke kryer vepra të këqija dhe nuk më qortove, e nuk më ndalove nga e keqja.»” (Mundhiri, et-Tergib ue't-Terhib, III, 164/3506; Rudani, Xhem'u'l-Feuaid, V, 384)

Nisur nga kjo, duhet të jemi të vetëdijshëm se shumë njerëz, të cilët i kemi neglizhuar në këtë dynja dhe nuk i kemi këshilluar në të mirë, ditën e Mahsherit mund të na kapin për jake duke na thënë:

“Ti u nderove me Islam në sajë të përpjekjeve të singerta të atyre që ishin para teje. Në sajë të tyre e mësove Islamin dhe besimin. Po mua, pse nuk ma tregove? Përse nuk më ndihmove të shpëtoja edhe unë nga zjarri?!”

Ebu Ali ed-Dekkak (Allahu e Mëshiroftë), për të treguar se heshtja para një padrejtësie është dobësi e besimit, shprehet:

“Personi që hesht dhe nuk thotë të vërtetën, është shejtan memec.”
(Kushejri, Risale, 1, 245; Neueui, Edhkar, fq. 335/1030)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush nga ju sheh një të keqe, le ta korrigjojë atë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi, atëherë le ta bëjë me fjalën e tij. E, nëse se ka të mundur as këtë, atëherë le ta urrejë me zemrën e tij. Mirëpo, kjo është gjendja më e dobët e besimit.” (Muslim, Iman, 78)

Me pak fjalë, njeriu nuk duhet ta harrojë kurrë se do të japë llogari për çdo gjë ditën kur nuk do të anashkalohet as grimca më e vogël, qoftë prej të mirës, qoftë prej së keqes!

Për të lehtësuar llogaridhënien

Për të dalë me sukses prej llogaridhënies së frikshme të ditës së Kiametit, është e domosdoshme që të ruhemi prej hakut të robit dhe të hallallohem mi me çdokënd që mund t'i kemi hyrë në hak. Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka këshilluar vazhdimisht ummetin e tij. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me të para se të vijë Dita e Kiametit. Atë ditë nuk do të kenë vlerë floriri dhe argjendi, por veprat. Nëse personi ka vepra të mira, do t'i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi. (dhe i jepet atij që i është bërë padrejtësi). Por nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait të cilit i është bërë padrejtësi, dhe do t'i ngarkohen atij.”
(Buhari, Medhalim, 10, Rikak, 48)



Ndërsa në një hadith tjetër, thuhet:

“O njerëz! Kush ka hak (robi) mbi shpinë, le ta paguajë atë menjëherë, e të mos mendojë se po turpërohet para botës! Dijeni mirë se turpërimi në këtë botë është shumë i më i lehtë se ai në botën tjetër.” (Taberani, Kebir, XVIII, 280; Ibn-i Esir, *el-Kamil*, II, 319; Hejthemi, IX, 26)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, për të treguar domosdoshmërinë e hallallimit në këtë botë, me qëllim që të lehtësohet llogaridhënia në Ahiret, ka bërë këtë dua:

“Allahu e mëshiroftë robin që vepron kështu (hallallohet)!” (shih. Tirmidhi, Kiamet, 2/2419)



Nuk duhet harruar se haku i robit është shumë i rëndësishëm, sepse është një çështje që ruhet deri në Kiamet. Dalja në Ditën e Gjykimit me hakun e dikujt mbi shpinë, siç shprehet edhe Profeti në një hadith fisnik, e çon njeriun në humbje:

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, u tha sahabëve të tij:

“A e dini kush është i falimentuar?” Ata u përgjigjën:

“Sipas nesh, i falimentuar është ai që nuk ka para dhe mall.”

Por i Dërguari i Allahu ﷺ, sqaroi:

“S’ka dyshim se të falimentuarit e umetit janë ata, të cilët ditën e Kiametit, do të vijnë me sevapet përkatëse të adhurimeve si namazi, agjërimi, zekati etj., por për shkak se dikë e ka sharë, për dikë ka shpifur për imoralitet, dikujt i ka ngrënë mallin padrejtësisht, dikujt tjetër i ka derdhur gjakun dhe dikë tjetër e ka rrahur, të gjitha sevapet e mirësive të tij, i kalojnë të dëmtuarve. Nëse sevapet i mbarojnë pa larë hakun e atyre që u ka bërë padrejtësi, gjynahet e atyre që kanë për të marrë hak, do t’i ngarkohen këtij, dhe si përfundim do të hidhet në Xhehenem.” (Muslim, Birr 59; Tirmidhi, Kiamet 2; Ahmed, II, 303, 324, 372)

Ja pra, ky është falimentimi i vërtetë! Allahu na ruajttë! Pra, në vend që të shkojë në Xhenet, robi bëhet udhëtar i Xhehenemit.

I nderuari Sufjan el-Theuri (Allahu e mëshiroftë) ka thënë:



“Të dalësh para Allahut të Madhëruar me shtatëdhjetë gjynahe midis teje dhe Atij, është më e lehtë se të dalësh me një gjynah midis teje dhe robërve.”

Lidhur me këtë shprehje, dijetari i tefsirit, hadithit dhe jurisprudencës Islame, Imam Kurtubiu ka thënë:

“Kjo fjalë është drejtë, sepse Allahu i Madhëruar është zemërgjerë dhe bujar, kurse biri i Ademit është i varfër dhe nevojtar. Atë ditë, njeriu ka nevojë qoftë edhe për një mirësi që të largojë gjynahet që ka mbi supe dhe që të mirat e sevapet t’i peshojnë rëndë në Mizan/peshore.” (Kurtubi, Tedhkire, fq. 726)



Muhamed ibn Xhahsh  tregon:

Ishim ulur pranë të Dërguarit të Allahut . Ai ngriti kokën nga qielli dhe pasi vuri dorën në ballë, tha:

“Subhanallah! (i patëmeta është Allahu) Sa vendim i rëndë zbriti!” Ne u frikësuam shumë dhe heshtëm. Vetëm ditën tjetër munda ta pyes:

“O i Dërguar i Allahut! Çfarë ishte ai vendim i rëndë që zbriti?”

I Dërguari i Allahut , tha:

“Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është jeta ime, se nëse dikush ka një borxh, nuk do të hyjnë në Xhenet derisa ta paguajë, edhe nëse ai vritet në rrugën e Allahut, më pas ringjallet e vritet përsëri dhe më pas ringjallet e përsëri vritet!” (Nesai, Buju, 98/4681)

Ndërsa në një hadith tjetër thuhet:

“Allahu i Madhëruar ia fal dëshmorit të gjitha gjynahet, përveç hakut të robit.” (Muslim, Imare, 119)

Ditën e Kiametit, dëshmorët e rënë në rrugën e Allahut do të jenë në gradën më të lartë, pas profetëve, por as kjo nuk do t’i shpëtojë nga llogaridhënia, kur bëhet fjalë për çështjen e hakut të robit. Imagjinoni gjendjen e robërve të tjerë!..



Një prej të drejtave më të rëndësishme, është ajo ndaj prindërve, e cila nuk mund të paguhet me asnjë të mirë. Në Islam, menjëherë pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, renditet bindja ndaj prindërve. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

وَفَضَىٰ رُبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا إِمَّا يَبُلُغَنَّ عِنْدَكَ
الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أَلْفٌ وَلَا تَنْهَرُهُمَا
وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë të ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” (Isra, 23)

Prindërit tanë janë shkaku i ardhjes sonë në këtë botë dhe mirësi e madhe për ne. Madje, Allahu i Madhëruar, kënaqësinë e Vet, e ka kush-tëzuar me kënaqësinë e prindërve. Këtë të vërtetë, Profeti ﷺ, na e bën të ditur me këto fjalë:

“Kënaqësia e Allahut është e fshehur në kënaqësinë e babait (prindit). (Po ashtu) Edhe zemërimi dhe ndëshkimi i Tij, është i fshehur në zemërimin dhe nevrikosjen e babait (prindit).” (Tirmidhi, Birr, 3/1899)

Të drejtat e prindërve tanë mbi ne, janë aq shumë sa nuk mund të numërohen. Ata sakrifikojnë edhe qenien e tyre me qëllim që neve të mos na dëmtojnë furtunat e jetës në këtë botë. Për rrjedhojë, a është e mundur t’ua shlyejmë atyre të gjitha sakrificat që bëjnë për ne? Lidhur me këtë fakt, në një hadith fisnik bie në sy një krahasim i tillë:

“Asnjë fëmijë nuk mund ta shlyejë hakun e babait, përveçse nëse e gjen atë si skllav, e blen dhe i jep lirinë. (Pra) Vetëm kështu mund ta shlyejë hakun e babait.” (Muslim, itk, 25; Ebu Daud, Edeb, 119-120; Tirmidhi, Birr, 8/1906)

Allahu i Madhëruar ka urdhëruar bashkëjetesë të mirë me prindërit, edhe nëse ata nuk janë myslimanë. Ai ka urdhëruar plotësimin e kërkesave të tyre të drejta dhe kënaqjen e tyre. Këtu bëjnë përjashtim vetëm çështjet që konsiderohen si kundërshtim i Allahut,¹⁹² sepse në çështjet ku kundërshtohet Allahu, nuk duhet t’i bindesh askujt!

Shkurtimisht, rruqa e Xhenetit kalon nga kënaqësia e prindërve. Madje, Allahu i Madhëruar e ka shtruar Xhenetin nën këmbët e nënës së mirë, ndërsa babanë e ka konsideruar si derën e mesme të Xhenetit.¹⁹³

Megjithëse të drejtat e prindërve kanë rëndësi kaq të madhe, nëse prindërit e neglizhojnë edukimin shpirtëror të fëmijëve të tyre, bëhen shkak që ata të marrin rrugë të keqe, në kundërshtim me kënaqësinë e Allahut. Në këtë rast, Ditën e Gjykimit, fëmija do t'i padisë prindërit e vet dhe do të ankohet duke thënë: “O Zot! Këta nuk ma mësuuan të vërtetën dhe të drejtën, nuk u bënë shembuj të mirë për mua dhe nuk i kryen ashtu siç duhet detyrat e tyre si prindër!..” Dhe pikërisht atëherë, prindërit do të kërkojnë të ikin prej fëmijëve të tyre.

Mizan

Mizan është emri i peshores e cila do të vendoset Ditën e Gjykimit për të peshuar gjynahet dhe sevapet, të mirat dhe të këqijat. Pra, ditën e llogarisë do të përdoren këto peshore, natyrën e vërtetë të të cilave e njeh vetëm Allahu i Madhëruar, dhe do të peshohen të gjitha veprat që njerëzit kanë bërë në dynja; pa i bërë padrejtësi askujt, qoftë edhe sa grimca më e vogël.

Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَنَضَعُ الْمَوَازِينَ الْقِسْطَ لِيَوْمِ الْقِيَامَةِ فَلَا تُظْلَمُ نَفْسٌ شَيْئًا
وَإِنْ كَانَ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِّنْ خَرْدَلٍ أَتَيْنَا بِهَا وَكَفَى بِنَا حَاسِبِينَ

“Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta, e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrre sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (Enbija, 47)

Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se ata, të cilëve do t'u peshojë rëndë ana e mirësive në peshore, do të shpëtojnë. Ndërsa ata, të cilëve që do t'u peshojë rëndë ana e gjynaheve, do të pësojnë dënimin e hidhur:

وَالْوِزْنَ يُومئذِ الْحَقُّ فَمَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

193. shih. Tirmidhi, Birr, 3; Ibn-i Maxhe, Talak, 36.



“Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë. Ata, të cilëve u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar!” (A'raf, 8)

وَمَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ بِمَا كَانُوا بِآيَاتِنَا يَظْلِمُونَ

“Kurse ata, të cilët e kanë të lehtë peshoren me vepra të mira, do të humbin veten e tyre, për shkak se mohuan shpalljet Tona.”

(A'raf, 9)¹⁹⁴

Në këto ajete fisnike, flitet për gjendjen e besimtarëve të devotshëm dhe idhujtarëve që mohojnë Kuranin. Për shkak se mohuesit nuk besojnë, edhe nëse ata kanë bërë disa të mira në këtë botë, ditën e Kiameti këto të mira nuk do të kenë asnjë vlerë, sepse ajo që u jep vlerë veprave tek Allahu, është besimi i vërtetë.

Ndërsa gjendja e besimtarëve gjynahqarë, të cilët kanë mbetur midis besimtarëve të devotshëm dhe mohuesve, na bëhet e ditur në këtë ajet fisnik:

وَأَخْرَجُوا عَتَقُوا بِذُنُوبِهِمْ خَلَطُوا عَمَلًا صَالِحًا وَآخَرَ سَيِّئًا
عَسَى اللَّهُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Ndërkaq, disa të tjerë i pranojnë gjynahet e veta, se i kanë përzier veprat e mira me të këqijat. Ka gjasë që Allahu t’ua pranojë pendimin. Vërtet, Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”

(Teube, 102)

Kur Allahu i Madhëruar vendos t’i dënojë gjynahqarët që nuk pendohen, ose që nuk u pranohet pendimi, Ai nuk i mëshiron ata dhe për rrjedhojë atyre u peshojnë lehtë mirësitë, gjë e cila i çon në Xhehenem.

Lidhur me peshimin e veprave, në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar urdhëron:

فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ ﴿٦﴾ فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ ﴿٧﴾

“Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet).” (Karia, 6-7)

وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ﴿٨﴾ فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ ﴿٩﴾

وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَ ﴿١٠﴾ نَارٌ حَامِيَةٌ ﴿١١﴾

“E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit). Kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është Humnera (e Xhehenemit)? Ajo është një Zjarr i vrullshëm.” (Karia, 8-11)



Enes ibn Malik  tregon:

“I kërkoja të Dërguarit të Allahut të më bënte shefaat/ndërmjetësim ditën e Kiametit dhe ai më tha:

«E bëj!» Pas kësaj, unë e pyeta:

«O i Dërguar i Allahut! Ku t’ju kërkoj (atë ditë)?»


«Në fillim më kërko mbi urën e Siratit!» -tha ai.

«Po nëse nuk ju gjej mbi urën e Siratit?» -pyeta unë përsëri.


«(Atëherë) Më kërko pranë Mizan-it!» -tha ai.

«Po sikur të mos ju gjej as pranë Mizan-it?» -e pyeta përsëri unë.

«Atëherë më kërko pranë Hauzit! Unë do të jem patjetër në njërin prej këtyre tre vendeve.» -tha ai.” (Tirmidhi, Kiamet, 9/2433; Ahmed, III, 178)

Domethënë se, Profeti  do të ndërmjetësojë për ummetin e tij në krye të Urës së Siratit dhe në krye të Mizanit. Ndërsa në krye të Hauzit, do t’i gostisë ata.

Ashtu siç e përmendëm edhe në çështjen e shefaatit, ndërmjetësimi është real dhe do të ndodhë me lejen e Allahut. Ndërsa përgjegjësia për lejen e ndërmjetësimit, gjendet plotësisht në dorën e Allahut të Madhëruar. Ai do t’i japë leje për ndërmjetësim kujt të dojë, e aq sa të dojë.

Allahu i Madhëruar, Profetit  nuk do t’i japë leje ndërmjetësimi për disa persona, ose do t’ia vonojë atë. Pra, është e domosdoshme që shefaati të mos keqkuptohet dhe të mos harrohet se gjithçka është në dorën e Allahut të Madhëruar.



Profeti ﷺ na përshkruan një skenë prej kohës së peshimit të veprave në Mizan:

“Ditën e gjykimit, Allahu i Madhëruar e veçon një person prej ummetit tim para të gjithëve dhe i hap nëntëdhjetë e nëntë libra kundër tij. Madhësia e çdo libri, është aq sa mund të shohë syri. Më pas pyetet:

«A mohon ndonjë gjë prej këtyre? (A ke kundërshtim?) A të kanë bërë padrejtësi melekët e Mi shkrues, të cilët shënojnë veprat?»

«Jo o Zot!» -përgjigjet ai i turpëruar.

«Ke ndonjë arsyetim?» -e pyet përsëri Allahu.

«Jo o Zot!» -përgjigjet ai. Pas kësaj, Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Në fakt, ti ke një mirësi tek Ne. Dhe sot nuk do të bëhet aspak padrejtësi!» Më pas nxirret një copë letër dhe mbi të cilën shkruhet:

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

«Dëshmoj se përveç Allahut s’ka zot tjetër dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ, është rob dhe i Dërguari i Tij!»

Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Shiko se si peshohen veprat!» Ndërsa njeriu i shastisur thotë:

«O Zot! E çfarë kuptimi ka një copë letër pranë gjithë këtyre librave?!» Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Sot nuk do të të bëhet aspak padrejtësi!»

Pastaj, librat vendosen në një anë të peshores, ndërsa copa e letrës në anën tjetër. Mirëpo, librat ngrihen lart, ndërsa copa e letrës peshon më rëndë, sepse asgjë nuk mund të peshojë më rëndë se sa Emri i bukur i Allahu të Madhëruar!” (Tirmidhi, Iman, 17/2639; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 35; Ahmed, II, 213; Hakim, I, 46/9)

Ky hadith fisnik, tregon se sa i çmuar dhe i virtytshme është besimi ndaj Allahut të Madhëruar, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Përveç kësaj, ai vë në pah rëndësinë e “kelime-i teuhidit”¹⁹⁵, e cila duhet të thuhet në

frymën e fundit. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar kështu besimtarët:

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al-i Imran, 102)

Po ashtu, një nga çështjet që do ta gëzojë njeriun përpara Mizan-it, është **“moral i bukur”**, që nënkupton reflektimin e një besimi të vërtetë në gjendje dhe vepra.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Gjëja që do të peshojë më rëndë në Mizan ditën e Kiametit, është morali i bukur!” (Ahmed, VI, 442, 451; Ibn-i Hibban, Sahih, II, 230)¹⁹⁶

Shefaati i besimtarëve, i veprave dhe i Kuranit

Përveç *“shefaatit udhë/ndërmjetësimit më të madh”* të Profetit ﷺ, do të ketë edhe ndërmjetësim të besimtarëve ndaj njëri-tjetrit. Lidhur me këtë, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Në sajë të shefaatit të një personi prej ummetit tim, do të hyjnë në Xhenet më shumë njerëz se çka fisi i Bijve të Temimit.”

Sahabët pyetën të habitur:

“O i Dërguari i Allahut! Me shefaatin e një njeriu tjetër përveç jush?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Po, me shefaatin e një tjetri përveç meje!” (Tirmidhi, Kiamet, 12/2438; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 37; Darimi, Rikak, 86; Ahmed, III, 469)



Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit njerëzit do të vendosen në rreshta. Ndërkohë, një nga njerëzit e Xhehenemit do të takojë një nga njerëzit e Xhenetit dhe do t'i thotë:

«O ti filan! A më mban mend? Njëherë kërkove ujë prej meje, e unë ta dhashë.»

196. shih. Ebu Daud, Edeb, 7/4799; Tirmidhi, Birr, 62/2002.



Atëherë besimtari do të ndërmjetësojë tek Allahu për atë njeri.

Një tjetër (prej njerëzve të Xhehenemit) do të shkojë pranë njërit prej atyre të Xhenetit dhe do t'i thotë:

«E mban mend, një ditë të kam dhënë ujë për të marrë abdest?» (pastaj do të kërkojë ndërmjetësim prej tij) dhe ai do të ndërmjetësojë për të.

Përsëri, njëri prej njerëzve të Xhehenemit, do t'i thotë njërit prej atyre të Xhenetit:

«O ti filan! A e mban mend atë ditë kur më dërgove për një punë dhe unë shkova për ty?» Pastaj edhe ky Xhenetli do të ndërmjetësojë tek Allahu për të.” (Ibën Maxhe, Edeb, 8)

Mësimi që duhet të marrim prej këtij hadithi fisnik, është rëndësia e madhe që ka shërbimi dhe ndihma që bëhet ndaj robërve të Allahut, pa bërë dallim, nëse është e vogël apo e madhe. Përfitimi prej lutjeve të besimtarëve, është një kapital i çmuar për Ahiretin.



Në një hadith tjetër, Profeti ﷺ, ka thënë se ditën e Kiametit edhe Kurani Fisnik do të vijë si ndërmjetësues për besimtarët:

“Lexoni Kuran, sepse ditën e Kiametit ai do të ndërmjetësojë për ata të cilët janë angazhuar me të!” (Muslim, Musafirin, 252)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Në Kuran është një sure me tridhjetë ajele... Ajo sure ndërmjetësoi për një person, derisa ai u fal. Ajo është surja, «تَبَارَكَ الَّذِي بِيَدِهِ الْمُلْكُ»¹⁹⁷ (Tirmidhi, Fedailu'l-Kuran (Seuabu'l-Kuran), 9/2891)

Kurani Fisnik është një libër i mrekullueshëm që të falë paqen dhe pranverën e lumturisë në jetën e dynjasë dhe të ahiretit. Bërja e një jete në përputhje me Kuranin, është detyra kryesore e çdo besimtari. Përndryshe, ndërkohë që shpresohet ndërmjetësimi i madh i Profetit ﷺ dhe dëshmia e mirë e Kuranit Fisnik ndaj nesh, -Allahu na ruajttë- ne mund të përballlemi me një katastrofë, siç është paditja e tyre ndaj nesh. Për rrjedhojë, në një ajet na bëhet e ditur se ditën e Kiametit, i Dërguari i Allahut ﷺ, do të

ankohet tek Allahu i Madhëruar për ata që bëjnë një jetë në kundërshtim me Kuranin Fisnik:

وَقَالَ الرَّسُولُ يَا رَبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا

“Dhe i Dërguari do të thotë: «O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer!» (Furkan, 30)

Sipas një transmetimi, thuhet se ditën e Kiametit, Kurani Fisnik do të marrë formë dhe do të ankohet:

“Këdo që e mëson Kuranin por nuk angazhohet me të, ditën e Kiametit, Kurani do ta kapë për jake dhe do t’i thotë:

*«O Zot! Ky robi yt më burgosi! Më braktisi, qëndroi larg prej meje dhe nuk punoi me mua! Prandaj gjyko Ti midis meje dhe këtij!»*¹⁹⁸

Domethënë, për të mos u përballur me një situatë të tillë në Ahiret, është e domosdoshme të bëhet kujdes në respektimin e leximit të Kuranit në mënyrën e duhur dhe të vazhdueshme, duke u familjarizuar me kuptimet në thellësi të tij dhe duke u përpjekur për zbatimin e tij gjatë gjithë jetës.

Angazhimi me gjithë zemër me Kuranin, i cili konsiderohet një letër hyjnore e dërguar prej Allahut, përbën recetën e lumturisë për të gjithë ne. Por nuk është e mjaftueshme të themi, “unë e dua Kuranin”! Nëse me të vërtetë e duam Kuranin, sa angazhohemi me të? Sa përfitojmë prej moralit të Kuranit? Sa veprojmë me gjykimet e Kuranit? Sa i edukojmë fëmijët tanë me Kuranin, kulturën dhe moralin e tij?

Këto lloj pyetjesh duhet t’ia bëjmë shpesh vetes sonë dhe duhet të përpiqemi t’i kompensojmë, pa humbur kohë, të gjitha mangësitë në këtë çështje.

Omeri  ka thënë:

“Dijeni se Kurani është një thesar sevapi dhe nderi për ju. Ndiqeni atë dhe mos e komentoni sipas interesave tuaja! Atë që e komenton Kuranin sipas interesave vetjake, Kurani e rrëzon dhe e hedh në Xhehenem. Atë, i cili e ndjek Kuranin, Kurani e dërgon në Xhenetin Firdeus. Nëse keni mundësi, përpiquni ta bëni Kuranin ndërmjetësuesin tuaj dhe jo armikun tuaj, sepse

198. shih. Alusi, Ruhul-meani, Bejrut, XIX, 14.



ai për të cilin Kurani bëhet ndërmjetësues, shkon në Xhenet, dhe ai ndaj të cilit Kurani ankohet, shkon në Xhehenem. Dijeni se Kurani është burimi i udhëzimit dhe dija më e shkëlqyer. Ai është libri i fundit që ka ardhur nga Rrahmani dhe me të hapen sytë e verbuar, veshët e shurdhër dhe zemrat e kyçura...” (Ali el-Muttaki, II, 285-286/4019)

Shkurtimisht, ne nuk duhet të harrojmë asnjëherë se, ditën e Kiametit, Kurani Fisnik do të jetë ose ndërmjetësues, ose -Allahu na ruajttë- paditës ndaj nesh.

Ura e Siratit

Sirat quhet ura e cila do të vendoset mbi Xhehenem ditën e Kiametit, në të cilën të gjithë njerëzit do të jenë të detyruar të kalojnë. Kalimi mbi këtë urë do të realizohet në bazë të gradës së besimit që njerëzit kanë pasur në jetën e dynjasë dhe të veprave që ata kanë kryer gjatë jetës. Për këtë arsye, kjo urë do të hollohet aq shumë nën këmbët e disave, sa që do të duket më e hollë se fija e flokut dhe më e mprehtë se shpata. Ndërsa nën këmbët e disa të tjerëve do të zgjerohet aq shumë, sa që ata do të kalojnë pa asnjë vështirësi dhe do të arrijnë Xhenetin ku ndodhen mirësitë që Allahu ka krijuar për ta.¹⁹⁹

Ndërsa gjynahqarëve dhe mohuesve do t’u rrëshqasin këmbët mbi këtë urë dhe do të bien në Xhehenem. Lidhur me këtë, Ebu Hurejre رضي الله عنه transmeton se njëherë disa sahabë e pyetën të Dërguarin e Allahut:

“O i Dërguari i Allahut! A do ta shohim Zotin tonë Ditën e Kiametit?”

Ai رضي الله عنه u përgjigj:

“A nguceni e shtyheni me njëri-tjetrin për të parë Diellin në një qiell pa re?”

“Jo, o i Dërguari i Allahut!” -thanë sahabët.

Profeti ﷺ pyeti përsëri:

“A nguceni e shtyheni me njëri-tjetrin për të parë Hënën katërmëdhjetëshe në një qiell pa re?”

“Jo, o i Dërguari i Allahut!” - thanë ata përsëri. Më pas, i Dërguari i Allahut ﷺ, sqaroi:

“Kështu pra do ta shihni edhe Zotin tuaj (Allahun) ditën e Kiametit. Allahu i Madhëruar do t’i tubojë njerëzit Ditën e Ringjalljes dhe do t’i urdhërojë:

«Secili të shkojë pas atij që ka adhuruar në dynja!»

Kështu, disa do të ndjekin Diellin, disa do të ndjekin Hënën dhe disa të tjerë do të ndjekin perëndi (të ashtuquajtura zota), e gjëra të tjera të adhuruara prej tyre në dynja. Në vend do të qëndrojë vetëm ky ummet (myslimanët) bashkë me hipokritët mes tyre. Allahu do të vijë (në një paraqitje ndryshe nga ajo që dinë ata) dhe do t’u thotë atyre:

«Unë jam Zoti juaj!» (Për shkak se nuk e njohin Allahun në atë paraqitje) Ata do të thonë:

«Ne do të qëndrojmë në këtë vend derisa të vijë Zoti ynë. Po erdhi Zoti ynë, ne do ta njohim Atë.» Pastaj Allahu do t’u vijë atyre përsëri (me paraqitjen që ata e njohin) dhe do t’u thotë:

«Unë jam Zoti juaj!» E ata do të thonë:

«Ti je Zoti ynë!» -dhe i binden Atij.²⁰⁰

Kështu, Allahu do t’u thërrasë atyre dhe do të vendoset Ura e Siratit ndërmjet dy anëve të Xhehenemit, ndërsa unë (Muhamedi a.s) do të jem i pari i të dërguarve që do ta kaloj atë bashkë me ummetin tim. Atë Ditë askush nuk do të mund të flasë, përveç të dërguarve, dhe fjala e tyre do të jetë vetëm: «O Allah, na shpëto! O Allah, na shpëto!»


Ura e Siratit do të ketë grepa si gjembat e saadan-it (gjembraçja ose murriza). A i keni parë gjembat e saj?” Njerëzit i thanë:

“Po, i kemi parë o i Dërguar i Allahut!” Më pas Profeti ﷺ, vazhdoi:


“Këto grepa do të jenë si gjembat e saadan-it, por askush përveç Allahut nuk e di sa të mëdhenj do të jenë. Këto do t’i pengojnë njerëzit sipas vepërave të tyre të këqija. Disa do të bien dhe do të mbeten përgjithmonë në zjarr, ndërsa disa të tjerë do të rrëzohen e do të marrin plagë (dënim sipas gjynaheve) dhe do të shpëtojnë!..” (Buhari, Rikak, 52)

200. Kadi Ijazi, në tefsirin e tij, shprehet se ata do t’i binden ndonjë urdhri të Allahut, ose ndonjë prej melekëve të Tij, që është ngarkuar me detyrë në këtë çështje.

Ura e Siratit, është i vetmi vendkalim për të gjithë njerëzimin, mohues a besimtarë qofshin ata. Mirëpo, siç shprehet edhe në Kuran²⁰¹, besimtarët e devotshëm nuk do të frikësohen atë ditë dhe do ta kalojnë të sigurt urën. Ndërsa gjynahqarët do të vuajnë në bazë të gjynaheve që kanë.

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte pranë nënës sonë, Hafsa , dhe tha:

“InshaAllah, (dashtë Allahu) askush nga Shokët e Pemës²⁰², nuk do të hyjë në Xhehenem!”

Nënës sonë Hafsas , së cilës i lindi një pyetje pas kësaj fjale, tha:

“Mirë o i Dërguari i Allahut, por Zoti urdhëron kështu:

«Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi)...»²⁰³
Si do të ndodhë kjo?”

Profeti , iu përgjigj duke kënduar ajetin në vijim:

“Allahu i Lartë ka urdhëruar edhe kështu:

«Pastaj do t’i shpëtojmë ata që kanë qenë besimtarë dhe do t’i lëmë keqbërësit të gjunjëzuar në të!»²⁰⁴ (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 163)

Në këtë mënyrë, u kuptua se me shprehjen **“do të arrijë në Xhehenem”**, nënkuptohet kalimi pranë Xhehenemit, mbi Urën e Siratit, dhe jo hyrja në Xhehenem.



Ndërsa i nderuari Mevlana, në veprën e tij “Mesnevi”, me anë të një tregimi e shpreh në mënyrë metaforike gjendjen mbi Urën e Siratit, të besimtarëve që jetojnë dhe vdesin si myslimanë të devotshëm:

“Ditën e Mahsherit, besimtarët do të thonë:

«O melekë! A nuk ishte Xhehenemi rruga e përbashkët për të gjithë njerëzit?²⁰⁵ Ne nuk pamë as tym, as zjarr në këtë rrugën nga do të kalojnë

201. shih. Junus, 62-64.

202. Sahabët që i dhanë besën Profetit , nën pemën e Riduanit.

203. shih. Merjem, 71.

204. shih. Merjem, 72.

205. shih. Merjem, 71-72.



edhe besimtarët, edhe mohuesit!.. Ja, këtu është Xheneti, vendi i sigurisë dhe shpëtimit. E ku mbeti ai vendkalim i frikshëm, ai vend katastrofë?»

Melekët do t'u thonë:

«E mbani mend atë kopshtin e gjelbër kur po kalonit në filan vend? Ja atje ishte Xhehenemi, vendi i frikshëm i dënimit! Mirëpo juve ju shfaq si kopsht i gjelbëruar.

Me adhurimet dhe mirësitë që keni bërë dhe jeni përpjekur t'i bënit, ju e keni fikur zjarrin e tij për hir të Allahut. Zjarri i epsheve tuaja që digjej flakë, u bë gjelbërimi i devotshmërisë dhe drita e udhëzimit.

Zjarri i zemërimit, u kthye në butësi në sajë të durimit, tolerancës dhe mirësive që keni bërë. Ndërsa errësira e paditurisë, u kthye në dije me anë të përpjekjeve tuaja në rrugën e devotshmërisë.

Zjarri i lakmisë dhe koprracisë u kthye në bujari. Ndërsa smira juaj që ishte si ferrë, u kthye në një kopsht. Pra, ju i keni fikur një nga një zjarret tuaja për hir të Allahut, kur ishit në dynja. Egon tuaj si zjarr, e kthyet në kopsht trëndafilash, ku mbollët farat e besnikërisë.

Juve ju përgjigjët ftesës së Profetit, i cili ftonte në të vërtetën! Xhehenemit të egos i hodhët ujë dhe e fikët zjarrin e tij. Ja pra, për këtë arsye Xhehenemi u bë si një kopsht trëndafilash i mbushur plot me gjelbërim dhe lloj-lloj mirësish!»”



Shpejtësia, me të cilën banorët e Xhenetit do të kalojnë mbi urën e Siratit, varion në bazë të veprave të mira që kanë bërë në dynja. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Njerëzit vijnë në Xhehenem dhe kalojnë prej aty sipas veprave të tyre. Grupi i parë prej tyre kalon me shpejtësinë e rrufesë, grupi i dytë si erë. Të tjerë kalojnë me shpejtësinë e kalit, pastaj me shpejtësinë e kalorësit, me vrapin e këmbësorit dhe me ecje normale këmbësori.” (Tirmidhi, Tefsir, 19/3159)

Sa më gjatë të qëndrojnë njeriu mbi Urën e Siratit, aq më shumë do të ekspozohet ndaj nxehtësisë së Xhehenemit, tymit, erës së keqe dhe pamjeve të tij të shëmtuara. Dhe më e keqja prej kësaj, është përjetimi i momenteve të tmerrshme të frikës nga rënia në çdo çast në Xhehenem. Për këtë arsye, sa më shpejt të kalojë robi prej aty, aq më i sigurt është.



Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﴿﴾, ka thënë:

“...Të parët prej jush që do të kalojnë mbi urën e Siratit, do të kalojnë me shpejtësinë e rrufesë... Më pas të tjerët do të kalojnë si era, të tjerët me shpejtësinë e fluturimit të zogut dhe me shpejtësinë e vrapit të një njeriu. Shpejtësia e tyre përcaktohet në bazë të veprave të secilit. Në këtë kohë, Profeti juaj do të qëndrojë në krye të Siratit dhe do të thotë vazhdimisht:

رَبِّ سَلِّمْ سَلِّمْ

«O Zot! Na shpëto, na shpëto!»

Kjo do të vazhdojë derisa veprat të mos i kalojnë dot më njerëzit nga Ura e Siratit. Madje, do të vijë një person, i cili nuk ka fuqi të ecë, por zvarritet. Në të dyja anët e Urës së Siratit gjenden çengelë të varur, të cilët kanë për detyrë të kapin njerëzit për të cilët u jepet urdhër. Një pjesë e njerëzve do të shpëtojnë të çjerrë dhe të plagosur prej këtyre çengelëve. Ndërsa një pjesë tjetër hidhen në Xhehenem.” (Muslim, Iman, 329)

Çdo gjynah që bëhet në dynja, në të vërtetë, do të thotë një çengel i madh i varur në anë të Urës së Siratit. Madje, i Dërguari i Allahut ﴿﴾, na ka bërë të ditur se respektimi i “**amanetit**” dhe “**lidhjes farefisnore**” do të qëndrojnë në të dy anët e Siratit, dhe do të kapin me çengela të mëdhenj, personat që në këtë botë nuk i kanë çuar në vend të drejtat e amanetit dhe lidhjeve farefisnore.²⁰⁶ Fakti që “**amaneti**” dhe “**lidhjet farefisnore**”, përmenden në mënyrë të veçantë, është për shkak të rëndësisë që kanë dhe për shkak se ka shumë njerëz që i neglizhojnë ato.

Në Urën e Siratit, edhe besimtarë do të bëjnë të njëjtën dua që bën Profeti ﴿﴾. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﴿﴾, ka thënë:

“Shenja dalluese e besimtarëve mbi Urën e Siratit, është duaja që bëjnë ata: رَّبِّ سَلِّمْ سَلِّمْ «O Zot! Na shpëto, na shpëto!»” (Tirmidhi, Kiamet, 9/2432)

Ndërsa qëndrimi i Profetit ﴿﴾ në krye të Urës së Siratit, është për të ndërmjetësuar. Lidhur me këtë, në një hadith fisnik thuhet:

“...Më pas vendoset ura mbi Xhehenem dhe jepet leje për shefaat...” (Muslim, Iman, 302)

Pritja pas kalimit të Siratit

Midis besimtarëve që shpëtojnë të plagosur prej çengelëve dhe kanxhave në Urën e Siratit, do të bëhet edhe një larje hesapesh për disa çështje të vogla. Mirëpo, këta janë besimtarë të cilëve nuk do t'u pakësohen mirësitë dhe nuk do të privohen nga Xheneti pasi të jenë larë hesapet. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, pasi të shpëtojnë prej zjarrit (duke kaluar nga ura e Siratit), besimtarët ndalohen mbi një urë midis Xhenetit dhe Xhehenemit.²⁰⁷ Aty lahen haqet për padrejtësitë (e vogla) që i kanë bërë njeri-tjetrit në jetën e dynjasë. E kur të jenë pastruar mirë nga padrejtësitë, atëherë do t'u jepet leje të hyjnë në Xhenet. Betohem në Allahun, i Cili ka në dorën jetën e Muhamedit, se secili prej tyre do ta gjejë vendin e vet në Xhenet, më lehtë se vendbanimin që kishin në dynja.” (Buhari, Rikak, 48)

Po ashtu, edhe ky hadith fisnik trajton këtë pritje:

“Qëndrova te porta e Xhenetit, kur ç'të shoh?! Shumica e njerëzve që hynin aty ishin të varfrit, ndërsa të pasurit i kishin ndaluar te porta (për llogari etj). Ndërkohë banorët e caktuar për në Zjarr, qenë urdhëruar të hidhen në Zjarr. Pastaj qëndrova te porta e Zjarrit, kur ç'të shoh?! Shumica e atyre që hynin aty ishin gra!” (Buhari, Rikak, 51; Muslim, Zuhd, 93)



Dita e Kiametit është një ditë jashtëzakonisht e frikshme dhe e gjatë. Mirëpo, Allahu i Madhëruar do t'ua lehtësojë besimtarëve atë ditë dhe do t'ua pengojë vuajtjet.

Një ditë, sahabët e nderuar iu drejtuan Profetit ﷺ dhe i shprehën habinë e tyre në lidhje me ditën e Kiametit:

“Ajo është një ditë që zgjat sa pesëdhjetëmijë vite! Sa e gjatë qenka kjo ditë!”

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Betohem në Allahun, që ka në dorën e Tij të fuqishme jetën time, se ajo ditë do t'i lehtësohet besimtarit. Madje, atij do t'i duket më e lehtë se një namaz farz që ka falur në dynja” (Ahmed, III, 75; Bejhaki, Shuab, I, 556/355; Hejthemi, X, 337)

207. Mesa kuptohet, kjo urë duhet të jetë ekstremi i Urës së Siratit nga ana e Xhenetit. Por, ka mundësi të jetë edhe ndonjë urë tjetër. Ose, mund të qëndrojnë mbi ndonjë vend si hark.



Ata që nuk do të ndiejnë frikë dhe hidhërim

Në atë ditë të tmerrshme të Kiametit, kur miku nuk do të pyesë më për mikun, kur njeriu do të ikë prej vëllait, prindit dhe fëmijës së tij, dhe kur fëmijët do të thinjen si pleq nga frika, janë disa njerëz të cilët do të gëzojnë mirësi të mëdha hyjnore, brenda një sigurie dhe qetësie të madhe. Për ta nuk do të ketë asnjë lloj frike dhe nuk do të jenë aspak të hidhëruar. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

بَلَىٰ مَنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ فَلَهُ أَجْرُهُ عِنْدَ رَبِّهِ
وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Vërtet, ata që i përuhlen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.” (Bekare, 112)

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٦٢﴾
الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿٦٣﴾

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut).” (Junus, 62-63)

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةُ أَلَّا تَخَافُوا
وَلَا تَحْزَنُوا وَأَبْشِرُوا بِالْجَنَّةِ الَّتِي كُنتُمْ تُوعَدُونَ

“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar!» (Fussilet, 30)²⁰⁸



Ndërsa robërit që përmenden në ajetet e tjera të Kuranit, të cilët kanë për të marrë shpërblime nga Allahu i Madhëruar dhe nuk do t’i prekë frika e hidhërimi, janë:



✓ Ata që i binden udhëzimit që ka ardhur prej Allahut dhe përpiqen në devotshmëri, duke e përmirësuar gjendjen e tyre, sapo dëgjojnë profetët që lexojnë ajetet e Allahut të Madhëruar. (shih. Bekare, 38; A'raf, 35; Xhin, 13)

✓ Ata që i besojnë Allahut, botës tjetër dhe kushteve të tjera të besimit, dhe e përmirësojnë veten, bëjnë punë të mira e të sinqerta, falin namazin dhe japin zekatin. (shih. Bekare, 62, 277; Maide, 69; En'am, 48; Ta-Ha, 112; Nur, 55)

✓ Ata që japin pasurinë e tyre në rrugë të Allahut, e që më pas nuk e përmendin dhe nuk i lëndojnë njerëzit për atë që japin. (shih. Bekare, 262)

✓ Ata që dhurojnë prej pasurisë së tyre natën dhe ditën, hapur dhe fshehtas. (shih. Bekare, 274)

✓ Shehidët (dëshmorët) që japin jetën në rrugën e Allahut. (shih. Al-i Imran, 169-170)

✓ Besimtarët, të cilëve mohuesit u thonë me përçmim, "Allahu nuk ua jep kurrë mirësinë e Tij këtyre!", por që në të vërtetë do t'i gëzojnë mirësitë dhe mëshirën e Allahut. (shih. A'raf, 49)

Përçmimi dhe tallja me besimtarët është një ves i pandryshueshëm i të gjithë jobesimtarëve. Ata mendojnë se besimtarët nuk do të gjejnë kurrë paqe dhe rehati, dhe do të jenë përherë të poshtëruar e të shtypur. Mirëpo, ata nuk e dinë se në fakt besimi është ai që i jep vlerë njeriut. Kur më në fund besimtarët të hyjnë në Xhenet, duke arritur mëshirën e Allahut të Madhëruar, mohuesve do t'u përmenden mendimet e mësipërme. Atje do t'u tregohet se si besimtarët të cilët konsideroheshin të dobët, do të jenë të sigurt nga frika dhe hidhërimi, ndërkohë që mohuesit do të mbeten në dështim dhe poshtërim të pasosur. Pra, përfundimi i bukur u takon të devotshmëve dhe vetëm besimtarët do të fitojnë në fund të rrugës.

✓ Ata që i dalin zot Librit të Allahut, e trashëgojnë atë, dhe që me lejen e Allahut garojnë për të qenë të parët në vepra të mira. (shih. Fatir, 32, 34)

✓ Robërit e devotshëm, të cilët i frikësohen Allahut dhe e respektojnë atë. (shih. Zumer, 61)

✓ Ata që i besojnë ajetet e Allahut dhe bëhen myslimanë, duke arritur pjekurinë e vërtetë në devotshmëri ashtu siç dëshiron Allahu, me një dorëzim të plotë. (shih. Zuhuf, 68-69)



Nga hadithet fisnike kuptojmë që në vendin e Mahsherit, ndërkohë që Dielli është afruar mjaft dhe gjenden shumë njerëz të cilët presin për një kohë të gjatë në vuajtje dhe të cilëve u ka arritur djersa deri në fyt, do të ketë disa robër që do të gëzojnë mirësi dhe gosti nën hijen e Arshit të Allahut.

Lidhur me këta robër të mirë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, kur nuk do të ketë hije tjetër (përveç hijes së Allahut), Allahu i Madhëruar do t’i strehojë nën hijen e arshit të Tij këto shtatë kategori njerëzish:

- *Kryetarin e drejtë të shtetit,*
- *Të riun që rritet dhe e kalon jetën duke adhuruar Allahun,*
- *Myslimanin, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë,*
- *Dy persona të cilët duhen për hir Allahut, e që bashkimin dhe ndarjen e bëjnë po për hir të Allahut,*
- *Trimin, i cili nuk i afrohet propozimit për të kryer zina me një grua të bukur e me pozitë, duke thënë “Unë i frikësohem Allahut!”,*
- *Atë që jep sadaka me dorën e djathtë pa e ditur e majta,*
- *Atë që e përmend Allahun dhe derdh lot kur është i vetmuar.”* (Buhari, Ezan, 36, Zekat, 16, Rikak, 24, Hudud 19; Muslim, Zekat, 91)



Siç bëhet e ditur në hadithin e mësipërm, një prej kategorive që do të lirohet prej vështirësive të ditës së Kiametit dhe nuk do të ndjejë as frikë e as hidhërim, janë besimtarët që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut. Lidhur me këtë të vërtetë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Ku janë ata që duhen me njëri-tjetrin për hatër të dashurisë që ndjejnë për mua? Unë do t’i strehoj ata nën Arshin Tim sot, kur s’ka asnjë strehim tjetër, dhe do t’i marr nën mbrojtjen time.» (Muslim, Birr, 37)

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ka disa njerëz prej robërve të Allahut, që nuk janë as profetë e as shehidë/dëshmorë, por për shkak të pozitës së lartë që do të kenë tek Allahu në ditën e Kiametit, do t’i kenë zili edhe profetët edhe dëshmorët.”



Sahabët e nderuar thanë:

“Kush janë këta dhe çfarë punësh të mira kanë bërë? Na i trego edhe neve, që t’i duam dhe të bëhemi të afërt me ta, o i Dërguar i Allahut!”

Profeti ﷺ, tha:

“Këta janë njerëz të tillë, që edhe pse midis tyre nuk ka asnjë lidhje farefisnore dhe asnjë marrëdhënie tregtie apo pune, ata e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut. Për Allahun! Fytyrat e tyre janë dritë, e ata vetë qëndrojnë mbi ulëse prej drite. Kur njerëzit të tmerrohen në ditën e Kiametit, këta nuk do të kenë frikë. Kur njerëzit të hidhërohen, këta nuk do të hidhërohen.” Pastaj, menjëherë pas këtyre fjalëve, lexoi ajetet 62-64 të sures Junus. (Ebu Daud, Buju, 76/3527; Hakim, IV, 188/7318)

Gjithashtu, edhe kjo ndodhi që ka treguar Profeti ﷺ e tregon më së miri vlerën që ka tek Allahu i Madhëruar dashuria midis vëllezërve të fesë, për hir të Tij:

“Një njeri doli që të shkonte për vizitë tek një vëllai i tij (i fesë) që ndodhej në një fshat tjetër. Allahu i Madhëruar i dërgoi një melek (në formën e njeriut) për ta vëzhguar (dhe sprovuar). Kur njeriu kaloi pranë melekut, ai e pyeti:

«Ku po shkon?» Njeriu u përgjigj:

«Tek ai fshat kam një vëlla të fesë, të cilit po i shkoj për vizitë.» Meleku pyeti përsëri:

«Ke ndonjë interes tek vëllai yt?» Njeriu përgjigjet:

«Jo, unë e dua atë vetëm për hir të Allahut, prandaj po i shkoj për vizitë.» Pas këtyre fjalëve, meleku thotë:

«Ashtu siç e do ti atë, edhe Allahu të do ty. Unë jam i dërguari i Allahut dhe kam ardhur të të përgëzoj për këtë.» (Muslim, Birr, 38; Ahmed, II, 292)



Ndërsa në një hadith tjetër, lidhur me atë që i jep borxh një vëllai të tij në vështirësi dhe e lehtëson atë në pagimin e këtij borxhi, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush i jep afat borxhliut në vështirësi, ose i bën zbritje prej borxhit, Allahu i Madhëruar do ta strehojë nën hijen e Tij.” (Muslim, Zuhd, 74)



“Nëse dikush i jep afat borxhliut në vështirësi ose ia fal një pjesë apo të gjithë borxhin, Allahu i Madhëruar do ta strehojë atë nën hijen e Arshit të Vet ditën e Kiametit, ku nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij.”

(Tirmidhi, Buju, 67/1306; Ibn-i Maxhe, Sadakat, 14)



Para se të kalojmë në temat e Xhenetit dhe Xhehenemit, të cilat janë stacionet e fundit të Ahiretit, mendojmë se është shumë e rëndësishme të kuptohet mirë çështja se:

Njeriu është krijuar i dobët në shumë aspekte. Për shembull, distanca që mund të shohë me sytë e tij dhe gama e frekuencës së zërit brenda së cilës mund të dëgjojnë veshët e tij, janë të kufizuara. Po ashtu, janë të kufizuara edhe çështjet që ai mund të kuptojë me mendjen e tij. Ai është i dënuar që bashkë me frymën e fundit ta braktisë dhe t’ia japë tokës edhe trupin e tij, i cili është si një lloj fronti mbi të cilin mbizotëron në këtë botë.

Allahu i Madhëruar, edhe mendjen e njeriut e ka krijuar në atë mënyrë, që të vërtetat t’i kuptojë më mirë me anë të shembujve të veçantë dhe këtë botë të përkohshme ia ka ofruar në formën e një ekspozite ku mund të marrë mësim. E atyre që jetojnë në përputhje me urdhrat hyjnore u ka premtuar Xhenetin, ndërsa atyre që qëndrojnë indiferentë ndaj fesë së vetme të vërtetë, Islamit, u ka premtuar Xhehenemin.

Pikësëpari duhet të themi se Xheneti dhe Xhehenemi që na përshkruhen në ajetet dhe hadithet fisnike, janë të pamundur të kuptohen në natyrën e tyre të vërtetë, me mendjet tona të kufizuara të cilat mund të kuptojnë vetëm me modele të kësaj bote. Kjo, sepse e kufishmja nuk mund ta përfshijë të pakufishmen dhe e përkohshmja nuk mund ta përfshijë të përhershmen! Megjithatë, ato që na janë bërë të ditura në lidhje me situatat e Ahiretit, janë të vërtetat hyjnore dhe profetike, të cilat i janë ofruar nivelit të botëkuptimit tonë, me qëllim që të mos mbetemi indiferentë ndaj përgatitjes që duhet të bëjmë për botën e përjetshme.

Allahu i Madhëruar, ka krijuar shumë botë me cilësi të veçanta, sikur ka dashur të demonstrojë Dijen dhe Fuqinë e Tij të pafundme; dhe njeriun e ka bërë udhëtarin e këtyre botëve.

Për shembull, në të shkuarën, trupi i njeriut ka qenë pjesë e tokës si element i natyrës. Me kohën, ai kaloi tek bimët që dalin prej tokës dhe



prej tyre tek disa kafshë. Ndërkohë, me anë të ushqimeve, ai kaloi si qelizë riprodhuese në trupin e babait të vet. E prej aty, u vendos në mitrën e nënës së tij.

Ndërkaq, “njeriu” fitoi një jetë krejtësisht të ndryshme në mitrën e nënës. Aty filloi të jetojë në errësi brenda një qeseje me ujë dhe të ushqehet prej trupit të nënës. Pas një farë kohe, ai u detyrua ta braktisë jetën në të cilën gjendej dhe i hapi sytë në një botë krejtësisht ndryshe, pra në këtë botë të përkohshme. Padyshim se kjo jetë e re, kishte kushte shumë të ndryshme nga ajo e mëparshme. Tashmë, nuk bëhej më fjalë të jetonte brenda në ujë si më parë dhe të ushqehet nga trupi i nënës. Tani, ai e vazhdonte jetën e tij duke thithur oksigjen dhe duke u ushqyer me mundësitë e tij.

Këtë fakt, i nderuari Mevlana, e ka shprehur me këto fjalë procesin e mësipërm:

“Sikur fëmijës në barkun e nënës t’i thuhej:

«Jashtë gjendet një botë e mirë dhe e kënaqshme. Atje toka është e gjerë dhe e begatë.

Atje ka mirësi të shumta dhe ushqime të panumërta. Po ashtu, ka edhe male, dete, shkretëtira, kopshte, vreshta, lëndina e livadhe.

Atje ka një qiell të lartë dhe të ndriçuar me drita, ka Diell, Hënë dhe yje. Atje fryjnë erëra prej jugut, veriut, lindjes dhe perëndimit.

Kopshtet dhe vreshtat janë zbukuruar si nusët që u bëhet dasma. O vogëlush! Ti je kryqëzuar në atë vend të ngushtë torturash dhe po thith gjak. Ke rënë në burg dhe je mes papastërtive dhe vuajtjeve!»

Por, pavarësisht gjithë këtyre fjalëve, ai vogëlush shikonte punën e vet dhe nuk ankohej për asgjë. Madje, ai i mohonte këto që i thuheshin, nuk i besonte këto fjalë dhe thoshte:

«Këto fjalë që thuhet, janë të pamundura. A mos doni të më mashtronin!?»

Ja pra, e tillë është edhe gjendja e shumë njerëzve në këtë botë. Ata i mohojnë fjalët e atyre që u sjellin lajme nga bota e shpirtit dhe u thonë:

«Kjo botë është e errët dhe e ngushtë si një pus. Por përtej kësaj bote ekziston një botë tjetër shumë e bukur.»

Mirëpo, këto fjalë nuk shkojnë në veshin e askujt prej tyre.”



Në të njëjtën mënyrë, pasi të vdesë, njeriu do të kalojë në një botë tjetër dhe kushtet e asaj bote do të jenë krejtësisht ndryshe nga këto të botës në të cilën jetojmë.

Siç na bëhet e ditur, jeta e atjeshme do të jetë e pavdekshme, ndërsa mirësitë dhe bukuritë do të jenë të pafundme dhe përtej imagjinatës. Kurse dënimi që do të vuajnë gjynahqarët, do të jetë aq i ashpër dhe i tmerrshëm, sa nuk është parë ndonjëherë në këtë botë. Pra, edhe vuajtjet edhe kënaqësitë do të jenë të pakrahasueshme me ato të kësaj bote, sepse atje koha, hapësira, dimensionet dhe distancat do të jenë ndryshe. Për këtë arsye, lidhur me botën tjetër të pafundme, njeriu mund të kuptojë vetëm aq sa i janë bërë të ditura në ajetet dhe hadithet fisnike dhe në sajë të krahasimeve që bën me modelet e kësaj bote.

Shkurtimisht, Allahu i Madhëruar, përmes profetëve të Tij, i ka lajmëruar njerëzit se si do të jetë bota e përjetshme dhe se si duhet të përgatiten për atje, duke ua treguar qartë edhe vendin e shpërblimit, edhe vendin e dënimit. Ai ka bërë të ditur se atyre që përdorin mendjen dhe ndjekin udhëzimin, do t'u falë mirësi të pafundme, ndërsa atyre që kundërshtojnë, do tu japë ndëshkim të dhembshëm. Këto janë të vërteta të cilat do të realizohen ashtu siç janë lajmëruar, sepse për Allahun e Madhëruar nuk ka asgjë të pamundur.

PJESA VII



Xhehenemi

Një natë e errët e dynjasë, që kalohet duke jetuar në mënyrë egoiste, zhytur në lloj-lloj argëtimesh e klithmash, larg Dashurisë hyjnore dhe kënaqësive shpirtërore, është e sigurt që nuk do të përfundojë kurrë me një mëngjes vdekjeje të ndritur.

Të mos harrojmë se ëndrrat egoiste ngjyrë rozë të jetës së dynjasë, janë të dënuara të përfundojnë të zbehura; e të qeshurat moskokëçarëse, me kërcitjet e Xhehenemit.

XHEHENEMI

Xheneti, vendi i lumturisë së përjetshme, dhe Xhehenemi, vendi i caktuar për ata që e meritojnë dënimin hyjnor për shkak të kundërshtimit të Allahut të Madhëruar, janë krijuar dhe ekzistojnë në këtë moment. Pasi të bëhet Kiameti, Xhehenemi do të sillet nga vendi ku ndodhet, në sheshin e Mahsherit. Me të, do të ndëshkohen ata që ikën prej diellit të udhëzimit dhe preferuan të qëndrojnë në errësirën e mohimit. Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَجِيءَ يَوْمَئِذٍ بِجَهَنَّمَ ۚ يَوْمَئِذٍ يَتَذَكَّرُ الْإِنسَانُ وَأَنَّى لَهُ الذِّكْرَىٰ

“Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet, por, ç’i duhet se u kujtua!” (Fexhr, 23)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, për të na kujtuar këtë të vërtetë dhe për të na tërhequr vëmendjen në lidhje me madhësinë dhe tmerrin e Xhehenemit, ka thënë:

“Ditën e Gjykimit do të sillet Xhehenemi, i cili ka shtatëdhjetë mijë frerë dhe secili prej tyre tërhiqet nga shtatëdhjetë mijë melekë.” (Muslim, Xhennet, 29)²⁰⁹



Disa prej gjynahqarëve do të nxirren nga Xhehenemi pasi të vuajnë dënimin. Ndërsa për jobesimtarët Xhehenemi do të jetë një dënim i përjetshëm. Lidhur me këtë të vërtetë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kur banorët e Xhenetit të kenë hyrë në Xhenet dhe banorët e Xhehenemit të kenë hyrë në Xhehenem, midis tyre do të ngrihet një thirrës që do të thërrasë:

«O banorët e Xhenetit, tashmë nuk ka më vdekje! O banorët e Zjarrit, tashmë nuk ka më vdekje! Këtej e tutje do të ketë përjetësi!» (Buhari, Rikak, 50)

209. shih. Tirmidhi, Xhehennem, 1/2573.



Tmerri i Xhehenemit

Lidhur me tmerrin, madhësinë dhe thellësinë e Xhehenemit, transmetohet një hadith nga Ebu Hurejre رضي الله عنه:

“Njëherë, ishim së bashku me të Dërguarin e Allahut ﷺ, kur papritur dëgjuam zhurmën e diçkaje që ra. Atë moment, Profeti ﷺ, na pyeti:

«A e dini çfarë është kjo?»

«Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!» -u përgjigjëm ne.

I Dërguari i Allahut ﷺ, vazhdoi sqarimin:

«Ky është një gur, i cili është hedhur në Xhehenem që para shtatëdhjetë vjetësh, dhe që prej asaj dite ishte në rënie. Tani sapo ra në fund të tij.»

(Muslim, Xhennet, 31; Ahmed, II, 371)

Allahu i Madhëruar, një zhurmë të cilën normalisht nuk e lejon të dëgjohet, atë moment e lejoi, me qëllim që të ishte një mësim për Profetin tonë ﷺ dhe shokët e tij.

Këtu duhet të kujtojmë edhe njëherë se koncepti jonë i distancës, lidhet me kushtet e kësaj bote, ndërsa koncepti i kohës dhe hapësirës në botën tjetër, ka veçori të tjera. Mundësitë dhe kushtet e jetës së dynjasë, janë shumë të ndryshme nga ato të jetës së Berzahut dhe të Ahiretit. Me anë të vdekjes, njeriu do të kalojë në një jetë krejtësisht të ndryshme. Për këtë arsye, kur të lexohet diçka në lidhje me botën e Berzahut dhe të Ahiretit, duhet merret gjithmonë parasysh se ato janë botë me kushte dhe ligje të ndryshme, të cilat nuk duhet të vlerësohen në bazë të kushteve dhe ligjeve të kësaj bote.



Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar shpjegon:

يَوْمَ نَقُولُ لِجَهَنَّمَ هَلِ امْتَلَأَتْ وَتَقُولُ هَلْ مِنْ مَّزِيدٍ

“Atë Ditë Ne do ta pyesim Xhehenemin: «A u mbushë?» e ai do të përgjigjet: «A ka edhe më?»” (Kaf, 50)

Lidhur me ajetin e mësipërm, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Sa herë që hidhen kriminelët në zjarr, Xhehenemi pyet vazhdimisht,

«A ka më?». Më në fund, kur Allahu i Madhëruar vë këmbën e Tij²¹⁰ mbi të, ai rrudhet, mblidhet (i mbyllen boshllëqet) dhe kësaj here thotë:

«Për hir të madhësisë dhe bujarisë Tënde, mjaft se u mbusha tashmë!»

Ndërkohë që vendet e tepërta në Xhenet vazhdojnë (të mbushen), Allahu i Madhëruar krijon njerëz të tjerë dhe i vendos në vendet që kanë tepruar në aty.” (Muslim, Xhennet, 38)

Në këtë hadith tregohet se Allahu i Madhëruar do të krijojë njerëz të tjerë për të mbushur vendet bosh të Xhenetit, ndërkohë që vendet bosh të Xhehenemit do t'i tkurrë dhe do t'i eliminojë. E gjithë kjo shpreh edhe njëherë të vërtetën se Allahu i Madhëruar nuk do t'i bëjë padrejtësi askujt²¹¹ dhe se mëshira e ka mbizotëruar zemërimin e Tij.



Njëherë, gjatë një bisede me sahabët, i Dërguari i Allahut ﷺ, u tha:

“Zjarri (i kësaj bote) është sa një e shtatëdhjeta pjesë e Zjarrit të Xhehenemit.”

Dikush tha:

“O i Dërguari i Allahut! Edhe sikur ky (i kësaj bote) të ishte, do të mjaftonte (për të ndëshkuar mosbesimtarët).”

Profeti ﷺ, tha:

“Zjarri (i Xhehenemit) është edhe gjashtëdhjetë e nëntë herë më i nxehtë sesa zjarri i zakonshëm dhe secila pjesë e tij është e nxehtë sa ky zjarr (që përdorim).” (Buhari, Bed' u'l-Halk, 10; Muslim, Xhennet, 30)

Lidhur me këtë hadith, Imam Kurtubi është shprehur:

“Nëse mblidhen të gjithë zjarret që ndezin bijtë e Ademit, nuk do të ishin as sa një e shtatëdhjeta e zjarrit të Xhehenemit. Domethënë, nëse mblidhen dhe ndizen të gjitha drutë dhe lëndët djegëse të dynjasë, pa asnjë dyshim se një e shtatëdhjeta e zjarrit të Xhehenemit do të ishte më i nxehtë se zjarri i dynjasë.” (Kurtubi, Tedhkire, fq. 861)



210. Këto lloj shprehjesh janë ngjasime, të cilat bëhen me qëllim që të lehtësojnë kuptimin e disa çështjeve dhe nuk kanë për qëllim të ngjasojnë Allahun me krijesat e Tij.

211. shih. Muslim, Xhennet, 35-39.


Po ashtu, edhe ky hadith fisnik tregon se sa i ashpër është zjarri i Xhehenemit:

“Xhehenemi u ankuat tek Zoti:

«O Zot! Një pjesë e imja po ha pjesën tjetër!»

Pas kësaj, Allahu i Madhëruar e lejoi atë (Xhehenemin) të marrë frymë dy herë. Njëherë në dimër, njëherë në verë. Në kohën kur i nxehti është më përvëlues dhe i ftohti më i hidhur, atëherë është frymëmarrja e tij.”

(Buhari Bed'u'l-Halk, 10)

Lidhur me kohën kur dimri është më i hidhur, Ibn-i Abbasi  thotë:

“Banorët e Xhehenemit kërkojnë ndihmë për të shpëtuar prej të nxehtit. Por si “ndihmë”, atyre u dërgohet një erë e ftohtë (shumë e hidhur). Ky është një i ftohtë i tillë që prej ashpërsisë së tij banorëve të Xhehenemit fillojnë t’u thyhen kockat. Për rrjedhojë, ata kërkojnë të kthehen përsëri tek zjarri i Xhehenemit.”²¹²

Në kushtet e dynjasë, zjarri e shkrumbon vendin ku bie. Mirëpo, në Ahiret, për shkak se vdekja nuk do të ekzistojë dhe çdo gjë do të marrë cilësi të përjetshme, mohuesit nuk do të vdesin dhe ndëshkimi i tyre do të vazhdojë pandërprerë. Siç lajmërohemi edhe në hadithet fisnike, me qëllim që ta vuajnë edhe më tepër ashpërsinë e dënimit, trupat e tyre do të krijohen më të mëdhenj dhe më të rezistueshëm.

Allahu i Madhëruar, i Cili ka mëshirë të pakufishme, në Kuranin Fisnik na paralajmëron shpesh herë ne, robërit e Tij, me qëllim që të mos e pësojmë dënimin e Tij të tmerrshëm. Prandaj nuk duhet të harrojmë asnjëherë se lajmet e Ahiretit, që na bëhen të ditura në Kuranin Fisnik dhe hadithet profetike, nuk janë aspak mite, por të vërteta me të cilat njeriu do të përballet në mënyrë absolute, ashtu siç është vdekja. Është e domosdoshme që ato lajme të merren seriozisht dhe të veprohet sipas tyre, duke u përgatitur sa më mirë për jetën e përjetshme, sa kemi ende mundësi.



Është shumë qesharake logjika e mohuesve, të cilët nuk e kuptojnë seriozitetin e lajmeve hyjnore dhe profetike, në lidhje me Xhehenemin, dhe

që me mendjen e tyre të kufizuar përpiqen t'i krahasojnë ato me modele të kësaj bote. Shembulli më i bukur i këtij fakti, është edhe kjo ndodhi:

Ibn-i Xherir, transmeton një ndodhi nga Ibn-i Abbasi رضي الله عنه:

Kur zbriti ajeti fisnik:

عَلَيْهَا تِسْعَةَ عَشَرَ

“Atij i rrinë roje nëntëmbëdhjetë (melekë).”²¹³ (Armiku i të Dërguarit të Allahut) Ebu Xhehli, i tha Kurejshëve:

“Ju qafshin nënat!”

Më pas, duke aluduar për Profetin ﷺ, tha:

“Ibn-i Ebi Keshshe, ju bën të ditur se rojet e Xhehenemit janë nëntëmbëdhjetë. Ju jeni kaq shumë dhe të fuqishëm, a nuk do të mund ta mbajnë dhjetë prej jush njërin prej rojave të Xhehenemit?”

Pas kësaj, Allahu i Madhëruar i urdhëroi Profetin ﷺ, që të shkonte tek Ebu Xhehli dhe t'i thoshte:

“*Turp të kesh! Turp të kesh! Përsëri turp të kesh, turp të kesh!*” (Sujuti, Lubabu'n-Nukul, II, 189)

Ndërsa këto dy ajete fisnike, i drejtohen në mënyrë të veçantë Ebu Xhehlit, dhe në mënyrë të përgjithshme të gjithë njerëzve indiferentë, që janë mendjemëdhenj, mburravecë dhe mohues:

أُولَىٰ لَكَ فَأُولَىٰ ﴿٣٤﴾ ثُمَّ أُولَىٰ لَكَ فَأُولَىٰ ﴿٣٥﴾

“Mjerë për ty! Mjerë për ty! Sërish: Mjerë për ty! Mjerë për ty!” (Kijame, 34-35)

Dënimi i Xhehenemit

Dënimi i atyre që do të shkojnë në Xhehenem, nuk do të jetë për të gjithë i njëjtë. Pra, të gjithë do të ndëshkohen me lloje të ndryshme dënimesh, në bazë të gjendjeve të tyre. Një pjesë e këtyre dënimeve na bëhet e ditur në Kuranin Fisnik:

213. Muddeththir, 30.

“Ata që s’besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t’i djegim në zjarr. Sapo t’u digjet lëkura, Ne do t’ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Nisa, 56)

“Për ata janë përgatitur shtretër zjarri dhe sipër tyre do të ketë mbulesa zjarri. Kështu i ndëshkojmë Ne keqbërësit.” (Araf, 41)

“Ata do të mbulohen me shtresa zjarri nga sipër dhe nga poshtë. Me këtë, Allahu i tremb robërit e Vet. «O robërit e Mi, më kini frikë Mua!»” (Zumer, 16)²¹⁴

“Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: «Ah, sikur t’i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!» Dhe do të thonë: «O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!»” (Ahzab, 66-68)

Sa skena të tmerrshme janë këto! Ndërkohë që fytyra i ekspozohet nxehtësisë më të madhe të zjarrit, sa nga një anë, në anën tjetër, e zjarri më i ashpër arrin çdo pikë të trupit dhe çdo qelizë të fytyrës, mohuesit të lodhur e të penduar, i rrëfejnë gjynahet e tyre të poshtëruar dhe duke u përgjyruar. Me një ton zëri të pashpresë, ata lëshojnë mallkime me zemërim dhe urrejtje të hidhur ndaj parisë së tyre, që i tërhoqën në këtë fund tragjik!..



“Besimtarët dhe jobesimtarët grinden për Zotin e tyre, por për ata që nuk besojnë janë përgatitur rroba prej zjarri, e mbi kokat e tyre do të hidhet ujë i valuar, me të cilin do t’u shkrihen ç’kanë në barqe dhe lëkura. Për ata ka kamxhikë prej hekuri. Sa herë, që do të përpiqen të dalin nga ankthi i zjarrit, do të rikthehen në të (e do t’u thuhet): «Shijoni dënimin me djegie të tmerrshme!»” (Haxhxxh, 19-22)²¹⁵

“Pa dyshim, Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr flakërues.” (Insan, 4)

Ibn-i Abbasi , transmeton se:

214. shih. Ankebut, 55.

215. shih. Sexhde, 20; Maide, 37.



“Profetit ﷺ i ra të fikët kur dëgjoi një person të këndonte ajetet: **«Pa dyshim, Ne kemi përgatitur për ata pranga, zjarr flakërues, ushqime që ngecin në fyt dhe dënime të dhembshme!»**²¹⁶” (Bejhaki, Shuab, I, 522/917; Ali el-Muttaki, VII, 206/18644)

Ndërsa në një hadith të Profetit ﷺ lidhur me dënimin e Xhehenemit thuhet:

“Zjarri i Xhehenemit i djeg organet e brendshme dhe fillon të hajë trupat. Kur arrin tek zemra ndalon dhe trupat e banorëve të Xhehenemit kthehen si më parë. Zjarri fillon t’i hajë duke i djegur përsëri dhe arrin deri tek zemra e tyre. Kjo vuajtje vazhdon njësoj përjetësisht. Madje, kjo gjendje na bëhet e ditur në ajetet: **«Ai është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.»**²¹⁷” (Ibnu’l-Mubarek, *ez-Zuhd ue’r-Rekaik*, II, 87; Ibn-i Ebi Dunja, *Sifatu’n-Nar*, fq. 94/139; Ibn-i Kethir, *en-Nihaje*, II, 147)



Ushqimi i mohuesve dhe gjynahqarëve, në Xhehenem, është pema e Zakkumit. Siç, shprehet edhe në Kuranin Fisnik, ajo rritet në fundin e Xhehenemit dhe frutat e saj i ngjajnë kokave të shejtanëve. Kur hahet, jo vetëm që nuk ta shuan urinë, por ajo fillon të valojë në bark si uji kur zien, ose si metal i shkrirë.

Pas këtij ushqimi, atyre do t’u jepet një pije e përzier me ujë të valuar. E për shkak se do t’u djegë barku, ata do ta pinë këtë ujë si deve të etura. Mirëpo, saherë që pinë prej tij, atyre u shtohet edhe më shumë etja. Më pas, do të hidhen në zjarrin përvëlues dhe sipër tyre do t’u derdhet përsëri ujë i valuar.²¹⁸

Ibn-i Abbasi , ka thënë:

“Nëse mbi dynja do të pikonte një pikë prej zakumit të Xhehenemit, do të prisheshin të gjitha ushqimet dhe pijet e njerëzve.”²¹⁹

Po ashtu, një ushqim tjetër që u shkakton vuajtje dhe dënim, banorëve të Xhehenemit, përshkruhet kështu në Kuranin Fisnik:

216. Muzzemmil, 12-13.

217. Humeze, 6-7.

218. shih. Saffat, 62-68; Duhan, 43-48; Uakia, 52-55.

219. Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 52/34144.



“Atë Ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish, që kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë). Ata do të digjen në zjarr të nxehtë e do të pinë nga burime të valuara. Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese, të cilat as nuk do t’i mbajnë, as nuk do t’ua shuajnë urinë.” (Gashije, 2-7)

Nga ky ajet kuptohet se uria e madhe do të jetë një lloj tjetër i dënimit të Xhehenemit.



Xhabiri ﷺ, tregon:

“Një person erdhi prej Xhejshanit (të Jemenit) dhe e pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ, në lidhje me një pije që e përdornin në vendin e tyre, që përgatitej prej misrit dhe quhej Mizr. I Dërguari i Allahut ﷺ, pyeti:

«A shkakton dehje?»

«Po!» -u përgjigj personi.

Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Çdo gjë dehëse është haram! Allahu, atyre që pinë gjëra dehëse u ka premtuar se do t’u jap të pinë “Tijnetu’l-Habal”.»

Të pranishmit pyetën:

«Çfarë është “Tijnetu’l-Habal” o i Dërguari i Allahut?»

Profeti ﷺ sqaroi:

«Ajo është djersa e banorëve të Xhehenemit, ose qelbi i banorëve të Xhehenemit» (Muslim, Eshribe, 72; Ebu Daud, Eshribe, 5)²²⁰

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, mendjemëdhenjtë do të ringjallen në formën e njeriut, por sa milingonat e vogla kuqalashë. Poshtërimi do t’i rrethojë nga çdo anë. Ata do të tërhiqen në një burg të quajtur “Bules”. Pastaj do t’i përfshijë zjarri i zjarreve dhe do t’u jepet të pinë pijen e banorëve të Xhehenemit, “Tijnetu’l-Habal”, prej gjakut, qelbit dhe ndyrësive.” (Tirmidhi, Kiamet, 47/2492; Ahmed, II, 179; Buhari, el-Edebu’l-Mufred, nr: 557)



Hasan el-Basri, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Nëse mbi tokë do të derdhej një kovë prej gjakut dhe qelbit që rrjedh prej banorëve të Xhehenemit, të gjithë do të vdisnin dhe mbi planet nuk do të mbetej askush.” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 52/34145)

Ndërsa Abdurrahman ibn Jezidi tregon:

“(Njëherë) Dolëm për udhëtim bashkë me Ata el-Horasanin. Ai i gjallëronte netët me namaz dhe pasi kalonte një e treta, apo gjysma e natës, na thërriste në emër nga çadra e tij:

«O Abdurrahman, o filan, o filan!.. Ngrihuni, merrni abdest dhe falni namaz! Kalimi i kësaj nate me namaz dhe agjërimi i kësaj dite, është më e lehtë se të pish gjak e qelb dhe të veshësh rroba prej hekuri në Xhehenem! Nxitoni, nxitoni! Shpëtoni veten tuaj!» Më pas vazhdonte namazin.” (Shih. Bejhaki, Shuab, IV, 528, V, 417; Ebu Nuajm, Hilje, V, 193; Ahmed, Zuhd, fq. 309)



I Dërguari i Allahut ﷺ, në hadithet e tij, na lajmëron se në Xhehenem, mohuesve të Allahut do t’u zmadhohen trupat dhe gjymtyrët sipas llojit të mohimit të tyre:

“Dhëmballa apo “dhëmbi i qenit” të banorëve të Xhehenemit do të jenë sa mali i Uhudit, ndërsa trashësia e lëkurës së tyre do të jetë sa tre ditë udhëtim.” (Muslim, Xhennet, 44)

“Distanca midis dy supeve të banorëve të Xhehenemit, është sa tre ditë udhëtim për një kalorës që ecën shpejt.” (Muslim, Xhennet, 45)

Vendi ku ulet mohuesi në Xhehenem, është sa distanca midis Mekës dhe Medinës.²²¹

Padyshim se zmadhimi në këtë mënyrë i trupave të mohuesve në Xhehenem, bëhet me qëllim që ata ta mbushin të gjithë Xhehenemin dhe ta vuajnë sa më shumë dënimin.

Duhet të kujtojmë se Allahu është Ai që e ka krijuar edhe milingonën, edhe elefantin. Po të dëshironte, mund ta bënte milingonën në madhësinë e elefantit dhe elefantin në madhësinë e milingonës. Po ashtu, edhe bale-

221. Tirmidhi, Xhehenem, 3/2578.



nën, edhe sardelen Ai i ka krijuar. Për Allahun e Madhëruar nuk ekziston asnjë vështirësi.

Për rrjedhojë, Allahu i Madhëruar ka edhe fuqinë që ditën e Kiametit t'i zmadhojë edhe më shumë përmasat trupore të njerëzve dhe distancat e vendeve. Pra, këto transmetime nuk kanë kuptim hiperbolik, por shprehin diçka reale. Ne e kemi për detyrë t'i pranojmë të gjitha transmetimet që na vijnë me zinxhir të saktë. Siç e shprehëm edhe më herët, ne nuk duhet të përpiqemi ta kuptojmë Ahiretin me kushtet e kësaj bote, por duhet të kemi gjithmonë parasysh se ajo është një botë krejtësisht ndryshe nga kjo ku jetojmë sot.



I Dërguari i Allahut ﷺ, në hadithet e tij ka thënë:

“Disa prej banorëve të Xhehenemit zjarri do t’u shkojë deri në thembra, disave deri në gjunjë, disave deri në brez dhe disave deri në klavikula (fyt).” (Muslim, Xhennet, 32-33)

*“Në botën tjetër, personi që do ta ketë dënimin më të lehtë prej banorëve të Xhehenemit, është ai të cilit do t’i vihen dy copa prushi poshtë këmbëve dhe për shkak të kësaj do t’i ziejë truri si kazan apo si gjym.”*²²² *“...E megjithatë, ai pandeh se askush tjetër nuk është duke u dënuar më shumë se ai. Por në fakt, ai ka dënimin më të lehtë prej banorëve të Xhehenemit.”* (Muslim, Iman, 364)

Katade ؓ, ka thënë:

“Nëse dikush hyn në Xhehenem vetëm aq sa zhytet dhe nxirret një kovë nga uji, edhe aq do të ishte një dënim i madh për të.” (Ibn-i Ebi’ d-Dunja, Sifatu’n-Nar, fq. 108, nr: 164)



Ndërsa dënimi më i madh që do të pësojnë banorët e Xhehenemit, do të jetë privimi nga shikimi i Bukurisë së Allahut dhe privimi nga shikimi mëshirues i Allahut ndaj tyre. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik lajmërohet:

كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَّحْجُوبُونَ

“Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t’i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre!” (Mutaffifin, 15)

Banorët e Xhehenemit nuk do të gëzojnë as shikimin mëshirues të Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë, Ebu Imran el-Xheuni thotë:

“Nëse Allahu i Madhëruar e sheh një njeri, patjetër që e mëshiron. Po të shihte edhe banorët e Xhehenemit, patjetër që edhe ata do t’i mëshironte. Mirëpo, Allahu i Madhëruar ka vendosur që të mos i shohë ata.” (Ebu Nuajm, Hilje, II, 314)



Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me gjendjen e disa gjynahqarëve që do të dënohen thotë:

“Natën e Miraxhit shkova pranë disa njerëzve me barqe të mëdhenj si shtëpi. Barqet i kishin të mbushura me gjarpërinj, të cilët shiheshin edhe nga jashtë.

«Kush janë këta o Xhibril?» -pyeta unë.

«Këta janë ata që kanë ngrënë kamatën!» -u përgjigj ai.» (Ibn-i Maxhe, Tixharat, 58)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kur u ngrita në Miraxh, kalova pranë një turme njerëzish që gërvishtnin fytyrat dhe kraharorët, me thonj prej bakri.

«Kush janë këta o Xhibril?» -pyeta unë.

«Këta janë ata që hanin mishin e njerëzve (duke përgjuar) dhe luanin me nderin e tyre.» - u përgjigj ai.» (Ebu Davud, Edeb, 35/4878; Ahmed, III, 224)



Ata që janë zhytur në gjynahe, të cilat e largojnë robin nga mëshira e Allahut dhe e bëjnë të meritojë dënimin hyjnor, duhet të pendohen një orë e më parë, duke derdhur lot keqardhjeje. Po ashtu, ata nuk duhet ta humbasin shpresën në mëshirën hyjnore dhe duhet të kërkojnë falje në mënyrë të sigurtë. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ
 إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“Thuaj: «O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.»” (Zumer, 53)

Në përgjithësi ky ajet këndohet nga muezinët pas namazit farz që falet në xhami dhe para namazeve të xhenazes, dhe më pas ngrihen duart dhe bëhet dua. Shpresa prej mëshirës hyjnore nuk këputet, sepse Allahu i fal të gjitha gjynahet. Mirëpo, kjo ka një kusht, i cili shpjegohet në ajetin fisnik që vjen menjëherë pas tij:

وَأَنِيبُوا إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَأَسْلُمُوا لَهُ مِن قَبْلِ أَن يَأْتِيَكُمُ الْعَذَابُ ثُمَّ لَا تُنصَرُونَ

“Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojni Atij, para se t’ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t’ju ndihmojë kush.”

(Zumer, 54)

Domethënë, është e domosdoshme të drejtohesh nga Allahu i Madhëruar, duke bërë pendesë pa humbur kohë, me qëllim që vdekja të mos na kapë si gjynahqar.

Allahu i Madhëruar kërkon pendimin e sinqertë prej robërve të Tij. Detyra e robit është të drejtohet kah pendimi, duke u përpjekur ta urrejë gjynahun dhe të mos kthehet më tek ai. Më pas, ai duhet të strehohet vazhdimisht tek Allahu, me qëllim që pendimi i tij të pranohet. Nëse dëshiron, Allahu e pranon pendimin e robit, sepse ashtu si pranimi i lutjeve dhe i adhurimeve, edhe pranimi i pendimit varet nga dëshira e Tij.

Nga ana tjetër, është jashtëzakonisht e domosdoshme të ruhemi edhe nga zhytja në gjynahe me mendimin: “*sidoqoftë do pendohem dhe do të falem*”! Ky është një kurth i shejtanit në të cilin kanë rënë shumë njerëz.

Duke dashur t’i paralajmërojë robërit e Tij nga rënia në këtë kurth, Allahu i Madhëruar urdhëron:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِاللَّهِ الْغُرُورُ



“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kursesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për Allahun!” (Fatir, 5)

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ وَأَخْشَوْا يَوْمًا لَا يَجْزِي وَالِدٌ عَنْ وَلَدِهِ
وَلَا مَوْلُودٌ هُوَ جَازٍ عَنِ وَالِدِهِ شَيْئًا إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ
فَلَا تُغْرِبْكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يُغْرِبْكُمُ بِاللَّهِ الْغُرُورُ

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtetë i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.” (Lukman, 33)

Nisur nga këto, duhet të mos e harrojmë kurrë se ashtu siç është e pafundme mëshira e Allahut, ashtu është i ashpër edhe dënimi i Tij, sepse Ai ashtu siç është **“Rahman / Mëshirues”**, ashtu është edhe **“Kahhar / Nënshtrues”!**

Siç përshkruhet edhe në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar është:

غَافِرِ الذَّنْبِ وَقَابِلِ التَّوْبِ شَدِيدِ الْعِقَابِ...

“Falësi i gjynaheve dhe Pranuesi i pendimit, i Cili dënon ashpër!..” (Gafir, 3)

Është shumë e domosdoshme të bëhen përpjekje për të jetuar një jetë të devotshme, duke menduar se ashtu siç mund të manifestohet mirësia e Allahut, mund të manifestohet edhe ndëshkimi i Tij; ashtu siç mund të shohim bukurinë e Tij, mund të shohim edhe zemërimin e Tij!

Siç na bëhet e ditur edhe në shumë ajete fisnike²²³, vetëm mohuesit e humbin shpresën nga mëshira e Allahut. Mirëpo, siç shprehet edhe Feriduddin Attari, -Allahu e Mëshiroftë-, në veprën e tij “Pendname”: “Edhe ata që jetojnë pa pasur frikë prej dënimit të Allahut, nuk janë besimtarë por mohues absolutë!”

223. shih. Jusuf, 87; Ankebut, 23; Hixhr, 56.

Do të dëshirojnë të zhduken

Mohuesit që e shijojnë dënimin e hidhur të Xhehenemit, do të dëshirojnë të vdesin, të zhduken e të asgjësohen, por kjo nuk do të jetë e mundur. Ata do të përpëliten vazhdimisht në një vuajtje të mërzitshme, që nuk të lë as të vdesësh e as të jetosh. Atje nuk ka vdekje, që ata të shpëtojnë!.. Vuajtjet nuk u mbarojnë, që jetën ta shijojnë!..

Në Kuranin Fisnik, urdhërohet:

“Këshillës) Do t’i shmanget vetëm më i keqi, i cili do të digjet në zjarrin e madh, ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë.”
(A’la, 11-13)²²⁴

“Sa për punë-mbrapshtët, pa dyshim që ata do të qëndrojnë përherë në dënimin e Xhehenemit. Ai (dënim) nuk do t’u lehtësohet atyre e kurrfarë shprese për shpëtim nuk do të kenë. Ne atyre nuk u bëmë padrejtësi, por ata vetë i bënë keq vetvetes. Ata do të thërrasin:

«O Malik! (Më mirë) Le të na vdesë Zoti yt!», ndërsa Ai do të thotë:

«Ju do të qëndroni përherë aty!» (Zuhruf, 74-77)²²⁵

Këto skena që përshkruajnë thirrjet për ndihmë, na përshkruajnë shpirta jashtëzakonisht të stresuar prej vuajtjeve, dhe trupa të shkatërruar dhe të konsumuar nga dhimbja e papërshkrueshme që përjetojnë çdo moment. Ndërsa përgjigjja ndaj kërkesave të tyre, tregon se nuk u jepet qoftë edhe një grimcë vlerë, por përkundrazi, lihen të poshtëruar e të përçmuar.



Po ashtu, lidhur me hakërrimat e padobishme të banorëve të Xhehenemit, në Kuranin Fisnik përshkrohet:

“Kur ai t’i vërë re prej së largu, ata do t’ia dëgjojnë vlimin dhe zemërimin. E kur të hidhen në një vend të ngushtë të tij, të lidhur duarsh, do të lutën për shkatërrimin (e vet). (Atyre u thuhet:) «Mos e kërkonti sot shkatërrimin vetëm një herë, por kërkojeni shumë herë!»” (Furkan, 12-14)

224. shih. TaHa, 74.


225. shih. Fatir, 36.

Pra, kur mohuesit të përballen me dënimin e ashpër në Xhehenem, do të duan me gjithë shpirt të shkatërrohen e të asgjësohen. Mirëpo do të jetë e pamundur të vdesin e të shpëtojnë prej atij dënimi të ashpër. Në Kuran urdhërohet:

“Pas tyre është Xhehenemi, ku do të pinë ujë të qelbur, të cilin do ta gjerbin e nuk do të mund ta gëlltisin. Vdekja do t’u vijë atyre nga të gjitha anët, por nuk do të vdesin. Ata i pret një dënim i rëndë.” (Ibrahim, 16-17)



Në Kuranin Fisnik, përshkrimet e dënimit tregohen më të detajuara se përshkrimet e mirësive. Tregimi më me detaje i skenave të ndëshkimeve, bëhet për shkak që të kenë më shumë ndikim në ndjenja dhe t’i ngjallin më shumë frikë egos.²²⁶

Njëherë, një prej sahabëve fisnikë, Sheddad ibn Eus , u shtri për të fjetur dhe u kthye sa majtas-djathtas, por nuk e zinte gjumi. Më në fund, tha: “O Allah! Frika prej Xhehenemit ma nxori gjumin!” Pastaj u ngrit dhe fali namaz deri në mëngjes. (Ebu Nuajm, Hilje, I, 264)

Po ashtu, një prej njerëzve të devotshëm të brezit të tabiinëve, Sila ibn Eshjem, -Allahu e Mëshiroftë-, kur errej shkonte në një pyll me drurë të dendur dhe adhuronte Allahun. Një ditë, dikush e pikasi dhe e ndoqi atë gjatë adhurimeve në mënyrë të fshehtë. Ai dëshmoi se Sila bënte adhurime deri në kohën e mëngjesit, dhe kur afrohej koha para agimit, lutej duke thënë:

“O Allah! Padyshim se Sila nuk ka fytyrë të kërkojë Xhenetin prej Teje, por më ruaj nga Xhehenemi me mirësinë Tënde!” (Ebu Nuajm, Hilje, II, 240)

Dera që hapet në Xhehenem: Haramet e hapëta dhe të fshehta

Në këtë botë sprovash, çdo gjë rrjedh në kahe të kundërta:

“Besimi dhe mohimi”, “e vërteta dhe e kota”, “e mira dhe e keqja”, “e bukura dhe e shëmtuara”, “hallalli dhe harami”... ndërsa njeriu, me

226. Shih. Sejjid Kutub, *Meshahidu'l-Kijame fi'l-Kuran*, fq. 65.



vullnetin e tij, zgjedh njërën prej të dyjave. Në këtë mënyrë, duke u bërë “besimtar ose mohues”, “i devotshëm ose gjynahqar”, “i drejtë ose i padrejtë”, “i mëshirshëm ose i pamëshirshëm”, “bujar ose koprrac”, ai përcakton qëndrimin e tij në njërën prej këtyre dy anëve.

Kjo rrjedhë, duke kaluar prej ngushticës së vdekjes, gurgullon në lumin e Kiametit, dhe kur derdhet në sheshin e Mahsherit, do të rrjedhë përsëri në dy kahe të kundërta.

Edhe pse dynjaja është një botë ku Allahu i Madhëruar i furnizon të gjitha krijesat, për një periudhë të përkohshme, dhe si besimtari, ashtu edhe mohuesi, si i devotshmi, edhe gjynahqari, në dukje janë të përzierë dhe të barabartë, ditën e Kiametit njerëzit e mirë dhe të këqij do të ndahen shumë qartë nga njëri-tjetri. Siç shprehet edhe në Kuranin Fisnik, në sheshin e Mahsherit do të thirret:

وَأَمَّا زُورًا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمُجْرِمُونَ

“Veçohuni sot ju, o kriminelë!” (JaSin, 59)

Më pas, ndërkohë që besimtarët e devotshëm dërgohen në Xhenet, mohuesit dhe gjynahqarët tërhiqen zvarrë drejt Xhehenemit.

Lidhur me ata të cilët gjatë jetës së dynjasë e kanë përdorur lirinë e zgjedhjes, jo nga ana e Allahut, por nga ana e dëshirave të egos së tyre, dhe që për rrjedhojë janë zhytur në gjynahe që do t’i çojnë në Xhehenem, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“(Banorët e Xhenetit do të pyesin kriminelët): **«Çfarë ju ka sjellë në Sekar?» Ata do të përgjigjen:**

«Nuk ishim nga ata që falnin namaz dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit. Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët dhe mohonim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja.»

Prandaj, kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t’i ndihmojë ata!” (Muddeththir, 41-48)



Omer ibn Abdulazizi, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Përgatituni për atje ku dëshironi të shkoni në Ahiret!”

Domethënë, robi është i detyruar të përpiqet, me vepra dhe me gjendje, që ta orientojë veten në njërën prej rrjedhave të mëdha që shkojnë drejt Xhenetit apo Xhehenemit, ku ai dëshiron bëjë pjesë në botën tjetër.

Me qëllim që fryma jonë e fundit të realizohet në drejtim të takimit me Zotin, është e domosdoshme që edhe jetën tonë ta kalojmë me entuziazmin e duhur për këtë takim. Nëse dëshirojmë që përfundimi ynë të jetë Xheneti dhe shikimi i Bukurisë hyjnore, duhet që patjetër të jetojmë në mënyrë të përshtatshme me urdhrat e Allahut. Me anë të gjendjeve dhe veprave tona në këtë botë, ne e vendosim vetë nëse do të jemi në Xhenet apo në Xhehenem, në botën tjetër.

Siç shprehet edhe në ajetin fisnik:

وَمَا ظَلَمَهُمُ اللَّهُ وَلَكِنْ أَنفُسُهُمْ يَظْلِمُونَ

“...Allahu nuk u ka bërë padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes!” (Al-i Imran, 117), njeriu e përgatit me duart e veta edhe lumturinë edhe fatkeqësinë.

As dënimi në Xhehenem nuk është padrejtësi e Allahut ndaj robit të Tij, por një e keqe që njerëzit ia bëjnë vetvetes, duke mos i vënë veshin paralajmërimeve hyjnore. Një shembull i bukur është edhe kjo ndodhi:

Behlul Dana ishte një nga njerëzit më të urtë të kohës, i cili këshillonte njerëzit, dhe në mënyrë të veçantë Halifin Harun Reshid. Harun Rashidi e donte atë për sinqeritetin e tij, dhe e lejonte të hynte e të dilte lirshëm në pallatin e tij. Pasi u bë një kohë mjaft e gjatë, që Behlul Dana nuk kishte shkuar më tek Haruni Rashidi, ky i fundit kur e takoi, e pyeti:

“Behlul, ku ke qenë, u bë shumë kohë që nuk je dukur?”

“Mu tregua Xhehenemi dhe gjendja në të!” -tha Behluli.

“Si hyre atje, a nuk te dogji zjarri?” -pyeti i habitur Harun Reshidi. Por Behlul Dana i dha Halifes një përgjigje që e shastisi edhe më shumë:

“Jo nuk më dogji! Aty nuk pashë fare zjarr, sepse të gjithë e sillnin zjarrin e vet nga kjo botë!..”

Domethënë, çka i ndez flakët e Xhehenemit, janë sjelljet e këqija të vetë njeriut. Ndërsa çka i gjelbëron kopshtet e Xhenetit, janë po ashtu sjelljet e mira dhe morali i bukur i vetë njeriut...



Herë-herë neve na kaplon frika nga katastrofat dhe fatkeqësitë e mëdha që ndodhin. Ne frikësohemi kur ndodh një tërmet apo një përmytje. Po ashtu, frikësohemi edhe nga falimentimi apo nga humbja e mundësive materiale. Sigurisht që një frikë e tillë është e natyrshme për ne si njerëz. Mirëpo, ajo për të cilën duhet të frikësohemi me të vërtetë, janë gjynahet tona që na largojnë nga Allahu i Madhëruar dhe e helmatisin jetën tonë shpirtërore.

Jahja ibn Muadh, -Allahu e mëshiroftë-, thotë:

“Është për t’u habitur me atë njeri i cili mban pehriz në ushqim nga frika e sëmundjes, por nuk mban pehriz në gjynahe nga frika e Xhehenemit.”

Me pak fjalë, ne duhet të kemi frikë nga gjynahet tona:

Duhet të kemi frikë nga fjalët e gabuara që dalin nga goja jonë!

Duhet të kemi frikë nga varfëria në mëshirë e dhembshuri!

Duhet të kemi frikë nga paaftësia e shfaqjes së personalitetit dhe karakterit Islam!

Duhet të kemi frikë nga paaftësia e shfaqjes së fytyrës së bukur të Islamit!

Duhet të kemi frikë nga përballja me skenat e tmerrshme në ditën e Kiametit, për shkak të këtyre gabimeve dhe të metave tona!

Duhet të kemi frikë nga të gjitha gjynahet, me qëllim që në frymën tonë të fundit, të mund të bëhemi prej robërve fatlumë, të cilët melekët i përgëzojnë me **“siguri prej frikës dhe hidhërimit”!**



Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik, sqaron:

...وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ

“...Allahu nuk do asnjë prej atyre që janë mohues - gjynaharë!” (Bekare, 276)

Gjynahet e bëjnë robin udhëtarë të Xhehenemit. Mirëpo, gjynahet janë të dukshme dhe të padukshme, pra edhe të hapura, edhe të fshehta. Prandaj, në një ajet tjetër të Kuranit Fisnik, Allahu i Madhëruar na urdhëron që përveç gjynaheve të hapura, ne duhet të braktisim edhe gjynahet e fshehta:

وَدَرُّوا ظَاهِرَ الْإِثْمِ وَبَاطِنَهُ
 إِنَّ الَّذِينَ يَكْسِبُونَ الْإِثْمَ سَيُجْزَوْنَ بِمَا كَانُوا يَقْتَرِفُونَ

“Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta, sepse, ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar.” (En'am, 120)

Domethënë, ashtu siç është i detyruar të qëndrojë larg gjynaheve të hapëta, si pija alkoolike, kumari, kurvëria, vjedhja dhe padrejtësia, njeriu është i detyruar të ruhet edhe nga gjynahet e fshehta që e helmojnë zemrën.

Në fakt, edhe gjynahet e hapëta janë produkt i gjynaheve të fshehta. Përveç kësaj, për shkak se nuk hetohen nga askush, në përgjithësi gjynahet e fshehta veprohen më shumë. Në të shumtën e rasteve, njerëzit i nënvleftësojnë këto lloj gjynahesh dhe për këtë arsye nuk tregojnë kujdesin e duhur për të shpëtuar dhe për t'u ruajtur prej tyre. Mirëpo, të eliminosh nga zemra veset e shëmtuara, që janë sëmundje të zemrës, si mendjemadhësia, smira apo koprracia, është po aq e rëndësishme sa edhe ruajtja prej gjynaheve të hapëta. Lidhur me këtë, i nderuari Ebu Hasan Harakani ka thënë:

“Ashtu siç janë farz, (të detyrueshme) namazi dhe agjërimi, në të njëjtën mënyrë është i detyrueshëm edhe eliminimi nga zemra i mendjemadhësisë, smirës dhe lakmisë.”²²⁷

“Nëse një shkëndijë zjarri bie mbi rrobën tënde, përpiqesh ta shuash menjëherë! Po zjarrin që do të të djegë fenë, pra qëndrimin në zemrën tënde të cilësive të këqija, si mendjemadhësia, smira dhe dyfyturësia, si arrin t'i durosh?!”²²⁸



Një pjesë e gjynaheve të fshehta, prej të cilave duhet të ruhet një rob besimtar që kërkon kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, janë:

227. Attar, Tezkiretu'l-Evlja, fq. 629.

228. - Harakani, Nuru'l-Ulum, fq. 239.

• Mburra, Mendjemadhësia:

Të mburresh dhe të jesh mendjemadh, do të thotë të pëlqesh veten, të vetëkonsiderohesh më lart se të tjerët dhe t'i përçmosh ata . Këto dy vese të këqija, të pandashme nga njëra-tjetra, janë shkaktare të problemeve në dynja dhe të dënimit në Ahiret.

Ata që përçmojnë vëllezërit e fesë, do të pësojnë disfatë të madhe në Ahiret, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Njeriut i mjafton si gjynah përçmimi i vëllait të tij mysliman!” (Muslim, Birr, 32)

Ndërsa ajetet fisnike shprehen kështu në lidhje me cilësitë e këqija si “mburra” dhe “mendjemadhësia”, të cilat janë pengesë për hyrjen në Xhenet:

تِلْكَ الدَّارُ الْآخِرَةُ نَجْعَلُهَا لِلَّذِينَ لَا يُرِيدُونَ عُلُوًّا فِي الْأَرْضِ
وَلَا فَسَادًا وَالْعَاقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ

“Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhësi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat.” (Kasas, 83)

وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلَا تَمْشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا
إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ

“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburra-cakët!” (Lukman, 18)

قِيلَ ادْخُلُوا أَبْوَابَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا فَبِئْسَ مَثْوَى الْمُتَكَبِّرِينَ

“Atyre u thuhet: «Hyni në portat e Xhehenemit, ku do të qëndroni gjithmonë!» Sa vend i shëmtuar që është ai për mendjemëdhenjtë!” (Zumer, 72)



Njëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Nuk hyn në Xhehenem askush që në zemrën e tij ka besim qoftë edhe sa një kokërr hardalli. (Po ashtu) Nuk hyn në Xhenet askush që në zemrën e tij ka mendjemadhësi qoftë edhe sa një kokërr hardalli!” (Muslim, Iman, 148-149)

Pas kësaj deklarate profetike, e cila thekson qartë se sa i çmuar është besimi në zemër për arritjen e lumturisë së përjetshme, dhe përkundër kësaj, se sa katastrofë fatale është për Ahiretin mendjemadhësia që helmatis shpirtin njerëzor, një prej sahabëve fisnikë pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Njeriut i pëlqen të ketë rroba dhe këpucë të bukura.”

Ndërsa Profeti ﷺ, duke sqaruar se kjo nuk është mendjemadhësi, tha:

“Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Ndërsa mendjemadhësi është mohimi dhe mosnjohja e meritës (duke ia atribuar vetes, mirësitë që të ka falur Allahu) dhe përçmimi i njerëzve.” (Muslim, Iman, 147; Tirmidhi, Birr, 61)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, është shprehur se njerëzit zemërgurë, të pacipë, koprracë dhe ata që ecin duke u mburrur, do të jenë prej banorëve të Xhehenemit²²⁹. Madje, ai thotë edhe se:

“Ditën e Kiametit, Allahu nuk ka për t’ia parë fytyrën atij që tërheq zvarrë rrobën e tij duke u mburrur.” (Buhari, Libas, 1; Muslim, Libas, 42)



Historia e mburrjes dhe mendjemadhësisë, që fillon që prej Iblisit për të gjithë botën, është si një ekspozitë e përfundimeve mësimdhënëse të shumë mendjelehtëve si nemrudët, faraonët, karunët dhe ebu xhehlët. Në Kuranin Fisnik, Iblisi na jepet si përfaqësuesi i parë i mendjemadhësisë, i cili ngriti krye ndaj urdhrit të Allahut: **“Bëji sexhde Ademit!”**²³⁰, dhe kjo mendjemadhësi e çoi në mohim. Lidhur me këtë sjellje të Iblisit:

قَالَ يَا إِبْلِيسُ مَا مَنَعَكَ أَنْ تَسْجُدَ لِمَا خَلَقْتُ بِإِيْدِي

أَسْتَكْبَرْتَ أَمْ كُنْتَ مِنَ الْعَالِينَ

229. shih. Buhari, Tefsir 68/1, Ejman, 9; Muslim, Xhenet, 46, 47.

230. shih. Bekare, 34.



“Zoti tha: «O Iblis, ç’ të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me duart e Mia? A mos u bërë mendjemadh apo mendon se je nga të lartët?»” (Sad, 75)

Në këtë mënyrë bëhet e ditur se shkelja e urdhrit hyjnor nga ana e Iblisit, pra mosrënia në sexhde, realisht nuk buronte nga ndonjë superioritet i tij, por vetëm prej iluzionit të tij për madhësinë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe Nemrudi tregoi mendjemadhësi përballë “kautës monoteiste” të Ibrahimit ﴿٢٤٥﴾ dhe e teproi aq shumë sa tha:

“Unë i shpall luftë Zotit të qiejve që thotë Ibrahim!”

Duke treguar mendjemadhësi dhe duke u mburrur përballë njerëzve që e rrethonin, ai nuk tregoi fuqinë dhe madhësitinë, por përkundrazi, mendjelehtësinë dhe mjerimin e tij.

Po ashtu, edhe Faraoni tregoi aq shumë mendjelehtësi, sa i tha vezirit të tij Hamanit:

“Më ndërto një kullë të lartë me tulla të pjekura, që të kërkoj atë Zotin e Musait!”

Edhe Ebu Xhehli dhe të tjerët si ai, e mohuan profecinë e të Dërguarit të Allahut ﴿٢٤٥﴾, për shkak të egos së tyre, edhe pse në fakt me logjikë e pranonin. Për shkak të krenarisë së tepërt, ata nuk pranuan të qëndronin në anën e besimtarëve, të cilët në atë kohë ishin shumica njerëz të varfër dhe skllëvër. Kjo i bëri ata të këmbëngulnin me një inat prej budallai dhe të binin në gropën e mendjemadhësisë, aq sa të thoshin:

لَوْلَا نُزِّلَ هَذَا الْقُرْآنُ عَلَى رَجُلٍ مِّنَ الْقَرَبَاتَيْنِ عَظِيمٍ...

“Sikur t’i kishte zbritur ky Kuran ndonjë njeriu të madh prej njërit nga këto dy qytete!” (Zuhruf, 31)

Këta idhujtarë, në vend që ta prisnin me falënderim dhe mirënjohje ftesën e lumturisë së përjetshme të Profetit ﴿٢٤٥﴾, dhe lajmet e tij në lidhje me të ardhmen, për fat të keq, për shkak të mendjemadhësisë së tyre, e pritën me një inat të fortë, me një negativitet të turpshëm, me tallje, me ofendime dhe me shqetësim të madh. Në një hadith fisnik thuhet:

“Ai që mburret vazhdimisht, futet në kategorinë e njerëzve mizorë dhe i jepet dënimi i mizorëve.” (Tirmidhi, Birr, 61/2000)



• Smira:

Smira, në një farë kuptimi, është kundërshtim me zemër i ndarjes që ka bërë Allahu, duke u bërë ziliqar ndaj mirësive që u janë dhënë të tjerëve. Për shembull, Karunit, edhe pse i ishin dhënë dije shpirtërore, pësoi humbjen e përjetshme për shkak se tregoi smirë ndaj Harunit عليه السلام. Allahu i madhëruar urdhëron:

أَمْ يَحْسُدُونَ النَّاسَ عَلَىٰ مَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ...

“A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga të mirat e Veta?..” (Nisa, 54)

Shenja e parë, që tregon ekzistencën e sëmundjes së smirës tek njeriu, është dëshira për zhdukjen e mirësisë së dikujt dhe ndjesia e qetësisë dhe gëzimit që e kaplon kur sheh se ajo mirësi është zhdukur.



I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, na paralajmëron ne, ummetin e tij, ndaj sëmundjes së smirës duke thënë:

“Ruhuni nga smira, sepse ajo i shkrumbon të mirat siç i shkrumbon zjarri drutë (apo barin)!” (Ebu Daud, Edeb, 44/4903)

“Juve ju ka prekur sëmundja e popujve të shkuar: smira dhe urrejtja. Kjo është rruajtëse! Dhe nuk po them se rruan flokët, por fenë!..” (Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 57)

“Mos mbani mëri, mos kini zili, mos ia ktheni shpinën dhe mos i ndërprisni marrëdhëniet me njëri-tjetrin. O robërit e Zotit, bëhuni vëllezër me njëri-tjetrin!” (Buhari, Edeb, 57)

Smirëziu përpëlitet mes ndjenjave të ulëta si urrejtja, zemërimi, tradhëtia, hakmarrja, hilja, turpërimi dhe përbaltja e personit që e ka smirë. Në këtë mënyrë, ai e çon dëm jetën e tij të përkohshme me iluzione dhe supozime të dëmshme, duke e helmuar edhe jetën e tij shpirtërore.

• Zemërimi:

Zemërimi, që është një nga faktorët më të rëndësishëm që prish ekulibrin dhe maturinë, në të njëjtën kohë është edhe tregues i dobësisë dhe

paaftësisë së njeriut. Ai përcaktohet si dobësim i pjesshëm i ekuilibrit mendor, sepse lidhet me mbivendosjen e zemërimit ndaj mendimit. Për rrjedhojë, shumica e vrasjeve dhe padrejtësive kanë burim zemërimit. Kapitulli i zemërimit në librin e jetës, përbën historinë e katastrofës.

Zemërimi është me të vërtetë një nga dobësitë më të rëndësishme njerëzore, që ia lehtëson ndjeshëm punën shejtanit. Kur njeriu zemërohet, shejtani luan me të ashtu siç luan një fëmijë me top.

Njeriu më i mençur është ai që arrin ta kontrollojë zemërimin e tij, sepse zemërimi është armiku më i madh i mendjes. Prandaj edhe është thënë:

“Kur zemërimi vjen erren sytë, kur ikën skuqet fytyra!”

Kur njeriu i fryhet deti i zemërimit, ai e humb vetëkontrollin. Lidhur me besimtarët që arrijnë ta ruajnë veten gjatë zemërimit, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Trim i vërtetë, nuk është ai që mposht kundërshtarin, por ai që mposht zemërimin kur nxeht!” (Buhari, Edeb, 76)

Njëherë Ebu Derda i tha të Dërguarit të Allahut:

“Më mëso diçka që do të më çojë në Xhenet!”

Profeti ﷺ, i tha:

“Mos u zemëro!” (Buhari, Edeb, 76; Tirmidhi, Birr, 73)

Ndërsa Allahu i Madhëruar shprehet kështu në lidhje me robërit e devotshëm, të cilët e mposhtin zemërimin e tyre për hir të kënaqësisë hyjnore:

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ
عَنِ النَّاسِ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

“Ata të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit!” (Al-i Imran, 134)

Këtu duhet të theksojmë faktin që zemërimi është një cilësi e keqe kur buron nga egoja, por nëse shfaqet për hir të Allahut, ai kthehet në virtut. Aq sa është e rëndësishme që zemërimi të mposhtet për të fituar kënaqësinë e Allahut, aq e rëndësishme është edhe të zemërohesh për hir të Allahut aty ku është e nevojshme.

• Syefaqësia:

Syefaqësia, e cila nënkupton dyfytirësinë, dëshirën për t'u dukur dhe shtirjen, është një cilësi e shëmtuar që i fshin shpërblimet e veprave. Feja Islame, kurrë nuk dëshiron t'i shohë myslimanët të sillen si dyfytirësh dhe pa sinqeritet. Për rrjedhojë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë!” (Bejjine, 5)

Ndërsa në një tjetër ajet fisnik, Zoti ynë i Madhëruar deklaroi se mirësitë që bëhen me qëllim për t'u dukur dhe për t'ia treguar njëri-tjetrit, do të çohen dëm për hiçgjë:

“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebes, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.” (Bekare, 264)

Nuk duhet harruar se besimi monoteist nuk e toleron ortakërinë. Njëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, ka nënvizuar se:

“Ajo që kam më shumë frikë për ju, është shirku i vogël.” Sahabët e pyetën:

“Çfarë është shirku i vogël o i Dërguari i Allahut?”

Profeti ﷺ, tha:

“Syefaqësia! Pra dëshira për t'u dukur. Ditën e Kiametit, kur njerëzit janë duke marrë shpërblimin e punëve, Allahu i Madhëruar u drejtohet dyfytirëshve dhe u thotë:

«Shkoni kërkoni shpërblimin tuaj prej atyre, për të cilët keni punuar në dynja! Të shohim a do të gjeni ndonjë shpërblim tek ata?» (Ahmed, V, 428, 429)



Dyftyrësia dhe syfaqësia, në punët që duhen bërë për hir të Allahut, janë sjellje jashtëzakonisht të rrezikshme, që mund ta çojnë njeriun deri në shirk. Ebu Hurejre رضي الله عنه, transmeton se Profeti صلى الله عليه وسلم ka dhënë sqarim për fundin e personave, të cilët e kanë humbur sinqeritetin në adhurime dhe kanë vënë në plan të parë egoizmin dhe dëshirat e tyre të ulëta:

“Ditën e Kiametit, personi i parë që do të japë llogari, do të jetë dësh-mori (shehidi, martiri). Ai do të sillet para Zotit, i Cili do t’i kujtojë dhuntitë që i ka dhënë. Dëshmorit do t’i kujtohen dhe do t’i pohojë. Atëherë Allahu do ta pyes:

«Mirë, por çfarë bërë në këmbim të këtyre?»

«Luftova në rrugën tënde gjersa rashë dëshmor në rrugën Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti luftove që njerëzit të të përmendin për hero dhe ashtu ndodhi!»

Pastaj jepet urdhër dhe ai person hidhet me fytyrë në Xhehenem. Pas tij, para Allahut sillet një person që ka marrë dituri, që u ka dhënë mësim të tjerëve dhe ka kënduar Kuran. Allahu i kujton atij dhuntitë që i ka dhënë dhe i dituri i kujton e i pohon ato. Më pas Allahu e pyet:

«Mirë, por çfarë bërë në këmbim të këtyre të mirave?»

«Mësova dituri, ua mësova edhe të tjerëve dhe këndova Kuran për kënaqësinë Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti mësove dituri që të thonë për ty se sa i ditur je, dhe këndo-ve Kuran që të thonë se sa bukur këndon. Dhe, të gjitha këto u thanë!»

Edhe për të jepet urdhër, dhe ai hidhet me fytyrë në Xhehenem. Pastaj sillet një person të cilit Allahu i kishte dhënë çdo mundësi materiale dhe pasuri. Allahu ia kujton dhuntitë dhe ai i kujton e i pohon. Më pas Allahu e pyet:

«Mirë, por çfarë bërë në këmbim të këtyre të mirave që të janë dhënë?»

«Nuk u kurseva të jap nga pasuria në të gjitha ato vende që ti i pëlqen, dhe shpenzova vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti i bërë të gjitha këto që të thonë se sa bujar je!». Dhe, kjo u tha!»

Edhe për të jepet urdhër, dhe ai hidhet me fytyrë në Xhehenem.”

(Muslim, Imare, 152)

• Koprracia:

Koprracia është cilësi e robrit, i cili ia dedikon vetëm vetes të gjitha mirësitë që Allahu i Madhëruar i ka falur. Në një ajet fisnik urdhërohet:

قُلْ لَوْ أَنْتُمْ تَمْلِكُونَ خَزَائِنَ رَحْمَةِ رَبِّي
إِذَا لَأَمْسَكْتُمْ خَشْيَةَ الْإِنْفَاقِ وَكَانَ الْإِنْسَانُ قَوْتُورًا

“Thuaj: «Sikur ju të zotëronit thesaret e mëshirës së Zotit tim, edhe atëherë ju do të rruhdnit dorën nga droja, se do të shpenzoheni. Njëmend, njeriu rëndom është koprrac!»” (Isra, 100)

Mirëpo, Allahu i Madhëruar dëshiron që robërit e Tij të mos jenë as koprracë dhe as shpërdorues. Për këtë arsye, Ai urdhëron:

وَلَا تَجْعَلْ يَدَكَ مَغْلُولَةً إِلَىٰ عُنُقِكَ وَلَا تَبْسُطْهَا
كُلَّ الْبَسْطِ فَتَقْعُدَ مَلُومًا مَّحْسُورًا

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë!” (Isra, 29)



I Dërguari i Allahut ﷺ, në hadithet e tij ka thënë:

“Dy cilësi nuk mund të gjenden kurrë tek një besimtar i vërtetë: koprracia dhe morali e shëmtuar!” (Tirmidhi, Birr, 41/1962)

“Ruhuni nga ushtrimi i padrejtësisë dhe dhunës, sepse ditën e Kiametit padrejtësia dhe dhuna kanë për t’u bërë errësirë e zezë sterrë për mizorin! Ruhuni edhe nga koprracia, sepse koprracia i ka shkatërruar popujt që kanë jetuar para jush, aq sa të vrasin njëri-tjetrin padrejtësisht dhe t’i konsiderojnë haramet si hallall!” (Muslim, Birr, 56)

“Nuk ka ditë që të mos zbresin nga qielli dy melekë, e njëri prej tyre të mos lutet:

«O Allah! Jepi pasuri çdokujt që shpenzon (për kënaqësinë Tënde)!»
Ndërsa tjetri lutet:

«O Allah! Shkatërroja pasurinë çdokujt që është koprrac!»” (Buhari, Zekat, 27)



Ndërsa Allahu i Madhëruar, lidhur me fundin e hidhur që do të ketë çdo koprrac që e ka lidhur zemrën me pasurinë e kësaj bote dhe nuk shpenzon për hir të Tij, urdhëron:

الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ ﴿٢﴾ يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ ﴿٣﴾
 كَلَّا لِيُنَبِّدَنَّ فِي الْحُطَمَةِ ﴿٤﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ ﴿٥﴾
 نَارُ اللَّهِ الْمَوْقُودَةُ ﴿٦﴾ الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ ﴿٧﴾

“(Ai) që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.” (Humeze, 2-7)

Koprraci, do të thotë të mos strehohesh tek mirësia e Allahut por tek pasuria, dhe të pandehësh se pasuria do të të bëjë të përjetshëm. Sa bukur shprehet një prej të dashurve të Allahut:

“Mos kërko përjetësi prej dynjasë! Ajo nuk e ka për vete, që të të japë ty!”

Ata që i kalojnë ditët e kësaj bote të perkohshme, në mënyrë të pavetëdijshme, duke iu dhënë lakmisë për të mbledhur pasuri, ditën kur të hyjnë në varr, në duar nuk do të gjejnë asgjë tjetër përveçse dhe. Pasuria e dynjasë, do të mbetet përsëri në dynja, ndërsa njeriu do të përballet me llogarinë e rëndë të pasurisë që ka mbledhur.



Njëherë, gjatë një hutbeje, i Dërguari i Allahut ﷺ, iu drejtua sahabëve dhe u tha:

“...Banorët e Xhenetit janë tre kategori:

- Njerëzit e pushtetshëm dhe të drejtë që dhurojnë dhe janë të su - sesshëm.
- Njerëzit shpirtbutë dhe të mëshirshëm ndaj të afërmve dhe mysl - manëve.
- Myslimanët e virtytshëm, të cilët, megjithëse kanë familje të madhe, ruhen nga fitimi haram dhe nuk lypin gjë nga të tjerët.



Ndërsa banorët e Xhehenemit janë pesë kategori:

● Njerëzit me vullnet të dobët, që nuk arrijnë ta përdorin mendjen për ta ruajtur veten prej gabimeve. Këta qëndrojnë natyrshëm midis jush dhe nuk përpiqen as për të krijuar familje dhe as për të fituar pasuri.

● Ata që nuk e shfaqin lakminë, por që tradhëtojnë në çdo derë që trokasin.

● Ata që të mashtrojnë në lidhje me pasurinë dhe familjen tënde mëngjes e mbrëmje, sa herë të kenë mundësi.

● Koprracët dhe gënjeshtarët.

● Njerëzit me moral të keq, që flasin fjalë të ashpra dhe të pista.”

Në vazhdim, i Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Allahu i Madhëruar më ka shpallur: “Tregohuni aq të përulur ndaj njëri-tjetrit, sa asnjë të mos e kalojë kufirin dhe t’i bëjë padrejtësi tjetrit!..”

(Muslim, Xhenet, 63-64)



Shejh Sadi paralajmëron ata që janë tepër të dhënë pas pasurisë së kësaj bote dhe tregohen koprracë:

“Mos pandeh se do të ngrihesh duke bërë para! Uji që nuk rrjedh, mban erë të keqe dhe thahet. Prandaj përpiqu të japësh e të rrjedhësh vazhdimisht! Ujin që rrjedh, e ndihmon qielli. Lëshon shi, dërgon përrenj dhe e bën det!”

Aftësia e vërtetë është ta bësh zemrën një det mëshire me bujari, sakrificë dhe altruizëm, dhe t’i kthesh mirësitë e falura nga Allahu i Madhëruar, në pasuri për Ahiretin. Pasuria më e mirë, është ajo që shkon në Ahiret para të zotit; ndërsa jeta më e mirë, është ajo që përdoret në rrugën e kënaqësisë së Allahut të Madhëruar.

I nderuari Es’ad Erbili ka thënë:

“Dihet se kur qiraxhinjtë transferohen nga një shtëpi në tjetrën, marrin me vete të gjitha plaçkat dhe nuk lënë pas asnjë prej sendeve që i duan. Prandaj, është shumë e çuditshme që njerëzit të mos marrin me vete qoftë edhe një pjesë të sendeve që i duan, kur shkojnë në shtëpinë e varrit (duke i çuar përpara vetes në botën tjetër me anë të dhurimit).” (Mektubat, fq. 16, nr. 5)



• **Shpërdorimi:**

Shpërdorimi është një demonstrim force, e cila bëhet për të shtypur ndjenjën e inferioritetit. Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik urdhëron:

وَلَا تُسْرِفُوا ۚ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ

“...Dhe mos shpërdoroni, (sepse) Allahu nuk i do ata që shpërdorjnë!” (En'am, 141)

إِنَّ الْمُبَدِّرِينَ كَانُوا إِخْوَانَ الشَّيَاطِينِ...

“Me të vërtetë dorëshpuarit janë vëllezërit e shejtanit!...” (Isra, 27)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar ua ka bërë haram (ndaluar) mosbindjen ndaj prindërve, mosdhënien e detyrimeve (zekatin, borxhin), kërkimin e gjërave që nuk ju takojnë dhe varrosjen e vajzave për së gjalli (urasjen e vajzave)! Po ashtu, Ai i ka bërë të urryera thashethemet, pyetjet e shumta dhe shpërdorimin e pasurisë!” (Buhari, Istikradh, 19, Edeb, 6)

Të shpërdorosh pasurinë, do të thotë ta shpenzosh atë larg kënaqësisë së Allahut të Madhëruar. Pasuria është një mirësi që i siguron njeriut nevojat bazike për të jetuar dhe një jetë të qetë, pa nevojën për t'i shtrirë dorën askujt. Mirëpo, ata që e shpërdorjnë atë, shumë shpejt do fillojnë t'i shtrijnë dorën të tjerëve. E arsyeshme dhe e drejtë, është që pasuria të shpenzohet në rrugën e Allahut, duke e bërë atë kapital të Ahiretit. Njeriu mund ta shpenzojë pasurinë e tij ashtu siç dëshiron, duke filluar nga ndihma prej më të afërmeve. Ky lloj shpenzimi është hallall. Ndërsa shpenzimi i pasurisë në vendet e ndaluara nga feja, është haram.

Gjithashtu, ka edhe shpenzime të pëlqyeshme të cilat bëhen për dëshirat personale. Megjithëse ato mund të ndryshojnë sipas gjendjes dhe mundësive të njerëzve, në përgjithësi nuk konsiderohen shpërdorime. Kriter matës në këtë çështje, përbëjnë edhe zakonet dhe traditat. Pra, ndërkohë që për një person shumë të pasur shpenzimet për disa dëshira të lejueshme konsiderohen të pranueshme, për një person me të ardhura mesatare, shpenzime të tilla mund të konsiderohen shpërdorime.

Ky ajet fisnik, vendos kriterin e duhur në lidhje me shpenzimin e pasurisë:



وَالَّذِينَ إِذَا أَنْفَقُوا لَمْ يُسْرِفُوا وَلَمْ يَقْتُرُوا وَكَانَ بَيْنَ ذَلِكَ قَوَامًا

“(Robërit e mirë të Allahut janë edhe) **ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.**” (Furkan, 67)

Shkurtimisht, shpërdorimi dhe koprracia janë vese të këqija, që i kanë rrënjët në Xhehenem.

• Hetimi i të metave:

Hetimi i të metave dhe gabimeve të të tjerëve, është një sjellje e shëmtuar që buron prej mendimit negativ për të tjerët.

Allahu i Madhëruar, i Cili është “Settaru’l-Ujub / Mbulues i të metave”, e dënon ashpër hetimin e të metave dhe gabimeve personale të të tjerëve dhe ekspozimin e tyre në publik. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

لَا يُحِبُّ اللَّهُ الْجَهْرَ بِالسُّوءِ مِنَ الْقَوْلِ إِلَّا مَنْ ظَلَمَ
وَكَانَ اللَّهُ سَمِيعًا عَلِيمًا

“**Allahu nuk do që të thuhet hapur fjalë të këqija, përveçse nga të dëmtuarit. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.**” (Nisa, 148)

Hetimi dhe ekspozimi në publik i të këqijave dhe veprave të shëmtuara e të fshehta të të tjerëve, mund të bëhet shkas që ato të përhapen në shoqëri si një sëmundje ngjitëse. Pra, publikimi dhe përhapja e tyre, përbën një rrezik edhe më të madh për moralin e shoqërisë.

Megjithatë, hetimi i të metave për të cilin bëhet fjalë këtu, më tepër ka të bëjë me zbulimin e çfarëdolloj gabimi apo të fshehte të ndonjë myslimani dhe publikimin me qëllim të keq. Kjo është një vepër e ndaluar rreptësisht, si nga Kurani, ashtu edhe nga Sunneti. Allahu i Madhëruar urdhëron:

...وَلَا تَجَسَّسُوا...

“**...Mos e spiunoni njëri-tjetrin!..**” (Huxhurat, 12)


Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Nëse tenton të ndjekësh dhe të hetosh të metat dhe gjendjet e fshehta

të myslimanëve, do të dëmtosh moralin e tyre, ose do të ndikosh negativisht tek ata!” (Ebu Daud, Edeb, 37)

“...Kush përgjon bisedën e disa njerëzve pa pëlqimin e tyre, Ditën e Gjykimit do t’i derdhet plumb i shkrirë në veshë!..” (Buhari, Tabir, 45)



Hetimi i të metave, është një cilësi që nuk përputhet aspak me të drejtat e vëllazërisë fetare. Kur Ibn-i Mes’udit , iu soll një person, për të cilin thanë:

“Ky është filani dhe prej mjekrës së tij pikonte verë!”, ai iu kthye:

“Neve na është ndaluar të hetojmë gabimet dhe të metat. Por nëse ky gabim del vetvetiu në pah, atëherë ne do të veprojmë siç e kërkon rasti.”
(shih. Ebu Daud, Edeb, 37/4890)



Sekretari i Ukbe ibn Amrit  tregon:

Njëherë i thash Ukbes:


“Vura re se disa prej fqinjëve të mi konsumonin alkool. Them t’i thërras zabitët e t’i kapin!” Por ai më tha:

“Mos vepro direkt! Në fillim këshilloji dhe paralajmëroji!”

Unë ndoqa këshillën e Ukbe-s, por ata nuk hoqën dorë. Prandaj shkova përsëri tek Ukbe dhe i thashë:

“Unë i këshillova, por ata nuk hoqën dorë. Tani do të thërras zabitët!”

Mirëpo, Ukbe më tha:

“Turp të kesh! Mos vepro ashtu! Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, , të thotë:

« Të mbulosh një të metë apo gabim të një besimtar, është njësoj si të nxjerrësh nga varri një vajzë të varrosur për së gjalli dhe ta shpëtosh atë!»

(Ahmed, IV, 153)



• Gënjeshtra:

Gënjeshtra është një nga të metat kryesore që e çojnë njeriu në Xhehenem.

I Dërguari i Allahut, ﷺ, ka thënë:

“Kush ia merr të drejtën një myslimani duke u betuar rrejshëm, Allahu ia bën haram Xhenetin dhe të detyruar Xhehenemin!” Dikush pyeti:

“Edhe në qoftë se është gjë e vogël, o i Dërguar i Allahut?” Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Qoftë edhe një shkop prej pemës Erak (misvak)!” dhe këtë e përsëriti tre herë. (Muslim, Iman, 218; Muuatta, Akdije, 11)

Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Besnikëria e çon njeriun në mirësi, ndërsa mirësia në Xhenet. Nëse njeriu thot gjithmonë të drejtën, në fund bëhet prej besnikëve. Gënjeshtra e çon njeriun në gjynah, ndërsa gjynahu në Xhehenem. Nëse njeriu thot gjithmonë gënjeshtër, si përfundim, ai shkruhet si gënjeshtar tek Allahu.” (Buhari, Edeb, 69)

Gënjeshtra është katastrofë e gjuhës. Gjuha luan rolin e zëdhënësit të zemrës, e cila ndikon në të gjitha organet dhe veprat e njeriut. Ai që arrin ta ruajë gjuhën nga gënjeshtër, shpëton prej përfundimit të keq, i cili na bëhet i ditur në hadithet profetike.



Allahu i Madhëruar urdhëron:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٧٠﴾
يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ...

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet!..”

(Ahzab, 70-71)

Përveç kësaj, besimtari nuk duhet të harrojë se çdo fjalë e nxjerrë nga goja regjistrohët nga melekët. Për këtë arsye, ai duhet të ruhet me shumë kuj-



des nga fjalët e rreme. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

مَا يَلْفُظُ مِنْ قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ

“Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” (Kaf, 18)



I Dërguari i Allahut ﷺ, shprehet se gënjeshttrat e çojnë njeriun drejt një përfundimi të keq në Ahiret:

“Kush shtiret sikur ka parë një ëndërr, të cilën në të vërtetë nuk e ka parë, do t’i kërkohet të lidhë nyje dy kokrra elbi, gjë të cilën ai nuk do të jetë në gjendje ta bëjë kurrë...”

Atij që krijon figura frymorësh, do t’i kërkohet që t’ua fryjë shpirtin atyre (Ditën e Llogarisë), gjë të cilën nuk do të jetë kurrë në gjendje ta bëjë.” (Buhari, Tabir, 45)

• Përgojimi:

Përgojimi është e folura pas shpinës së një myslimanit tjetër në lidhje me të metat, të cilat po t’i dëgjonte i zoti, do të mërzhitej ose do të turpërohej. Allahu i Madhëruar e çmon aq shumë nderin dhe ndjenjën e birit të njeriut, sa që e ka deklaruar si krim të rëndë, në aspektin fetar, përfoljen e të metave në mungesë të personit dhe cënimin e nderit të tij. Ky fakt, tregon qartë se Zoti ynë, mëshira e të Cilit e mbizotëron zemërimin e Tij, i mbron edhe robërit gjynahqarë dhe me të meta.

Shkaku i ndalimit të përgojimit, nuk mbështetet vetëm në dëshirën e Allahut të Madhëruar për të mbrojtur edhe të drejtën e një robit të Tij gjynahqar. Një shkak tjetër është edhe roli që luan përgojimi në shkatërrimin e paqes dhe qetësisë së jetës shoqërore dhe të ndjenjave vëllazërore.

Përgojimi është një nga gjynahet e mëdha që prish vëllazërinë Islame, përmbys rregullin shoqëror dhe përhap urrejtjen dhe armiqësinë, duke asgjësuar shpirtin e bashkimit dhe unitetit. Por, pavarësisht kësaj, shumë njerëz e mashtrojnë veten me mendimin se fjalët e tyre janë të vërteta. Mirëpo, në fakt ky quhet përgojim, pra përfolja e një të mete që në të vërtetë ekziston. Ndërsa përfolja e një të mete që nuk ekziston, quhet shpifje. Për rrjedhojë,



duke e anashkaluar këtë, njeriu që përgojon ngushëllohet me faktin se fjalët e tij janë të vërteta dhe vazhdon ta mbrojë gabimin që bën, gjë e cila është tregues i indiferencës së tij, dhe ia shton edhe më shumë gjynahun.

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“A e dini se ç’është përgojimi?” Sahabët e nderuar thanë:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë.” Profeti ynë shpjegoi:

“Përgojim, është ta përkujtosh vëllain e fesë me një gjë të cilën ai nuk e pëlqen.”

Dikush pyeti:

“Po nëse ajo e metë që them gjendet vërtet tek vëllai im?” Profeti ﷺ, tha:

“Nëse është e vërtetë, ky është përgojim; e nëse jo, ke bërë shpifje.”

(Muslim, Birr, 70; Ebu Davud, Edeb, 40/4874)



Ndërsa Allahu i Madhëruar, na urdhëron që të ruhemi me shumë kujdes nga gjynahu i përgojimit, që përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të robit:

وَلَا يُعْتَبُ بَعْضُكُمْ بَعْضًا أَيُّحِبُّ أَحَدُكُمْ أَنْ يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا
فَكَرَهُتُمُوهُ وَأَتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ رَحِيمٌ

“...Mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë!” (Huxhurat, 12)

Krahasimi i përgojimit me shprehjen “**të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur**”, në këtë ajet, tregon se sa gjynah i madh është ai. Në fakt, mishi i njeriut konsiderohet haram dhe cofëtinë, edhe po të jetë i gjallë. Por mendimi që mund të hash mishin e vëllait tënd të vdekur, tregon se sa degjenerim të madh ka pësuar mendja, zemra dhe morali.

Përgojimi është një shkelje e rëndë e të drejtave të robit. Për rrjedhojë,



kush e përgojon një vëlla të fesë, duhet të shkojë e t'i kërkojë hallallëk dhe të pohojë hapur veprën e vet, duke detajuar fjalët që ka thënë dhe emrat e personave që e kanë dëgjuar. Po ashtu, nëse përgojimi që ka bërë, ka shkaktuar ndonjë fitne (ngatërresë), ai duhet të kërkojë shumë falje prej Allahut, duhet të japë sadaka dhe duhet të pendohet tek Allahu i Madhëruar me përgjërim.

Përgojimi është një shkelje e rëndë e të drejtave të robit, e cila është shumë e vështirë të kompensohet. Prandaj, rruga më e mirë, është t'i dalësh zot gjuhës dhe të mos e përziesh atë me një gjynah të tillë.



Allahu i Madhëruar, ashtu siç e ka ndaluar përgojimin, e ka ndaluar edhe dëgjimin e tij, sepse heshtja përballë përgojimit dhe dëgjimi i tij, nënkupton pjesëmarrje në këtë gjynah. Tregohet se një ditë, kur i nderuari Abdullah Dehlevi ishte agjërueshëm, dikush foli keq për sultanin. Abdullahu tha:

“Obobo, na u prish agjërimi!” Një nxënës i tij tha:

“Zotëri, po ju nuk përgojuat!” Mirëpo, Abdullahu tha:

“Po, ne nuk përgojuam, por dëgjuam. Gjatë përgojimit, edhe ai që flet, edhe ai që dëgjon janë të njëjtë.”²³¹

Allahu i Madhëruar na bën të ditur se besimtarët e vërtetë janë larg këtyre lloj cilësive të shëmtuara:

وَإِذَا سَمِعُوا اللَّغْوَ أَعْرَضُوا عَنْهُ...

“Kur dëgjojnë ndonjë llomotitje, i shmangen asaj!..” (Kasas, 55)

وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ

“(Ata) të cilët shmangen nga fjalët e kota.” (Mu'minun, 3)

Sepse besimtari zotëron vetëdijen e përgjegjësisë. Ai e di se do të pyetet për çdo mirësi dhe mundësi që i është falur, dhe se do të japë llogari për sjelljen që bën. Prandaj, Allahu i Madhëruar na lajmëron ne, robërit e Tij në këtë mënyrë:

وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ
كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا

“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”

(Isra, 36)



Ndërsa i Dërguari i Allahut, lidhur me ruajtjen nga përgojimi, na ka paralajmëruar kështu:

“O ju të cilët besuat me gjuhë, por që besimi ende nuk ka zënë vend plotësisht në zemrat tuaja! Mos i përgojoni myslimanët dhe mos hetoni të metat dhe gabimet e tyre! Atyre që hetojnë të metat dhe gabimet e myslimanëve, edhe Allahu do t’ua hetojë të metat dhe gabimet. Kujt ia heton Allahu të metat dhe gabimet, e poshtëron atë qoftë edhe brenda shtëpisë së tij.” (Ebu Daud, Edeb, 35/4880; Tirmidhi, Birr, 85/2932; Ibn-i Kethir, Tefsir, IV, 229)

“Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, ose të flasë mirë, ose të heshtë!” (Buhari, Edeb, 31)

“Shpëtoi ai që e ruajti gjuhën!” (Tirmidhi, Kiamet, 50; Darimi, Rikak, 5)

“Atij që e ruan një besimtar nga një munafik (dyfytirësh), ditën e Kiametit, Allahu do t’ia ruajë mishin nga zjarri i Xhehenemit, duke dërguar një melek. Por atë që shpif, duke dëshiruar që të flitet keq për një mysliman, ditën e Kiametit, Allahu e mban të burgosur në një nga urat që ndodhen mbi zjarrin e Xhehenemit, deri sa të shlyhet ajo që ka thënë.” (Ebu Davud, Edeb, 36/4883)

Shkurtimisht, përgojimi është tregues i nënshtimit ndaj egos, ndjenjave të këqija në zemër dhe moralit të prishur; një sëmundje shpirtërore që e shkatërron edhe jetën e kësaj bote, edhe atë të botës tjetër.

Megjithatë, për fat të keq, një pjesë e madhe e njerëzve bien në këtë gjynah shumë lehtë dhe pa e vrarë mendjen, sikur të ishin duke dëgjuar ndonjë melodi të ëmbël. Madje e kthejnë në diçka të zakonshme. Zoti ynë na e bëftë të mundur të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe vigjilentë ndaj të gjithë këtyre haremeve dhe të ngjashme me këto, qofshin ato të hapura apo të fshehta.

Ata që shpëtojnë prej Xhehenemit

Ata që kanë njolla të gjynaheve, edhe pse kanë gëzuar mirësinë e besimit, për një farë kohe do të mbahen në Xhehenem për t'u pastruar. Këta persona do të shpëtojnë prej Xhehenemit dhe do të futen në Xhenet, ose me faljen e Allahut dhe me ndërmjetësim, ose pasi t'u ketë mbaruar dënimi. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“...Kur besimtarët shpëtojnë prej Xhehenemit, ata i përgjérohen me këmbëngulje Allahut të Madhëruar edhe për shpëtimin e vëllezërve të tyre të fesë, të cilët kanë mbetur aty, duke u lutur me zë të lartë. Beto hem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën time, se askush prej jush nuk lufton me aq forcë për të marrë prej borxhliut plotësisht atë që i ka dhënë, sa luftojnë besimtarët ditën e Kiametit, duke iu përgjëruar Allahut, me qëllim që të shpëtojnë vëllezërit e tyre në Xhehenem. Ata përgjérohen me këmbëngulje:

«O Zoti ynë! (Vëllezërit tanë që mbetën në Xhehenem) Agjëronin me ne, falnin namaz me ne dhe bënë haxh me ne!» Pas kësaj, atyre u thuhet:

«Ejani nxirrni ata që njihni! Që këtej e tutje, fytyrat e tyre janë haram për Xhehenemin.» Më pas, ata nxjerrin nga Xhehenemi shumë njerëz, disa prej të cilëve kanë qenë të zhytur në zjarr deri në gjysmë të kofshëve, e disa të tjerë deri në gjunjë. Më pas thonë:

«O Zoti ynë! Në Xhehenem nuk mbeti më asnjë prej atyre që na urdhërove të nxjerrim.»

(Mirëpo, Allahu i Madhëruar) do të urdhërojë:

«Kthehuni dhe nxirrni këdo që në zemrën e tij gjendet qoftë edhe një mirësi që peshon sa dinari!» Për rrjedhojë, ata nxjerrin nga Xhehenemi edhe shumë të tjerë. Më pas thonë përsëri:

«O Zoti ynë! Në Xhehenem nuk mbeti më asnjë prej atyre që na urdhërove të nxjerrim.»

Allahu i Madhëruar do të urdhërojë:

«Kthehuni pas dhe nxirrni këdo që në zemrën e tij ka mirësi qoftë edhe sa një gjysmë dinari!» Përsëri, ata do të nxjerrin shumë të tjerë. Më pas thonë:

«O Zoti ynë! Në Xhehenem nuk mbeti më asnjë prej atyre që na urdhërove të nxjerrim.»



Kësaj here, Allahu i Madhëruar do të urdhërojë:

«Kthehuni pas dhe nxirrni këdo që në zemrën e tij ka qoftë edhe një grimcë mirësie!»

Edhe kësaj here nxjerrin shumë njerëz prej zjarrit. Më pas thonë:

«O Zot! Ne nuk lamë asnjë mirësi (njeri që ka pasur qoftë edhe një grimcë mirësi) në Xhehenem.»²³²»

Ebu Said el-Hudriu رضي الله عنه, që e transmeton këtë hadith, kur arrin në këtë pikë, thotë:

“Nëse nuk më besoni në lidhje me këtë hadith, atëherë lexoni ajetin e Allahu të Madhëruar:

«Vërtet, Allahu nuk dëmton askënd asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën mirësi, Allahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërbllim të madh.»²³²»

Në vijim të këtij hadithi, i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, sqaron:

“Pasi besimtarët thonë se nuk kanë lënë asnjë mirësi në Xhehenem, Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Edhe melekët, edhe profetët, edhe besimtarët ndërmjetësuan. Tashmë, përveç Erhamu’r-Rahimin-it / Mëshiruesit të mëshiruesve, nuk ka mbetur askush tjetër për të ndërmjetësuar.» Pas kësaj, Ai merr prej Xhehenemit një grusht njerëzish, që (përveç besimit) nuk kanë bërë asnjë vepër të mirë, dhe që janë kthyer thuajse në qymyr. Pastaj i hedh ata në një lum që quhet «Lumi i Jetës», i cili ndodhet në rrugën e Xhenetit. Ata dalin prej atij lumi si bari që mbin tek dheu që sjell përroi.

A nuk e keni parë barin që mbin prej mbeturinave të përroit?! Ai mbin edhe nën gur, edhe nën pemë. Pjesa që e rreh dielli zverdhet dhe gjelbërohet, ndërsa pjesa që gjendet nën hije, mbetet e bardhë.”

Pas këtyre fjalëve të fundit, sahabët e nderuar thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Mesa duket ju keni qenë bari në shkretëtirë?!”

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, vazhdoi:

232. Nisa, 40.

“Tani, ata dalin prej Lumit të Jetës me gjerdane perlash në qafat e tyre. Banorët e Xhenetit i njohin ata (prej këtyre shenjave) dhe u thonë:

«Ja, këta janë ata të cilët Allahu i vendosi në Xhenet pa bërë asnjë vepër të mirë dhe pa ofruar (pa dhënë në këmbim) asnjë mirësi. Këta janë ata që ka liruar Allahu!»

Më pas, Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Hyni në Xhenet! Çdo gjë që shihni aty është e juaja!» Ata thonë:

«O Zoti ynë! Na ke dhënë mirësi, të cilat nuk ia ke dhënë askujt në këtë botë!» Dhe e falënderojnë Allahun e Madhëruar. Ndërsa Allahu urdhëron:

«Për ju kam një mirësi edhe më të madhe se kjo!» Banorët e Xhenetit thonë:

«O Zoti ynë! E çfarë mund të jetë më e madhe se kjo?» Allahu i Madhëruar urdhëron:

«Pëlqimi Im!.. Prej sot e tutje, nuk do të zemërohem më me ju!» (Muslim, Iman, 302)



Nuk duhet harruar se feja është një e tërë dhe rregullon çdo fushë të jetës. Për rrjedhojë, nuk është e mundur që herë të jetohet (zbatohet), e herë të braktiset. Ajo nuk duhet të neglizhohet në asnjë çast të jetës. Përndryshe, kjo e metë e robit në fe, i shkruhet atij si gjynah dhe, «Allahu na ruajttë!- nëse nuk arrihet falja e Allahut, apo leja e Tij për ndërmjetësim, i zoti i asaj mangësie do të vuajë dënimin e tij në zjarr. Xhehenemi, siç shprehet edhe në një ajet fisnik: “...është vendbanimi më i keq!”²³³

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, na përshkruan gjendjen e besimtarit të fundit që do të dali nga Xhehenemi dhe do të shkojë në Xhenet:

“...Më në fund, pasi Allahu i Madhëruar të ketë vendosur në lidhje me çështjet midis robërve, do të urdhërojë melekët që të nxjerrin prej zjarrit ata që patën adhuruar vetëm Atë.

Kështu, melekët do t'i nxjerrin ata që do t'i njohin nga shenjat e sexh-

des, sepse Allahu ia ka ndaluar zjarrit të Xhehenemit përpirjen e shenjave të sexhdes²³⁴.

Domethënë, ata do të nxirren prej zjarrit sterrë të zinj, vetëm si skelet, pastaj do t'u hidhet "Uji i Jetës", i cili do t'i bëjë të përtërihen e të rriten, si fara që rritet në anë të ujit që rrjedh. Ndërkohë, një person i mbetur me fytyrë të kthyer nga zjarri do të thotë:

«O Zoti im! Ma largo fytyrën nga zjarri, sepse më helmon era e tij dhe më djeg nxehtësia e tij.» Ai lutet aq shumë në këtë mënyrë, sa më në fund, Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

«Nëse ta plotësoj këtë kërkesë, ti do të kërkosh diçka tjetër!» Ai do të thotë:

«Jo! Beto hem në Fuqinë dhe Madhërinë Tënde se nuk do të kërkoj asgjë tjetër prej Teje!» Atëherë Allahu do t'ia largojë atij fytyrën nga Zjarri. Por, kur të kthehet dhe të shohë Xhenetin me bukuritë e tij, do të rrijë i heshtur sa të dojë Allahu, pastaj do të thotë:

«O Zoti im! Më afro tek dera e Xhenetit!» Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

«A nuk më premtove se nuk do të duash gjë tjetër veç asaj që kërkove herën e parë? Turp të kesh o biri i Ademit! Sa besëthyer dhe shkelës premtimi qenke!» Robi do t'i lutet shumë e do t'i thotë:

«O Zoti im! Mos më lër të jem më i mjeri nga krijesat e Tua!» Më në fund, Allahu do t'i thotë:

«Nëse ta plotësoj këtë kërkesë, ti do të kërkosh diçka tjetër!» Ai do të thotë:

«Jo! Beto hem në Fuqinë dhe Madhërinë Tënde se nuk do të kërkoj asgjë tjetër prej Teje!» Më pas do t'i japë Zotit fjalën dhe besën e tij. Në këtë mënyrë, Allahu do ta lejojë të afrohet te porta e Xhenetit. Kur arrin atje dhe sheh bukuritë dhe kënaqësitë e Xhenetit, hesht për aq kohë sa dëshiron Allahu dhe pastaj thotë:

«O Zoti im! Më vendos brenda në Xhenet!» Allahu do t'i thotë:

«A nuk më premtove se nuk do të duash gjë tjetër veç asaj që kërkove

234. Pjesët e trupit që prekin tokën kur biem me fytyrë përtokë në sexhde

më parë? Turp të kesh o biri i Ademit! Sa besëthyer dhe shkelës premtimi qenke!» Ai do të thotë:

«O Zoti im! Mos më bëj mua më të mjerin e krijesave të Tual!» Dhe vazhdon të lutet kështu pa u lodhur e pa u mërzhitur. Pas kësaj, Allahu do të qeshë dhe do ta lejojë atë të hyjë në Xhenet. Kur ai të hyjë në Xhenet, Allahu do t'i thotë të kërkojë ç'të dojë dhe sa të dojë. Ai do të vazhdojë të kërkojë derisa t'i plotësohen të gjitha dëshirat, pastaj Allahu do t'i thotë:

«Kërko më shumë prej këtyre dhe atyre gjërave!» Kështu, Zoti do t'i kujtojë atij shumë e shumë gjëra derisa t'i plotësohen të gjitha dëshirat. Më pas Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

«E gjithë kjo dhe një herë aq, janë të tuat!»...»

Ebu Hurejra ﴿﴾ ka thënë:

“Ky person do të jetë njeriu i fundit që do të hyjnë në Xhenet!” (Buhari, Rikak, 52)



Sipas një transmetimi tjetër, besimtarët që do të hyjnë në Xhehenem për shkak të gjynaheve dhe gabimeve të tyre, pasi ta vuajnë dënimin për një farë kohe, Allahu i Madhëruar do t'u japë një lloj vdekjeje, me qëllim që të mos vuajnë shumë. Kur të digjen e të bëhen si qymyr dhe pasi të qëndrojnë ashtu të burgosur për aq kohë sa do Allahu, do të nxirren prej atje me ndërmjetësim. Pas kësaj do të hidhen në lumenjtë e Xhenetit dhe do t'u jepet përsëri jetë.²³⁵





PJESA VIII

Xheneti

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit!..” (Teube, 111)

Ndërsa Aliu ﷺ ka thënë:

“Jetët (dhe pasuria) tuaja nuk mund të çmohen përveçse me Xhenet. Prandaj, jetën (dhe pasurinë) tuaj shiteni vetëm në këmbim të Xhenetit!”

XHENETI

Xheneti është manifestimi i mëshirës, mirësisë dhe bujarisë së paku-fishme të Allahut të Madhëruar. Ai është krijuar dhe tashmë ekziston.²³⁶ Xheneti është një gostitje hyjnore e përjetshme, e mbushur me mirësi dhe bukuri, që e tejkalojnë mendjen dhe imagjinatën tonë. Ai do t'i falet atyre që kanë bërë një jetë me devotshmëri të lartë në rrugën e ndritur të Kuranit dhe Sunnetit, në fund të frymëmarrjeve të përkohshme që konsumohen në këtë dynja, e cila është vend sprovash.

I Dërguari i Allahut ﷺ, në një hadith fisnik, na ka bërë të ditur se ditën e Kiametit, vdekjes do t'i jepet fund dhe ata që do të hyjnë në Xhenet dhe në Xhehenem, do të qëndrojnë aty përjetë:

“Ditën e Kiametit vdekja do të sillet si një dash me pulla dhe do të mbahet midis Xhenetit dhe Xhehenemit. Më pas pyetet:

«O banorët e Xhenetit! A e njihni këtë?» Ata zgjasin kokat, e shohin dhe thonë:

«Po, kjo është vdekja!» Më pas pyetet prap:

«O banorët e Xhehenemit! A e njihni këtë?» Edhe këta zgjasin kokat, e shohin dhe thonë:

«Po, kjo është vdekja!» Pas kësaj, jepet urdhër dhe vdekja (në formë dashi) theret. Pastaj thirret (në mënyrë që të dëgjojnë banorët e Xhenetit dhe Xhehenemit):

«O banorët e Xhenetit! Tashmë nuk ka më vdekje dhe ju jeni të përjetshëm! O banorët e Xhehenemit! Tashmë nuk ka më vdekje dhe ju jeni të përjetshëm!»

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, këndoi ajetin:

“Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur

236. shih. Buhari, Bed'u'l-Halk, 8.



do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë!”²³⁷

E ndërkohë që këndonte këtë ajet, i Dërguari i Allahut ﷺ, me dorën e tij të bekuar bënte me shenjë për këtë botë. (Muslim, Xhennet, 40)



Kur të njoftohen në lidhje me përjetësinë, banorëve të Xhenetit do t’u shtohet gëzimi dhe hareja, ndërsa banorëve të Xhehenemit do t’u shtohet edhe më tepër hidhërimi dhe mërzia.²³⁸ Lidhur me këtë, Profeti ﷺ, ka thënë:

“...Dashi shtrihet dhe theret. Nëse Allahu i Madhëruar nuk do të kishte vendosur që banorët e Xhenetit të jetonin (përjetësisht), ata do të vdisnin nga forca e gëzimit dhe lumturisë. Po ashtu, nëse nuk do të kishte vendosur që edhe banorët e Xhehenemit të qëndronin aty përjetë, edhe ata do të vdisnin nga hidhërimi.” (Tirmidhi, Tefsir, 19/3156)

“Nëse dikush do të vdiste prej gëzimit, do të vdisnin banorët e Xhenetit. Po ashtu, nëse dikush do të vdiste prej hidhërimit, padyshim se do të vdisnin banorët e Xhehenemit.” (Tirmidhi, Xhennet, 20/2558)

Shkaku i vetëm i një niveli kaq të lartë e të paimagjinueshëm të gëzimit dhe hidhërimit, është përjetësia, pra pafundësia e tyre. A mund të jetë e barabartë gjendja e dikujt që lajmërohet se do të jetë përgjithmonë i lumtur dhe në paqe, me gjendjen e atij që lajmërohet se do të dënohet e do të vuajë përgjithmonë? Njëri ka shpëtuar plotësisht prej çdolloj frike dhe hidhërimi dhe gjendet në siguri, paqe dhe lumturi të përjetshme, ndërsa tjetri ka rënë në një dënim të përjetshëm dhe nuk ka asnjë fije shprese për të shpëtuar! Nëse do të kishte qoftë edhe pak shpresë, ai nuk do të mbytej nga një hidhërim kaq i madh.



Hyrja e besimtarëve në Xhenet, realizohet në sajë të mirësisë dhe bujarisë së Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë, njëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

237. Merjem, 39.

238. shih. Buhari, Rikak, 51; Muslim, Xhennet, 40, 43; Tirmidhi, Zuhd, 39, Xhennet, 20, Tefsir, 19; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 38; Ahmed, II, 118, 121, 261; III, 9.



“...Ta dini se askush nuk do të shpëtojë në sajë të punëve të tij.”

Sahabët e pranishëm, pyetën me habi:

“As ju nuk mund të shpëtoni, o i Dërguar i Allahut?” Profeti , u përgjigj:

“As unë nuk mund të shpëtoj, përveçse, nëse Allahu më fal me mëshirën dhe bujarinë e Tij!.. Nëse nuk më mbështjell mirësia, mëshira dhe falja e Tij, as unë nuk mund të hyj në Xhenet! Veprat e mia nuk mund të më shpëtojnë!..” (Buhari, Rikak, 18; Muslim, Munafikin, 71-72)²³⁹

Pra pavarësisht se mund të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi në adhurime, bindje ndaj Allahut, shërbim ndaj fesë dhe vepra të mira me të cilat fitohet kënaqësia e Allahut, ne nuk duhet të mbështetemi tek këto, por duhet të strehohemi gjithmonë tek mëshira dhe bujaria e Allahut. Kjo është edukata e devotshmërisë për të cilën kemi nevojë të gjithë.

Nga ana tjetër, me lejen e Allahut, disa prej gradave në Xhenet do të arrihen sipas veprave dhe besimit të çdokujt.



Ata që në këtë botë e konsumojnë jetën si robër të egos së tyre, të zhytur në mendjemadhësi, mburrje e degjenerim; duke rendur si të çmendur pas dëshirave të ulëta pa ndjerë asnjë lloj shqetësimi për llogarinë që do të japin, në botën tjetër do të zhyten në frikë dhe hidhërim. Ndërsa ata që në këtë botë ruhen me kujdes të madh nga haramet dhe jetojnë në rrugë të drejtë, duke pasur frikë nga ndëshkimi i Allahut, në botën tjetër do të jenë të sigurt nga çdo lloj frike dhe do të arrijnë paqen e përfundimtare.

Në Kuranin Fisnik, lajmërohet:

“Ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.” (Naziat, 40-41)

“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!” (Rahman, 46)

“(Banorët e Xhenetit do t’i thonë njëri-tjetrit):

239. shih. Ibn-i Maxhe, Zuhd, 20; Darimi, Rikak, 24.



«Më parë, Ne kemi pasur frikë në familjet tona (nga gjykimi i Allahut), por, Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përvëluese (e Zjarrit). Ne qysh më parë i jemi falur Atij. Ai është vërtet Bamirës dhe Mëshirëplotë!» (Tur, 26-28)

Po ashtu, në Kuranin Fisnik, na bëhet e ditur se Allahu i Madhëruar do të mundësojë që banorët e Xhenetit të mos ndjejnë kurrë mërzi dhe lodhje:

“Pastaj do të thonë: «Lavdi Allahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtetë, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues. Është Ai që me mirësinë e Tij na ka pranuar në shtëpinë e banimit të përhershëm, në të cilën nuk do të lodhemi e nuk do të raskapi-temi.»” (Fatir, 34-35)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, në një hadith fisnik ka thënë:

“Në Xhenet do të hyjnë disa njerëz, zemrat e të cilëve janë si zemra e zogut (të mbështetura dhe të dorëzuara plotësisht tek Allahut)” (Muslim, Xhenet, 27)

Pra, Xheneti është vendi ku do të shkojnë besimtarët zemërbutë, të cilët kanë frikë nga humbja e kënaqësisë së Allahut dhe meritimi i dënimit të Tij, të cilët ruhen me kujdes nga gjynahet, qëndrojnë larg nga lëndimi i njerëzve dhe mbështeten ashtu siç duhet tek Allahu i Madhëruar.

Gjerësia dhe bukuria e Xhenetit

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik urdhëron kështu në lidhje me gjerësinë e Xhenetit:

وَسَارِعُوا إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَاوَاتُ
وَالْأَرْضُ أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit!” (Al-i Imran, 133)²⁴⁰

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me këtë ka thënë:

“Xheneti ka njëqind gradë dhe ndërmjet çdo grade distanca është njëqind vjet.” (Tirmidhi, Xhenet, 4/2529)

“(Në Xhenet) Ata që ndodhen poshtë, do t’i shohin ata që ndodhen në gradat e larta, ashtu siç e shihni ju lindjen e një ylli në horizontin e qiellit. Ebu Bekri dhe Omeri janë prej tyre, madje edhe më të lartë!” (Tirmidhi, Menakib, 14/3658; Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 11; Ahmed, III, 26, 98)²⁴¹

“Banorët e Xhenetit, do t’i shohin banorët e pallateve sipër tyre, ashtu siç shohin një yll që shkëlqen larg nga lindja a nga perëndimi. Kjo për shkak të epërsisë që kanë ndaj njëri-tjetrit në shpërblim.”

Kur dëgjuan këtë, sahabët thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Padyshim se këto janë vendbanime të larta për profetët. Sepse ato s’mund t’i arrijë askush tjetër përveç tyre!”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Jo! Për Atë, në Duart e të Cilit është jeta ime! Ato janë vendet e nje-rëzve që besuan në Allahun dhe të dërguarit e Tij.” (Buhari, Bed’ul-Halk, 8, Rikak, 51; Muslim, Xhennet, 11)



Ndërsa lidhur me bukuritë e Xhenetit, në hadithet fisnike na jepen këto të dhëna:

Ndërtesat e Xhenetit janë me tulla prej ari dhe argjendi. Ato janë ndër-tuar me material që ka aromën e fortë të miskut, me guralecë prej perlave dhe jakutëve. Ndërsa toka mbi të cilën janë ndërtuar, është prej shafrani. Trungjet e pemëve të Xhenetit janë prej ari.²⁴² Madje, “në Xhenet ndodhet një pemë e tillë, të cilën një kalorës i stërvitur nuk mund ta përshkojë as për njëqind vjet, nga njëri cep në tjetrin.”²⁴³

Po ashtu, ka xhenete të atillë, ku enët e ushqimeve dhe çdo gjë bre-nda tyre, janë prej argjendi. Ka edhe xhenete të atillë, ku enët dhe çdo gjë brenda tyre janë prej ari.²⁴⁴

241. shih. Buhari, Rikak, 51; Muslim, Xhennet, 10.

242. shih. Tirmidhi, Xhennet, 1/2525.

243. shih. Buhari, Rikak, 51, Bed’u’l-Halk, 8, Tefsir 56/1; Muslim, Xhennet, 6-8; Tirmidhi, Xhennet, 1/2524.

244. shih. Tirmidhi, Xhennet, 2/2528.



Mirësitë e Xhenetit

Në Kuranin Fisnik gjenden shumë ajete që përshkruajnë mirësitë e Xhenetit. Ja disa prej tyre:

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre t’u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë:

«Këtë e kemi ngrënë edhe përpara!»

Por atyre do t’u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të Tokës. Në Xhenet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë.” (Bekare, 25)

“Vërtet, punëmirët do të jenë në kopshtet e Xhenetit pranë burimeve. Atyre do t’u thuhet:

«Hyni atje me paqe dhe siguri!»

Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane. Aty nuk do t’i mundojë lodhja e prej aty kurrë nuk do të dëbohen.” (Hixhr, 45-48)

“Pikërisht atyre u përket Xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur!” (Kehf, 31)



Besimtarët që hyjnë në Xhenet, do ta harrojnë frikën dhe hidhërimin, dhe nuk do të përballen më kurrë me to. Allahu i Madhëruar, përveçse i bën të sigurt prej çdolloj frike, u jep atyre edhe shumë mirësi e kënaqësi që janë përtej çdo imagjinate. Lidhur me këto, në Kuranin Fisnik lajmërohet:

“(Allahu do t’u thotë): «O robërit e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni. Ju që keni besuar shpalljet Tona dhe keni qenë myslimanë, hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja, ku do t’ju shërbehet me pjata dhe gota prej ari. Aty do të ketë çfarë t’ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë. Ja, ky është Xheneti që ju



është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë. Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani.» (Zuhruf, 68-73)

“Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim dhe, për durimin e tyre, Ai do t’i shpërblejë me Xhenet dhe petka të mëndafshta. Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë. Hija e pemëve të tij (Xhenetit) është afër mbi kokat e tyre, ndërsa frutat e tyre do t’i kenë afër sa t’i arrijnë me dorë.

Aty do t’u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali, kupa të tejdukshme argjendi, madhësinë e të cilave (do ta zgjedhin) sipas dëshirës. Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil, prej një burimi të quajtur Selsebil. Atyre do t’u shërbejnë djem përherë të rinj, që, kur i shikon, të duken si margaritarë të shpërndarë.

Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumturi dhe një mbretëri të madhe. Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzlykë të argjendte. Zoti i tyre do t’u japë të pinë pije të pastër.” (Insan, 11-21)



Në Xhenet do të ketë edhe vila transparente, ku pjesa e jashtme do të shihet nga brenda dhe pjesa e brendshme do të shihet nga jashtë. Në një hadith thuhet se këto: *“U takojnë njerëzve gojëmbël që flasin bukur, që të gostitin, agjërojnë dhe natën kur të gjithë flenë, falin namaz për Allahun!”* (Tirmidhi, Xhenet, 3/2527, Birr, 53/1984)

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Çadra (që i jepet besimtarit në Xhenet)²⁴⁵ është (një saraj) shumë e gjerë dhe e punuar me perla të shpuara. Lartësia e saj drejt qiellit është tridhjetë (ose gjashtëdhjetë) milje. Në çdo cep të kësaj çadre gjendet nga një familje për besimtarin. Dhe ato nuk e shohin njëra-tjetrën!” (Buhari, Bed’u’l-Halk, 8, Tefsir, 55/2; Muslim, Xhenet, 23-25)



245. shih. Rrahman, 72.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Banorët e Xhenetit hanë e pinë, por nuk pështyjnë asnjëherë, nuk kryejnë as nevojat personale dhe nuk kanë sekrecione nga hundët!”²⁴⁶

Sahabët me habi pyetën:

“Po atëherë si do të dalin ushqimet që hanë?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Ata do të nxjerrin vetëm një gromësirë me aromë të këndshme dhe një djersë që mban era misk. Njeriu ka për ta madhëruar dhe falënderuar Allahun e madhëruar, ashtu siç merr frymë vetvetiu.” (Muslim, xhenet, 18)²⁴⁷



Ata që do të hyjnë në Xhenet, do të gjejnë gjithmonë rehati e paqe midis të mirave dhe nuk do të hasin kurrë vështirësi dhe vuajtje. Sytë e banorëve të Xhenetit do të jenë të lyer dhe trupat e tyre do të jenë të pastër nga qimet. Ata do të jenë jashtëzakonisht të bukur dhe të pashëm. Ndërsa mosha e tyre do të jetë 30 ose 33 vjeç.²⁴⁸

Në Xhenet nuk do të ketë lodhje dhe humbje fuqie. Po ashtu, Xheneti është një vend aq i pastër, sa nuk do të ketë as pluhur. Në trupin e njeriut, për shembull në hundë dhe veshë, nuk do të ketë asnjë papastërti. Askush nuk do të ketë huqe dhe vese. Nuk do të ketë fjalë të kota dhe të këqija. Të gjithë do ta duan njëri-tjetrin dhe do të dëshirojnë të shohin fytyrat e vëllezërve të tyre.


I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:



“Fytyrat e të parëve që do të hyjnë në Xhenet do të shkëlqejnë si hënë e plotë. Ndërsa fytyrat e atyre që do të hyjnë pas tyre, do të shkëlqejnë si ylli më i shndritshëm në qiell. Aty, njerëzit nuk do të kryejnë as nevojat personale, as do të pështyjnë, e as do të kenë sekrecione nga hundët. Krehrat e tyre do të jenë prej ari dhe djersa e tyre do të mbajë era misk. Aromat e që lëshojnë temjanicat e tyre, janë prej pemëve me aromë të këndshme të

246. shih. Bekare, 25; Al-i Imran, 15; Nisa, 57.

247. shih. Buhari, Bed'u'l-Halk, 8, Enbija, 1.

248. shih. Tirmidhi, Xhennet, 12/2545.


Xhenetit. Bashkëshortet e tyre (banorëve të Xhenetit) janë hyritë. Të gjithë banorët e Xhenetit janë krijuar në formën e babait të tyre Ademit , dhe lartësia e trupave të tyre është gjashtëdhjetë parakrahë.” (Buhari, Enbija, 1, Bed’u’l-Halk, 8; Muslim, Xhenet, 14-19)²⁴⁹

Siç na bëhet e ditur edhe në hadithet fisnike, banorët e Xhenetit do të kenë formën e Ademit . Pra, do t’i ngjajnë atij në lartësi, bukuri dhe përsosmëri fizike. Trupi i tij ka qenë gjashtëdhjetë parakrah. Në fakt, që prej asaj kohe, njerëzit kanë ardhur duke e humbur përsosmërinë fizike të Ademit , në çdo aspekt, sidomos në masë, në jetëgjatësi dhe bukuri. Mirëpo, në Xhenet, të gjithë njerëzit do të jenë njësoj me trup.²⁵⁰

Në një hadith tjetër fisnik, sqarohet se:

“...Enët (e banorëve të Xhenetit) do të jenë prej floriri... Secili do të ketë dy bashkëshorte²⁵¹, palca e kockës së këmbëve të të cilave do të shihet nëpërmjet mishit, nga bukuria e jashtëzakonshme që kanë.²⁵² Ata (banorët e Xhenetit) nuk do të kenë as mosmarrëveshje, as urrejtje e as armiqësi mes tyre; zemrat e tyre do të jenë si një e vetme (në ndjenja) dhe do të laudërojnë Allahun në mëngjes e mbrëmje.” (Buhari, Bed’u’l-Halk, 8, Enbija, 1; Muslim, Xhenet, 14, 17)

Nisur nga këto transmetime, nuk duhet menduar se mirësitë që do t’u jepen grave janë më të pakta nga ato të burrave. Në fakt, burrat dhe gratë do të jenë të barabartë në mirësitë që do të gëzojnë. Mirëpo, në disa çështje, do të ketë disa ndryshime në përputhje me natyrën e secilit. Për rrjedhojë, gratë e devotshme që do të hyjnë në Xhenet, do të jenë shumë më të bukura se ç’kanë qenë në jetën e dynjasë, do të jenë të pastra në çdo aspekt dhe do të gëzojnë mirësitë më të larta. Madje, mendohet se gratë besimtare që do të hyjnë në Xhenet, do të jenë më superiore se hyritë e Xhenetit në çdo aspekt.

Gjithashtu, me shprehjen: *“Xheneti është nën këmbët e nënave!”²⁵³*, i Dërguari i Allahut , e ka ngritur gruan në pozitën që ajo meriton. Në të njëjtën mënyrë, edhe ky hadith fisnik, tregon vlerën e lartë që i jepet gruas së devotshme në Islam:

249. shih. Tirmidhi, Kiamet, 60, Xhenet, 5; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 39.

250. shih. Buhari, Enbija, 1, Isti’dhan, 1; Muslim, Xhenet, 28.

251. Në Xhenet nuk do të kete asnjëri të pamartuar.

252. shih. Muslim, Xhenet, 14.

253. shih. Nesai, Xhihad, 6; Ahmed, III, 429; Sujuti, I, 125.



“Kjo botë është një mirësi. Kurse mirësia më e madhe e kësaj bote, është gruaja e devotshme” (Muslim, Rada, 64; Nesai, Nikah, 15; Ibn-i Maxhe, Nikah, 5)

“Nga bota juaj më janë bërë të dashura gruaja dhe aroma e mirë. Ndërsa namazi më është bërë drita e syrit tim!” (Nesai, Ishretu’-n-Nisa, 10; Ahmed, III, 128, 199)

Po ashtu, është me vend të theksohet se gruaja e cila ka bërë disa martesë në këtë botë, në Ahiret do të martohet me më të devotshmin e burrave të saj.



Mirësitë, me të cilat gostiten banorët e Xhenetit, nuk janë për t’ju larguar atyre ndonjë shqetësim, dhimbje apo vështirësi. Po ashtu, as ushqimet dhe pijet, nuk do të jenë për shkak të urisë apo etjes. Në të njëjtën mënyrë, as parfumet e këndshme nuk do të jenë për shkak të ndonjë arome të keqe. Këto janë vetëm mirësi dhe kënaqësi që ndjekin njëra-tjetrën. Allahu i Madhëruar sqaron:

“Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur dhe nuk do të kesh as etje, as vapë!” (TaHa, 118-119)²⁵⁴

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush hyn në Xhenet, do të jetë përjetësisht mes të mirave. Ai nuk do të hidhërohet aspak, nuk do të vuajë, nuk do t’i vjetrohen veshjet dhe nuk do t’i konsumohet rinia!” (Muslim, Xhennet, 22)

“Një lajmëtar do të thërrasë:

«Ju do të jeni përgjithmonë të shëndetshëm në Xhenet dhe nuk do të sëmureni kurrë! Do të jetoni përgjithmonë dhe nuk do të vdisni kurrë! Do të jeni gjithmonë të rinj dhe nuk do të plakeni kurrë! Do jetoni gjithmonë të lumtur mes të mirave dhe nuk do të hidhëroheni kurrë!» (Muslim, Xhennet, 22)

Ky fakt na bëhet i ditur edhe në këtë ajet fisnik:

“...një zë do t’i thërrasë: «Ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar!»”²⁵⁵ (Muslim, Xhennet, 22)²⁵⁶

254. shih. Kurtubi, Tedhkire, fq. 984.

255. A’raf, 43.

256. shih. Tirmdhi, Tesiretu’l-Kuran, 41.



Lumenjtë e Xhenetit

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut); një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehenemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t’u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!” (Muhamed, 15)

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Në Xhennet ka det uji, det mjalti, det qumështi dhe det vere, prej të cilëve do të gufojnë lumenj.” (Tirmidhi, Xhennet, 27/2571)

Mirëpo, vera e Xhenetit nuk ngjan aspak me verën e dynjasë. Lidhur me këtë, Allahut i Madhëruar shpjegon se:

“Aty do t’u shërbehet një gotë e mbushur nga një burimi i rrjedhshëm, (me pije) të bardhë e të shijshme për ata që do ta pinë. Prej saj as nuk do të trullosen dhe as nuk do të dehen. Pranë tyre do të jenë gra me shikim të ulur e sy të bukur sikur të ishin vezë të ruajtura mirë.” (Saffat, 45-49)



Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, u pyet:

“Çfarë është Keutheri?” Dhe ai u përgjigj:

“Ai është një lumë që Allahu i Madhëruar do të ma japë në Xhenet. Uji i tij është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti. Në breg të tij janë disa zogj me qafa si qafat e devesë.”

Omeri رضي الله عنه tha:

“Mesa duket, këto janë mirësi ushqyese dhe shumë të këndshme!”

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, sqaroi:

“Ata (banorët e Xhenetit) që i hanë ato, janë vetë më të bukur dhe më të këndshëm!” (Tirmidhi, Xhennet, 10/2542)



Madhështi dhe përsosmëri, përtej imagjinatës

I Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me madhësitinë dhe përsosmërinë e Xhenetit, e cila shkon përtej imagjinatës sonë, është shprehur:

“...Në Xhenet, një hapësirë sa harku i njërit prej jush, apo sa vendi ku vendosni këmbën tuaj, është më e mirë se dynjaja dhe çdo gjë që ka në të. Nëse një prej grave të Xhenetit do t’ia hidhte njëherë sytë tokës, hapësira midis tokës dhe qiellit do të ndriçohej dhe do të mbushej me aromën e miskut. Dhe padyshim se mbulesa e asaj gruaje, është më e mirë se dynjaja dhe çdo gjë që ka në të.” (Buhari, Rikak, 51)

“Nëse mbi dynja do të shfaqej qoftë edhe pak gjë, aq sa mund të mbajë thoi, prej mirësive të Xhenetit, të gjithë horizontet e qiejve dhe të tokës do të zbukuroheshin e stoliseshin. Nëse një prej banorëve të Xhenetit do t’i hidhte njëherë sytë nga toka dhe një prej byzylykëve të tij të shfaqej në dynja, do ta shuante dhe asgjësonte dritën e Diellit, ashtu siç shuan dhe asgjëson Dielli dritën e yjeve.” (Tirmidhi, Xhenet, 7/2538)

Enesi ؓ tregon:

“Të Dërguarit të Allahut ﷺ, iu dhurua një xhybe prej atllasi të hollë (nga Ukejdiri). I Dërguari i Allahut ﷺ, e kishte ndaluar mëndafshin për meshkujt. Prandaj, njerëzit u mahnitën me bukurinë dhe butësinë e kësaj rrobe dhe e pëlqyen shumë atë. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

«Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën e Muhamedit, se shamitë e Sa’d ibn Muadhrit në Xhenet, janë më të bukura se kjo!» (Buhari, Bed’u’l-Halk, 8, Menakibu’l-Ensar, 12)



Një person e pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ:

“A flenë banorët e Xhenetit?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, u përgjigj:

“Gjumi është vëllai i vdekjes, por banorët e Xhenetit nuk vdesin!” (Bejhaki, Shuab, VI, 409/4416; Hejthemi, X, 415)

Dihet se në kushtet e kësaj bote, para pasqyrës njerëzit përballen me një fytyrë që ndryshon çdo ditë dhe plaket vazhdimisht. Mirëpo, jeta në Xhenet do të zhvillohet plotësisht ndryshe nga kjo jetë. Atje njerëzit do të



zbukurohen nga dita në ditë.²⁵⁷ Profeti ﷺ, këtë të vërtetë na e ka bërë të ditur me këto fjalë:

“Në Xhenet, ndodhet një treg ku banorët e tij shkojnë çdo ditë xhumaje. Atje, një erë veriu ua fryn aromat e Xhenetit në fytyra dhe veshje, duke ua shtuar edhe më tepër bukurinë. Kur kthehen tek bashkëshortet e tyre, më të bukur e më të pashëm se më parë, familjet e tyre thonë:

«Vallahi juve ju është shtuar edhe më tepër bukuria pasi u larguat prej nesh!» Ndërsa ata pohojnë:

«Vallahi, edhe ju jeni bërë edhe më të bukur që pasi u larguam prej jush!» (Muslim, Xhennet, 13)

Ndërsa Shejh Mekinuddin Esmeri ka thënë:

“Në ëndërr pash një hyri, e cila më thoshte: «Unë jam e jotja, e ti je i imi!» E folura e saj ishte aq e ëmbël dhe e këndshme, saqë dy a tre muaj pas asaj dite, më vinte pështirë dhe villja kur dëgjoja të folurat e njerëzve.” (Ibn-i Ataullah el-Iskenderi, Taxhu'l-Arus, fq. 40)



Ndërsa lidhur me mirësitë që do t'i jepen njeriut të fundit që hyn në Xhenet, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Unë e njoh personin që do të dalë i fundit nga Xhehenemi dhe do të hyjë i fundit në Xhenet. Ky njeri do të dalë këmbadoras prej Xhehenemit dhe Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

«Shko, hyr në Xhenet!»

Ai do të shkojë në Xhenet, por Xheneti do të jetë aq i mbushur, saqë çdo njeri do të ketë vendin e tij dhe do të duket sikur nuk ka mbetur asnjë hapësirë. Ai do të kthehet dhe do të thotë:

«O Zoti im! Unë e gjeta Xhenetin të mbushur plot!»

Allahu i Madhëruar do t'i thotë sërish:

«Shko, hyr në Xhenet!»

257. shih. Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 35/34005. Krahaso. Muslim, Xhennet, 13.



Ai do të hyjë në Xhenet, por përsëri do ta gjejë të mbushur plot e përplot, e do të kthehet përsëri e do të thotë:

«O Zoti im! E gjeta Xhenetin të mbushur plot!» Kësaj here, Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

«Shko, hyr në Xhenet, vendi yt është sa e gjithë bota dhe dhjetë herë më i madh se ajo!» (Ose vendi yt është dhjetëfish sa bota) Mirëpo, njeriu do të pyes:

«(O Zot!) A po tallesh me mua, edhe pse je Sunduesi i vetëm!» (ose a mos po qesh me mua?)

Abdullah ibn Mesudi, që e transmeton këtë hadith thotë: “Për Zotin, Profeti ﷺ qeshi aq shumë, sa iu dukën dhe dhëmbët e fundit. Kurse ndër sahabët flitej se ky do të ishte njeriu me gradën më të ulët në Xhenet.” (Buhari, Rikak, 51)

Nga kjo, duket sikur çdo banor i Xhenetit do të jetë mbret në pronën e vet, sepse Allahu i Madhëruar, u ka dhuruar atyre shumëfish më tepër se prona dhe pasuria që kanë pasur mbretërit në dynja.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَإِذَا رَأَيْتَ ثَمَّ رَأَيْتَ نَعِيمًا وَمُلْكًا كَبِيرًا

“Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumturi dhe një mbretëri të madhe!” (Insan, 20)

Nëse edhe personit që do të jetë në gradën më të ulët të Xheneti, do t'i jepen kaq mirësi madhështore, vallë çfarë do t'u jepet atyre që janë në gradën më të lartë?! Sepse Xheneti ka gradë shumë të larta. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Xheneti ka njëqind shkallë, të cilat Allahu i ka përgatitur vetëm për ata që luftojnë për çështjen e Tij. Distanca nga njëra shkallë në tjetrën, është sa hapësira mes qiellit dhe tokës. Prandaj, kur të kërkoni prej Allahut (ndonjë gjë), kërkoni Firdeusin, sepse ai është mesi i Xhenetit dhe vendi më i lartë i tij!” (Buhari, Xhihad, 4, Teuhid, 22)



Shumë mirësi të tjera banorët e Xhenetit do t'i shohin atje për herë të parë. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar, ka urdhëruar: «(Në Xhenet) **Për robërit e Mi të devotshëm kam përgatitur mirësi të cilat nuk i ka parë asnjë sy, nuk i ka dëgjuar asnjë vesh dhe nuk i ka imagjinuar asnjë njeri!**»

«**Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata** (në jetën tjetër), **si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.**» (Sexhde, 17)” (Buhari, Bed’u’l-Halk, 8)

Sehl ibn Sa’di رضي الله عنه ka thënë:

“Një ditë, mora pjesë në një prej ligjëratave ku i Dërguari i Allahut ﷺ, e tregoi Xhenetin me detaje. Në fund të fjalimit ai tha:

«*Atje ka mirësi që nuk i ka parë asnjë sy, nuk i ka dëgjuar asnjë vesh dhe nuk i ka imagjinuar asnjë mendje njerëzore ndonjëherë!*» Më pas, ai këndoi këto ajete:

«**Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata** (në jetën tjetër), **si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.**» (Sexhde, 16-17)” (Muslim, Xhennet, 2-5)

Kurora e mirësive të Xhenetit: Kënaqësia Hyjnore

Për robërit fatlumë, që kapitalin e jetës së tyre të përbërë prej frymëmarrjeve të numëruara, e përdorin në rrugën e të vërtetave hyjnore dhe arrijnë lumturinë e përjetshme, do të ketë mirësi dhe gostitje të veçanta, ashtu siç i kanë hije madhësisë së Allahut. Ndërsa kurora e këtyre mirësive hyjnore, është **“kënaqësia dhe pëlqimi i Allahut të Madhëruar”**.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

قُلْ أُو۟سِب۟تُكُمْ بِخَيْرٍ مِّنۢ ذٰلِكُمْ ۚ لِّلَّذِينَ اتَّقَوْا۟ عِنۡدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي۟ مِنۡ تَحْتِهَا۟ الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَأَزۡوَاجٌ مُّطَهَّرَةٌ وَرِضۡوَانٌ مِّنَ اللّٰهِ ۗ وَاللّٰهُ بَصِيرٌۢ بِالْعِبَادِ

“**Thuaj** (o Muhamed!): **«A doni t’ju tregoj për gjëra më të mira se ato? Për ata që janë të devotshëm, te Zoti i tyre do të ketë Xhenete (kopshte), nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Aty do të kenë bashkëshorte të pastra dhe kënaqësinë (Riduanullah) e Allahut!»** **Allahu i vrojton robërit e Vet**” (Al-i Imran, 15)

Ndërsa të urtët kanë thënë:

“Shprehja «Xhenetet» që përdoret në këtë ajet, bën fjalë për Xhenetet me mirësi materiale. Ndërsa «Riduan»-i, pra kënaqësia e Allahut, është «Xheneti shpirtëror» dhe grada më e lartë...

Në gradën e parë, robi është i kënaqur me Allahun, ndërsa në gradën e fundit, Allahu është i kënaqur me robin e Tij. Në suren Fexhr, kjo e vërtetë na bëhet e ditur me këto fjalë: **«Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!»**²⁵⁸ (shih. Razi, Mefatihul-Gajb, [Al-i Imran, 15.]

Ndërsa në një ajet tjetër fisnik urdhërohet:

وَعَدَ اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ
خَالِدِينَ فِيهَا وَمَسَاكِنَ طَيِّبَةً فِي جَنَّاتِ عَدْنٍ وَرِضْوَانٌ مِّنَ اللَّهِ أَكْبَرُ
ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

“Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore.” (Teube, 72)

Kënaqësia e Allahut të Madhëruar, është mirësia më e madhe dhe më e çmuar ndër të gjitha ato të Xhenetit të Tij, sepse ajo është shtylla e çdo lumturie, nderi dhe madhështie. Kryerja me sinqeritet e detyrës së devotshmërisë ndaj Allahut në këtë botë, duke synuar kënaqësinë e Tij, është mënyra e vetme për të kërkuar mirësinë dhe lumturinë më të madhe që mund të arrihet.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu, i Lartësuari me Madhështi, do t’u thërrasë banorëve të Xhenetit:

«O banorët e Xhenetit!» E ata do t’i përgjigjen:

«Urdhëro, të përgjigjemi, o Zoti ynë!» Ai, me Madhërinë e Vet, do t'u thotë:

«A jeni të kënaqur?» Ata do të thonë:

«E si të mos jemi të kënaqur, kur Ti na ke dhuruar atë që nuk ia ke dhënë askujt tjetër nga krijesat e Tua?» Allahu i Madhëruar do t'u thotë:

«Unë do t'ju jap diçka edhe më të mirë se ato që ju kam dhënë deri tani!» Ata do t'i thonë:

«Zoti ynë! E ç'është më e mirë se kjo që kemi?» Allahu i Lartësuar do t'u thotë:

«Unë do të zbres mbi ju kënaqësinë Time dhe nuk do të zemërohem kurrë më me ju, këtej e tutje!» (Buhari, Rikak, 51, Teuhid, 38; Muslim, Xhennet, 9)²⁵⁹

Nga ky hadith fisnik, kuptohet se sa e madhe është dashuria dhe mëshira që Allahu i Madhëruar ndjen për robërit e Tij. Gjithashtu, kuptohet edhe se Allahu dëshiron që robërit e Tij, të cilëve u ka falur Xhenetin, të jetojnë aty të kënaqur dhe në paqe. Madje, vërehet se Allahu nuk dëshiron as që ata të ndihen në siklet e të mendojnë mos po bëjnë ndonjë gabim apo veprim që do ta mërzisë Zotin, ndërkohë që notojnë në mirësitë e pafundme të Xhenetit. Allahu i Madhëruar i pyet për gjendjen e tyre banorët e Xhenetit, të cilët jetojnë në mirësi të pashoqe që as mund të imagjinohen. Dhe pasi merr përgjigje, për të kurorëzuar lumturinë e tyre, i përgëzon ata me lajmin e kënaqësisë së Tij ndaj tyre dhe me njoftimin se tashmë nuk do të zemërohet më kurrë me ta.

Sa nder dhe sa fatmirësi e madhe është për një rob që nuk posedon asnjë lloj kapitali, të gëzojë të gjitha këto mirësi dhe lavdërime të Allahut të Madhëruar, i Cili është Krijuesi dhe Sunduesi i vetëm i gjithësisë!

Ismail Hakki Burseviu, -Allahu e mëshiroftë-, e shpreh kështu indiferencën e përgjithshme të njeriut në jetën e kësaj bote, kundrejt mirësive të pafundme që i ka falur Allahu i Madhëruar:

“Sa i madh është Allahu,
i Cili e bën të dëgjojë një copë delli si veshi,
e bën të shohë një copë dhjami si kokërdhoku i syrit
dhe e bën të flasë një copë mishi si gjuha...”

259. shih. Tirmidhi, Xhennet, 18.



Ai që i ka pajisur bimët me fruta e fara, kafshët me mish e me dhjam, tokën me pemë e lumenj dhe qiellin me yje dhe dritën e tyre...

Ai që e ka caktuar natën për të pushuar njerëzit dhe që dhuron aq sa dëshiron prej mirësive të panumërta të ditës!...

Megjithëse ti nuk arrin të bëhesh rob i Tij i merituar, Ai të trajton si të vetmin rob të Tij, të vlerëson dhe të furnizon materialisht dhe shpirtërisht. Ndërsa ti je aq indiferent ndaj adhurimit ndaj Tij, sikur të kishe ndonjë Zot tjetër (strehim, mbështetje) përveç Tij. (Sa injorancë e madhe dhe mosnjohje e vetes është kjo!)²⁶⁰

Ru'jetullah: Bajrami i shikimit të bukurisë së Allahu

Kulmi i mirësive hyjnore për një rob që ka gëzuar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, është Ru'jetullah-u, pra shikimi i Allahut të Madhëruar dhe soditja e bukurisë së Tij. Lidhur me këtë fakt, Allahu i Madhëruar urdhëron:

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاصِرَةٌ ﴿٢٢﴾ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ ﴿٢٣﴾

“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin!” (Kijame, 22-23)

Madje, lumturi dhe mirësi më të madhe se kjo, nuk do të ketë. Prandaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, na ka bërë të ditur se:

“Kur banorët e Xhenetit të hyjnë në aty, Allahu i Madhëruar do t'i pyesë:

«A ka ndonjë mirësi tjetër që dëshironi t'jua shtoj?» Ata do të thonë:

«O Zot! A nuk na e zbardhe faqen? A nuk na vendose në Xhenet dhe na shpëtove nga Xhehenemi (pra, çfarë të kërkojmë tjetër)?!»

Dhe pikërisht atëherë, Allahu i Madhëruar do të ngrejë perden (dhe ata do të shohin bukurinë e Tij). Atyre nuk i është dhënë asnjë mirësi më e dashur se sa shikimi i Zotit të tyre!” (Muslim, Iman, 297; Tirmidhi, Tefsiru'l-Kuran, 11)



Bejazid Bistami, e ka përkthyer me këto fjalë gjendjen e të dashuruarve pas Allahut:

“Janë disa robër të mirë të Allahut, që nëse i privon pakëz prej soditjes së bukurisë së Allahut në Xhenet, ata përgjërohen për të shpëtuar nga ky privim, ashtu siç i përgjërohen banorët e Xhenemit Allahut të Madhëruar për të shpëtuar nga dënimi.”²⁶¹

Ndërsa Ismail Hakki Bursevi, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:


“Ne kemi tre bajrame. I pari është Bajrami i Ramazanit (dhe i Kurbanit). Ky është bajrami i natyrës/egos njerëzore (ku sakrifikohen disa të mira materiale). I dyti, është Bajrami i vdekjes, me kusht që të shkosh me besim në botën tjetër. Ky është një Bajram i Madh. Bajrami i tretë dhe më i madhi, është arritja e shikimit të bukurisë së Allahut në Ahiret.”²⁶²



Shkurtimisht, çdo besimtar që dëshiron të nderohet me Xhenetin dhe me shikimin e Allahut të Madhëruar, duhet të përpiqet të jetojë me pasion dhe dashuri një jetë të devotshme në përputhje me Kuranin dhe Sunnetin. Imam Sharani, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“O vëllezërit e mi! Shtojini veprat e sinqerta dhe mirësitë duke menduar për mirësitë e Xhenetit që Allahu i Madhëruar tregon në Librin e Tij, sepse për çdo gjë që urdhëron feja, ka një shkallë me mirësi në Xhenet. Dhe ato mirësi, mund t'i arrijnë vetëm ata që i zbatojnë këto urdhra.”²⁶³

Është e domosdoshme që robi, në çdo fazë të jetës së tij, ta kërkojë me seriozitet Xhenetin, që është i mundur vetëm me arritjen e kënaqësisë së Allahut, dhe po me të njëjtën ndjesi të strehohet tek Allahu edhe prej Xhehenemit, që është manifestimi i zemërimit të Tij.

Omeri , ajetin fisnik: **“Ata që u kemi dhënë Librin dhe e lexojnë ashtu siç duhet lexuar, besojnë vërtet në të!..”**²⁶⁴ e ka komentuar në këtë mënyrë:

261. Ebu Nuajm, Hilje, X, 34; Kushejri, Risale, fq. 499.

262. Bursevi, Ruhu'l-Bejan, c. 2, sf. 200.

263. Imam Sharani, Vdekja, Kiameti dhe Ahireti, fq. 48.

264. Bekare, 121.



“Ata, të cilët kur lexojnë ajetet ku përmendet Xheneti, e kërkojnë atë prej Allahut; dhe kur lexojnë ajetet ku përmendet Xhehenemi, strehohen prej tij tek Allahu.” (Ibn-i Ebi Hatim, Tefsir, I, 218; Ali el-Muttaki, Kenz, II, 357/4230)

Allahu i Madhëruar na ruajttë të gjithëve prej Xhehenemit dhe na pranofte në Xhenetin e Tij më të lartë! Po ashtu, na bëftë edhe neve robërit e tij të mjerë, prej atyre njerëzve fatlumë, të cilët i ka nderuar me mirësitë më të përsosura dhe me bajramin e shikimit të bukurisë së Tij!

Amin!..

Dera që të çon në Xhenet: Farzet e hapura dhe të fshehta

Është detyrë e njeriut që të mos mashtrohet nga kjo botë, dhe të merret me përgatitjen për në botën tjetër, që është edhe jeta e vërtetë. Besimtari duhet t'i shtojë vazhdimisht adhurimet, bindjen e tij ndaj Allahut dhe çdolloj shërbimi dhe sakrifice në rrugën e Tij. Të gjitha demonstrimet e devotshmërisë që falin kënaqësinë e Allahut, në të njëjtën kohë janë viza për në Xhenet.

Njeriu është një qenie e përbërë prej dy elementeve: shpirtit dhe trupit. Për rrjedhojë, edhe veprat e njeriut ndahen në dy pjesë: materiale dhe shpirtërore, të hapëta dhe të fshehta. Në veprat që bëhen për hir të Allahut, këto dy elemente janë plotësues të njëri-tjetrit. Pra, nëse njëri nuk merr pjesë, edhe tjetri mbetet i mangët.

Aspekti i jashtëm i veprave që do ta bëjnë njeriun të fitojë kënaqësinë e Allahut, e për rrjedhojë Xhenetin, vendin e lumturisë së përjetshme, shfaqet në farzet si namazi, agjërimi, zekati, haxhi dhe xihadi që shpreh çdolloj veprë apo përpjekje në rrugë të Allahut. Mirëpo, edhe këto kanë disa rregulla shpirtërore të cilat duhen respektuar.

Farzet e dukshme/të jashtme

I Dërguari i Allahut ﷺ, në disa hadithe fisnike, lidhur me veprat e dukshme që bëhen shkak i fitimit të kënaqësisë së Allahut dhe për rrjedhojë i Xhenetit, pra lidhur me disa prej demonstrimeve të devotshmërisë që pasqyrohen jashtë, ka thënë:

Rebia ibn Ka'bi  tregon:

“Unë e gdhija natën tek dera e të Dërguarit të Allahut, i përgatitja ujin e abdesit dhe i sillja gjërat për të cilat kishte nevojë...”²⁶⁵

Në këmbim të kësaj (shërbimit), njëherë më tha:


«Kërko (ç'të duash prej meje)!» Unë i thashë:




«Dëshiroj të jem së bashku me ty në Xhenet.»

Ndërsa Profeti , tha:




«A nuk dëshiron diçka tjetër?»

«Kjo është dëshira ime!» - thashë unë.

«Atëherë, që dëshira jote të realizohet, më ndihmo duke bërë shumë sexhde!» -tha Profeti .” (Muslim, Salat, 226)

Po ashtu, një prej të dashuruarve pas Profetit , Theubanit , iu kërkua “një këshillë për një vepër që do ta çonte njeriun në Xhenet”, kërkesë kjo që i ishte përsëritur tre herë. Pas kërkesës me këmbëngulje, Theubani  transmetoi këtë hadith fisnik:

“Bëj shumë sexhde, sepse në këmbim të çdo sexhdeje që ti bën për Allahun, Ai të ngre një gradë dhe të fshin një gabim.” (Muslim, Salat, 225)²⁶⁶

“Sexhdja” për të cilën bëhet fjalë në këto hadithe, siç dihet, është namazi. Prandaj, ata që dëshirojnë të hyjnë në Xhenet dhe të jenë fqinjë me të Dërguarin e Allahut , duhet të falin sa më shumë namaze, duke i shtuar sexhdet, të cilat janë momentet më të afërta me Allahun e Madhëruar. Pozita e Profetit , është një vend i lartë, i cili e tejkalon edhe pozitën e profetëve të tjerë. Pra, për të qenë bashkë me Profetin  në Xhenet, duhet që sot (në këtë botë) t'i ngajmë atij në gjendje, vepra, ndjenja, mendime dhe në mënyrë të veçantë, në faljen e sa më shumë namazeve me përkushtim.



Namazi është shtylla e fesë dhe miraxhi i besimtarit. Ai është një prej shkaqeve më të rëndësishme të arritjes së kënaqësisë së Allahut dhe për rrjedhojë edhe Xhenetit më të lartë.

265. shih. Ibn-i Sa'd, IV, 313.

266. shih. Ebu Daud, Tatavvu, 22; Tirmidhi, Salat, 169; Nesai, Tatbik, 80, 89.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Atij që shkon e vjen nga xhamia sabah-aksham, Allahu i përgatit gosti në Xhenet për çdo vajtje-ardhje.” (Buhari, Ezan, 37; Muslim, Mesaxhid, 285)

“Nëse myslimani fal çdo ditë dymbëdhjetë rekate namaz nafile, përveç farzeve, Allahu i Madhëruar i përgatit një pallat në Xhenet!” ose *“atij i bëhet një pallat në Xhenet”*. (Muslim, Musafirin, 103)

“Kini frikë Allahun! Falni pesë kohët e namazit dhe agjëroni Ramazanin! Jepni zekatin e pasurisë suaj dhe binduni ndaj prijësve tuaj! Kështu do të hyni në Xhenetin e Zotit tuaj!” (Tirmidhi, Xhum'a, 80)

“O njerëz! Përhapeni selamin, ushqeni të tjerët dhe mos e ndërprisni interesimin dhe ndihmën për të afërmit! Falni namaz kur njerëzit flenë! Në këtë mënyrë do të hyni të shpëtuar në Xhenet!” (Tirmidhi, Kiamet, 42)²⁶⁷

Njëherë, një person i tha të Dërguarit të Allahut ﷺ:

“Më tregoni një vepër që do të më çojë në Xhenet!”

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Adhuro Allahun dhe mos i shoqëro Atij askënd (në adhurim)! Fal namazin, jep zekatin dhe kujdesu për të afërmit!” (Buhari, Zekat, 1, Edeb, 10; Muslim, Iman, 12, 14)²⁶⁸



Ka edhe hadithe të cilat na bëjnë të ditur se ashtu si namazi, edhe shumë vepra të tjera janë shkak i fitimit të Xhenetit. Në njërin prej këtyre haditheve, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Riti i umres (vizitës së Qabesë) është shpagim për gjynahet që do të bëhen deri në umren tjetër. Ndërsa shpërblimi i një haxhi të pranuar, është vetëm Xheneti.” (Buhari, Umre, 1; Muslim, Haxh, 437)

Gjithashtu, një prej veprave që bart përgëzimin e Xhenetit, është marrja e dijës së dobishme. Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

267. shih. Ibn-i Maxhe, Ikamet, 174, Et'ime, 1.

268. shih. Nesai, Salat, 10.


“Atij që del në udhën e dijes, Allahu i Madhëruar ia lehtëson rrugën e Xhenetit. Melekët i duan dhe i mbrojnë njerëzit që mbruhen me dituri. Krijesat që ndodhen në qiej e në tokë, madje, edhe peshqit në ujëra, i luten Allahut që t’i falë dijetarët! Epërsia e një dijetari ndaj dikujt që merret vetëm me adhurim, është si epërsia (në ndriçim) e hënës pesëmbëdhjetëshe ndaj yjeve! Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve. Profetët nuk kanë lënë trashëgim ar e argjend, por vetëm dituri. Prandaj, kush merr nga kjo trashëgimi diturie, fiton një dhunti shumë të madhe!” (Ebu Daud, Ilm, 1; Tirmidhi, Ilm, 19)




Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, pyeti sahabët që ndodheshin pranë tij:

“Kush prej jush agjëron sot?”


Ebu Bekri , u përgjigj: “Unë o i Dërguari i Allahut.”

Profeti , pyeti sërish: “Kush ka përcjellë një të vdekur për në varreza sot?”

Ebu Bekri , u përgjigj: “Unë o i Dërguari i Allahut.”

Profeti , i pyeti: “Kush ka vizituar një të sëmurë sot?”

Ebu Bekri , u përgjigj: “Unë o i Dërguari i Allahut.”

Profeti , i pyeti për të katërtën herë: “Kush ka dhënë sadaka sot?”

Ebu Bekri , u përgjigj: “Unë o i Dërguari i Allahut.”

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Kush i bën të gjitha këto vepra të mira së bashku, patjetër që do të hyjë në Xhenet!” (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 12)



Një nga veprat më të rëndësishme, që e bën njeriun të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe Xhenetin, është edhe lufta në rrugën e Allahut. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më



fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore.” (Teube, 111)

Sipas transmetimeve, ky ajet fisnik është zbritur në lidhje me besën që besimtarët e Medinës i dhanë Profetit ﷺ në Akabe, pasi e kishin ftuar atë në qytetin e tyre, në një periudhë kur Profeti po luftonte dhe po mudohej për të vendosur monoteizmin në Mekë. Gjatë kësaj besëlidhjeje, Abdullah ibn Reuaha رضي الله عنه prej Medinës, u ngrit në këmbë dhe tha:

“O i Dërguar i Allahut! Ti mund të na vësh çdo kusht që të duash për veten dhe Zotin tënd!”

Profeti ﷺ tha:

“Kushtet për Zotin tim janë: ta adhuroni Atë dhe të mos i shoqëroni Atij asnjë ortak (shok). Kurse kushti në lidhje me mua është: të më mbroni ashtu siç mbroni jetën dhe pasurinë tuaj!”

Sahabët fisnikë pyetën:

“Nëse veprimet kështu, cili është shpërblimi ynë?”

“Xheneti!” - u përgjigj Profeti ﷺ.

“Çfarë tregtie fitimprurëse! Ne as e prishim këtë marrëveshje, dhe as duam që të priset!” - thanë ata. (Ibn-i Kethir, Tefsir, II, 406)

Abdullah ibn Reuaha رضي الله عنه e plotësoi këtë tregti fitimprurëse në betejën e Mutes. Ai mori nga Profeti ﷺ përgëzimin se do të binte dëshmor dhe shkoi në luftë me entuziazëm dhe nivel të lartë besimi. Kështu, duke ia dhuruar pasurinë thesarit të shtetit dhe jetën e tij Allahut të Madhëruar, ai fluturoi drejt Xhenetit më të lartë.

Edhe sahabët e tjerë i qëndruan besnikë kësaj besëlidhjeje, duke u përpjekur në rrugën e Allahut në vende të ndryshme, dhe duke ia shtuar edhe më tepër begatinë kësaj tregtie fitimprurëse.



Këtu dëshirojmë të sjellim ndërmend edhe faktin se të gjitha veprat e mira si namazi, agjërimi, zekati, haxhi, dituria, kumtesa e fesë dhe lufta në rrugën e Allahut, bëhen shkak i fitimit të Xhenetit vetëm nëse veprohen bashkë me farzet e tjera. Pra, të mendosh se mund të shpëtosh duke vepruar vetëm njëren prej punëve të përgëzuara me Xhenet dhe të neglizhosh



detyrat e vogla dhe të mëdha që feja i ka ngarkuar besimtarit, nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim i vetvetes dhe indiferencë e madhe.

Farzet e padukshme/të fshehta

Përkrah farzeve të dukshme, ka edhe shumë farze të padukshme siç janë morali i bukur, sinqeriteti, devotshmëria, mirësia, përkushtimi, mëshira, bujaria, drejtësia, modestia, edukata, nderi, turpi dhe durimi.

Për shembull, Allahu i Madhëruar dëshiron që kur robi i Tij të jetë duke falur namazin, i cili është një takim i veçantë me Të, të përkushtohet maksimalisht. Kur të jetë duke i dhënë zekatin, sadakanë apo dhuratën një nevojtar, i vë atij kushtin që t'ia ofrojë ato pa e qortuar, pa i thyer zemrën, me edukatë dhe me ndjenjën e falënderimit. Po ashtu, Ai urdhëron që në të gjitha adhurimet njeriu të synojë vetëm kënaqësinë hyjnore, pra të veprojë me sinqeritet. Të gjitha këto urdhra janë vetëm nga një shembull i farzeve të padukshme.

Nuk duhet harruar se personaliteti i një besimtari mund të jetë i plotësuar vetëm nëse i respekton siç duhet të gjitha urdhrat dhe ndalesat, të hapura dhe të fshehta, të Allahut.

Allahu i Madhëruar, na e ka bërë të ditur qëllimin e krijimit të njeriut, duke thënë: “لِيَعْبُدُونِ / për të më adhuruar Mua”.²⁶⁹ Ndërsa komentuesit e Kuranit shprehjen “لِيَعْبُدُونِ”, e kanë komentuar: “për të më njohur Mua”, pra për të arritur njohjen e Allahut.

Njohja e Allahut, nënkupton njohjen e Tij me zemër. Kjo arrihet vetëm me zhvillimin e zemrës, që realizohet duke bërë kujdes për anën e padukshme të adhurimeve, ashtu siç bëhet kujdes për anën e dukshme të tyre.

Imam Rabbani ka thënë:

“Pasi ta kemi zbukuruar anën e dukshme (të jashtme) të veprave tona në përputhje me kriteret juridike (Islame), duhet të kujdesemi edhe për anën e tyre të padukshme (të brendshme), që ato të mos përzihen me indiferencë. Pa mbështetjen e të brendshmes, zbukurimi i anës së jashtme të veprave tona në përputhje me gjykimet juridike, është një punë shumë e vështirë...”

269. shih. Dharijat, 56.



Kujdesi ndaj anës së brendshme, bën të domosdoshëm edhe kujdesin ndaj anës së jashtme. Ai që merret vetëm me anën e brendshme dhe neglizhon anën e jashtme të veprave, është i pafe, dhe të gjitha gjendjet shpirtërore që ai arrin, janë të padobishme. Kriteri më i mirë që tregon vlerën e gjendjeve tona shpirtërore, është rregullimi i veprave tona të jashtme në përputhje me kriteret juridike Islame. Kjo është edhe rruga e drejtë!”²⁷⁰

Nuk duhet harruar se devotshmëria nuk është e plotë nëse adhurimet bëhen vetëm në mënyrë formale, por edhe përkufizimi i devotshmërisë vetëm me moralin, duke mos i respektuar urdhrat në lidhje me anën e jashtme të adhurimeve, me pretendimin se ke zemër të pastër, nuk ndihmon në realizimin e plotë të pjekurisë së devotshmërisë që dëshiron Allahu i Madhëruar.

Për arritjen e një devotshmërie të vërtetë, ana e brendshme dhe ana e jashtme e veprave, duhet të realizohen në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Një pjesë e farzeve të padukshme (të fshehta), ndaj të cilave duhet të kujdeset besimtari që dëshiron të afrohet sa më shumë me Allahun, janë si më poshtë:

• **Morali i bukur:**

Më i rëndësishmi prej urdhrave, në fushën e farzeve të padukshme, është morali. Për rrjedhojë, edhe treguesi më i rëndësishëm i besimit të vërtetë dhe i adhurimeve të pranueshme, është pjekuria e njeriut në aspektin moral.

Në një hadith fisnik urdhërohet:

“Në ditën e Kiametit, në peshoren e robit besimtar nuk do të ketë asgjë që peshon më tepër se morali i tij i bukur. Allahu i Madhëruar, e urren atë që bën veprime të shëmtuara dhe flet fjalë të pista.” (Tirmidhi, Birr, 62/2002)

E në fakt, Allahu i Madhëruar, kulmin e moralit të bukur e ka ekspozuar tek Profeti ﷺ. Ai e ka dërguar atë si mëshirë për botët dhe ia ka dhuruar botës si “usue-i hasene”, pra si “personalitetin e pashoq dhe më shembullor”. Kjo cilësi e tij vërtetohet qartë edhe në këtë ajet fisnik:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Ti padyshim je mbi një moral madhështor!” (Kalem, 4)

Gjithashtu, në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Unë nuk jam dërguar për asnjë qëllim tjetër, përveçse që të plotësoj moralin e bukur!” (Muuatta, Husnu'l-Halk, 8)

Detyra jonë është që të marrim shembull moralin e bukur të Profetit tonë ﷺ dhe ta kontrollojmë shpesh veten tonë në lidhje me këtë çështje.

Për shembull, sa i ngjajmë të Dërguarit të Allahut në lidhje me jetën e adhurimeve? Profeti ﷺ, ka thënë:

“Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur!” (Buhari, Ezan, 18)

Sa i ngjajmë të Dërguarit të Allahut ﷺ, në vepra dhe në sjelljen me të tjerët?

Sahabët e nderuar, të cilët Allahu i Madhëruar na i prezantoi si brezin më shembullor, e ndoqën të Dërguarin e Allahut ﷺ, hap pas hapi, njëlljo siç ecën njeriu mbi dëborë duke shkelur mbi hapat e atij që ka para. Ata nuk u ndanë qoftë edhe për një çast prej gjurmëve të tij, duke i qëndruar besnik njësoj si hija të zotit, sepse dëshira dhe përpjekja më e madhe e sahabëve ishte të qenit pjesë e përgëzimit të hadithit profetik:

الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ

*“Njeriu është me atë që do!”*²⁷¹

Ata dëshironin që afërsinë që kishin me të Dërguarin e Allahut në këtë botë, ta vazhdonin edhe në botën tjetër. Me qëllim që edhe ne të jemi afër të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili është udhëzuesi ynë në dynja dhe mundësia jonë e ndërmjetësimit në Ahiret, duhet ta shtojmë sa më shumë dashurinë ndaj tij. Dhe kushti i **dashurisë**, është **bindja** dhe **sakrifica**.

Nisur nga kjo, i nderuari Hasan Basriu, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“O njerëz! Mos e keqkuptoni hadithin: «Njeriu është me atë që do!»! Nëse nuk veproni si njerëzit e devotshëm, nuk mund të bëheni prej tyre, sepse edhe hebrenjtë me të krishterët pretendojnë se i duan profetët e tyre,

271. Buhari, Edeb, 96.



mirëpo ata nuk janë bashkë me ta (në gjendje, moral dhe sjellje).” (Ihja, V. II, fq. 402)

Ndërsa i nderuari Fudajl ibn Ijazi, i kërkonte llogari vetes në këtë mënyrë:

“Ti dëshiron të jesh bashkë me profetët dhe besnikët në Xhenetin Firdeus, por çfarë veprash ke bërë për këtë? Cilat prej dëshirave epshore i ke mbizotëruar? Cilin zemërim ke mposhtur? Tek cili prej të afërmve që nuk të vjen ke shkuar? Cilin prej gabimeve të vëllait tënd ke falur? Nga cilët prej të afërmve të tu je larguar dhe cilëve prej të largëtve u je afruar për hir të Allahut?..” (Ihja, V. II, fq. 402)

Prandaj, le të bëjmë edhe ne një llogari të vetes sonë:

Në çfarë mase është përpjekja jonë për t’i ngjarë Profetit ﷺ, për t’iu bindur atij dhe çfarë sakrificash kemi bërë për të? Të mos harrojmë se bindja ndaj Profetit ﷺ, është si një pasqyrë e pastër që tregon nivelin e dashurisë që ndiejmë për Allahun e Madhëruar. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ
وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Thuaju (o Muhamed): «Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë!»” (Al-i Imran, 31)

Ndërsa vetë i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Përveç atyre që nuk duan, të gjithë do të hyjnë në Xhenet!”

Të pranishmit pyetën: “O i Dërguari i Allahut! Kush nuk dëshiron të hyjë në Xhenet?”

Profeti ﷺ u përgjigj: “Ata që më binden mua hyjnë në Xhenet. Kush më kundërshton, do të thotë se nuk e do Xhenetin.” (Buhari, I’tisam, 2)



Sa bukur e ka shprehur ky hadith, i transmetuar nga Enes ibn Maliku رضي الله عنه, faktin se ai mysliman që arrin këtë nivel shpirtëror, ka për të qenë udhëtar drejt Xhenetit:

Po qëndronim së bashku me të Dërguarin e Allahut ﷺ, i cili tha:

“Tani do të vijë në mesin tonë një njeri që do të jetë në Xhenet në botën tjetër.”

Ne pritëm dhe pamë se erdhi një sahab nga ensarët, të cilit po i rridhte uji i abdestit nga mjekra dhe po i mbante këpucët në dorën e majtë. Ditën e nesërme, Profeti ﷺ përsëriti të njëjtat fjalë. Pritëm dhe erdhi sërish i njëjti person. Kjo u përsërit edhe ditën e tretë. Pasi i Dërguari i Allahut ﷺ, u ngrit e shkoi, Abdullah ibn Amr ؓ, e ndoqi sahabin dhe kur e arriti e pyeti:

“Jam zënë me babanë tim dhe u betova se nuk do të shkoj ta takoj për tri ditë. A pranon të më mbash si mysafir në shtëpinë tënde gjatë këtyre tri ditëve?”

Personi pranoi. Pastaj, Abdullah ibn Amr ؓ, rrëfeu:

“Kam jetuar tri net në shtëpinë e tij. Ai nuk falte shumë namaz gjatë natës. Vetëm se aty afër agimit zgjohej dhe bënte dhikër. Në fakt, nuk e kam dëgjuar të thoshte fjalë tjetër përveçse fjalë të mira. Pas tri netësh, në sytë e mi, ai person nuk ishte më i ndryshëm nga unë nga aspekti i adhurimeve. E pyeta:

«O rob i Zotit! Në fakt unë nuk jam grindur me babanë tim. Arsyeya përse kërkova të banoja këto tri net në shtëpinë tënde, ka të bëjë me faktin se i Dërguari i Allahut ﷺ, tri ditë me radhë tha se personi që do të vinte i pari në xhami, kishte për të hyrë në Xhenet në botën tjetër; dhe çdo herë personi i parë që vinte në xhami ishte ti. Desha të qëndroja pranë teje që të mësoja se çfarë veprash bën ti dhe të kryeja edhe unë të njëjtat veprime, që të meritoja të hyja në Xhenet. Por, pas tri netësh, nuk kam parë se ti bën ndonjë punë të ndryshme nga ato që bën çdo mysliman i mirë. Vallë, për çfarë arsyeje e ke mbërritur shkallën e lartë, të cilën e ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut ﷺ, për ty?»

Ai u përgjigj:

«Unë nuk kryej asnjë veprim tjetër, përveç atyre që ti ke parë me sytë e tu.»

Teksa po bëhesha gati të largohesha, ai më bëri zë dhe më tha:

«Unë nuk bëj asgjë më shumë se sa bën një mysliman i rregullt në jetën e tij, por nuk i mbaj as mërinë më të vogël ndonjë myslimani dhe nuk ia kam zili asnjë personi begatitë dhe mirësitë që i ka dhuruar Allahu.»

«Ja pra!» - i thashë unë, «për këtë arsye ti ke arritur gradën për të cilën të ka përgëzuar Allahu.» (Ahmed, III, 166)

• Edukata dhe turpi:

Edukata është aq e rëndësishme në Islam, saqë po të përkufizohet shkurtimisht, mund të thuhet se feja është një tërësi e rregullave të edukatës.

Parë nga aspekti i logjikës dhe i urtësisë, çështja e cila trajtohet më së shumti në Kuran, është edukata dhe turpi. Madje, edhe ngjarjet historike që tregohen në Kuran, përmenden me qëllim për të nxitur edukatën dhe ndjenjën e turpits, pra përsosjen e sjelljeve dhe ruajtjen nga të këqijat, për shkak të frikës ndaj Allahut. Sa bukur e ka shprehur këtë i nderuari Mevlana:

“Kush nuk ka edukatë, nuk është njeri, sepse dallimi midis njeriut dhe kafshës, është edukata!”

“Hapi sytë dhe shihe fund e krye fjalën e Allahut! I gjithë Kurani, ajet për ajet, është një trajnim edukate.”

“Pyeta mendjen time: «ç’ është besimi?» Ajo u përkul tek veshi i zemrës sime dhe i pëshpëriti: «Besimi është edukatë!»”

“Prej Allahut duhet të kërkojmë sukses në arritjen e edukatës, sepse ai që nuk ka edukatë, është privuar prej mirësisë së Allahut...”

“Kush tregohet pa takt në rrugën drejt miqësisë, i pret rrugën edhe të tjerëve. Një njeri i tillë është burracak. Dhe kushdo që tregohet i pafytyrë në këtë rrugë, fundi ka mbytjen në luginën e hidhërimit dhe pendesës.”


“Në sajë të edukatës edhe qielli u ndriçua, edhe melekët u bënë të pafajshëm!”

“Dëbimi i Iblisit nga dera hyjnore, u bë për shkak të guximit për të folur pa edukatë përballë Allahut të Madhëruar. Nëse dëshiron t’i shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë dhe shih! Ajo që e shkatërron shejtanin është edukata.”

Ata që gjenden përpara një mbreti apo një personi me pozitë të lartë, nuk sillen lirshëm si jashtë, por tregojnë edukatën dhe sjelljet e duhura sipas vendit ku ndodhen. Po kështu, edhe besimtarët e devotshëm, për shkak se jetojnë me vetëdijen se ndodhen para Allahut të Madhëruar, tregojnë shumë kujdes në çështjen e edukatës dhe e pasqyrojnë atë në të gjithë gjymtyrët e

tyre. Pra, ata jetojnë çdo çast me vetëdijen se ndodhen bashkë me Allahun në përputhje me ajetin: “...**Ai është me ju kudo që të jeni!..**” (Hadid, 4)

Ibn-i Mes’udi  tregon:

Një ditë, i Dërguari i Allahut , tha: “Kini turp nga Allahu ashtu siç duhet!”

Ne thamë: “O i Dërguari i Allahut! Falënderimi i qoftë Allahut, ne kemi turp nga Ai!”

Profeti  tha:

“Nuk është ashtu si mendoni. Të kesh turp vërtet ndaj Tij, nënkupton: të ruash kokën dhe çka ka në të (nga harami), barkun dhe çka përmban ai, trupin dhe organet në të, si dhe të përkujtosh vdekjen dhe kalbjen në tokë. Kush e dëshiron botën tjetër, le t’i braktisë kënaqësitë e kësaj bote dhe të zgjedhë Ahiretin në vend të saj! E kush vepron kështu, ka turp siç duhet prej Allahut!” (Tirmidhi, Kiamet, 24/2458)

• Pastrimi (Tezkije):

Allahu i Madhëruar urdhëron:

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ
يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ
وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.” (Al-i Imran, 164)

Pastrimi i botës së brendshme nga gjërat negative, fillon me pastrimin nga mohimi i Allahut, nga hipokrizia dhe nga shirkun i madh e i vogël. Kjo, sepse më i rëndësishmi prej farzeve të padukshme që Allahu i Madhëruar ka urdhëruar për robërit e Tij, është besimi i ekzistencës dhe njëshmërisë së Tij, dhe mos adhurimi i askujt tjetër përveç Tij.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush vdes pa i bërë Allahut shok, hyn në Xhenet! Por kush vdes duke i bërë shok Allahu, hyn në Xhehenem!” (Muslim, Iman, 151)

Si fillim njerëzit duhet të pastrohen prej mohimit, hipokrizisë dhe shirkut, me qëllim që të mund të pranojnë të vërtetat hyjnore që u vijnë. Kjo i ngjan dezinfektimit të plagës, para se të vendosësh ilaçin. Për këtë arsye edhe është thënë: “Eliminimi i së keqes dhe së dëmshmes, është më primare se arritja e së mirës dhe së dobishmes.”. Edhe formula e teuhidit fillon me pjesën “la ilahe / s’ka Zot”. Pra, në fillim eliminohet nga zemra çdo gjë që e largon robin nga Allahu, më pas në truallin e pastër të asaj zemre ngulitet e vërteta “il-lallah / përveç Allahut”, duke skalitur kështu teuhidin në zemër.

Pasi të pastrohet bota e brendshme prej negativiteteve dhe të mbrohet prej të këqijave, ajo zbukurohet me cilësi të bukura si besimi, kultura, dituria, urtësia, ndjenjat e bukura, zakonet e mira dhe devotshmëria.

Në tasavuf (misticizëm), të pastrohesh (tezkije) do të thotë të ulësh në minimum dëshirat e egos, duke thyer mbizotërimin e saj ndaj trupit, ndërkohë që i jep mundësi mbizotërimit të shpirtit. Dhe kjo mund të arrihet vetëm me anë të metodës së “vetëkontrollit” dhe “përpjekjes”, të cilat e forcojnë vullnetin kundër egos. Pra duke i vënë fre egos ndaj dëshirave ekstreme dhe duke e detyruar atë të bëjë disa shërbime, përpjekje dhe sakrifica.

Në fakt, eliminimi i plotë i egos është i pamundur. Madje as feja nuk e urdhëron diçka të tillë. Nisur nga kjo, pastrim do të thotë mbajtja e prirjeve të egos brenda kufijve hyjnorë dhe normave të lejuara, duke u përpjekur ta edukosh atë. Pastrimi shpreh shpëtimin prej lakmisë së kësaj bote, që është nëna e të gjitha papastërtive shpirtërore.

Pastrim (tezkije), në të njëjtën kohë, do të thotë edhe “**të shtosh**” dhe “**të arrish pjekurinë shpirtërore**”. Në kuadër të këtij kuptimi, pastrimi shpreh të gjithë procesin e edukimit shpirtëror. Allahu i madhëruar urdhëron:

أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ﴿١٤﴾ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ﴿١٥﴾

“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!” (A’la, 14-15)

وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ﴿٧﴾ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ﴿٨﴾
 قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ﴿٩﴾ وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ﴿١٠﴾

“Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.” (Shems, 7-10)

• **Sinqeriteti:**

Kusht kryesor për pranimin e veprave nga Allahu, është sinqeriteti (ihlas), që nënkupton kryerjen e veprave duke synuar vetëm pëlqimin hyjnor dhe duke moslejuar që mbi to të bjerë qoftë edhe hija e ndonjë qëllimi egoist, që buron nga kjo botë.

Sinqeriteti për veprën është si shpirti për trupin. Vepra pa sinqeritet është diçka formale dhe pa thelb. Për rrjedhojë, ajo nuk është gjë tjetër përveçse një lodhje e thatë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Veprat janë sipas qëllimit!..” (Buhari, Iman, 41)

Detyra më e rëndësishme e myslimanit në devotshmëri është shkulja dhe flakja prej zemrës e të gjitha synimeve që janë larg pëlqimit hyjnor. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ

“Me të vërtetë, Ne ta kemi zbritur ty Librin me të vërtetën. Andaj adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të!”

(Zumer, 2)

قُلْ إِنِّي أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ

“Thuaj: «Unë jam urdhëruar që ta adhuroj Allahun me përkushtim të sinqertë.»” (Zumer, 11)

Ndërsa një shprehje e famshme e Dhunnuni Misriut thotë:



“Njerëzit janë të vdekur, përveç të diturve! Të gjithë të diturit janë në gjumë, përveç atyre që punojnë (me dijet e tyre)! Të gjithë ata që punojnë kaplohen dhe mashtrohen prej krenarisë, përveç robërve që Allahu u ka dhënë sinqeritet! Por edhe robërit e sinqertë janë përballë një rreziku të madh (çdo çast në këtë botë)!” (Bejhaki, Shuab, IX, 181)

• Meditimi:

Një prej cilësive më të rëndësishme, që do ta ngrejë njeriun në majat më të larta shpirtërore, është meditimi i së vërtetës duke u zhytur në thellësitë e heshtjes.

Meditimi i realizuar nën dritën e shpalljes hyjnore, është çelës i besimit. Sa më shumë të përparojë njeriu gjatë jetës me meditim në thellësitë e ndjenjave, aq më shumë përfiton prej dashurisë hyjnore dhe aq më shumë i shtohet edhe lumturia në botën e përjetshme.

Allahu i Madhëruar, duke i ftuar robërit e Tij drejt meditimit, urdhëron:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ
لآيَاتٍ لِّأُولِي الْأَلْبَابِ

**“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndër-
rimin e natës e të ditës, ka shenja për të zotët e mendjes!”** (Al-i
Imran, 190)

الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَامًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ
فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ
رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا سُبْحَانَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

**“Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë,
ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe
të Tokës (duke thënë:): «O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto -
lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i
zjarrit.»”** (Al-i Imran, 191)



﴿١٨﴾ أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ ﴿١٧﴾ وَإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ﴿١٨﴾
 وَإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ ﴿١٩﴾ وَإِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ ﴿٢٠﴾

“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po Tokën, se si është shtrirë?!” (Gashije, 17-20)

Kurani Fisnik është një udhërrëfyes i pashoq i udhëzimit dhe lumturisë, i cili e fton njeriun vazhdimisht drejt meditimit, që prej ajetit të parë e deri tek ajeti i fundit, duke kërkuar prej tij reflektimin mbi urtësitë e krijimit, rregullin e përsosur në gjithësi dhe në Kuranin Fisnik, si një mrekulli e fjalës. Gjithashtu, Kurani Fisnik e paralajmëron njeriun me shprehje si: **“A nuk po mendoni? A nuk po meditonin? A nuk po merrni mësim?, etj.”** Për rrjedhojë, të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë në mënyrë dinjitoze dhe të fitojnë thellësi e gjallëri shpirtërore, duhet të hyjnë në botën e meditimit, drejt së cilës orienton Kurani Fisnik.

Në këtë rrugë, gjenden tre pika të rëndësishme që do t’ia lehtësojnë punën besimtarit:

1. Përfitimi shpirtëror prej kohës para agimit.

Allahu i Madhëruar i fton të përfitojnë prej kohës para agimit,²⁷² të gjithë ata që dëshirojnë t’i afrohen Atij, sepse koha para agimit është:

- ✓ Koha kur kërkimi i faljes është më i pranueshëm.
- ✓ Koha e përtëritjes së besimit me Shprehjen e Teuhidit (La ilahe il-lallah).
- ✓ Koha më e mirë për dërgimin e selameve dhe salavateve ndaj Profetit tonë ﷺ dhe shfaqja e dashurisë ndaj tij.
- ✓ Koha e parapërgatitjes për atmosferën e varrit, me anë të meditimit rreth vdekjes, në muzgun e mëngjesit.

2. Qëndrimi me njerëzit e sinqertë

Allahu i Madhëruar, urdhëron:

272. shih. Al-i Imran, 17; Zumer, 9; Furkan, 64.



“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!” (Teube, 119)

Njerëzit e mirë dhe të sinqertë ndikojnë pozitivisht në zemër. Ai që përpiket të shoqërohet me njerëz të mirë e të sinqertë, kërkon prej vetes po këto vlera. Njëlloj, ai që shoqërohet me njerëz negativë, rrezikon të bëhet edhe vetë i tillë.

3. Hallalli si burim force

Hallall e çon njeriun në mirësi, ndërsa harami e çon në fatkeqësi.

Nëse njeriu:

- E çon dëm kohën para agimit duke fjetur gjumë,
- Shoqërohet me njerëzit indiferentë dhe negativë, në vend që të shoqërohet me njerëzit e mirë e të sinqertë
- Nuk bën kujdes që të qëndrojë fort në gjithçka që është hallall, dhe në vend që të mbushet me energji pozitive, ai ngarkohet me negativitete.

Kjo gjendje e shkatërron meditimn dhe e bën njeriun të ngathët dhe indiferent ndaj detyrave të devotshmërisë.

• Modestia:

Modestia dhe përlësia, në radhë të parë nënkuptojnë vetëdijen e të genit i dobët dhe një hiç, përballë Allahut të Madhëruar. Allahu ka premtuar se lumturinë e Ahiretit do t’ia bëjë të mundur atyre që në këtë botë nuk kanë pretenduar madhështi, nuk janë treguar arrogantë dhe nuk kanë bërë çrregullime, por e kanë pasur zemrën të mbushur me frikën dhe dashurinë ndaj Allahut.²⁷³ Ata që janë larguar nga mirësia e modestisë dhe janë kapluar prej krenarisë së tepruar dhe mendjemadhësisë, nuk kanë mundur të shpëtojnë as nga idhujtarizimi i dëshirave dhe kënaqësive të egos së tyre.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“A t’ju tregoj se kush janë njerëzit e Xhenetit? Ata janë njerëz, të cilët për shkak se janë të dobët dhe konsiderohen të dobët edhe nga shoqëria,

askush nuk u jep rëndësi, por nëse do të luteshin që të ndodhte diçka , Allahu do t'ua plotësonte dëshirën. A t'ju them se kush janë banorët e Xhehenemit? Janë njerëzit zemërgurë, të pacipë, koprracë dhe ata që ecin duke u mburrur.” (Buhari, Ejman 9, Tefsir 68/1, Edeb 61; Muslim, Xhennet, 47)

Allahu i Madhëruar, na ka urdhëruar që të tregohemi modestë edhe ndaj Atij, edhe ndaj robërve të Tij. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَاخْفِضْ جَنَاحَكَ لِمَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ

“Tregohu i butë me besimtarët që të pasojnë ty!” (Shu'ara, 215)

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ

هَوْنًا وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: «Paqe qoftë!»” (Furkan, 63)

Ndërsa i nderuari Jusuf Esbati, përjetimin e gjendjes së modestisë, në kuptimin e plotë të fjalës, e shpjegon kështu:

“Kur të dalësh në mëngjes nga shtëpia, shihe më lart se vetja këdo që të takosh! Modesti, është të pranosh të vërtetën e çdokujt dhe t'i shohësh mbi veten edhe ata që janë poshtë teje. Edhe ai që të shan, edhe ai që të lavdëron, duhet të jenë të barabartë për ty...”

Njëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar më ka urdhëruar: «Bëhuni aq modest, saqë askush të mos i mburret dhe të mos i bëj padrejtësi askujt!»” (Muslim, Xhennet, 64)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush tregon një gradë modesti për hir të Allahut (kundrejt robërve të Tij), Ai do ta ngrrej një gradë...” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 16)

Siç shprehet një poet:

Pa rënë në tokë fara, as rritet, as begatohet,

Me mëshirën e Allahut, i përluri ngrihet dhe lartësohet!



• Të jesh Emin dhe Sadik:

Një besimtar duhet gjithmonë të reflektojë paqen dhe sigurinë që i kërkon personaliteti dhe karakteri Islam. Prej dorës, gjuhës dhe veprave të tij, duhet të jenë të sigurt të gjithë njerëzit. Gënjeshtër, mashtrimi, hilja dhe cilësi të tjera të shëmtuara, nuk duhet të jenë në asnjë moment pjesë e jetës së tij.

Ebu Musa  ka thënë:

E pyeta të Dërguarin e Allahut:

“O i Dërguar i Allahut! Kush është më i miri prej myslimanëve?” Ai mu përgjigj:

“Ai, prej gjuhës dhe dorës së të cilit janë të sigurt myslimanët!” (Buhari, Iman, 4, 5, Rikak, 26; Muslim, Iman, 64, 65)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut , ka thënë:

“Besnikëria e çon njeriun në mirësi, ndërsa mirësia në Xhenet. Nëse njeriu vazhdon të thotë gjithmonë të drejtën, në fund bëhet prej besnikëve. Gënjeshtër e çon njeriun në gjynah, ndërsa gjynahu në Xhehenem. Nëse njeriu vazhdon të thotë gjithmonë gënjeshtër, si përfundim, shkruhet si gënjeshtar tek Allahu.” (Buhari, Edeb, 69; Muslim, Birr, 103-105)

• Durimi:

Durim do të thotë ruajtje e ekuilibrit dhe maturisë, përballë kushteve të ndryshueshme në aspektin material e shpirtëror. Po ashtu, do të thotë të tregosh tolerancë ndaj problemeve, të përballosh dhimbjet, të tregosh forcë përballë vështirësive dhe vuajtjeve, dhe të mos lëshosh pe nga feja dhe besimi pavarësisht llojit të sprovës që të godet.

Durimi është epiqendra e moralit të bukur, gjysma e besimit dhe çelësi i qetësisë dhe lumturisë.

Durimi duhet të tregohet në kohën e duhur, përndryshe nuk ka ndonjë shpërblim të madh.²⁷⁴

Sa më i hidhur të jetë durimi në këtë botë, aq më i ndritur do jetë në

botën tjetër. Ata që i bartin në gji dhimbjet e durimit, do të arrijnë kënaqësinë e Allahut, e për rrjedhojë Xhenetin, vendin e lumturisë së përjetshme.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.” (Bekare, 153)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اصْبِرُوا وَصَابِرُوا وَرَابِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!”

(Al-i Imran, 200)



...إِنَّمَا يُوفِي الصَّابِرُونَ أَجْرَهُمْ بِغَيْرِ حِسَابٍ

“...Padyshim që të durimtarët do të shpërblehen pa masë!”

(Zumer, 10)





Po ashtu, edhe kjo ndodhi, e cila tregon se durimi për hir të Allahut, ka si shpërblim vetëm Xhenetin, është shumë mësimdhënëse:

Një ditë, Ibn-i Abbasi , i tha Ata ibn Ebi Rabah-ut :

“A të tregoj një grua nga gratë e Xhenetit?”

Ai iu përgjigj: “Po, tregoma!”

Atëherë, Ibni Abbasi  tha: “Ajo gruaja zezake shkoi tek i Dërguari i Allahut  dhe i tha:

«Unë kam sëmundjen e tokës. Kur më kapin krizat, zbuloj kokën dhe trupin. Lutjuni Allahut për mua që të shërohem!»

Profeti i tha: «Po deshe, bëj durim dhe do të të jepet Xheneti; po deshe, mund t'i lutem Allahut që të të japë shërim!»

Gruaja i tha:



«Nëse është kështu, do të bëj durim! Por, lutuni që të mos zbulohem!»

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, u lut për të!” (Buhari, Merda, 6; Muslim, Birr, 54)

Ja pra, kjo është vlera e lartë që ka tek Allahu i Madhëruar durimi që bëhet ndaj problemeve, duke shprehur kënaqësinë e Tij...



PJESA IX

*Porosi për udhëtarët
e përjetësisë*

*Një jetë indiferente është lojë në
fëmijëri, epsh në rini, mosko-
këçarje në moshë të rritur dhe
mall e pendesë në pleqëri...*

POROSI PËR UDHËTARËT E PËRJETËSISË

I Dërguari i Allahut ﷺ, rrëfeu:

“Më erdhi Xhibrili ﷺ dhe më tha:

«O Muhamed! Jeto sa të duash, por një ditë patjetër do të vdesësh. Duaj kë të duash, por patjetër do të ndahesh prej tij. Puno me çfarë të duash, por vetëm shpërblimin e saj do të marrësh.

Dije se nderi i besimtarit është në qëndrimin në këmbë natën (në faljen e namazit të natës), ndërsa dinjiteti i tij është në të mos pasurit nevojë për të tjerët!» (Hakim, IV, 360-361/7921)



“Vlerëso pesë gjëra pa ardhur pesë të tjera:

- ✓ Rininë pa ardhur pleqëria,
- ✓ Shëndetin pa ardhur sëmundja,
- ✓ Pasurinë pa ardhur varfëria,
- ✓ Kohën e lirë pa ardhur angazhimi,
- ✓ Jetën pa ardhur vdekja.” (Buhari, Rikak, 3; Tirmizi, Zuhd, 25)



“Atij që shqetësohet për Ahiretin, Allahu ia vendos pasurinë në zemrën e tij, ia mbron punët dhe kjo botë i përulet. Atij që shqetësohet për këtë botë, Allahu ia vendos para syve varfërinë dhe nga kjo botë i vjen vetëm aq sa i është përcaktuar”. (Tirmidhi, Sifatu'l-kijame, 30)



“Biri i Ademit thotë vetëm: «pasuria ime, pasuria ime!». O biri i Ademit! A mos ke pasuri tjetër përveç asaj që ha dhe konsumon, që vesh dhe e



vjetron dhe asaj që e dërgon në Botën tjetër si shpërblim, të cilin e ke fituar duke dhënë sadaka (lëmoshë)!?» (Muslim, Zuhd, 3-4; Tirmidhi, Zuhd, 34)



“Nëse biri i njeriut do të kishte një luginë me ar, ai do të kërkonte edhe një luginë tjetër. Syrinx e tij nuk e mbush asgjë tjetër përveç dheut...”
(Buhari, Rikak, 10)



“Kur të lidhesh në namaz, falu si të ishte namazi i fundit! Mos thuaj asgjë për të cilën nesër do të pendohesh!” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 15)



“Ditën e Kiametit sillet njeriu që ka pasur më shumë mirësi në dynja, por që është nga banorët Xhehenemit. Ai zhytet njëherë në zjarr, pastaj i thuhet:

«O biri i Ademit! A ke parë ndonjë ditë të mirë? A të ka ndodhur ndonjë mirësi ndonjëherë?» Ai thotë:

«Jo, vallahi (betohem në Ty) o Zoti im! Nuk kam parë gjë të tillë»

Më pas sillet njeriu që ka pasur më shumë vuajtje, në dynja e që është nga banorët e Xhenetit. Ai futet njëherë në Xhenet dhe i thuhet:

«O biri i Ademit! A ke parë ndonjëherë vuajtje? A të ka ndodhur ndonjë fatkeqësi a vështirësi ndonjëherë?» Ai thotë:

«Jo, vallahi (betohem në Ty) o Zoti im! Nuk më kanë ndodhur vuajtje kurrë, dhe kurrë nuk kam parë fatkeqësi a vështirësi!» (Muslim, Munafikin, 55)



“Vetëm dy sy nuk i prek zjarri i Xhehenemit: Syrinx që qan për Allahun dhe syrinx që gdhahet i zgjuar duke bërë roje në rrugën e Allahut.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 12/1639)



“Unë do të jem i pari nga ju që do të arrij në hauzin e Keutherit dhe do t’ju pres atje. Ky hauz është vendi i takimit tonë. Këtë çast unë jam duke



e parë atë! Unë do të dëshmoj për ju!.. Beto hem në Allahun se për ju nuk kam frikë se mos bini në shirk (idhujtari)! Por kam frikë se mos jepeni pas kësaj bote dhe vrisni njëri-tjetrin!..” (Buhari, Megazi, 17; Muslim, Fedail, 31)



“Dijeni mirë se unë do të shkoj para jush dhe do t’ju pres atje. Vini re! Vendi i takimit tonë nesër (në jetën tjetër, Ahiret) është kreu i hauzit të Keutherit. Kush dëshiron të takohet nesër me mua, ta heqë dorën dhe gjuhën nga gjynahet...” (Buhari, Salat, 80; Ibni Sa’d, II, 227)



Ebu Bekri  ka thënë:

“Dynjaja është tregu i besimtarëve, nata dhe dita janë kapitali i tyre, veprat e mira janë mallrat e tregtisë, fitimi i tyre është Xheneti dhe humbja e tyre është Xhehenemi.”



“Ku janë ata njerëz me fytyra të bukura prej të cilëve mahniten të gjithë? Ku janë trimat që krenohen me rininë e tyre? Ku janë sunduesit që themelojnë qytete madhështore dhe i rrethojnë me mure të larta? Ku janë heronjtë që nuk njohin humbje në fushëbeteja?”

Koha i kalbi të gjithë dhe i bëri njësh me tokën. Të gjithë u varrosën dhe u zhdukën në errësirat e varrit. Nxitoni, nxitoni! Thirrini mendjes pa u bërë ende vonë dhe përgatituni një orë e më parë për vdekjen dhe përtej saj!

Shpëtoni veten, shpëtoni veten!”



Omeri  ka thënë:

“E çfarë është dynjaja krahasuar me Ahiretin, përveçse si kërcimi i një lepuri?!”



“Pakësoji dëshirat e tua në lidhje me këtë botë, që të jetosh i lirë! Pakësoji gjynahet që vdekja të të vijë e lehtë!”



Osmani ﷺ ka thënë:

“Janë katër gjëra, e dukshmja e të cilave është virtyt, ndërsa e padukshmja është farz:

1. Qëndrimi me njerëzit e mirë është virtyt, pasimi i tyre është farz!
2. Leximi i Kuranit është virtyt, ndërsa puna me të është farz!
3. Vizita e varreve është virtyt, ndërsa përgatitja për atje është farz!
4. Vizita e të sëmurit është virtyt, ndërsa marrja mësim prej situatës është farz!



“Humbja më e madhe, është jeta e gjatë, në të cilën i zoti i saj nuk përgatitet për udhëtimin e Ahiretit.”



“Mendimi për dynjanë është errësirë në zemër, ndërsa mendimi për Ahiretin është dritë në zemër.”



“Njeriu më i mençur, është ai që e llogarit veten, e menaxhon mirë atë, punon fort për pas vdekjes dhe përfiton prej dritës së Allahut për errësirën e varrit.”



Aliu ﷺ ka thënë:

“Islami të mjafton si mirësi e kësaj bote! Adhurimet dhe bindja ndaj Allahut të mjaftojnë si angazhim! Ndërsa vdekja të mjafton si mësim!”



“Jetët tuaja s’kanë çmim tjetër përveç Xhenetit! Prandaj, jetët tuaja shitini vetëm në këmbim të Xhenetit!”



“Vlera e njeriut është aq sa vlera e dëshirave dhe kërkesave të tij!”



“Arritja e mirësisë më të madhe, është vdekja me Islam!”



“E ç’i duhet mburrja birit të Ademit!? Fillimi i tij është pikë uji, ndërsa fundi i tij është cofëtinë! Ai nuk mund të krijojë as furnizimin e vet dhe nuk mund të shpëtojë as veten.”



“Frymët janë hapa drejt vdekjes!”



“Nuk mund të mbledhësh buqeta trëndafilash nga ara ku mbillen ferra!”



Aliu  i vizitonte shpesh varret. Një ditë i thanë:

“Ç’është me ty o Ali? Je bërë fqinj me varret?!” Aliu , tha:

“Vura re se ata janë fqinj besnikë! E në fakt, ata nuk bëjnë asnjë të keqe dhe më e rëndësishmja, të kujtojnë Ahiretin!”



Muadh ibn Xhebeli  e ka këshilluar kështu djalin e tij:

“Biri im! Kur të falësh namaz, mendo sikur të jetë namazi i fundit që fal dhe mos shpreso se do të arrish përsëri një kohë të tillë namazi!..

“Biri im! Një njeri besimtar, duhet të vdesë ndërmjet dy punëve të mira. Domethënë, kur besimtari bën një punë të mirë, duhet të synojë të bëjë një punë tjetër të mirë dhe nuk duhet të fusë ndërmjet tyre asnjë punë të keqe!”



Ebu Derda  ka thënë:

“Nuk do të dëshiroja të qëndroja në dynja, nëse nuk do të ekzistonin këto tre mundësi:

1. Sexhdja ndaj Krijuesit tim, duke vendosur ballin në tokë ditë e natë.
2. Përballimi i agjërimit në momentet më të nxehta të ditës.
3. Qëndrimi me njerëzit që zgjedhin fjalët më të mira, ashtu siç zgjidhen frutat më të mira.”



Imam Shafiu, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“O dynja dhe ti që pandeh se fiton nder me stolitë e saj! Vdekja do t’i vijë edhe ndërtesës, edhe ndërtesuesit... Kush e sheh dinjitetin e tij tek dynjaja dhe stolitë e saja, ta dijë se dinjiteti i tij është shumë i pakët, i dënuar të zhduket dhe i përkohshëm... Dije se thesaret e dynjasë janë prej ari. Por, ti mblihd thesaret prej besimit, punëve të mira dhe bamirësive!..”



“A ka logjikë që karvanet të ndërtojnë shtëpi gjatë udhëtimit?..”



“Qëndrimi me njerëzit e dhënë pas kësaj bote, e sëmurë edhe më të shëndetshmin!”



“Kush thotë se mund të mbledhë në një vend edhe dashurinë për dynjanë, edhe dashurinë për Allahun, veçse ka gënjer!”



Mevlana ka thënë:

“O udhëtar i së vërtetës! Lidhe miqësinë me Mbretin e të vërtetës (Zotin tënd) para se të vijë Dita e Gjykimit, me qëllim që në ato momente të vështira, të të mbajë për dore, sepse askush nuk të ndihmon dot pa lejen e Tij. Atë ditë njeriu do të largohet nga vëllai, nëna, babai, njerëzit e afërm dhe fëmijët e tij. Prandaj kuptoje drejt miqësinë me Zotin dhe dije se miqësia e ngushtë është thelbi i frymës së fundit.”



“Mos u kap fort pas mallit dhe pasurisë, që të mund t’i lëshosh lehtësisht, kur të jetë e nevojshme... Që t’i dorëzosh e të ikësh kollaj, por edhe që të fitosh sevap. Ti kapu fort pas Atij që të mban fort, sepse Ai është edhe i pari, edhe i fundit! Nëse dëshiron ta gjesh Atë, nxirre dhe hidhe çfarëdo peshe të egos që mund të mbysë anijen e zemrës! Kështu do të arrish shëndosh e mirë në breg!”



“Jeta e dynjasë është veç një ëndërr. Pasuria në dynja, i ngjan gjetjes së thesarit në ëndërr. Ndërsa pasuria e dynjasë, mbetet po në dynja duke u trashëguar nga brezi në brez!”

“Kur meleku i vdekjes i merr shpirtin të pasurit indiferent, e zgjon atë prej gjumit. Ndërsa ai ankohet e rënkon me habi për shkak të vuajtjeve që ka hequr në dynja për një pasuri që në të vërtetë nuk e ka të vetën. Në fund ai bëhet pishman, por ndërkohë çdo gjë ka mbaruar!”



“Dhuro me bollëk prej pasurisë tënde dhe fito një zemër, me qëllim që lutja e saj të japë dritë e të ndriçojë natën e errët!..”

“Pakësoje një pjesë të asaj që ha e pi në këtë botë, për bamirësi, me qëllim që ta gjesh atë më vonë në hauzin e Keutherit! E si mund të shpëtojë gjahu i lumturisë prej atij që derdh një gllënkë në tokën e besnikërisë?..”



“Ai që ia jep zemrën dynjasë, i ngjan gjuetarit që gjuan hije. E si mund të jetë hija pronë e tij?! Gjuetar budalla, hijen e zogut e pandehu si zogun vetë dhe deshi ta kapte. Mirëpo, edhe zogu mbi degë u shastis prej këtij të marri!”



“Në lutje dhe adhurim je me Allahun. Dhe, për dikë që është me Allahun, edhe jeta është e këndshme, por edhe vdekja!..”



Shejh Sadi, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Një njeri të urtë e pyetën:

«Kush quhet fatlum, e kush quhet fatkeq?»

Ai u përgjigj:

«Fatlum quhet ai që ha dhe mbjell. Ndërsa fatkeq quhet ai që (kursen dhe) kur vdes ikën dhe lë gjithçka.»



“Kur babai im ishte duke i dorëzuar shpirtin Allahut, më këshilloi kështu:

«Biri im! Çdo dëshirë egoiste që të largon prej Allahut, është një zjarr i frikshëm, prandaj ruhu prej saj! Mos ia ndiz vetes zjarrin e Xhehenemit! Nëse nuk ke forcë të digjesh në atë zjarr, hidhi ujë që sot me durim!»



“Pashë një beduin, i cili i thoshte të birit:

«Biri im! Ditën e Kiametit do të të pyesin «çfarë fitove?» dhe jo «prej cilit fis je?»! Pra, do të të pyesin për veprat, e jo për prejardhjen!..”



“Njerëzit e mençur e marrin pasurinë dhe pronën me vete kur shkojnë në Botën tjetër. Ndërsa koprracët janë ata që ikin duke e lënë këtu!”



“Mos u zemëro tepër dhe pavend, qoftë edhe me një skllav që është në urdhrat e tua dhe në shërbimin tënd! Ruaj kufijtë dhe mos e tepro, sepse ditën e Mahsherit, nëse skllavi lirohet e ti që je zotëria i tij lidhesh me zinxhirë, do të jetë një poshtërimi i madh për ty!..”



Ebu Hazmi, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Gjeji dhe braktisi veprat, për shkak të të cilave vdekja të duket e papëlqyeshme! Kështu ato nuk do mund të të bëjnë dëm, kurdo që të vdesësh.”



Njëherë **Ibrahim ibn Ed'hem** e pyetën:

“Përse nuk na pranohen duatë?”

Ai u përgjigj:

- ✓ *Allahun e njihni, por urdhrat e Tij nuk i zbatoni!*
- ✓ *Profetin e njihni, por sunnetin e tij nuk e veproni!*
- ✓ *Kuranin e lexoni, por me të nuk punoni!*
- ✓ *Hani nga të mirat që u ka falur Allahu, por nuk falënderoni!*
- ✓ *Xhenetin e dini, por nuk mundoheni ta fitoni!*
- ✓ *Xhehenemin e dini, por nuk shqetësoheni!*
- ✓ *Thoni se ka vdekje, por nuk përgatiteni!*
- ✓ *Të vdekurit i vendosni në varr me duart tuaja, por nuk merrni mësim!*

E si të pranohet duaja me gjithë këto të këqija?!”



Të nderuarin **Hatem-i Esam** e pyetën:

“Kur dhe si mund të bëhemi prej atyre që e shohin botën me syrin e urtësisë, për të marrë mësim?”

Hatem-i Esam u përgjigj:

“Kur të shihni (kuptoni) se fundi i çdo gjëje në këtë botë është shkatërrimi dhe se toka është vendi ku do të shkojmë të gjithë! Nëse dikush nuk merr mësim nga një xhenaze, e cila del nga shtëpia e tij apo e ndonjë të afërmi, atij nuk i bëjnë dobi as dija, as urtësia dhe as këshilla.”



Ebu Hatimi, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Vëllai im! Nëse i shtyn këto katër gjëra për më vonë, hyn në Xhenet:

- ✓ *Gjumin për në varr,*



- ✓ *Rehatinë për në Urën e Siratit,*
- ✓ *Mburrlen para Mizanit / Peshores,*
- ✓ *Dëshirat e egos për në Xhenet.”*



FJALA E FUNDIT

Allahu i Madhëruar, ka caktuar pesë faza për jetën e njeriut. E para është **“alem-i eruah”**, e dyta është **“barku i nënës”**, e treta është **“jeta e dynjasë”**, e katërta është **“bota e varrit/Berzahu”** dhe e pesta është **“Jeta e përjetshme”**, e cila përfundon me Xhenet ose me Xhehenem.

Faza e tretë, që është jeta e dynjasë, është programuar si një botë sprovashe për njeriun. Lumturia ose dënimi i përjetshëm është lidhur pas veprave dhe sjelljeve të njeriut në këtë botë. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا
وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.” (Mulk, 2)

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ ۗ وَنَبْلُوكُم بِالشَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً ۗ وَإِلَيْنَا تُرْجَعُونَ

“Çdokush do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.” (Enbija, 35)

Mirëpo, është shumë e çuditshme se, njeriu, i cili e sheh se freskia dhe gjallëria e çdo qenie të përkohshme bluhet në mënyrë të vazhdueshme në mullirin e kohës, përsëri e mashtron veten e tij në këtë botë ku do të qëndrojë si mysafir vetëm për disa ditë! Megjithëse ai sheh përditë skena të ceremonive mortore, vdekjen e vet e konsideron gjithmonë larg. Madje, ai e pandeh veten si pronarin e amaneteve të përkohshme, por që në fakt mund t’i humbasë në çdo moment.

Sa bukur shprehet Mevlana:

“O udhëtar! Shiko në pasqyrë qëndisjen e fundit, mendo shëmtinë e



një bukurie në pleqëri dhe gërmadhën e një ndërtese, dhe mos u mashtro nga pamja në pasqyrë!..”

Kur shpirtit i vishet rroba e trupit dhe hyn në këtë botë, tashmë njeriu është udhëtar i vdekjes. Ai që është i vetëdijshëm për vdekjen, nuk mashtrohet prej kënaqësive të kësaj bote të përkohshme. Po ashtu, ai që e di se është udhëtar i përjetësisë, nuk dashurohet pas dekorit, zbukurimeve dhe sendeve të vendit ku pushon për një kohë të shkurtër! Sepse sendet i takojnë vendpushimit në dynja dhe nuk mund të ndahen prej saj.

Nëse të gjitha mirësitë e përkohshme do të mblidheshin në një njeri të vetëm dhe ai të jetonte njëmijë vite në lumturi e madhësi, përsëri nuk do t'i bënin dobi!.. A nuk është një gropë e ngushtë në dhe, vendi ku ai do të hyjë më në fund?!

Është e çuditshme se si njeriu është vazhdimisht në kërkim të zjarrtë të një jete më të gjatë në këtë botë, për të jetuar edhe disa ditë më tepër. Mirëpo, ditën e Kiametit, askush nuk do të ketë mall e dëshirë për jetën në dynja. Dëshira e tyre e vetme do të lidhet me veprat me të cilat kanë mundur të zbukurojnë kohën që kanë kaluar në dynja. E në fakt e rëndësishme është se si i ke konsumuar frymët e numëruara kur ke qenë në dynja.

Sado që nga jashtë mund të duket si një grumbull dheu i heshtur, në fakt varri ku do të hyjë biri i njeriut, është një demonstrim i Mahsherit. Varri, për të cilin në hadithet fisnike na bëhet e ditur se do të jetë stacioni i parë i botës tjetër²⁷⁵, do të marrë formë sipas nivelit të bindjes sonë ndaj urdhrave të Allahut në këtë botë. I Dërguari i Allahut ﷺ, e ka shprehur kështu këtë të vërtetë:

“Varri është ose një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, ose një gropë prej gropave të Xhehenemit...” (Tirmidhi, Kiamet, 26)

Siç e kemi shprehur edhe më parë, jeta e kësaj bote është vendi i vetëm ku mund të kryhen vepra për të fituar në botën tjetër të përjetshme. Për rrjedhojë, jeta është një e vërtetë madhështore, e cila nuk mund të kufizohet në distancën mes djepit dhe varrit.

Nëse pyetjes “Çfarë është jeta?”, i përgjigjemi: “Është vetëm lagështira e ftohtë e tokës dhe heshtja e ngurtë e gurëve të varrit”, atëherë çfarë

hidhërimi më të madh mund të ketë se sa një jetë kaq e errët?! Një jetë e tillë, është e mbushur me mall dhe pendesa për lojërat në fëmijëri, për shkujdesjen në adoleshencë, për epshin në rini dhe për ato që tashmë janë humbur, në pleqëri.

Ndërsa besimtarët e urtë, të cilët arrijnë ta shohin jetën dhe ndodhitë prej horizontit të besimit, duke qenë të vetëdijshëm edhe për jetën e vërtetë pas vdekjes, jetojnë me kujdes, butësi dhe ndjenja të larta. Për t'u përgatitur seriozisht për udhëtimin e përjetësisë, është e domosdoshme që tek njeriu të formësohet vetëdija e një besimi të vërtetë, sepse të mirat dhe gjynahet që vepron njeriu në këtë botë të përkohshme, është e sigurt se do t'i shohë në ekranin e Kiametit. I nderuari Mevlana ka thënë:

“Thirri mendjes dhe llogarit këtë ditë të jetës në të cilën gjendesh! Pa shiko, me çfarë dashurish po e harxhon këtë ditë?!”

“Këtë jetë të dobët e kalon herë me hallin e mbushjes së kuletës me para, herë me hallin e ushqimit e pijes!.. Dhe çdo frymë të dhënë po e pakëson!..”

“Çfarë ke, çfarë ke fituar? Çfarë perle ke nxjerrë prej fundit të detit? Kjo do të shihet ditën e vdekjes!”

S'ka asnjë dyshim se, vdekja është një e vërtetë e fortë e së nesërme, e cila do t'i arrijë të gjithë. Supet e dobët të disave nuk mund ta bartin peshën e frikshme të vdekjes! Vdekjet janë mësimë të heshtura dhe urtësi për zemrat e ndjeshme, dhe të vërteta më ndikuese se fjalët më elokuate. Sa kuptime madhështore ka varrosur në heshtje të thellë vdekja me gjuhën e saj! Natyrisht, për ata që mund të dëgjojnë, të shohin e të ndjejnë...

Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë të vërtetë:

Hasan Basriu kishte marrë pjesë në një xhenaze. Kur mbaruan të gjitha punët e varrimit, pyeti një të moshuar që kishte pranë:

“Po të pyes për hir të Allahut. Si thua, vallë a mendon të kthehet përsëri në këtë botë dhe të shtojë punët e mira, dhikrin e të kërkojë falje për gjynahet, ky njeri që ka vdekur?”

Pa hezituar aspak, plaku i thotë: “Po! Sigurisht që mendon!”

Pas këtyre fjalëve, Hasan Basriu thotë:

“Atëherë, po ne pse nuk mendojmë si ky njeri që ka vdekur?”

Më pas, ndërkohë që po ndahej prej aty, thoshte:

“Sa këshilluese e jashtëzakonshme është vdekja! Sa këshillë ndikuese është nëse në zemra do të kishte jetë! Por tek njerëzit të cilëve u thërret, nuk ka jetë!”²⁷⁶



Jeta është si një masur së cilës nuk i njihet metrazihi. Për rrjedhojë, nuk dihet as se kur do të mbarojë, e as ku do të këputet. Vdekja nuk është një takim ku thirren vetëm të vjetrit. Çdo gjallesë që lind është kandidat për të vdekur dhe çdo njeri është në moshë për të vdekur. Nëse shkojmë në një varrezë, do të shohim se atje gjenden shumë të vdekur në moshë më të re se tonën.

Për këtë arsye, lënia e namazit dhe e haxhit për në moshën e pensionit dhe shtyrja e teubes, punëve të mira dhe devotshmërisë për një të nesërme të panjohur, bëhet shkak i një dështimi shumë të hidhur.

Do të vijë një ditë, e cila nuk do të ketë të nesërme! Ajo ditë është e panjohur për të gjithë ne! Allahu i Madhëruar e ka bërë atë të panjohur, me qëllim që ne të jemi të përgatitur çdo moment për atë ditë.

Për këtë arsye, nuk duhet ta harrojmë asnjëherë vdekjen dhe udhëtimin e përjetësisë, por përkundrazi t’i kujtojmë ato sa më shpesh, të meditojmë mbi to dhe të jemi çdo çast gati. Dhe këtë, feja Islame e ka konsideruar si treguesin më të madh të “mençurisë dhe zgjuarsisë” së vërtetë.

Njëherë, një sahab e pyet të Dërguarin e Allahut ﷺ:

“Cili prej besimtarëve është më i mençur o i Dërguari i Allahut?”

Profeti ﷺ u përgjigj:

“Ata që e kujtojnë shpesh vdekjen dhe përgatiten mirë për kohën që e pason vdekjen. Ja pra, ata janë njerëzit më të mençur...” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 31)

Një vdekje e cila vjen me përgëzimet e lumturisë së përjetshme, është fat vetëm i besimtarëve të mençur për të cilët ka folur Profeti ﷺ, sepse këta besimtarë nga hambari i jetës kanë mbledhur vetëm farat së vërtetës, nga kopshti i virtyeteve kanë vjelë vetëm frutat e lumturisë dhe në arën e besimit

kanë mbjellë vetëm farat e falënderimit, mirënjohjes dhe kënaqësisë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“...Jeta e vërtetë, është ajo e Ahiretit! (Lumturia e vërtetë është ajo e Përjetësisë)” (Buhari, Xhihad, 33, Salat, 48, Rikak, 1.9)

Prandaj edhe ne nuk duhet ta harrojmë kurrë se në dynja kemi ardhur për Ahiretin. Duhet të meditojmë shpesh se: “Për ku udhëtojnë gjithë këto krijesa? Për çfarë arsyeje ekziston kjo rrjedhë e ardhjes në dynja, e vajtjes në Ahiret, nga një anë me lindje, e nga ana tjetër me vdekje? Pse kemi ardhur në dynja, në pronën e kujt po jetojmë dhe për ku po udhëtojmë? Si do të jetë përfundimi ynë? A jemi gati për llogaridhënien në Mahsher? Çfarë kemi përgatitur sot për Ahiretin?..”

Allahu i Madhëruar na fton shpesh të meditojmë rreth Kiametit. Në Kuran, na jepen lajme në lidhje me Kiametin, e sidomos në tre xhuzet e fundit. Çfarë do të ndodhë me Tokën, me qiejt dhe me njerëzit?.. Ne duhet të përparojmë në devotshmëri, duke u thelluar sa më shumë në meditimin e këtyre të vërtetave.

Po ashtu, nuk duhet të harrojmë se vdekja, e cila është akti përmbyllës i teatrit të jetës, është si një pasqyrë ku të gjithë do të shohin fundin e tyre të përjetshëm. Prandaj sot, ne nuk duhet ta nxijmë pasqyrën e frymës së fundit me njollat e gjynaheve, indiferencës dhe të këqijave, me qëllim që vdekja të mos na vijë si një fatkeqësi, por si një gëzim takimi.

Mundësia e vetme për ta zbukuruar vdekjen, është të respektojmë ashtu siç duhet urdhrin hyjnor:

وَأَعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ

“**Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!**” (Hixhr, 99)

Atëherë, le të mendojmë njëherë nivelin e devotshmërisë sonë ndaj Allahut:

- ✓ A na çon në Xhenet jeta që po bëjmë?
- ✓ A na e zbardhin faqen në Mizan/Peshore veprat që kemi bërë?
- ✓ A na kalojnë në Urën e Siratit sakrificat që kemi bërë?
- ✓ Kur të pyeten gjynahet e të gjithë atyre, që i kanë djegur e shkru-



mbuar të dyja botët në zjarrin flakërues të mohimit dhe gjynaheve, a kemi ndonjë përpjekje të kumtimit të fesë, që mund të themi: “O Zot! Unë bëra aq sa kisha në dorë!..”?

Allahu i Madhëruar na e bëftë të gjithëve të mundur ta përdorim mirësinë e jetës që na ka falur, në rrugën e kënaqësisë së Tij; të jetojmë në frymëzimin shpirtëror të besimit dhe Kuranit, të japim frymën e fundit si myslimanë, të dalim para Tij duke gëzuar mëshirën dhe faljen hyjnore dhe të nderohemi me Xhenetin dhe shikimin e bukurisë së Tij!

Amin!..

**Lum ata që arrijnë të kthehen tek Zoti i tyre pa u ardhur vdekja!
Lum ata robër të mirë që arrijnë të emigrojnë në përjetësi duke lënë pas zë të mirë në këtë nënqiell!..**

PËRMBAJTJA

PREZANTIM	5
PARATHËNIE	7

PJESA I

UDHËTIMI I PËRJETËSISË / 13

UDHËTIMI I PËRJETËSISË	15
Çdokush do ta shijojë vdekjen!	16
Të përpiqesh të zbukurosh vdekjen	18
Vdekja e secilit do të ketë ngjyrën e tij	22
Ta japësh shpirtin si mysliman	24
Të gjithë janë të shqetësuar	27
Si do të jetë gjendja jonë atë ditë?	33

PJESA II

BESIMI NË BOTËN TJETËR / 37

BESIMI NË BOTËN TJETËR	39
Dynjaja pranë Ahiretit	42
Cila mendje do të zgjidhte “çastin” në vend të “së pafundmes”?!	44
Përgatitja për Ahiret	51
Dobitë e besimit në botën tjetër	54
Si e fton Allahu i Madhëruar para Vetes robin e Tij?	60



PJESA III
VDEKJA / 71

VDEKJA	73
Meditimi i vdekjes	73
Një udhëtim i vetmuar dhe pa kthim	80
Si të jetosh, ashtu do të vdesësh dhe po ashtu do të ringjallesh	82
Për të dhënë frymën e fundit me besim.....	85
Pranë personit që është duke vdekur	93
Çasti i vdekjes.....	94
Pendimi	98
Udhëtimi i shpirtit	104
Udhëtimi i trupit	108

PJESA IV
JETA E VARRIT / 108

JETA E BERZAHUT DHE BOTA E AHIRETIT*	110
JETA E VARRIT	113
Pyetjet e varrit.....	116
Dënimi i varrit	121
Për të shpëtuar prej dënimit të varrit.....	129
Mirësitë e varrit	130
A tyre të cilëve nuk u prishet trupi në varr.....	134
Veprat që duhen bërë pas vdekjes së dikujt.....	139
1. Përgatitja, qefinosja dhe përcjellja	139
2. Pagimi i borxheve	144
3. Respektimi i testamentit	146
4. Lutjet dhe kërkimi i faljes	147
5. Sadakaja dhe dhurimi	155
6. Leximi i Kuranit	157
7. Ngushëllimet	159

Gabimet që bëhen pas të vdekjes së dikujt.....	160
Disa besëtytni në lidhje me xhenazen.....	169
Gabimet që bëhen gjatë vizitave në varreza.....	170

PJESA V

KIAMETI / 175

KIAMETI	177
Shenjat e Kiametit	177
a) Shenjat e vogla dhe të mesme.....	178
1. Dërgimi i Muhamedit ﷺ si profet	178
2. Shtimi i paditurisë në dijet fetare	179
3. Shtimi i fitneve dhe vrasja e njerëzve	181
4. Dhënia autoritet njerëzve të paaftë e pa merita	183
5. Kalimi i shpejtë i kohës	184
6. Shtimi i pasurisë së kësaj bote	185
7. Dobësimi i përshëndetjes me selam.....	186
8. Disa shenja të tjera të Kiametit për të cilat ka lajmëruar Profeti ﷺ	186
9. Do të vijë një kohë e tillë që.....	189
b) Shenjat e mëdha.....	194
1. Duhan-i / Tymi	196
2. Dexhali	198
Cilësitë e Dexhalit.....	206
Për t'u ruajtur prej Dexhalit	208
3. Dabbetu'l-Ard	209
4. Lindja e Diellit nga perëndimi.....	211
5. Zbritja e Isait عليه السلام	213
6. Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët	215
7. Fundosja e tokës në Lindje	
8. Në Perëndim dhe	

9. Në Gadishullin Arabik.....	218
10. Zjarri i madh në Jemen dhe Hixhaz.....	218
SHPËRTHIMI KIAMETIT.....	219
Fryrja e Surit	219

PJESA VI

BOTA TJETËR / 223

BOTA TJETËR.....	225
1. Ba'th (Ringjallja).....	225
<i>Shembujt e ringjalljes në Kuranin Fisnik</i>	<i>232</i>
a) Ringjallja e shpendëve të copëtuar:	232
b) Ringjallja e atyre që vdiqën nga goditja e rrufesë:	235
c) Ringjallja e atij që qëndroi njëqind vjet i vdekur:	235
Hauzi	236
Ringjallja dhe Mahsheri	239
Shefaati (ndërmjetësimi) i Profetit ﷺ.....	242
Zbritja e banorëve të qiellit në tokë.....	250
Shfaqja e Allahut të Madhëruar	251
Ata që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari.....	253
Ata që do të hyjnë në Xhehenem pa dhënë llogari	258
Hapja e librit të veprave.....	261
Llogaria.....	265
<i>Llogaria e kafshëve</i>	<i>265</i>
<i>Llogaridhënia e njerëzve</i>	<i>268</i>
<i>Dëshmitarë të fortë</i>	<i>271</i>
<i>Ashpërsia e llogaridhënies</i>	<i>276</i>
<i>Manifestimi i mëshirës për besimtarët</i>	<i>281</i>
<i>Çfarë do të pyetet?</i>	<i>282</i>
<i>Për të lehtësuar llogaridhënien</i>	<i>287</i>
Mizan	291



<i>Shefaati i besimtarëve, i veprave dhe i Kuranit</i>	295
Ura e Siratit	298
<i>Pritja pas kalimit të Siratit</i>	303
Ata që nuk do të ndjejnë frikë dhe hidhërim.....	304

PJESA VII

XHEHENEMI / 311

XHEHENEMI	313
Tmerri i Xhehenemit.....	314
Dënimi i Xhehenemit.....	317
Do të dëshirojnë të zhduken.....	326
Dera që hapet në Xhehenem:	
Haramet e hapëta dhe të fshehta	327
• Mburrja, Mendjemadhësia:	332
• Smira:.....	335
• Zemërimi:.....	335
• Syefaqsia:	337
• Koprracia:	339
• Shpërdorimi:.....	342
• Hetimi i të metave:	343
• Gënjeshttra:.....	345
• Përgojimi:	346
Ata që shpëtojnë prej Xhehenemit.....	350

PJESA VIII

XHENETI / 355

XHENETI	357
Gjerësia dhe bukuria e Xhenetit.....	360
Mirësitë e Xhenetit	362
Lumenjtë e Xhenetit.....	367

Madhështi dhe përsosmëri, përtej imagjinatës.....	368
Ru'jetullah: Bajrami i shikimit të bukurisë së Allahu	374
Dera që të çon në Xhenet:	
Farzet e hapura dhe të fshehta	376
Farzet e dukshme/të jashtme	376
Farzet e padukshme/të fshehta	381
• Morali i bukur:	382
• Edukata dhe turpi:.....	386
• Pastrimi (Tezkije):	387
• Singëriteti:.....	389
• Meditimi:	390
• Modestia:	392
• Të jesh Emin dhe Sadik:.....	394
• Durimi:	394

PJESA IX

POROSI PËR UDHËTARËT E PËRJETËSISË / 397

POROSI PËR UDHËTARËT E PËRJETËSISË.....	399
FJALA E FUNDIT	409

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Topbas, Osman Nûri
Udhëtimi i përjetësisë:
vdekja, varri, kiameti dhe jeta e përtejme / Osman Nuri Topbash;
përkth. Ilir Hoxha; red. Zija Vukaj, Alban Kali. –
Shkodër: Progresi, 2018
420 f. ; 16 x 23 cm.
Tit. origj.: Ebediyet yolculuglu
ISBN 978-9928-207-22-7

1. Feja islame 2. Përjetësia 3. Vdekja 4. Jeta pas vdekjes

28-12
28-187